INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË

K O S O V A

39
2014

PRISHTINË
2014

REDAKSIA

Prof. assoc. dr. Sabit SYLA (kryeredaktor),

Akademik Beqir META (zëvendëskryeredaktor),

Mr. sc. Arben ARIFI (sekretar shkencor),

Akademik assoc. Marenglen VERLI,

Prof. dr. Sabile BASHA - KEÇMEZI,

Prof. dr. Hamit KABA,

Prof. dr. Haki KASUMI,

Prof. dr. Pëllumb XHUFI,

Prof. assoc. Frashër DEMAJ,

Dr. sc. Gjon BERISHA.

THE INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA

K O S O V A

39
2014

PRISHTINA
2014

PËRMBAJTJA - CONTENTS

Exhlale DOBRUNA - SALIHU
Prania e perëndive të trinisë së mjekësisë dhe e mjekëve
në Dardani.....9
The presence of the trinity of medicine deities and healers
in Dardania……..…..33

Arben ARIFI
Cezaropapizmi i Konstandinit të Madh.....35
Cesaropapisme of Constantine the Great……...57

Skënder GASHI
Mendime rreth prejardhjes së emrave Janjevë e Ceceli.....59
Thoughts on the origin of cognomens Janja and Cecelija……..82

Luan TETAJ
Shqiptarët dhe reformat e Tanzimatit në fillim të shekullit XIX.....83
Albanians and the Tanzimat reformations in the beginning of the
19th century……94

Fitim RIFATI
Shqiptarët në lëvizjen xhonturke (1907 - gjysma e korrikut 1908).....95
Albanians during the Young Turks movement (from 1907 until
mid-july 1908)……..113

Xheladin SHALA
Disa momente të kryengritjes së vitit 1912 dhe marshimi për Shkup
- pushtimi serb i asaj ane.....115
A few historical moments from the 1912 uprising, the march to
Skopje and the Serbian invasion of the region……...…138

Fejzulla Shabani
Trajtimi i çështjes shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në
Londër dhe pasojat gjeopolitike në Ballkan.....139
An analysis of the albanian case at the conference of ambassadors
in London and the geopolitical consequences of it in the Balkans.....154

Hasan BELLO
Kodi Civil Osman dhe trashëgimia juridike osmane në Shqipërinë e viteve 1912 – 1928.....151
The Ottoman Civil Code and the Ottoman legal legacy in Albania in the years 1912 – 1928……..171

Jani SOTA
Kongresi Arsimor i vitit 1920 dhe rëndësia e tij në përcaktimin e fizionomisë kombëtare të arsimit në Shqipërinë e viteve 1920 – 1922.....173
The Congress for Education of 1920 and its importance in defining the structure of the National Education System in Albania 1920 – 1922.....197

Albana MEMA
Parlamenti i parë i zgjedhur në Shqipëri 1921 – 1923.....199
First Parliament Elected in Albania 1921-1923.....225

Anduena SHAHINI (KERTALLI)
Qëndrimi politik i Shqipërisë dhe pengesat e ndeshura në Konferencën e Parë dhe të Dytë Ballkanike.....227
The political stances of Albania and the obstacles encountered at the First and Second Balkan Conference…….....248

Beqir META
Përpjekjet greke në vitet 1936 - 1939 për të rigjallëruar helenizmin në Shqipëri dhe për të dobësuar elementin shqiptar në Çamëri.....249
Greek attempts to revive Hellenization in Albania and to weaken the Albanian element in Çamëria from 1936 until 1939…….273

Nuri DRAGOJ
Vështrim mbi luftën italo - greke dhe pasojat që rrodhën prej saj në trevat jugore të Shqipërisë.....275
Thoughts on the Italian - Greek war and its impact on Southern Albania.....307

Zelihe SHALA
Planet çetnike për shfarosjen e popullatës myslimane dhe shqiptare.....309
Chetnik plans to annihilate the Muslim and Albanian population…...314

Fehmi REXHEPI
Lufta e Dytë Botërore dhe lufta antifashiste në Kosovë.....315
The Second World War And the anti-fascist war in Kosova……..324

Muharrem DEZHGIU
"Vatra" për çështjen kombëtare shqiptare në vitet e Luftës së Dytë Botërore.....327
"Vatra" and its Activities for the Albanian national cause during the Second World War.....335

Sabile KEÇMEZI - BASHA
Organizimi i të burgosurve politikë shqiptarë në burgun e Mitrovicës së Sremit më 1946.....337
The Albanian political prisoners in the prison of Mitrovica of Srem and their organization in 1946……..347

Hamit KABA
Qëndrimi i politikës greke ndaj krizës shqiptaro - sovjetike, 1960 – 1961.....349
The Greek policies in regard to the Albanian - Soviet crisis of 1960 – 1961……..373

Sabit SYLA
Bashkëpunimi Kosovë – Shqipëri.....375
Kosovar - Albanian cooperation……..392

MATERIALE DHE DOKUMENTE

Hatixhe AHMEDI
Tri mbishkrime varresh në qytetin e Preshevës……..397
Three tombstone inscriptions in the city of Presheva……...414

Marenglen VERLI
Me rastin e 50-vjetorit të revistës "Studime historike" (1964 - 2014).....415
On the occasion of the 50th anniversary of the journal "Historical Studies" (1964-2014)

Jorina VERLI
Interesimi dhe ndërhyrja e autoriteteve italiane të pushtimit
mbi problemet fetare në Shqipëri.....423
The intervention of Italian authorities in religious problems in Albania

RECENSIONE

Marenglen VERLI
Kur historia ndau dy popuj fqinj: Shqipëria dhe Greqia
(1912 - 1914).....437
When history divided two neighbouring peoples: Albania and Greece 1912 - 1914

Miftar KURTI
Kontribut i çmuar për historinë dhe historiografinë shqiptare.....441
A valuable contribution to Albanian history and historiography

AKTIVITETE

Teuta SHALA - PELI
Aktivitetet e Institutit të Historisë Prishtinë, gjatë vitit 2013.....447
The activities of the Institute of History in Prishtina during 2013

Exhlale DOBRUNA - SALIHU

PRANIA E PERËNDIVE TË TRINISË SË MJEKËSISË DHE E MJEKËVE NË DARDANI

Monumentet e Dardanisë me paraqitjet figurative dhe dekorative - simbolike si dhe me mbishkrimet e tyre gjatë antikitetit, krahas materialit tjetër arkeologjik, na ofrojnë të dhëna të vlefshme nga shumë aspekte të veprimtarisë së asaj kohe. Në njërën anë këtu janë ato të kultit, ndërsa në anën tjetër ato të varreve. Të parat me të dhënat në fushë të religjionit dhe të dytat me monumentet mbivarrore dhe inventarin e varreve kontribuojnë mjaft në fusha të tjera të jetës së përditshme, në mesin e të cilave një vend me rëndësi zë mjekësia, e cila është pasqyrë e nivelit të kulturës shëndetësore së një treve. Prandaj, kësaj radhe do t'i trajtojmë si monumentet skulpturore të realizuara në reliev dhe skulpturë të plotë të tre perëndive që përbëjnë trininë e mjekësisë: Asklepi (Eskulapi), Higia (Salus) dhe Telesfori, ashtu edhe të dhënat epigrafike dhe të pajisjeve mjekësore, që flasin për praninë e mjekëve, për të parë se sa manifestohej mjekësia përmes këtyre perëndive dhe sa ishte e zhvilluar ajo përmes pranisë së mjekëve gjatë kohës romake në Dardani.

Monumentet e Trinisë së Mjekësisë - i përbëjnë altarët dhe realizimet në skulpturë të plotë.

Altarët

Deri tash disponojmë me katër ekzemplarë: tre nga pjesa qendrore dhe një nga ajo veriore. Mirëpo, vetëm dy janë të realizuar në reliev, të cilët vijnë nga pjesa qendrore dardane. Që të dytë janënga Prizreni dhe i

takojnë tipit me kurorë kubike dhe mbarim të drejtë, por që dallojnë për nga numri i paraqitjes së këtyre perëndive, cilësia e punimit të figurave të tyre dhe ikonografia e Asklepit (Eskulapit). Mirëpo, karakteristikë të përbashkët kanë paraqitjen relievore të njërit, përkatësisht të të tre perëndive në anën e përparme të trupit në mes të mbishkrimit, që shënon unikat në mbarë Dardaninë. Përndryshe, i takojnë grupit më të rëndësishëm të altarëve me dekorim të kësaj treve, të cilin e përbëjnë altarët e zbukuruar në anën e përparme ose në faqet anësore të trupit me figurat e perëndive vetëm, apo me atributet e tyre, ose me simbolet e lidhura me perëndinë e paraqitur në mbishkrim. Deri më tani, së bashku me dy ekzemplarët e cekur, gjithsej kemi tetë ekzemplarë të tillë[1], nga të cilët te dy sish paraqiten figurat e perëndive me atributet e tyre.[2]

Njëri altar, i cili i takon shekullit III, është gjetur në murin e absidës së kishës së Shën Premtes, ku gjendet edhe sot. I skalitur në mermer të bardhë me përmasa 76, 5 x 39 cm është i ruajtur i tëri (fig. 1).[3] Në pjesën e sipërme të trupit, në mes, në një fushë pak të thelluar, në reliev të ulët, është skalitur vetëm figura e Asklepit, e cila është punuar në mënyrë cilësore. Ai ka qëndrim frontal, me këmbën e djathtë të përkulur lehtë në gju e të hedhur pak përpara, ndërsa të majtën e ka tërhequr prapa. Duket se ka flokë të gjatë dhe mjekër. Është i veshur me himation të gjatë deri te nyjat e këmbëve, palat e të cilit janë trajtuar në paralelizëm të plotë. Ai i mbështjellë krejt trupin së bashku me dorën e majtë të mbështetur në shpinë, ndërsa i lë të zbuluar gjoksin dhe dorën e djathtë të lëshuar poshtë, në të cilën mban fjalën. E mu nën sqetullën e këtij krahu e ka vendosur shkopin me gjarprin e përdredhur me kokë të ngritur, në të cilin mbështetet. Mbishkrimi, duke filluar në kurorë dhe vazhduar në të dy anët e paraqitjes figurative dhe përfundi saj është në greqisht dhe i kushtohet Asklepit me epitetin *Soter*, dedikantët e të cilit janë të huaj me prejardhje nga Azia e Vogël.[4]

---

[1] Khr. Exhlale Dobruna - Salihu, *Plastika dekorative dhe figurative e gurit në Dardani gjatë kohës romake*, Prishtinë, 2003-2005, f. 833, n. 355, T. 164, fig. 305, f. 839-834, n. 368, T. 170-171, fig. 316 A-C (nga Smira te Vitia), f. 834, n. 358, T. 166, fig. 308 (nga Peja), f. 840, n. 369, T. 172, fig. 317 A, B (nga Koprivnica afër Nishit) me literaturën e cituar.

[2] Po aty, f. 836, n. 361, T. 167, fig. 311 A-C (nga Llopati te Kumanova), f. 841, n. 371 (nga Runjeva te Kaçaniku) me literaturën e mëhershme.

[3] M. Dušanić, "Asklepijev EX VOTO iz Prizrena", *Živa Antika* (*ŽA*) 33/1, Skopje 1983, f. 27-32, fig. 1; Dobruna-Salihu, *vep. cit*., f. 825-826, n. 339, T. 157, fig. 292.

[4] Khr. M. Dušanić, po aty, f. 31.

Altari tjetër, i gjetur në një shtëpi private dhe i bartur në Muzeun e Maqedonisë në Shkup, po ashtu është i punuar në mermer të bardhë, por me përmasa diç më të vogla: 58 x 22 x 18 cm. I takon shekullit II dhe është i dëmtuar në pjesën e përparme të kurorës dhe një pjese të relievit (fig. 2).[5] Në mes të trupit, në një fushë katërkëndëshe pak të thelluar, janë skalitur figurat e të tri perëndive: Asklepit Higisë dhe Telesforit, punuar në mënyrë mjaft rustike. Asklepi qëndron në pozicion kontraposto dhe është i veshur me himation në mënyrë të ngjashme, por me ndryshim në paraqitjen e palave, të cilat janë mjaft të gjera dhe të modeluara ashpër. Ndërkaq, për dallim, në dorën e djathtë, të shtrirë, mban shkopin me gjarprin e përdredhur, ndërsa të majtën, të lakuar në bërryl, e ka mbështetur në ije. Po ashtu, edhe koka nuk është modeluar në përpjesëtim me trupin, dukshëm është më e madhe me fytyrë në trajtë dardhe, ku mund të dallohen vetëm mustaqet. Flokët janë mjaft të dendur dhe të ndarë në mes, të cilët, duke u bashkuar me mjekrën njësoj të dendur, rrethojnë fytyrën në trajtë kurore, ashtu që kokës i japin pamje rrumbullake, pa analogji në trevat tjera. Pranë tij, në mes, gjendet figura e vogël e Telesforit (*Telesphoros*)[6], i cili, si zakonisht, është i veshur me një mantel të gjatë me kësulë të mprehtë (*paenula cucullata*). Në anën e djathtë të tij qëndron Higia, koka e së cilës është plotësisht e dëmtuar. Ka qëndrim frontal dhe është e veshur në hiton të gjatë dhe himationin mbi të, me pala të trajtuara në të njëjtën mënyrë si në veshjen e Asklepit. Në njërën dorë mban gjarprin dhe në tjetrën paterën, nga e cila e ushqen atë. Te të gjitha figurat gjatësia e veshjes është e njëjtë, duke i lënë të zbuluara shputat deri te kërcini pa detaje të mbathjes, të cilat tek Asklepi janë mjaft të mëdha. Mbishkrimi, i cili fillon përfundi kurorës dhe me pjesën më të madhe të tij vazhdon përfundi paraqitjes figurative, në trup, dhe mbaron në bazament, është në latinisht dhe mund të bëhet se më parë i kushtohet të tre perëndive të

[5] N. Vulić, "Antički spomenici naše zemlje", *Spomenik SKA* 71 (55), Beograd 1931, f. 133, n. 322; M. P. Spiedel, "An alter to the healer gods and the Genius Iuppiter Dolichenus", *Arheološki vestnik* 31, Ljubljana 1980,f. 182-184; Z. Mirdita, *Antroponimia e Dardanisë në kohën romake*, Prishtinë, 1981, f. 261, n. 297; A. et J. Šašel, "Inscriptiones Latinae quae in Iugoslavia inter annos MCMII et MCMXL repertae et editae sunt", *Situla* 25, Ljubljana 1986, n. 1438; Dobruna-Salihu, po aty, f. 836-837, n. 362, T. 168, fig. 312.

[6] Mbi Telesforin, gjeniun e vogël shih: M. A. Bruhl, "Asclépions et Télesphore sur un autel funéraire. Truvé prés de la via Aurelia", *Mélanges d' archéologie et d' histoire* 68, Paris 1956, f. 131 e tutje, n. 3 me literaturën e cituar; B. M. Felletti Maj, "Telesforo", *Enciclopedia dell' arte antica, classica e orientale, Instituto dell'Enciclopedia Italiana*, Roma (*EAA*) 7, 1966, f. 674-675.

paraqitur në reliev dhe dy gjenive, nga të cilët njëri është Gjeni i Dolikenit e tjetri Gjeni i kohortës.[7]

Mbishkrimi i kësaj trinie, po ashtu në latinisht, është i skalitur edhe në altarin e tretë po nga kjo pjesë dardane, të gjetur në Pejë, nga shek. II, me dekorim vetëm të kurorës me një kurorë në qendër, ku kemi të bëjmë me trajtën latine të Asklepit - Eskulap (fig.3).[8] Kurse altari tjetër nga *Timacum minus*-i, nga shek. I, në pjesën veriore, pa dekorime, i përkushtohet vetëm dy perëndive: Eskulapit dhe perëndeshës me emrin *Salus*[9], që është përkthimi latin i emrit të Higisë.[10]

Shikuar nga stili i punimit, duket qartë se këto dy relieve janë vepra të mjeshtërve të ndryshëm, nga të cilët ai i altarit të dytë pa dyshim ka dalë nga dora e mjeshtrit të pashkolluar lokal. Por, me siguri janë krijime të së njëjtës punëtori, e cila gjendej diku rreth Prizrenit të sotëm.[11] Paraqitja figurative e Asklepit, përkatësisht e kësaj trinie në këta dy altarë paraqet të vetmin rast të skalitjes të tyre në reliev në të gjithë Dardaninë dhe në përgjithësi në provincën e Mezisë së Epërme. Sipas evidencës sonë, nga provincat e tjera nuk kemi hasur në ndonjë ekzemplar të tillë të altarëve votivë. Të vetmen analogji, sa i takon kësaj paraqitjeje, e kemi hasur në një cipus romak, i cili ruhet në Muzeun Kombëtar të Romës, karakteri i të cilit nuk është i sigurt, ndoshta është edhe votiv, por që cipusët e karakterit të tillë janë përdorur rrallëherë në ambientin romak. Te ky, në faqen anësore, në një nishe me fronton trekëndësh gjendet paraqitja relievore e kësaj trinie perëndish, por, për dallim nga ekzemplari ynë, Higia (Salus) vjen në rend të parë dhe

[7] Khr. M. P. Spiedel, *vep. cit*. Ndërsa sipas mendimit N. Vulić, *vep. cit*., dhe Z. Mirdita, *vep. cit*., i kushtohet Asklepit vetëm, të dy gjenive dhe ndoshta edhe Solit.

[8] N. Vulić, po aty, f. 112, n. 274; Z. Mirdita, po aty, f. 257, n. 269; A. et. J. Šašel, po aty, n. 1447; E. Dobruna-Salihu, *vep. cit*., 838, n. 365. Ky altar, nga mermeri i bardhë (70 x 25 x 19 cm), i gjetur nga Vuliqi në vitët e 30-ta të shek. XX, sot është i humbur.

[9] N. Vulić, "Antički spomenici naše zemlje", *Spomenik SKA* 75 (58),1933, f. 42, n. 142; P. Petrović, "Timacum Minus et la vallée du Timok", *Inscriptions de la Mésie Supérieure* (*IMS*) 3/2, Beograd, 1995, f. 63, n. 1. Po ashtu nga mermeri i bardhë (0,36 x 0,46 cm) dhe i gjetur në kohën e N. Vuliqit, sot është i humbur.

[10] Khr. R. Marić, *Antički kultovi u našoj zemlji*, Beograd,1933, f. 41; P. Petroviæ, po aty, f. 63, duke shpjeguar se *Salus*, në fakt, ishte perëndeshë e prosperitetit të popullit dhe shtetit romak, por që shumë më vonë identifikohet me Higinë dhe nderohej si perëndeshë e shëndetit.

[11] Khr. A. Mócsy, *Gesellschaft und Romanisation in der römischen Provinz Moesia Superior*, Budapest, 1970, f. 80; E. Dobruna-Salihu, "Stone-carving workshops in Dardania", Actes du Xe Colloque International sur l'Art Provincial Romain (Arles et Aix-en-Provence, 21-23 Mai 2007), *Les atelies de sculpture régionaux: techniques, styles et iconographie*, Arles et Aix-en-Provence, 2009, f. 309.

Asklepi (Eskulapi) në të tretin.[12] Kurse paraqitjen relievore vetëm të Asklepit me Telesforin, pa Higinë, e kemi të pranishme në akroterin e një altari sepulkral nga Roma, që i takon fundit të shekullit II apo fillimit të shekullit III, dedikantët e të cilit i takojnë botës greke.[13] Që të dy këta ekzemplarë si ikonografikisht ashtu edhe stilistikisht dallohen dukshëm nga ekzemplarët tanë.

Për dallim të altarëve, një paraqitje relievore të tillë, sidomos të të tre perëndive së bashku, e hasim shpesh te pllakat votive të provincave fqinje. Kështu, dy shembuj të tillë i kemi nga pjesa veriore e provincës së Maqedonisë: *Astibus*-i (Shtipi i sotëm) me këtë trini, ku në fund të pllakës është gdhendur përkushtimi i Asklepit në greqisht, i cili po ashtu mban epitetin *Soter*[14], ndërsa tjetranga *Ceramia* (Varoshi te Prilepi) vetëm me Asklepin dhe Higinë.[15] Mirëpo, këto pllaka, më të shumta janë në provincat lindore ballkanike, zakonisht me paraqitje të kësaj trinie: Traki, të cilat janë zbuluar në faltoret e Asklepit, që me siguri gjenden në disa vende[16], Mezi të Poshtme[17], Daki, ku është gjetur edhe një tempull[18], si dhe në trevën tjetër danubiane, atë të Panonisë, të cilat me siguri vijnë nga faltoret e kësaj trinie perëndish.[19]

---

[12] P. Rendini, *Cippo con relievi figurati, Museo Nazionale Romano*. *Le sculture* 1/1, Roma,1981, f.. 208-210, n. 16, fig. 3/16.

[13] Khr. M. A. Bruhl, *vep. cit*., f. 126-138, T. 1, fig. 1.

[14] Z. Beldedovski, "Mitraistički spomenici od Sv. NikolskoMacedoniae",*Acta Archaeologica* (*MAA*) 6, Prilep, Skopje, 1979, f. 118-119, fig. 1.

[15] N. Vulić, "Antički spomenici naše zemlje", *Spomenik SAN* 98 (77),1941-48, f. 173, n. 360.

[16] Khr. G. Dobruski, "Trakijsko svetilište na Asklepiji do Glava Panega", *Arheologičeski izvestija na Narodnij muzej vo Sofija* 1, Sofija 1907, f. 15-22, figg. 13-20, f. 27-28, figg. 25-26, f. 33, fig. 27 nga Gllava Panega e sotme; G. Mihailov, *Inscriptiones Graecae in Bulgaria repertae,* III/1, Sofija 1961, T. 17, n. 912, T. 27, n. 934, T. 93, n.1141, T. 104, nn. 1173-1174, T. 105, n.1175 nga Filipopoli; i njëjti, IV, 1966, T. 62, n. 2060, T. 63, nn. 2061, 2062 nga Pautalia; B. Bötyer - B. Döhle - K. Wachtel, *Bulgarien-Eine Reise zu antiken Kulturestätter*, Berlin, 1971, f. 33, fig. 10, f. 34, fig. 11 nga Batkuni i sotëm.

[17] C. Tončeva, "Neizdadeni kultovi pametnici vo varnenskija muzej", *Izvestija na varnensko arheologičesko druževstvo* 9, Varna,1960, f. 71-94, fig. 33 nga Odesi; G. Bordenache, *Sculture greche e romane* 1, Bucureşti1969, f. 18, fig. 18 nga Tomi.

[18] D. Alicu – C. Pop – V. Catanas, "Ateliere de pietrarie la Ulpia Traiana Sarmizegestusa", *Acta Musei Napocensis* (*AMN*) 13,Cluj-Napoca, 1976, f. 125-140 nga Sarmizegetusa, ku janë të shunta.

[19] K. Tomić-Karović, "Tragovi Asjklepijeva (Eskulapova) kulta na teritoriji Jugoslavije", *Rasprave i gradja za povijest nauka* 1,Zagreb, 1963, f. 191, n. 6, fig. 5; V. Dautova-Ruševljan, *Rimska kamena plastika u jugoslovenskom delu provincije donje Panonije*, Novi Sad,1983, ff. 87-88, shën. 3, T. 20, fig. 4 sidomos nga dy

Shikuar nga aspekti ikonografik, dallimet edhe në mes të këtyre ekzemplarëve dhe dy tanëve janë të dukshme. Në rend të parë, te këto pllaka Higia është paraqitur gjithmonë në vend të parë. Por, mbi të gjitha, modelimi dhe cilësia e punimit të këtyre paraqitjeve figurative është krejtësisht tjetër, ku relievet tona janë punuar sipas traditës së artit ilir, që sidomos është e shprehur në altarin e dytë.

Prania e këtyre dy *ex voto* të Asklepit ka ndikuar në shfaqjen e kahershme të idesë së pranisë së faltores së kësaj perëndie në vetë Prizrenin e sotëm, meqë, sipas praktikës që sundonte në botën antike, është edhe e logjikshme të presësh që dhurata votive të tilla të dërgohen në tempullin e perëndisë që ka ndihmuar shërimin ose ruajtjen e shëndetit pas rrugës së mundimshme.[20] Duke u bazuar në faktin se këto *ex voto* nga provincat e tjera në më të shumtën e rasteve vijnë nga faltoret e Asklepit, atëherë është mëse e mundshme që edhe dy altarët tanë t'i kenë takuar faltores së tij, por që lokacioni i saj tash për tash nuk dihet me saktësi.

Mbi të gjitha, këta dy altarë figurativo - epigrafik së bashku me altarin epigrafik nga Peja kushtuar kësaj triade dëshmojnë qartë nderimin e kultit të Asklepit - Eskulapit, përkatësisht të trinisë së cekur, në pjesën qendrore të trevës dardane, si perëndi të shëndetësisë me funksion të shpëtimtarit.

Skulptura e plotë

Monumentet e kësaj trinie të skalitura në skulpturë janë në numër dukshëm më të madh. Deri më sot kemi shtatë ekzemplarë, që të gjithë vetëm nga pjesa veriore dardane. Pos njërit nga Timak minusi, i cili është gjetur në gërmadhat e tempullit romak në kodrën e Shën Trinisë dhe tash i humbur[21], të gjithë janë nga areali i Naisit (*Naissus,* Nishi), të cilët në pesë raste janë gjetur në peristilin e pallatit (vilës) së kohës së vonë romake në Medianë[22] (*Mediana*, Bërzi Brodi), ku gjenden edhe sot. Ekzemplarët e kësaj qendre i përbëjnë statuetat dhe dy grupe statuare, të cilat, pos një rasti me kokë të ruajtur, në të gjitha rastet tjera janë pa kokë dhe me dëmtime në trup. Karakteristika kryesore e tyre

qendrat më të largëta Taurun dhe Akuink.

[20] M. Dušanić, *vep. cit*., f. 30.

[21] N. Vulić, *Spomenik SKA* 75 f. 44, n. 152, 2; i njëjti, *Spomenik SAN* 98, f. 315, n. 108.

[22] A. Jovanović, "Neki aspekti problema skupnog nalaza skulpture sa Medijane kod Niša", *Starinar* 24-25/1973-74, Beograd, 1975, f. 57 e tutje.

është guri shumë cilësor - mermer i bardhë kristalor dhe në dy raste porfir i kuq - cilësia e lartë e punimit dhe, pos një ekzemplari, përkatësia e njëkohshme, çereku i parë i shek. IV. Ndërkaq, për dallim nga altarët, në asnjë rast nuk kemi të bëjmë me grup statuar të trinisë.

Asklepi - Eskulapi *(Asklepios - Aesculapius)* - i takojnë katër ekzemplarë - dy statueta dhe të dy grupet statuare, të cilat u përkasin tipave të ndryshëm. Që të gjithë kanë dëmtime të dukshme. Njëra statuetë është e punuar në porfir. Me gjatësi 43 cm, asaj sot, pos kokës, i mungojnë e gjithë dora e djathtë deri te sqetulla së bashku me atribut, pëllëmba e dorës së majtë dhe nyelli i këmbës së djathtë, ndërsa pjesa tjetër është e ruajtur mirë (fig. 4).[23] Pesha e trupit rëndon mbi këmbën e majtë, ndërsa e djathta me një përkulje të lehtë gjuri qitet pak përpara. Perëndia, si zakonisht, është e veshur me një mantel (himation) me draperi të pasur i cili i lë të zbuluar gjithë pjesën e sipërme të trupit deri në kërthizë dhe mbështjell krejt pjesën e poshtme deri te shputat, prej nga një kind kalon mbi llërën e dorës së majtë dhe me pala të dendura bie deri te nyjat e këmbëve, ndërsa kindi tjetër është hedhur nga shpina mbi supin e majtë dhe me pala vertikale lëshohet përskaj gjoksit deri në brez. Në këmbë mban sandale me rripa. Prapa, ku gjendet një mbështetëse në formë shtyllëze, është trajtuar sipërfaqësisht, që të jep të kuptosh se kjo anë nuk ka qenë e dukshme për shikuesin. Në bazë të shembujve të ngjashëm të shtatoreve nga qendrat e ndryshme të Perandorisë, mund të bëjmë edhe rikonstruksionin e gjithë figurës. Kështu, me dorën e majtë me siguri mbante paterën, e me të djathtën duhet ta ketë mbajtur shkopin me gjarprin e përdredhur rreth tij në të cilin mbështetej, por në rastin tonë duket se dorën e kishte të lakuar në bërryl e të vendosur në ije, meqë këtu kemi një mbeturinë plastike. Së bashku me statuetën është ruajtur edhe bazamenti katërkëndësh membishkrim në greqisht,kushtuar kësaj perëndie, e cila, si zakonisht, mban epitetin Soter.

Kjo figurë e Asklepit ikonografikisht është e afërt me tipin e ashtuquajtur *Florence*, që ka marrë emrin sipas shtatores që ruhet në Galleria degli Uffizi të Firences.[24] Ky tip nga A. Furtwängler-i i

[23] A. Jovanović, po aty, f. 57, n. 1, T. 2, fig. 2; P. Petrović, "Naissus-Remisiana-Horreum Margi", *IMS* 4, 1979, f. 95-96, n. 59; D. Srejović – A. Cermanović-Kuzmanović, *Rimska skulptura u Srbiji*, Beograd, 1987, f. 136, n. 59; M. Tomović, *Roman Sculpture in Upper Moesia*, Beograd, 1993, f. 98, n. 112, fig. 36/1-2; E. Dobruna-Salihu, *Plastika*, f. 843, n. 374, T. 174, fig. 320.

[24] B. Holtzmann, "Asklepios", *Lexicon Iconographicum Mythologiae Classicae* (*LIMC*) 2/1, Zürich-München 1984, f. 878-879, n. 145.

atribuohet Mironit, ndërsa sipas P. Leveque-s e G. Donnay-s i mveshet Kalamisit për *Sikion* (afër Korintit).[25] Sipas Furtwängler-it dhe G. Heiderich-it i të njëjtës prejardhje (sipas të parit nga Mironi, e të dytit nga Kalamisi)[26] duhet të jetë edhe tipii ashtuquajtur *Petersburg*[27], injohur edhe sitip *Campana*[28],i cili ka marrë këtë emër sipas kopjes më adekuate nga koleksioni "Campana" që ruhet në Ermitazhin e St. Peterburgut, ku perëndia me dorën e majtë mban paterën[29], me çka tregon ngjashmëri me statuetën tonë. Kurse për nga pozicioni i dorës së djathtë, të mbështetur në ije, tregon ngjashmëri edhe me tipin e fundit të shekullit IV "Helenistik", i cili i atribuohet Briaksit për *Megarë.*[30]

Paraqitje adekuate figurative të Asklepit vështirë mund të gjejmë, por diç të ngjashme kemi edhe te disa ekzemplarë statuarë dhe relievorë nga pjesët e ndryshme të Perandorisë. Nga të gjithë më së shumti ngjashmëri tregon me katër sosh: shtatoren nga koleksioni "Campana"[31], grupin statuar me Telesforin nga koleksioni i Vila Borgjezes në Romë[32] dhe me dy shtatore nga *Montana* (Mihajlovgradi) në Mezi të Poshtme[33] dhe *Leptis* M*agna* (afër Lebidës)në provincën e Afrikës Prokonsullare[34], me një dallim të vogël në pjesën e përparme të mantelit. Kurse për nga draperia, është shumë e ngjashme edhe me statuetën nga Trakia të gjetur në Batkunin e sotëm (Bullgari).[35] Të afërta me këta ekzemplarë janë edhe disa shtatore me disa ndryshime specifike, që janë të theksuara posaçërisht në pozicionin e duarve, ku e

[25] Khr. po aty, f. 895.
[26] Po aty, f. 986.
[27] M. Bieber, "A Bronze Statuette in Cincinnati and its place in the history of the Asklepios types", *Proceedings of the American Philosophical Society* 101/1, Philadelphia 1957, f. 87, 89. Mbi datimin e këtij tipi dhe autorin e saj janë marrë edhe studiues të tjerë, khr. G. Tončeva, "Skulpturata v Odesos ot V-I vek p.n.e*.", Izvestija na Narodnija muzej v Varna* 4 (20), Varna 1969, f. 10; Lj. Ognenova-Marinova, "Skulpturata ot svetiliščeto na Diana i Apolon", *Montana* 1,Sofija, 1987, f. 49.
[28] B. Holtzmann, *vep. cit*., f. 884.
[29] Khr. M. Bieber, po aty, f. 87, n. 13; G. Tončeva, po aty, f. 9 - 10, shën. 19, fig. 7b.
[30] M. Bieber, po aty, f. 85, 87 (i njohur edhe si tip *Kos);* B. Holtzmann, po aty, f . 895 (i njohur me tipet: *Este, Epidaur* dhe *Velia*).
[31] B. Holtzmann, po aty, f. 878, n. 146; *LIMC* 2/2, f. 46, fig. 146.
[32] E. Höllander, *Plastik und Medizin, Stuttgart*,1912, f. 129-130, fig. 59.
[33] Lj. Ognenova - Marinova, *vep. cit*., f. 49, n. 17, fig. 21.
[34] H. Manderscheid, *Die Skulpturenausstattung der kaiserzeitlichen Thermeaanlagen*, Berlin,1981, f. 104, n. 295, T. 39, fig. 295 (e njohur si tipi *Campana)*.
[35] D. Tsontchev, *La sanctuaire Thrace pres du village de Batkoun*, Institut archéologique Bulgare-Fonds du département de Plovdiv 2, Sofija,1941, T. 30, fig. 118.

majta gjithmonë është e mbuluar. Në mesin e tyre katër sosh janë nga Gadishulli Apenin[36],dhe një grup nga Kirena (*Cyrene*, Shahat) në Libi, ku perëndia dorën e djathtë të lakuar në bërryl (si në rastin tonë), e ka të mbështetur me pëllëmbë në ije, që edhe i afron, ndërsa me tjetrën, të lëshuar teposhtë, mban shkopin në të cilin mbështetet.[37] Te një ekzemplar që ruhet në Muzeun Britanik të Londrës, ku perëndia është paraqitur pa atribute, himationi është i drapiruar në mënyrë mjaft të ngjashme me statuetën tonë, kështu që e gjithë shtatorja nga të gjithë këta ekzemplarë është më e afërta.[38] Një shtatore të fragmentuar, po ashtu, pa atribute, nga e cila është ruajtur vetëm pjesa e sipërme me mbetje të ngjashme të himationit, e kemi nga Amani në Jordani.[39]

Të dy grupet statuare, ku Asklepi është paraqitur me Telesforin, janë të punuara në mermer. Në njërin grup, statuetës së Asklepit i mungojnë edhe qafa, e gjithë dora e djathtë dhe të dy shputat deri te nyelli, së bashku me bazament, kurse pjesa tjetër është e ruajtur mirë me gjatësi 24 cm, (fig. 5).[40] Trupi mbështetet në këmbën e majtë, ndërsa të djathtën të përkulur lehtë në gju e ka tërhequr prapa. Te ky ekzemplar himationi i lë të zbuluar vetëm gjoksin, supin e djathtë me tërë dorën dhe shpatullën e kësaj ane, kurse, duke rënë deri te nyjat e këmbëve, i mbulon pjesën më të madhe të trupit, prej nga njëri kind kalon nën sqetullën e djathtë dhe në kraharor, ku mbështillet në krahun e majtë dhe bie me pala të dendura përgjatë anës së majtë të trupit, kurse kindi tjetër është hedhur mbi supin e djathtë dhe mbulon gjithë dorën e lakuar në bërryl e të mbështetur në shpinë. Pranë këmbës së majtë të perëndisë qëndron Telesfori, pos dy shputave, i ruajtur në tërësi. Ai është trajtuar sipërfaqësisht së bashku me mantelin e zakonshëm të gjerë e të gjatë deri në fund të këmbëve dhe me kësulën e mprehtë.

---

[36] D. Mustilli, *Il Museo Mussolini*, Roma,1939, f. 25-26, n. 20, fig. 70. M. Bieber, *vep. cit*., f. 85-86, figg. 30-31; V. S. M. Scrinari, *Catalogo delle sculture romane, Museo archeologico di Aquilea*, Roma1972, f. 5, n. 9.

[37] E. Paribeni, *Catalogo delle sculture di Cirene - statue e relievi carattere religioso*, Roma,1959, f. 83-86, nn. 202-213.

[38] J. Huskinson, "Roman Sculpture from Cyrenaica in the British Museum", *Corpus Signorum Imperii Romani* (CSIR), Great Britain 2/1, London,1975, f. 11, n. 20, T. 8, fig. 21.

[39] E. A. Frieland - R. H. Tykot, "Quarry Origins, commission and import of the marble sculptures from the Roman Theater in Philadelphia/Amman, Jordan", *Interdesciplionary Studies on Ancient Stone*. Proceedings of the IX ASMOSIA Conference (Tarragona 2009), Tarragona, 2012, f. 55, fig. 3.

[40] A. Jovanović, *vep. cit*., f. 58, n. 5, T. 5, fig. 6; D. Srejović – A. Cermanović-Kuzmanović, *vep. cit*. f. 140, n. 61; M. Tomović, *vep. cit*., f. 99, n. 144, fig. 35/3; E. Dobruna-Salihu, *Plastika*, f. 843-844, n. 375, T. 175, fig. 321.

Kjo mënyrë e paraqitjes së figurës së Asklepit ikonografikisht i përgjigjet tipit të ashtuquajtur *Neugebauer*, të njohur mirë, i cili ka marrë këtë emër sipas studiuesit që e ka shkruar veprën më komplete për paraqitjet figurative të kësaj perëndie.[41] Ajo është mbaruar sipas modelit të *AsklepiosGiustini* - kopjes së bukur nga fillimi i shekullit IV p. l. k., e cila sipas D. Mustillit është bërë në bazë të origjinalit në bronz, ndoshta mu shtatores së faltores së Asklepit *(asklepieion)* në pjesën jugore të Akropolit në Athinë, që është vepër e krijuesit atikas Alkamen në vitin 420 p. l. k.[42] Në kohën romake janë të njohura një mori kopjesh të këtij tipi, të cilat zakonisht në vend të Telesforit e kanë të paraqitur omfalin *(omphalos).* Një numër i madh i tyre është zbuluar në Itali[43], nga të cilët ekzemplarët më të bukur vijnë nga Roma[44], që veçanërisht e dëshmon ai nga ujdhesa në lumin Tiber që ruhet në Muzeun Kombëtar të Napolit.[45] Shtatore të ngjashme gjenden edhe në qendrat dhe muzetë e tjera, në mesin e të cilave në Muzeun e Luvrit perëndia është paraqitur me Telesforin.[46] Një numër i madh shtatoresh të këtij tipi është zbuluar edhe në fqinjësi të Dardanisë, në territorin trak të provincave të Mezisë së Poshtme[47] dhe sidomos të Trakisë[48], ku në të shumtën e rasteve kjo perëndi është paraqitur vetëm, kurse në një ekzemplar nga *Philippopolis*-i (Plovdivi) kemi të bëjmë po ashtu me grup statuar së bashku me Telesforin, të paraqitur në të njëjtin pozicion me grupin tonë.[49]

Nga grupi tjetër statuar ka mbetur vetëm statueta e Asklepit e gjatësisë 52 cm, me gjurmët e shkopit me gjarprin e përdredhur dhe shputa e këmbës së djathtë të Telesforit, së bashku me bazamentin

[41] M. Bieber, *vep. cit*., f. 73.
[42] D. Mustilli, *vep. cit*., f. 118-119.
[43] Khr. E. Höllander, *vep. cit*., f. 64, fig. 17, f. 80, fig. 31; M. Bieber, *The Sculpture of the Hellenistic Age*, New York, 1955, f. 74-75, figg. 6, 8; V. S. M. Scrinari, *vep. cit*., f. 5, n. 8.
[44] M. Bieber, po aty, f. 74, fig. 7, f. 89, nn. 37-38.
[45] A. Furtwängler – H. L. Urlichs*, Denkmäler Griechischer und Römischer Skulptur*, München, 1911, T. 10; M. Bieber, po aty, f. 74, fig. 5.
[46] W. Fröehner, *Notice de la sculptura antique du Louvre*, Paris,1878, f. 369, n. 400.
[47] G. Bordenache, *vep. cit*., f. 16-18, nn. 6-8.
[48] D. Tsontschev, *La sanctuaire Thrace pres du village de Batkoun, Institut archéologique Bulgare-Fonds du département de Plovdiv 2*, Sofija1941, T. 29, fig. 14, T. 30, figg. 119-120; G. Tončeva, "Neizdadeni kultovi pametnici vo varnenskija muzej", *Izvestija na varnensko arheologičesko druževstvo* 9, Varna,1960, f. 89, fig. 32.
[49] B. Djaković, "Frizja na zdravenosnite božestva", *Glasnik na Naradnaja Biblioteka v Plovdiv* 1, Plovdiv1921, f. 135-136, fig. 2.

elipsoid të thyer me një pjesë në anën e djathtë (fig. 6).[50] Statueta këtu ka edhe kokën, e cila sot është e shkëputur nga trupi dhe e thyer në qafë dhe shumë e dëmtuar në pjesën e sipërme. Mirëpo, me gjithë këtë dëmtim, mund të vërehet fytyra e perëndisë me fizionomi të burrit të moshës mesatare me mjekër të shkurtër dhe të ndarë në mes, e cila bashkohet me mustaqet dhe flokët e gjatë që bien mbi supe. Statuetës sot i mungojnë e gjithë dora e djathtë dhe pëllëmba e dorës së majtë me një pjesë të parallërës. Pesha e trupit rëndon mbi këmbën e majtë, ndërsa e djathta është e përkulur lehtë në gju dhe e tërhequr pak prapa. Himationi i mbulon tërë trupin deri në fund të këmbëve, duke i lënë të zbuluar vetëm supin dhe dorën e djathtë së bashku me pjesën e gjoksit të kësaj ane. Me pëllëmbën e dorës së majtë, të lakuar në bërryl, me siguri mbante kindin e himationit. Në këmbë mban sandale rripash. Në bazamentin eliptik gjendet dedikimi i graviruar në greqisht, ku perëndia mban po ashtu epitetin *Soter.*

Në bazë të mbetjes së kësaj statuete mund të bëjmë rikonstruksionin e këtij grupi statuar. Asklepi me siguri me dorën e djathtë ka mbajtur shkopin, në të cilin edhe mbështetej, kurse pranë këmbës së majtë qëndronte Telesfori. Duket se kjo paraqitje e perëndisë ikonografikisht mund të lidhet me tipin e statuetes së dytë, ndërsa sipas modelimit të draperisë me një variant të tipit të statuetes së parë.[51] Veshjen e drapiruar në mënyrë shumë të ngjashme e gjejmë në një grup statuar nga *Miletos*-i (Balati) në Kari (Azi të Vogël) të kohës së Antoninëve, që ruhet në muzeun Arkeologjik të Stambollit. Dallimi në mes ekzemplarit tonë dhe këtij qëndron në pozicionin e duarve*,* meqë në këtë rast Asklepi shkopin e mban në dorën e majtë, kurse të djathtën e ka vendosur në ije.[52] Për nga qëndrimi, përkatësisht pozicioni i trupit dhe nga modelimi i veshjes, të ngjashme janë edhe disa shtatore nga Kirena.[53] Në mesin e tyre gjendet edhe ekzemplari i cekur më herët që ruhet në Londër, i cili sipas pozicionit të dorës së majtë është mjaft i ngjashëm me statuetën tonë.

Sa i takon ekzemplarit të katërt të Asklepit, shtatores nga Timak minusi, punuar në mermer të bardhë, edhe pse për shkak vetëm të gjurmëve vështirë mund t'i përcaktohet tipi, bazuar në mbeturinat e

[50] A. Jovanović, *vep. cit*., f. 58, nn. 3, 4, T. 4 figg. 4, 5; P. Petrović, *Nissus*, f. 96, n. 60; D. Srejović – A. Cermanović-Kuzmanović, *vep. cit*., f. 142, n. 62; M. Tomović, *vep. cit*., f. 88-89, n. 113, fig. 35/4; E. Dobruna-Salihu, *Plastika*, f. 844, n. 376, T. 175, fig. 322.
[51] Khr. B. Holtzmann, *vep. cit*., f. 884-885 i ashtuquajtur tipi *Tunis*.
[52] E. Höllander, *vep. cit*., f. 135, 137, fig. 65.
[53] E. Paribeni, *vep. cit*., f. 84, nn. 202-204, 207.

shkopit me gjarprin e përdredhur në anën e djathtë mund të konstatohet pozicioni i kësaj perëndie, e cila pa dyshim në këtë anë mbështetej në të.[54]

Higia *(Hygieia)* - është e skalitur në tri statuetat tjera, të cilat po ashtu janë punuar sipas modeleve të veçanta dhe u takojnë tipave të ndryshëm. Mirëpo janë të ruajtura më mirë se ekzemplarët e Asklepit. Njëra statuetë me gjatësi 49 cm, e cila është punuar në porfir, së bashku me atribute dhe bazamentin katërkëndësh me mbishkrimin në greqisht është e ruajtur mjaft mirë (fig. 7).[55] Pesha e trupit rëndon mbi këmbën e majtë, ndërsa të djathtën, të përkulur lehtë në gju, e ka tërhequr paksa prapa. Perëndesha është e veshur me hiton të gjatë, i cili i bie deri në fund mbi bazament dhe shputat e këmbëve, ku duken vetëm gishtërinjtë. Mbi të ka hedhur himationin deri pak mbi gjunjë. Ai mbulon tërë pjesën e sipërme të trupit së bashku me të dy duart deri te pëllëmba, me ç'rast një kind me pala të dendura bie mbi llërën e dorës së majtë, duke u lëshuar poshtë deri përfundi gjurit. Që të dy duart janë të lakuara në bërryla, ku në të majtën mban paterën, e në djathtën gjarprin e mbështjellë rreth llërës. Ana e prapme e figurës është trajtuar plotësisht sipërfaqësisht dhe në mes për së gjati ka një mbështetëse në trajtë shtyllëze. Megjithëse paraqitjet figurative të Higisë, qoftë në skulpturë të plotë, qoftë në reliev, gjenden nëpër të gjithë Perandorinë, modeli sipas të cilit është punuar kjo statuetë nuk është i njohur.

Statueta tjetër nga i njëjti vend, me gjatësi 35 cm, e cila është punuar në mermer kristalor, është e ruajtur shumë mirë, përveç thyerjes së pëllëmbës së dorës së majtë, në të cilën mbante atributin, dhe të bazamentin, (fig. 8).[56] Pesha e trupit rëndon mbi këmbën e djathtë, ndërsa të majtën, të përkulur lehtë në gju, e ka tërhequr pak prapa. Perëndesha, po ashtu, është e veshur në hiton të gjatë deri në fund të këmbëve, që i mbulon edhe shputat, ndërsa nën gji shtrëngohet me një brez. Sipër ka hedhur himationin e shkurtër deri përmbi gju të këmbës së majtë, i cili prapa i mbulon tërë shpinën, ndërsa përpara një kind i tij mbulon dorën e majtë, kurse kindi tjetër, duke kaluar nga supi dhe krahu i djathtë në gjoks dhe në llërën e dorës së majtë, për të rënë poshtë me

[54] Khr. E. Dobruna-Salihu, *Plastika*, 845, n. 377.

[55] A. Jovanović, *vep. cit*., f. 57-58, n. 2, T. 3, fig. 3; P. Petrović, *Naissus*, f. 97, n. 61; D. Srejović - A. Cermanović-Kuzmanović, *vep. cit*., f. 138, n. 60; M. Tomović, *vep. cit*., f. 98, n. 111, fig. 27/1-2; E. Dobruna-Salihu, *Plastika*, f. 845, n. 378, T. 176, fig. 323.

[56] A. Jovanović, po aty., f. 59, n. 15, T. 12, fig. 16; D. Srejović - A. Cermanović-Kuzmanović, po aty, f. 144, n. 63; M. Tomović, po aty., f. 97-98, n. 110, fig. 28/5-6; E. Dobruna-Salihu, po aty, f. 845- 846, n. 379, T. 176, fig. 324.

pala vertikale, mbulon krejt pjesën e sipërme, pos gjirit të majtë. Të dy duart i ka të lakuar në bërryla, ku me të djathtën mban njërin kind të himationit, ndërsa në tjetrën mbante paterën.

Paraqitjet e ngjashme statuare të grave janë të rralla në Perandorinë Romake, kurse në mungesë të atributit është vështirë të thuhet se në të vërtetë kush fshihet pas tyre. Me këto tipare, kjo statuetë, ka ngjashmëri më së shumti me dy shtatore: një nga *Sarmizegetusa* (Varhelia) në Daki[57] dhe një nga Muzeu i Qytetërimit galo - romak të Lionit.[58] Që të dy ekzemplarët janë pa kokë dhe pa atribute, siç e kemi edhe në një ekzemplar nga Muzeu Arkeologjik i Aleksandrisë.[59] Një paraqitje e tillë, pra, vështirëson identifikimin e tyre. Mirëpo, te një shtatore e tillë nga Shiragani i sotëm (Francë) në Gali, që ruhet në Muzeun e Tuluzës (Francë), cila me qëndrim dhe mënyrë të veshjes është shumë e ngjashme me statuetën tonë, në reliev është paraqitur edhe gjarpri i ngritur, bishti i të cilit gjendet në dorën e djathtë të hyjneshës, kurse koka ngjitur për skaj të hitonit në gjoks. Prandaj, në bazë të këtij atributi, në këtë rast, e njohim Higinë.[60] Edhe dy shtatore të ngjashme janë identifikuar me Higinë, prej së cilave njëra gjendet në Romë dhe tek e cila ka mbetur vetëm koka e gjarprit, kurse tjetra në Gliptotek të Mynihut.[61] Mirëpo, gjatë shekullit II p. l. k. në të njëjtin tip statuar është futur edhe një muzë nga Mileti dhe perëndesha Izida nga Muzeu i Kapitolit në Romës.[62] Kjo tregon qartë se tipi i njëjtë statuar është përvetësuar për paraqitjen e të tri perëndeshave.

Sa i takon modelit sipas të cilit janë punuar këto shtatore ekzistojnë dy mendime: sipas njërit një dritë mund ta hedhë studimi i pesë shtatoreve, të cilat paraqesin Izidën ose figurat iziake[63], kurse sipas

[57] D. Alicu – C. Pop – V. Wollman, *Figured Monuments from Ulpia Traiana Sarmizegetusa, BAR International Series* 55, Oxford 1979, f. 135, n. 333, T. 57.
[58] E. Espérandieu, *Recueil général des bas-reliefs, statues et bustes de la Gaule romaine, 8*, Paris et Bruxelles,1937, f. 21, n. 1763.
[59] M. Bieber, *Ancient Copies, Contributions of the History of Greek and Roman Art*, New York,1977, f. 128, T. 759; L. Guerrini – C. Gasparri, *Collezioni romane di antichita il Palazzo del Quirinale*, Roma,1985, f. 61-62, fig. 14.
[60] E. Espérandieu, *Recueil général*, 2, 1908, f. 52, n. 931.
[61] M. Bieber, po aty, T. 128, nn. 760, 763.
[62] Cf. C. Pietrangeli, *Musei Capitolini, I monumenti dei kulti orientali*, Roma, 1951, f. 50, n. 7; H. Manderscheid, *vep. cit*., f. 95, n. 218, T. 31; L. Guerrini – C. Gasparri, po aty, f. 61-64, fig. 14.
[63] L. Guerrini – C. Gasparri, po aty, f. 61-64, fig. 15.

mendimit tjetër origjinali grek është formuar në fundin e shekullit V p. l. k., nën ndikimin e drejtpërdrejtë të Fidias dhe shkollës së tij.[64]

Duke u nisur nga fakti se statueta jonë sipas pozicionit të duarve dhe të këmbëve, si dhe mënyrës së mbajtjes së himationit u përngjan paraqitjeve të Higisë, atëherë, me gjithë mungesën e gjarprit, të cilin në këtë rast gjithsesi duhet ta ketë pasur, apo ndoshta mjeshtri nuk ka arritur ta skalisë, mendojmë se gjen shprehje perëndesha Higia - Salus.

Statueta e tretë e kësaj perëndeshe është gjetur në Klisurë te Nishi. E punuar po ashtu në mermer kristalor, me gjatësi 56 cm, është më e dëmtuar, (fig. 9).[65] I mungojnë një pjesë e supit të majtë, një pjesë e vogël e anës së djathtë poshtë, të dy shputat së bashku me bazament. Pesha e trupit edhe këtu rëndon mbi këmbën e djathtë, ndërsa e majta është e përkulur lehtë në gju dhe e tërhequr diskret nga prapa. Është e veshur, njëjtë, në hiton të gjatë dhe himation mbi të deri përfundi gjunjëve, i cili i mbështjellë pjesën më të madhe të trupit me dy duart, pos pëllëmbëve dhe pjesës së majtë të gjoksit. Me dorën e majtë, të lakuar në bërryl dhe të ngritur në lartësi të gjoksit, mban bishtin e gjarprit të paraqitur sipërfaqësisht përgjatë skajit të himationi, kurse të majtën, të lëshuar poshtë e të mbështetur në ije, mban kokën e gjarprit.

Modeli sipas të cilit u punua kjo shtatore është i qartë, ai ka të bëjë me klishenë e njohur të "Herkulanës së Madhe". Mirëpo, meqë ajo ikonografikisht nuk lidhet me paraqitjet e Higisë, por me shtatoret e grave me qëndrim dhe veshje të këtij tipi, të cilat në të shumtën e rasteve paraqesin romaket e klasës së lartë ose perandoreshat[66], atëherë skulptori rreth skajit të mantelit në gjoks e ka shtuar gjarprin. Nga materiali i publikuar deri më tash, nuk kemi hasur në shembuj të tillë në trevat e tjera. Sipas cilësisë së punimit dhe llojit të gurit, i cili nuk është i kësaj ane, këto vepra skulpturore u punuan në atelie të ndryshme. Të gjithë ekzemplarët e Medianës, të cilët paraqesin vepra me cilësi të larta artistike, janë krijime të atelieve të njohura të qendrave të mëdha, prej nga u importuan. Lloji i mermerit kristalor me kokrriza të imta tregon se ato u punuan në njërën nga punëtoritë e Greqisë, përkatësisht të Athinës[67], ndërsa porfiri flet se të dy ekzemplarët janë realizime të të

[64] D. Srejović – A. Cermanović-Kuzmanović, *vep. cit*., f. 144.
[65] D. Srejović – A. Cermanović-Kuzmanović, po aty., f. 156, n. 69; M. Tomović, *vep. cit*., f. 97, n. 109, fig. 28/1; E. Dobruna-Salihu, *Plastika*, f. 846, n. 380, T. 176, fig. 325.
[66] Për tipin e shtatoreve të "Herkulanës së Madhe" shih.: M. Collignon, *Les statues funéraires dans l'art Grec*, Paris,1911, f. 168-170, fig. 99.
[67] Khr. A. Cermanović-Kuzmanović, "Rimska skulptura u Srbiji", *Grčko-rimska antika vo Jugoslavija i na Balkanot* - prilozi od 5-iot Naučen sobir na Sojuzot na

njëjtës punëtori të Egjiptit, para së gjithash të Aleksandrisë, ku skaliteshin shtatoret e perandorëve[68], në të mirë të së cilës flet edhe funksioni i dedikantit.[69] Kurse ekzemplari nga Klisura, edhe pse u punua nga mermeri kristalor me kokrriza të mëdhenj të guroreve të Azisë së Vogël, paraqet vepër të ateliesë lokale të Naisit aty nga fundi i shekullit III dhe fillimi i shekullit IV.[70]

Të gjithë këta ekzemplarë dëshmojnë nderimin e kultit të kësaj trinie perëndish në arealin e Naisit. Madje faltorja ka mundur të ishte rreth burimeve termale në Banjën e sotme të Nishit, ku duket se ishin të vendosura këto statueta dhe grupe statuare, prej nga mandej janë bartur në një vend kulti të Medianës.[71] Ato së bashku me statuetën e Asklepit dhe altarin e përkushtuar Eskulapit dhe Salus nga Timak minusi, flasin për nderimin e tyre në të gjithë pjesën veriore dardane.

Të dhënat e pranisë së mjekëve - i përbëjnë monumentet epigrafike dhe pajisjet mjekësore.

Monumentet epigrafike

Fjala është për një stelë mbivarrore të fundit të shek. II dhe fillimit të shek. III nga Timak minusi e cila i kushtohet mjekut vendës të njësisë ushtarake - kohortës II *Aurelia Dardanorum*[72], ku, pos këtij epitafi, është skalitur edhe gjarpri i mbështjellë rreth shkopit, që paraqet rastin e vetëm në Dardani dhe në monumente të këtij lloji rrallë haset edhe në trevat e tjera. Nga ato të Ballkanit një shembull të tillë e kemi nga ishulli *Dellus* në Greqi, ku fjala është për një cipus kuadratik po ashtu nga koha romake, tek i cili ky motiv është gdhendur në qendër të anës së përparme, në mes të të dy pëllëmbëve.[73] Rëndësia e këtij motivi

društvata za antički studii na Jugoslavija (Skopje 26-29 septembri 1989), Posebni izdania, *ŽA* 9, 1991, f. 224, ku vetëm ekzeplarët e rrallë mund të jenë prodhim vendës.

[68] Zs. Kiss, *Études sur le portrait Impérial romain en Egypte*, Varsovie, 1984, f. 100, 102.

[69] Khr. P. Petrović, *Naissus*, f. 79.

[70] Khr. D. Srejović – A. Cermanović - Kuzmanović, *vep. cit*., f. 156; M. Tomović, *vep. cit*., f. 97, 99.

[71] A. Jovanović, *vep. cit*., f. 63.

[72] P. Petrović, "Timacum minus", f. 97, n. 49; E. Dobruna-Salihu, *Plastika*, f. 780, n. 257 me literaturën e cituar. Mbishkrimi: *D(is) M(anibus) / T. Ae[l(io)] Mar/tia[l(i)] med(ico) /co[h(ortis)] II Aur(eliae) / Dar(danorum)*.....

[73] B. Avezou - Ch. Picard, "Inscriptions de Macédoniene et de Thrace", *Bulletin de*

qëndron në faktin se flet qartë për ndërlidhjen e ngushtë të atributit të Eskulapit me profesionin e të ndjerit gjatë jetës, duke u bërë edhe simbol i mjekësisë.

Kjo stelë, e cila na e zbulon praninë e mjekut ushtarak nga Timak minusi, ku qëndron edhe vlera e veçantë e saj, jo vetëm në Dardani, por në të gjithë Mezinë e Epërme paraqet rastin e vetëm të monumenteve të mjekëve. Kurse nga treva tjetër ilire, ajo e provincës së Dalmacisë, në *Salona* (Solini) janë gjetur tri monumente mbivarrore epigrafike dhe një me skalitje të instrumenteve medicinale[74], ndërsa nga treva iliro - panone e provincës së Panonisë vetëm një stelë epigrafike e mjekut ushtarak nga *Siscia* (Sisaku)[75], kurse nga pjesa tjetër e kësaj province disa sosh të mjekëve ushtarakë janë të pranishme në *Aquincum* (Ó Buda)[76]. Nga qendrat e afërta të provincave lindore fqinje dy monumete të mjekëve ushtarak vijnë nga *Montana* (Mihajlovgradi) në Mezi të Poshtme dhe *Turnu Severin* (Drobeta) në Daki të Poshtme.[77] Ndërkaq, nga të gjitha provincat e perëndimit latin - Evropë dhe Afrikë e Veriut - kohë më parë, janë dëshmuar rreth 403 mbishkrime të mjekëve, me numrin më të madh në Romë[78] të cilët, edhe si mjekë ushtarakë në të shumtën e rasteve, ngjashëm me stelën tonë, mbajnë vetëm titullin *medicus.*[79]

Pajisjet mjekësore

Këto pajisje dolën në dritë në varrin e zbuluar në nekropolin lindor të Skupit gjatë gërmimeve të viteve 1970 - 1971, ku po ashtu fjala është për mjek vendës. Në këtë varr, të muruar me tulla dhe të lyer me llaç, i cili i takon ritit me vendosje trupi nga çereku i dytë i shekullit II në bazë të gjetjes së monedhës së Hadriani, pranë skeletit në grumbull kanë

correspondence hellénique 37/1-6, Atenes-Paris, 1913, f. 111, fig. 7.

[74] N. Cambi, "Prilozi poznavanju antičke medicine u Dalmaciji", *Acta historie medicine, stomatologie, pharmacie, veterine*, Trogir, 1987, figg. 1, 2, 5, 7.

[75] Z. Gregel, "Rimski medicinski instrumenti iz Hrvatske", *Histria Antiqua* 14, Pula, 2006, f. 34-35, fig. 8.

[76] Khr. P. Milošević, "Rimski nalazi u Savi kod Sremske Raće", *Starinar* 31/1980, 1981, f. 38

[77] Khr. M. Korać, "Medicus et chirurgus ocularius iz Viminacijuma", *Starinar* 37, 1986, f. 70, shën. 205, 207.

[78] H. Gummerus, *Der Arztestand im römischen Reiche nach den Inschriften, Commentationes Humanarum Literarum* 3, Helsingfors, 1932, f. 103.

[79] Khr. R. W. Davies, *The Medici of the Roman Armed forces*, Epigraphische Studies 8, Düsseldorf, 1969, f. 83 e tutje.

qëndruar instrumentet mjekësore, kryesisht kirurgjike, ngahekuri, bronzi, plumbi, argjendi dhe gjami, së bashku me ilaçe, si inventar i të ndjerit, të cilat më parë kanë qenë të futura në një kuti druri.[80] Instrumentet mjekësore të punuara nga materiale të ndryshme, por gjithnjë duke dominuar bronzi, ishin gjë e zakonshme gjatë antikitetit.[81] Po ashtu edhe ruajtja dhe bartja e instrumenteve kirurgjike në kuti druri ishte rregull e botës antike, traditë kjo e cila është ruajtur deri vonë.[82]

Kjo gjetje deri tash paraqet rastin e vetëm në Dardani dhe në tërë Mezinë e Epërme të katërtin, ku të tri varret tjera janë nga *Viminacium*-i (Kostolci): njëri i gjetur në shekullin e XIX, tjetri pa precizim të varrit[83], kurse i treti është gjetur në vitet e '80-ta të shekullit XX, i cili i takon një kirurgu okular (ushtarak apo civil ?) nga fundi i shek. I apo fillimi shek. II, ku është gjetur kutia katërkëndëshe e bronzit me ilaçe dhe instrumente mjekësore në kapak, të cilat më parë ishin të vendosura po ashtu në kuti druri.[84] Këto varre po ashtu të pakta janë edhe në provincat fqinje: në Dalmaci një nga *Aenona* (Nini)[85] dhe një nga rrethi i Stocit të sotëm[86], kurse në Maqedoni një nga rrethina e Ohrit.[87] Varret e mjekëve të periudhës romake, të evidentuara në tërë Perandorinë nga studiuesi Ernst Künzl (78 sosh) me rastin e trajtimit të instrumenteve mjekësore (*dhe farmaceutike*) të gjetura në këto varre në punimin studioz të tij - i cili është themel për të gjitha hulumtimet e këtyre instrumenteve gjatë antikitetit - më të numërta janë në provincat veriore dhe verilindore. Pos në këto varre, një numër i madh i instrumenteve mjekësore dhe ilaçeve ka dalë në dritë edhe në lokalitete të ndryshme me gjetje të rastit në mbarë Perandorinë. Nga provinca fqinje e Dalmacisë të numërta janë nga *Jader*-i (Zara), Salona dhe Enona, të cilat ruhen në muzetë Arkeologjike të Zarës dhe Splitit[88], ndërsa në pjesën iliro - panone të

[80] I. Mikulčić, "Ranorimski skeletni grobovi iz Skupi", *Starinar* 24-25/1973-74, 1975, f. 91-92.

[81] E. Künzl, "Medizinische Instrumente aus Sepulkralfunden der römischen Kaiserzeit", *Bonner Jahrbücher* 182, 1982 Bonn, f. 15-29.

[82] E. Benion, *Stari medicinski instrumenti*, Beograd 1979, f. 106, fig. 11, f. 110, fig. 4, f. 130, fig. 21, f. 174, fig. 23.

[83] E. Künzl, *vep. cit*. f. 109-110.

[84] M. Korać, *vep. cit*., f. 53 e tutje.

[85] M. D. Grmek – S. Čmelik "Kemijski sastav antičke pilule iz Nina", *Vjesnik za arheologiju i historiju dalmatinsku* (*VAHD*), Split 54, 1952, f. 128-137.

[86] Z. Gregl, "Rimski medicinski instrumenti iz Hrvatske" I, *Vjesnik Arheološkog muzeja u Zagrebu* (*VAMZ*), 3. s.15,Zagreb,1982, f. 177.

[87] V. Lahtov, "Slučaen nalod na "Gorica" kraj seloto Leskoec Ohridsko", *Situla* 4, Ljubljana, 1961, f. 57 e tutje.

[88] *Muzeji i zbirke Zadra*, Zagreb 1954; S. Ivčević, "Antički medicinsko-farmaceutski

Panonisë një numër kolosal është nga Siscia, ku edhe prodhoheshin, të cilat ruhen në Muzeun Arkeologjik të Zagrebit, i cili me mbi 900 eksponate paraqet njërin ndër koleksionet më të mëdha në Evropë.[89] Në këtë pjesë të Panonisë kanë dalë edhe në afërsi të *Sirmium*-it (Sremit), ku mendohet se duhet t'i takojnë mjekut ushtarak nga gjysma e dytë e shek. II.[90] Po ashtu edhe nga pjesa veriore e Mezisë së Epërme një numër i madh është gjetur në *Singidunum* (Beogradi), të cilat ruhen në muzeun e Qytetit.[91] Ndërkaq në arealin e Viminacit është gjetur edhe një vulë mjeku (*signaculum*).[92]

Përkitazi me pajisjet mjekësore të varrezës sonë, të cilat edhe zënë një hapësirë të veçantë në këtë punim, i përbëjnë këto instrumente dhe ilaçe: dy sonda kirurgjike nga bronzi, dy thika kirurgjike nga hekuri, daltëza kirurgjike nga hekuri, instrumenti kirurgjik (ekarteri) nga xhami me ngjyrë të verdhë, i cili u gjet ndaras te shputa e djathtë, pasqyra mjekësore (otoskopi) nga argjendi, shtypësi i vogël nga hekuri, kutiza (kapsolla) me trajtë cilindrike nga bronzi dhe piksida cilindrike nga plumbi, (fig. 10).[93]

Sondat (*specillum*), të cilat përbënim instrumentet e përdorura edhe në farmaci dhe kozmetikë, u takojnë të dy grupeve.[94] Njëra i takon grupit të sondave gjethe (*cyathiscomela*), të cilat njehsohen ndër instrumentet më të përdorura mjekësore dhe janë pajisje të shpeshta në varret e mjekëve (fig. 10/1a). Lugëza, e cila gjendet në majë të dorezës me prerje rrethore, ka formë gjetheje me ndarje të theksuar në mes, pëfundi së cilës është e zbukuruar me nga dy rrathë të graviruar të hollë anash dhe dy trashje të lehta nyetake në mes, që është rregull i të gjitha sondave të këtij grupi. Doreza, si zakonisht, në fund duhej të mbaronte me një trashje të lehtë në formë boshti, apo ulliri, mirëpo ajo përfundon me një trashje nyetake të theksuar me nga dy rrathë po ashtu të

instrumenti iz Arheološkog muzeja u Splitu", *VAHD* 90-91/1997-98, 1999, f. 101-160.

[89] Z. Gregl, *Histria Antiqua* 14, f. 31 me literaturën e cituar.

[90] P. Milošević, *vep. cit*., f. 35 e tutje.

[91] S. Krunić, *Rimski nedicinski instrumenti iz Singidunuma i okoline*, Muzej grada Beograda. Katalog izložbe 40, Beograd 1992.

[92] Khr. Korać, *vep. cit*., f. 54, shën. 11.

[93] Khr.shën. 80.

[94] E. Künzl, *vep. cit*., f. 5, f. 12-13, fig. 3 nga palestra e Pompeut, f. 27-28 për qendrat tjera. Për përdorimin e tyre në kozmetikë khr. Z. Gregl, *VAMZ* 15, f. 177-178, shën. 14, 15 varret e grave të pasura të Emonës; Grup autorësh, *La Civilisation romaine de la Moselle a la Sarre*, Paris, Musee du Luxemburg 1983, f. 272, 273, n. 238 ku është dhënë kompleti i toaletit.

graviruar anash[95], që flet se kemi të bëjmë me një thyerje në pjesën fundore. Këto sonda, të cilat punohen vetëm nga bronzi, janë gjetur në numër të madh në mbarë Perandorinë.[96]

Tjetra i takon grupit të sondave lugë, ose të ashtuquajtura sonda veshi (17,5 cm), meqë kanë shërbyer edhe për mbajtje të higjienës së veshit (*auriscalpium*). Njëjtë, përbëhet nga doreza (trupi) me prerje rrethore dhe pllakëza po ashtu në majë, por në trajtë të thjerrëzës njëanësore dhe e vendosur në pozitë të pjerrtë, ndërsa në fund mbaron me një trashje të lehtë (fig. 10/1b), që nuk është e zakonshme, meqë ky grup sondash kanë mbarim të mprehtë dhe në raste të rralla mbaron me një trajtë tjetër, siç e hasim edhe në Sisci.[97] Doreza në gjysmën e sipërme, në afërsi të pllakëzës, ngjashëm me sondën lugë, është e zbukuruar me disa rrathë të graviruar të hollë dhe trashje më të theksuar nyetake në mes, që po ashtu është në pajtim të plotë me sondat e këtij grupi. Edhe këto sonda, të cilat, pos në bronz, janë edhe nga ashti dhe argjendi, hasen në të gjithë Perandorinë Romake[98]

Thikat kirurgjike (*culter*, *scalper, scalpellus*) edhe pse janë të përbëra nga dy ekzemplarë vetëm njëra është e ruajtur (11 cm). Ajo mbaron me maje të lakuar të tehut, por që nuk mund të dihet se a kishte prerje të dyfishtë, kurse nga doreza duket pjesa e ngulitjes së saj dhe njëherësh janë ruajtur gjurmët e drurit (fig. 10/2). Deri tash për nga tehu ngjashmëri kemi hasur te një ekzemplar nga Kallioni i Ahajës, po ashtu nga hekuri.[99] Kurse tjetrës për shkak dëmtimit dhe deformimit (7,8 cm) nuk mund t'i konstatohet forma (fig. 10/3). Përndryshe skalperët gjatë kohës romake ishin disa tipash: me një teh në forma të ndryshme dhe teh të dyfishtë në formë gjetheje po ashtu variantesh të ndryshme, kurse doreza ishte katërkëndëshe apo shumëkëndëshe - ndonjëherë më e zhvilluar, siç janë kanelyrat dhe tordirimi - që mbaronte me një zgjerim në formë trekëndëshi, apo trashje në trajtë boshti.[100]

---

[95] Khr. Gregl, po ay, T. 4, fig. 3, T. 11, fig. 4 ku kemi të bëjmë me një sondë të plotë nga Siscia me një zbukurim të përafërt po në at vend.

[96] Khr. E. Künzl, *vep. cit*.; P. Milošević, *vep. cit*., f. 36, TT 1-2 nga Sirmi; Gregl, po aty, f. 180-181, TT. 4-5; i njëjti, *Histria Antiqua* 14, f. 32, fig. 2 nga Siscia; *Muzeji i*, f. 16, fig. 43 nga Zara; S. Ivčević, *vep. cit*., f. 112, 151-152, figg. 18-21 nga Salona.

[97] Z. Gregl, *VAMZ* 15, f. 180, T. 3, fig. 6.

[98] Khr. Gregl, po aty, f. 180, TT. 1-3; i njëjti, *Histria Antiqua* 14, f. 32-33, fig. 3 nga Siscia; *Muzeji*, po aty, nga Zara;S. Ivčević, po aty, f. 111-112, 150-151, figg. 12-16 nga Salona.

[99] E. Künzl, *vep. cit*., f. 40, 42, fig. 11/3.

[100] Khr. S. Milne, *Surgical Instruments in Greek and RomanTime*, Oxford 1907, 44; E. Künzl, po aty, f. 14, fig. 5 nga palestra e Pompeut, f. 15-17 për tipat e qendrave tjera.

Dalta kirurgjike (10,6 cm) përfundon me maje të mprehtë, kurse në pjesën e sipërme gjysmëharkore gjendet një mbetje e vogël që shërbente për ngulitje të dorezës me gjurmët e drurit (fig. 10/4). Për këtë instrument mjekësor, funksioni i saktë i të cilit nuk dihet, deri tash nuk kemi hasur në analogji, pos një ngjashmërie të largët në *Ephesus* (Efes) të Azisë së Vogël, ku bëhet fjalë për një instrument të dyfishtë: në njërën anë gjendet thika në trajtë dalte me maje të mprehtë dhe në anën tjetër një shpatull trekëndore.[101]

Ekarteri, instrumenti i madh kirurgjik mbaron me dorezën në formë rrethi - unazeje, por që gjatë nxjerrjes është dëmtuar plotësisht (fig. 10/5). Ky instrument, që ka shërbyer gjatë operacionit për ta mbajtur vendin e operimit hapur, i cili në rastin tonë i takon llojit të topitur, në gjetjet e instrumenteve kirurgjike të provincave tjera haset rrallë. Nga ato fqinje dy ekzemplarë në bronz vijnë nga Dalmacia, të gjetur në Salonë dhe *Naronë* (Vid te Metkoviqi)[102] dhe një nga Mezia e Poshtme, e gjetur në *Odessos* (Varna)[103], ndërsa dy ekzemplarë vijnë nga trevat e largëta, Italia dhe Gjermania e Poshtme[104], që të gjithë me dallime në dorezë.

Otoskopi, pasqyra mjekësore e konkave është e ruajtur shumë mirë. E punuar nga argjendi shumë cilësor, ka sipërfaqe përsosmërisht të lëmuar (diametër 3, 9 cm) dhe dorezë të vogël të praruar (fig. 10/6). Kjo pasqyrë, e cila ka shërbyer për shikim të veshit, haset shumë rrallë dhe deri tash nuk kemi hasur në analogji. Mirëpo tri pasqyra (*speculum*) të karakterit tjetër mjekësor janë të njohura nga tri qendra të ndryshme të Perandorisë: një fragmentare nga Odesi në Mezi të Poshtme, një me dimensione të mëdha nga *Emerita Augusta* (Merida) në Hispani dhe një nga Azia e Vogël në Muzeun e Majncit.[105]

Shtypësi (*pistillum*) në trajtë kupe (3,5 cm.), i cili është përdorur edhe në farmaci dhe ka shërbye për grimcim dhe bluarje të bimëve shëruese dhe ilaçeve (fig. 10/7), haset po ashtu edhe në trevat tjera, por me forma dhe materiale të ndryshme. Në Muzun Arkeologjik të Splitit

---

Për trevat e afërta khr. P. Milošević, *vep. cit*., f. 36, TT. 1-2 nga Sirmi; M. Korać, *vep. cit*., f. 66, T. 3, figg. D, E, G. H, T. 4, figg. 2-5 nga Viminaci; S. Ivčević, *vep. cit*., f. 119, nn. 223, 224 nga Salona.

[101] E. Künzl, po aty, f. 50-51, fig. 19/17).

[102] S. Ivčević, po aty, f. 120, 147, nn. 228, 229, figg. 51, 52.

[103] E. Künzl, po aty, f. 112, 113, figg 113/2.

[104] E. Künzl, po aty, f. 93, fig. 73, f. 105, fig. 84.

[105] E. Künzl, po aty, f. 23, fig. 7, f. 102, 112.

ruhen dy sosh në trajtë çizmeje së bashku me *mortarium*-in përkatës nga mermeri të gjetura në Salonë.[106]

Kutiza (kapsolla) cilindrike është dy pjesëshe - trup dhe kapak me një zgavër të vogël në mes (7,7 cm) dhe e lëmuar dhe e zbukuruar me vija të holla të graviruara disa radhëshe në katër vende përreth (fig. 10/8). Në të është gjetur mbetja e një pluhurit të zi, që, përkundër mungesës së analizës, është thënë se ka të bëjë me një preparat kundër dhimbjeve.[107] Këto kutiza kanë shërbyer për ruajtje të ilaçeve - tabletave dhe pluhurit mjekësor për shërim të plagëve dhe sëmundjeve tjera. Nga trevat fqinje, dy të tilla janë gjetur në Salonë të Dalmacisë, po ashtu me mbetje të këtij pluhuri së bashku me pllakëzat për përzierje të ilaçeve.[108] Ato hasen po ashtu edhe në varret e mjekëve të trevave tjera të Perandorisë dhe në të shumtën e rasteve me mbetjet e po këtij pluhuri.[109] I njëjti pluhur është gjetur edhe në pjesën e mesme të kutisë katërkëndëshe nga varri i mjekut në Viminac, ku në anësore gjendeshin tabletat.[110] Është e njohur se ky pluhur përmbante një përqindje të plumbit (*plumbum nigrum*) të cilin e përmbanin edhe tabletat[111], që e tregoi edhe analiza e atyre të gjetura në varrin e Enonës.[112]

Piksida (*pyksos*) cilindrike po ashtu dy pjesëshe - trup me fund të drejtë dhe kapak (4,4 cm), pas nxjerrjes është shkatërruar (fig. 10/9). Në të janë gjetur gjurmët e një preparati të yndyrshëm, i cili duhet të ketë pasur të njëjtin funksion me pluhurin e gjetur në kutizë, meqë edhe një preparat i tillë (mehlem) mbarohej në bazë të pluhurit të plumbit.[113] Për përdorimin e plumbit në mjekësi dhe kozmetikë njoftohemi edhe nga Plini.[114] Pa dyshim së bashku me kutizën kanë shërbyer për ruajtjen e këtyre ilaçeve, meqë në mjekësi piksidat janë përdorur për mbajtjen e preparateve të yndyrshme. Megjithëse kupa të ndryshme në mesin e

[106] S. Ivčević, *vep. cit*, f. 117, 144-145, nn. 213, 214, figg. 46-47. Të njëjta ruhen edhe në Muzeun e Zarës të gjetura në Zarë, khr. *Muzeji i*, f. 59.
[107] Khr. shën. 83.
[108] S. Ivčević, po aty, f. 115-116, 143-144, nn. 202, 203.
[109] E. Künzl, *vep. cit*., f. 40, 42, fig. 11/8 nga Ahaja, f. 45, 48, fig. 16/28, 29 nga Azia e Vogël, f. 68-69, fig. 43/2 nga Galia. Ky numër mund të jetë më i madh, meqë formë të njëjtë ka edhe futrola e instrumenteve medicinale *theca vulneraria*, për ç'arsye vështirë dallohen, khr. E. Künzl, po aty, f. 28-29.
[110] M. Korać, *vep. cit*. f. 57, T. 2, f. 61.
[111] Khr. M. Korać, po aty, f. 61, shën. 48.
[112] M. D. Grmek – S. Čmelik, *vep. cit*., f. 129; S. Ivčević, *vep. cit*., f. 116.
[113] Khr. M. Korać, po aty, f. 61.
[114] Nat. Hist., XIII, 19, XXXII, 68, 135, XXXIII, 60.

instrumenteve medicinale janë gjetur edhe në varret e trevave tjera[115], ky ekzemplar mbetet pa analogji.

Këto instrumente, për të cilat vështirë është të flitet për vendin e prodhimit, por që, mund të thuhet se disa nga to (sidomos sondat, ekarteri dhe otoskopi) formën themelore e kanë ruajtur deri sot[116], na e zbulojnë se kemi të bëjmë me një otolog dhe kirurg - degë kjo e cila zinte një vend me rëndësi. Kurse prania e shtypësit, si instrument farmaceutik dhe e ilaçeve në kutizë dhe piksidë ka të bëjë me faktin e njohur se gjatë antikitetit mjekët njëkohësisht ishin edhe farmaceutë, duke i përgatitur ilaçet vetë - ashtu siç përdoreshin edhe disa nga instrumentet në të dy fushat[117] - që shumë qartë u dëshmua në njërën nga stelat epigrafike të mjekëve të gjetura në Salonë, në të cilën është skalitur edhe pllakëza për përzierje dhe përgatitje të ilaçeve.[118]

Që të dy këto të dhëna dëshmojnë praninë e mjekëve vendës në qendrat e ndryshme dardane. Sa i takon mjekut ushtarak, edhe pse nuk mund të dihet specializimi i tij, më parë duhet të jetë fjala për kirurg, meqë ishin më të kërkuarit në ushtri,ndërsa për mjekun kirurg dhe specialist për sëmundje të veshit nuk mund të dimë se a ishte civil apo ushtarak, meqë pajisjet mjekësore në mes tyre nuk dallonin.[119]

Nga ky prezantim mund të konkludohet se i gjithë ky material ka rezultuar me të dhëna të vlefshme në fushë të mjekësisë. Në një anë, ekzemplarët e kësaj trinie perëndish të mjekësisë nga Prizreni dhe Naisi punuar në reliev dhe skulpturë së bashku me dy altarët epigrafikë nga Peja dhe Timak minusi flasin qartë për nderimin e kultit të Asklepit - Eskulapit, përkatësisht të trinisë në tërë Dardaninë - që është në pajtim të plotë me nderimin e tij te të gjithë ilirët gjatë tërë antikitetit[120] - duke treguar nivelin e manifestimit të mjekësisë përmes kësaj perëndie. Në anën tjetër, gjetjet e monumentit epigrafik dhe të pajisjeve mjekësore në dy qendrat kufitare të Dardanisë, Timak minus dhe Skup, dokumentojnë praninë dhe veprimtarinë e mjekëve vendës në këtë trevë edhe si ushtarak edhe si specialist otolog e kirurg. E që të gjithë së bashku

[115] E. Künzl, *vep. cit*., f. 88-89, figg. 64, 65 e tuje.
[116] Shih publikimin *Aesculap. Hauptkatalog – General catalogue*, Tuttlingen 1998.
[117] E. Künzl, po aty, f. 5; Z. Gregl "Rimski medicinski instrumenti iz Hrvatke II", *VHAD* 16-17/1983-84, 1984, f. 175-176.
[118] N. Cambi, *vep. cit*., fig. 1.
[119] E. Künzl,po aty, f. 35.
[120] Ky nderim mund të shpjegohet edhe me lidhjen e saj me gjarpërin Khr. R. Ferri, "Prilog poznavanju ilirske mitologije 1. Kult zmije kod starih ilira", *Anali Historijskog Instituta JAZU u Dubrovniku* 2, Dubrovnik 1953, f. 424-426.

dëshmojnë zhvillimin e mjekësisë gjatë kohës romake në të gjithë Dardaninë. Mbetet për t'u shpresuar se këso gjetjesh do të ketë edhe më tej.

Fig. 1

Fig. 2

Fig. 3

Fig. 4

Fig. 5

Fig. 6

Fig. 7

Fig. 8

Fig. 9



Fig. 10

Exhlale DOBRUNA – SALIHU

SUMMARY

THE PRESENCE OF THE TRINITY OF MEDICINE DEITIES AND HEALERS IN DARDANIA

This paper treats two sets of materials pertaining to the period of antiquity: the sculptural monuments as depicted through relief decorations and sculptures of the three deities that are considered as the trinity of medicine: Asklepios (Aesculapius), Hygiea (Salus) and Telesphorus. The paper also analyzes epigraphical records of medical equipment which indicate the presence of healers in order to draw a clearer picture of medicine as practiced in Dardania during Roman times.

The collected material has provided us with valuable data regarding this particular topic. On one hand, the samples of the trinity deities of medicine consisting of altars found in Prizren (fig. 1-2) and complete sculptures as excavated in ancient Naissus (Figs. 4-9) as well as two epigraphical altars from Peja (Fig. 3) and ancient Timacum minus, indicate the presence of the cult of Asklepios - Aesculapius - which deity was venerated throughout antiquity by Illyrians. The presence of these epigraphical and votive monuments can be correlated with the development of medicine in these areas. Similarly, the finding of a stela, medical equipments and ancient medicaments that were found in two archaeological locations on the brim of the ancient Dardania's border, namely Timacum minus and Scupi, indicate the presence of ancient healers with advanced abilities to perform surgeries (fig. 10/1-9). The finding of these well-preserved equipments presents an important archaeological finding, and are being published for the first time in this paper. The findings indicate the level of development of medicine during Roman times in Dardania.

Arben ARIFI

CEZAROPAPIZMI I KONSTANDINIT TË MADH

Në perandorinë romake në fillimin e shek. IV ndodhen ndryshime të mëdha duke nisur nga sulmet barbare, e përcjellur gjithnjë me dobësimin dhe ndarjen e saj në dy pjesë. Por risia e gjithë kësaj është fundi i politeizmit romak dhe dalja ne skenë e krishterimit i cili edhe pse ishte i përndjekur për dy tre shekuj më radhë vjen e bëhet fe shtetërore! Si fillim perandori më i madh romak Konstandini i Madh, dardan me origjinë se pari me ediktin e njohur të Milanit të vitit 313 pushon se përndjekuri krishterimin dhe njëherit duke i dhënë liri fetare të gjitha feve i bën fe të barabarta. Pas ardhjes së tij në pushtet pasi i konsolidon radhët e veta duke e shembur tetrarkinë e Dioklecianit dhe duke e parë se krishterimi po bëhej një forcë gjithnjë e në rritje patjetër që apetitet e tija ishin për ta pasur nën kontroll edhe këtë të fundit. Kjo u arrit më anë të Cezaropapizmit ku ai u bë i pari i shtetit dhe i pari i religjionit. Më këtë ai menaxhoi shumë mirë me perandorinë duke e krijuar edhe një qendër të re Konstantinopojën duke ia dhënë edhe emrin e tij dhe duke i zgjatur jetën dhe kthyer dinjitetin perandorisë për herë të fundit para ndarjes së saj në dy pjesë. Ky qytet që ai e krijoi vjen e bëhet epiqendër e qytetërimit botëror. Po për habi ai u pagëzua në shtratin e vdekjes përderisa adhuronte kultin e diellit *Sol invictus* kult mjaft i përhapur tek dardanët ku ishte edhe vendlindja e tij.

Qeveria dhe feja kanë qenë gjithmonë forcat më të rëndësishme në jetën dhe mendimet e njerëzimit në përgjithësi. Marrëdhëniet në mes këtyre dy institucioneve kishin potencial për t'i ndryshuar thellësisht të dyja bashkë, fenë dhe shtetin, dhe për ta transformuar shoqërinë. Në tre shekujt e parë pas Krishtit, feja e krishterë kishte zhvilluar influencën e nevojshme për të bërë ndryshime në Perandorinë Romake. Por raporti i qytetarëve të krishterë në raport me ata pagan ishte në disproporcion të madh për shkak se edhe numerikisht, politikisht dhe ushtarakisht kontrollin e kishin paganët mbi të krishterët. Përderisa paganët i panë të

krishterët si një kërcënim të rrezikshëm për kurorën mbretërore si një forcë mirë e organizuar e gjithnjë në rritje, në anën tjetër të krishterët thjesht donin të liroheshin nga persekutimi. Këtu në mënyrë të qartë shihej që të dy nuk do të mund të bashkëjetojnë pa ndonjë ndryshim në rregullin ekzistues. Kur Diokleciani[1] lëshoi fronin në vitin 305, "asnjë nga konkurrentët (për perandor) nuk mund t'i shmangeshin çështjeve fetare, dhe secili kishte politikën e tij.[2]

Në fund të shekullit të IV pas Krishtit, këto ndryshime kishin ndodhur. Perandoria e dikurshme pagane ishte bashkuar me Kishën e krishterë, duke kombinuar fuqinë e të të dyja institucioneve për të formuar shtetin kishtar. Kush ishte përgjegjës për këtë ndryshim? Përderisa disa historianë janë të mendimit që bashkimi i tyre ishte si një rezultat i pashmangshëm i rritjes së krishterimit, shkak i vërtetë i bashkimit të menjëhershëm te kishës dhe shtetit ishte rruga e trasuar nga Perandori Konstandini (312 - 337). Si rezultat i politikave të Konstandinit, kisha e krishterë dhe shteti romak fituan kontrollin mbi njëra - tjetrën dhe në mënyrë simultante vareshin nga njëri - tjetri për të ruajtur kontrollin mbi popullin. Qëndrimi fetar i Konstandinit mbetët ende një enigmë. Duke u futur ne fron menjëherë pas persekutimit të Dioklecianit, duke i dhënë që nga fillimi i mbretërimit të tij *liri për të krishterët*, ai është konsideruar për historinë tradicionale "*perandori i par*ë *i krishterë*".[3]

Konstandinit mund të ia mveshim me të drejtë titullin i Madh, sepse ai e ktheu historinë e botës në një kurs të ri dhe e bëri krishterimin, i cili deri atëherë kishte pësuar përndjekje të përgjakshme, fenë e shtetit romak. Është e vërtetë se arsyet më të thella për këtë ndryshim do të gjenden në lëvizjet fetare të kohës, se të krishterët e përbënin vetëm një pjesë të vogël të popullsisë, duke qenë një e pesta në perëndim dhe gjysma e popullsisë në një pjesë të madhe të Lindjes. Vendimi i Kostandinit varej më pak nga kushtet e përgjithshme se sa nga një akt

[1] Diokleciani bëhet perandor në vitin 284, më vonë do ta vendos Tetrarkinë (sundimin e katër mbretërve) dhe pushtetin e tij do ta ndajë me Maksimianin (August) si dhe Konstantiusin(babain e Konstandinit te Madh) dhe Galerin (Cezar).

[2] Latourette, Kenneth Scott., The First Five Centuries: A History of the Expansion of Christianity Vol. 1, New York: Harper Brothers, 1937, f. 155.

[3] R. Palanque, 'CONSTANTIN I[er] LE GRAND, V. CONCLUSION', in *Dictionnaire d'histoire et de géographie ecclésiastiques*. Paris: Letouzey et Ané, 1956, vol. 13, cols 606.

personal i tij, të personalitetit të tij, prandaj, meriton vëmendje të kujdesshme.[4]

Por si nisi rruga e Konstandinit deri në fronin mbretëror?

Pasi Diokleciani u hoq nga rruga, disa kandidatë për perandor u shfaqen në skenë. Njëri ndër ta ishte edhe Konstandini. Pas vdekjes së babait të tij, Konstantius,[5] Konstandini u emërua Augustus në vend të tij.[6] Pas eliminimit të tre anëtarëve të tjerë në pushtet në Tetrarki,[7] atij i mbetej vetëm për të mposhtur Maksentiusin, birin e Maksimianit, për të fituar kontrollin e plotë të pjesës perëndimore të perandorisë. Në vitin 312 pas Krishtit, në betejën te Ura e Milvianit, Konstandini e mundi Maksentiusin dhe hyri në Romë si Augustus fitimtar në perëndim.[8] Politika e tij religjioze e cila na intereson këtu nuk është hiç më pak e pa rëndësishme pasi që veprimi i tij personal i cili rrjedh nga zhvillimet e tij të historisë kishtare të cilën e quajnë *Paqa e Kishës*, me të kisha pushon se qenuri e persekutuar dhe fillon të përfitojë favore nga shteti, me të legjislacioni fillon të inspirohet nga mençuria e krishterë, por më të filloi ndërhyrja e shtetit në çështjet e brendshme të kishës e cila ndryshe do të emërohet *cezaropapizmi*. Cezaropapizmi e ka origjinën e vet në konceptimin romak të pushtetit perandorak. Që nga Augusti, perandori mblidhte në personin e tij politikat e perandorisë dhe pushtetit fetar. Kjo është me të vërtetë *Pontifex Maximus*, kryeprift, që do të thotë, kreu i fesë romake. Kulti perandorak bashkon komunitetin e banorëve të Perandorisë Romake rreth lutjeve për perandorin, për sakrifica ceremoniale. Lojaliteti politik dhe besimi fetar janë të ndërlidhura, në mënyrë që ata që refuzojnë kultin perandorak, si të krishterë, shiheshin si tradhtarë të Romes.[9]

---

[4] Charles Herbermann., Constantine the Great, The Catholic Encyclopedia, New York, 1908.

[5] Pas abdikimit të Dioklecianit dhe të Maksimianit, Constantius dhe Galeriusi u ngriten në August, me Maximianin dhe Severusin si Caesars, ata përbënin Tetrarkinë e dytë.

[6] Ky titull i ishte dhuruar Konstandinit nga ushtria e babait të tij, por nuk është mirëpritur nga njërëzit e tjerë që synonin pushtetin.

[7] Shumica nga pretendentët për pushtet në Tetrarkinë e dytë, nëpërmjet luftës politike dhe intrigave, gradualisht arritën të eliminonin njëri - tjetrin. Për më hollësisht shih, Edward Gibbon, The Decline and Fall of the Roman Empire,vol. 1 (New York: 1845 revised) f. 341-370.

[8] Licini ishte emëruar August në lindje në vitin 307.

[9] Jean GOUILLARD, Michel MESLIN, «Césaropapisme de l'Encyclopaedia Universalis, DVD, Paris, 2007.

Cezaropapizmi citohet shpesh për të përshkruar fuqinë Konstandiniane. Është e qartë se pas antikitetit, ky term i referohet kryesisht prirjeve të një monarku për të udhëhequr çështjet fetare në një shtet të krishterë. Ne duhet të kujtojmë se, në historinë e Romës, kisha dhe shteti ishin të ndërthurura gjithmonë. Kalimi nga *Republika* në *Principat* kishte forcuar lidhjen, pasi që nga Augusti, princi ishte edhe *Pontifex Maximus*, që do të thotë, autoriteti suprem i fesë tradicionale.[10] Augustati dhe Papati arriti kështu edhe të Gratiani dhe Teodosi, i cili i përkulet këtij dinjiteti në vitin 379. Krishterimi plotësisht i shpëtoi priftërisë së lartë të fesë romake. Udhëheqësit e saj ishin peshkopët, duke përfshirë në mesin e tyre edhe ata në qytetet më të mëdha të Perandorisë: Romë, Aleksandri, Kartagjenë, Antioki dhe Kostandinopojë.[11] Cezaropapizmi /ˌsiːzəroʊpaɪpɪzəm/ është ideja e kombinuar në mes fuqisë së qeverisë laike me pusht fetar, ose duke e bërë atë më të lartë në autoritetin shpirtëror të Kishës; veçanërisht në lidhje me kishën, me qeverinë edhe në çështjet shpirtërore edhe në ato të brendshme. Termi cezaropapizmi (Caeseropapismus) për herë të parë është shpikur nga Justus Henning BOHMER,[12] në fillim të shekullit të XVIII, ku termi është zbatuar sidomos në autoritetin kishtar të perandorëve nga Kostandini i Madh deri në Mosmarrëveshjet e Investitures, mbi të gjitha për sistemin Lindor Romak /Perandorisë Bizantine dhe më vonë u definua nga Max Weber si "një laik, sundimtari cezaropapist ... ushtron autoritetin suprem në çështjet kishtare në bazë të legjitimitetit të tij autonom". Sipas sociologjisë politike të Veberit, *cezaropapizmi* nënkupton "nënshtrimin e plotë të priftërinjve ndaj pushtetit laik".[13]

Në enciklopedinë britanike të vitit 1985 *cezaropapizmi* përshkruhet si sistem politik në të cilin kreu i shtetit është edhe kreu i kishës si dhe gjykatësi suprem në çështjet fetare. Termi është i lidhur më së shpeshti me Perandorinë e vonë Romake, apo atë Bizantine. Shumica e historianëve modern pranojnë se tekstet ligjore bizantine flasin për

[10] Bertrand LANCON, Constantin (306 - 337) «Que sais-je ?», Press Universitaire de France, Paris, 1998, f. 111.
[11] Bertrand LANCON, 1998, f. 112.
[12] Ken Pennington, "Caesaropapism," The New Catholic Encyclopedia: Supplement 2010 (2 Vols. Detroit: Gale Publishers 2010) 1. f. 18; Shih po ashtu, Wall, Heinrich. "Caesaropapism". Religion Past and Present. Brill Online, 2014, http://referenceworks.brillonline.com
[13] Richard Swedberg, Ola Agevall, The Max Weber Dictionary: Key Words and Central Concepts, Stanford University Press 2005, p. 22.

ndërvarësinë ndërmjet strukturave perandorake dhe kishtare e jo nga një varësi të njëanshme të këtij të fundit; historianët besojnë gjithashtu se nuk kishte asgjë në të kuptuarit bizantinë të besimit të krishterë që do të njohin perandorin si doktrinë e pagabueshme apo investim në fuqitë priftërore.[14]

Sipas teorisë së të drejtës hyjnore mbreti ishte Hyjnor i cili konsiderohet mëkëmbësi i Jezu Krishtit në tokë; ai i ishte përgjegjës vetëm Zotit për veprat e tij; në emër të Perëndisë, ai qeveriste subjektet e tij në të dy çështjet atë shpirtërore dhe tokësore, kjo jo shkathtësi e teorisë së bashkuar shpirtërore dhe fuqisë së përkohshme në një subjekt, ku rrjedhë autoriteti i kombinuar prej delegacionit të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm të Zotit, dhe është quajtur cezaropapizmi.[15] Pra, cezaropapizmi siç shihet e ka kontrollin edhe mbi klerin i cili vjen e fuqizohet në masë të madhe, por ne anën tjetër pushteti ka nevojë ta kontrollojë secilën forcë me ndikim qe paraqitet dhe se domosdoshmërisht është dashur të jetë nën ndikimin e perandorit për të qenë i gjithëpushtetshëm. Kështu, njëherit na paraqiten dy fenomene në të njëjtën kohë, klerikalizmi dhe cezaropapizmi pasi që janë të ndërlidhura njëra me tjetrën. Është shumë e vështirë për të gjetur një pozicion të balancuar në mes të këtyre dy ekstremeve, aq të inatosur njëri në tjetrin: klerikalizmi dhe cesaropapizmi. Çfarë kuptimi kane këto fjalë të huaja? Klerikalizëm do të thotë një sistem në të cilin fuqia e klerit, po ashtu priftërinjve është aq e madhe në çështjet publike që nuk ka pothuajse asnjë fuqi të pushteti civil, të kundërtën e quajmë cesaropapizëm regjimi në të cilin pushteti politik drejton edhe botën shpirtërore, kështu që shteti dominon kishën, ose Papa i përket Cezarit, pra me një emër është cezaropapizmi.[16]

Me këtë rast erdhi në shprehje doktrina e cezaropapizmit, por kjo doktrinë do të mund të merret vetëm në një perandori luftarake të krishterë, jo të një pagane. Themeluesi i saj ishte Teodosi, "biri i Kishës" e jo Konstandini, *Pontifex Maximus*. Sigurisht, cezaropapizmin e vërtetë nuk mund ta pohojmë para se krishterimi të ishte kult shtetëror: që vjen, para se Gratiani kishte refuzuar titullin "*Pontifex Maximus*", dhe më saktësisht, para se Teodosi lëshoi ediktin (urdhrin) "populos Cunctos" që kërkon aderimin universal dhe respektimin universal për problemin e marrëdhënieve institucionale që nuk u bë e qartë nën

[14] Encyclopædia Britannica, London 1985, vol. 2, p. 718-719, "Caesaropapism".
[15] Slater, T. Civil Allegiance. In The Catholic Encyclopedia. New York, 1908.
[16] Max Dominicé; La reforme et nous, Cahiers du renouveau, Genève, 1972, f. 40.

sundimin e Konstandinit. Për Perandorinë e mbetur pagane, perandori ishte vetëm kuazi - krishterë; Konstandini vazhdoi të mbajë titullin dhe për të kryer funksionet e Pontifex Maximus, dhe ta pranojë atë, madje edhe për t'i nxitur grandet pagane - publike, institucionet dhe praktikat.[17] Politika e Konstandinit ishte aq e paqartë sa që në vdekjen e tij ai mori nderin pagan të apoteozës (hyjnizimit)[18] nga Roma pagane.
Disa nga elementet e cezaropapizmit ishin me siguri të pranishëm nën Konstandinin. Këto janë, konceptet Helenistike të tilla si ato të perandorit si "*ligj i gjallë*," si përfaqësues të Zotit me të cilin ai kishte komunikim të drejtpërdrejtë, dhe si imazh i Perëndisë që ende gëzonte energji të madhe, dhe shumë prej tyre shfaqen në veprat bashkëkohore te autorët e krishterë.[19]

Konstandini qeverisi një perandori pagane, që përmbysen shumë nga paraardhësit e tij si perëndi dhe e cila i jepte atij edhe nderin pagan te apoteozës pas vdekjes së tij. Bashkimi ideologjik dhe institucional i ardhshëm, në mes të Kishës dhe Perandorisë që do të shndërrohen nga atributet helenistike në atributet e krishtera te hyjnisë perandorake, e cila do të kishte ndryshuar formën pagane në cezaropapizëm, nuk kishte ndodhur në kohën e vdekjes së Kostandinit.[20]
Ai kishte ndërmarrë hapin e parë drejt fazës ku të dy institucionet do të përziheshin, dhe ku konceptet helenistike në lidhje me mbretërimin hyjnor do të shndërrohen ne cezaropapizëm.[21]

Duke e ngjitur Kishën dhe Perandorinë në një institucion që filloi vetëm në shekullin e IV; siç e kemi sugjeruar, të dyja ende kanë mbetur krejtësisht të pavarura në mendjet e mendimtarëve ortodoksë deri në fund të kësaj periudhe. Në të njëjtën kohë, ata kishin përafruar njëri - tjetrin, dhe marrëdhëniet e tyre nën Teodosin që ishin shumë të ndryshme nga ato nën Konstandinin. Ai e konsideroi krishterimin si një kult të favorizuar, por ai toleroi edhe fetë e tjera në kuadër të Perandorisë. Ndërsa, ai argëtoi peshkopët më lavde e shkëlqime disa nga të cilët i vlerësoi si një imazh i mbretërisë qiellore,[22] ai gjithashtu ka

[17] Karl Frederick Morrison, Rome and the City of God: An Essay on the Constitutional Relationships of Empire and Church in the Fourth Centur: Transactions of the American Philosophical Society, New Series, Vol. 54, No. 1 (1964), p. 5.
[18] Gjeja me e larte e zhvillimit te diçkaje, pika kulminante e arritjes, hyjnizimi.
[19] Karl Frederick Morrison, vep.cit.f. 5
[20] Ibid.,f. 5
[21] Karl Frederick Morrison, 1964,f.7
[22] Bauer dhe Muller të dy theksojnë gradualitetin e ndryshimeve në politikën perandorake fetare nën Konstandinit të Madh, dhe ata refuzojnë qëndrimin se veprimet

funksionuar si Pontifex Maximus i shtetit pagan, duke i shpërblyer anëtarët e kolegjeve të tija priftërore dhe fondet publike për sakrificat dhe ritualet e tij.[23]

Kështu ai vuri kushtet e buta me dekretin e Milanos, me të cilin ai dhe Licinius i dhanë krishterimit statusin e një *religio licita* dhe specifikuan se "... të gjithë të tjerëve duhet t'u lejohet praktikim i lirshëm dhe i pakufizuar i feve të tyre; sepse ajo përputhet me gjendjen e mirë të mbretërisë dhe të paqes së kohës sonë që secili duhet të ketë lirinë për të adhuruar Perëndinë, sipas zgjedhjes së tij; dhe ne nuk kemi ndërmend të heqim nga nderimi çdo fe apo praktikues të saj".[24]

Konstandini nuk u pagëzua deri në shtrat të vdekjes, gati tridhjetë vjet pas konvertimit të tij. Nga fundi i shekullit, Teodosi u pagëzua brenda një viti të hyrjes së tij, dhe ai ndoqi politikën fetare të Gratianit, duke hequr dorë nga titulli dhe funksionet e *Maximus Pontifex* dhe lëshimin e dekreteve më të rrepta kundër paganëve dhe heretikëve. Ai shkoi edhe më tej; me kërkesën e Këshillit të Konstandinopojës (381), ai themeloi profesionin Nikeas si fenë e vërtetë mbi "të gjithë popujt të cilët qeveria e jonë i sundon".[25]

Në të vërtetë, ai shkoi aq larg në identifikimin e interesave të Kishës me ato të Perandorisë, sa që dekretoi që i njëjti dënim kapital i përshkruar për trazirë *lèse majesté* kundër shtetit duhet të vendoset për prishjen e qetësisë së Kishës.[26] Siç mund të shihet e barazoi kishën më shtetin sa i përket aspektit ligjor. Por, gradualisht duke e koncentruar në duart e veta edhe religjionin si i pari i tij.

---

e Kostandinit ishin cezaropapizëm. C. Bauer, "Die Anfange des byzantinischen Casaropapismus," Archiv des katholischen Kirchenrechts 140 (1931): especially f. 113: "Einen grundsatzlichen 'Casaro- papismus' in dem Sinne, dass die byzantinischen Kaiser selbst ein formelles Recht, die Kirche zu lehren und zu regieren beansprucht hatten, hat es nie gegeben. Praktisch haben sie fast alle tief in das kirchliche Përsonen- und Verwaltungsrecht eingegriffen. . . ." H. Muller, Christians and Pagans from Constantine to Augustine (Pretoria, 1946) 1: pp. 23, 34 ff. por shih Biondi, i cili nuk e konsideroj në detaje bazën juridike të marrëdhënieve Kishë-Perandori në shekullin e katërt.. B. Biondi, II Diritto Romano Christiano (Milan, 1952) 1: f. 185: "Per designare questa situazione, in cui l'imperatore interviene liberamente nell' ambito della Chiesa in questioni di fede, si e escagitato il termine di cesarismo o cesaropapismo. . . . Constantino si qualifica come fondatore del cesaropapismo.

[23] Karl Frederick Morrison, 1964,f. 20.

[24] Lactantius, De mortibus persecutorum, c. 48 (Corpus Scriptorum Ecclesiasticorum Latinorum , f, 27: 230 ,)

[25] Cod. Th. XVI, 1,2,3.

[26] Cod. Th. XVI, 1,4.

Ky kalim nga toleranca e gjerë për krijimin e një feje të shtetit, ekskluzive e të gjitha kulteve të tjera, duhet të shpjegohet duke iu referuar të tre faktorëve: perandorit, pushtetit perandorak, dhe Perandorisë. Këto ishin elemente të dallueshme në kushtetutë romake. Perandoria ishte skena e veprimit; pushtetit perandorak, instrument; perandori, motivues dhe drejtues. Deri në fund të shekullit të IV, perandorët kishin përdorur pushtetin e tyre jo vetëm për të njohur komunitetin e krishterë si pjesë legjitime e Perandorisë, por shumë më tepër, për ta bërë Perandorinë një komunitet të krishterë. Edhe pse thuhet në ligj, ky rregullim ishte i paqëndrueshëm; ai mbeti tërësisht në vendosmëri i pasuar nga perandorët ortodoks dhe prirjet e tyre për të përdorur pushtetin e tyre për të mirën e Kishës.[27]

Shprehja e njohur e Shën Augustinit se të dy krerët, e mira dhe e liga e mbajnë pushtetin e tyre me providencën e Perëndisë, e mira për të shpërblyer njerëzit, dhe të pabesët për t'i ndëshkuar, është një deklaratë patentë për këtë fakt.[28] Kjo duhet të kuptohet se kur Konstandini u bë perandor i të gjithë Perandorisë Romake në vitin 324 pas krishtit, të krishterët përbënin vetëm rreth katër për qind të popullsisë së përgjithshme. Kjo pakicë e vogël kishte qenë persekutuar dhe dëbuar nga tërë shërbimi publik në perandori. Shumica nga bashkëkohësit romakë të Konstandinit menduan se uniteti mund të mbrohet më tej me shtypjen dhe eliminimin e të krishterëve.[29] Por, nuk kaloi shumë kohë dhe mendimi se të krishterët duhet të përndiqen u pa se ishte gabim. Më pas kur panë se krishterimi ishte si një forcë e vogël, mirëpo shumë e organizuar mirë perandorët filluan të mendonin ta përdornin edhe si model.

Siç na meson Sozomeni deri në kohën e Konstandinit kisha ishte një organizatë mjaft e fuqishme për perandorin që të angazhojë atë si një partner në unifikimin e perandorisë. Sistemet e autoriteteve, modelet e besimit dhe kontrollit të fondeve dhe pasurisë i kishin kthyer komunitetet e hershme kishtare në një strukturë organizative të ndërlidhura përgjatë perandorisë që në rritje e sipër e pasqyronin strukturën e vetë perandorisë. Ajo është një fakt i thënë që kur renegat

[27] Karl Frederick Morrison, 1964, p. 20.

[28] St. Augustine, De civitate Dei, V, 19 (Corpus Scriptorum Ecclesiasticorum Latinorum 40, 1: 253).

[29] Terry Julian, Constantine the Great, Christianity, and Constantinople, Trafford Publishing, 2005, faqe 12, shih poashtu Paul Veyne, *Quand notre monde est devenu chrétien (312-394)*, p. 9-13, Paris: Éditions Albin Michel, «**Idées**», 2007, i cili përqindjen e shton ne 5%, nga kjo kuptojm se shifra nuk ka shkuar mbi 5.

Juliani ishte përpjekur për të kthyer orën prapa në 360s, ai kishte vendosur "për të futur në tempuj pagane rendin dhe disiplinën e krishterimit".[30]

Kjo vije nga vetë fakti se besimi monoteist apriori e kundërshton adhurimin e zotave tjerë që në besimin romak ishin të shumtë. Kjo i krijonte vështirësi edhe vetë Konstandinit për t'u pozicionuar në favor të krishterimit edhe po te ishte numri i krishterëve edhe shumë herë me i madh. Këtu është në pyetje edhe thyerja e konceptit të besimit romak me anë të të cilit Perandoria Romake jetoi me shekuj të tërë, ku vetë perandori e merrte titullin *pontifex maximus*, çka do të thotë ta ketë të koncentruar të gjithë aparatin shtetëror në duart e një përsoni. Kështu, perandori kishte në duart e tij edhe pushtetin laik edhe atë fetar si dhe pushtetin ushtarak. Por, Konstandini do të ia arrijë që me sukses të notojë nëpër këto ujëra të trazuara më shumë përplasje duke e kthyer prapë pushtetin ne duart e një personi qe nga tetrarkia e Dioklecianit. Por, nga vetë natyra dhe përgatitja e tij romake do të shohim se do ta qoj drejt cezaropapizmit. Por pranimi i krishterimit nga ana e tij në shtratin e tij të vdekjes e bënë shumë më kompleks studimin e figurës dhe personalitetit të tij.

Konstandini përhapë idenë e ndriçuar të një perëndie supreme, por kjo i mori disa kohë para se ai të identifikojë atë me Zotin e të krishterëve. Ai respektonte padyshim nderimet bashkëkohore të diellit si zot të lartë. Por, i impresionuar nga rezistenca e të krishterëve kundër persekutimit sistematik dhe mizor që ndonjëherë kishin vuajtur, ai ia kushtoi rrugën e tij Krishtit, në rast të zhvillimit të ndonjë beteje kundër rivalit të tij në pjesën perëndimore të Perandorisë së tij. Fitorja e tij konfirmoi atë në bindjen e tij se ka angazhuar zotin e "drejtë" dhe veten konsideronte si i zgjedhur i Zotit për të çuar misionin e tij deri në fund.[31]

Karakteri i hekurt i paganizmit përjashton idenë e ndarjes shpirtërore nga ajo kohore, dhe se trashëgimia e *bazileus helenistik* dhe cezarëve romak ishte i pamundur të pranohej. Në mes tjerash mund të nënvizojmë që madhështia e njerëzve të kishës dhe mrekullia para kësaj risie të një perandori të krishterë i ka larguar të gjitha rezistencat e vjetra

[30] Sozomen, Histoire Ecclesiasstique , 5.16., éd. J.Bidez et G.C. Hansen, trad. André – Jean Festugière, annoté par Guy Sabbah, coll. "Sources Chretienes" nr. 495, Paris, 2005.

[31] Johannes Roldanus.,The Church in the Age of Constantine, The theological challenges. Routledge 2006 f. 34.

të princave, të gjitha protestat kundër fantazisë teologjike madje as papa Silvestri nuk ka mundur ta kërkojë primatin për te gjykuar donatizmin dhe arianizmin, madje para se ta konvokoj koncilin ekumenik të vitit 325. Konstandini nuk e konsulton fare papa Silvestrin,[32] as Athanasi nuk e ka mohuar karshi perandorit të drejtën për ta gjykuar. Përfituesit ose viktimat e ndërhyrjeve mbretërore u morën vesh për t'i pranuar ndikimet e tyre. Kështu perandori i krishterë e bëri si zakon që të konvokon këshilltarët, për të organizuar dhe lehtësuar mbledhjet e tyre, për të zbatuar mendimet e tyre, por krahu sekular para se të jetë organ ekzekutiv shpesh ka qenë organ i këshillave. Prijësi ose së paku këshilltari kishtar në të cilin kishte plot besim përgatiste dhe orientonte vendimet kapitale, në favor të ndikimit personal të perandorit ose të ndikimeve që ushtroheshin mbi të, triumfi i ortodoksisë ose tendenca e favorshme e herezisë. Për çdo rast autonomia e kishës është sakrifikuar, kjo traditë do të peshojë rëndë mbi historinë e mbretërisë bizantine dhe mbi atë të shteteve të krishtera mesjetare. Megjithatë kisha nuk e kishte atë dëshirë në lindje ku cezaropapizmi gjithmonë dukej normal.

Konstandini, në kërkimin për të rregulluar marrëdhënien e re mes qeverisë dhe kishës romake të krishterë tani të njohur ligjërisht, e krijoi një precedent të rëndësishëm për perandorët e mëvonshëm. Arsyet për konvertimin e Konstandinit ndaj krishterimit, janë natyrisht themelorë, për çdo kuptim jo vetëm të politikës së tij ndaj marrëdhënieve kishë-shtet, por edhe e motiveve të tij në ndërtimin e kishave dhe faltoreve.[33] Por, një nga ndryshimet e mëdha që bëri ai ishte krishterimi gradual i Perandorisë Romake. Andaj, në kohën që ai ishte i lindur, krishterimi ishte një grup i rëndësishëm presioni pavarësisht nga të qenurit një pakicë. Komunitetet e tyre ishin të pasura, me ndikim dhe të organizuar. Por, për shkak të refuzimit të tyre në përputhje me dëshirat e qeverisë romake, ata u përballen me një histori të gjatë të persekutimit.[34] Konstandini megjithatë, vlerësoi pikat e forta të krishterëve. Ai besonte se organizata e tyre dhe mësimet e bamirësisë, dashurisë dhe mëshirës do të unifikojnë Perandorinë Romake. Në vitin 313, pas konvertimin në

[32] Pierre Letamendia, La Démocratie chrétienne, Paris, 1977, f. 126.

[33] Deno John Geanakoplos, Church Building and 'Caesaropapism,'A.D. 312-565, UNIVERSITY OF ILLINOIS *,1966, f. 169.*

[34] Michael Grant, The Emperor Constantine (England: Orion Books Ltd, 1998), f. 126-127; John Julius Norwich, Byzantium: The Early Centuries (England: Penguin Books, 1990),f, 32; Warren Treadgold, A History of the Byzantine State and Society (California: Stanford University Press, 1997), f. 25.

krishterim[35], Konstandini filloi të japë klerit të krishterë edhe përfitimet e ndryshme të komunitetit. Ai zgjeroi patronazhin e tij për bashkësitë e krishtera në të gjithë perandorinë e tij, kur ai u bë i vetmi perandor romak. Edhe legjislacioni i tij favorizoi të krishterët. Por çmimi i patronazhit bujar të Konstandinit ishte cezaropapizmi: kontrolli monarkik mbi Kishën.[36] Për t'i venë taksa Konstandinit cezaropapizmi do të rikthehet për t'i plotësuar dëshirën për të investuar autoritetin suprem të kishave të krishtera. Ky nuk ishte rasti. Nëse ai e thirri Këshillin e Arles-it në vitin 314, dhe atë të Nikesë në vitin 325, që ishte edhe si nevojë e unitetit dhe e rendit publik, të kërcënuar nga grindjet Donatiste dhe Arianiste. Ai ishte sigurisht i pranishëm në Koncilin e Nikesë dhe kryesoi sesionet. Ai ia bëri më dije ipeshkëve atë që ai e priti prej tyre. Por ai atyre nuk iu imponoi asnjë vendim. Historia e Sozomenit është e qartë: ai i zbaton vendimet e ipeshkvinjëve.[37]

Qëllimi ishte ta koncentrojë aparatin shtetëror në duart e veta si dhe në të njëjtën kohë ishte ai i cili merrte pjesë në çdo aktivitet kishtar edhe si faktor vendimmarrës. Kështu ai e vuri aparatin shtetëror dhe ligjin në shërbim të atyre që do të behën "ipeshkv nga jashtë". Ai urdhëroi vetëm ipeshkvinjët për të vënë rendin në zonën e tyre qe ishte e caktuar për ta. Ajo çfarë ka mund të krijojë iluzion është që peshkopët e Romës dhe Kostandinopojës ai i bëri te zbehtë në krahasim me princin. Djali i tij Constantius II implikon shumë më tepër autoritet në çështjet fetare duke u përpjekur për të imponuar Arianizmin. Në qoftë se termi i cezaropapizmit ka ndonjë rëndësi në shekullin IV, do të ishte mu ky rast. Dhe, në mënyrë paradoksale, në politikën e tij fetare, Julien ishte më tepër udhëheqës sesa xhaxhai i tij.[38]

Krahas me lutjet e tij kishtare Kostandini i Madh vazhdoi ta adhuronte, ashtu si perandori Klaudi II (daja i babait të tij, Kostanc Klorit), kultin pagan dhe ilir të Diellit. Krishterimi i hershëm i tij duket se përshkohet me koncepte astrologjike, dhe për disa vite Dielli nderohet në monedha, prej ku kaloi në simbol të shpëtimtarit (Krishtit), Diellit të Drejtësisë e të Shkrimit, po ashtu një ligj i vitit 321 e quan të dielën Dies Solis (ditë të Diellit).[39] Këtu duket se Konstandini ka bërë

[35] Shumë autor e marrin këtë datë si konvertimin e Konstandinit nga vetë fakti qe ai filloi të mendojë se ishte i zgjedhuri i Zotit nga paraqitja e shenjës se kryqit *in hoc signe vinces*.
[36] Michael Grant., vep. cit. f . 150-151.
[37] Bertrand LANCON. 1998, f. 112.
[38] Bertrand LANCON. 1998, f. 112.
[39] Konstandini dekretoi (7 Mars 321) dies Solis ditë-e diellit, "E diel"-si dita e

diplomaci duke mos dashur ta humb përkrahjen dhe mbështetjen e asaj pjese që adhuronin kultin e diellit i cili ishte mjaft i përhapur tek ilirët respektivisht dardanët dhe në anën tjetër si i krishterë donte që gradualisht ta këtë edhe mbështetjen e një shtrese gjithnjë e në rritje, të krishterëve. Një panegjirik latin me shkrim në Gali në 310 e përshkruan atë si ka pasur një vizion të Apollonit, dhe dedikimeve ndaj Diellit të pamposhtur (Sol Invictus) me tipare në monedhat e tij deri në fund të vitit si 320s.[40]

Por pas 320 të gjitha imazhet pagane zhdukën nga monedhat dhe nga tekstet e ligjit që Konstandini kishte nënshkruar, i rishkruar në vitin 324 ku vërtetësia e tij ka të ngjarë të jetë denoncuar me terma nënçmues "gabim paganë," duke përfshirë orakujt e Apollonit.[41] Respekti për “Dies Solis” apo “Diten e Diellit”, viti 321 ishte veçanërisht e favorshme për privilegjet e Kishës Katolike. Në prill, njohja e vlefshmërisë kishtare në asamble; 3 korriku i shfaq Romës kapacitetet dhe sukseset e kishave dhe të njëjtën ditë në Calaris (Cagliari) kryeqyteti i provincës së Sardenjës u botua një kushtetutë në Helpidius, vikar i Romës, në vëzhgimin e Dies Solis, duke përfshirë dy fragmente që ne i kemi te ruajtura nga kodet, (Cod. Théod., 1. II, t. VIII, c, 1; Code de Justinien, 1. III, t. XII, c. 2.).[42]

Kjo ditë, dita e diellit ruhet vetëm në gjuhën shqipe ku për ditën e fundit të javës themi dita e Diell, përveç kësaj edhe tek populli deri vonë dhe sot e kësaj dite përdoret emri Dile tek gjinia femërore sidomos tek katolikët shqiptarë që i është kushtuar ditës së fundit të së dielës.

Për më tepër, në këtë drejtim Bizanti, i cili gradualisht krishtërohet për më shumë me ideologjinë neo-pitagoro-euzebiane i takon një tradite të gjatë të botës greko - folëse. Por, këtu duhet të behët një observacion ndër me interesantet. Ndërsa, gjatë formimit të doktrinës patristike dhe bizantine të Trinisë dhe të imazhit, imazhi i perandorit na ofron një krahasim të rëndësishëm, konceptin e vetë sovranit si një imazh apo një imitues i Perëndisë që ishte paralel me fushën ideologjike të imazheve fetare megjithatë pa cenuar atë. Me fjalë të tjera, ai kurrë nuk i ka përdorur marrëdhëniet Zot - sovran në teorinë e imazhit fetar. Vërtetë,

pushimit romak, Cod. Just. 3.12.2

[40] Cambridge History of Christianisme , vol 1 , Cambridge 2008, f. 541.

[41] J.-R. Palanque, 'CONSTANTIN I[er] LE GRAND, II. LE PROBLÈME DE LA CONVERSION DE CONSTANTIN', in *Dictionnaire d'histoire et de géographie ecclésiastiques*. Paris: Letouzey et Ané, 1956, vol. 13, f. 598.

[42] Codex Théodosien, éd. Th. Mommsen, Berlin, Weidmann, 3e éd., 1962., : *Codex Justinianus*, éd. P. Krueger, Corpus Iuris Civilis, t. II, Berlin, 1914.

një metaforë si "sovran si imazh" nuk i huazojnë lehtësisht përdorimeve të tjera metaforike, si ajo që duhet të jetë për të krahasuar perandorin (imazhin e Perëndisë) më një vepër arti, imazh të prototipit të tij.[43] Por kjo nuk mund të jetë arsyeja e vetme për të mos përdorur një mënyrë konvencionale marrëdhënien Perëndi - perandor, që prej marrëdhënieve të thjeshta Zot - njëri shërbejnë për të përdorur thjesht vetëm si një krahasim analog.[44]

Unë besoj se ajo çka këto fakte kanë tendencë për të përforcuar zbulimin në rritje të asaj çka nuk duhet të merret parasysh, jetes fetare te Bizantit sikurse i zihet fryma nën cezaropapizmin gjoja kudo. Shtresat më të thella të doktrinës dhe shpirtërores - e cila i përkiste vërtetë ikonave të shenjta - nuk janë prekur nga pozita e perandorit në Kishë me rastin e rrethanave të jashtëzakonshme, të tilla shfaqje te një herezie të re, çfarë Ikonoklastia sjell janë shembulli më i mirë. Fjalët e Krishtit, "Jepjani Cezarit atë që i përket Cezarit; dhe Zotit atë që është e Zotit" (Mt. 22, 21.), mbeti një parim edhe në krishterimin perëndimor.[45]

Në lindje cezaropapizmi pati tendenca në rritje të vazhdueshme. Sistemi ku një monark absolut ka kontroll suprem mbi kishën më gjithë zotërimet e tij duke e ushtruar ndikimin edhe në çështje, si p.sh. doktrina, e cila normalisht që ishte e rezervuar për autoritetin kishtar e forconte edhe më shumë pozitën e perandorit. Termi në përgjithësi më së shumti është ushtruar nga perandorët bizantin në mbarë patriarkalët lindorë, sidomos në shekujt që i paraprijnë ndarjes skizmatike të vitit

---

[43] Gerhart Ladner and Patrick Carré: Le concept d'image chez les Pères grecs et la querelle iconoclaste de Byzance: Rue Descartes, No. 8/9, Mensonge et image, PUF, Paris 1993, f. 47.

[44] Shih më sipër. Megjithatë, ajo duhet të mbahet mend se në traditën e kombinuar bibliko - platonike këto dy raporte shpesh ishin si një: së pari, njeriu i përsosur si i tillë është një mbret (i konceptit platonik të filozofit-mbretit, si dhe me idetë biblike te karakterit mbretërorë Adamit dhe Mbretërisë së Perëndisë në çdo të krishterë të vërtetë); nga ana tjetër, sovran është Perëndia në një mënyrë të veçantë dhe për të hedhur votën. Kështu, për Klementin e Aleksandrisë (krh. sidomos Stromata I, 24, GCS, Clemens Alex., II, 99 ff. [158, 1 ff.]), Si dhe njëjtë për Philon e aprovon (shih. Philo, De vita Mosis III, 1 sq., ed. Cohn et WENDLAND, Berlin de Gruyter 1962, loc. cit. IV, 200 ff.), cf. Stromata I, 26, II, 4, ibid. II, 104 [168, 1], 122 [18, 4 sq.]) s'appliquent ici, dans un sens authentiquement biblique et platonicien, à l'homme et à Moïse, respectivement, plutôt que, à la manière hellénistique, au souverain. Shih njëjtë, Grégoire de Nysse, De opificio hominis, 4, PG XLIV, 136 C,/ njëjtë F.E. Cranz, « Kingdom and Polity in Eusebius of Caesarea», Harvard Theological Review XLV (1952), 47 sq., veçanërisht 51-56.

[45] Gerhart Ladner and Patrick Carré: Paris 1993,f. 47.

1054.[46] Kjo dukuri nuk ishte e shprehur vetëm në Bizant por edhe në vendet tjera, p.sh. në Rusi, Pjetri i Madh e bëri qytetin verior të tij si metropol politik dhe kishtarë, dhe duke transferuar autoritetin e Patriakanës së Moskës për të "Sinodi i Shenjtë" (1721), qe banon në mënyrë të përhershme në Shën Petersburg dhe përbënë gjyqësorin më të lartë kishtar të Rusisë nën sundimin cezaropapist të Carit, rivalit më të fuqishëm të Papës romak.[47] Në anën tjetër mbreti Charles, edhe pse i ishte bashkangjitur me devocion e kishës dhe Papës, ishte shumë absolut që një monark të njohë një sovranitet brenda sovranitetit të tij. Ai rrjedh idenë e tij të teokracisë nga Dhjata e Vjetër, dhe lidhje në mes Moisiut dhe të Aaronit. Ai e kuptoi dhe ushtroi dinjitetin e tij perandorak shumë më tepër në të njëjtën mënyrë sesa Konstandini i Madh dhe Teodosi i Madh, që kishin bërë në perandorinë bizantine, i cili ishte cezaropapizëm në parim dhe praktikë, dhe kështu që perandoria ruse është pasardhësi i tij.[48]

Në vazhdimin për përfundimin e punës së Dioklecianit, Konstandini krijoi bazën e shtetit bizantin që do të jetojë për më shumë se një milenium pas tij dhe se ruajti letërsinë greke dhe kodifikoi ligjin romak; kjo është padyshim një arritje e madhe për t'i dhënë vulën përfundimtare në kodifikimin e ligjeve nga perandori Justinian me vonë me *Corpus Juriis Civilis*-in e njohur botërisht.

Emri i tij pati jehonë aq të madhe sa që edhe dhjetë perandorët mbas tij që erdhën në pushtet, duke përfshirë perandorin e fundit të Bizantit, mbanin për nder emrin e tij, dhe një perandor i ri nuk mund të marrë asnjë kompliment më të madh se sa të quhet "një Konstandin i ri". Kjo i derivon shtetit Bizantin një pjesë të konsiderueshme të identitetit të tij nga identiteti fetar; ajo është ndërtuar mbi një aleancë të fronit dhe altarit, por dy partnerë në këtë aleancë nuk ishin të barabartë; ka pasur gjithmonë një epërsi të autoritetit perandorak mbi autoritetin kishtar. Edhe pse Konstandini kishte qenë i kujdesshëm për të lënë peshkopët, të mblidhen në këshill, marrin vendime në çështjet shpirtërore, dhe edhe pse ende nuk mund të flitet për krishterimin si fe shtetërore, ai qëndron në fillim të atij urdhri të kishës - shtet marrëdhënie e cila ka shumë kohë, por jo shumë të përkufizuar saktë, është quajtur cezaropapizmi.

---

[46] Oxford Dictionary of the Christian Church, ed. F.L. Cross & E.A. Livingstone, Oxford Univ. Press, 2nd ed., 1983, "Caesaropapism", f. 218.
[47] Schaff, Philip, History of the Christian Church, Volume IV: Mediaeval Christianity. A.D. 590-1073.Wm. B. Eerdmans Publishing Company, 1910, f. 124.
[48] *Po aty*, f. 220.

Pikëpamje moderne e atij rregulli që nuk është zakonisht një rregull pozitiv.[49] Megjithatë nga shekujt V dhe VI, vetë Konstandini është ngulitur thellë në mendjen popullore bizantine si themelues i shenjtë i krishterimit të kryeqytetit, dhe, me nënën e tij Helenën, si një përgjegjës për gjetjen e kryqit të Vërtetë në Jerusalem. Figura e Kryqit të Vërtetë gjithnjë e më shumë futet në llogaritë e mëvonshme legjendare, deri sa e ndërtojnë Konstandinin historik.[50] Kjo më shumti u shtri sidomos në Greqi, Bullgari e Serbi.

Në Lindje, ku cezaropapizmi gjithmonë dukej regjim normal, Konstandini është ngritur ne gradën e shenjtorëve dhe Kisha greke ende e feston 21 Majin si Dita e "isapostoles së lavdishme, sovrane, kurorëzuar nga Zoti, Konstandini", dhe nëna e tij Helena.[51]

Pra adhurimi i tij si i shenjtë ka shkuar deri në përmasa te tilla saqë është hyjnizuar bashkë edhe me nënën e tij. Pra, sllavët e jugut që arritën në Ballkan nga koha e dyndjeve barbare të cilët me vonë gjatë shek VIII - IX u ngulitën përfundimisht në këto anë filluan që edhe nga aspekti religjioz të përvetësojnë shumë duke u përpjekur për të krijuar diçka të veçantë nga të tjerë, por në fakt ishin vetëm modifikime të tyre e asgjë kreaturë e tyre.

Studiuesi i njohur M. Spinka shprehet: Nëse sllavët fillimisht pushtuan krahinat perandorake Danubiane, kultura bizantine në fund i pushtoi ato. Por, në thelb për t'i dhënë karakterin bizantin kulturës së sllavëve të Ballkanit, ata arritën ta bëjnë atë me të vërtetë kombëtare. Natyrisht, në një mënyrë, edhe ky tipar është me të vërtetë bizantin. Ortodoksia e Perandorisë zhvilloi një frymë nënshtrimi të shtetit të cilat shpesh degjeneronin në servilizëm. Kisha u bë një krah i qeverisë, një departament i shtetit cezaropapist.[52] Kjo më së miri mund të ilustrohet edhe me ndarjen e madhe skizmatike dhe më pas në vazhdimësi më formimin e kishave nacionale si kisha të pavarura siç janë ato serbe e greke të cilat vihen në diktatin e shtetit të cilat si një binom i pandashëm

---

[49] Hans A. Pohlsander, THE EMPEROR CONSTANTINE, Second Edition, Routledge New York 2004, f.91

[50] Samuel N.C.Lieu and Dominic Montserrat CONSTANTINE History, historiography and legend London and New York, 2002, f. 3.

[51] R. Palanque, 'CONSTANTIN I[er] LE GRAND, V. CONCLUSION', in *Dictionnaire d'histoire et de géographie ecclésiastiques*. Paris: Letouzey et Ané, 1956, vol. 13, cols 606-607.

[52] Spinka, Matthew, Spinka A History of Christianity in the Balkans: A Study in the Spread of Byzantine Culture Among the Slaves [Studies in Church History, Volume I. Chicago 1933, f. 186.

do të funksiononin gjatë tërë kohës. Por, ajo se çka është me e dëmshme këto kisha dolën jashtë natyrës së tyre fetare dhe morën pjesë në çdo veprim qe kishin marrë shtetet e tyre. Për të dal edhe nga vetë parimet bazë të krishtera duke ndërtuar edhe platforma shfarosëse ndaj popujve te tjerë siç është rasti me "*Megalli Idhea"* greke, si dhe "*Naçertanjën*" serbe të hartuara në vitin 1844. Në këto vende cezaropapizmi ka prodhuar shumë efekte negative dhe sot e kësaj dite kisha është në shërbim të shtetit dhe të politikave ditore.

Jo vetëm në këto vende por edhe në Evropën Perëndimore, Kisha Romake është një fuqi shpirtërore, shumë e centralizuar. Në Lindje, ajo nuk është e njëjtë, se kishat janë autoqefale, d.m.th. mund të themi se janë më shumë të pavarura nga njëra - tjetra, secila me planin e vet. Për shembull, nuk ishte kjo gjë e çuditshme në Rusi, deri në vitin 1917 Cari, apo perandori ishte konsideruar si kreu suprem i Kishës.[53]

Unë nuk mendoj se nuk mund të flasim për atë Rusinë cariste, për një cezaropapizëm absolut, sepse Kisha ka ruajtur gjithmonë strukturën e saj me , peshkopët e saj, patrikët e saj, dhe sinodit të shenjtë të saj.

Nuk po flasim shumë për përparësitë e cezaropapizmit absolut në Britani, edhe pse Mbretëresha e Anglisë edhe sot teorikisht, konsiderohet si kreu i Kishës Anglikane. Kjo kishë është e strukturuar shumë fort dhe përfaqëson në masë vetveten e vet. Megjithatë ka ende zona në Angli ku gjithnjë e më pak klerikët janë emëruar në famullinë e tyre nga zotëria i vendit. Dhe aty, jo aq larg nga ky shekull, parlamenti, trupi ynë politik, Dhoma e Lordëve dhe Dhoma e Komunave, kishin për të vendosur për miratimin e një libri të ri lutjesh, d.m.th. një energji e re për Kishën Anglikane.[54]

Por në anën tjetër nuk janë vetëm kishat e krishtera që i kaploi cezaropapizmi, pre e kësaj strukture u bënë edhe shumë vende islamike siç ishte rasti me shtetin e Ajatullah Homeinit apo me atë të Sadam Hyseinit por edhe sot te shumë vendeve arabe te cilat drejtohen sot nga i pari i vendit i cili e ka ne dorë edhe kontrollin fetar. Në fakt edhe këndej edhe pse në shumë vende përdoret rregulli i sheriatit me të cilin bëhet rregullimi shtetëror në asnjë masë nuk mund të ketë drejtësi për shkak që feja duhet të jetë e ndarë nga shteti duke mos ushtruar ndikim në njëra - tjetrën.

[53] Max Weber 2005…, f. 41.

[54] Charles Journet, L'Eglise du verbe incarné: La hiérarchie apostolique, St. Augustin Editions 1998 , p. 902.

Cezaropapizmi ishte më famëkeqi në carizmin Rusë, kur Ivan IV Grozni (i Tmerrshëm) mori titullin car në 1547 dhe e futi në vartësi Kishën Ortodokse të Rusisë ndaj shtetit.[55] Ky nivel i cezaropapizmit e tejkalonte atë të Perandorisë Bizantine.[56] Cezaropapizmi në Rusi shkoi në një nivel të ri në vitin 1721, kur Pjetri i Madh e shfuqizoi patriarkanën dhe zyrtarisht e bëri kishën një departament të qeverisë së tij të njohur zyrtarisht si fillim të Perandorisë Ruse. Megjithatë, në asnjë mënyrë cezaropapizmi nuk është pjesë e dogmës ortodokse. Realiteti historik, në krahasim me miratimin doktrinar apo përkufizimin dogmatik, të cezaropapizmit buron, sipas Metropolitanit Kallistos Ware[57], në konfuzionin e Perandorisë Bizantine me Mbretërinë e Zotit dhe zelli i Bizantit "që të vendoset këtu në tokë një ikonë e gjallë e qeverisjes së Zotit në parajsë".[58] Nga kjo mund të përfundojmë se është shteti i cili ka ndërhyrë ne religjion për ta pasur nën kontroll ndikimin e madh që kishin kishat në shoqëri. Në rastin e një njeriu gjeni, siç shprehet Baynes, të cilit ambicia dhe dashuria për pushtet i refuzojnë atij momentet e paqes, këtu nuk mund të ketë pyetje të krishterimit ose paganizmit, e besimit apo mosbesimit të vetëdijshëm. Një njëri i tillë është, edhe kur ai e bind veten se ai aty e ka pas vendin e tij.[59] Kjo bindje ka qenë prezente edhe tek Konstandini edhe tek Teodosi, Justiniani e shumë te tjerë, të cilët në mendjet e tyre konsideronin se ata ishin te dërguar te zotit për të kryer një mision. Një ngatërresë komplekse në forma të ndryshme të autoritetit në organizimin e krishterë e përshkruan një kler monarkik të vërtetë, e cila vjen në kontekste të ndryshme mes cezaropapizmit ku Perandoria dhe Kisha janë një trup i vetëm.[60] (Sidomos nën mbretërimin e Teodosit), Papa

[55] Bainton, Roland H. , Christendom: A Short History of Christianity I, New York: Harpër & Row, 1966, p. 119.

[56] Billington, James H., The Icon and the Axe: An Interpretive History of Russian Culture, New York: Random House,1966, p. 67.

[57] Kallistos Ware (lindur Timothy Ware më 11 shtator 1934) është një peshkop anglezë brenda Kishës Ortodokse Lindore nën Patriarkanën Ekumenike të Kostandinopojës dhe një prej teologëve më të njohur ortodoksë lindor bashkëkohore. Nga viti 1982 ai ka mbajtur titullin Peshkopi i Diokleia. Në vitin 2007 peshkopi u ngritë në peshkop titullar metropolitan.

[58] Ware, Timothy , The Orthodox Church (revised ed.), New York: Penguin Books 1980, f. 50.

[59] N. H. Baynes, Constantine the Great and the Christian Church, The Raleigh Lecture on History, Proceedings of the British Academy, 35 (I929), p. 4; Jacob Burckhardt, Die Zeit Constantins des Grossen, 3rd ed. (Leipzig, 1898), f. 369 (Ist ed., Basel, 1853).

[60] Célia Poulet, « Olivier Bobineau, L'empire des papes. Une sociologie du pouvoir

intervenoi rregullisht në çështjet publike, është papocezarizëm ku "Kisha gjykon, dhe ekzekuton fuqinë politike". Pra, ka raste edhe kur kisha ka ndikuar ne shtet, por në asnjë rast kur janë ngatërruar njëra me tjetrën nuk ka pasur zhvillime pozitive. Ky ndikim ka qenë po ashtu edhe gjatë kohës se inkuizicionit kishtar.

Por, merita kryesore i takon Konstandinit të Madh i cili jo vetëm që nisi rrugën që gradualisht krishterimi të bëhej fe shtetërore, por në anën tjetër i jep fund politeizmit. Deri në vendosjen përfundimtare të krishterimit si fe zyrtare shtetërore u deshtë të kalojnë edhe disa dekada kështu që në vitin 380 Teodosit dhe bashkë - perandorit të tij perëndimor Gratianus krishterimin e kishin ngritur në rangun e fesë shtetërore. Kur, si një hap i ardhshëm, të gjitha kultet pagane u nxorën jashtë ligjit, ende elita e vjetër romake me ndikim e dhanë mbështetjen e tyre për një kryengritje të një komandanti të ushtrisë kundër Teodosit. Kjo revoltë mund të shihet si rezistenca e fundit domethënëse e mjedisit pagan kundër aleancës së ngushtë te kishës dhe shtetit[61], respektivisht cezaropapizmit të cilin në vazhdim do ta ndjekin shumica e perandorëve sidomos ata të lindjes. Më vonë këtë shembull do ta shohim tek perandori më i madh bizantinas Justiniani i Madh. Ai sillet si paraardhësit të Pontifex Maximus, edhe në qoftë se ai nuk e bart titullin. Ky konfuzion i autoritetit civil dhe fetar, të quajtur "cezaropapizmi" jo vetëm që përfshin funksionet rituale e imperator - sacerdos (prift) pagan, por edhe i jep perandorit një vend të veçantë në sferën legjislative dhe teologjinë e Kishës siç tregon titulli që ai mban që nga Konstandini, isopostole, të barabartë me apostujt, që edhe ky pushtet vjen nga vetë iniciativa ose pranimi i përgjithshëm të një fakti të vendosur në dy shekujt e mëparshëm në vend të një të drejte të përcaktuar në mënyrë të qartë.[62]

Ky sistem ku fuqitë civile dhe fetare janë të bashkuara vetëm nën autoritetin e perandorit rrjedh nga identifikimi i këtyre dy fuqive në një person të vetëm që ka funksionet nga njëri ne domenin tjetër. Justiniani i konsideronte Papën dhe peshkopët e tij si zyrtarët në rregullin fetarë; ipeshkvinjët janë përgjegjës për administrimin financiar të qyteteve[63],

dans l'Église »,, Les comptes rendus, Paris CNRS, 2013,f,3

[61] Johannes Roldanus., The Church in the Age of Constantine The theological challenges . Routledge 2006 f.2

[62] Anne Fraïsse, Pouvoir de la religion et politique religieuse dans les premiers siècles du christianisme, l'exemple de deux empereurs : Constantin et Justinien, dans Cahiers d'études du religieux. Recherches interdisciplinaires , Paris 2007, p.7

[63] Cod. Just.1, 4, 26.

ata kontrollojnë qeveritarët provincialë, por ata edhe dëgjojnë edhe përkulen para vendimeve fetare të perandorit. Ai i bën mendimet e tij teologjike ligje të pagabueshme. Papa Agapet gjithashtu në një vizitë në Konstandinopojë u shpreh: "Unë kam ardhur në Konstandinopojë për të gjetur një besimtar Konstantin dhe unë jam para një Dioklecianit".[64] Kjo përforcon idenë time se nuk ka vazhdimësi në mendimin e perandorëve paganë dhe të krishterë, lidhja mes pushtetit dhe fesë: perandori duhet të ruajë rendin botëror i cili bashkon njerëzoren dhe hyjnoren[65]

Studimet e fundit të politikës fetare theksojnë se ai zhvilloi një mendim shumë të lartë të detyrimeve të tij si një perandor i krishterë. Dhe se legjislacioni i tij (duke përfshirë Kodin e famshëm të Justinianit) kishte favorizuar shpenzimet kishtare dhe administrative të strukturave të autoriteteve civile, por për më tepër, ato përforcuan absolutizmin perandorak ndaj Kishës dhe hierarkisë së saj, duke theksuar orientimin drejt Bizantit cezaropapist. Nga ana tjetër, ne mund të konsiderojmë se sundimi i Justinianit ishte një hap i rëndësishëm në largimin gradual midis Bizantit dhe Kishës Latine të Perëndimit, pjesërisht për shkak të rastit të Tre Kapitujve dhe se si Papa Vigjil u trajtua në Kostandinopojë.[66]

Nën sundimin e Justinit I (518 - 27) dhe nipit të tij Justinianit të madh (527 - 65), Kisha Katolike Romake rifitoi prestigjin e saj në Lindje, por gjëja e dytë e këtyre perandorëve është se ata nganjëherë krijojnë vështirësi serioze. Nëse marrim për bazë nderin e Papa S. Agapet në 536, ai depërtoi Silvère (Silverin 536 - 38) dhe u soll në mënyrë të padenjë ndaj Vigjilit (538 - 55), dhe e shpalli fajtor për mos miratimin e shpejtë të politikave perandorake në rastin e Tre Kapitujve. Perandori gjithashtu mori lirshëm zotërimet e ipeshkvinjeve të shtetit të tij, si dhe ligjeve për çështje të rendit thjesht dogmatik madje pa e pyetur mendimin e tyre, edhe pse deri atëherë vetëm ata

[64] Liber pontificalis, ed. Duchêsne, t.1, Paris 1886, p.2 86.

[65] Në antikë nuk besohej se qeniet njerëzore janë të natyrshme të mira, sociale, të civilizuara. Shoqëria, si gjithësia, e vendosur në një në rregull si një force superiore ka nevojë për anarki, revoltë natyrore. Është e njëjta gjë që të jesh një njëri, i devotshëm, qytetar i mirë dhe romak (kështu ka vështirësi në përkthimin e asaj qe prek njerëzoren dhe fetaren).

[66] JUSTINIEN I[er], në *Dictionnaire d'histoire et de géographie ecclésiastiques*. Paris: Letouzey et Ané, 2000-2003, vol. 28, cols 679-680.

ishin kompetent në këtë çështje. Në të vërtetë është ai i cili themeloi cezaropapizmin aq fatal për Kishën.[67]

Dukuria e cezaropapizmit e ka dëmtuar kishën në të shumtën e rasteve por asnjëherë shtetin. Kurse në anën tjetër kur kisha është përzier në shtet e cila qoftë në mënyrë direkte qoftë indirekte ka drejtuar në një formë apo ndonjë formë tjetër shtetin, imazhi i saj ka qenë i dëmtuar për shkak se vetë natyra e kishës nuk e lejon drejtimin e shtetit por drejton besimin e njerëzve tek Zoti. Pra, në të dyja rastet është kisha e dëmtuar sepse ajo nuk ka instrumente të forcës të cilat i determinojnë shpesh rrjedhat.

Kjo është parë në shumë raste edhe më vonë p.sh. në Gjermani rasti i mbretit Henri IV, ku ndikimi i perandorit ishte absolut ku mund ta marrim si një shembull si mbreti e fut në lojë papën. Marrëdhëniet në mes papës dhe mbretit kishin filluar nën kushte të favorshme; Henri IV, i sigurt që peshonte rreth një dënimi të miratuar nga Alexander II, bëri aktin e dorëzimit dhe premtoi në mënyrë të veçantë që të mos ndërhyjë në punët e Milanos, ku dy kryepeshkopët rival përfshiheshin (shtator 1073)[68]; Papa, nga ana e tij ndërkohë, kishte lehtësuar nënshtrimin e Saksonve të revoltuar kundër mbretit (1073 - 1074). Por shoku ishte i pashmangshëm mes një princi qe barte kurorën e një tradite të gjatë të cezaropapizmit dhe papatit për të afirmuar po të drejtën e tij për të gjykuar dhe ta sjellë atë edhe tek vetë perandori. Kështu mbreti Henri IV i ngriti ipeshkvinjët gjerman kundër papës, ky i fundit e përdori lëvizjen e fundit si armën më të fuqishme çkisherimin e mbretit Henri IV. Por mbreti arriti që të ngrit një papë tjetër Klementin e III. Në një luftë të gjatë për disa vite, disa qindra metra larg Sh. Pjetrit, Henry IV tregoi menjëherë fitoren e tij me kurorëzimin solemn të Klementit III,

[67] R. Janin, 'CONSTANTINOPLE, IV. RELATIONS AVEC ROME. LE TITRE DE PATRIARCHE ŒCUMÉNIQUE', in *Dictionnaire d'histoire et de géographie ecclésiastiques*. Paris: Letouzey et Ané, 1956, vol. 13, cols 643-645.

[68] Me propozimin milanez që konflikti shpërtheu në 1074, mbreti e kishte kënaqur Papën duke pranuar si të vërtetë Kryeipeshkvin Atton, pro-reformës. Në mars 1075, ekstremistët reformatorë, Pataret, ngjallen aq çrregullime të rënda sa që qyteti ishte djegur, ndërsa udhëheqësi i tyre, Erlembaud u vra. Mbështetësit e mbretit pastaj u kthyen tek ai dhe kërkuan edhe një kryeipeshkv. Edhe pse ai kishte një vit më parë, që njihte Attonin, Henry vuri këtë herë gjakonin Tédald, i cili u dorëzua me gjithë mbrojtjen e papës. Ky i fundit, në një bule të 8 dhjetorit 1075 kritikoi ashpër mbretin që nuk ka mbajtur fjalën e tij, në kundërshtim më dekretet papnore, kishte kryer emërimet ipeshkvnore në Fermo dhe Spoleto.

24 mars 1084, e ndjekur më 31 mars, në kurorëzimin shumëpritur perandorak.[69] Kështu u pa që mbreti dominoi edhe mbi papatin.

Mirëpo, Konstandini edhe pse e futi cezaropapizmin në veprim nuk mund të themi se në tërësi e kishte instaluar në aparatin shtetëror. Por, ajo çka është me rëndësi është që edhe pasardhësit e tij vazhduan që ta trashëgojnë sidomos të bijtë e tij që do të vijnë në pushtet menjëherë pas tij. Sipas Charles Pietri "në dekadën e fundit të mbretërimit të Konstandinit, qëndrimi si një fuqi mbrojtëse dhe si polic, mirëbërës dhe ngatërrestar në matjen e butësinë apo pavarësisë se ipeshkvinjëve, të ngritur në Lindje më shumë se në Perëndim në përkrahje të ipeshkvisë, një teknikë për kapjen e shijes, e përdorur për të kapërcyer një teologji apo ambicie më shumë personale. Sistemi cezaropapist ende nuk është vendosur në krye të shtetit, me të gjitha instrumentet e tij të kontrollit dhe të ideologjisë, qoftë edhe në mendjen e princit. Ai është tashmë në mendjen dhe qëndrimin e një pjesë të ipeshkvisë. Kjo është ajo që e bën të pasigurt këtë *imitatio Constantini*".[70] Ky dëshmitar i besnikërisë siguron shqetësimet ndoshta të qarta, disa vjet më vonë, siç pohon Eusebius i Cezares; si për të ruajtur veprën e perandorit "shpalli fjalën, e nderuar *Kishë si nuk ke bërë asnjë princ, si gjuetarë i politeizmit*". Në *Vita Constantini*, ipeshkvi rrëfen se e gjithë perandoria e krishterë që i është besuar të bijve të Kostandinit, pishtarëve të dritës së pasosur (V. C., I dhe IV 1.3 72); të caktuar nga babai i tyre (Konstandini), si tre Caezar legjitim të trashëgojnë pushtetin e tij, politikën e tij.[71]

Mirëpo trashëgimi i fronit nga të bijtë dhe ndjekja e politikës së babait të tyre solli një rënie të perandorisë romake sepse siç u pa edhe nga koha e babait të tyre. Konstandini i eliminoi kundërshtarët e tij dhe mbeti i vetëm. Ai eliminoi sistemin e tetrarkisë duke i dhënë fund këtij sistemi diçka të cilën do të provojnë ta ringjallin bijtë e tij, mirëpo nuk patën sukses. Në anën tjetër ishte krishterimi që ishte futur në shtet i cili edhe pse nën diktatin e Cezarit prapë se prapë kishte një ndikim mjaft të madh në Perandorinë Romake dhe si të tillë ata nuk ishin të gatshëm të ballafaqoheshin me të duke u munduar që vetëm ta imitojnë babain e

---

[69] 'GRÉGOIRE VII, 4° *Le conflit avec Henri IV*', in *Dictionnaire d'histoire et de géographie ecclésiastiques*. Paris: Letouzey et Ané, 1986, vol. 21, cols 1429-1432.

[70] Charles Pietri,La politique de Constance II: un premier 'césaropapisme' ou l'imitatio constantini?, Romë, 1997, f. 171.

[71] Eusebios, Vita Constantini,. IV 63, 3, 65, 1, 71, 2; Eusebii Pamphili, episcopi Caesareae, ... De vita Constantini imperat. libri quinque recèns conuersi de Graecis. Ioanne Portesio interprete , Publisher ex officina Michaëlis Fezandat, in domo Albretica è regione D. Hilarij, 1546.

tyre që solli si pasojë edhe konfliktin në mes tyre. Por, cezaropzpizmi zuri vend në politiken e tyre dhe në vazhdimësi të të gjithë sundimtarët tjerë sidomos ata lindorë duke u bërë pjesë e pandashme e qeverisjes.

Cezaropapizmi përveç qe ka vazhduar të jetë në fuqi gjatë tërë kohës në Perandorinë Bizantine ai vazhdoi të merret si model dhe të përdoret nga shumë shtete dhe mbretëri të ndryshme nëpër botë. Edhe sot e kësaj dite kemi shembuj të cezaropapizmit si në vendet arabe ku shteti dhe feja janë një, shteti funksionon sipas rregullave të sheriatit. Pra shembulli dhe modeli janë marrë nga Konstandini i cili për herë të parë e futi krishterimin në shtet dhe pas shpalljes se Ediktit famoz të Milanit të vitit 313 fillon që monoteizmi respektivisht krishterimi gradualisht të bëhet fe zyrtare kur më vonë Teodosi në vitin 389 do ta bëjë të vetmen fe zyrtare në perandori. Por, në anën tjetër ishte cezaropapizmi i cili çoj drejt skizmës se madhe kishtare qe ndau krishterimin në dysh e më vonë janë po ashtu kishat nacionale te cilat quan tani më ne ndarje të reja dhe sot krishterimi ka shumë degë qe dolën nga trungu katolik. Këtu do te kisha shtuar edhe gabimet e kishës perëndimore të papatit në Romë e cila sidomos gjatë periudhës se inkuizicionit kaloi një ndër etapat më të errëta në historinë e saj dhe se ajo kontribuoi në ndarjen e dytë pas reformacionit. Edhe në rastet e tilla ku i pari i fesë e ka pushtetin mbi qeverinë është gabim i madh. Në rastin e Konstandinit i cili i pari e aplikoi cezaropapizmin ka pasur një bazë të qëndrueshme sepse edhe në shoqëritë romake tek politeizmi perandori me titullin Pontifex Maximus ishte edhe i pari i shtetit edhe i pari i religjionit. Se nuk ka mundur t'i ikë riteve të vjetra shihet adhurimi i kultit të diellit i cili ishte shumë i përhapur tek ilirët dhe dardanët dhe si i tillë duket që ka qenë i ngulitur tek ai që nga fëmijëria. Vetë fakti qe Konstandini ishte i edukuar në oborrin e një perandori, Dioklecianit njëri ndër perandorët më të njohur në Romë na bën të kuptojmë se ai ishte i prirur ta ketë pushtetin absolut dhe kjo ka qenë shumë e frytshme tek politeizmi por jo edhe tek monoteizmi respektivisht krishterimi. Cezaropapizmi është parë se nuk jep rezultate pozitive dhe në vendet ku është prezentë dominon teokracia dhe qeveritë e tilla shkojnë drejt totalitarizmit.

Arben ARIFI

SUMMARY

CESAROPAPISME OF CONSTANTINE THE GREAT

At the beginning of the IVth century, numerous changes happened in the Roman Empire of which the most significant were the Barbarian invasions and the separation of the Empire. However, this period is also characterized by the end of Roman polytheism and the emergence of Christianity, whose followers were persecuted for centuries before its emergence as an official Roman state religion. To begin with, the great emperor of Dardanian descent, Constantine the Great, signed the renown edict of Milan in 313, at which point he ceases to persecute Christians and at the same time grants religious freedom of exercising all religions equally. After he came to power, at which point he had already disintegrated the tetrarchy of Diocletian, Constantine the Great was eager to keep under his control the ever growing number of Christians throughout the Empire. He achieved this by creating the Ceasaropapism, which granted him supreme religious and public authority. Through this he managed to administer the Empire very well by creating another center to the Empire, namely Constantinople – christening the city by his name – and reclaiming the Empire's dignitiy once again before its demise and separation in two. The city that Constantine founded became an epicenter of human civilization. However quite surprisingly, Constantine the Great was a follower of a very widespread cult among the Dardanians which worshiped the son deity *Sol invictus,* and was only baptized and accepted Christianity in his deathbed.

Skënder GASHI

MENDIME RRETH PREJARDHJES SË EMRAVE JANJEVË E CECELI

Objekt trajtimi në këtë shkrim është prejardhja, në rrafshin gjuhësor, e emrit Janjevë të *qytetthit* në komunën e Lypianit dhe Ceceli e katundit të komunës së Vushtrrisë. Në këtë kuadër është gjurmuar çështja e themeluesit të kishës së kryehershme të Janjevës dhe të kishës që do të ketë ekzistuar në katundin e sotëm Ceceli të Vushtrrisë.

I. Janjevë

Të gjitha burimet që dihen deri tani përkitazi me historikun e *qytetthit* të Janjevës tregojnë se në këtë rast kemi të bëjmë me një vendbanim të ngritur në krye të herës nga elementi etnik sas (gjerman), i ardhur këndej për të (ri)aktivizuar miniera* dhe i rritur me të vendosur të tregtarëve, nëpunësve e qytetarëve të Republikës së Raguzës dhe nga qytete të tjera të Jugut të Adriatikut si dhe nga Venediku, Gjenova etj.

Sado që nuk ka ndonjë njoftim për kohën e saktë të themelimit të kolonisë xehetare të Janjevës së sotme, të dhëna të tërthorta e lejojnë paravendimin që fillet e ngritjes së këtij vendbanimi janë të pandashme nga vendosja aty e elementit etnik sas. Kjo lidhet me një letër të papës Benedikti XI (të vitit 1303) drejtuar arqipeshkvit të Tivarit në të cilën, përkrah kishave katolike në Bërskovë, Rudnik, Rogoznë e në Trepçe, përmendet edhe një kishë katolike në famullinë e Graçanicës, përkatësisht të Janjevës.[1] Kisha e përmendur në këtë burim nuk ka të

---

*Më gjerësisht përkitazi me rrethanat nën të cilat ngriteshin vendbanime të këtij tipi khs. trajtesën time "Albanisch - Sächsische Berührungen in Kosova und einige ihrer onomastischen und lexikalischen Relikte", *Dardania*, 4 (1995), f. 86-127.

[1] 1Khs.:„*Benedictus XI. Papa adpetitionem Marini archiepiscopi Antibarenses eidem concedit fascultate minstituendiet destituendir ectoresin ecclesia parochialibus„de*

bëjë as me Janjevën e sotme e as me kishën ekzistuese të saj, porse me Janjevën e vjetër dhe me kishën e saj të atëhershme, gjë që donë të thotë se vendbanimi ka qenë i ngritur shumë kohë përpara vitit 1303. Nuk është e njohur se në ç'kohë, përpara përmendjes më 1303, ajo kishë ishte bërë qendër e famullisë, cilit shenjtor i ishte kushtuar e as cilat kisha ishin nën juridiksionin e asaj famullie. Sipas mendimit të përgjithshëm, famullia e përmendur në letrën e Papës Benedikti XI për si e Graçanicës ka të bëjë në të vërtetë me famullinë katolike të Janjevës, por që është ngatërruar nga shkruesi i oborrit të Papës.

Duket se arsyeja përse në dokumentin e vitit 1303 famullia e Janjevës nuk përmendet me emrin e vet, porse quhet gabimisht për e Graçanicës, (khs. më lart) duhet të kërkohet tek rrethana që vendbanimi i sasëve minatorë dhe i kishës së tyre (famullitare) në Janjevë ishte ende i panjohur për nëpunësit e oborrit të Vatikanit. Ata do të kenë ditur (vetëm me të dëgjuar) se në afërsi të Graçanicës, përkatësisht të ipeshkvisë bizantine - serbe të Lypenionit / Lypianit, kishte një enklavë katolike që e kishte një kishë dhe, asgjë më shumë.

Pranohet përgjithësisht që popullata shumicë e Janjevës së kryehershme përbëhej nga sasë. Evidentimi i kësaj kishe katolike që mund të jetë ngritur gjatë shek. XII, është për historianin serb Stojan Novakoviq[2] dëshmi se Janjeva (bashkë me Novobërdën) nuk ishte në atë kohë nën sovranitetin e shtetit serb të Rashës. Ky fakt del i qartë në një shënim të arqipeshkvit serb Danilo, i cili më 1282, "kur po e përshkruante fillimin e sundimit të atij mbreti (SG: të Millutinit) shkruante (përkthimi im i lirë): se: "*po ta shikoje ato ditë tokën serbe do ta shihje atë të ngushtuar shumë, të varfër e të zvogëluar; shteti ishte i mbretërisë greke që shtrihej deri në vendin e quajtur glagolisht, Liplan*".[3] Me këto fjalë , vazhdon St. Novakoviq - është thënë edhe ajo

---

Briscouia(Bristonia),de Rudenico,de Rogosna et de Trepzo et de Grazaniza in Regno Servie"constituitis „ubifi des cattolica colituretritus Romane eclesie observatur episcopitamen illarum patrium, qui des uisasserunt diecesibus ecclesiases isteresupradictas, fide metri tushuismo di non opservant" cit. sipas J. Drançolli, Raguzanët në Kosovë, Prishtinë, 1986, f. 64, ref. 2.

[2] Khs. Stojan Novaković. *Novo Brdo i Vranjsko Pomoravlje u istoriji srpskoj XIV i XV veka*, Beograd: Državna štamparija, 1880, f. 29.

[3] Khs. origjinalin: „*bě bon vь tы dьni viděti zemlju srьbьskoju vь těsnotě vєlicě obьjetou i umaljenou; drьžava bo carsьstva grьčьkago bě priležešti do města glagoljenago Lipljan*"te St. Novaković*, Novo Brdo i Vranjsko Pomoralvje*, f. 28., përkatësisht: „ kraljevstvo moє mnogьimi napastmi i outeskьijemїєmъ srьbskoi zєmli ωbьєtě souštї i oumaljenie; drьžava bo grьčeskago carьstva bě priležešti do města glagoljenago Lipljanja" te Ljub. Stojanović, "Srpski hrisovulji, akti, biografije,

që serbët, duke mos e pasur për të vetin Lypianin, vija kthyese[*] e të cilit ishte në vijën Gjilan - Kumanovë e Kaçanik, nuk kanë mundur ta kishin nën sundim as Vranjën, as Novobërdën, porse që kufiri (S.G: midis shtetit të Bizantit dhe principatës në ekspansion të Rashës) ishte diku midis Lypianit e Prishtinës".[4] Në referencën 1 të po këtij punimi St. Novakoviq vërente se "Dragosheviq shkruante në Glasnik XLV fq. 78 të Akademisë Serbe të Shkencave se: "Midis Zhegovcit e Moravës është Mali i Zhegovcit, në të cilin ishte kufiri i perandorisë bizantine dhe i mbretërisë serbe në këtë anë në fillim të sundimit të mbretit Millutin", për të vazhduar pastaj "Që Lypiani me të vërtetë ishte një kohë jashtë pushtetit serb, kujtoj se e dëshmon krisobula e Millutin-it manastirit të Graçanicës lëshuar për arqipeshkvinë e Lypianit[5] përmes së cilës ky e ngrite rishtazi ipeshkvinë e rrënuar e të djegur dhe ia kthente kësaj pronat sipas krisobulës së të gjyshit e të t'et (d.m.th. sipas krisobulave të Stefan Nemanjës dhe të të birit, të quajtur po ashtu Stefan, Mbretit të Parë të Kurorëzuar[*] të serbëve) që fundja, e dëshmon edhe rrethana që manastirit ato prona të Lypianit (Rrafshit të Kosovës), të Moravës (Gjilanit) e të Topolnicës (Krivarekës) ia jepte *pushteti grek dhe sundimtari* (SG: serb, nënvizim i imi). Ato luftëra dhe pushtime alternative midis bizantinëve e serbëve bënë që Graçanica të shkatërrohej[**] e të lehej pasdore". Me këtë ka lidhje edhe konstatimi i këtij autori se pikërisht për këtë arsye as një xehetari në Novobërdë e në Janjevë, që do të ishte e drejtuar nga serbët, nuk mund të jetë më e hershme se e shekullit të XIV, përkatësisht më e vjetër se viti 1326 kur Millutini i pushtoi të dy Pollogët, Ovqepolje-n e Zletovo-n në Maqedoni dhe Novobërdën, sepse thotë Novakoviq - në Janjevë dëshmohet qysh më 1303 kisha katolike dhe pse në fund të shek. XIII, përkatësisht në

---

ljetopisi, tipici, pomenici, zapisi i dr", *Spomenik* SKA III (1890), f. 18.

[*] Unë e kuptoj këtë shprehje në kuptimin që këto vende mund të ishin nën juridiksionin e ipeshkvisë së Lypianit.

[4] Shih St. Novaković, *Novo Brdo i Vranjsko pomoravlje*, f. 28-29.

[5] Khs. Fr. Miklosich, *Monumenta serbica spectantia historiam Serbiae, Bosnae, Ragusii*, Viennae, 1858, f. 562. etj.

[*] I bir i Stefan Nemanjës. Edhe ky quhej Stefan. Falë martesës së tij me bijën e një venedikasi të shtresës së lartë, kurorën mbretërore ia dha vetë papa aktual. Më gjerësisht shih te Sime Ljubić, *Opis jugoslavenskih novaca, Zagreb*, 1875.

[**] Ky rrënim e shkretim do të jetë vetëm njëri ndër disa sish që kjo qendër ipeshkvnore i pësoi nga sulmet e herëpashershme të kontëve serbë të Rashës. Kështu e kishte pësuar Lypiani një herë edhe nga një sulm i kontit të madh serb Vukan më 1091 kur ky e kishte djegur Lypianin dhe kishte shkatërruar vise të tjera. Khs. për këtë J.Osmani, "Lypjani", *Vendbanimet e Kosovës*, Prishtinë 2004, f. 149.

periudhën midis viteve 1282 - 1336 në hapësirën midis lumenjve të Sitnicës e të Moravës xehetaria kishte marrë hov të madh zhvillimi."[6] Dhe, kjo xehetari as nuk ishte nxitur e as nuk drejtohej nga serbët.

Këtyre të dhënave bën t'u shtohen edhe disa të tjera që nuk i përmend Novakoviq-i e këto janë se Lypiani sulmohej e pushtohej apo shkretohej nga zhupanë të principatës së Rashës. Dihet p.sh. se Lypianin e kishte sulmuar një herë zhupani i Madh Vlkan në vitin 1091 dhe e kishte djegur atë. Mirëpo, Lypiani nuk ra që atëherë në duar të serbëve. Kjo mësohet edhe nga rrethana se, sipas Anna Komnena-s (1083 - 1150) vetë perandori bizantin Alexios I Komnenos-i (1048 - 1118) kishte ardhur në vitin 1097 në qytetin Zygos (vendi i sotëm *Kalaja* në katundin Zhegovc? të rrethinave të Lypianit), për ta drejtuar luftën kundër sulmeve të Vlkan-it (Vukanit). Sulmet serbe dhe pushtimet e herëpashershme vazhduan edhe më tej. Në shkrime të karakterit gjenealogjik, biografik mësohet se edhe Stefan Nemanja kishte rrënuar qytete të „grekëve". Nemanja e paska marrë pushtetin „në shtetin serb",[***] - kështu thuhet në shkrime të kësaj natyre-, vitin e 24-t të sundimit të Mihael Komnenit; se i vëllai i tij Miroslav-i kishte qenë knez në shtetin e Zahumit[****] dhe se Dalmacinë e mbanin "Grekët". Pikërisht në këtë kohë 12 bujarë të mëdhenj e paskan nisur përndjekjen e bullgarëve e të grekëve dhe i rrënuan qytetet e tyre".[7] Nga burime të tjera mësohet se famullitari katolik i kësaj kishte dëshmohet qysh në vitin 1328[8] dhe se Janjeva kishte asokohe dy kisha katolike. Njëra ndër kishat katolike të Janjevës përmendet, bashkë me kishat katolike të kolonive raguzase, edhe në një dokument të vitit 1426 në të cilin numëroheshin kishat „[...] *in Prisren*, *Novo Berda*, *Trepte* (lexo*: Trepce*), *Janeua*, *Coporichc*, *Plane* [...]", të cilat i takonin ipeshkvisë së Kotorrit.[9]

---

[6] Shih St. Novaković, *Novo Brdo i Vranjsko Pomoravlje*, f. 29.

[***] Në origjinal: "u srpskoj zemlji".

[****] Në origjinal: „u zahumskoj zemlji". Ky regjion ka të bëjë me Hercegovinën e sotme.

[7] Khs. Ljub. Stoj"nović, "Stari srpski hrisovulji", f. 18.

[8] Sipas Gaspër Gjini, *Ipeshkvia Shkup - Prizren nëpër shekuj*, Drita, Ferizaj, 1992, f. 84.

[9] Shih C. Jireček, *Staat und Gesellschaft im mittelalterlichen Serbien, Studien zur Kulturgeschichte des 13-15 Jahrhunderts,* I, II, Denkschriften des Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften in Wien, Philosophisch- Historische Klasse, Band LVI, Wien, 1912, f. 66, 68.

Se kishat e Janjevës ishin ngritur nga sasët dëshmohet edhe përmes mbishkrimesh me alfabet gotik në ato kisha, përkatësisht në pajisje të tyre të brendshme. Kështu, sipas. I. Jastrebov,[10] i njohur për qëndrimin pansllavist të tij, një mbishkrim gotik qenka gdhendur në një gur të gjetur, "*gjatë kohës së ngritjes së kishës së sotme latine mbi themele të kishës së dikurshme pravosllave, i cili (gur) gjendet i murosur në murin perëndimor të kishës - bukur lart mbi dyert e perëndimit nga jashtë*." Mbishkrimi tjetër është, përsëri sipas Jastrebov-it, "*përreth kambanës së kishës së tanishme latine në Janjevë, në emër të Shën Kollit, dikur në kohë të moçme kishë pravosllave*"[11], ortodokse serbe!).

Këto të dhëna i ka trajtuar edhe kleriku e dijetari ynë Gaspër Gjini[12] i cili përkitazi me këto sqaronte se: „kambana më e vogël që edhe sot gjendet në kambanoren e kishës së Janjevës rrjedh nga vitet 1368 dhe ka mbishkrim gotik.[*] Në kambanoren e kishës së Janjevës është murosur një pllakë guri me shkronja latine dhe gotike, e cila këtu është sjellë nga kisha e moçme e Shën Kollit. Kjo do të mund të na shtynte të përfundojmë se banorët e parë të Janjevës kanë qenë sasët apo se ata ishin shumica, dhe prandaj ia jepnin ngjyrën jetës publike. Mirëpo në dokumentet e papës, Janjeva siç do të shohim më vonë, për herë të parë përmendet në vitin 1346. Ndërsa, kolonia e Dubrovnikut, siç është konstatuar në bazë të akteve dubrovnikase, si bashkësi e formuar e dubrovnikasve në Janjevë, paraqitet për herë të parë në vitin 1433". Për arsye teknike, mungesa e shkronjave gotike nëpër shtypshkronja, tekstet e mbishkrimeve gotike nuk janë dhënë as nga Jastrebov as nga G. Gjini. Duket se[13] fjala është për mbishkrimin IVNII IOC OPVUS FECIT FI ERI PLEBNVUS STEPIIA NV MARCI P.P. OP. TESA. A, të cilin porse e kanë transliteruar Nikola Čolak & Ive Mažuran.[14] Ky mbishkrim qenka sot i murosur në godinën e vjetër të shkollës së Janjevës. I. Jastrebov[14a] na mëson se, "Në një gur tjetër të gjetur po në këtë kohë në Janjevë, porse jo të murosur në mur, është ky mbishkrim latin: *Successo*

[10]Shih I. Jastrebov „Podaci za istoriju crkve u Staroj Srbiji", *Glasnik Srpskog Učenog Društva* XLII(1875), f. 357.
[11]*Po aty*.
[12] Shih G. Gjini, *Ipeshkvia Shkup-Prizren*, f. 84-85.
[*]S.G: Unë ia shtoj kësaj të dhënën se kjo kumbonë ishte shkrirë në Köln në vitin 1368 dhe prej andej u soll në Janjevë.
[13]Sipas J. Osmani, *Vendbanimet e Kosovës*, 5, f. 133.
[14] Shih librin e tyre Nikola Čolak, Ive Mažuran, *Janjevo: sedam stoljeća opstojnosti Hrvata na Kosovu*, Zagreb, 2000, f. 22.
[14a] Shih. I. Jastrebov "Podaci za istoriju crkve", f. 357.

et Aelio agrippina ejus parentibus et ac aselepia de generorum aeli ingenia et successa Agrippae licet innovanti ingeus genere durel aurelus Nepos. B. M. F. E. C. Havet Rosiaee".

Mungesën e të dhënave se në ç'stil arkitektonik ishte ngritur kisha e kryehershme e Shën Kollit të Janajevës, e kompensojnë bukur fort studimet që janë bërë për "*Kishën e Sasëve*" të Novobërdës - e shënjuar në burime si „*Santa Maria de Nuovamonte*", kishë për të cilën, sikundër e tregon edhe vetë atributi "e sasëve", ishte kishë e elementit kolon sas të këtij qyteti. Kemi të bëjmë me gërmadhat e një kishe, gjurmët e së cilës shihen edhe sot në katundin Bostan rrëzë Novobërdës, të cilën (kishë) popullata serbe e këtij katundi e quan edhe sot *Saška crkva* "Kisha e Sasëve". Në defterin osman të fundshekullit XV kjo kishë, po si *Šaška crkva* „Kisha e Sasëve", është evidentuar për mëhallën e Novobërdës. Përveç të tjerësh, aty jetonin edhe banorët shqiptarë: Gjon -i i bir i Marko -s; Tuna i bir i Jovan -it dhe pop (prifti) *dom* Nikolla e të tjerë[15], gjë që e dëshmon bashkëjetesën e shqiptarëve dhe të sasëve.
Mendimi i shprehur nga J. Drançolli,[16] mbase me pak kompetencë në fushën e arkitekturës, se Kisha e Sasëve qenka ndërtuar sipas stilit të arkitekturës së Kuvendit Françeskan dhe të Kuvendit Dominikan të Raguzës, përkatësisht sipas arkitekturës romane, nuk mund t'i dalë përballë të vërtetës tjetër se kjo ishte ngritur sipas stilit gotik, përkatësisht sipas stilit gjerman. Dijetari hungarez M. Takács[17] ka treguar megjithatë se ajo paska qenë ndërtuar nga sasët, përkatësisht se ishte kishë gotike. Kjo paska qenë, në këtë pikëpamje, një unikat në gjithë Ballkanin. Kjo kishë paska qenë e tipit të kishave që u përhap në shek. XI - XII dhe që të tilla ndeshen në hapësirën etnike gjermane, përfshirë edhe Austrinë e Poshtme. *Kisha e Sasëve* qenka ngritur dy - tre breza pas ngulitjes së sasëve në Novobërdë, duke i ndenjur besnik traditës arkitektonike të kishave të atdheut të tyre të kryehershëm, përkatësisht landit të Sasëve në pjesën lindore të Gjermanisë së sotme. Se kisha e quajtur "e Sasëve" e Novobërdës e mbase edhe ajo e Janjevës ishte kishë në të cilën gjuhë e liturgjisë ishte gjermanishtja dhe se edhe vetë besimtarët sasë e flisnin atë gjuhë, e tregojnë edhe ardhje-vajtjet e herëpashershme të klerikëve katolikë në kishat e qyteteve -

[15] Shih. Iljaz Rexha, "Regjistrimi i vendbanimeve dhe i popullsisë së kazasë së Novobërdës sipas defterit të fundshekullit XV", *Vjetar* XXVII - XXVIII (2002), f. 68, 69.
[16] J.Drançolli, *Raguzanët në Kosovë*, f. 232.
[17] Khs. Miklós Takács, "Sächsische Bergleute im mittelalterlichen Serbien und die „sächsische Kirche" von Novo Brdo", *Südost-Forschungen*, Band L (1991), f. 48-60.

miniera raguzase e sase të Kosovës të cilët (priftërinjtë) nuk kishin manastire të tyret madje as në Novobërdë e pra as në Janjevë.

Kjo rrethanë e tregon mbase karakterin prej kolonish, mungesën e priftërinjve vendës në ambientet e minatorëve sasë dhe mbajtjen e kishave e të besimtarëve të atyre qyteteve pothuaj në formë misionesh nga priftërinjtë që dërgoheshin alternativisht. Le të na kujtohet p.sh. rasti i plebanit Parcus, të birit të gjermanit të ndjerë Paulus, përkatësisht famullitari *donus Parcus quondam Pauli Theutonicus*, që ishte një gjerman i ardhur në Novobërdë nga qyteti i Köln-it dhe që në Novobërdë shërbeu në vitet 1421 - 1422.[18]Vështruar kronologjikisht, duket se me vendbanimin e sotëm mund të ketë të bëjë varianti *Aiano* i emrit, i dëshmuar në shek. XII;[19]variantet *Janeuo* (lexo Janevo) i dëshmuar në vitin 1438;[20]*Jagnevo* në burime raguzase të shek. XV; *Agneva* në vitin 1441: "presbiter *Andreas* plebanus sancti Nicolai de Agneva".[21]*Janjeva* (e Poshtme dhe e Epërme) në vitet 1566-1574; *Ianeuo* (lexo Janevo) e dëshmuar në vitin 1624;[22]*Yanova* (lexo Janova) në vitin 1657;[23]*Iagnevo* (lexo Janjevo) në një hartë të vitit 1689[24] dhe në një hartë tjetër të vitit 1788 të autorit Maximilian Schimeck;[25]*Janjevo* në vitin 1867;[26]*Janievo* në vitin 1877 etj. Mbase pse ishte koloni eksklavë e sasëve dhe e raguzasve katolikë, Janjeva mbetet jashtë domenit të dokumentacionit kishtar serb. Duket se kështu duhet sqaruar edhe rrethana përse Janjeva dhe lagjet e saj nuk ishin përfshirë në regjistrimin osman - turk të v. 1455, që lë të nënkuptohet se kjo nuk ishte përfshirë ende në kuadrin e territorit vasal të Brankoviq-ëve.Ndër të parët që u morën me çështjen e prejardhjes së këtij emri është dijetari frëng Ami

[18]M. Takács, "Sächsische Bergleute", f. 39; khs. edhe M. Dinić, *Za istoriju rudarstva*, I, f. 6; Muhamet Tërnava, *Popullsia e Kosovës gjatë shekujve XIV - XVI*, Prishtinë, 1995, f. 385.

[19] Sipas Muharrem Carrabregu, *Kosova në hartat e vjetra - Kontribut gjeografisë historike të Kosovës*, Prishtinë, 1977, f. 43.

[20] M. Dinić, *Iz dubrovačkog arhiva*, I, Beograd, 1957, f. 7.

[21]SipasN. Čolak-I. Mažuran, *Janjevo*, f. 22, 23.

[22] Injac Zamputi, *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII*, vëll. I, Tiranë, 1963,. f. 335.

[23] Sipas M. Carrabregu, *Kosova në hartat e vjetra*, f. 75.

[24] E titulluar *Regno della Servia detta altrimenti Rascia* ..., 1689 e autorit Giacomo Cantelli da Vignola.

[25] Sipas N. Čolak - I. Mažuran, *Janjevo*, f. 8.

[26] Khs. Todor P. Stanković, *Putne beleške po Staroj Srbiji,* Beograd, 1910, f. 89.

Boué. Në veprën e tij udhëpërshkruese,[27] ky e shfaqte mendimin se emri i Janjevës na qenka me prejardhje sllave.

Ky emër po rrjedhka, sipas tij, nga fjala sllave *janje* cila në dalmatishten e sllavizuar / kroatishten do të thotë "plep" (bot. Populus) ndërsa në serbishten *jasen* "frashër" (bot. Fraxinus) dhe „qingj". Autori ynë sqaronte se në hapësira të banuara nga sllavë, toponimet e sajuara nga emri i plepit ndeshen mjaft dendur. Prej të së njëjtës prejardhje Boué i shihte edhe emrat *Janja* në Bosne, *Janica* e *Janova* afër Dubnicës dhe *Janjari* në Eipir e ndoshta, madje, edhe *Janina*[28] e shqiptarëve. Unë paramendoj që ka shumë mundësi që, më parë se nga emri sllav *janj* i drurit të plepit apo të frashërit, kolonia sase e Janjevës së kryehershme mund ta ketë pasur për distinktiv emrin e shenjtores **Agnes*, *a* së cilës mund t'i jetë kushtuar kapela apo kisha origjinare e sasëve të kohës së ngulitjes së tyre në këtë hapësirë. Emri i kryehershëm i padëshmuar në burime i kishës dhe i vendbanimit të sasëve mund të jetë përkthyer / adaptuar nga raguzasit sllavishtfolës pas bashkëngjitjes së bashkësisë sase më të vogël për nga numri Janjevës së re të fillimit të shek. XV kur kjo mbizotërohej nga popullata ardhëse e raguzasve. Kjo aq më parë pse dihet që trajta *Janja* edhe është variant sllav i antroponimit femëror *Agnes*,-*a*[29] i uzusit atroponimik të kishës së Perëndimit, (khs. angl. *Agnes*, fr. *Agnès*, gjerm. *Agnes*, it. *Agnese*, span. e port. Iñês, hung. *Ágnes*, në rus. (si emër modern) *Agnesa*, ndërsa në pol. *Jagna*, *Jagnieszka* etj.)[30] i cili (antroponim) qenka[31] në të vërtetë me prejardhje greke nga greq. *Ἁγνή*, (Agne) përkatësisht *Ἀνέξα* (Anesa)dhe e paska kuptimin e rum. *casta*, përkatësisht "e dlirë; e dlirët; e papërlyer", por që më vonë gabimisht u lidh me fjalën latine *agnus* "qengj" (përkatësisht *agna*, *ae* "qengj femër"). Nga kjo histori duhet të ndahet atributi *Agnus Dei* (greq. "Qengji i Zotit") që i jepet Jezu Krishtit dhe nga Pessach-u "Çlirimi nga skllavëria egjyptase" i hebrenjve.

Këtë emër e mbante Sh'na *Agnesa,* e cila gjithmonë portretohet bashkë me një qengj në prehër. Kjo shenjtore u martirizua në kohën e Dioklecianit (rreth vitit 300). Ajo nderohet për si patrone e virgjërisë.[32] Dita e kremtes së kësaj shenjtoreje është, si në kishën e Perëndimit

[27]*Recueil d'itinéraires dans la Turquie d'Europe*, I., Vienne, 1854, f. 348, cit. sipas N. Čolak - I.Mažuran, *Janjevo*, f. 23.
[28]Sipas N.Čolak - I.Mažuran, *Janjevo*, f. 23.
[29]Po aty.
[30] Sipas Cristian Ionescu, *Mică enciclopedie onomastică*, Bucureşti, 1975, f. 29.
[31] Sipas N. A. Constantinescu, *Dicţionar onomastic romînesc*, Bucureşti, 1963, f. 6.
[32]Sipas Lutz Mackensen, *Das große Buch der Vornamen*, Wiesbaden, 1990, f. 215.

ashtu edhe në atë të Lindjes, më 21 janar. Ka mundësi që kisha e kryehershme e sasëve t'i ketë qenë kushtuar Sh'na *Agnes* -ës në bazë të së cilës do të jetë quajtur edhe vendbanimi, emri *Janjevo* i të cilit, si adaptim kroat, përputhet kuptimisht me emrin e shenjtores. Tek shqiptarët e ritit katolik, ky antroponim ndeshet në trajtat *Agnesa*, *Anjeza,Anjeze* dhe në trajta të shkurtra *Njeze* e *Jana*. Në Kosovë ndeshet edhe si emër mashkulli në trajtën *Agni*. Tek shqiptarët e ritit ortodoks, ky emër ndeshet si emër mashkullor në trajtat *Jan*, *Jani* e *Janaç*. Ndryshe, në hapësira të Evropës Perëndimore dëshmohen më shumë se 83 variante, femërore e mashkullore, të këtij antroponimi.

Antroponimi *Jan*, për si pjesë e dytë e një emri kompozitë (i sajuar nga mbiemri grek καλός "i bukur" dhe antroponimi *Jan*), dëshmohet edhe në krisobulën e viteve 1313 - 1318. Asokohe, manastirit të Banjskës, përkatësisht të Shën Stefanit, i falej edhe katundi Gumnishtë, i krahinëzës. Në kufijtë e Gumnishtës me Plluzhinën, në bregun e përtejmë të lumit të Klinës ishte edhe vendi i quajtur Kroi i Kallojanit. Khs. tekstin: "Dhe në Hvostne katundin Gumnishta dhe kufijnë e tij nga Plluzhina nga Dardha e Bojat-it përroit teposhtë e në Kundeg. Nga Kundegu nëpër Majën e Gurit dhe udhës nëpër mal deri te Udha e Kreçet-it ku udha bie në Ledinën e Dupet-it. Dhe udhës përfundi Shtëpive të Didl-it në përrua në anën/bregun tjetër të Kninës (G.G. lumit të Klinës) tek bërraka [...] dhe nga brrakanë anën tjetër të Kninës sipri Kroit të Kallojanit dhe nga kroi në atë anë sipëri Llazit të Farkëtarit nëpër mal përmes Përroit të Mrat-it dhe në mal i cili shkon nga Plluzhina përballë Vneshtës së Georg-ut. Në [...] të Dardhës së Bojat-it".[33]

Megjithëse unë nuk e di se cili ishte katundi Gumnishta i krisobulës, e sigurt është që Plluzhina e këtij dokumenti është katundi i sotëm Plluzhinë i komunës së Skenderajt. Në të mirë të këtij identifikimi shkon, përveç emrit të katundit, edhe vazhdimi deri në ditë tonat i

[33] Khs. origjinalin tek *Svetostefanka hrisovulja*..., f. 3: „I u Hvost'në. Selo goum'ništa. a megje mou. ωt ploužinь ωt kroušьke bojatije nz potokь ou koun'dёgь. ωt koun'degja ous kamenьi rьtь. i po dělou poutemь. do pouti krečet'skoga. kako poutь spada na doupetini laze. i nis poutь niže didlovёhь kouštьь ou potokь. Sь sije strane knine. na tip'čanju lokvou. i ωt louke sь sije strane knine nadь stouden'cь kalojanь i ωt stouden'ca na ωnou stranou nadь kovačeve laze po dělou ouz' mratinь potok. i ou dělь koi grede ωt ploužinь proivou geωr'gijevu vinogradou. ou toužde krou'škou bojatuiju.".

mikrotoponimit *mratinь potok*, në trajtën *Mratinci* i cili sot shënjon kompleksin me pyje të këtij katundi të Drenicës.[34]

Në këtë katund ka edhe mikrotoponime të tjera që dëshmojnë se ky ishte i banuar (edhe) në kohën para se të dëshmohej në këtë krisobulë. Të kësaj natyre unë i mbaj mikrotoponimet aktuale *Gjyteti* dhe *Kroi i kishës*, të cilat i ka shënuar në terren J. Osmani.[35]I kësaj prejardhje është edhe antroponimi *kalojanь* që në vitin 1330[36] e mbante një banor i katundit të sotëm Prapaqan të rrethinës së Deçanit.

Një vend, përkatësisht një krua i quajtur *Janja* (sipas transliterimit të M. Pavloviq)[37] përkatësisht *Jania* (sipas transliterimit të A. Solovjev) përmendet jo larg Janjevës së sotme, në kartën e sundimtarit serb St. Millutin të vitit 1321 për themelimin e Manastirit të Graçanicës. Më shumë të dhëna për përkufizimin e këtij vendbanimi ka në versionin e botuar nga A. Solovjev[38] të kësaj karte. Këtu thuhet se manastirit që po rindërtohej i faleshin katundet e quajtura Sushica, Selce me lagjet dhe me kufijtë e tij dhe *Kroi Jania* (nënviz. i imi) drejt e në fushë në Brestie (S.G.: katundi i sotëm Bresje i Fushë Kosovës) tek Kisha e Bresties nëpër fushë e drejt tek Mullini i Skulan-it, drejt (e) në lumin e Graçanicës e Kov [...] dhe nga Dardha përtej e në Krushevc dhe nga Krushevci [...] e drejt e në *Butovecь* (nënviz. i imi) dhe nëpër mal tek Ara e Korrun në Kodrën e Kuman-it, tek (S.G.: Kisha?) Nedelja nëpër mal drejt e në Brus dhe nga Brusi nëpër mal e në Ostrivьhь dhe nga Ostro Vrh-i në Veletin midis Sushicës e Gushtericës [...] drejt e në udhën që vie nga qyteti i Prishtinës".

Duket se me emrin e kësaj shenjtoreje (në variantin e kishës ortodokse) do të jetë i lidhur edhe emri i katundit të sotëm *Jançishtë* i komunës së Malishevës. Ky vendbanim dëshmohet në vitin 1348, në

[34] Këtë mikrtoponim e ka shënuar në terren Rexhep Doçi, *Onomastika e Drenicës* I, Prishtinë, 2005, f. 136.

[35] Shih J. Osmani, "Drenica", *Vendbanimet e Kosovës* 20, Prishtinë, 2005, f. 152.

[36] Khs. Miloš S. Milojević, "Dečanske hrisovulje",*Glasnik Srpskog Učenog Društva*, XII (1880), f. 74.

[37]Khs. përkthimin shqip të tekstit: „dhe i shkrova në krisobulë katundet me emrat Graçanica e Sushica dhe Selce bashkë me lagjet e me kufinjtë e tyre ... (vendet e lëna me pika i mungojnë edhe origjinalit) kroni ... janja drejt e në fushë në Bresje (origj. Brestije) te Kisha e Spasit përmes fushës te Mullijt e Skullanit drejt e në lumin e Graçanicës dhe ..., [...]" Origjinalin dhe më shumë tekst sh. tek Milivoj Pavlović, "Gračanička Povelja", *Glasnik Skopskog Naučnog Društva* ,III, Shkup, 1928, f. 127.

[38] Shih A. Solovjev, Odobrani *spomenici srpskog prava (od XII do kraja XV veka),* Beograd 1926, f. 100.

lokativin serb, si "*a odь jančištь*".[39] Ky vend, tani me katër lagje (Zhidomishta, Dubnik, Novosellë e Venik) përmendet edhe në një krisobulë të sundimtarit serb St. Dušan të datës 12 qershor 1349 kur ky vendin Jančišta ia falte një manastiri rus.[40] Lidhjen e emrit të këtij vendbanimi me emrin *Jan*(j)*a* të shenjtores e tregon zgjerimi i këtij emri me prapashtesën *-ište* me të cilën emërtohet (edhe) një vend ku më parë kishte ekzistuar ndonjë vendbanim ose objekt i zhdukur që, në rastin tonë, lidhej me Sh'na Agnesën, përkatësisht Jan(j)ën. Se këtu vërtetë kemi të bëjmë me një vendbanim të kryehershëm i cili për shkaqe të ndryshme do të ketë ndërruar truall e tregojnë mikrotoponimet aktuale *Trojet e vjetra*, *Guri Jançishtit*, gjurmët e varrezave të vjetra me veçori të krishterimitdhe sidomos mikrotoponimi *Te Kisha* në vendin e quajtur *Shullani* të këtij katundi. Kujtesa kolektive e banorëve të Jançishtës tregon se pararendësit e lagjes së Krasniqëve të këtushëm kishin pasur lidhje gjaku me banorë (sot serbë) të Hoçës.[41] Sado që nuk thuhet shprehimisht, duket se pikërisht me truallin e vjetër të Jançishtës së sotme kemi të bëjmë tek një dëshmi e vitit 1355 kur është evidentuar truallishta *Janino,* khs.: "Dhe që ishte truallishta e lanë shkret poshtë Hoçës, e quajtur Janino".[42]Edhe vetë trajta e gjenitivit serb tregon se këtu kemi të bëjmë me një truallishtë në të cilën do të ketë qenë një kishë e kushtuar Sh'na Agnesës, përkatësisht Jan(j)ës.

Duke u larguar nga etimologjia e emrit e gjykuar, në rastin tonë, në mbështetje të dokumentacionit kishtar serb, në këtë mes duhet theksuar se kjo hapësirë e territorit të Kosovës së sotme ishte e banuar me shumicë nga shqiptarët. Këtë e dëshmon shumësia e mikrotoponimeve që përmbajnë antroponime shqipe e të shqiptarëve; individë me antroponime shqipe e të shqiptarëve që përmenden në kontekste juridike siç është p.sh. një dokument i vitit 1454 në të cilin përmenden edhe pleqnarët *Ruš Ginovikь* i katundit Sllapuzhan të Suharekës, *David Buzulьk* nga Korishi i Prizrenit, *Peiko Gинčevik* nga Reshtani; *Rušь*

[39] Khs. tekstin „Dhe, mbretnia ime ia bashkangjiti shkorretin Krushçica, ndërsa kufini i tij nga Rahoveci [...] tek Gradishta [...] dhe nga aty tek Llazi i Mretit, aty ku humbet sipri Jançishtës tek Gradishta". Origj. tek J. Šafarik, "HrisovuljacaraStefanaDušanakoiomь osnivarnonastirь Sv. Arhangela Mihaila i Gavrilja u Prizrenu godine 1348 ?", *Glasnik Društva Srbske Slovesnosti* 15 (1862), f. 276.

[40]Khs. Stojan Novaković, *Selo*, Beograd, 1965, reprindt, f. 98.

[41] Për mikrotoponimet aktuale dhe traditën gojore khs. J. Osmani, "Malisheva", *Vendbanimet e Kosovës*, 19, Prishtinë, 2006, f. 118-119.

[42]Khs. te St. Novaković, *Selo*, f. 111 dhe poai, *Zakonski spomenici*, f. 430.

Ginovik (tjetër) nga Studençani, *Petko Bušatь* nga Leshani i Suharekës etj.[43], si dhe ruajtja e antroponimit *Jana* në mikrotoponiminë aktuale në vendbanimin shqiptar, khs. *Livadhi Janës* në katundin Retijë të Rahovecit, në të cilin janë zbuluar edhe mbishkrime (natyrisht në latinishte) të periudhës romake.[44]

Dëshmia më e vjetër e qenies në përdorim të antroponimit mashkullor *Jan*, përkatësisht *Janj* rrjedh nga krisobula për manastirin e Shën Stefanit në Banjskë të viteve 1313 - 1318. Atëherë është evidentuar banori i quajtur *janj* i katundit të vllehëve të Barelit, përkatësisht të "vlasi bareljev'ski".[45] Më shumë dëshmi për ekzistimin e këtij antroponimi në ambiente raguzase kemi (edhe) në *Testamentin* e tregtarit raguzas Gostissa Bratoslalich të Novoberdës të vitit 1411. Atëherë, ndër borxhlinj të këtij tregtari përmendet edhe njëfarë *Nikoliça Yancich* (lexo Jançiq), një tjetër i quajtur *Yano* (lexo Jano) dhe një shpërlarës i xehes i quajtur *Yanaç* (lexo Janaq).[46] Meqë për asnjërin nga këta persona nuk janë shënjuar vendbanimet në të cilat jetonin, lejohet paravendimi që këta mund të kenë qenë më parë raguzas që i takonin shtresës së ulët shoqërore, se sa vendës të Novobërdës apo të rrethinës së saj.

Në defterin e vitit 1455 kemi gjithsej dy dëshmi të qenies në përdorim të këtij antroponimi: khs. Velimir-i, i bir i *Jan*-it (në transliterimin serb "sin Janja") në katundin Brainë të komunës së Prishtinës dhe Boshko, i bir i *Janç*-ës (në transliterimin serb "sin Janča") në katundin Lubnica [47] të regjionit të Toplicës, prej nga janë të ardhur pas vitit 1876 Llumincët e Barilevës së Prishtinës. Në defterin osmano - turk të regjistrimit të fundshekullit XV të kazasë së Novobërdës ky antroponim dëshmohet në trajtat *Jan*-, *Janin,Janiq* e *Janko* (si emër mashkullor) khs. Bashtina *Jani* në dorën e Rajk-os, në kat. Robovc të Kamenicës; Marko *Jan*-i, Dimitri *Jan*-i në Dobërçan të Gjilan; Mojsi-u, i bir i *Jan*-it, në mëhallën Sopot të Janjevës; bashtina *Jan*-i, në katundin e paidentifikuar Markofça; *Jan*-i, i bir i Pejoqin-it, në katundin e paidentifikuar Bujkofqa; Gjura *Janin*-i, në kat. Trepanja në "Serbinë e Jugut"; Gjurashin *Janiq*-i, në katundin e panjohur Mizka;

[43]Shih Aleksandar V. So1ovjev *Odobrani spomenici srpskog prava (od XII do kraja XV veka)*, Beograd, 1926, f. 215.
[44] Khs. J. Osmani, "Rahoveci", *Vendbanimet e Kosovës*, 2, Prishtinë, 2003, f. 122-123.
[45] Shih Lj. Kovačević, "Svetostefanska hrisovulja", *Spomenik* IV, SKA (1890), f. 8.
[46]Shih M. Dinić, *Iz Dubrovačkog arhiva* I, Beograd, 1957, f. 28-29.
[47]Shih Hamid Hadžibegić, Adem Handžić, Ešref Kovačević, *Oblast Brankovića, Opširni katastarski popis iz 1455. godine*, Sarajevo, 1972. f. 63.

Jovan *Janiq*-i, në katundin Malishevë të Gjilanit?; Gjon *Janiq*-i, në katundin e panjohur Nikopolja; Radovan *Jank*-a, në katundin Izvor të Novobërdës dhe Jovan *Janka*,* në katundin e panjohur Orohofça; ndërsa si emër femëror në trajtat *Janika* e *Janka* khs.: *Janika*, e vejë, në katundin Tullar të Medvexhës; *Janka,* e vejë, në mëhallën Pop Petroilja dhe *Janka*, e vejë, në mëhallën Sveta Petka të qytetit të Novoberdës.[48]

Duket se me emrin e kësaj shenjtoreje bën të lidhet edhe emri *Janinavoda*, tani lagje e katundit Caravadicë (serb. Crkvena Vodica) në komunën e Obiliqit. J. Osmani,[49] pa i pas bartur në mënyrë korrekte të dhënat që me të vërtetë përmbahen në burimin (Defterin osman të vitit 1455) e cituar nga ky, na mëson se emri i këtij vendbanimi na paska qenë evidentuar si *Jovaniševci*.

Çështje me shumë rëndësi përkitazi me fatin e kolonëve xehetarë të elementit etnik sas është ajo e degjermanizimit, përkatësisht e asimilimit të tyre. Dijetari i shquar i historisë së popujve të Ballkanit, K. Jireček[50] ishte i mendimit se me të shuar të zejes së xehetarisë kah fundi i shek. XVII, sasët u kthyen në atdheun e tyre të kryehershëm ose u vendosën në Raguzë e nëpër qytete të tjera të Dalmacisë, në Itali e ndonjëri edhe në Hungari. Ky mendim do të duhej relativizuar sepse ka raste që tregojnë se sasët, përveç që, si rezultat bashkëjetesës së gjatë në kolonitë raguzase të Kosovës, në pjesën më të madhe mund të jenë shkrirë në raguzas, ka dëshmi onomastike se një numër i vogël, mbase kryesisht jashtë kolonive të madha, edhe u bashkëshkri me shqiptarë.

Kur bëhet fjalë për degjermanizimin e sasëve duhet vërejtur që pothuaj të gjithë dijetarët serbë që u morën me këtë problematikë kujtojnë se sasët në të vërtetë vetëm qenkan serbizuar. Këtë qëndrim jo të drejtë e korrigjoi dijetari kosovar M. Tërnava[51] i cili me të drejtë i jep krah tezës që rezulton nga hulumtimet e K. Jireček -ut se sasët në të vërtetë u kroatizuan. Kësaj teze i del krah realiteti historik i kohës: që nga koha e ardhjes së sasëve në Kosovë këta bashkëjetonin kryesisht me raguzasit që i kishin partnerë afaristë; sasët si edhe raguzasit ishin

* Unë kujtoj se të dy këta emra do të duhej të transliteroheshin si *Jan-ko*.

[48] I.Rexha, "Regjistrimi i vendbanimeve dhe i popullsisë së kazasë së Novabërdës", f. 80, 89, 123, 125, 102, 106, 157, 143, 98, 70, 78.

[49] Shih J. Osmani, "Prishtina, Kastrioti dhe Fushë-Kosova", *Vendbanimet e Kosovës* 1, Prishtinë, 2003, f. 259.

[50] Khs. *Die Bedeutung von Ragusa in der Handelsgeschichte des Mittelalters*, Wien, 1899, Referenca 9.

[51] Për gjithë problematikën në shqyrtim sh. librin Muhamet Tërnava, *Popullsia e Kosovës gjatë shekujve XIV-XVI*, Prishtinë, 1995, sidomos f. 388-390.

katolikë; sado që në koloni më të njohura sase - raguzase si në Novobërdë e në Janjevë sasët i kishin kishat e tyre të veçanta gjithmonë porse në *mercata*- t, sheshet e qyteteve jo shumë larg njëra - tjetrës ku edhe popullata e thjeshtë sase, raguzase e shqiptare do të jetë takuar së pakut çdo të diele, nuk mund të përjashtohet mundësia që në lokalitete më të vogla kishat katolike të kenë qenë të përbashkëta; përkatësia ritit katolik roman e të dyja këtyre elementeve (duke përfshirë këtu edhe faktorin katolik shqiptar) do t'i ketë favorizuar martesat e përziera që domosdo e nënkupton një simbiozë. Dhe, kjo simbiozë zgjati sa edhe shfrytëzimi aktiv nga këto dy palë i minierave të Kosovës, përkatësisht së pakut tre shekuj. Kroatizimin e sasëve do ta ketë përshpejtuar edhe rrethana që sasët ishin shumë më të pakët në numër se sa raguzasit. Të gjithë këta faktorë e bëjnë fort të lëkundshëm e pak të besueshëm pretendimin e p.sh. dijetarit serb M. Diniq, sipas të cilit sasët na qenkan serbizuar. Kësaj teze, historiani ynë M. Tërnava ia vë përballë mungesën e bindshme të faktorëve historikë, religjiozë e socialë që do ta favorizonin serbizimin e sasëve sa kohë që serbët ishin ortodoksë, se në kolonitë sase -raguzase të Kosovës nuk kishte jetë të organizuar kishtare ortodokse e mbi të gjitha se nëpër ato qendra koloniale nuk kishte popullatë kompakte serbe. Edhe mbi bazën e këtij argumenti po shtoj, në frymën e tezës së M. Tërnavës, se në ato koloni xehetare - tregtare të sasëve e të raguzasve, përveç kosovarëve vendës si punëtorë krahu e më rrallë drejtues të vegjël të punës nëpër miniera por edhe partnerë afaristë, kishte - sidomos në Novobërdë, Janjevë e në Trepçë shqiptarë të ritit katolik të ardhur bashkë me raguzasit nga qyteti - republikë i Raguzës, sish nga regjioni i Matit përkatësisht nga Drishti, Pulti, Shkodra, Ulqini, Tivari, Kotori që nuk ishin qytetarë të rëndomtë porse kryesisht argjendarë dhe se vetëm me ndonjë përjashtim që s'çon në peshë, të gjithë priftërinjtë në ato qendra ishin shqiptarë, kryesisht të ardhur në ato qendra. E pandashme, madje esenciale në këtë mes do të jetë edhe gjuha e liturgjisë në ato kisha. Nuk ka as ndonjë mundësi minimale që gjuhë e liturgjisë të ketë qenë serbishtja. Përkundrazi, ajo mund të ishte në rend të parë vetëm kroatishtja e ushtruar nga priftërinj shqiptarë vendas - shtetas të Republikës së Raguzës e ndoshta edhe shqip nga priftërinj të ardhur nga veriu katolik i Shqipërisë. Të gjithë këta faktorë historikë të shpijnë tek korrektësia e tezës së M. Tërnavës, së cilës i bashkohem edhe vetë, se elementi etnik sas, përveç që u kroatizua, pjesërisht edhe do të jetë shqiptarizuar.

E kontestueshme del edhe çështja në ç'kohë filloi e kur përfundoi procesi i degjermanizimit të sasëve. Edhe në këtë pikë dijetarit të

merituar serb M. Diniq ia ka ëndja të besojë se procesi i sllavizimit të sasëve paska përfunduar para fundit të gjysmës së parë të shek. XV, përkatësisht pak vite pas pushtimit osman. Korrektësinë e kundërshtimit edhe të kësaj teze nga historiani kosovar M. Tërnava e dëshmon edhe materiali onomastik përkatësisht prania e njerëzve me antroponime sase në defterin osman të regjistrimit të kryefamiljarëve në vitin 1455 dhe mungesa e antroponimeve të tilla në regjistrimin osman të fundshekullit XV (1498/1499?) madje edhe në vendbanime që mbajnë emra me prejardhje sase. Fundja, edhe njoftimet përkitazi me të folurit e gjuhës gjermane nëpër miniera tregojnë se zhdukja e gjermanishtfolësve vërehet që në vitin 1555 kur udhëpërshkruesi frëng kishte shënuar se njerëzit që banojnë nëpër miniera (në Maqedoni) përdorin gjuhë të ndryshme si sllavonishten, bullgarishten, greqishten e shqipen,[52] përkatësisht se që nga viti 1600 gjuha gjermane nuk përmendet më nëpër miniera,[53] sado që në vitin 1685, mbase për herë të fundit, përmenden *lavoratori christiani*[54] "punëtorët krishterë" që ndoshta ka të bëjë me sasët e me raguzasit. Procesit të degjermanizimit të sasëve do t'i ketë kontribuar patjetër rrethana e konstatuar nga K. Jireček se as në shtetin mesjetar serb e as në Bosnje nuk ka pasur ndonjëherë masa të mëdha kompakte sasësh.[55] Siç mund të vërehet nga materiali i sjellë më poshtë, procesi i degjermanizimit të sasëve kishte përfunduar kohë përpara fundit të shek. XV.

Edhe pse temë bosht e këtij punimi nuk është struktura etnike e popullsisë së Kosovës së sotme në fund të shek. XV, pikërisht rezultatet e dalura nga burimet që u përdorën për këtë trajtesë tregojnë se jo vetëm elementi etnik shqiptar i ardhur bashkë me raguzasit si qytetarë të Raguzës dhe individë (priftërinj e tregtarë) nga qytete të Shqipërisë së Veriut porse edhe ai vendës pati dorë në degjermanizimin e sasëve, prandaj teza për kinse ardhjen e shqiptarëve në Kosovë pas së ashtuquajturës "Shpërngulje e Madhe" e serbëve nga Kosova pas vitit 1689 duhet parë për si lajthitje e qëllimshme, e motivuar politikisht, e lansuar dhe e *fryrë* nga historiografia serbe e shek. XIX dhe sidomos, aktuale.

[52]Khs. cit. origj. „Ceux qui habitent aux miniers de Siderocopsa, sont gents ramasses et usent de langage different, comme Eslawon, Bulgare, Grec, Albanais", E. Pressig, *Deutsche Bergbauwörter in den Balkansprachen*, f. 144-145.
[53]C. Jireček, *Staat und Gesellschaf*, III, f. 45.
[54]Shih K. Jireček, *Trgovački drumovi i rudnici*, f. 215.
[55] Sipas M. Tërnava, *Popullsia e Kosovës,* f. 388-390.

Thellësia reale e një simbioze sase - shqiptare në Kosovë, përkatësisht e shqiptarizimit të mundshëm të elementit etnik sas, do të mund të shihej edhe më mirë mbi bazën e gjurmimeve të mëtejshme në fushën e mikrotoponimisë së Kosovës.

Çështje me rëndësi fort të madhe në këtë kontekst është përbërja etnike e banorëve, përkatësisht (edhe) simbioza raguzase - shqiptare në këtë lokalitet. Meqë trajtimi i këtij segmenti kërkon më shumë hapësirë, në vend të analizës së dëshirueshme rekomandoj që studiuesit e rinj ta marrin në konsideratë dhe ta analizojnë gjithanshëm antroponiminë e Janjevës dhe lagjeve të saj në (fund) shekullin XV dhe në vitet 1566 - 1574[56]

II. Cecelia

Dëshmia më e vjetër e përmendjes së katundit të sotëm *Ceceli* të komunës së Vushtrrisë rrjedh nga defteri osman - turk i regjistrimit të kryefamiljarëve dhe të pronave të viteve 1566 - 1574. Në këtë burim, emri i këtij katundi është shënuar në trajtën *Çeçilja*;[57] në versionin e këtij defteri, të transkriptuar nga Qemal Haruni nga Shkupi, emri i këtij katundi është transliteruar si *Çeçelbija*;[58] M. Tërnava e ka transkriptuar si *Qecelija*,[59] ndërsa më 1763 është shënuar si *Cecelija*.[60]

Emri *Ceceli*,-a i këtij vendbanimi i heq rrënjët nga emri femëror me prejardhje latine *Cecelia*. Dëshmia më e vjetër e këtij antroponimi në hapësirën gjuhësore të shqipes rrjedh nga një mbishkrim varri i periudhës së sundimit romak, i zbuluar në Prizren. Në këtë mbishkrim dëshmohet emri i skllaves *Caecillia serva* (i evidentuar tek CIL 8240). Këtu bie gjithsesi edhe dëshmia: "*D*(is) *m* (anibus) *Sex*(tus) *Caecilius vix*(it) *an* (nis) *XXX* ...", i dëshmuar në një mbishkrim të gjetur në Shkup.[61] E vetmja dëshmi e njohur deri tani mesjetare e antroponimit

[56] Që janë botuar nga I.Rexha, "Regjistrimi i vendbanimeve dhe i popullsisë së kazasë së Novobërdës", f. 120-123.dhe Selami Pulaha, *Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shek. XV-XVI*, Tiranë, 1983, f. 552-556

[57] Khs. S. Pulaha, *Popullsia shqiptare e Kosovës*, f. 704.

[58] Tek Tapu ve katastro ümüm müdürlügünün Arşivi, Defter Nr. 124, f. 135 (Dorëshkrim).

[59] Shih M. Tërnava, *Popullsia e Kosovës,* f. 74.

[60] Khs. Gliša Elezović, *Rečnik Kosovsko -Metohijskog Dijalekta* II, Beograd, 1935, f. 428.

[61] Khs. Nikola Vulić, „Antički spomenici naše zemlje", *Spomenik SKA*, LXXI (1931), f. 91, mbishkrimi 536.

mashkullor *Cecel*, është ajo e vitit 1330 kur, në Krisobulat e Deçanit, ndër banorë të katundit të sotëm Çabiq të komunës së Klinës përmendet edhe banori i quajtur *Družoje Ceceliq.*[62] Emri femëror Ceceli,-a nuk ndeshet sot si antroponim aktiv i popullatës së Vushtrrisë e të Mitrovicës, sepse kjo është krejtësisht myslimane, ruhet porse tek pjesa katolike e shqiptarëve në pjesë të tjera të Kosovës e të veriut katolik të Shqipërisë në trajtat *Cecile*, *Çeçile* dhe në trajtën e shkurtër *Cile*. Trajta e fundit përdoret edhe ndër shqiptarë të besimit mysliman si emër përkëdhelës për nënën.

Me rastin e shfaqjes së ndonjë mendimi për prejardhjen e mundshme të këtij toponimi, dy janë çështjet historike që duhet mbajtur parasysh: 1. a ka dëshmi të qenies në përdorim dhe a ka vazhdimësi në të përdorur nga shqiptarët të antroponimit femëror *Ceceli -a* dhe 2. a ka dëshmi të ekzistimit ndonjëherë të ndonjë kishe që do ta ketë mbajtur emrin e shenjtores *Sh'na Cecelia* dhe cili komunitet do ta ketë ngritur atë kishë. Rrethana që në burimet shkrimore që i kemi në dispozicion e që përmbajnë lëndë onomastike të Kosovës mesjetare (dokumentacioni kishtar serb dhe defterët osmanë - turq të regjistrimit të kryefamiljarëve) nuk ka dëshmi të këtij antroponimi femëror nuk do të thotë kurrsesi se ky nuk do të ketë qenë në përdorim, sepse në dokumentacionin kishtar serb nuk përmendet kurrë ndonjë grua, nëse ajo nuk ishte sundimtare apo murgeshë, ndërsa në regjistrimet turko - osmane gratë evidentoheshin vetëm nëse ishin kryefamiljare të veja. Qenien në përdorim të këtij antroponimi edhe nga gratë e dëshmon jo krejt vetëm tërthorazi, evidentimi i emrit mashkullor Cecel në funksion mbiemri të banorit *Sextus* në trajtën *Caecilius* në periudhën romake dhe të banorit *Druzhoje Ceceliq* të katundit Çabiq në shek. XIV. Nga këto dy dëshmi mund të nxirren dy përfundime: 1. ka një kontinuitet në relacionin antikë - mesjetë e vonë të përdorimit të këtij emri nga banorë të Dardanisë antike dhe 2. duke qenë emër i uzusit antroponimik të kishës katolike, bartës të këtij emri nuk mund të jenë jokatolikët, përkatësisht serbët ortodoksë të ardhur në Kosovë në shek. XII - sado që bartësi i mbiemrit *Ceceliq* kishte një antroponim me prejardhje nga leksiku sllav, jo porse një emër kalendarik të kishës së Lindjes. Antroponimi Cecilia bie ndër emra shumë të vjetër të popullatës romane (më vonë edhe të atyre joromane, por të besimit të krishterë të ritit roman si p.sh. te polakët e te hungarezët - sh. më poshtë). Sa i bie etimologjisë së këtij emri, ka një mendim se ky emër rrjedh nga mbiemri latin *caesus* "i

[62] Shih M. S. Milojević, *Dečanske hrisovulje*, f. 23.

shurdhër" që konsiderohet për etimologji popullore dhe një mendim tjetër se ky emër është në të vërtetë me prejardhje paralatine dhe se qenka një formë latine e emrit etrusk *Caecína*, *Caecinnius*, një mendim ky që është më i pranueshëm. Ky antroponim dëshmohet kryesisht ndër popuj të besimit të krishterë të ritit katolik khs. p.sh. tek francezët *Cécile*, it. *Ceclio*, *Cecilia*, span. *Cecilia*, hung. *Ceclia*, *Cecilian*, pol. *Cecylia*. Depërtimi i këtij antroponimi edhe tek rusët si *Kikilia* e *Cecilia* dhe tek bullgarët si *Cecilia*[63] duhet parë vetëm si rezultat mode të ndikuar nga frëngjishtja. Në mbështetje të këtyre barazimeve etimologjike sikur s'mbetet vend të dyshohet se emrin fem. *Caecilia,* mashk. *Caecilius* në Dardaninë antike e sollën romakët. Prej këndej do ta ketë marrë edhe popullata dardane, në rend të parë ajo e qendrave urbane si pjesë e integruar më fort në formacionin shtetëror e social të pushtuesit, përkatësisht nga ajo pjesë e popullatës dardane që kishte mundësi materiale t'u ngrite pllaka mbivarrore pjesëtarëve të familjeve të tyre. Fundja, edhe vetë vendgjetjet e mbishkrimeve mbivarrore ku dëshmohet ky emër: në Theranda e në Scupi, përkatësisht në Prizren e në Shkup e tregon qartë se këtë emër, në periudhën romake, e kishin marrë dardanët vendës të integruar në shoqërinë romake, përkatësisht ata të qendrave të mëdha urbane të kohës. Kjo nuk do të thotë se nuk do të ketë pasur plot vajza e gra dardane, edhe të vendbanimeve rurale, që do ta kenë bartur emrin Cecilia. Emrat e tyre nuk janë dëshmuar, sepse ato i takonin shtresës katundare që nuk kishte mundësi apo as traditë të ngrite pllaka mbivarrore.

Sa i përket konkretisht prejardhjes së emrit *Cecelia* të katundit të Vushtrrisë duhet theksuar se është e vështirë të paravendohet që një vendbanim të jetë quajtur sipas emrit të një gruaje, nëse ajo nuk do të kishte pozitë të lartë shoqërore, përkatësisht nëse ajo nuk do të ishte sundimtare apo shenjtore. Në rastin tonë, shumë më i besueshëm do të jetë paravendimi se ky emër katundi do të ketë dalë nga emri i ndonjë kishe të kushtuar Sh'na Cecelisë, sesa thjesht nga një grua anonime e quajtur Cecelia. Unë nuk kam ndeshur nëpër burime të jetë dëshmuar ekzistimi i ndonjë kishe që do ta mbante emrin e kësaj shenjtoreje dhe, aq më keq për mua, nuk e njoh as mikrotoponiminë aktuale të katundit Ceceli,-a të Vushtrrisë. Megjithatë, kujtoj se emri i këtij katundi duhet të jetë i lidhur me emrin e ndonjë kishe të ritit katolik, kushtuar Sh'na Cecelisë. Njoftime për ekzistimin e ndonjë kishe në hapësirën e këtij katundi përmbahen mbase në mikrotoponimet *Lugu i Kish's* e *Kodra e*

[63] Sipas Ch. Ionescu, *Mică eciclopedie onomastică*, f. 80.

Kish's të këtij katundi ndërsa, në mos qoftë pasojë e zgjerimit territorial, përkatësisht e ngulitjeve të reja, emri i shenjtores Cecilia ka mundësi të jetë ruajtur tek mikrotoponimet *Kodra e Cicilisë*, dhe *Lugu i Cicilisë* të po këtij katundi. Gjallimin e shqiptarëve të besimit të krishter të ritit roman do ta tregonin, në këtë mes, mikrotoponimet *Lugu i Doçit* dhe *Rrezja e Doçit*[64] në të cilat përmbahet antroponimi *Doç* i shqiptarëve.

Sh'na Cecelia ishte martire e Romës, virgjëreshë dhe shenjtore e cila që nga gjysma e dytë e shek. V nderohet për shenjtore e kishës katolike. Të dhëna të besueshme përkitazi me jetën e saj mungojnë. Sipas një legjende, kjo rridhte nga dera aristokrate e Cecilëve dhe bashkë me të fejuarin Valerian dhe me të vëllanë e tij, të cilët kjo i paska pas bindur ta pranonin krishterimin dhe papa Urbani I., i kishte pagëzuar për të tillë, u ekzekutua me prerje koke. Nuk është e sigurt nëse kjo ndodhi në kohën e Alexander Severus (222 - 235), të Valerian-it (258) apo të Dioklecianit (304). Dihet porse që Sh'na Cecelia u varros në katakombet e Calixtus-it. Papa Paschalis I, urdhëroi rivarrosjen e eshtrave të saj në bazilikën Sancta Caecilia në Trastevere. Duke filluar që nga shek. XV Sh'na Cecelia nderohet për patrone e muzikës kishtare. Portretizimi më i vjetër i saj gjendet në mozaikun e vitit 570 në pjesën e majtë të tavanit të tempullit St. Apollinare Nuovo në Ravenë, ku Cecelia është portretizuar si anëtare e korit. Dita e kremtes së Sh'na Cecelisë mbahet më 22 nëntor dhe përshkohet kryesisht nga shfaqje muzikore.

Mbetet, për mendimin tim, e hapur çështja se cila ishte ajo popullatë që do ta ketë ngritur një kishë të kushtuar kësaj shenjtoreje katolike dhe që do të jetë lutur në të. Duke u nisur nga rrethana e ditur që besimtarë të krishterë të ritit katolik të territoreve të përfshira nën juridiksionin shtetëror - kishtar ortodoks të perandorisë jetëshkurtër serbe të Nemanjidasve, zyrtarisht (edhe) në hapësirat etnolinguistike të kosovarëve ishin vetëm apo kryesisht kolonitë e raguzasve katolikë, që kishin edhe konsuj e gjykatës të tyre, në qytetet - miniera të Novobërdës, Trepçës, Janjevës, Bellasicës, të Prizrenit, Prishtinës e Shkupit dhe të katundeve që pothuajse ishin eksklava të tyre kishat e të cilëve s'guxonte t'i prekte, rezulton se është e vështirë të besohet që në mesjetën e vonë në Kosovë të ketë pasur shqiptarë katolikë e aq më pak që pushteti e kisha mesjetare serbe të kishte lënë në këmbë, pa e pas adaptuar në kishë ortodokse, ndonjë kishë katolike të shqiptarëve. Mbetet, prandaj, paksa enigmatike nëse masat ndëshkuese ndaj atyre që

[64] Mikrotoponimet e cituara më lart janë shënuar në terren nga J. Osmani, *Vendbanimet e Kosovës,* 16, Prishtinë, 2004, f. 125.

do ta kishin pasur guximin të deklaroheshin hapur për të ritit katolik dhe ndaj atyre që do t'i strehonin të tillët si dhe masat ndëshkuese që parashihen për priftërinjtë katolikë që do ta kishin guximin ta bekonin konvertimin e "kriptoortodoksëve" (term i imi) në ritin katolik kanë të bëjnë edhe me hapësirën e Kosovës së sotme dhe me veriun katolik të Shqipërisë. Ndalimet e kësaj natyre hetohen qartazi nëse i hedhet një sy Kodit të Stefan Dushan-it, i cili në njëfarë mënyre mund të konsiderohet edhe si kushtetutë e mbretërisë mesjetare të Serbisë. Kodi i Dushan-it e legjitimonte rolin e mbretit serb si patron mbrojtës të kishës serbe dhe si "shfarosës" të herezisë latine, përkatësisht katolike. Mbetet e paqartë, sipas mendimit tim aspak e besueshme, nëse sanksionimi sipas Kodit që të gjithë shtetasit e mbretërisë serbe, të cilët i takojnë një bashkësie të huaj fetare, duhet patjetër të ripagëzohen në kishën serbe, përkatësisht në ortodoksë mund të ketë të bëjë edhe me kolonitë sase - raguzase të Kosovës të cilat, sado që edhe zyrtarisht, kishin rregullim të brendshëm juridik e fetar dhe jeta në ato qendra zhvillohej sipas mënyrës raguzase e sase, nga të cilat shteti i serbëve i nxirrte fitimet më të mëdha financiare, e ndaj shqiptarëve jo se jo. Apo ky paragraf aq cinik që e reflekton urrejtjen deri në injorim të saj ndaj katolicizmit ka të bëjë me ndonjë hapësirë tjetër (Panonia, pjesë të Kroacisë, Hercegovina?) të pushtuar nga Nemanjidasit. Ka shumë mundësi që as kërkesa, e përcjellur me sanksione, që jokatolikët të ripagëzohen me emra sllavë të lejueshëm nga uzusi onomastik i kishës serbe mund të ketë të bëjë me katolikët ardhës në qytete - miniera të Kosovës e as me shqiptarët tek të cilët procesi i sllavizimit onomastik, i ripagëzimit dhe i inkuadrimit të tyre në uzusin antroponimik e ritual të ortodoksisë së variantit serb e bullgar, pothuajse asokohe kishte përfunduar.

Ka arsye të besohet që as të ashtuquajturit "artikuj kundër herezisë" ose "si të pastrohet krishterimi" (= ortodoksia) të Kodit të Stefan Dushan-it ku thuhet ndër të tjera: "Dhe për herezinë latine, që të krishterët (= besimtarët e ortodoksisë serbe) i ka kthyer në herezi, të kthehen përsëri në krishterizëm (= ortodoksi); nëse akëcili nuk është i dëgjueshëm dhe nuk i kthehet krishterimit, të dënohet ashtu siç është shkruar në ligjin e etërve të shenjtë", nuk kanë të bëjnë me eksklavat katolike raguzase të Kosovës. Me popullatën edhe ashtu ortodokse shqiptare e me kolonitë raguzase vështirë se ka të bëjë edhe neni 137 i Kodit, në variantin e botuar nga St. Novakoviq, në të cilin nen parashihej që për veprën e konvertimit të ortodoksit në katolik urdhërohet që atij "që e shet të krishterin në atë besim të paqenë (= katolicizëm) t'i prehet dora dhe t'i shkallmohet gjuha". Për ta arritur

këtë, në Kod parashihet që "Kisha e Madhe të vendos protopopë nëpër të gjitha qytetet e nëpër sheshe, që t'i kthejë të krishterët nga herezia latine, atyre që kanë kaluar në fenë latine, t'ua japë urdhëresën shpirtërore dhe secili (nga ata) t'i kthehet krishterimit" (= ortodoksisë serbe).[65]

Pas hulumtimeve të mia disavjeçare përkitazi me raguzasit e me sasët e ardhur në qytetet - miniera të Kosovës e të larguar ose edhe pjesërisht të asimiluar dhe sidomos pas përfundimit të tezës sime të doktoraturës për emrat e shqiptarëve në shekujt XIV - XV në dritën e burimeve kishtare serbe mua më rezulton se, siç do të vërejë kohëve të fundit edhe Oliver Jens Schmitt,[66] është pak e besueshme që përcaktimet kundër katolikëve të kuptohen si masa kundër shqiptarëve, sa kohë që përveç në Zakonik-un e Dushan-it nuk kemi asnjë burim tjetër që do ta vërtetonte një përndjekje kundër katolikëve në Kosovës. Kjo aq më parë pse këto dispozita të Kodit nuk u aplikuan as në Shkodrën e dominuar nga katolikët, e as në Kotorin me shumicë katolike sllave - romane që ishin, edhe këto, të pushtuara nga shteti në ekspansion i Serbisë së Nemanjidasve.

Unë kujtoj se rasti i emrit *Cecelia* të një kishe që e mban emrin e një shenjtoreje katolike është prototip që do të tregonte se nuk duhet nxjerrë konkludime të ngutshme që do ta definonin përkatësinë konfesionale (katolike) të shqiptarëve të hapësirës së Dardanisë antike vetëm mbi bazën e etimologjisë së emrit, porse që duhet ecur dora - dorës me rrethanat historike e sociale që kishin mbizotëruar në periudha konkrete historike. E, kjo periudhë është e tillë që e eliminon faktorin shqiptar si pronar shpirtëror të një kishe aktive katolike, sa kohë që vetë ky faktor ishte, para instalimit të pushtetit serb në shek. XII në Kosovë, qytetar i Perandorisë Bizantine dhe pjesëtar i kishës ortodokse të ritit bizantin dhe, si rezultat i presionit dyshekullor institucional serb, të konvertimit me dhunë në ortodoksinë serbe, faktor i të nënshtruarit të shtetit e të kishës serbe. Së këndejmi kujtoj se kisha e kushtuar Sh'na Cecelisë do të ketë qenë kishë e riaktivizuar apo e ngritur rishtazi e elementit ardhës katolik nga Raguza e nga qytete të tjera të brigjeve të jugut të Adriatikut. Fundja, është e ditur se në Kosovën e shekujve XIV - XVI, riti katolik i krishterimit ushtrohej haptazi vetëm në qytetet-miniera të

[65] Khs. Stojan Novaković, *Zakonik Stefana Dušana cara srpskog 1349 i 1354*, Beograd, 1870, f. 44 dhe Svetozar Pajić Diak, *Zakonik velikog cara Stefana Dušana silnog*, në www.oldserbia.plus.co.yu-index.htm

[66] Khs. Oliver Jens Schmitt, *Një histori shqiptare, si histori ballkanike*, II**;** 16/10/2013.

Trepçës, Novobërdës, Janjevës, Bellosicës, Letnicës [si edhe në lagje të veçanta të Prishtinës, Vushtrrisë, Prizrenit e Shkupit], e madje edhe në qytete - miniera të vetë shtetit serb të Rashës si në Koporiq, Pllana, Bërskova, Prokopie, Vranjë e Nish vetëm nga tregtarë dubrovnikas, romanë të tjerë e nga minatorë sasë. Sa kohë që dihet se në qytetin e Vushtrrisë janë dëshmuar nëpër burime shkrimore të shek. XV familjet dubrovnikase *Babalia*, *Cassica* e *Prodanello* dhe se raguzasit ishin ata që gjatë viteve 1404 - 1441 i mbanin doganat jo vetëm në Prishtinë, por edhe në katundin e sotëm Dobrevë (shq. Miradi) „*Dohanam de Dobrievo et de Pristina*", [në të cilën doganën e paguanin edhe tregtarë raguzas të qytetit të Vushtrrisë].[67] ka shumë arsye të besohet që kisha e Sh'na Cecelisë të të ketë qenë kishë apo vetëm një kapelë e raguzasve. Në të mirë të këtij mendimi do të shkonte rrethana që në rrethina të Vushtrrisë, mbase jo larg nga katundi Ceceli, ekziston mikrotponmi *Vorret e llatin've*[68] pjesa e dytë e të cilit shënon, tradicionalisht, katolikët në përgjithësi, jo porse edhe apo aq më pak vetëm shqiptarët si etnos të veçantë të këtij rit.

Dëshmitë për ushtrimin e ritit katolik të krishterimit në qytetet që u përmendën më lart duhet të merren vetëm për argument se në Kosovën e shekujve XIV - XV kishte koloni katolikësh të ardhur dubrovnikas e sasë, në të cilat bashkëjetonin edhe shqiptarë katolikë të ardhur këndej si shtetas të Republikës së Raguzës, nga qytete të tjera të jugut të Adriatikut dhe nga Drishti e Shkodra të veriut të Shqipërisë, kryesisht si priftërinj.

Në dritën e burimeve të shkruara rezulton që vendbanimi i kryehrshëm i Janjevës, jo porse edhe ky i sotëm, ishte ngritur përreth kishës së ndërtuar nga minatorët sasë, të cilët ishin vendosur këtu më së voni në fund të shek. XIII. Kjo dëshmohet edhe me rrethanën që edhe kambana e vogël, me mbishkrim gotik, e cila ndodhet në kishën aktuale të Janjevës, është shkrirë në vitin 1368, në qytetin e Köln-it.

Në bazë të shkoklimeve gjuhësore, ka shumë arsye të besohet që kjo në krye të herës i ishte kushtuar shenjtores Agnesa. Duke qenë se sasët ishin, në krahasim me raguzasit, më të pakët për ka numri, emri Agnesa i shenjtores u mbulua nga varianti Janja i raguzasve romanë gjuhësisht të sllavizuar.

---

[67]Sipas J. Osmani, "Prishtina, Kastrioti dhe Fushë-Kosova", *Vendbanimet e Kosovës*, 1, Prishtinë, 2003, f. 340.

[68] Khs. G. Gjini, *Ipeshkvia Shkup-Prizren*, f. 87.

Nga raguzasit mund të jetë ngritur edhe kisha katolike kushtuar Sh'na Cecelisë, nga e cila rrjedh edhe emri Ceceli i katundit të sotëm të komunës së Vushtrrisë. Në të mirë të këtij paravendimi shkon edhe rrethana që në Vushtrrinë e sotme kishte në shek. XV familje tregtarësh raguzas dhe nga këta mbahej edhe dogana në Dobrevë.

Skënder GASHI

SUMMARY

THOUGHTS ON THE ORIGIN OF COGNOMENS JANJA AND CECELIJA

The issue treated in this column regards the linguistic origin of the toponyms Janejeve of the municipality of Lypjan and the toponym Cecelija in the municipality of Vushtrri.

The ancient location of Janjeva with its early Catholic church have been founded by Saxon miners who came in these areas by the end of the XIIIth century, when it was first mentioned in 1403. The first church in Janjeva was dedicated to Saint Agnes. The only remaining material from this church is its bell, which was manufactured in Koeln in 1368 and was brought later on in Janjeva in this particular church. Considering that the Saxons comprised a small minority in the region, they promptly assimilated with the migrating Slavic speaking traders, Albanian citizens from the Republic of Ragusa (modern-day Dubrovnik) as well as Albanians from modern day Northern Albania.

On the basis of microtoponymic references such as *Lugu i Kish's* e *Kodra e Kish's* in the village of Ceceli, as well as *Voret e llatin've* on the region of Vushtrri – and above all, considering the origin of the villages' name in the first place – one has reason to believe that prior to the Ottoman invasion, there existed a catholic church attributed to Saint Cecelia in this region. It can be postulated that it was the Ragusans who built a church devoted to Saint Cecelia, from which the village holds its name today. Considering that there is evidence suggesting that Ragusian families such as *Babalia, Cassica* and *Prodanello* inhabited Vushtrri during the XVth century, as well as noting that it was the Ragusians who were responsible of collecting taxes not only in Prishtinë, but also in the modern day village of Dobrevë (*Miradi* in Albanian), of which taxes the Ragusians in Vushtrri were not exempt, it provides sufficient evidence to support the above mentioned argument.

Luan TETAJ

SHQIPTARËT DHE REFORMAT E TANZIMATIT NË FILLIM TË SHEKULLIT XIX

Në Perandorin Osmane për më shumë së një shekull ishte nxitur ideja për fillimin e reformave, por, deri në fillim të shekullit XIX nuk ishte marrë ndonjë hap konkret për fillimin e tyre. Tanzimati (organizimi) është një periudhë reformash në Perandorinë Osmane (1839 - 1876) qëllimi i të cilës ishte ruajtja territoriale e saj. Këto reforma synoheshin të arriheshin përmes masave të modernizimit të inspiruar nga modelet evropiane. Organizimi administrativ i inspiruar nga modeli francez, ndanë Perandorinë në provinca, rrethe, kantone, fshatra e qytete.[1] Është me rendësi të kuptohet se si popullatat e ndryshme i pritën këto reforma dhe çfarë nënkuptojnë ato për popullatat e integruara në Perandorinë Osmane. Si dhe para se të analizohen këto problematika të lidhura me pasoja të përmbledhim përmbajtjen e Tanzimatit.[2] Me termin Tanzimat nënkuptojmë "reformat" e periudhës së reformimit të Perandorisë Osmane, përuruar në nëntor të vitit 1839 me aktet e Khatt-i sherif (kartës mbretërore - imperiale) të Gjylhanës nga Sulltani Abd al-Madjid. Kjo kartë proklamon drejtësi në gjithë Perandorinë pa marrë parasysh fenë dhe kombësinë e tyre të drejtën për drejtësi për të gjithë, shpërndarjen e drejtë të taksave, shërbimit ushtarak me riorganizimin e ushtrisë. Me vonë u ndërmerren reforma të reja arsimore: shkolla private me mësimdhënës të emëruar nga shteti (1845), shkolla fillore të larta, liceu i Galatasarajit në Stamboll (1868),

---

[1]Jean-Paul Burdy, *Les mots de la Turquie* (Presses Universitares du Mirail, 2006, Université de Toulouse-le Mirail).f. 117.

[2]Bashkim Iseni, *La question nacional en Europe du sud-est, genèse, ènergence et développement de I'identiténational albanaise au Kosovo et en Macédonie, Peter Lang SA, Editions scientifiques internacionales* (Berne, 2008). f. 169, 170.

universiteti në Stamboll. Qeveria qendrore u mundua të riorganizohet në mënyrë evropiane. Këto reforma u riafirmuan me dekretin e Gjylhanës (dekret mbretëror) të vitit 1856. Pika kulmore është arritur në vitin 1876 me shpalljen e Kushtetutës që krijon një parlament të zgjedhur, por ndryshimi politik i Sulltanit Abdul Hamitit i jep fund, që nga shkurti i vitit 1878, Parlamentit, Kushtetutës dhe periudhës së Tanzimatit.[3] Masat e dala nga këto reforma tronditën shoqërinë shqiptare dhe popullatat tjera (myslimane dhe krishtere), sepse ato krijuan një sistem organizimi shumë të ndryshëm nga ai i paraparë deri më tani.

Në vitin 1830, në kohën e Sulltan Mahmudit, Admirali i madh Halil Pasha, burrë shumë inteligjent dhe me shpirt liberal, duke parë barbarinë më të cilën trajtohej pjesa krishtere e cila rrezikonte edhe ekzistimin e Perandorisë Osmane, fillimisht siguroi një parti të përkushtuar dhe nuk hezitoi të punojë dhe përparojë rreth fillimit të reformave në Perandorinë Osmane. Historia e reformave në Perandorinë Osmane është e njohur me emrin "Epoka e Tanzimatit". Admirali i madh thoshte: "Jam i bindur së në qoftë se nuk ngutemi të emitojmë Evropën do të na duhet të heqim dorë nga kthimi në Azi".[4]

Reformat e Tanzimatit ishin lëvizje kulturore dhe politike përmes të cilave synohej të përgatitej rregullimi kushtetues në Perandoria Osmane. Shteti osman kishte ngecur prapa në krahasim me vendet tjera të Evropës në zhvillimin ekonomik dhe arsimor si dhe në rregullimin e brendshme. Reformat ishin pothuajse të pashmangshme në ndryshimin dhe reformimin dhe në sistemin ekonomik dhe politik. Sipas Engelhardit, "me fillimin e Tanzimatit filloi lëvizja e zbatimit të masave të reja për t'ia plotësuar dëshirën Evropës, në mënyrë që ajo të ketë qëndrim tolerues ndaj saj". Me reformat e Tanzimatit ishte parashikuar forcimi i sundimit qendror, eliminimi i arbitrimit dhe korrupsionit, rregullimi administrativ dhe financiar, riorganizimin e sistemit fiskal etj.[5] Në fillim të shekullit XIX kushtet ekonomike, sociale, politike dhe kulturore në Perandorin Osmane ndryshuan nga ato të vendeve të Evropës Perëndimore. Që nga viti 1821 administrata osmane filloi zbatimin e këtyre reformave, edhe pse kishte shumë probleme të pazgjidhura brenda administrimit të saj. Perandoria Osmane brenda gjirit të saj kishte një mori kombesh të nënshtruara, me përkatësi të

[3] www.universalis.fr/encyclopedie/tanziat/

[4] Arkivi i Kosovës, Fondi: Arkivi Qendror i Rumanisë - Bukuresht, Gazeta Periodiku, 1899 - 1936.

[5] Emin Pllana, *Kosova dhe reformat në Turqi*, Prishtinë, 1987, f. 52.

ndryshme fetare, secila prej tyre me gjuhë, zakone, kulturë dhe edukatë të veçantë, të cilat e kundërshtonin në mënyra të ndryshme qeverisjen osmane.[6]

Sulltani nuk i kundërshtonte dhe as nuk e injoronte faktin se reformat kanë qenë të nevojshme për t'ia siguruar mirëqenien perandorisë, i cili e kishte dëgjuar këtë edhe nga (kushëriri i tij), Sulltan Selimi i III-të. Nëse, Sulltan Mahmudi nuk e ka bërë këtë gjë siç ka dëshiruar ta bënte, është së ka qenë shumë vështirë të realizohej në atë periudhë. Sepse, si do të mund të bëhej, që një sulltan, i cili njëkohësisht udhëheqës i lartë politik i shtetit dhe me ndikim të madh fetar, të fillojë reformat në Perandorin e tij të parë, për t'i arritur kështu principet e konsideruara deri me tani si të paprekshme. Dhe me tepër si do mund që ai në funksion t'i shkelte tekstet e shenjta të Kuranit. Dëshira e Sulltan Mahmudit ka mundur të jetë e sinqertë sa i përket barazisë së temave. Sa herë ai i ka përsëritur fjalitë e tij të famshme, "dua të shoh tani e tutje myslimanët në xhami, të krishterët në kishë dhe çifutët në sinagogë". Pra, ishte mëse e vështirë për Sulltan Mehmetin të arrihej në një rezultat, do të duhej të ndryshohej natyra e çështjeve, veprim shumë i rrezikshëm për të mos thënë i pamundur. Duke pasur parasysh përpjekjet e bëra nga paraardhësit e sulltanit të tanishëm, mbetej të pritshin me skepticizëm rezultatet e një tentative të re. Duke marrë parasysh gjendjes brenda Perandorisë Osmane, çfarëdolloj natyre që i përkasin ato, të prodhuara nga presioni i vazhdueshëm, ndjenja nacionaliste kishte arritur kulmin tek të gjithë popujt e Ballkanit sa që asnjëherë Sulltan Abdul-Hamiti nuk do t'ia dilte të aplikojë reformat e imponuara.[7] Të gjithë popujt e Ballkanit, veçanërisht populli shqiptar shprehu pakënaqësi të madhe kundër reformave si dhe ndaj grabitjeve dhe padrejtësive të shumta që zbatoheshin nga Porta e Lartë në krye me sulltanin.[8] Shqiptarët nuk ishin të gatshëm që ta pranonin administratën centrale të Perandorisë Osmane, shërbimin ushtarak të obligueshëm dhe taksa të rënda që nuk dihej se si do të menaxhoheshin. Emërimi dhe zëvendësimi i nëpunësve shqiptarë me ata nga administrata, domethënë Valinj e Mytesarifë në vend të bejlerëve dhe pashallarëve vendas që

[6]Zana Lito, *Mbi fillimin e Tanzimatit dhe të Rilindjes Kombëtare në Shqipëri, Studime Historike, (3-4), Viti LIII (XXXVI)*, Tiranë, 1998, f. 25.

[7] Arkivi i Kosovës, Fondi: Arkivi Qendror i Rumanisë - Bukuresht, Gazeta Periodiku, 1899 - 1936.

[8] Arkivi i Kosovës, Fondi: Iliaz Rexha, Dokumente të përkthyera nga osmanishtja, Regresa Hatti - Humayun, 1816 - 1941.

qeverisin me tokat shqiptare, administrata osmane u prit si e huaj. Shqiptarët të pakënaqur me administratën osmane, dërguan një notë protestë me shkrim në Stamboll duke i bërë me dije qeverisë, se shqiptarët do të ngriheshin në kryengritje në qoftë se nuk do të largoheshin nëpunësit më të cilët ishte i pamundur bashkëpunimi.[9] Kundërshtimi i shqiptarëve bërë reformave të Qeverisë osmane në regjionin e tyre ka tërhequr papritmas vëmendjen e fuqive evropiane, pa i dhënë rëndësi kësaj çështje duke qenë të bindur se nuk kishte arsye tjetër përveç fanatizmit fetar të shqiptarëve dhe se ky kundërshtim ishte bërë vetëm nga shqiptarët muhamedan. Shtypi evropian kishte shkruar për këtë çështje duke thënë në mes tjerash që Arnautët (shqiptarët muhamedan), të Serbisë së vjetër, të verbuar si çdo mysliman nga fanatizmi fetar i tyre ishin revoltuar kundër reformave të propozuara nga Rusia. E vërteta qëndronte në të kundërtën e asaj që ishte shkruar në shtypin evropian të kohës dhe kundërshtimi i shqiptarëve për fillimin e reformave ishte absolutisht legjitim dhe se refuzimi nuk kishte asnjë shkak tjetër përpos atij kombëtar. Shqiptarët e kundërshtonin zbatimin e reformave nuk ishin vetëm të fesë myslimane siç shkruhej në shtypin evropian, por shumë nga ata i përkisnin edhe fesë katolike.

Në anën tjetër nëse revolta e tyre kishte pasur si shkas fanatizmin fetar, ata nuk do të ndaleshin me burgosjen e xhandarëve serbë të emëruar nga Qeveria osmane, të ngarkuar për t'i çarmatosur dhe vendosur në kainakan, por në të kundërtën ata do t'i masakronin, të gjithë si turqit e Kostandinopojës që kanë bërë me armenianët. Nuk ishte e vërtetë marrja e armeve dhe tërbimi kundër funksionarëve krishterë. Shqiptarët ishin mbledhur për të shkuar te mytesarifi për protestë kundër reformave të pjesshme dhe ilegale të propozuara nga Sulltani nga Austria dhe Rusia, për t'i aplikuar ato në Serbinë e vjetër dhe në Maqedoni. Shqiptarët asnjëherë nuk kishin dëgjuar të flitej që vendi i tyre ku kishin qenë autokton ishte emëruar Serbia e Vjetër dhe që Vilajeti i Kosovës dhe i Manastirit paskan qenë pjesë të Maqedonisë. Këto troje kanë qenë të shqiptarëve që nga koha e pellazgeve dhe është mëse e drejtë t'ju përkasin gjithmonë.[10]

Pashallëqet shqiptare që në çerekun e parë të shekullit të XIX filluan të shfaqin përpjekjet e para për shkëputjen nga shteti osman, por u eliminuan që në fillim të viteve '30-ta të shekullit XIX më masat që

[9]Tajar Zavalani, *mendimi shqiptar, Histori e Shqipnis* (Tiranë, 1998). f. 165.
[10] Arkivi i Kosovës, Fondi: Arkivi Qendror i Rumanisë - Bukuresht, Gazeta Periodiku, 1899 - 1936.

mori Mahmuti II. Pastaj pashallëqet shqiptare kaluan në vendosjen e administratës së re dhe nën mbikëqyrjen e pushtetit osman. Gjatë kësaj faze të zhvillimeve, në vend të një njësie administrative, tokat shqiptare u ndanë në katër Vilajete, Vilajeti i Shkodrës, Vilajeti i Manastirit, Vilajeti i Janinës dhe ai i Kosovës. Kështu, tokat shqiptare u ndanë në katër rajone administrative të pavarura nga njëra - tjetra. Më 1832 Perandoria Osmane futi nën kontrollin e saj hapësira të mëdha tokësore që ishin pronë e pashallëqeve shqiptare.[11]

Vilajeti i Kosovës i cili ishte i banuar tërësisht me popullatë shqiptare, edhe pse kishin kaluar pesë shekuj nga pushtimi i këtyre tokave nga Perandoria Osmane, kurrë nuk i kishin pranuar ligjet e tyre. Perandoria Osmane e kishte shumë vështirë t'i mblidhte taksat, ndërsa banoret formuan këshillin e pleqve, sipas zakoneve të vjetra të shqiptarëve. Ky këshill i quajtur pleqësia inspirohej dhe qeverisej nga një përmbledhje ligjesh të njohura si Kanuni i Lekës. Pamundësia e aplikimit të reformave në trevat shqiptare njihej shumë mirë nga Fuqitë e Mëdha. Austria po e shtynte Perandorinë Osmane të provokonte përkundër dëshirës së saj, në mënyrë që të krijonte një rast të intervenimit në Shqipëri si pretekst i revoltës së shkaktuar dhe okupimit të vendit. Shqiptarët e kishin kuptuar më herët planin dhe për këtë arsye u revoltuan dhe protestuan, më armë në duar, kundër reformave të pjesshme që dëshironin t'i obligojnë, dhe për t'i treguar njëkohësisht Evropës vendimin e tyre të prerë për të mos lenë të huajin të merrej më çështjet e tyre të brendshme dhe të pengojnë me çdo mjet të mundshëm, ndarjen e vendit të tyre siç dëshironin ta bëjnë me reformat. Nuk është hera e parë që shqiptarët merrnin armët për mbrojtjen e të drejtave të tyre natyrale.[12]

Duke u revoltuar, shqiptarët dëshironin t'ia bënin me dije Evropës së ndjenja kombëtare ishte shumë e fortë siç edhe ka qenë tek stërgjyshërit e kohës së Gjergj Kastriotit. Përderisa këta e kanë mbrojtur gjakun e tyre, pavarësinë e vendit të tyre të kërcuar nga osmanet dhe nëse do të kishte nevojë do të ishim të gatshëm që në çdo kohë të sakrifikohem për t'i mbrojtur interesat kombëtare. Për revoltën e kohës nuk duhej besuar së shqiptarët ishin kundër çdo reforme, kishin më shumë se çdo popull tjetër i Ballkanit nevojë për reforma të shumta, por

[11]Nuray Bozbora, *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane* (Tiranë, 2002). f. 130, 131.

[12] Arkivi i Kosovës, Fondi: Arkivi Qendror i Rumanisë - Bukuresht, Gazeta Periodiku, 1899 - 1936.

janë thjesht kundër reformave të pjesshme të propozuara nga Austria dhe Rusia. Shqiptarët dëshironin mbi të gjitha reforma të drejta, të barabarta, komplet nën kontrollin evropian, sepse besimi ishte humbur në Perandorinë Osmane, dhe kërkonin aplikimin e tyre në tërë viset e banuara me shqiptarë. Traditat dhe zakonet e shqiptarëve ishin të veçanta, pa marrë parasysh religjionin e tyre, të krishterë apo mysliman, ata nuk kanë të drejtën e mbajtjes së armeve me vete, edhe sot e kësaj dite në të gjitha trevat që banonin shqiptarët është traditë e njëjtë. Shqiptaret nuk ishin kundër çdo reforme legale dhe të drejtë, të aplikuar me barazi të njëjta në tërë trevat ku banonin shqiptarët, por ishin kundër çdo reforme që shkonte në dëm të tyre ose të aplikuara vetëm në një pjesë të vendit të tyre. Shqiptarët nuk u ndalen se protestuari çdo herë kur panë vendin e tyre në rrezik domethënë të ndarë siç dëshironin ta bëjnë me reformat. Kush ishin të egrit dhe fanatikët? Shqiptarët apo turqit? E nëse shqiptaret nuk ishin të civilizuar, i kujt është gabimi? I tyre apo i Evropës, të cilën e paramendonin si shumë njerëzore dhe qytetëruese.[13]

Gjatë këtyre ngjarjeve në Mitrovicë ishte vrarë konsulli rus Ščerbinova.[14] Për vdekjen e tij fajësohen shqiptarët, konsulli nuk kishte gjetur vdekjen nga armët e shqiptarëve por nga armët turke, sepse Ibrahimi, vrasësi i tij, edhe pse shqiptar ishte në shërbim të Perandorisë Osmane dhe si i tillë, duhej të respektonte urdhrat e udhëheqësve të tij. Ishte mëse evidente se komandanti i cili kishte drejtuar armët kundër shqiptarëve kishte urdhëruar Ibrahimin të gjuante në konsullin Ščerbinova. Më një fjalë, këto ishin arsyet që kishin shtyrë shqiptarët të protestonin kundër reformave të propozuara nga Austria dhe Rusia. Shqiptarëve reformat ua hiqnin të drejtat e tyre, duke mos iu dhënë asgjë në shkëmbim. Në momentin e shtypjes kuptohej se kjo ishte në

[13] *Po aty*.

[14] Kush ishte konsulli rus? Ščerbinova ishte një njeri me aftësi të jashtëzakonshme. I lindur në Chernigov në 1868, pas përfundimit të shkollës së mesme, të cilën e kishte ndjekur në Lazarevska, Akademinë e Gjuhëve Orientale, dhe pas përfundimit, ai u pranua në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Ai fliste turqisht, arabisht, gjuhën armene, bullgare, serbe si dhe gjuhën shqipe. Ai hyri në shërbimin diplomatik në Kostandinopojë në moshën 23 vjeçare. Para se të mbërrijë në Mitrovicë, ishte sekretar i Konsullatës në Shkup, më pas deputet në Cetine. Ai njihte mirë situatën në Serbinë e Vjetër, historinë dhe modernitetin e popujve të Ballkanit, dhe ishte shumë guximtar. Kur ai arriti në Mitrovicë, nga frika e shtypjes nga shqiptarët askush nuk guxoi t'i ofrojë shtëpi me qira. Megjithatë, ai filloi të punojë edhe përkundër faktit se e paralajmëruan se shqiptarët mund ta vrisnin, dhe tha: "Ju do të ishit me fat sikur të vdisja...sepse vdekja ime do të ju sillte lirinë".

kundërshtim me tekstin e reformave të propozuara drejtuar shkëlqesisë së tij Sulltanit nga ana e shqiptarëve.[15]

Zbatimi i reformave nga administrata osmane në fillim të shekullit të XIX cenonte rënd të drejtat e popullit shqiptar. Fillimisht prekte autonominë fisnore, vihej në pyetje ekzistenca e territorit jetësor të tyre. Me reforma mohohej kombësia dhe gjuha shqipe, nëpunësit shqiptarë zëvendësoheshin me ata osmanë, viheshin tatime të reja, përmes forcës ushtarake. Porta kishte ndërmarr ekspeditë kundër feudalëve të mëdhenj për të forcuar pozitën e Sulltanit. Reformat osmane të aplikuara në pjesën e parë të shekullit të XIX u kundërshtuan nga populli shqiptar. Me reforma masat e gjëra dhe të varfra kanë qenë të goditura rënd, sepse tatimet e reja dhe të larta nuk ishin në gjendje t'i përballonin. Agallarët, bejlerët dhe feudalët e mëdhenj, ishin kundër forcimit të sundimit qendror të Sulltanit, sepse privilegjet dhe pozitat e tyre ishin të rrezikuara nga administrata centralizuese osmane. Feudalët dëshironin të sundonin të pavarur në krahinat e tyre. Kundër reformave u dalluan edhe shtresat progresive, intelektualët e pakët, nëpunësit me origjinë shqiptare, tregtarët dhe zejtarët. Me kalimin e kohës kjo rrymë udhëhoqi Lëvizjen Kombëtareme karakter kombëtar politik. Kjo lëvizje luftonte për të drejtat e popullit shqiptar, për pranimin e kombësisë shqiptare, të gjuhës dhe hapjen e shkollave shqipe, anash nuk u la përmirësimi dhe mirëqenia e gjendjes ekonomike të popullit shqiptar.[16]

Njëra ndër reformat me të padurueshme për shqiptarët ishte shërbimi ushtarak i detyrueshëm. Pushtuesit osman u detyruan të tërhiqnin Valiun e Janinës më 1837 dhe kishin marrë urdhër "që të mos bëheshin përpjekje aty për aty pasi detyruan shqiptarët të shkonin ushtar në regjimentet e Sulltanit". Ngjarja që kishte ndodhur në Janinës nuk ishte një ngjarje e izoluar, sepse shqiptarët kudo që jetonin në forma të ndryshme e kundërshtuan me sukses rekrutimin e detyrueshëm në ushtrinë osmane gjatë shekullit të XIX. Autoritetet osmane duke përdorur mënyrën e ngadalësimit arritën në një far mënyre të zbatonin ligjin e shërbimit ushtarak të detyrueshëm mbi një përqindje të vogël të popullatës së Shqipërisë. Qeveria osmane në fillim të shekullit të XIX arriti suksese të kufizuara vetëm në krahinat fushore të Shqipërisë së Mesme dhe Jugore. Kurse në vitin 1843 Qeveria osmane në krye, me

[15] Arkivi i Kosovës, Fondi: Arkivi Qendror i Rumanisë - Bukuresht, Gazeta Periodiku, 1899 - 1936.

[16] Emin Pllana, *Reformat turke në pjesën e parë të shekullit XIX dhe rezistenca shqiptare kundër tyre, Vjetari, VI-VII* (Prishtinë, 1974). f. 27.

Sulltan Abdyl Mexhidit bëri përpjekje të madhe me anën e forcës që ta imponoi zbatimin e ligjit mbi shërbimin ushtarak.[17]

Rezistenca më e fuqishme kundër reformave osmane u bë në Shqipërinë Veriore, në Malësinë e Madhe, Dukagjin dhe Kosovë, veçanërisht në ato krahina ku kishin dominuar marrëdhëniet patriarkale fisnore dhe ku Kanuni akoma ishte në fuqi. Në pjesët e thella malore ekzistonin principatat e vogla fisnore që ishin pjesërisht të varura, të cilat udhëhiqeshin nga të parët e tyre, kapedanët, bajraktarët, apo nga krerët e fisit. Në fillim të shekullit të XIX në krahinat më të zhvilluara në pikëpamje ekonomike, sundimin administrativ e kishin familjet trashëgimtare të cilat kishin pozita më të privilegjuara në rangun e shoqërisë shqiptare. Ndërsa, sanxhaqet, kazatë, nahijet, dhe krahinat më të vogla qeveriseshin nga pashatë, agallarët dhe bejlerët prej të cilëve shumica ishte me orgjinë shqiptare. Në disa krahina të Shqipërisë Veriore, popullsia mbante armë dhe nuk iu kishte nënshtruar sundimit osman, nuk iu kishin dhenë ushtarë dhe as nuk ju kishin përgjigjur fare taksave.

Vlen të theksohet së gjatë studimit osman fiset shqiptare u konsoliduan dhe u forcuan kundër padrejtësive që u bëheshin në mënyrë sistematike. Shqiptarët e krahinave Veriore kanë pasur bajraqet e tyre të cilët luftonin nën udhëheqjen e bajraktarëve. Pavarësia e fiseve shqiptare ekzistoi gjatë shekullit të XVIII dhe në fillim të shekullit XIX, kur sundimi osman nuk ishte në ditë më të mira të tij. Sundimi osman ka qenë më rigoroz në Shqipërinë Jugore, në krahinat e rrafshëta dhe në qytetet e Shqipërisë së Mesme, të Veriut, të Kosovës, ndërsa krahinat në mes të Dibrës, Prizrenit, Shkodrës dhe Podgoricës kanë qenë formalisht nën sundimin osman.[18] Perandoria Osmane në pjesën e parë të shekullit të XIX ishte në pozitë të palakmueshme nga lëvizjet separatiste të feudalëve të mëdhenj. Në vitin 1822 kishte një valë të protestuesve shqiptarë të Kosovës kundër Maliq Pashës. Një numër i madh i shqiptarëve kishin shkuar në Stamboll me kërkesë që Maliq Pasha të largohet nga sundimi për arsye të terrorit dhe dëmeve që bënte ndaj popullit. Protestat u përhapen në tërë Vilajetin e Kosovës, në Shqipëri, Bosnje, u shprehën pakënaqësi kundër kërkesave të administratës osmane në sistemin fiskal, kundër çarmatimit, rekrutimit dhe vendosjes së sistemit të ri gjyqësor. Më 1826 Sulltani eliminoi oxhakun e

[17] T. Zavalani, *mendimi shqiptar, Histori e Shqipnis*..., f. 166.
[18] Pllana, *Reformat turke në pjesën e parë të shekullit XIX dhe rezistenca shqiptare kundër tyre, Vjetari, VI-VII*..., f. 28.

jeniçerëve dhe mori masa rigoroze për zhdukjen e feudalëve të mëdhenj. Porta e Lartë kërkonte nga feudalët shqiptarë në Shkodër dhe në qytetet e tjera të pranoheshin garnizonet e rregullta osmane, të paguheshin tatimet e reja dhe popullsia të çarmatosej. Sulltani ishte shumë i vendosur në zbatimin e reformave. Më 1830 Mehmed Reshid Pasha, i likuidoi në Manastir përmes tradhtisë afërsisht rreth 500 feudalë shqiptarë, po ashtu në të njëjtë kohën vëllai i tij likuidoi një grup krerësh shqiptarë nga Janina. Pas zhvillimeve të këtyre ngjarjeve ushtria osmane, nën udhëheqjen e Mehmed Reshid Pashës, filloi ekspeditën ushtarake për t'i zbatuar reformat. Qytetet si Dibra, Elbasani, Durrësi, Tirana etj., u dorëzuan pa bërë rezistencë.[19]

Më 24 shtator të vitit 1844 konsulli austriak në Selanik shkruante: pushteti osman e kishte aplikuar zbatimin e reformave të reja në Prizren, Gjakovë, Prishtinë, Shkup, Tetovë dhe Dibër. Autoritetet osmane edhe pse i zbatuan reformat për një kohë të gjatë e patën shumë vështirë që të nxjerrin rekrutë nga Prizreni, Peja dhe Gjakova. Konsulli anglez në Selaniku lidhur më këtë, në raportin e tij të datës 8 mars 1854 shkruante se në rrethinën e Prizrenit dhe të Pejës nuk ishte dhënë asnjë njeri për rekrutim dhe shtonte se pa përdorimin e forcës, shqiptarët nuk do te jepnin rekrutë. Këto të dhëna i vërteton edhe zëvendëskonsulli austriak në Shkodër i cili raportonte se, "në Stamboll u mbyllën sytë për këtë, gjërat mbeten në abuzime, shpërdorime si më parë, e në këtë argument Hatisherifi i Gjylhanës mbeti si dokument pa efekt".[20]

Me fillimin dhe zbatimin e reformave shkollat shqipe nuk u lejuan, sepse reformat i favorizonin të drejtat mbi bazë fetare dhe jo etnike. Nuk u lejua edhe pas vitit 1856, kur ishte shpallur dekreti perandorak (Hatti Humaium), që premtonte trajtim të drejtë dhe të barabartë për arsimin mes gjithë popujve të Perandorisë. Shqiptarëve iu mohua e drejta të hapin shkolla në gjuhën shqipe.[21] Me reformat e Tanzimatit u prekën të gjitha shtresat e popullatës shqiptare dhe jo vetëm ato të elitës sunduese. Në mënyrë që Perandoria Osmane të pranohej e barabartë më fuqitë e mëdha të Evropës, elitat osmane tentuan të zbatonin ndaj

[19] *Po aty*, f. 31.
[20] Marjan Prenkaj, *Prizreni dhe rrethina në shekullin XIX dhe në fillim të shekullit XX* (Prishtinë, 1998). f. 180.
[21] Xhevat Lloshi, *Rreth alfabetit të shqipes* (Logos-A, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2008). f. 234.

provincave të tyre perspektiven që Selim Deringli e kishte quajtur "kolonializëm i huazuar".[22]

Shqiptaret u gjenden të papërgatitur nga zhvillimet e reja që ndërmerrte Perandoria Osmane për të vënë në jetë zbatimin e reformave. Ata të pakënaqur me reformat filluan të organizohen për të bërë rezistencë të armatosur që të pengonin të gjitha përpjekjet që ndërmerrte Perandoria Osmane. Kryengritjet e armatosura u shoqëruan me ngritje dhe ulje të kohëpaskohshme, që e shoqëruan periudhën tanzimatiste nga vitet (1832 - 1875). Përmes kryengritjeve të armatosura u kundërshtuan masat antitanzimatiste dhe vendosja e pushtetit centralist dhe burokratik në tokat shqiptare. Gjatë kësaj kohe lindi dhe u zhvillua lëvizja e njohur me emrin "Rilindja Kombëtare", e cila me ide të qarta politike, shoqërore, kulturore dhe nacionaliste luftoi kundër pushtuesve osman për çlirimin dhe formimin e kombit shqiptar.[23] Shqiptarët u detyruan edhe përmes kryengritjeve të armatosura ta kundërshtonin zbatimin e reformave. Në vitin 1831 nën udhëheqjen e Zylyftar Podës, shpërtheu kryengritja në Çamëri, pastaj në vitin 1833 kryengritjet u shtrinë edhe në Shqipërinë Jugore nën udhëheqjen e Abdyl Beg Kokës, Tafil Buzës, Zenel Agës dhe Gjoleka Mehmet Bajraktari. Kryengritjet më vrull më të madh u zhvilluan në vitin 1834 në Vlorë dhe Berat. Në maj të vitit 1834 shpërtheu kryengritja në krahinën e Gollakut, sepse popullata e kësaj ane e kundërshtoj ta paguanin tatimin për dhenë (agnam) dhe tatimet për luftë. Populsia shqiptare e Kosovës, agallarët dhe bejlerët ishin të pakënaqur me aplikimin e reformave osmane. Kundër reformave osmane u ngritën po ashtu gjitha trevat e Kosovës, Prishtina, Prizreni, Gjakova, pastaj edhe Shkupi, Tetova etj. Nën udhëheqjen e Dervish Agës një numër i konsiderueshëm prej 10 000 shqiptarë u ngritën kundër këtij sundimit.[24] Kryengritjet e shqiptarëve që e përbenin pjesa dërmuese e popullsisë, ishin të orientuara kundër reformave dhe sundimit osman. Kryengritjet asnjëherë nuk arritën të marrin karaktere mbarëkombëtar, por më shumë kishin karakter lokal, dhe kjo ja lehtësoi punët sunduesve osman që t'i shuan kryengritjet kundër osmane.

---

[22]Enis Sulstarova, *Arratisja nga lindja: Orientalizmi shqiptar nga Naimi të Kadarja* (Tiranë, 2006). f. 36.

[23]Lito, *Mbi fillimin e Tanzimatit dhe të Rilindjes Kombëtare në Shqipëri, Studime Historike, (3-4), Viti LIII (XXXVI)*..., f. 31.

[24]Pllana, *Reformat turke në pjesën e parë të shekullit XIX dhe rezistenca shqiptare kundër tyre, Vjetari, VI-VII*..., f. 35.

Shqiptarët si çdo vend tjetër kërkuan të drejtat e tyre, kërkonin të njihej zyrtarisht kombësia shqiptare, tu jepej e drejta e qytetërimit duke kultivuar gjuhën e tyre kombëtare dhe amtare, tu lejoheshin festimet, të respektohej kapaciteti personal i personave, të përdorej një pjesë e taksave të paguara nga shqiptarët në ndërtimin e shkollave dhe rrugëve të komunikacionit për të përmirësuar tregtinë, dhe, pastaj shqiptarët nuk do të kundërshtonin reformat osmane, por në të kundërtën do të bëheshin pjesë e rendi dhe qytetërimit.

Luan TETAJ

SUMMARY

ALBANIANS AND THE TANZIMAT REFORMATIONS IN THE BEGINNING OF THE 19TH CENTURY

The Tanzimat Reformation was a cultural and political movement the aim of which was to prepare for changing the constitution of the Ottoman Empire. The reformation was inevitable in the face of the ever-transforming political and economic system. The Albanians were not willing to accept central administration from the Empire, obligatory military duty and high taxes.

Albanians were not against any legal and rightful reform, which would be applied with equal distribution throughout all the territories where Albanians lived, however they were against any reformation that would harm them or any reformation that would be only partially applied. The implementation of the Tanzimat reform from the Ottoman administration at the beginning of the 19th century strongly inhibited the rights of Albanians. The Tanzimat initially only harmed the tribal autonomy, where their territorial existence would be questioned. With the implementation of the reform, Albanian schools were no longer allowed, simply because the reform favored rights on religious grounds rather than ethnic ones. Albanian schools were not allowed even after 1856, when the imperial decree (Hatti Humaium) was released, which promoted equal treatment for education among all the people of the Empire. Albanians were unprepared to face the new developments that the Ottoman Empire was undertaking in putting into practice the reformation.

Fitim RIFATI

SHQIPTARËT NË LËVIZJEN XHONTURKE (1907 - gjysma e korrikut 1908)*

Situata politike nëpër të cilën po kalonte Perandoria Osmane dhe kontradiktat që po thelloheshin në sferat e interesave të Fuqive të Mëdha, i dhanë mesazhin shoqërisë "Bashkim e Përparim" të ndryshonte kursin e aktivitetit të saj për reforma, ndërsa shqiptarët po vazhdonin përpjekjet e tyre për realizimin e të drejtave kombëtare në kuadër të Perandorisë Osmane.

Gjatë kësaj periudhe u rrit motivi luftarak nga ana e shqiptarëve, sidomos pas Kongresit Xhonturk të Parisit, por njëkohësisht ndryshoi edhe qasja e Komitetit "Bashkim e Përparim", ku Baudin Shaqiri me të arritur në Paris e riorganizoi grupin e Ahmet Rizait, gjë që ndikoi edhe në transformimin thelbësor të shoqërisë, duke nisur botimin e një gazete të re dhe formimin e degëve të reja të Komitetit si në Evropë, ashtu edhe në vise të Perandorisë Osmane.[1] Në këtë fazë, edhe Mustafa Kemali2ishte

---

* Në këtë punim është paraqitur vetëm pjesa e parë e kësaj problematike.

[1] George Gawrych, *Gjysmëhëna dhe Shqiponja - Sundimi Otoman, Islamizmi dhe Shqiptarët, 1874 - 1913* (The Cresent and the Eagle), përktheu nga origjinali: Aurel Manushi, Tiranë: "Bota shqiptare", 2007, f. 221.

[2] Mustafa Kemali - Ataturku (1881 - 1938) lindi në Selanik. I ati, Ali Riza Beu, një nëpunës i vogël në doganën e Selanikut, ishte nga një katund i Vilajetit të Kosovës, kurse e ëma ishte nga Toskëria. Mësimet fillestare i ndoqi në Selanik, ndërsa në vitin 1895 hyri në Liceun Ushtarak të Manastirit. Sa qëndroi aty lexonte veprat e Monteskjesë, të Volterit e të Rusoit, fjalimet e Mirabosë, një biografi të Robespierit dhe libra të tjerë që ndaloheshin kategorikisht nga regjimi i sulltan Abdyl Hamitit II. Në mars të vitit 1899 u regjistrua në kursin e këmbësorisë të shkollës ushtarake në Stamboll. Sa ishte në shkollën ushtarake lexonte veprat e filozofit - poet, Namik Kemalit. Pas përfundimit të shkollës ushtarake, në vitin 1902 hyri në Akademinë e Luftës dhe në janar të vitit 1905 ai mori gradën e kapitenit. Së bashku me shokët e tij themeluan një shoqëri të fshehtë me emrin "Atdhe e liri", përmes të cilës nuk pajtoheshin me regjimin obskurantist të sulltanit dhe kërkonin dorëheqjen e tij. Veprimtaria e shoqërisë ra në sy të spiunëve të sulltanit. Ai së

njëri nga pjesëtarët e Turqve të Rinj. Pas internimit të tij në Damask të Sirisë, në shtator të vitit 1907 u caktua në shtabin e Armatës së Tretë në Selanik. Aty, ai e shkriu organizatën e tij "Atdhe e liri" me Komitetin "Bashkim e Përparim". Mirëpo, me sa duket ai ra në kundërshtim me Komitetin, duke e gjykuar atë për pasivitet dhe demagogji. Disa vite më vonë ai do të thoshte: "... ne nuk mund të këmbëngulim në gabimin që na bën të mendojmë se jemi zotërit e botës. Ka ardhur koha t`i japim fund këtij vargu fatkeqësish, ku na ka çuar nanurisja me ëndrra në diell reth pozitës sonë të vërtetë dhe asaj të botës mbarë. Ne nuk mund të lejojmë më kurrsesi që kjo dramë të vazhdojë".[3]

Suksesi që pretendonte të arrinte Lëvizja Xhonturke me anë të propagandës së shtypit ishte një mënyrë që tashmë nuk tregonte efekte konkrete, madje edhe veprimtarët e saj që ndodheshin në mërgim e kuptuan se mjeti i vetëm që do të përshpejtonte ngadhënjimin e platformës politike të tyre, do të ishte përfshirja dhe aktiviteti i drejtpërdrejtë brenda Perandorisë, posaçërisht në Rumeli, ku popullsia në vilajetet e Kosovës, Manastirit dhe Selanikut ishte në qendër të vëmendjes. Kështu, nga viti 1906, si qendër kryesore e kësaj lëvizje u bë Selaniku, në të cilin u formua një shoqëri e fshehtë, e cila më vonë do të njihej si Komiteti "Bashkim e Përparim", që fillimisht nuk ishte degë e ndonjërës prej organizatave xhonturke në Evropë, por më vonë u lidhë me grupe të tjera të tyre,[4] veçanërisht me degën e Parisit, me të cilën u bashkua më 27 shtator të vitit 1907.[5]

---

bashku me shokët e tij u arrestua dhe u mbajt në burg me muaj të tërë, ku më pas i internuan (Mustafa Kemali u internua në Damask të Sirisë). Atje ai e përforcoi dhe zgjeroi shoqërinë "Atdhe e liri", në mesin e shumë oficerëve e pjesëtarëve të ushtrisë. Shih: Kopi Kyçyku, *Mustafa Qemal Aaturku*, Tiranë: "Arbri", 1993, f. 13-17; Ismet Toto, *Aaturk*, Tiranë: "Toena", 1998, f. 8-18; Patrick Kinross, *Ataturku - rilindja e një kombi*, Përkheu: L. Marku & A. Nake, Tiranë: "Eugen", 2003, f. 10-24.

[3] *Po aty*; Tachat Ravindranathan Ramavarma, *The Young Turk Revolution - July 1908 to April 1909*, Utah State University, 1965, f. 41-46; Georges Castellan, *Histori e Ballkanit (shekulli XVI - XX),* Tiranë: "Çabej", 1991, f. 385; Bernard Lewis, *Lindja e Turqisë Moderne*, përktheu: Krenar Hajdari, Tiranë: "Shtëpia e Librit & Komunikimit", 2004, f. 237; "Ataturku - krijues i Turqisë moderne", Gazeta"Rilindja", 11.VIII.1988, f. 17.

[4] Stavro Skendi, *Zgjimi kombëtar shqiptar 1878 - 1912*, përkthyer nga: Skënder Luarasi dhe Nestor Nepravishta, Tiranë: "Phoeniks", 2000, f. 309; Miranda Vickers, *Shqiptarët - një histori moderne*, Përktheu: Xhevdet Shehu, Tiranë: "Bota shqiptare", 2008, f. 90.

[5] Metoda më e përshtatshme për të përhapur idetë xhonturke ishte përmes organizatave masonike të Selanikut, ku disa nga anëtarët e Komitetit "Bashkim e Përparim" ishin të lidhur me frankmasonët. Organizatat masonike përbënin një rrjet të sigurt për anëtarët e Komitetit "Bashkim e Përparim". Nëpërmjet këtyre organizatave që vareshin nga Franca, Komiteti krijoi lidhje edhe me borgjezinë hebraike, e cila po ashtu sikur xhonturqit,

Situata nëpër të cilën po kalonte Perandoria Osmane[6], diktonte nevojën e përshpejtimit të aktivitetit intelektual xhonturk dhe në hartimin e një plani operativ që do të kanalizonte dhe përshpejtonte procesin e ngadhënjimit të tij. Kështu, xhonturqit vendosën të thërrisnin një Kongres që prapë do të mbahej në Paris. Ibrahim Temo ishte ftuar të merrte pjesë, por siç kishte bërë edhe në rastin e parë, si përfaqësues të degës së Konstancës kishte dërguar Mahmut Çelebiun.[7] Kongresi zhvilloi punimet pjesërisht dhe me dyer të mbyllura[8] gjatë 27 dhe 29 dhjetorit të vitit 1907, nën kryesimin e princ Sabahedinit. Vendimet që nxori Kongresi i vitit 1907 ishin më progresiste se ato të vitit 1902. Revolucionarët xhonturq deklaruan se gjatë tridhjetë viteve të sundimit të sulltan Abdyl Hamiti II kishin pësuar goditje të madhe jo vetëm popullata e krishterë, por edhe ajo myslimane. Mbretërimi i tij u kritikua për brutalitet, represion ndaj lirive politike, si dhe për efektet tepër negative në tregti, administratë dhe në sistemin e arsimit. Në veçanti, sistemi qeverisës i tij u akuzua për korrupsion, mbledhjen e taksave vetëm për të mirën e pallatit dhe vazhdimësinë e regjimit absolutist. Praktika e mohimit të pasaportave për tregtarët u kritikua gjithashtu, por jo vetëm për t'u mohuar individëve të drejtën e udhëtimit, por ata argumentuan se kjo kishte një ndikim të dëmshëm në zhvillimin e tregtisë dhe industrisë. Kushtet ekonomike nën sundimin absolutist, kundërshtarët e tij i dëshmuan se kishin përkeqësuar aq shumë jetesën e shtetasve osmanë saqë atyre nuk u kishte mbetur zgjidhje tjetër pos të emigrojnë në Evropë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.[9]

Tashmë, edhe Ahmet Rizai ra dakord për rrëzimin me dhunë nga froni i të parit të Perandorisë Osmane, sulltan Abdyl Hamitin II, vendosjen e një sistemi qeverisës që do të dilte nga parlamenti, vazhdimin e kalifatit dhe sulltanatit. Metoda që do të ndiqej për rrëzimin e pushtetit të sulltanit parashihej të kalonte nëpër këto faza:

---

kërkonte që vilajetet e Kosovës, Manastirit dhe Selanikut të mos shkëputeshin nga Perandoria Osmane, pasi që ato përbënin një treg të rëndësishëm për veprimtari ekonomike. Në bazë të këtyre rrugëve, Komiteti mblodhi në gjirin e tij mëse 15.000 anëtarë. Shih: Robert Mantrani, *Historia e Perandorisë Osmane*, Tiranë: "Dituria", 2004, f. 532; Kristaq Prifti, *Doktor Ibrahim Temo Temo - Jeta dhe vepra 1865 - 1945*, Prishtinë: "Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës", 1996, f. 212; T. R. Ravindranathan, *The Young...*, f. 47-49; G. Gawrych, *Gjysmëhëna...*, f. 221.

[6] Aykut Knasu, *The Revolution of 1908 in Turkey*, USA: "Brill", 1997, f. 29-72.

[7] K. Prifti, *Doktor...*, f. 213.

[8] B. Lewis, *Lindja...*, f. 238.

[9] A. Knasu, *The Revolution...*, f. 79-80.

1. Përmes qëndresës së armatosur ndaj politikës shtypëse të qeverisë;
2. Qëndresës paqësore të organizuar përmes grevave;
3. Mohimit për pagesën e taksave;
4. Zhvillimin e propagandës edhe në mesin e ushtrisë për të fituar besimin e saj të mos i kundërvihej ndonjë lëvizjeje kryengritëse;
5. Organizimin e kryengritjes së përgjithshme.[10]

Me sa do të shihet, miratimi i një deklarate të tillë, që thërriste për barazi të plotë për të gjithë shtetasit e Perandorisë, në të cilën si gjithnjë vihej në spikamë patriotizmi shtetëror dhe jo ai kombëtar, i afroi shqiptarët me Lëvizjen Xhonturke, pasi që tani kërcënohej rreziku i ricopëtimit a pushtimit të tokave shqiptare.

Gjatë kësaj periudhe të vitit 1907 dhe gjysmës së parë të vitit 1908, rëndësia dhe ndikimi i Ibrahim Temos ishte fort i dukshëm në Lëvizjen Xhonturke. Atij i bëhej thirrje që të kërkonte nga komitetet shqiptare dhe ato bullgare ta përkrahnin nismën e Turqve të Rinj dhe të mobilizoheshin për një kryengritje në rrëzimin e regjimit despotik të sulltan Abdyl Hamitit II.[11] Kështu, gjatë kësaj faze, nën drejtimin e tij, edhe dega e Bukureshtit filloi të vepronte në Shqipëri, Manastir, Kosovë dhe Selanik.[12]

Në janar të vitit 1908 ministri i Jashtëm i Austro - Hungarisë, Erental, kishte deklaruar se me aprovimin edhe të qeverisë së Stambollit13, Vjena do të fillonte ndërtimin e hekurudhës së Mitrovicës, e cila do të kalonte përmes territoreve shqiptare në vilajetet e Kosovës dhe të Manastirit dhe do të dilte në Selanik, gjë që do të pasqyronte kontrollin e këtij territori nga ana e Austro - Hungarisë, duke filluar nga Bosnja, Sanxhaku i Novi Pazarit, në drejtim të Mitrovicës, Kosovës, Luginës së Vardarit e deri në

[10] T. R. Ravindranathan, *The Young...*, f. 50; K. Prifti, *Doktor...*, f. 213; G. Gawrych, *Gjysmëhëna...*, f. 222; Bujar Dugolli, *Drenica në kthesat historike të Ballkanit 1908-1913*, Prishtinë: "Brezi `81", 2008, f. 39.

[11] K. Prifti, *Doktor...*, f. 214-216.

[12] Nuray Bozbora, *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane (Osmanli Yönetiminde Arnavytluk ve Arnavut),* përktheu nga origjinali në turqisht: Dritan Egro, Tiranë: "Dituria", 2002, f. 243.

[13] Dikur Porta e Lartë e kundërshtonte një akt të tillë nëse ndërmerrej pa konsultimin dhe pëlqimin e saj. Shih: Republika e Turqisë - Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave Shtetërore të Qeverisë së Republikës së Turqisë (Departamenti i Arkivit Osman), *Vilajeti i Kosovës në dokumentet arkivore osmane*, Stamboll, 2007, f. 91.

Selanik.[14] Në anën tjetër, Rusia ndikoi që të paraqitej një projekt hekurudhor nga Rumania e Serbia në vijën Tun - Adriatik, që do të shkonte nëpër Kurshumli, Prishtinë, Prizren, bregu i Drinit, Vau i Dejës dhe do të dilte në det përmes portit të Shën Gjinit.[15] Projekte të tilla hekurudhore, të cilat qenë burim i Fuqive të Mëdha (Fuqive të Boshtit Qendror dhe Antantës) në Ballkan tashmë në rivalitet me njëra tjetrën, e që kryqëzonin interesat e tyre, natyrisht se kishin për qëllim forcimin e lidhjeve ekonomike, por edhe ndikimin ekonomik dhe politik në tokat shqiptare. Këto plane hekurudhore sigurisht që shqetësuan shqiptarët, zemërim të cilin e shfrytëzuan xhonturqit për t'i tërhequr ata në kryengritje të armatosur kundër sulltan Abdyl Hamitit II, të cilin xhonturqit do ta akuzonin se po bënte pazarllëqe me armiqtë e shqiptarëve, të cilat ishin në kundërshtim me interesat e tyre dhe të vetë ekzistencës së Perandorisë. Me sa do të shihet, xhonturqit ia arritën qëllimit të tyre, duke realizuar praktikisht vendimet e Kongresit të Dytë Xhonturk në Paris.

Meqenëse kishte filluar edhe lufta japoneze - ruse në vitet 1904-1905, kjo kishte ndikuar sado në përqendrimin e Rusisë kundrejt interesave të saj që kishte në Ballkan, gjë e cila ndikoi që Austro-Hungaria të shtonte përpjekjet përmes programeve të ndryshme të dominonte në jug të kufijve të saj. Në këtë kontekst, meqë siguria për jetë të qetë e popullsisë që ishte brenda kufijve të viseve evropiane të Perandorisë Osmane, nuk mundësohej nga autoritetet vendëse, nisën ndërmarrjet për hartimin e programeve reformiste duke filluar nga ato të dhjetorit të vitit 1902, të shkurtit 1903, të Myrcshtegut në tetor vitit 1903, që iu paraqitën Portës së Lartë dhe deri tek ato të vitit 1905 dhe të Revalit të vitit 1908, të cilat nuk do të realizoheshin me sukses dhe nuk përmirësuan pozitën e popujve të Perandorisë Osmane.[16] Meqë Rusia tashmë kishte dalë humbëse në luftën me Japoninë, ajo e riktheu interesimin e saj drejt Ballkanit, duke vënë në

[14] Ramiz Abdyli, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1908 - 1910*, Libri 1, Prishtinë: "Instituti i Historisë - Prishtinë", 2004, f. 15; K. Prifti, *Doktor...*, f. 213; Emin Pllana, *Kosova dhe reformat në Turqi (1839 - 1912)*, Enti i Historisë së Kosovës, Prishtinë, 1978, f. 223-224; Akademia e Shkencave e Shqipërisë & Instituti i Historisë, *Historia e Popullit Shqiptar II (Rilindja Kombëtare Shqiptare - vitet '30 të shek. XIX - 1912)*, Tiranë: "Toena", 2002, f. 373; Sylë Ukshini, "Kuvendi i Ferizajt në burimet e proveniencës austro - hungareze", *Vjetar*, nr. 41-42, Arkivi Shtetëror i Kosovës, Prishtinë, 2009, f. 292.

[15] Zekeria Cana, *Politika e Serbisë kundrejt çështjes shqiptare 1903 - 1913*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2006, f. 33; Shukri Rahimi, "Kombinimet politike rreth Kosovës gjatë viteve 1902 - 1908 dhe qëndrimi i shqiptarëve", *Kosova*, nr. 3, Instituti i Historisë - Prishtinë, Prishtinë, 1974, f. 155.

[16] E. Pllana, *Kosova...*, f. 223.

pah gjendjen e vështirë që po mbretëronte në vilajetet e Manastirit dhe të Selanikut, e që si pretekst përdorte popullsinë e ashtuquajtur maqedonase.

Në këtë drejtim, nuk mungoi as tentativa e Bullgarisë që të përdorte atë pjesë të popullsisë bullgare përmes komiteteve të formuara në këto vise, me synimin që territoret e tyre të ngrinin krye kundër autoriteteve osmane, duke kërkuar bashkimin e tyre me Bullgarinë. Duhet theksuar se veprimtaria e çetave guerile që po vepronte kryesisht në vilajetet e Kosovës, Manastirit dhe të Selanikut, kishte ndikuar që në mars të vitit 1908, ministri i Jashtëm britanik, Sër Eduard Grej, të propozonte krijimin e një autonomie për një pjesë të territoreve në fjalë, gjë e cila sipas tij do të ndikonte pozitivisht në parandalimin e veprimtarisë së çetave. Madje në rrethana të tilla të krizës ekonomike dhe dhunës kriminale e trazirave shoqërore, u ndikuan që më 10 qershor të vitit 1908, mbreti i Anglisë Eduardi VII dhe perandori i Rusisë Nikolla II, të takoheshin në Reval (Talin - Estoni). Në Takimin e Revalit, gjoja për shpëtimin e kësaj pjese, u morën vendime mbi të ardhmen e saj, të cilat do të rezultonin me shkëputje nga Perandoria Osmane.[17]

Në promemorien e cila ka të bëjë me reformat në vilajetet e Kosovës, Manastirit dhe Selanikut, theksohen ndërhyrjet që duhet të bëhen nga gjenerali riorganizues. Aty parashihej nevoja e financave dhe ndryshimet administrative për reforma në xhandarmëri dhe shërbimin osman. Në kuadër të këtyre reformave parashihej që një numër i banorëve nga secili fshat, me propozimin e xhandarmërisë, të armatoseshin në mënyrë që të mbroheshin nga bandat e armatosura. Kështu, ata do të ndihmonin xhandarmërinë në kapjen e tyre. Në këtë aspekt, parashihej edhe mbështetja financiare. Mesatarisht rreth 130 raste kriminele kishin ndodhur në këto tri vilajete, si pasojë e bandave që qarkullonin. Pra, ishte

[17] Shih më gjerësisht: "Neue Freie Presse", Kolwratring, Fichtegasse, Nr. 11, Vienne, 10 july 1908; Skënder Rizaj, "Roli i shqiptarëve në Revolucionin Xhonturk të vitit 1908", *Kosova*, nr. 3, Instituti i Historisë - Prishtinë, Prishtinë, 1974, f. 165; A. Knasu, *The Revolution...*, f. 89; T. R. Ravindranathan, *The Young...*, f. 55; Tajar Zavalani, *Histori e Shqipnis*, Tiranë: "Phoenix & Shtëpia e Librit", 1998, f. 208; Misha Glenny, *Histori e Ballkanit (1804 - 1999), Nacionalizmi, luftërat dhe Fuqitë e Mëdha,* Tiranë: "Toena", 2007, f. 215; Sulejman Kylçe, *Shqipëria në historinë osmane*, nga origjinali turqisht: përkthyer dhe pajisur me vërejtje nga Zyber Hasan Bakiu, në vitin 1972, Tiranë: "Globus R", 2004, f. 159-160; R. Mantrani, *Historia...*, f. 531-533; Ismet Dërmaku, *Rilindja Kombëtare Shqiptare dhe kolonitë shqiptare të mërgimit në Rumani dhe në Bullgari*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve të KSAK, Prishtinë, 1983, f. 338; B. Lewis, *Lindja...*, f. 239;Shefqet Pllana, "Kuvendi i Ferzajit më 1908 sipas disa bashkëkohësve", *Gjurmime Albanologjike* (Seria e shkencave historike), nr. 26-1996, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1997, f. 99.

e nevojshme që të krijohej një elitë preventive në pengimin dhe zhdukjen e bandave kriminele. Parashiheshin reforma lokale edhe në gjyqësi, administratë e financa, të cilat do të mbikëqyreshin nga një inspektor gjeneral (në rangun e vezirit), nën garancinë e Fuqive të Mëdha.[18]

Takimi i Revalit ndikoi në përshpejtimin e shpërthimit të kryengritjes së përgjithshme.19 Komiteti "Bashkim e Përparim" e vlerësoi këtë projekt reformash si një hap drejt shkëputjes së këtyre territoreve nga shteti osman, gjë që reflektoi në kundërshtimin e vendimeve të këtij takimi pranë konsujve të huaj në këto vilajete. Prandaj, Komiteti konsideronte se problemet e tilla janë pjesë përbërëse e Perandorisë dhe se shkaku kryesor është regjimi i kohës dhe njëkohësisht e cilësonte si të panevojshëm ndërhyrjen e fuqive të huaja.[20]

Tashmë ishte i njohur programi gjithëpërfshirës dhe reprezentativ që xhonturqit kishin proklamuar. Mirëpo, me qëllim që të tërhiqnin masat popullore përkrah tyre, ata bënë disa ndryshime programore, të cilat në thelb preknin edhe kërkesat e shqiptarëve. Ndër këto çështje ishte eliminimi i taksave të papërballueshme, largimi i zyrtarëve të korruptuar e despotikë dhe mbrojtja e shqiptarëve nga synimet austriake dhe italiane.[21] Gjithë popujve të Perandorisë u premtohej rishpallja e kushtetutës, liria, barazia, vëllazëria e drejtësia. Edhe gjatë kësaj kohe shqiptarët u konsideruan si faktorë mjaft i rëndësishëm për suksesin e Lëvizjes Xhonturke, ku kryesisht shtresa të caktuara të popullsisë që ishin myslimanë vlerësoheshin prerazi për suksesin e lëvizjes. Meqë ngërthente pjesë elementare me kërkesat e shqiptarëve, një shumë e konsiderueshme e tyre nuk mungoi të jetë anëtare e këtij Komiteti, gjë e cila u reflektua që edhe në Manastir të formohej një qendër e Komitetit "Bashkim e Përparim", mjaft e rëndësishme për proceset në vazhdim. Kjo qendër u pasqyrua si shembull për formimin e degëve të tjera, si në Resnjë, Ohër, Strugë, Gjirokastër (jug); Shkodër, Shkup,[22] Ferizaj, Mitrovicë dhe Prizren

[18] Arkivi Shtetëror i Maqedonisë, Ministria e Punëve të Jashtme të Serbisë, 1.17.1. 39/251-259.
[19] G. Gawrych, *Gjysmëhëna...*, f. 228.
[20] N. Bozbora, *Shqipëria...*, f. 214.
[21] R. Abdyli, *Lëvizja...*, f. 23.
[22] Krerët shqiptarë nisën të anëtarësoheshin nëpër degët e Komitetit "Bashkim e Përparim", ku ndër ta ishin edhe prijësit e kazasë së Gjilanit, Islam Pira e Murat Bilalli, të cilët u regjistruan në degën e Komitetit Xhonturk në Shkup dhe i premtuan xhonturqve se do të angazhoheshin për luftë kundër absolutizmit të sulltanit, për një shtet të bazuar në kushtetutë, ku gjithë kombësitë do të siguronin të drejtat e tyre. Shih: Sadullah Brestovci, *Lëvizja Kombëtare në Kazanë e Gjilanit - Islam Pira (1861 - 1931)*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2008, f. 32.

(veri).[23] Në fillim të vitit 1908 në Janinë gjendeshin shumë veprimtarë shqiptarë midis ushtarakëve dhe nëpunësve, territor ky në të cilin po përhapej dhe zhvillohej me shpejtësi opozita xhonturke.[24]

Siç është theksuar dhe më parë, shqiptarët vepronin në Lëvizjen Xhonturke nëpërmjet dy roleve; si shqiptarë dhe si osmanë. Me këtë rast Gjirokastra dhe Dibra ishin dy degë në të cilat vepronte edhe Komiteti Shqiptar e ai Xhonturk, në të cilin harmonizohej veprimtaria me njëri - tjetrin.[25] Kjo dëshmon se në shumë qytete, krahas çetave kryengritëse, bashkërendimi ndërmjet xhonturqve dhe komiteteve shqiptare "Për lirinë e Shqipërisë", ishte i dendur dhe harmonik, duke vënë në pah sidomos komitetin shqiptar të Dibrës, i cili u bashkua që në vitin 1907 me Komitetin "Bashkim e Përparim". Po ashtu, komiteti xhonturk në Shkup, në përbërjen e tij kishte shumicën e anëtarëve shqiptarë lokal.[26]

Qëllimi i komiteteve revolucionare shqiptare, të cilët tashmë kishin krijuar raporte veprimi të ngushta me qendrën e Komitetit "Bashkim e Përparim", ishte të krijonin një administratë autonome dhe të privilegjuar në territorin e sanxhaqeve shqiptare (Shkodër, Durrës, Pejë, Prizren, Prishtinë, Dibër, Elbasan, Berat etj.) dhe në fund të formonin një shtet të pavarur shqiptar. Turqit e Rinj e zgjeruan propagandën e tyre në masat e gjera shqiptare kryesisht përmes oficerëve shqiptarë që shërbenin në ushtrinë osmane. Të dhënat flasin për mëse 3/4 e oficerëve revolucionarë që vepronin në territorin e Vilajetit të Kosovësishin anëtarë të komiteteve xhonturke dhe me kombësi shqiptare, si pjesëtarë të armatës së tretë, e stacionuar në vilajetet e Manastirit, Selanikut dhe të Kosovës.[27] Në këtë kontekst, shumica e oficerëve shqiptarë të garnizonit të Shkupit e mbështeti Lëvizjen e Turqve të Rinj, ndërsa në verë të vitit 1908 u shpeshtuan veprimet antiqeveritare të ushtarëve dhe oficerëve shqiptarë të garnizonit të këtij garnizoni.[28]

---

[23] Kristaq Prifti, "Kontributi i shqiptarëve në Lëvizjen e Turqve të Rinj (1889-1908)", *Gjurmime Albanologjike* (Seria e shkencave historike), nr. 31-32/2001-2002, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2002, f. 226; Zekeria Cana, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Kosovë 1908 - 1912*, Prishtinë: "Rilindja", 1979, f. 29; AShSh & IH, *Historia e Popullit Shqiptar II...*, f. 374.

[24] Nathalie Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar - lindja e një kombi me shumicë myslimane në Evropë*, përktheu nga origjinali: Artan Puto, Tiranë: "Përpjekja", 2009, f. 498.

[25] K. Prifti, "Kontributi...", f. 226.

[26] R. Abdyli, *Lëvizja...*, f. 13;P. Bartl, *Myslimanët...*, f. 190.

[27] S. Rizaj, "Roli...", f. 164-165.

[28] AShSh & IH, *Historia e Popullit Shqiptar II...*, f. 374; Shukri Rahimi, *Lufta e shqiptarëve për autonomi (1897 - 1912),* Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSA

Problemet ekonomike, politike e sociale, në njërën anë, dhe rreziku i mundshëm i ndërhyrjes së fuqive të huaja në punët e brendshme të Perandorisë, ishin disa nga shkaqet me të cilat po ballafaqohej sulltan Abdyl Hamiti II. Klima e thatë, ulja e rendimentit të prodhimit, ngritja e çmimeve ushqimore, ku në pjesën evropiane goditjen më të madhe të thatësisë po e pësonte Vilajeti i Kosovës, pati për pasojë fillimin e protestave nëpër rrugë, ku popullsia ankohej për shkak të mungesës së ushqimit, ndërsa xhonturqit po përgatiteshin që këtë lëvizje të brendshme të shqiptarëve ta shfrytëzonin në favor të interesave të tyre.[29]

Në këto rrethana, projekti hekurudhor austro - hungarez dhe takimi i Revalit, konsiderohen si dy shkaqet kryesore që çuan në zgjerimin dhe në forcimin e mëtejshëm të luftës së armatosur të çetave shqiptare, të cilat udhëhiqeshin nga komiteti "Për lirinë e Shqipërisë", që pretendonin të shmangnin ndërhyrjen e huaj dhe ricopëtimin e viseve shqiptare dhe njëkohësisht për të detyruar Portën e Lartë të miratonte aktin e një Shqipërie autonome.[30] Mirëpo, përfshirja e elementëve të ndryshëm në këtë situatë, do të ndikonte që interesa të posaçme kombëtare të gërshetoheshin me ato të ruajtjes së kompaktësisë territoriale dhe pacenueshmërisë politike të Perandorisë Osmane, ku rolin kryesor do ta merrte Komiteti "Bashkim e Përparim". Nisja e veprimtarisë së armatosur të Komitetit "Bashkim e Përparim" u pasqyrua në gjithë territorin e Perandorisë, e sidomos në vilajetet e Kosovës, Manastirit dhe të Selanikut, ku pakënaqësia midis oficerëve, një numër i madh prej të cilëve ishin shqiptarë, u rrit për shkak të mospagimit të rrogave. Ndërsa, në Vilajetin e Kosovës shqiptarët e ndjenin veten në rrezik nga projekti austro - hungarez për ndërtimin e hekurudhës Uvac - Mitrovicë si dhe kundërshtonin rekrutimin e tyre për të shuar lëvizjen çlirimtare në Jemen.[31] Trazirat të cilat shpërthyen në Vilajetin e Kosovës kundër projektit austro-hungarez mbi hekurudhën, kishin nisur që nga fundi i muajit prill të vitit 1908 në kazatë e Mitrovicës dhe të Pejës, ku fshatarë të revoltuar për shkak të moskompensimit të tokës që u merrej për trasenë e hekurudhës, u shtynë të sulmojnë stafin e inxhinierëve austriakë, të cilët po bënin matjen e saj. Me këtë rast reagoi ushtria osmane, e cila dërgoi reparte ushtarake kundër fshatarëve të revoltuar.[32] Në rrethana të tilla,

---

të Kosovës, Prishtinë, 1978, f. 140.
[29] G. Gawrych, *Gjysmëhëna...*, f. 227.
[30] R. Abdyli, *Lëvizja...*, f. 16.
[31] *Po aty*, f. 17; B. Lewis, *Lindja...*, f. 239.
[32] Z. Cana, *Lëvizja...*, f. 31.

shqiptarët e cilësuan këtë projekt si një synim për të ricopëtuar tokat e tyre, të cilët tani filluan të formonin çeta kryengritëse në mbrojtje të tokave të tyre.[33]

Gjatë kësaj kohe, aktiv në përhapjen e programit të Komitetit "Bashkim e Përparim" ishte edhe Ibrahim Temo, i cili mbante lidhje me degët e shoqërisë në qytetet e vilajeteve të Kosovës, të Manastirit e Selanikut, me atdhetarët shqiptarë dhe pjesëtarët e Turqve të Rinj që gjendeshin e vepronin atje. Ai, përmes konsullatave të shteteve të huaja, i çonte atyre letra, gazeta, shpallje dhe dokumente të tjera që i hartonte vetë, së bashku me anëtarët e tjerë të degës së Konstancës "Bashkim e Përparim", ose që i vinin të hartuara nga qendra e Parisit.[34] Po ashtu, një përkrahje Turqve të Rinj drejt thirrjes së shqiptarëve për t'u bashkuar me Lëvizjen Xhonturke, po e jepte edhe Mit'hat Frashëri, i cili ishte në krye të klubit shqiptar të Selanikut dhe kishte bashkëpunim me degën e Komitetit "Bashkim e Përparim" në Selanik.[35] Ai, më 14 korrik të vitit 1908, ditën e përvjetorit të sulmit mbi Bastijë (Revolucionit Borgjez Francez të vitit 1789), filloi botimin e gazetës "Lirija", e cila ndikoi mjaft në lëvizjen dhe kulturën kombëtare, por edhe në kohën e shpërthimit të Revolucionit Xhonturk.[36] Situata e re, që ishte krijuar dhe po vazhdonte të përhapej me shpejtësi në vilajetet e Kosovës, Manastirit dhe Selanikut, ku çetat shqiptare dhe bullgare, duke i bashkëngjitur këtu edhe pakënaqësitë që ekzistonin në mesin e ushtrisë dhe paralizimi i shërbimeve civile dhe administratës ushtarake, ishin një truall i përshtatshëm për realizimin e programit të Turqve të Rinj.

Kështu, në Resnjë, komandant i 10.000 vetëve ishte majori shqiptar, Ahmet Nijazi Beu,[37] i cili ishte bashkuar me Lëvizjen e Turqve të Rinj në sanxhakun e Ohrit. Para se të dilte në mal, ai i kishte shkruar kunatit të tij: "*Preferoj më mirë të vdes se sa të rroj i poshtëruar... Ose vdekje ose shpëtimin e atdheut*".[38] Ai tashmë kishte ndërmarrë masat kryengritëse, duke e ftuar popullin t'i bashkohej në kryengritje. Për këtë veprim, sulltani e kishte ftuar që të shkonte në Stamboll, mirëpo një ftesë të tillë e kishte

[33] R. Abdyli, *Lëvizja...*, f. 17; A. Knasu, *The Revolution...*, f. 86.
[34] K. Prifti, *Doktor...*, f. 221.
[35] P. Bartl, *Myslimanët...*, f. 192.
[36] Mid`hat Frashëri (Lumo Skëndo), *Elita Shqiptare 1 - Një studim mbi veprimtarinë kryesore të Mid`hat Frashërit (Lumo Skëndo) dhe pjesë të zgjedhura nga vepra e tij*, Përgatitur nga Uran Butka, Tiranë: "Plejad", f. 16-17.
[37] Ahmet Mizuri, ose Nijazi Resnja është i lindur në fshatin Bukovë në rrëzë të malit Biglla në hapësirën midis Ohrit dhe Resnjës.
[38] S. Skendi, *Zgjimi...*, f. 311.

refuzuar meqë e kuptonte qëllimin e saj. Për të vënë në një harmoni më të plotë veprimtarinë e tij, Nijazi Beu me mëse 50 pjesëtarë të Komitetit "Bashkim e Përparim" mbajti një mbledhje me ç`rast vendosi të formojë çetën kryengritëse prej 200 vullnetarësh në malet e Resnjës. Këtë vendim e përqafuan edhe major Remziu, kapiten Xhafer Tajari dhe Sylejman Beu.[39] Kështu, më 3 korrik të vitit 1908, ai u arratisë në mal së bashku me njësitin e tij prej 160 - 200 luftëtarësh.[40] Kjo ngjarje shënoi dhe fillimin e Revolucionit Xhonturk të vitit 1908. Shembullin e Nijazi Beut e ndoqi edhe reparti i Demir Hisarit, që komandohej nga Enver Beu.[41]

Që nga dita e parë kur u arratisë në mal, Ahmet Nijazi beu i paraqiti një proklamatë oborrit të sulltanit, përmes inspektorit të përgjithshëm të Rumelisë në Selanik, Hysen Hilmi Pashës, komandantit të regjimentit të xhandarmërisë së Manastirit. Në proklamatë theksohej kërkesa e rivendosjes me çdo kusht të sistemit shtetëror kushtetues dhe parlamentar. Nëse nuk realizohej kjo dëshirë e tyre, atëherë ata kërcënonin se do të përdornin forcën për të arritur në qëllimin që kishin.[42] Po ashtu, në proklamatë kërkohej që ky program të merrte në mbrojtje lirinë dhe të zbatonte reformat në mënyrë të barabartë për të gjithë shtetasit e Perandorisë, pa dallim besimi.[43]

Ahmet Nijazi beu ishte i vetëdijshëm se vetëm me çetën e tij nuk mund të tregonte ndonjë sukses konkret. Kjo ndikoi që ai të kishte si objektiv takimin me Çerçiz Topullin në Starovë për të marrë përkrahjen e tij nga Shqipëria e Jugut. Mirëpo, ai nuk e mori miratimin e Çerçiz Topullit për shkak se ky i fundit po luftonte me çetën e tij për të realizuar të drejtat e kombit shqiptar dhe jo të të gjithë popujve në shtetin osman.[44] Në këtë mënyrë çeta e Ahmet Nijazi beut u fokusua kryesisht në krahinën e Ohrit, të Strugës, të Dibrës dhe të Kërçovës. Në këto anë, ai gjeti mbështetjen e popullsisë fshatare shqiptare, e cila jepte betimin për

[39] Nijazi Beu, meqë ishte udhëheqës i kryengritjes dhe me ide përparimtare, kishte siguruar plumba zjarri, 75 pushkë mauzerkë, 15 kutia municion dhe 540 lira osmane nga arka e regjimentit. Kësaj kryengritjeje iu kishin bashkuar afër 100 ushtarë dhe shumë bashibozukë (ushtarë jo të rregullt), dy togerë të këmbësorisë me shumë gjuajtës; Shih: S. Rizaj, "Roli...", f. 165.

[40] Arkivi i Institutit të Historisë në Tiranë (më tej: AIHT), Vj-18-9-970, Raport i konsullit austro - hungarez nga Selaniku dërguar ambasadorit në Stamboll, 7 korrik 1908.

[41] Gazmend Shpuza, *Në vazhdën e gjurmëve për epokën e Rilindjes Kombëtare (Përmbledhje shënimesh historike dhe historiografike)*, Tiranë: "Toena", 1997, f. 146; Sh. Rahimi, *Vilajeti...*, f. 124; B. Lewis, *Lindja...*, f. 240.

[42] R. Abdyli, *Lëvizja...*, f. 17.

[43] S. Rizaj, "Roli...", f. 165; S. Skendi, *Zgjimi...*, f. 311.

[44] *Po aty,* f. 159-163.

Komitetin "Bashkim e Përparim". Në fjalimin që mbajti para fshatarëve të Llavcit, Ahmet Nijazi beu i kërkonte atyre që të falnin gjaqet, hakmarrjen dhe ngatërresat. Me sa duket, Ahmet Nijazi beu pas një takimi që pati në Ohër me drejtues të Komitetit "Bashkim e Përparim", me sugjerimin e tyre, hartoi dhe shpalli një proklamatë tjetër me të cilën i drejtohej popujve të ndryshëm të Rumelisë, ku i bënte të ditur mbi qëllimin e kryengritjes dhe kërkonte përkrahjen e tyre për rivendosjen e kushtetutës.[45] Në këtë mënyrë, si rezultat i thirrjeve dhe qëllimit të kryengritjes, rreth 100 fshatra të këtyre anëve kishin dhënë mbështetje të gjithanshme njësitit të Ahmet Nijazi beut, posaçërisht popullata shqiptare myslimane.[46]

Ndikimi i tij në këto anë tashmë u pasqyrua edhe në aspektin administrativ, ku arriti të largonte sistemin e pushtetit vendor, të dëbonte zyrtarët dhe tagrambledhësit dhe të krijonte një milici shqiptare për të ruajtur rendin. Kishin filluar të përdoreshin edhe dëftesa si prova për pagesën e taksave. Mirëpo, shumica e shqiptarëve nuk pranonin të merrnin asnjë kompensim për ndihmën e dhënë njësitit të tij.[47]

Sipas raporteve të konsujve austro - hungarez në Manastir dhe Vlorë, njësiti i Nijazi Beut, sikurse kishte gjetur mirëpritje e mbështetje nga rrethet e Resnjës, Ohrit, Strugës dhe Kërçovës, në një atmosferë të tillë u prit edhe nga banorët e zonës së Pogradecit. Ndërsa, sa i përket takimit me Çerçiz Topullin, aq i kërkuar nga Nijazi Beu, nuk u realizua, sepse Çerçiz Topulli me një pjesë të çetës së tij ndodhej afër Korçës.[48]

Në kohën kur njësiti i Nijazi Beut po drejtohej nga zëvendësi i tij, Remzi Beu, erdhi deri tek takimi i këtij të fundit fillimisht me njerëzit e Çerçiz Topullit dhe më vonë edhe me Çerçizin dhe anëtarë të tjerë të Komitetit të Korçës "Për lirinë e Shqipërisë". Siç theksuam edhe më herët, Çerçiz Topulli ishte i interesuar në realizimin e interesave kombëtare të shqiptarëve (autonominë e Shqipërisë), por edhe pse u arrit një marrëveshje gojore mes tij dhe zëvendësit të Nijazi Beut, i cili premtoi se do të përmbushej kjo kërkesë, faktikisht kjo nuk paraqiti një rëndësi të posaçme, sepse nuk ishte një marrëveshje me shkrim, që do të shërbente si një akt i vlefshëm në justifikimin e saj para Komitetit "Bashkim e Përparim", kur dihet fakti se programi i Lëvizjes Xhonturke nuk

[45] R. Abdyli, *Lëvizja...*, f. 19; *Kujtime veteranësh për Luftën Çlirimtare Kombëtare në vitet 1878-1912*, "Rilindja" (Fejton), Prishtinë, 25.IV.1970.
[46] *Po aty*, f. 20; P. Bartl, *Myslimanët...*, f. 190-191.
[47] *Po aty*.
[48] AIHT, Vj-18-12-1237, Raport i konsullit austro - hungarez nga Manastiri, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, 22 korrik 1908; Vj-18-5-598, Raport i konsullit austro-hungarez nga Vlora, dërguar MPJ në Vjenë, 7 qershor 1908.

parashihte realizimin e kërkesave individuale kombëtare, por që në thelb kishte devizën për "liri, barazi e vëllazëri për të gjithë osmanët".[49]

Duke u referuar në E. I. Nikollaidhu, udhëheqësit shqiptarë kishin paraqitur si parakusht bashkëpunimin me Komitetin "Bashkim e Përparim" vetëm nëse njihej gjuha shqipe si gjuhë e barabartë me gjuhët e tjera në Perandorinë Osmane, hapjen e shkollave shqipe, botimin dhe qarkullimin e librave dhe gazetave shqipe, formimi i një trupe xhandarmërie të përbërë nga shqiptarët, e cila do të kujdesej për ruajtjen e rendit dhe qetësisë dhe të ngrihej flamuri shqiptar. Tri nga kërkesat e para u pranuan nga Komiteti "Bashkim e Përparim", por kërkesa e fundit nuk u pranua fare.[50]

Megjithëkëtë, duhet theksuar se bashkëpunimi i shqiptarëve me Turqit e Rinj u ngrit në një shkallë më të lartë edhe në kazatë e Korçës, Pogradecit dhe Elbasanit. Po ashtu, edhe komiteti shqiptar i Ohrit dhe i Korçës ishte orientuar për t'i dhënë përkrahje shpërthimit të Revolucionit Xhonturk, duke u bërë thirrje çetave kryengritëse të krahinave përreth që t'i bashkoheshin njësitit të Nijazi Beut.[51] Në këtë mënyrë, çeta e Nijazi Beut u shumëfishua, ku arriti shifrën prej 3.000 vetash të gjithë me përkatësi kombëtare shqiptare. Ajo e bëri program politik kërkesën për Kushtetutën e vitit 1876, urrejtjen kundër politikës së sulltan Abdyl Hamitit II dhe rrezikun e ricopëtimit të trojeve shqiptare.[52] Aksionet e suksesshme që ndërmori Nijazi Beu u zhvilluan në koincidencë me shpërthimin e pakënaqësisë së shqiptarëve në Vilajetin e Kosovës si pasojë e rrezikut që kanosej me rastin e hekurudhës austro - hungareze dhe rritjes së rrezikut të ricopëtimit të tokave shqiptare, ku revolta e shfaqur në kazanë e Mitrovicës dhe në kazanë e Pejës në fund të prillit do të marrin një karakter zhvillimi në gjithë Vilajetin. Në këto rrethana, shqiptarë të armatosur nisën të marrin në zotërim krahinat e Prizrenit, Gjakovës, Prishtinës dhe të Vushtrrisë.[53] Gatishmëria e shqiptarëve dhe nxitja armiqësore që ushtrohej edhe nga agjitatorët serbë kundër projektit austro - hungarez të hekurudhës,[54] ku mijëra shqiptarë që ishin thellësisht të

[49] R. Abdyli, *Lëvizja...*, f. 21.
[50] AIHT, A-IV-405, ΕλεΦτερία Νικολλαίδυ, *Lëvizja Shqiptare në Vilajetin e Janinës dhe kontributi i klubeve në zhvillimin e saj (1908 - 1912)*, cituar sipas R. Abdyli, *Lëvizja...*, f. 21-22.
[51] *Po aty*, f. 22.
[52] G. Shpuza, *Në vazhdën...*, f. 150.
[53] R. Abdyli, *Lëvizja...*, f. 22.
[54] Noel Malcolm, *Kosova - një histori e shkurtër*, Përktheu nga anglishtja: Dr. Abdullah Karjagdiu, botim i dytë, Prishtinë - Tiranë: "Koha & Shtëpia e Librit", 2001, f. 246; Ismet

shqetësuar kishin vendosur ta parandalojnë realizimin e këtyre reformave "prosllave" në tokat shqiptare,[55] njëkohësisht iu shërbeu edhe ekskursioni i nxënësve të shkollës së mesme hekurudhore austriake të Shkupit, që po planifikohej të mbahej më 5 korrik të vitit 1908 në fshatin Sarajishtë (sot Lloshkobare, F. R.) afër Ferizajt, i cili u konsiderua si pretekst për të thirrur shqiptarët në mbrojtje të viseve të tyre nga rreziku i okupacionit austro-hungarez, ashtu siç e cilësonin ata.

Për organizimin e këtij ekskursioni kishte dhënë leje Drejtorati i Vilajetit të Kosovës në Shkup dhe në këtë ekskursion do të merrnin pjesë, përveç përfaqësuesve të konsullatës austro-hungareze, edhe autoritetet e Drejtorisë së Vilajetit dhe përfaqësuesit e diplomacive të shteteve të tjera.[56] Në të u ngrit tribuna, e cila u dekorua dhe njëkohësisht u ngrit flamuri i Austrisë. Në ndërkohë, austriakët kishin bërë edhe sulme të papritura.[57] Për këto arsye, shumë shpejt u mblodhën mijëra shqiptarë të armatosur, të shtyrë edhe nga të dërguar të posaçëm serbë, u nisën drejt Ferizajt dhe Sarajishtës.[58] Lidhur me këtë ngjarje, konsulli austro - hungarez në Mitrovicë, Zambaur, njofton se afër stacionit të hekurudhës në Ferizaj ishin mbledhur një numër shqiptarësh prej 3.000 vetash. Si pasojë e kësaj ngjarje, në Ferizaj kishin shkuar Shemsi Pasha nga Prizreni dhe mytesarifi i Prishtinës.[59] Shqiptarët të revoltuar ishin mbledhur shpejt dhe ishin nisur në Sarajishtë. Djegia e korijes austro - hungareze në Sarajishtë[60] nga ana e shqiptarëve, sipas një dokumenti që posedojmë, me gjasë që duhet të ketë ndodhur më 6 korrik të vitit 1908.[61] Djegia e Sarajishtës u përjetua edhe në këngët popullore.[62] Shemsi Pasha, që më datën 5 korrik është takuar në rrugën nga Prizreni për në Ferizaj me Hasan Hysenin e Budakovës, ku i kishte këshilluar shqiptarët të që të

Dërmaku, "Kuvendi i Ferizajt (1908) dhe Revolucioni i Xhonturqve", Buletin i Muzeut të Kosovës XV - XVI (1987 - 1988) - SEPARAT - Prishtinë, 1988, f. 100-101.

[55] Eqrem bej Vlora, *Kujtime*, Vëllimi i parë (1885 - 1912), Përktheu nga origjinali gjermanisht: Afrim Koçi, Tiranë: "Shtëpia e Librit & Komunikimit", 2001, f. 230.

[56] I. Dërmaku, "Kuvendi...", f. 99.

[57] S. Rizaj, "Roli...", f. 170.

[58] AIHT, Vj-18-11-1137 dhe Vj-18-8-894, Raporte të konsullit austro - hungarez nga Mitrovica, dërguar MPJ në Vjenë, 8 dhe 20 korrik 1908; Vj-18-7-792, Raport i konsullit austro - hungarez në Prizren, dërguar MPJ në Vjenë, 7 korrik 1908.

[59] AIHT, Vj-18-11-1136, Telegram i konsullit austro - hungarez nga Mitrovica, dërguar MPJ në Vjenë, 6 korrik 1908.

[60] S. Kylçe, *Shqipëria...*, f. 172-173; S. Brestovci, *Lëvizja...*, f. 35-37.

[61] AIHT, A-IV-103, f. 10-11.

[62] Instituti Albanologjik i Prishtinës, *Këngë popullore të Rilindjes Kombëtare*, Prishtinë, 1978, f. 268-270.

mblidheshin e të shkonin në Manastir, sepse ai qenka i kërcënuar nga bandat bullgare. Hasan Hysen Budakova, ndër të parët e kësaj ane, me katër mijë pushkë të tij i kishte dhënë karakterin e shtrënguar të qeverisë dhe kishte ndikuar në parandalimin e shpërndarjes së shqiptarëve të tubuar në Ferizaj.[63] Mirëpo, qëllimi për instrumentalizimin e shqiptarëve nga ana e Shemsi Pashës nuk do të arrihet.

Zhvillimi i ngjarjeve të tilla në të njëjtën kohë ngjallë perceptimin se bashkërendimi i tyre në interesin e përbashkët ishte mëse i lidhur ngushtë me veprimtarinë e shqiptarëve. Reagimet e përgjithshme provojnë se rreziku ishte i përbashkët, kryesisht në ato anë ku pretendohej të bëheshin ndërhyrjet e jashtme. Shqiptarët e Vilajetit të Kosovës dhe më gjerë, ishin mbledhur në Ferizaj dhe po planifikonin të mbanin një kuvend për të diskutuar situatën politike në vend dhe për të vendosur mbi masat që do të ndërmerreshin.

Kuvendit të Ferizajt i kishte paraprirë një tubim i fshehtë në Orman të Shkupit, ku nën organizimin e xhonturqve kishin marrë pjesë krerët shqiptarë të kazasë së Gjilanit, siç ishin Idriz Seferi, Islam Pira, Hamdi Kurteshi etj.[64] Mirëpo, organizimi kryesor i shqiptarëve do të bëhej në Ferizaj. Kështu, më 5 korrik filloi Kuvendi i Ferizajt, i cili do të zgjaste punimet e tij deri më 23 korrik të vitit 1908, kur edhe u rishpall kushtetuta. Banorët e qytetit familjet e veta i sistemuan nëpër fshatrat përreth, ndërsa nisën të lironin shtëpitë e tyre për të strehuar kryengritësit që vinin të armatosur,[65] si në Orman e Badofc, ku parashihej të vendoseshin rreth 2.000 kryengritës, ndërsa në Shkup ishin paguar 10 furra për bukë dhe ishin blerë 200 tenda për vendosjen e tyre.[66] Janë dhënë shifra të ndryshme lidhur me numrin e kryengritësve, mirëpo deri në fund të punimeve të tij ato sillen mes 3.000 - 4.000 në fillim dhe në 30.000 - 50.000 deri në fund të tij.[67] Kuvendi i Ferizajt do të jetë një shprehje e gatishmërisë së popullit shqiptarë të Vilajetit të Kosovës, që të mbrojë territoret nga ripushtimi i ndonjë fuqie të huaj dhe do t'i jepte fund regjimit absolutist të sulltan Abdyl Hamitit II, pasigurisë, mosrespektimit të ligjeve dhe do të kërkonte

[63] AIHT, Vj-18-8-894, Raport i konsullit austro - hungarez nga Mitrovica, dërguar MPJ në Vjenë, 20 korrik 1908.
[64] S. Brestovci, *Lëvizja...*, f. 41-43.
[65] G. Shpuza, *Në vazhdën...*, f. 154.
[66] **"**Политика", **Београд,** 9 (22) **ЈУЛА** 1908.
[67] AIHT, Vj-18-11-1136, Raport i konsullit austro - hungarez nga Mitrovica, dërguar MPJ në Vjenë, 5 korrik 1908; G. Shpuza, *Në vazhdën...*, f. 164; Sadulla Brestovci, "Idriz Seferi - Kreshniku i Karadakut", *Rilindja* (Fejton), Prishtinë, 19.I.1970, f. 13; I. Dërmaku, "Kuvendi...", f. 338.

zgjidhjen e çështjes kombëtare të shqiptarëve nën Perandorinë Osmane përmes autonomisë administrative.[68]

Kuvendi i Ferizajt i kishte zhvilluar mbledhjet e tij në xhaminë e vetme të Ferizajt, ndërsa efektivi i kryengritësve gjatë gjithë kohës sa zgjati punimet Kuvendi, ishte i sistemuar në qytet dhe fshatrat përreth tij, ku për çdo zhvillim që bëhej informoheshin nga lajmëtarët. Në Kuvendin e Ferizajt morën pjesë përfaqësues të shquar të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, siç ishin: Isa Boletini, Bajram Curri, Nexhip Draga, Idriz Seferi, Sulejman Batusha, Ramadan Zaskoci, Xhemal bej Prishtina, Zenel bej Vushtrria, Ramë Abdyli, Rexhep efendi Tetova, Sherif efendi Prizreni, Hasan Hyseni nga Budakova, paria e Shkupit, paria e Prishtinës dhe paria e Jeni Pazarit.[69] Pohime të ndryshme të cilat theksojnë se pjesëmarrës në këtë Kuvend ka qenë edhe Hasan Prishtina,[70] në bazë të dokumentacionit që posedojmë, nuk kemi arritur t`i vërtetojmë. Megjithatë, vlen të theksohet se fjalën kryesore në këtë Kuvend e kishin Rexhep efendi Tetova dhe Sherif efendiu nga Prizreni, ndërsa më pas paria e Shkupit, Prishtinës, Vushtrrisë, Mitrovicës (në krye me Isa Boletinin), Pejës, Pazarit të Ri etj.[71]

---

[68] I. Dërmaku, "Kuvendi...", f. 97 - 98.

[69] AIHT, Vj-18-12-1273, Raport i konsullit austro - hungarez nga Mitrovica dërguar MPJ në Vjenë, 20 korrik 1908.

[70] AShSh & IH, *Historia e Popullit Shqiptar II...*, f. 376; B. Dugolli, *Drenica...*, f. 74. Ndërkaq, Ajet Haxhiu e Tahir Abdyli, autorë të monografive për Hasan Prishtinën, nuk përmendin se ai ishte pjesëmarrës në Kuvendin e Ferizajt, por siç thekson A. Haxhiu: "*Hasan Prishtina ishte njëri nga inisiatorët e kësaj lëvizje të armatosur*", ndërsa T. Abdyli shprehet se "*Hasan Prishtina... kontribuoi në përgatitjen e Revolucionit borgjez...*" të xhonturqve. Shih: Ajet Haxhiu, *Hasan Prishtina dhe lëvizja patriotike e Kosovës*, Tiranë: "Naim Frashëri", 1968, f. 19; Tahir Abdyli, *Hasan Prishtina në Lëvizjen Kombëtare e Demokratike Shqiptare 1908 - 1933*, Prishtinë: "Rilindja", 1990, f. 25.

[71] AIHT, Vj-18-12-1273, Raport i konsullit austro - hungarez nga Mitrovica, dërguar MPJ në Vjenë, 20 korrik 1908; Fatmira Musaj, *Isa Boletini (1864 - 1916)*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë (Instituti i Historisë), Tiranë, 1987, f. 52;Tahir Abdyli, "Tribuni popullor i bashkëjetesës (Me rastin e 70-vjetorit të vrasjes së Isa Boletinit)", *Kosova*, nr. 15, Instituti i Historisë - Prishtinë, Prishtinë, 1986, f. 13; Shaban Braha, *Idriz Seferi në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare*, Tiranë: "8 Nëntori", 1981, f. 71;Fehmi Rexhepi, "Kontributi i Idriz Seferit në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare", *Jeta dhe vepra e Idriz Seferit,* Instituti i Historisë - Prishtinë, Prishtinë, 2003, f. 43-44, dhe Adem Murati "Sali Kupina bashkëluftëtar i Idriz Seferit", *Jeta dhe vepra e Idriz Seferit,* Instituti i Historisë - Prishtinë, Prishtinë, 2003, f.83-86; Sabit A. Demiri - Qunaj, *Jeta dhe lufta çlirimtare e Idriz Seferit në LKSH (gjysma e dytë e shek. XIX dhe fillimi i shek. XX)*, Gjilan, 1997, f. 30; Sheremet Krasniqi, *Hasan Hysen Budakova*, Prishtinë: "Rilindja", 1997 f. 79; Ismet Dërmaku, *Shoqëria e Mësimit Shqip "Drita" e Bukureshtit në zgjimin dhe çlirimin kombëtar (1884 - 1914) sipas dokumenteve më të reja arkivore*, Prishtinë, 2009, f. 241.

Ndër temat kryesore që u diskutua fillimisht në Kuvendin e Ferizajt ishin ato mbi reformat dhe rrezikun e ndërhyrjes së jashtme, ku drejtpërdrejtë vlerësohej se ricopëtonte trojet shqiptare, gjë e cila diktoi nevojën e domosdoshme për organizimin e rezistencës së armatosur në arritjen e programit kombëtar, që sipas konsullit serb në Shkup, Ballukxhiq, në ditët e para të punimeve ishte trajtuar edhe çështja e autonomisë së Shqipërisë në kuadër të katër vilajeteve shqiptare të Kosovës, Manastirit, Shkodrës dhe Janinës.[72]

Lëvizja Xhonturke nisi të bënte orvatje konkrete të vinte nën kontroll Kuvendin e Ferizajt dhe të përdorte atë për realizimin e qëllimeve të veta. Ajo, përmes të dërguarve të saj të posaçëm, veproi gjatë gjithë punimeve të Kuvendit që masën e mbledhur aty ta kalonte në direktiva të saj. Kështu, pas dy ditë të punimeve të tij, më 7 korrik të vitit 1908, Galip Beu,[73] koloneli i xhandarmërisë së Vilajetit të Kosovës, njëherësh edhe anëtar i Komitetit "Bashkim e Përparim" në Shkup, arriti në Ferizaj.[74] Qëllimi i tij ishte që t'i bindte shqiptarët të përkrahnin programin për rishpalljen e kushtetutës. Ai dërgoi njerëz dhe telegrame nëpër qytete të Vilajetit të Kosovës për të masivizuar numrin e përfaqësuesve dhe demonstrimeve.[75] Ai përdori edhe autoritetin e udhëheqësve shqiptarë si Nexhip Draga dhe Bajram Curri, përmes të cilëve telegrafisht e ftonte më 8 korrik parinë e Gjakovës, të Mitrovicës dhe të Vushtrrisë që të vinin në Ferizaj me çetat e tyre, gjë e cila do të reflektohej në sensibilizimin e Kuvendit të Ferizajt.[76] Galip Beu kishte shkuar në Shkup së bashku me Nexhip Dragën dhe Bajram Currin për të bindur pjesëmarrësit e Kuvendit të Ferizajt që të deklaroheshin për kushtetutën.[77] Paraqitja e programit të Lëvizjes Xhonturke para masave drejtuese shqiptare ndikoi që nga kjo kohë idetë e Turqve të Rinj të depërtonin në gjitha viset e banuara me shqiptarë të Vilajetit të Kosovës, ndërsa marrja e pushtetit në duart e shqiptarëve po pasqyrohej në qarqet osmane, ku përfaqësues të

[72] R. Abdyli, *Lëvizja...*, f. 24.

[73] Me origjinë turke; Shih për këtë: G. Shpuza, *Në vazhdën...*, f. 155. Ndërsa Sylejman Kylçe thotë se ai ishte nga fshati Bishovë i Rozhajës prej një familje të përzier shqiptaro-boshnjake; Shih: Adem Murati, "Kuvendi i Ferizajt dhe Revolucioni Xhonturk më 1908", *Gjurmime Albanologjike* (Seria e shkencave historike)", nr. 26-1996, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1997, f. 103.

[74] AIHT, Vj-18-7-800, Telegram i konsullit austro - hungarez nga Prizreni, dërguar MPJ në Vjenë, 15 korrik 1908.

[75] S. Skendi, *Zgjimi...*, f. 312; R. Abdyli, *Lëvizja...*, f. 24; Z. Cana, *Lëvizja...*, f. 35.

[76] AIHT, Vj-18-11-1145, Raport i konsullit austro - hungarez nga Mitrovica, dërguar MPJ në Vjenë, 5 gusht 1908.

[77] G. Shpuza, *Në vazhdën..*, f. 158.

administratës detyroheshin të braktisnin punën e tyre, siç qe rasti i myhyrit (rojës së vulës shtetërore - sekretarit) të Ferizajt.[78] Kjo provohet edhe nga ana e konsullit italian në Shkup, Augusto Stanierit, i cili shprehej se "*...shqiptarët janë zot të tokës së tyre...*" dhe nuk lejojnë që njerëz që dëmtojnë interesin kombëtar të mos vihen në pozita drejtuese e administrative në vendin e tyre.[79]

Në fillim Porta e Lartë nuk mori ndonjë masë për qetësimin e situatës.80 Sulltan Abdyl Hamitit II ishte i vetëdijshëm se ushtria tashmë qe ndarë në dy pjesë dhe se situata në Perandori ishte mjaft e trazuar.[81] Përderisa nuk dërgoheshin forca të reja nga Anadolli, sekretaria e pallatit të sulltanit sugjeronte për mbështetje tek shqiptarët. Sipas politikës së pallatit të sulltanit, lëshimet që po u bëheshin krerëve bejlerë - çifligarë dhe bajraktarëve shqiptarë, gjoja do të ndikonin në mobilizimin e tyre për të mbrojtur autokracinë kundër kryengritësve.[82] Duke mos pasur sukses në këtë tendencë, Porta e Lartë e ndjeu rrezikun nga masa e kryengritësve të mbledhur në Ferizaj dhe vendosi të vepronte. Ajo e urdhëroi Shemsi Pashën,[83] një shqiptar i Tërgovishtës, që fillimisht kishte arritur në Prizren dhe më pas do të shkonte dhe shpërndante kryengritësit në Ferizaj, por nuk pati sukses. Më pas ai u nis drejt Manastirit për të ndëshkuar lëvizjen e reformave të Nijazi Beut dhe njësitit të tij.[84]

[78] AIHT, Vj-18-11-1138, Raport i konsullit austro - hungarez nga Mitrovica, dërguar MPJ në Vjenë, 7 korrik 1908.
[79] Shaban Hashani, "Isa Boletini dhe rezistenca shqiptare kundër pushtuesve turq në Ferizaj dhe rrethinë më 1908-1910", *Isa Boletini dhe koha e tij,* Instituti i Historisë - Prishtinë, Prishtinë, 1998, f. 65.
[80] S. Rizaj, "Roli...", f. 167.
[81] Sulltan Abdylhamiti, *Kujtimet e mia nga politika*, Shkup: "Logos", 2010, f. 114.
[82] G. Shpuza, *Në vazhdën...*, f. 147-148.
[83] Ka zëra që pohojnë se ai ishte me origjinë boshnjake; Shih për këtë: G. Shpuza, *Në vazhdën...*, f. 147.
[84] AIHT, Vj-18-11-1136, Raport i konsullit austro - hungarez nga Mitrovica, dërguar MPJ në Vjenë, 6 korrik 1908; Vj-18-7-791, 792, 795, Raporte dhe telegrame të konsullit austro - hungarez nga Prizreni, dërguar MPJ në Vjenë, 6, 7 dhe 11 korrik 1908.

Fitim RIFATI

SUMMARY

ALBANIANS DURING THE YOUNG TURKS MOVEMENT (from 1907 until mid-july 1908)

At the last quarter of the first decade of the 20th century, Albanians were facing national hardship as a consequence of the absolutist regime of Sultan Abdul Hamid II, as well as from the expansionist projects of neighboring Balkan countries alongside the clash of interests with the Great Powers. The Albanians were still unable to acquire the support they requested from the Great Powers, through which the Albanian national element within the Ottoman Empire would be reviewed, in which case this support would influence the formation of national rights on the path of acquiring the status of an autonomous or independent Albanian region. In these circumstances, even-though the Albanians were not particularly trusting of the Young Turks movement because of the Young Turks Congress in Paris in 1902, it was indeed this particular movement on the ranks of which the Albanians joined in hope of re-declaring the Empire's constitution. Through this, the Albanians hoped they would achieve autonomy of Albanian territories within the Ottoman Empire.

Therefore, having observed that the Albanian territories were being targeted for dissolution which they encountered at the railway projects of Austria-Hungary, Russia, Romania and Serbia, the Albanians used these reasons and other pretexts to organize an uprising. It is through this event that the Albanians acquired the support of the “Bashkim e Përparim” Committee, which formulated its objectives at the Assembly of Ferizaj which began its work on the 5th of July 1908.

Xheladin SHALA

DISA MOMENTE TË KRYENGRITJES SË VITIT 1912 DHE MARSHIMI PËR SHKUP - PUSHTIMI SERB I ASAJ ANE

Derisa popujt fqinjë të shqiptarëve, si: serbët, grekët, malazezët dhe bullgarët e fitonin autonominë dhe pavarësinë, duke u forcuar dhe stabilizuar si shtete në shekullin XIX, shqiptarëve nuk iu lejua as autonomia e synuar qysh në kohën e pashallëqeve shqiptare të Shkodrës dhe Janinës, e sidomos me kërkesat dhe përpjekjet e tyre këmbëngulëse pas formimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit më 1878.

Politika e moslëshimit pe ndaj të drejtave të ligjshme dhe elementare të popullit shqiptar, të garantuara me Kushtetutë e kishte burimin te shovinizmi xhonturk, te qëllimet osmanomëdha, me anë të të cilave synohej që Shqipëria të shndërrohej në një provincë të asimiluar islame, si pararojë e pjesës evropiane të Portës së Lartë. Krahas kësaj, qëndrimi ndaj çështjes shqiptare kishte edhe një prapavijë: regjimi xhonturk, sikurse paraardhësit e tyre nuk mund ta pranonin që edhe popujve me fe myslimane t'u njiheshin të drejtat sikur popujve të krishterë, të cilët më pas mund të kërkonin decentralizimin e Perandorisë Osmane dhe së fundi shkëputjen prej saj. Ata llogarisnin që me anë të shqiptarëve në aspektin strategjik të krijonin një bastion të Perandorisë kundër copëtimeve të mëtejme në pjesën ballkanike.[1] Duhet vënë në pah se ishte provuar pothuaj gjatë gjithë kohës së këtij regjimi xhonturk, nëpërkëmbja edhe e të drejtave më elementare kombëtare të shqiptarëve, siç ishte e drejta e shkollimit në gjuhën amtare dhe përdorimi i alfabetit kombëtar. Edhe në fushën e zhvillimit ekonomik, asgjë nuk u ndërmor. Nëse ndërtohej ndonjë rrugë, ajo bëhej për të vënë nën kontroll më lehtë trevat shqiptare.[2] Mirëpo, populli shqiptar, si zakonisht gjatë historisë, pra edhe gjatë Rilindjes Kombëtare në fund të

---

[1]Noel Malcolm*, Kosova një histori e shkurtër*, Prishtinë 1998, f.260.
[2]Arkivi i Institutit të Historisë, Tiranë, Vj-22-13-1355.

shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, për ta ngjallur edhe më shumë ndjenjën kombëtare dhe me qëllim që të mos identifikoheshin si turq osmanlinj, si dhe të mos mbesin nën mëshirën e fqinjëve shovinistë e grabitqarë, u organizuan politikisht, duke vepruar edhe ushtarakisht për t'u çliruar nga robëria otomane. Në anën tjetër, sidomos në fillim të shekullit XX, xhonturqit me të gjitha mjetet orvateshin dhe luftonin që kombin shqiptar ta identifikonin me osmanizmin.[3]

Gjithashtu, aksioni italian në Tripoli të Libisë tregoi qartë se parimi i integritetit territorial të Perandorisë Osmane nuk respektohej më. Për qetësinë e popujve të vegjël të Ballkanit mbetej për t'u dyshuar shumë. Andaj, për një të papritur të tillë, domethënë për copëtimin e Perandorisë Osmane, Shqipëria nuk ishte aspak e përgatitur. Ajo nuk ishte njohur ende as si provincë, as si komb.[4] Në vjeshtën e vitit 1911 po bëhej gjithnjë e më e qartë se lufta e Tripolit do të pasohej me siguri nga një përplasje tjetër e madhe - lufta ballkanike, e cila do të kishte si epilog fundin e Perandorisë Osmane, po edhe copëtimin e tokave shqiptare. Prandaj, Kryengritja e vitit 1911 në Malësinë e Mbishkodrës ishte paralojë e asaj të vitit 1912. Acarimi i gjendjes ekonomike dhe politike e bënte të pashmangshëm konfliktin e armatosur kundër qeverisë. Lufta e mëtejme politike - parlamentare ishte një blerje kohe. Të kota qenë përpjekjet e deputetëve shqiptarë të prirë nga Ismail Qemali dhe Hasan Prishtina për të kërkuar për të satën herë zbatimin e reformave gjithëpërfshirëse - politike, ekonomike dhe kulturore.[5] Prandaj, që nga koha e kryengritjeve shqiptare në Kosovë më 1909 - 1910, që ishin shtypur egërsisht nga ushtria otomane, urrejtja dhe kujtimi mbi djegiet, vrasjet dhe varrjet ndaj atdhetarëve të shquar shqiptarë nuk ishin harruar dhe ende ishin të freskëta. Kështu që, pakënaqësia e popullit në Kosovë dhe më gjerë kundër regjimit xhonturk kishte arritur kulmin e acarimit në fund të vitit 1911 dhe në fillim të vitit 1912. Andaj, kryengritja shqiptare në Kosovë kundër këtij regjimi të rryer ishte e pashmangshme.

[3] Hakif Bajrami, *Si e okupoi Serbia Kosovën më 1912*, Prishtinë, 2003, f.174.

[4] Ismail Qemali, Përmbledhje dokumentesh (1888 - 1919), përgatitur nga Teuta Hoxha, Tiranë, 2002, f. 185.

[5] *Kryengritja shqiptare e vitit 1912 në dokumentet serbe*, përgatitur nga Zekeria Cana, Prishtinë, 2008, f. 7.

Mbledhja e 12 janarit në Stamboll

Gjithashtu, atdhetari i shquar dhe ideologu i çështjes kombëtare, Hasan Prishtina, më 11 janar 1912 në Parlamentin osman para rreth 200 deputetëve deklaroi se nëse xhonturqit do të vazhdonin me politikën e tyre mizore, ai do të ishte i pari që do ta rrëmbente "flamurin e kryengritjes në Shqipëri". Pas asaj rrëmuje seanca parlamentare u ndërpre dhe deputetët shqiptarë u larguan përfundimisht nga Parlamenti osman. Hasan Prishtina në kujtimet e tij do të shprehej: "mbaroi nji ditë historike, që nuk patë lanë shteg pajtimi në mes të Shqypnisë e të Komitetit xhonturk".[6]

Në mbledhjen e mbajtur më 12 janar 1912 në lagjen Taksim të Stambollit, nën kryesinë e Ismail Qemalit, krahas Hasan Prishtinës morën pjesë edhe Myfit Libohova, Esat Toptani, Aziz Vrioni dhe Syrja Vlora. Para se të fillonte mbledhja, me propozimin e Hasan Prishtinës, pjesëmarrësit u betuan se do të ruanin sekretin e diskutimeve dhe të vendimeve që do të merreshin. Në mbledhje u mor vendimi historik që në pranverë të atij viti të fillonte Kryengritja e Përgjithshme Shqiptare antiosmane. Me propozimin e Hasan Prishtinës, zjarri i saj do të shpërthente në Kosovë dhe pastaj do të përhapej në të gjitha trevat tjera të Shqipërisë.[7]

Mbledhja e Taksimit rolin vendimtar në kryengritjen e përgjithshme për pavarësinë e Shqipërisë ia parapa Kosovës, ngase në këtë territor ideja për liri ishte mbjellur thellë në tokën e ujitur me gjak në luftën e gjatë njëshekullore. Në Kosovë dhe në territoret përreth, së paku nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit, nuk kishte shtëpi apo familje që nuk kishte përjetuar tmerrin e ushtrisë osmane. Nga territori i Kosovës ishte Hasan Prishtina, i cili me sakrificën, bamirësinë dhe trimërinë e vet i kishte vënë nën hijen e tij të gjithë deputetët shqiptarë dhe personalitetet tjera shqiptare të kohës së tij. Të besatuarit e Taksimit morën detyra të qarta. Hasan Prishtina, si flamurtar dhe udhëheqës do të vinte në fushëbetejë, në Kosovë, dhe do të përgatiste fillet e kryengritjes së përgjithshme. Ismail Qemali do të shkonte në Evropë dhe do të siguronte 15 000 pushkë dhe 10 000 napoleona. Esat Toptani do të organizonte kryengritjen në Vilajetin e Shkodrës, kurse Myfit Libohova, Aziz Vrioni dhe Syrja Vlora do ta organizonin Kryengritjen në Vilajetin e Manastirit dhe të Janinës. Hasan

[6] Hasan Prishtina, Nji ditë historike në parlamentin otoman; Lufta për çlirim kombëtar 1878 - 1912, Kujtime veteranësh, Tiranë 1962, f. 424.
[7] Ramiz Abdyli, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1911 - 1912*, Prishtinë, 2004, f. 152.

Prishtina, megjithatë nuk kishte shumë besim në bejlerët e jugut, kishte frikë se nuk do ta ndiqnin pas, andaj para se të ndaheshin e shpërndaheshin në terren edhe njëherë kërkoi fjalën e fundit të tyre: "Jam i bindun se të gjithë jeni të ndershëm, por po ju deklaroj edhe nji herë qi, ku të dalë le të dalë, unë kam për të kenë në mal kur ka me tingllue çasti i kryengritjes. Për këtë kam vu peng përpara fjalën teme të nderës. Ju lutem pra mos me më lanë vetëm, pse jeni betue edhe Ju".[8] Pra, për çdo ditë e më tepër shihej qartë se piqeshin kushtet për një kryengritje të përgjithshme shqiptare, e cila si hap të parë për pavarësi, do të siguronte bashkimin e katër Vilajeteve të banuara me shumicë shqiptare dhe të shpallnin autonominë e Shqipërisë. Në ballë të kësaj ideje, tani me kompetencë dhe pranim gjithëshqiptar, u vu Hasan Prishtina, politikan i dëshmuar në çështjen e mbrojtjes së kombit shqiptar.[9] Reagimi i Hasan Prishtinës në parlamentin osman kundër paudhësive otomane në Shqipëri, shtypi shqiptar i kohës i dha publicitet të madh, duke e quajtur Hasanin - Luani i Prishtinës.[10]

Kuvendi i Junikut

Pas shpërndarjes së Parlamentit osman në janar 1912, në pranverë u organizuan zgjedhje të reja në tërë Perandorinë. Këto zgjedhje u organizuan edhe në katër vilajetet shqiptare, ku u zhvillua një fushatë e ashpër në mes partisë "Bashkim e përparim" kundër kandidatëve opozitar. Në të vërtetë, skenari ishte i qartë dhe tendencioz për të siguruar me çdo kusht fitoren e partisë xhonturke, prandaj pushteti në fjalë përdori forma të ndryshme për të përçarë e mbjellë grindje midis opozitës në të gjitha trevat shqiptare.[11] Kështu, xhonturqit nuk lanë gurë pa lëvizur për të penguar zgjedhjen e atdhetarëve shqiptarë në parlament. Shpërdorimet e qeverisë xhonturke gjatë fushatës së zgjedhjeve, shtrëngesa policore dhe ushtarake pas votimeve, lëvizje të vazhdueshme të patrullave në fshatra dhe në qytete, e acaruan edhe më shumë situatën në vend dhe e mbushën kupën e durimit. Doli se dy ishin qëllimet e Komisionit qeveritar. Së pari, të ndërhynte kudo në fushatën elektorale për të siguruar fitoren e kandidatëve xhonturq, duke përdorur gjithfarë mënyrash e formash, ndërrimin arbitrar të vendvotimeve,

[8]Tahir Abdyli, *Hasan Prishtina*, Prishtinë, 1990, f. 101.
[9]*Po aty*, f. 57.
[10]Liria, 10-XII-1910, Selanik.
[11]Fitim Rifati, "Gjilani në Kryengritjen e Përgjithshme të vitit 1912", *Gjurmime albanologjike* - seria e shkencave historike, nr. 41-42, Prishtinë 2012, f. 144.

ryshfetet, kërcënimet e shantazhet e ndryshme, burgosjen e ithtarëve të opozitës, dhunën dhe forcën e armëve. Së dyti, shtimin e forcave të xhandarmërisë, ngritjen e burgjeve, hapjen e rrugëve të reja për lehtësimin e lëvizshmërisë së forcave ushtarake osmane.[12] Pra, përpjekjet e Komisionit të reformave për t'i sjellë në anën e tyre dhe për t'i qetësuar shqiptarët nuk e arritën objektivin e synuar si rrjedhojë e një politike të dështuar trevjeçare të xhonturqve ndaj çështjes shqiptare. Andaj, me përshpejtimin e zgjedhjeve, xhonturqit provuan se me politikën e tyre të osmanizimit dhe të centralizimit të Perandorisë, prej kohësh nuk kishin mbështetjen e popujve të nënshtruar. Gazeta "Shkupi" me të drejtë vinte re se në Pejë, Gjakovë, Prishtinë, Gjilan, Preshevë, Ferizaj, Mitrovicë etj., "nuk u zgjodhën deputetët se qeveria nuk e la miletin me i zgjedhë deputetët e vet".[13] Udhëheqësit shqiptarë, në krye me Hasan Prishtinën, ishin plotësisht të bindur se janë vitet kur vendosej për ardhmërinë e tyre; do të dalin prej godinës perandorake osmane që po pësonte dridhjet e fundit, ose do të mbeteshin të zënë nën të kur të shembej; do të jetë popull i lirë, në shtetin e vet të pavarur, apo do të jenë të copëtuar prej fqinjëve grabitqarë ballkanikë dhe të humbur njëherë e përgjithmonë nën emrat e tyre kombëtarë dhe shtetërorë.[14]

Prandaj, në muajt maj, qershor e korrik të vitit 1912, Kryengritja shqiptare në Kosovë mori përmasa të mëdha, vërtet përmasa të një revolucioni. Në të gjitha kuvendet e besëlidhjes u bë betimi për luftë në bazë të tekstit të betimit të hartuar prej Hasan Prishtinës: "Bajmë be e japim besen e burravet, se kemi me ba çfaredo flije e në kjoftë nevoja kemi me i ba kurban me duer t'ona robet e femit t'anë". Besëlidhja e përgjithshme duhej të bëhej në Kuvendin e Junikut më 21 - 25 maj, ku do të nënshkruhej betimi dhe vendimi për Kryengritje të Përgjithshme deri në fitore të plotë.[15] Pra, Kuvendi i Junikut zgjati 5 ditë. Në të morën pjesë 250 përfaqësues nga shumë treva të Vilajetit të Kosovës dhe territore tjera përreth saj. Më 25 maj përfaqësuesit e atij kuvendi deklaruan se e mbështesnin Kryengritjen e Përgjithshme. Ndonëse ishte paralajmëruar pjesëmarrja e Ismail Qemalit, ai për shkaqe të panjohura nuk mori pjesë dhe në vend të tij shkoi sekretari i tij personal, Salih

[12]Kryengritja shqiptare e vitit 1912 në dokumentet serbe, përgatitur nga Zekeria Cana, Prishtinë 2008, f. 10, 12.
[13]Ramiz Abdyli, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1911 - 1912*, Prishtinë, 2004, f. 180, 196.
[14] Rexhep Qosja, *Çështja shqiptare*, Prishtinë, 1994, f. 82.
[15] Tahir Abdyli, *Hasan Prishtina*, Prishtinë, 1990, f. 108.

Hoxha - Elbasani.[16] Duhet theksuar se krahu autonomist ia mori anën e parisë turkomane, ku e shpalosën programin politik të kryengritjes, i cili u miratua nga Kuvendi i Junikut dhe iu dorëzua qeverisë së Stambollit. Pos tjerash u kërkua: njohja e autonomisë së Shqipërisë, vendosja e administratës shqiptare, gjuha shqipe me alfabetin kombëtar të jetë gjuhë zyrtare, ngritja e flamurit shqiptar në gjithë vendin, emërimi i një stërnipi të familjeve princore shqiptare si guvernator i përgjithshëm dhe garanca e Fuqive të Mëdha për plotësimin e këtyre kërkesave. Para këtij kuvendi u shtrua detyra e drejtimit të kryengritjes së mëtejme dhe vënia në jetë e vendimeve të Kuvendit të Junikut. Hasan Prishtina lëshoi një shpallje në gjuhën turke dhe në gjuhë të tjera, drejtuar shqiptarëve liridashës dhe botës së qytetëruar, në të cilën theksonte se "pas përpjekjes së pafrytshme për sigurimin e të drejtave kombëtare me mjete ligjore, përmes zbatimit të kushtetutës, shqiptarëve nuk u mbeti rrugë tjetër veç asaj të rrëmbimit të armëve. Është momenti kur vendoset fati i Shqipërisë: vdekja ose liria e saj".[17]

Kuvendi i Junikut hartoi edhe planin e strategjisë luftarake për jetësimin e kërkesave të shtruara politike. Sipas këtij plani, do të ndërmerrej një sulm mbi Pejën dhe Gjakovën e pastaj do të shtiheshin në dorë dy pikat strategjike - Gryka e Carralevës dhe Gryka e Kaçanikut, që në këtë mënyrë të jetësohej autonomia e Shqipërisë.[18] Lidhur me rrjedhën dhe rezultatin e punimeve të Kuvendit të Junikut, shqiptarët e kazasë së Gjilanit, Preshevës, Kumanovës dhe Sanxhakut të Shkupit deklaroheshin telegrafisht se i pranonin paraprakisht të gjitha vendimet që do të dilnin nga punimet e këtij kuvendi.[19] Pakënaqësia e popullit të anës së Karadakut - përkatësisht anës së Gjilanit dhe Preshevës për ta qetësuar situatën ishin dërguar disa bateri artilerie nga Shkupi.[20] Gjithashtu, qeveria e Stambollit autorizoi valiun e Kosovës e të Manastirit, si dhe komandantët e Truparmatës së VI dhe VII të këtyre dy vilajeteve që të mund të vënin në veprim të gjitha mjetet e mundshme për të shuar kryengritjen.[21] Në anën tjetër përpjekjet për përgatitjen e kryengritjes në Shqipërinë e Mesme dhe të Jugut shkonin shumë ngadalë. Madje, kërkesat e Hasan Prishtinës që Ismail Qemali të ngutej për t'i përmbushur detyrat e pranuara në

[16]Ramiz Abdyli, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1911 - 1912*, Prishtinë, 2004, f. 238.
[17]Kryengritja shqiptare e vitit 1912 në dokumentet serbe, përgatitur nga Zekeria Cana, Prishtinë 2008, 17.
[18]Ramiz Abdyli, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1911 - 1912*, Prishtinë, 2004, f. 241.
[19]Fitim Rifati, "Gjilani në Kryengritjen e Përgjithshme të vitit 1912", *Gjurmime albanologjike* - seria e shkencave historike, nr. 41 - 42, Prishtinë, 2012, f. 151.
[20]*Po aty,* f. 155.
[21]Politika, 12-V-1912, Beograd.

mbledhjen e Taksimit, ky i përgjigjej "me sot e nesër e me premtime të thata".[22]

Përmasat e kryengritjes shqiptare në Kosovë

Në mesin e korrikut, në zonën e Kumanovës, të Preshevës, të Shkupit e të Tetovës vepronin disa çeta, si ajo e Çerkez Ali Beut, Haxhi Hysenit, Ejup e Halil Vaksincës, Hasan Kadriut nga Presheva, si dhe çeta e Aziz Rebelit nga Pollogu. Të gjithë drejtuesit e çetave të këtyre zonave ishin të lidhur me Ali Bej Topallin, drejtuesin kryesor të kryengritjes në kazanë e Shkupit.[23] Pra, shumë shqiptarë të kazasë së Preshevës, Shkupit dhe të Kumanovës iu bashkuan kryengritjes, të prirë nga drejtues të kryengritjes së atyre anëve si Ahmet Bej Kumanova, Hasan Kadri Presheva dhe Ahmet Efendi Topalli.[24] Duhet theksuar se në gjysmën e korrikut 1912 kryengritja e armatosur mori hov të madh në kazanë e Shkupit, të Kumanovës dhe të Preshevës. Në krye të tyre ishin drejtuesit e njohur si Sheh Strima, Dan Çarri dhe Hasan Kadriu.[25]

Pas sukseseve të jashtëzakonshme rreth gjysmës së korrikut, Hasan Prishtina i njoftoi deputetët shqiptarë në Stamboll me anë të telegrafit se ishte çliruar Prishtina, se në trevat e çliruara ishte vënë "pushteti shqiptar" dhe se së shpejti do të konstituohej parlamenti shqiptar, meqë "shqiptarët më nuk i besojnë Stambollit". Po ashtu, pas çlirimit të Gjakovës, Prizrenit dhe kuptohet të Prishtinës, të cilët ranë në duar të kryengritësve bëhej e ditur se edhe Tetova ishte në duar të kryengritësve, të prirë nga Mehmet Pashë Deralla.[26] Në një qarkore të shpallur në Prishtinë kërkohej nga qytetet tjera të Vilajetit të Kosovës që t'i dërgonin delegatët më të devotshëm në Prishtinë (më 18 korrik 1912). Andaj, më 24 korrik në Prishtinë kishin arritur delegatët nga Gjilani, Presheva, Ferizaj, Shkupi, Tetova etj. Ndërkohë më 24 korrik, u mbajt një kuvend i parisë së kazasë së Kumanovës dhe të Preshevës në fshatin Izvor, në Karadakun e Kumanovës, ku u arrit marrëveshja që të gjithë shqiptarët e këtyre anëve t'i bashkoheshin kryengritësve të anëve tjera përreth. Kjo bëri që të grumbulloheshin mbi 2 000 kryengritës të kazasë së Kumanovës dhe të Preshevës, ku u prit urdhri i drejtuesve të kryengritjes së kazasë së Gjilanit që të mësyhej Kumanova. Në

[22]Tahir Abdyli, *Hasan Prishtina*, Prishtinë, 1990, f. 105.
[23]Ramiz Abdyli, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1911-1912*, Prishtinë, 2004, f. 301.
[24]*Po aty*, f. 322.
[25] *Po aty*, f. 300.
[26]*Po aty*, f. 321.

ndërkohë, shqiptarët e Preshevës shtinë në dorë me forcë klubin e xhonturqve në këtë qytet.[27] Ndërkaq, në Gjilan dhe përreth tij ishin përqendruar rreth 4 000 kryengritës, që prisnin sinjalin të marshonin për Preshevë, Kumanovë e Shkup. Më 25 korrik 1912 kryengritësit e kazasë së Gjilanit depërtuan në fshatin Tërnoc të Luginës së Preshevës. Atyre iu bashkuan edhe xhandarët shqiptarë të Bujanocit. Ditën e nesërme, më 26 korrik kryengritësit e çliruan Bujanocin, ku i çarmatosën ushtarët, i dëbuan nëpunësit e administratës dhe formuan Këshillin, i cili kujdesej për rendin dhe qetësinë.[28] Kjo masë e kryengritësve planifikohej që të ndahej në dy grupe, ku njëri prej tyre do t'ia mësynte Shkupit përmes Preshevës, kurse grupi tjetër në krye me Idriz Seferin përmes Kaçanikut do t'i drejtohej Shkupit.[29]

Idriz Seferi, u ndesh me forcat osmane të dërguara nga Shkupi dhe Kumanova, të cilat i theu, gjë që i hapi rrugë dominimit të kryengritësve në tërë kazanë e Gjilanit. Pas kësaj fitorja, më 28 korrik 1912, ai hyri në Gjilan së bashku me mijëra kryengritës, të cilët u pritën nga populli në mënyrë madhështore. Çlirimi i Gjilanit do të ndikojë që autoritetet osmane në kryeqytetin e Vilajetit të Kosovës, në Shkup, t'i nxirrnin topat në llogore në pjesën veriperëndimore të Shkupit në drejtim të kazave të Gjilanit dhe të Preshevës, prej nga konsideronin se vinte rreziku më i madh.[30] Kështu, në fund të korrikut forcat kryengritëse ia dolën të çlironin pjesën veriore të Vilajetit të Kosovës deri në Grykë të Kaçanikut. Edhe në jug të kësaj pike strategjike, në trevat shqiptare të kazasë së Preshevës, Kumanovës, Shkupit në një anë, si dhe të kazasë së Tetovës e të Gostivarit në anën tjetër.[31] Pas këtyre sukseseve të kryengritësve, të cilët ishin bërë "zotër të vetëm të situatës" autoritetet osmane të vilajetit u alarmuan për një rrezik të madh për administratën e tyre. Kjo qe arsyeja që më 27 korrik valiu i Kosovës, Masar Beu, të detyrohej të jepte dorëheqje nga posti i tij. Në arsyetimin e tekstit të dorëheqjes shkruan se shqiptarët ishin zotër të situatës në tërë pjesën e Vilajetit në veriperëndim të Shkupit. "Unë po shoh - shkruan ai - se si po krijohet Shqipëria autonome, të cilën si otoman assesi nuk mund ta pranoj". Gjithashtu, deklaron se i gjithë Vilajeti i Kosovës me ndonjë përjashtim të vogël, është në duar të shqiptarëve, të cilët kanë vendosur pushtetin e tyre kudo, kanë çarmatosur garnizonet dhe kanë liruar të burgosurit. Andaj, pushteti im, sado i mbështetur në ligj, nuk

[27] *Po aty*,f. 323.
[28] *Po aty*, f. 327.
[29] Fitim Rifati, "Gjilani në Kryengritjen e Përgjithshme të vitit 1912", *Gjurmime albanologjike* - seria e shkencave historike, nr. 41-42, Prishtinë, 2012, f. 160.
[30] *Po aty*, f. 161.
[31] Ramiz Abdyli, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1911 - 1912*, Prishtinë, 2004, f. 336.

vlen më. Komisioni qeveritar që arrin nesër do të zhvillojë bisedime me ngadhënjimtarët, të cilët do t'i diktojnë kushte të rënda administrimit tonë.[32]

Fitoret e kryengritësve shqiptarë

Qeveria xhonturke nga fillimi i korrikut të vitit 1912 po tregohej e pafuqishme ta shtypte kryengritjen shqiptare, kështu që kah mesi i korrikut ra Kabineti i xhonturqve dhe u formua Qeveria e re osmane në krye me Qamil Pashën pak më të moderuar, i cili menjëherë telegrafisht lajmëroi se në Prishtinë do ta dërgonte një komision (mision) zyrtar në krye me Ibrahim Pashën, me qëllim të marrëveshjes me udhëheqësit e kryengritjes së Kosovës - përkatësisht në Shqipërinë Verilindore.

Nga pala shqiptare për bisedime në krye të delegacionit caktohet Hasan Prishtina, udhëheqësi kryesor i kryengritjes - gjegjësisht revolucionit të verës së vitit 1912. Hasan Prishtina kërkesat i përmblodhi në disa pika, por kryesoret ishin: a) të njihen zyrtarisht kufijtë e Shqipërisë, b) autoritetet civile e ushtarake të kenë kombësinë shqiptare, c) ushtria shqiptare të shërbejë në Shqipëri dhe të komandohej nga oficerët shqiptarë, ç) veprimet zyrtare në Shqipëri të bëhen në gjuhën shqipe.[33] Me çlirimin e Prishtinës, rreth mesit të korrikut 1912, pothuajse ra në dorë të kryengritësve tërë Vilajeti i Kosovës. Një pjesë e kryengritësve iu drejtua qytetit të Ferizajt. Kështu, i pari Bajram Curri u nis për në Ferizaj. Në këtë qytet u grumbulluan të gjitha fuqitë. Aty erdhën paria e Gjilanit; Idriz Seferi, Ramë Pozharani, Sali Aga, Tahir Agë Budriku, Bejtullah Begu; ashtu edhe paria e Preshevës, e Kumanovës, e Kaçanikut, e Lumës, e Gostivarit, e Tetovës dhe e Therandës. Ferizaj me fshatrat përreth deri te Gryka e Kaçanikut ishte mbushur me dhjetëra mijëra kryengritës. Në Ferizaj u bënë kërkesat për katër vilajetet: Kosovë, Shkodër, Manastir e Janinë. Kërkesat kishin karakter kombëtar. Qeveria osmane mbante çështjen e bisedimeve (kërkesave) zvarrë, për atë arsye u pa e domosdoshme të shkohej patjetër deri në kryeqytetin e Vilajetit të Kosovës, në Shkup, me çdo sakrificë. Për shkuarje në Shkup është folur qysh në Kuvendin e Junikut, por duke pasur parasysh grumbullimin e madh të ushtrisë osmane në atë qytet, si dhe për shkak të fortifikimeve ushtarake në Grykën e Kaçanikut nuk

[32] *Po aty*, f. 329; Kryengritja shqiptare e vitit 1912 në dokumentet serbe, përgatitur nga Zekeria Cana, Prishtinë 2008, 431-432.
[33] Hasan Prishtina, Dokumente, Tiranë 1983, 85.

ishte marrë vendimi më herët.[34] Duke parë që "14 pikat e Hasan Prishtinës" nuk kishin marrë akoma përgjigje, Idriz Seferi së bashku me Isa Boletinin hartuan planin e fshehtë për çlirimin e Shkupit, plan ky që parashihte depërtimin në Shkup jo përmes Grykës së Kaçanikut, ku ishte koncentruar një forcë e konsiderueshme ushtarake osmane, por përmes rrugëve të Karadakut të Gjilanit dhe Karadakut të Shkupit, Preshevës dhe Kumanovës. [35] Më 30 korrik, një grup kryengritësish me Bajram Currin në krye hynë në Preshevë, bllokuan rrugën Preshevë - Kumanovë dhe Kumanovë - Shkup, duke pritur urdhrin nga Prishtina për të marshuar drejt Kumanovës e Shkupit.[36] Pos rrethinës së Pejës, Prizrenit, Gjakovës, Prishtinës dhe Mitrovicës, rrugën për Shkup përgatitej edhe Gjilani, Presheva, Kumanova, Tetova, Gostivari dhe Dibra. [37] Gjithashtu nga Bujanoci vinte lajmi më 4 gusht se në Preshevë me porosinë e Idriz Seferit u tubuan 1 000 kryengritës shqiptarë. Atyre iu bë me dije se u thirrën për ta çliruar Shkupin.[38] Duhet theksuar se në këto dy qytete u shkarkuan dhe u dëbuan administratorët osmanë, duke u zëvendësuar me ata shqiptarë.

Duke parë organizimin e udhëheqësve të kryengritjes shqiptare, qeveritarët osman deklaronin: "Po e morën shqiptarët Shkupin - na iku Rumelia, Austria do ta pushtoj fill Sanxhakun e Pazarit të Ri, kurse Serbia, Mali i Zi dhe Bullgaria janë të gatshme të na sulmojnë".[39] Kryengritësit shqiptarë drejt kryeqytetit të Kosovës, Shkupit, nuk kishin të ndalur. Më 11 gusht Bajram Daklani me 320 të armatosur depërtoi në qytetin e Shkupit. Ndërkaq, një ditë më vonë arrijnë 60 vagona me shqiptarë nga Ferizaj për Shkup. Po ashtu, një pjesë e madhe e kryengritësve shqiptarë është nisur në këmbë nga Ferizaj për Shkup. Mendohej dhe propagandohej se në Shkup do të mbahej një tubim i madh për të vazhduar luftën deri në fitimin e autonomisë së Shqipërisë.[40] Për sa u tha më sipër, mund të konkludojmë se kryengritësit shqiptarë të Preshevës, Kumanovës, Shkupit dhe

[34] Tafil Boletini, *Kujtime*, Tiranë, 2003, f. 138 - 139.

[35]Fitim Rifati, "Gjilani në Kryengritjen e Përgjithshme të vitit 1912", *Gjurmime albanologjike* - seria e shkencave historike, nr. 41-42, Prishtinë, 2012, f. 160.

[35]*Po aty*, 163.

[36]Pravda, 31-VII-1912, Beograd.

[37]Kryengritja shqiptare e vitit 1912 në dokumentet serbe, përgatitur nga Zekeria Cana, Prishtinë 2008, 467.

[38]*Po aty*, f. 469.

[39]*Po aty*, f. 499.

[40]*Po aty*, f. 510.

rrethinave të tyre me drejtuesit e vet u dalluan me pjesëmarrje aktive gjatë tërë kohës së kryengritjes shqiptare të vitit 1912.
Pra, meqenëse përgjigjja ishte vonuar, kryengritësit në krye me Hasan Prishtinën iu drejtuan Shkupit dhe e morën më 12 gusht 1912. Rënia e Shkupit, kryeqytetit të Vilajetit të Kosovës, shënoi një fitore kapitale - shumë të rëndësishme të udhëheqësve të Kryengritjes së Madhe Shqiptare në Kosovë më 1912, gjë që ishte një goditje e rëndë për Stambollin,[41] për shovinistët sllavo - ortodoksë fqinjë dhe për Fuqitë e Mëdha evropiane, të cilat bluanin në mendjet e tyre interesat politike dhe strategjike për veten e tyre.

Deri më 16 gusht 1912 në kryeqytetin e Vilajetit të Kosovës në Shkup, u grumbulluan mbi 35 000 kryengritës shqiptarë, pa i llogaritur këtu edhe 2 000 pjesëmarrës të tjerë nga vet qyteti i Shkupit.42 Paralajmërimi se në Shkup do të mblidhej kuvendi gjithëshqiptar ishte bërë edhe një trysni shumë e fortë ndaj Portës së Lartë për t'i plotësuar kërkesat e kryengritësve. Në fund, u arrit marrëveshja sipas së cilës pranohen kërkesat e paraqitura. Më 17 gusht, Veziri i madh nisi për në Shkup telegramin e gjerësishëm, përmbajtja e të cilit do t'u komunikohej prijësve shqiptarë. Telegrami mbyllej me urdhëresën e qeverisë që kryengritësit ta zbrazin Shkupin brenda 40 orëve, përndryshe do të merren masa kundër tyre. Këtë vendim për largimin e shqiptarëve nga Shkupi, Ibrahim Pasha ua bëri të ditur edhe konsujve të huaj.[43] Udhëheqja e kryengritjes deklaroi se e pranonte marrëveshjen me qeverinë osmane dhe shpalli përfundimin e kryengritjes. Hasan Prishtina u bëri thirrje kryengritësve për t'u larguar nga Shkupi dhe për të shkuar në trevat e tyre. Më 19 gusht filloi zbrazja e qytetit.[44] Duhet theksuar se solidarizimet patriotike, përkrahja morale e mandatet që i jepeshin Hasan Prishtinës nuk ishin të mjaftueshme. Mungesa e përfaqësuesve të të gjitha vilajeteve në bisedimet shqiptaro - osmane e topiste tehun e luftës për t'i shkëputur Stambollit autonominë territoriale - administrative të Shqipërisë, e dobësoi pozitën e Hasan Prishtinës dhe përkrahësve të tij përballë krahut të moderuar - proosman dhe Komisionit qeveritar.[45]

---

[41] Hasan Prishtina, Dokumente, Tiranë 1983, 10, 84-85.

[42]Ramiz Abdyli, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1911 - 1912*, Prishtinë, 2004, f. 370.

[43]Kryengritja shqiptare e vitit 1912 në dokumentet serbe, përgatitur nga Zekeria Cana, Prishtinë 2008, 38.

[44]*Po aty*, f. 39.

[45]*Po aty*, f. 40.

Synimet e kryengritjes

Megjithatë, kryengritja shqiptare e vitit 1912 kishte thjesht karakter antiosman, më konkretisht ishte kundër qeverisë xhonturke. Ajo nuk ishte kundër popullit otoman e as kundër popujve të tjerë fqinjë, megjithëse ajo nuk mund të mos drejtohej kundër planeve aneksioniste të shteteve ballkanike të mbështetura nga Fuqitë e Mëdha evropiane, planet e të cilave synonin të zhduknin popullin tonë si komb dhe Shqipërinë nga harta e Ballkanit. Ky qëndrim i popullit shqiptar ishte plotësisht i ligjshëm. Andaj, lëvizjet dhe kryengritjet e mëdha të shqiptarëve, në vitet 1908 - 1912, shënojnë një faqe të re, më të lartë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Ato qenë rrjedhim i natyrshëm i acarimit të kontradiktave ekonomike, ideologjike, politike e kulturore midis shqiptarëve dhe pushtetarëve të rinj - xhonturq. Për vetë synimet, shkallën e organizimit dhe sidomos për forcën e tyre luftarake, këto kryengritje duhet të zënë një vend edhe më të rëndësishëm në historinë e popullit shqiptar.[46] Andaj, duhet theksuar faktin se në rrethana të tilla ballkanike dhe më gjerë, elitës së udhëheqjes më të shëndoshë të Kryengritjes së Madhe Shqiptare antiosmane në Kosovë më 1912 nuk i mungoi në përgjithësi largpamësia dhe aftësia politike për të ndjekur zhvillimet e situatës së brendshme e të jashtme dhe për të nuhatur e përcaktuar rrezikun kryesor.

Pastaj, duhet potencuar faktin se në Shkup vepronin shumë shoqata e klube. Ndër to shquhej për aktivitet klubi "Bashkimi", që veproi gjatë viteve 1908 - 1912, në krye të të cilit ishte Nexhip Draga, që u mundua me tërë fuqinë intelektuale dhe politike për bashkimin e të gjitha forcave në çdo aspekt, sidomos në Vilajetin e Kosovës, që në esencë luajti rolin e një partie politike. Anëtarë të Klubit ishin: Hasan Prishtina, Rexhep Mitrovica, Bajram Curri, Bedri Pejani, Rrokë Berisha, Halim Gostivari, Qerim Begolli, Sali Gjuka, Sali Tetova, Ymer Strazimiri etj. [47] Në të ardhmen padyshim duhet ndriçuar se të gjitha nismat kombëtare të asaj kohe dramatike e kishin Shkupin si epiqendër. Gjatë bisedimeve maratonike rreth një muaj ditë të Hasan Prishtinës me Ibrahim Pashën, nuk e panë të udhës t'i shkonin në ndihmë dhe ta shkelin tokën e Kosovës, por sorollateshin andej e këndej (në Greqi, Mal të Zi e gjetiu), duke mos i zbatuar vendimet e mbledhjes së Taksimit më 12 janar 1912 (Ismail

[46] Gazmend Shpuza, *Në prag të Pavarësisë*, New York, 1999, f. 67.

[47] Hakif Bajrami, *Si e okupoi Serbia Kosovën më 1912*, Prishtinë, 2003, f. 175.

Qemali, Myfit Libohova, Esat pashë Toptani, Aziz pashë Vrioni dhe Syrja bej Vlora) dhe shumë treva të tjera shqiptare shikonin si të habitura dhe pothuajse ishin të përgjumura.

Pra, programet, vendimet, kërkesat, veprimet luftarake kryesore të Kryengritjes së Madhe Shqiptare më 1912 e kanë brenda mendimin dhe aftësinë e Hasan Prishtinës. Ai u vu në ballë të Kryengritjes së Përgjithshme të vitit 1912, duke përfshirë tërë popullin shqiptar të Kosovës në të, e të vilajeteve të tjera shqiptare - Shkodrës, Manastirit e Janinës dhe zëri i tij u dëgjua në tërë Shqipërinë etnike, gjë që u njoh si udhëheqës i kryengritjes antiosmane në verë të vitit 1912.[48] Megjithatë, mungoi ndihma e drejtpërdrejtë dhe praktike e bashkëpunëtorëve e ideologëve tjerë, duke shkaktuar pasoja për të gjithë shqiptarët, veçmas për ata të Shqipërisë Verilindore.

Është shumë me vend mendimi i shkrimtarit më të afirmuar shqiptar, Ismail Kadare, kur shkruan edhe pas rreth nëntë dekadash: "Mos vëmendja për Kosovën është rrjedhojë, është pjesë e vetë shpërfilljes, me fjalë të tjera e vetëvrasjes së përgjithshme shqiptare. Është prishur diçka në themel dhe mu atje duhet të ndreqet. Po pikërisht ato, ndreqjet në themel, janë më të vështira".[49] Në të vërtetë, me luftën e UÇK-së 1998 - 1999 dhe sidomos më 17 shkurt 2008 ka filluar ajo ndreqje me arritjen e Shpalljes së Pavarësisë së trungut të Kosovës. Pas një presioni të madh nga tubimi i kryengritësve në Shkup, Perandoria Osmane më 18 gusht 1912 i pranoi 14 pikat, përveç kërkesës për t'u dhënë shqiptarëve armët e nevojshme dhe për ta hedhur në gjyq kabinetin xhonturk të Haki e Seit Pashës, duke deklaruar se kjo çështje e fundit ishte në kompetencën e Parlamentit Osman. Pra, udhëheqja e kryengritjes në Kosovë e përfundoi marrëveshjen e Prishtinës, në bazë të së cilës shqiptarët fitonin një varg të drejtash ekonomike, politike, administrative e kulturore. Kështu, më në fund, pas shumë vështirësish e shumë kërkesave që iu shtruan Ibrahim Pashës, u pranuan prej qeverisë së Qamil Pashës. Andaj, shprehej edhe mendimi se kush mundet t'i mohoj se këto privilegje nuk kanë qenë hapa të mëdha kah independenca e jonë.[50] Shkruhet e flitet edhe ky mendim se, pas ultimatumit të shqiptarëve për shpërndarjen e Parlamentit osman, Stambolli kishte shpërbërë parlamentin dhe më 5 gusht 1912 thuhet se në fondin e qeverisë së Qamil Pashës, si sekret ruhet

[48] Hasan Prishtina, Dokumente 1908-1934, Tiranë 1983, 9.

[49] Ismail Kadare, *Ra ky mort e u pamë*, Tiranë, 2000, f. 46.

[50] Ajet Haxhiu, *Hasan Prishtina dhe lëvizja patriotike e Kosovës*, Tiranë, 1964, f. 87,89-90.

dokumenti i pabotuar lidhur me Shqipërinë që të pranohet si e pavarur (gjë që në të ardhmen duhet hulumtuar dhe zbuluar se çfarë ka ndodhur në ato ditë dramatike), meqë prej 12 deri 14 gusht Shkupi, kryeqyteti i Vilajetit të Kosovës, ishte çliruar nga 35 000 kryengritës.

Mirëpo, thuhet se do të ndikojnë drejtpërdrejt diplomatët e Fuqive të Mëdha evropiane, duke ndërhyrë dhe kërcënuar udhëheqësit e kryengritësve: "Çfarë do rezultati të ketë lufta juaj, ndërrim të kufijve të Perandorisë Osmane në Evropë nuk ka". Andaj, Shtabi Shqiptar i Luftës për Liri, në përbërje Hasan Prishtina, Isa Boletini, Bajram Curri, Idriz Seferi, Riza Kryeziu, Zefi i Vogël, Bajram Daklani, Ahmet Delia etj., pas atij kërcënimi të fuqive evropiane, urdhërojnë demobilizimin, duke ua komunikuar lajmin kobzi, për çka do të ketë probleme çështja shqiptare deri në ditët e sotme.[51] Kështu, makinacionet e reja të disa fuqive evropiane dhe të bashkëpunëtorëve të tyre ballkanikë, provojnë edhe njëherë se xhonturqit nuk kuptonin asgjë dhe me të vërtetë asgjë nga problemet e zotërimeve të tyre evropiane dhe ishin bërë thjesht top loje në duart e armiqve të tyre. Njëherësh, ata provojnë se sa pa mend vepronin xhonturqit, duke iu kundërvënë verbërisht kërkesës së shqiptarëve për autonomi dhe bashkim të tokave të tyre. Pasoja më e rrezikshme e këtij qëndrimi do të shfaqej në fund të vitit 1912, kur shqiptarët jo vetëm që nuk iu kundërvunë, me vrullin heroik të kohës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, serbëve dhe grekëve, por shumica e tyre u bënë sehirxhinj të këtyre luftimeve. Ndërsa, këtë zhvillim xhonturqit ia mveshin deri vonë prirjes së lindur për "tradhti" të shqiptarëve dhe propagandës së huaj. Mirëpo, e vërteta është se xhonturqit, me miopinë e tyre, ia rrëmuan varrin vetes, duke iu bërë njëherësh gur në qafë edhe shqiptarëve, të cilët mendohet se e filluan me vonesë luftën e tyre çlirimtare. Por, arsyeja kryesore është se plogështia mendore otomane dhe përpjekjet e vonuara fëmijërore të xhonturqve për t'i bërë shqiptarët myslimanë "turq - osmanë të mirë", i futi të dy popujt në qorrsokakun e një moskuptimi tragjik, i cili i dërgoi në shprishje.[52]

[51]Hakif Bajrami, Vep. e cit., f. 64.

[52] Eqrem bej Vlora, *Kujtime 1985 - 1925*, Tiranë, 2003, f. 173 - 174.

Autonomia e Shqipërisë reale - shkak i Luftës së Parë Ballkanike

Thuhet se në prag të luftës ballkanike nga shkaku i rrezikut që parashihej qysh me çlirimin e Shkupit, u krijua një situatë jashtëzakonisht nervoze; populli u hutua, kush thumit e kush patkoit, nga të katër anët të rrethuar prej katër monarkive. Bëhej pyetja nëse e mundin Perandorinë Osmane, meqë ishim ende si pjesë e saj do të na copëtojnë midis tyre. Mirëpo, po të deklarohemi të ndarë prej saj pa kurrfarë përgatitjesh, na fshijnë më lehtë. Vërtet, lufta i shpallej Perandorisë Osmane, por, në fakt, grabiteshin tokat tona shqiptare e jo të Anadollit.[53] Pa dyshim, territori i Vilajetit të Kosovës, përkatësisht Shqipërisë Verilindore u bë arenë e rivaliteteve politike nga më të ashprat jo vetëm midis shteteve shoviniste ballkanike, por edhe midis fuqive të shteteve evropiane.[54] Në të vërtetë dihej se, Rusia ishte në krye të ekspansionizmit që kishte marrë hov pansllavizmi asokohe, meqë ajo ishte miku i armikut tonë, vetvetiu kuptohet se Rusia ishte armiku i shqiptarëve. Situata ishte jashtëzakonisht e vështirë për popullin tonë.

Gjithashtu, duhet vënë në pah se, në kohën e bisedimeve midis Hasan Prishtinës dhe Ibrahim Pashës, Qeveria e Serbisë, përkatësisht konsullata në Prishtinë dhe në Shkup bën çmos për t'i përçarë dhe për t'i korruptuar disa krerë të Kryengritjes Shqiptare të Kosovës. Mirëpo, diplomacinë serbe e mundonte pa masë fakti që kryengritësit shqiptarë të udhëhequr nga Hasan Prishtina kudo ku shkeli këmba e tyre kishin vënë rend e qetësi demokratike në Vilajetin e Kosovës, gjë që i habiste shovinistët serbomëdhenj, meqë paqja dhe rregulli ishin për çdo lëvdatë.[55] Pra, më 1912 luftën për liri në Ballkan e nisën shqiptarët, por shtetet ballkanike, të shqetësuara nga përmasat e Kryengritjes shqiptare në Shqipërinë Verilindore, shpejtuan të hidhen në valle, për t'i marrë ata trofetë.[56] Kështu, kërkesa e shqiptarëve për autonomi - pohonte kryeministri serb Pashiq, - e bën të pashmangshëm konfliktin me Perandorinë Osmane. Pra, lufta sa për sy e faqe që ata përgatisnin t'i shpallnin Perandorisë Osmane do të bëhej për copëtimin e tokave shqiptare dhe territoreve të tjera në Ballkan, të pushtuara nga Porta e Lartë. Vendin e sunduesve shekullorë otomanë donin ta zinin shkelës të rinj, një skllavëri e re dhe më e keqe. Shqipëria, deri atëherë e robëruar, por e

[53] Tafil Boletini, *Kujtime*, Tiranë, 2003, f. 141.
[54] Gazmend Shpuza, Vep. e cit., f. 8.
[55]Tahir Abdyli, *Hasan Prishtina*, Prishtinë, 1990, f. 127 - 12.8
[56] Uran Butka, *Gjeniu i Kombit*, Tiranë, 2000, f. 48.

pandarë, po rrezikohej seriozisht të mbetej përsëri e robëruar dhe veç kësaj edhe e copëtuar. S'do mend, kjo do ta rëndonte gjendjen, do ta vështirësonte perspektivën e luftës çlirimtare mbi bazën e përbashkët kombëtare. Tallazet e rrezikut të copëtimit dhe pushtimit të ri trokisnin në dyert e tokave të atdheut të shqiptarëve. Duket se edhe kësaj radhe rruga më e vështirë ishte rruga e drejtë.[57] Si rrjedhim, afrimi i Luftës së Parë Ballkanike krijoi për shqiptarët një situatë kontradiktore, tepër paradoksale. Nga njëra anë, po afrohej fundi i sundimit osman në Ballkan, aq i dëshiruar nga populli ynë, për të cilin ai kishte dhënë një kontribut kolosal, kurse nga ana tjetër këtij populli po i mbyllej rruga për t'u çliruar vetë, sepse po i përgatiteshin vargonj të rinj robërie, më të rëndë e shumë më të rrezikshëm.[58] Nëse në Kongresin e Berlinit vërtet u vonuan kur u formua Lidhja Shqiptare e Prizrenit, vetëm tri ditë para fillimit të Kongresit të Berlinit, a mund të themi këtë gjë edhe për lëvizjet dhe kryengritjet e vazhdueshme - pandërprerë gjatë katër viteve 1908 - 1912. Çfarë bënë Serbia dhe Mali i Zi kur edhe më 1876 e humbën luftën me Perandorinë Osmane, e ato e fitojnë dy vjet më vonë, madje pavarësinë. Dihet se në tavolinën e Kongresit të Berlinit ishte ulur dhe luante rol si gjithnjë Rusia. Pa dorëza themi se për Vilajetin e Kosovës me 32.900 km² - përkatësisht Shqipërinë Verilindore, askujt, ama asnjërit shtet aspak nuk i ka interesuar, edhe pse asnjë pjesë tjetër e territorit në Ballkan nuk ka bërë përpjekje dhe sakrifica si Kosova etnike dhe historike.

Në atë gjendje kritike për vendin (Shqipërinë), më 12 tetor 1912, Hasan Prishtina niset nga Shkupi për në veri të Prishtinës, në Merdar, ku mori drejtimin e frontit të luftës së popullit të Kosovës përballë sulmit të armatës serbe. Bajram Curri e Riza Kryeziu u nisën kah Plavë - Gucia përballë Malit të Zi, ndërsa Isa Boletini, Idriz Seferi, Hasan Ferri etj., u ndodhën në frontet e krahinave të tyre.[59] Krahas organizimit të qëndresës së popullit të Kosovës, me iniciativën e Hasan Prishtinës, Bajram Currit, Nexhip Dragës, Isa Boletinit, Sali Gjukës, Mitat Frashërit, Bedri Pejanit, Rexhep Mitrovicës e të tjerëve, u organizuan mbledhjet e rëndësishme politike të Shkupit, Pejës dhe rrethit të Gjakovës kah gjysma e muajit tetor të vitit 1912. Mbledhja e Shkupit (14 deri 16 tetor 1912) caktoi edhe një delegacion që do të shkonte në krahinat e tjera të vendit e të merrej vesh për ta shpëtuar Shqipërinë nga rreziku i

[57] Ajet Haxhiu, *Hasan Prishtina dhe lëvizja patriotike e Kosovës*, Tiranë, 1964, f. 85, 92.
[58] Gazmend Shpuza, *Në prag të Pavarësisë*, New York, 1999, f. 68.
[59] Ajet Haxhiu, *Hasan Prishtina dhe lëvizja patriotike e Kosovës*, Tiranë, 1964, f. 94.

copëtimit. Delegacioni kaloi nëpër Pejë e Gjakovë, ku mori autorizimin nga populli për ta përfaqësuar në veprimtarinë kundër copëtimit të Atdheut. Ai delegacion (Sali Gjuka, Bedri Pejani, Mitat Frashëri, Rexhep Mitrovica etj.) zbriti nga Shqipëria e Sipërme në Durrës, Fier dhe arriti në Vlorë. Pos delegatëve, nga Kosova kishin arritur në Vlorë edhe rreth 400 luftëtarë trima të drejtuar nga Isa Boletini.

Kështu, në kohën kur bëheshin përgatitjet për kurorëzim të fitores së luftës shekullore për çlirim kombëtar dhe formim të shtetit etnik shqiptar, Serbia, Mali i Zi, Greqia dhe Bullgaria, të përkrahura në mënyrë të gjithanshme nga Rusia, hynë në luftë me Perandorinë Osmane të dërrmuar, me qëllim të vetëm që t'i ngopnin synimet grabitqare ndaj tokave shqiptare.[60] Pra, derisa serbët, grekët, malazezët, rumunët dhe bullgarët arritën autonominë dhe më vonë pavarësinë, falë ndërhyrjes së drejtpërdrejtë të fuqive të huaja, populli shqiptar ia detyron ato vetëm fuqisë dhe gatishmërisë së tij për t'u therorizuar,[61] meqenëse interesi shqiptar ishte i papërfillshëm në pazaret historike që njiheshin nga Traktati i Shën Stefanit, Kongresi i Berlinit, Konferenca e Londrës etj. Andaj, populli shqiptar ishte i pambrojtur, në radhë të parë, nga vetë Perandoria Osmane, e cila vazhdimisht e trajtonte si mall për këmbim, e pastaj nga fuqitë tjera evropiane.[62] Pra, duhet pranuar se në fund të fundit gati gjithçka ishte në duar të Fuqive të Mëdha.

Të katër shtetet ballkanike nxituan ta fillonin luftën përpara se të kishte kohë të konsolidohej Shqipëria. Pra, Kryengritja e fuqishme shqiptare në Kosovë, që e filloi shkatërrimin e Perandorisë Osmane në pjesën evropiane dhe se nga frika e një Shqipërie autonome me katër vilajetet e veta e shkaktoi plasjen e Luftës së Parë Ballkanike.[63] Vërtet, ky ishte shkaku kryesor dhe i vetëm i fillimit të luftës ballkanike në fund të vitit 1912. Për shqiptarët, të cilët e kishin çliruar Atdheun prej osmanlinjve deri më 18 gusht 1912 me armët dhe forcat e veta, politika dhe diplomacia e fuqive evropiane pas kësaj nuk lejoi të pranohej rezultati i luftës dhe vënia e kufijve, gjë që po ajo diplomaci dyfytyrëshe, pas tre muajsh do të pranojë ndryshim kufijsh në dobi të sllavëve dhe grekëve ortodoksë të Ballkanit. Ç'është e vërteta, kryengritjet shqiptare nga viti 1909 e deri në verë të vitit 1912 (tri në Kosovë 1909 - 1910 - 1912 dhe një në Malësinë e Mbishkodrës 1911) e kishin shkatërruar

[60] Haki Kasumi, *Segmente të gërshetuara historike*, Prishtinë, 2011, f. 113.
[61] Eqrem bej Vlora, *Kujtime 1885 - 1925*, Tiranë, 2003, f. 381.
[62] Çështja Çame dhe integrimi evropian, Konferencë shkencore 2004, Tiranë 2005, 100
[63] Edith Durham, *Njëzet vjet ngatërresa ballkanike*, Tiranë, 2001, f. 239.

tërë sistemin okupues osman. Jo vetëm kaq, por më 18 gusht të vitit 1912 pushteti i Perandorisë Osmane e kishte pranuar "Pavarësinë e Shqipërisë", por ndërkohë thuhej se ishte vonë, sepse Aleanca Ballkanike kishte filluar t'i dërgojë forcat e veta në kufijtë e vendosur në Kongresin e Berlinit, kinse për ta sulmuar Perandorinë Osmane.[64] Duhet theksuar se veç naivët dhe kokëtrashët mund të mendojnë se mos lëvizjen në ato momente vendimtare të historisë edhe në trevat tjera të Shqipërisë nuk e kanë kuptuar dhe lexuar armiqtë shekullorë të popullit tonë, jovendosmërinë, jounitetin dhe pa bashkimin e disa liderëve sehirxhinj shqiptarë në pranverë e verë të vitit 1912.

Mu atëherë kur Perandoria Osmane u detyrua të premtojë njohjen e Autonomisë së Shqipërisë në të katër vilajetet të Shkodrës, Kosovës, Janinës dhe Manastirit, ku do të qeverisnin vendasit, u mendua se për Shqipërinë u hap rruga e shpresave të mëdha për popullin shqiptar. Mirëpo, papritmas në vjeshtë të vitit 1912 plasi Lufta e Parë Ballkanike, e cila vuri gjithçka në pikëpyetje. Dhe, viktima e parë e asaj lufte ballkanike ishte Shqipëria.[65] Më 8, 17 dhe 18 tetor të vitit 1912 të katër shtetet fqinje të shqiptarëve ia nisën luftës kundër Perandorisë Osmane - përkatësisht kundër popullit shqiptar. Të rralla janë veprimet shumë të poshtra e të pabesa që kanë ngjarë në historinë njerëzore, ashtu siç u ndodhi shqiptarëve në prag të fitimit të autonomisë së kryengritësve shqiptarë, e të cilët do të sulmohen furishëm nga të gjitha anët tokësore dhe nga deti prej katër shteteve fqinje grabitqare.

Së pari, Perandorisë Osmane i shpalli luftë Mali i Zi më 8 tetor, Serbia e Bullgaria i shpallën më 17 tetor, ndërsa Greqia më 18 tetor 1912. Ballkanin e përfshiu flaka e luftës. Ishte e qartë se shkaku kryesor i luftës ishte çështja shqiptare që pritej të zgjidhej asokohe. Zgjidhja e drejtë e kësaj çështjeje nuk i pëlqente asnjërit shtet shovinist përreth Shqipërisë etnike.

Të katër shtetet ballkanike luftën kundër Perandorisë Osmane e filluan nën motivin e "bashkimit kombëtar të papërfunduar". Në realitet, bashkimin kombëtar e kishin arritur dhe tejkaluar që të gjitha. Qëllimi i vërtetë i tyre, i Serbisë, Malit të Zi, Greqisë dhe Bullgarisë ishte realizimi i projekteve të hartuara kohë më parë për zgjerimin e tyre territorial si: programet shoviniste të Megali Idesë për Greqinë, të Naçertanies për Serbinë dhe projekti i Shën Stefanit për Bullgarinë. Objektivi kryesor ishin tokat shqiptare. Kjo kishte lidhje edhe me planet

[64] Hakif Bajrami, *Si e okupoi Serbia Kosovën më 1912*, Prishtinë, 2003, f. 65,179.

[65] Jacques Bourcart, *Shqipëria dhe shqiptarët*, Tiranë, 2004, f. 96.

e fuqive evropiane. Dy blloqet politiko - ushtarake ishin krijuar dhe lufta ndërmjet tyre ishte në prag. Ballkani ishte nyja që i ndante dhe i bashkonte. Ishte urgjente që të bëhej strukturimi i ri i Ballkanit në përputhje me nevojat ushtarake të luftës që po e përgatisnin. Pos synimeve tjera, Antanta nuk mund të pranonte një vazhdimësi të pandërprerë të Bllokut Qendror Gjermani - Austro - Hungari - Ballkan - Perandori Osmane. Duhej këputur lidhja para se të fillonte lufta e madhe. Prandaj, luftërat ballkanike janë quajtur edhe preludi i Luftës së Parë Botërore.[66]

Vërtet, të katër shtetet ballkanike e dëshironin dëbimin e sunduesve osmanë nga Ballkani, por, ama, ata synim kryesor kishin fillimisht copëtimin e Shqipërisë dhe përfundimisht zhdukjen e saj nga faqja e dheut. Kështu, në vjeshtë të vitit 1912, me fillimin e Luftës së Parë Ballkanike, ndodhi që Shqipëria, e cila e para ia nisi luftës për liri, çuditërisht u hap shtegu për invadimin e shteteve ballkanike në kurriz të saj. Pra, rol vendimtar në këtë tragjedi kombëtare shqiptare luajtën synimet ekspansioniste të pansllavizmit. Zaten, fati ynë kombëtar u bë shumë herë gjatë historisë objekt i padrejtësive, i aleancave ndjellakeqe, i komploteve dhe i intrigave, me ç'rast shkaktarët kryesorë të tragjedive tona ishin fqinjët përgjatë tërë pjesës tokësore të territoreve etnike shqiptare, në ballë të të cilëve si nxitëse dhe frymëzuese qëndronte si zakonisht Rusia.

Kështu, nga njëra anë, shqiptarët në verë të vitit 1912 dhe në fillim të asaj vjeshte ishin vërtet në kulm të fitores, por nga ana tjetër edhe në kulm të rrezikut. Ajo që u ndodhi shqiptarëve, me të vërtetë nuk ka të ngjarë në historinë e popujve: të arrish pothuajse ta shporrësh nga territoret etnike shqiptare pushtuesin pesëshekullor, ndërsa njëkohësisht prapa shpine të sulmohesh nga fqinjët, nga të katër anët, me një eufori e barbarizëm të pashembullt, ajo ishte diçka e paparë - edhe pse kryengritësit shqiptarë dhe ideologët e tyre kryesorë patën kujdes të madh në relacionet me të gjithë fqinjët, duke mos i provokuar asnjëherë me asgjë. Mirëpo, Hasan Prishtina me luftëtarët e vet më të besueshëm nga kryengritja e muajve maj-gusht 1912, në linjën e kufirit me Serbinë dhe Bullgarinë organizoi, në disa punkte, rezistencë të përgjakshme kundër depërtimit të ushtrive pushtuese ballkanike. Rezistenca shqiptare përgjatë kufirit nga veriu i Mitrovicës - Merdar - Bujanoc - Preshevë - Kumanovë gozhdoi shumë reparte të ushtrisë okupuese serbe e

[66] Bajram Xhafa, *Historia e Shqipërisë 1912 - 1939*, Shkodër, 2009, f. 13.

bullgare.[67] Pra, ajo është një dëshmi e pakontestueshme për një rezistencë heroike të shqiptarëve në kufirin e caktuar nga Kongresi i Berlinit.

Pushtimi i Shkupit me rrethinë nga serbët

Më 17 tetor 1912 Serbia i shpalli luftë Perandorisë Osmane, e cila kishte një forcë ushtarake të organizuar në tri armata dhe në disa reparte operative. Armata e parë prej 132 000 vetash komandohej nga princi trashëgimtar Aleksandër, duke u përqendruar në Luginën e Moravës Jugore dhe rrethin e Vrajës përball anës së Preshevës. Ndërsa, armata e tretë, kishte një forcë prej 76 000 ushtarësh dhe u pozicionua në rajonin e Toplicës, Merdarit dhe Medvegjës. Ushtria e Ibrit me një forcë ushtarake prej 25 000 vetash u përqendrua në rajonin e Rashkës. Ndërsa, në drejtim të Sanxhakut të Jeni Pazarit dhe Rrafshit të Dukagjinit, Serbia mobilizoi 113 000 forca ushtarake. Në fillim të luftës Serbia mobilizoi rreth 300 000 trupa dhe 550 armë artilerie. Pastaj numri u rrit edhe për rreth 100 000 trupa rezervë. Komandant i përgjithshëm ishte vetë mbreti Petar Karagjorgjeviq.

Ende pa u shpallur lufta zyrtarisht, konfliktet shqiptaro - serbe kishin filluar përgjatë kufirit të vendosur në Kongresin e Berlinit më 1878, sidomos kah Merdara përreth krahinës së Llapit, rreth Mitrovicës, Peshterit, Medvegjës, Dardanës, kah Bujanoci, Presheva, Vraja etj., ku u zhvilluan luftime me sulme e kundërsulme nga të dyja anët e kufirit shqiptaro - serb. Këtyre sulmeve e kundërsulmeve u kishin paraprirë një varg sulmesh të planifikuara, me qëllim që të zbulohen përqendrimet e mbrojtësve shqiptarë. Gjithashtu, në brendi të Kosovës në prapavijë ishin dërguar çetat kriminale serbe, të cilat, me anë të djegieve, vrasjeve dhe masakrave, ashtu siç dinë të veprojnë vetëm sllavët gjakpirës, filluan të mbjellin frikë, ta shqetësojnë popullin shqiptar me qëllim nxitjeje dhe ta shpallin si palë kundërshtare. Përqendrimi i këtyre forcave ishte paraparë për sulm të përgjithshëm kah mesi i muajit tetor 1912. Në drejtim të Mitrovicës ushtria e Ibrit; në drejtim të Podujevës dhe Prishtinës Armata e tretë; kurse në drejtim të Preshevës dhe kryeqytetit të Kosovës, Shkupit, Armata e parë; ndërkaq, Armata e dytë në drejtim të Luginës së Vardarit.[68]

---

[67]Tahir Abdyli*, Hasan Prishtina*, Prishtinë, 1990, f. 168.
[68] Hakif Bajrami, *Si e okupoi Serbia Kosovën më 1912*, Prishtinë, 2003, f. 66 - 67.

Mbreti serb, Petar Karagjorgjeviq, rreth gjysmës së tetorit 1912 kishte deklaruar në mënyrë demagogjike dhe gënjeshtare: "E ngrita ushtrinë në këmbë për t'i liruar vëllezërit tanë, për t'u dhuruar një mbrojtje më të mirë. Si serbët ashtu i duam edhe shqiptarët, të krishterë e myslimanë, sepse me ta populli ynë e ka ndarë gazin dhe helmin që trembëdhjetë shekuj e këtu. Ne ua sjellim atyre lirinë e plotë, vëllazërinë e barazinë".[69] Mirëpo, sulmet e pareshtura të ushtrisë serbe, duke dërguar pandërprerë forca të freskëta, kështu që në krahun e Armatës së parë, në luftime disaditëshe në zonat kufitare, Divizioni i thirrjes së parë të Moravës dhe ai i Danubit deri më 19 tetor 1912 i pushtuan këto vende kufitare: Sveti Ilija, Novosellë, Gjurgjec, Ushe, Leboc, Karpinë, Kozarnik dhe depërtuan kah Bujanoci. Depërtimi i këtyre dy divizioneve të Armatës së parë në atë drejtim pati 26 të vrarë dhe 113 të plagosur.[70]

Gjithashtu, armatat serbe depërtuan kah ana e Preshevës - përgjatë Luginës së saj rreth dhjetëditëshit të tretë të muajit tetor, duke djegur dhe shkatërruar çdo gjë para vetes. Depërtimi i rrufeshëm i përcjellë me artileri të rëndë serbe, ishte bërë sepse shqiptarëve u mungonte armatimi i rëndë, komanda unike dhe mungesa e municionit si dhe e ushqimit rezervë. Në fakt, kundër shqiptarëve komanda serbe kishte vendosur që të luftonte ekskluzivisht me armatim të rëndë artilerik, që shkaktonte djegie, rrënime të mëdha dhe frikë në popull.[71] Panorama vërtet ishte e lemerishme. Ushtima e topave dëgjohej nga të gjitha anët. Dëshpërimi i popullit nuk kishte kufi. Paniku e kishte përfshirë popullin nga barbaria e pushtuesve të rinj. Nëpër shi e borë nuk dinin nga t'ia mbanin. Në njërën anë ushtria vrastare serbe, në anën tjetër pushtuesit gjakpirës malazez. Populli u ndodh mes dy zjarresh pa shpresë shpëtimi. Dita bëhej natë nga tymi dhe nata ditë nga flakët e ngritura deri në qiell që digjeshin fshatrat shqiptare të Kosovës nga pushtuesit e egër serbo - malazez.[72] Gjatë muajve tetor e nëntor të vitit 1912 nga pushtuesit serbo-malazez u robërua i tërë Vilajeti i Kosovës, i Manastirit dhe një pjesë e madhe e Vilajetit të

[69] Përlindja e Shqipëniës, 27-IX-1913, Vlorë; Proklamata apo gënjeshtra serbe jepet më 14 tetor 1912; Millovan Sekuliq, Kosovo od 1912 do 1918 godine, (Doktoratë), Prishtinë 1980, 203; Zekeria Cana, Politika e qeverisë serbe ndaj Lëvizjes Kombëtare Shqiptare 1908-1912, Gjurmime albanologjike, seria e shkencave historike, nr.VI 1976, Prishtinë 1977, 111; Një është e vërtetë që mbi dhjetë shekuj sllavët i kanë sulmuar tokat e shqiptarëve, duke i grabitur territoret prej tyre- shkruan Rose Vilder Lane, Majat e Shalës, Tiranë 2004, 148.

[70] Aleksandar Stojiqeviq, *Istorija nashih ratova 1912 - 1918*, Beograd, 1932, f. 123.

[71] *Po aty*, f. 99 – 100.

[72] Skënder Luarasi, Isa Boletini, Tiranë 1971, 191-192; Dr.Xheladin Shala, Marrëdhëniet shqiptaro-serbe 1912-1918, Prishtinë 1989, 56-57

Shkodrës. Pushtim më të zi as që është parë e menduar ndonjëherë në këto hapësira gjeografike. Vetë pushtuesit ushtarakë serbo - malazez deklarojnë: "Kudo që shkel këmba jonë ua vëmë zjarrin shtëpive dhe ushqimit, plaçkitim mallin, bagëtinë dhe çfarë gjejmë",[73] duke u kërcënuar për të padëgjueshmit e rezistuesit se "do t'i qesim fare të gjithë shqiptarët; sllavë jemi dhe se kjo është tokë serbe", andaj nuk do ta lëmë gjallë as fëmijën në djep.[74] Duhet thënë troç: Mali i Zi dhe Serbia e filluan luftën ballkanike për ta robëruar dhe shfarosur popullin shqiptar, duke i shkaktuar pasoja të rënda dhe të pariparueshme popullit tonë liridashës. U shkelën të gjitha ato të mira që i bënë shqiptarët në kryengritjet e fundit që, duke e dërrmuar një ushtri të tërë iu mundësuan fqinjëve që me humbje sa më të pakta ta shporrin nga Ballkani pushtuesin pesëshekullor. Kështu, krahas sukseseve të Aleancës Ballkanike, u zhvillua njëkohësisht edhe tragjedia e paparë e Shqipërisë.

Pas shpërthimit të kufirit shqiptaro - serb, nga Sanxhaku i Jeni Pazarit, në veri të Mitrovicës, në Merdar, kah Medvegja, Bujanoci e Presheva, depërtimi i ushtrisë serbe nuk kishte të ndalur. Armata e parë serbe në fund të dhjetëditëshit të tretë të muajit tetor 1912 u ndesh me ushtrinë osmane në afërsi të Kumanovës. Kjo luftë në histori njihet si Beteja e Kumanovës. Mirëpo, duhet theksuar që para se të fillonte kjo betejë, luftëtarët shqiptarë bënë rezistencë edhe në atë krah, por reprezaljet nga gjuajtja e topave artilerikë i detyruan të tërhiqen.[75] Beteja e Kumanovës u zhvillua midis malit Koziak në lindje, Malit të Zi (Karadakut) të Shkupit në perëndim, midis lumenjve Pçinjë dhe Lumit të Madh në jug, si dhe në veri të fshatrave Llojan, Karabiqan, Nikulan dhe Strezovc.[76] Në Betejën e Kumanovës, e cila mendohet se ishte vendimtare për fatin e luftës së vitit 1912, armata serbe pati 21 oficerë dhe 702 ushtarë të vrarë.[77] Ndërsa, sipas shënimeve tjera armata serbe pati edhe 64 oficerë dhe 3 377 ushtarë të plagosur, si dhe 602 të vrarë. Pra, gjithsej 85 oficerë dhe 4 681 ushtarë serbë të vrarë e të plagosur. Kurse otomanët dhe shqiptarët kishin rreth 12 000 të vrarë e të plagosur dhe të zënë robër.[78] Ndërkaq, gazeta "Politika" e Beogradit e datës 1 nëntor 1912, menjëherë pas betejës i jep rreth 400 të vrarë dhe 1 800

[73] Zekeria Cana, Gjenocidi i Malit të Zi mbi popullin shqiptar 1912-1913 (Dokumente), Prishtinë 1997, 95

[74] Po aty, 101,108

[75] Arhiv Srbije (AS) MID-PO 1912, fasc.1, dos.V, br.1/13

[76] Aleksandar Stojiqeviq, Istorija nashih ratova 1912-1918, Beograd 1932, 143

[77] Po aty, 164

[78] Josip Horvat, Prvi Svijetski Rat, Zagreb 1967, 86

deri 2 000 të plagosur nga radhët e armatës serbe. Kurse, osmanët më tepër se 2 000 të vrarë dhe rreth 3 000 - 4 000 të plagosur. Ajo, vërtet, qe një ndër fitoret më të mëdha të ushtrisë pushtuese serbe.

Pas Betejës së Kumanovës, pjesa më e madhe e këtij qyteti ishte shkretuar, kurse shumë fshatra nga Ristovci deri në Shkup kishin mbetur të boshatisura nga frika e barbarisë serbe. Familjet e këtyre vendbanimeve shqiptare ishin shpërngulur në Shkup dhe ishin vendosur nëpër xhamia e vende të ndryshme publike. Ikja ishte tmerr - shkruante një udhëpërshkrues serb. Rreth 150 000 shqiptarë të ikur u përqendruan në Shkup, ku mbretëroi një kaos i vërtetë.[79] Pushtuesit serbë në luginën e Vardarit (armata I dhe II), pas pushtimit të Shkupit, më 30 tetor 1912, e vazhduan fushatën drejt jugut për ta pushtuar qendrën tjetër të Vilajetit shqiptar - Manastirin, pastaj Ohrin, Strugën, Dibrën etj. Armata e parë serbe iu drejtua Manastirit përpara se ta pushtonin grekët apo bullgarët. Më 31 tetor u pushtua Tetova, më 2 nëntor Gostivari dhe pas luftimeve të ashpra më 5 nëntor ra Kërçova. Manastiri u pushtua më 19 nëntor 1912. Andaj, forca e armëve të katër shteteve pushtuese ballkanike, të ndihmuara në mënyrë të organizuar e komplotiste nga Rusia, Franca dhe Anglia, i hodhi në plan të dytë kërkesat e ligjshme të shqiptarëve. Një hije e rëndë i pllakosi pothuajse të gjitha territoret e katër vilajeteve shqiptare gjatë muajve tetor - nëntor të vitit 1912, duke u pushtuar e masakruar pa mëshirë nga ushtritë e Aleancës Ballkanike. Pra, Lufta e Parë Ballkanike ishte de jure kundër Perandorisë Osmane, por de facto ishte luftë shfarosëse kundër kombit shqiptar.

Të përfundojmë se pozita jashtëzakonisht e volitshme gjeografike, si nyje lidhëse e territoreve të disa popujve, Shkupi me rrethinë, ishte dhe mbetet halë në sy për politikën ballkanike e më gjerë. Prandaj, qysh nga fundi i vitit 1912 fillon shpërngulja e shqiptarëve të asaj ane, gjë që për shkak të presioneve të ndryshme vazhdon edhe në ditët e sotme. Ndërkaq, shikuar historikisht e gjeografikisht është një lidhje tokësore mijëravjeçare në vazhdimësi e popullsisë shqiptare të Kosovës dhe të Maqedonisë së sotme Veri - Perëndimore.

[79] Srbija pred rat 1912, 261 (pa vend botimi, vetëm artikuj); Rat 1912, Beograd 1913, 29.

Xheladin SHALA

SUMMARY

A FEW HISTORICAL MOMENTS FROM THE 1912 UPRISING, THE MARCH TO SKOPJE AND THE SERBIAN INVASION OF THE REGION

After successive uprisings, the attempts made to implement the all-encompassing political, cultural and economical reformations by the Albanian members of the parliament headed by Ismail Qemali and Hasan Prishtina, resulted futile. In the meeting held on the 12th of January 1912 in the neighborhood Taksim of Istanbul organized by Ismail Qemali, where several prominent figures participated including Hasan Prishtina, Myfit Libohova, Esat Toptani, Aziz Vrioni and Syrja Vlora, it was decided that by the spring of that year another armed uprising was to be organized, which would become active in June or July of 1912.

The uprising was later dubbed the armed uprising of Kosova, which was one of the largest Albanian uprisings up until that point. Considering that 14 points of Hasan Prishtina remained unfulfilled, Hasan Prishtina and the revolutionaries headed towards Skopje from 12-14 August 1912, which they manage to take under control. The fall of Skopje marked an important victory for the leaders of the Great Albanian Uprising in Kosova in 1912. By 18 of August the Ottoman Empire was forced to promise the revolutionaries the recognition of Albania's autonomy including the four Albanian Vilayets, Shkodër, Kosovë, Janinë, and Manastir. It was agreed that these Vilayets would be administered by locals, which decision gave great hopes to Albanians. However, in an unexpected turn of events, the First Balkan War began in 1912 and put every development to a halt. The first victim of the war would be Albania.

Fejzulla SHABANI

TRAJTIMI I ÇËSHTJES SHQIPTARE NË KONFERENCËN E AMBASADORËVE NË LONDËR DHE PASOJAT GJEOPOLITIKE NË BALLKAN

Ndryshimet politiko - ushtarake që ndodhën në fillim të shekullit XX, e që erdhën si rezultat i Aleancës Ballkanike e më vonë edhe të luftërave ballkanike që kishin për qëllim shkatërrimin e Perandorisë Osmane, do sjellin një realitet të ri në Ballkan, për shkak se kjo situatë do t'i detyronte Fuqitë e Mëdha që edhe me tepër të jenë prezent në Ballkan për shkak të interesave të tyre dhe se në këto ndryshime gjeopolitike që do të ndodhin nuk do te ngelin jashtë edhe shqiptarët, pavarësisht që nuk do të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë si të gjithë popujt tjerë të Ballkanit, por për fat të keq në të shumtën e rasteve do të jenë pjesë e interesave të Fuqive të Mëdha në dëm të tyre dhe dobi të shteteve ballkanike në njërën anë dhe në anën tjetër çështja shqiptare do të jetë faktor kryesor për konfrontimet diplomatike dhe ndarje të interesave të tyre në Ballkan. E gjithë kjo situatë do të arrinte kulminacionin e vet me fillimin e punimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Londër në të cilën Fuqitë e Mëdha ishin të ndarë në dy grupe, në njërin grup ka qenë Austro - Hungaria, Gjermania dhe Italia, ndërsa në grupin tjetër Rusia, Franca dhe Anglia, të cilët do t'i gërshetonin interesat e tyre, ndërsa në prapavijë qëndronte edhe grupi i shteteve ballkanike që më tepër kishin për qëllim copëtimin e tokave shqiptare, ishin kundër Pavarësisë së Shqipërisë që ishte shpallur më 28 nëntor 1912 në Vlorë nga Ismail Qemali, në të cilën Kuvend ishte formuar edhe Qeveria e Përkohshme, e cila qeveri nuk pranohej jo vetëm nga shtetet ballkanike, por as edhe nga Fuqitë e Mëdha. Që në fillim të Luftës së Parë Ballkanike shqiptarët bënin përpjekje që mos përfshihen në "valën e lojërave diplomatike", por që në fillim u pa se cili është qëllimi i shteteve ballkanike, të cilët territoret shqiptare i llogaritnin si trofe lufte. Pasi Fuqitë e Mëdha nuk arritën që të pengojnë

luftën ballkanike, së paku për një kohë arritën që të pengojnë një konfrontim ndërmjet tyre që sillte te prishja e paqes në Evropë, për këtë qëllim filluan që të mendojnë për organizimin e një konference në Londër. Ky rrezik i hapi rrugë idesë së ministrit të Punëve të Jashtme të Francës, Puankare, që të përhapte idenë e një konference e cila ide në fillim u kundërshtua nga Vjena dhe Berlini, duke menduar se gjërat mund të zhvillohen në Ballkan në favorin e politikës së tyre, ndërsa Grey mendonte se me reformat e Stambollit mund të evitohej një katastrofë më e madhe në Ballkan.[1] Por, nga ana tjetër Franca dhe Rusia që më herët i kishin harmonizuar qëndrimet e veta për një Konferencë, për këtë qëllim Rusia kërkonte nga Grey që ai të merrte këtë iniciativë të thirrjes së Konferencës. Ndërsa, nga ana tjetër insistimin e Rusisë, Grey do ta komentonte në këtë mënyrë: "Nëse Rusia e bëri këtë propozim, besoj që e bëri për të fituar kredi si inicuese e zgjedhjes e cila e ruante paqen në Evropë dhe njëkohësisht u siguronte aleatëve ballkanik përfitime të reja të cilat mund të rrezikohen po qe se shpërthente lufta evropiane për portin serb".[2]

Është me rëndësi të potencohet se Anglia në fazën para mbajtjes së Konferencës ka qenë aktive, për këtë qëllim Grey që më 21 nëntor 1912 në takim me ambasadorin gjerman në Londër princin Lichnovsky, analizuan situatën në Ballkan si dhe hapat që duhet të ndërmerren, për këtë qëllim ai propozoi tri çështje themelore me të cilat duhet të mirën Fuqitë e Mëdha: Mundësia e krijimit të një shteti shqiptar autonom dhe kufijtë që duhet të ketë; Metodat dhe konditat e sigurimit të Serbisë në Adriatik; Çështja e ishujve të Egjeut.[3] Për këtë takim ai i informoi përfaqësuesit e Rusisë dhe Francës me të cilët ishte më afër për nga interesat e tyre në Ballkan. Duke parë situatën ushtarake që po zhvillohej në teren, Vjena dhe Berlini ranë dakord që të mbahet një konferencë, por jo në Paris siç propozonte Franca, por në Londër. Është me rëndësi të theksohet se mbajtja e kësaj konference nuk u mblodh pas përfundimit të luftës, por punimet i filloi gjatë luftës, si dhe të shpalljes së shtetit të pavarur të Shqipërisë, si një dukuri e re në ndryshimet gjeopolitike në Ballkan në prag të kësaj konference. Një karakteristikë e veçantë që do të jetë e disfavorshme për çështjen shqiptare në këtë konferencë qëndron në atë se palët e përfshira në konfliktin ballkanik

[1] Gazmend Rizaj, *Shqipëria e Sipërme 1800-1913*, Prishtinë, 2011, f. 335.
[2] *Po aty*.
[3] Frashër Demaj, *Britania e Madhe dhe çështja Shqiptare 1875-1913*, Instituti i Historisë - Prishtinë, Prishtinë, 2011, f. 258.

kishin të drejtë që të paraqesin qëndrimet e tyre, por jo të merrnin pjesë në vendimet, gjithashtu shtetet ballkanike ruajtën të drejtën që konferencës 'ti paraqesin kërkesat e tyre territoriale, ndërsa Shqipëria nuk e kishte këtë të drejtë[4], për shkak se ende nuk kishte fituar njohjen si shtet dhe subjekt i pavarur ndërkombëtar dhe nga kjo mund të konkludojmë se Shqipëria që në fillim do të jetë e hendikepuar në këtë drejtim, ndërsa shtetet ballkanike nuk do t'i fshihnin pretendimet territoriale ndaj shtetit dhe tokave shqiptare, në njërën anë dhe në anën tjetër Fuqitë e Mëdha trevat shqiptare i përdornin për interesat e veta, pavarësisht që Vjena e Roma por sidomos Vjena do të mbronte qëndrimin që në fillim të Konferencës për formimin e një shteti të pavarur shqiptar nën sovranitetin e Fuqive të Mëdha. Në këto rrethana të krijuara në prag të Konferencës së Londrës, gjithmonë shtrohet pyetja se çfarë qëndrimi diplomatike do të mbajë Qeveria e Vlorës e cila nuk pranohej nga Fuqitë e Mëdha dhe cilat do të jenë mundësitë e saj në mbrojtje të tërësisë territoriale të shtetit shqiptar. Duke ditur që ishte e pamundur që të kërkohej mbështetje nga Rusia e cila ishte kundër formimit të shtetit shqiptar, Francës që mbante anën ruse, dhe një qëndrimi neutral të Anglisë, vetëm Aleanca Tripalëshe në krye me Vjenën mund të ishte rruga ku mund të mbështetej Qeveria e Vlorës edhe pse nga ana e tyre nuk kishte një sinqeritet real mbi shtrirjen e kufijve të shtetit të ardhshëm shqiptar.

Pas shumë përgatitjeve dhe bisedimeve, më 17 dhjetor 191,2 filloi punimet Konferenca e Ambasadorëve në Londër, e cila Konferencë që në fillim të punimeve të veta do të ballafaqohet me çështjen shqiptare dhe në bazë të dokumenteve diplomatike të kohës del qartë se në këtë Konferencë çështja shqiptare është trajtuar në tri segmente: e ardhmja politike e Shqipërisë; caktimi i statusit të Shqipërisë dhe caktimi i kufijve të Shqipërisë.[5] Në lidhje me statusin e Shqipërisë u pajtuan që të formohet një Shqipëri autonome nën sovranitetin e Sulltanit dhe nën garancat e gjashtë Fuqive të Mëdha si dhe ishte neutral. Nga ana tjetër ky vendim kishte një rëndësi të veçantë se përfundimisht shuajti aspiratat e shteteve ballkanike që ishin kundër formimit të çfarëdo lloj të shtetit shqiptar, ndërsa nga ana tjetër shuajti shpresat që shqiptarët të jetojnë në një shtet ku do të shtrihet në të gjitha territoret e saj siç ishte marrë vendimi në Kuvendin e Vlorës. Edhe përkundër këtij vendimi, Ismail Qemali si një diplomat i shquar i drejtohet me një telegram

[4] *Po aty*, f. 257.
[5] Fejzulla Shabani, *Shqiptarët e Maqedonisë 1908-1913*, Tetovë, 1996, f. 186.

Greyit në të cilën theksohet: "Kam kënaqësinë Ekselenca e juaj tu shpreh admirimin më të thellë dhe falemenderimet më të sinqerta të Qeverisë së Përkohshme dhe të tërë popullit shqiptarë për vendimin e marë nën kryesimin tuaj të lartë në favor të Shqipërisë në Konferencën e Londrës… Shqiptarët veçanarisht kanë besim në Anglinë, vatër e qytetërimit dhe i mbrojtjes të të drejtave të popujve për realizimin e të drejtave kombëtare".[6] Në lidhje me të ardhmen politike, mund të potencohet se Konferenca e Londrës mori vendim për krijimin e një shteti shqiptar, por nuk e njohu kurrë qeverinë e dalur në Vlorë në krye me Ismail Qemalin, por më vonë do të përcaktojë një mbret të huaj. Ndërsa, për pikën e tretë dhe më të nxehtë në lidhje me caktimin e kufijve të shtetit të ardhshëm shqiptarë, këtu Fuqitë e Mëdha si në jug por edhe në veri e verilindje bënë padrejtësinë më të madhe në historinë e Ballkanit duke bërë copëtimin e tokave shqiptare në mes shteteve ballkanike, me çka më vonë në rrafshin gjeopolitik nuk do ta zgjidhte problemin, por se vetëm që e la problemin shqiptar të hapur në Ballkan. Me rëndësi të veçantë vlen të theksohet se pavarësisht këtyre gabimeve ndaj popullit shqiptar, përsëri Konferenca e Ambasadorëve në Londër është takim i lartë diplomatikë që u shtrua në tavolinë të bisedimeve edhe çështja shqiptare.

Edhe përkundër që në mes Vjenës dhe Romës që ishin aleatë por edhe rivale për tokat shqiptare përsëri në Konferencë kishin një qëndrim në lidhje me çështjen shqiptare që mbronin tezën për krijimin e një shteti shqiptar, por vetëm për interesat e tyre duke lënë me një lehtësi të madhe të diskutohet për shumë vendbanime shqiptare si në Kosovë por edhe në trevat lindore në Konferencë me të vetmin qëllim që mos cenohen interesat e tyre por edhe të kënaqin deri diku kërkesat e shteteve ballkanike që e bënin nëpërmjet Rusisë. Prandaj në bazë të kësaj mund të nxjerrim konkluzione edhe atë: 1. Moslejimi i daljes së Serbisë në bregdetin shqiptar; 2. Moslejimi që Shkodra t'i jepej Malit të Zi dhe Vlora Greqisë; 3. Sigurimin e vitalitetit të ekzistencës së shtetit shqiptar në lidhje me kufijtë aq sa ato mendonin".[7]

Siç potencuam edhe më lartë një nga çështjet që më tepër do të diskutohet në Konferencën e Londrës do të jetë ajo shqiptare e sidomos pika e tretë e cila kishte të bënte me caktimin e kufijve të shtetit të ardhshëm shqiptar me të cilën nuk mund të pajtoheshin shtetet ballkanike, prandaj që në fillim të punimit të Konferencës filluan edhe

[6] Gazmend Rizaj, vep. cit., f. 341.
[7] *Po aty*.

propozim projekt - hartat për atë se si duhet, ku duhet të shtrihen kufijtë e shtetit shqiptar dhe këto propozime vinin edhe nga Fuqitë e Mëdha, shtetet ballkanike por edhe nga Qeveria e Vlorës. Që në fillim të këtyre propozimeve mund të konstatojmë se në rrafshin diplomatik do të kemi një tensionim të marrëdhënieve austro - ruse, e cila mbronte interesat e shteteve ballkanike. Duke analizuar rrethanat politike -ushtarake dhe gjeopolitike në Ballkan në këtë periudhë, mund të nxjerrim disa konkluzione në lidhje me këto projekt - harta: 1. Shqipëria ka qenë nën sundimin pesë shekullor osman dhe njihet vetëm si nocion etnik; 2. Luftërat ballkanike dhe disfata e Perandorisë Osmane kishte lënë në gjysmë rruge çështjen e autonomisë së Shqipërisë; 3. Aleatët ballkanik pavarësisht se akoma nuk kishte përfunduar lufta, kishin pushtuar një pjesë të madhe të tokave shqiptare dhe katër aleatët ballkanik kishin në mbështetje të madhe ruso - frënge[8].

Është me rëndësi të potencohet se që në fillim të punimeve të Konferencës, Fuqitë e Mëdha ua bënë me dije shteteve ballkanike se janë për një shtet shqiptar të pavarur, ndërsa për kufijtë e saj do të diskutohet në Konferencë, me çka u shuan të gjitha apetitet e tyre për copëtimin e tokave shqiptare, e sidomos të Serbisë. Për këtë realitet të ri në Ballkan Nikolla Pashiqi e urdhëroi Bogiçeviqin nga Athina të njoftonte delegacionin serb se "Serbia nuk është për copëtimin e Shqipërisë, por që Serbia të ketë dalje patjetër në detin Adriatik dhe se Durrësi t'i takojë Serbisë".[9] Duke parë situatën që do të zhvillohet, Konferenca në lidhje me çështjen e trajtimit të kufirit të shtetit të ardhshëm me shtetet ballkanik, këto shtete vendosën që Konferencës së Ambasadorëve 'ti drejtohen me kërkesat e tyre edhe atë: Serbia kërkonte që kufiri lindor prej liqenit të Ohrit, përgjatë Drinit të Zi deri te Drini i Bardhë që nënkuptonte krahinat të banuara me shqiptarë në rrafshin e Dukagjinit, Kosovës si dhe pjesët lindore të ngelin jashtë shtetit shqiptar. Mali i Zi përveç që kërkonte Shkodrën por edhe territorin deri në lumin Mat ose të paktën deri te pika ku Drini derdhet në detin Adriatik.[10] Nga ana tjetër me rëndësi të madhe për trajtimin e çështjes shqiptare në këtë Konferencë do të kenë paraqitja e projekt - hartave të Fuqive të Mëdha e sidomos propozimi i Vjenës dhe Petersburgut se këto dy fuqi i gërshetonin interesat e tyre në Ballkan dhe

[8] *Po aty*, f. 350.
[9] Dokumenti o Spolnoj Politici Kralevine Srbie 1904 - 1913, Letër e Pashiqit dërguar përfaqësuesit serb Bogiçeviçit në Athinë më 24 nëntor - 7 dhjetor 1912.
[10] HHStA-PAA- Telegram i Mensdorf-it nga Londra më 4 janar 1913, Dok. 5190.

nuk kishin një trajtim të përafërt rreth çështjes shqiptare, si dhe kufijve të ardhshëm të shtetit të ri shqiptar. Që në fillim të paraqitjes së projekt - hartës, Mensdorfi paraqiti pikëpamjet austo - hungareze në lidhje me kufijtë e ardhshëm të shtetit të ri shqiptar. Sipas tij, ato pjesë që janë të banuara vetëm nga shqiptarët duhet t'i përkisnin Shqipërisë[11]. Pas disa konsultimeve që bëri ky me Vjenën rreth detajeve në lidhje me kufijtë e shtetit shqiptar, për shkak se në propozimin e parë disa vendbanime shqiptare nuk ishin përfshirë në shtetin shqiptar më 20 nëntor 1912, ky paraqiti projektin përfundimtar të kufijve të shtetit shqiptar me shtetet ballkanike. Sipas këtij projekti, në veri vija kufitare me Malin e Zi shkonte përgjatë lumit Buna, mandej qytetet Plava e Gucia, ku vazhdonte në Pejë, Gjakovë, Prizren që i takonin shtetit shqiptar. Nga Prizreni deri në territorin e Liqenit të Ohrit dhe Prespës të gjitha vendbanimet do t'i takonin shtetit shqiptarë.[12]

Ky propozim i Vjenës në fakt paraqiste realitetin etnik dhe historik të shtetit të ardhshëm shqiptar, si dhe një trajtim më të drejtë të çështjes shqiptare në këtë Konferencë. Por, që në fillim ky propozim u kundërshtua nga Franca e sidomos nga Rusia, ku Ambasadori rus Bekendorfi potencoi: "kjo çështje nuk mund të zgjidhet duke parë vetëm nga pikëpamja etnike sado e bazuar të jetë por duke marrë në konsideratë edhe interesat e ndryshme, përfshirë edhe ato të shteteve kufitare".[13] Përballë parimit etnik, ky vuri nevojën për kompromis për të arritur në një marrëveshje të kënaqshme që të merë parasysh pikërisht këto interesa të ndryshme.[14] Nga ana tjetër Rusia nuk vonoi që Konferencës t'i paraqes një kundër propozim që ishte në kundërshtim me interesat shqiptare dhe një trajtim jo parimor nga ana e Rusisë. Sipas propozimit të tyre, kufiri duhej të ishte lumi Drin deri në derdhjen e tij në det, ndërsa në lindje aty ku bashkohen Drini i Bardhë dhe i Zi, çka nënkuptonte se territori nga Liqeni i Ohrit deri në Prizren të ngelnin jashtë Shqipërisë.[15] Pikëpamjet e Vjenës u kundërshtuan nga Sazanovi për të cilën qytetet Prizreni, Gjakova, Peja dhe Dibra nuk do të

[11] HHStA-PAA- Propozimi i Mensedorf-it, ambasador austro - hungarez në Angli më 2 dhjetor 1912, Dok. nr.2.
[12] HHStA-PAA, Raport i Mensdorf-it, dt. 18 dhjetor, Dok. nr. 4957.
[13] *Po aty*.
[14] HHStA-PAA- Raport i Mensdorf-it, dt. 21 dhjetor, 1912, Dok. 5012.
[15] Fejzulla Shabani, vep. cit., f. 190.

diskutohet se këto do t'i takonin Serbisë për shkak se ishin vise jetësore për Serbinë.[16]

Kontradiktat në mes Vjenës dhe Rusisë për trajtimin e çështjes shqiptare në lidhje me kufijtë e ardhshëm të shtetit shqiptar u acaruan edhe me tepër e kjo vërehet edhe nga takimi i Bekendorfit me ambasadorin gjerman Lihnovskin, ku përfaqësuesi rus potencoi se "ne nuk jemi dakord me propozimin e Vjenës dhe nëse vazhdon kështu Vjena, mund të vijë deri te ndërprerja e punimeve të Konferencës që mund të sillte deri te ashpërsimi më i madh si dhe të shpërthejë lufta në mes Rusisë dhe Austro - Hungarisë".[17] Duke parë situatën që mund të merë kahje të padëshirueshme për Fuqitë e Mëdha, përfaqësuesi i Gjermanisë ofroi një propozim ku Dibra dhe Gjakova t'i mbeteshin Shqipërisë[18], me të cilën nuk u pajtua Rusia e cila propozoi që Shkodra t'i takojë Shqipërisë, ndërsa Dibra dhe Gjakova Serbisë se janë vendbanime shumë jetike për Serbinë.

Nga kjo mund të shohim se sa ka qenë prezente çështja shqiptare në këtë Konferencë, por në të njëjtën kohë mund të vërejmë se sa në mënyrë jo parimore është trajtuar çështja shqiptare, nga shkaku se territoret e saja etnike ishin si në treg për t'i kënaqur kërkesat e shteteve ballkanike të cilët e bënin me ndihmën e Rusisë, ndërsa në fillim Vjena do të jetë me këmbëngulëse në mbrojtje të projektit të vet, por me vonë gjoja se në interes të çështjeve më të mëdha do të pranonte copëtimin e tokave shqiptare, sipas dëshirës dhe kërkesës së shteteve ballkanike. Duke parë situatën që po zhvillohej në Konferencën e Londrës dhe si po trajtohej çështja shqiptare nga ana e Fuqive të Mëdha në njërën anë dhe në anën tjetër kërkesat e shteteve ballkanike, më 2 janar të vitit 1913, Qeveria e Përkohshme e Vlorës vendosi që Konferencës t'i paraqes një memorandum në lidhje me çështjen e kufijve të shtetit shqiptar, duke u bazuar në argumentet faktike, por edhe në zhvillimin e perspektivës të marrëdhënieve me shtete ballkanike. Në këtë memorandum në mes tjerave theksohet: "Sot që zgjedhja përfundimtare e problemit ballkanik, patjetër dhe pa vonesë, populli shqiptar nuk do të mund të duronte që të drejtat e tij të sakrifikoheshin pjesërisht dhe që e ardhmja e pavarësisë së tij të mbështetet në themelet e paqëndrueshmërisë… Duke vazhduar

[16] HHStA-PAA- Raport i Ambasadorit Turim nga Petrogradi drejtuar Berhtoldit, më 4 janar 1913.
[17] Arbe *Puto, Pavarësia Shqiptare dhe Diplomacia e Fuqive të Mëdha 1912-1914*, Tiranë, 1978, f. 199.
[18] *Po aty*.

se "Ballkani i popujve ballkanik" është vështirë që të mendohet për një ndarje që nuk i takon realitetit historik. Nuk mund të përfytyrojmë paqen e plotë të Gadishullit deri kur kufijtë për çdo etnitet politik të mos frymëzohen nga kufijtë gjeografik dhe demografik të çdo shteti. Duke ngritur zërin në emër të popullit shqiptar, Qeveria e Përkohshme e përfaqëson popullin, prandaj kemi besim të madh në Fuqitë e Mëdha, që në mënyrë të drejtë të trajtojë çështjen tonë si për të gjithë popujt tjerë të Ballkanit dhe se me një trajtim të barabartë do të sjellë paqe dhe stabilitet në këtë rajon, prandaj kërkojmë që për vendin dhe shtetin tonë kufijtë të mos ndryshojnë dhe të mos jenë objekt i trajtimit jo të barabartë në Konferencë".[19]

Fillimi i vitit 1913 në Koherencën e Londrës nuk solli asgjë të re, por edhe më tepër po ashpërsoheshin kontradiktat në mes Serbisë e ndihmuar nga Rusia dhe të Vjenës, për këtë qëllim muaji janar është muaji në të cilën Grey do të tentonte që të zvarrisë thirrjet e mbledhjeve me të vetmin qëllim që të tentohet që të arrihet një harmonizim i qëndrimeve të palëve kontradiktore, prandaj qëndrimi i diplomacisë Angleze në këtë fazë do të jetë sa më qetësues dhe se kjo kontradiktë mos ketë pasoja më të mëdha në mes Fuqive të Mëdha që mund të sillte deri te një konflikt ushtarak. Nga ana tjetër Serbia kërkonte mbështetje në kërkesat e veta edhe te Anglia, prandaj më 9 janar 1913 Pashiqi nëpërmjet përfaqësuesit të vet në Londër, Gruiqi i dërgoi një letër, ku thuhet se Serbia patjetër duhet të ketë dalje në "bregdetin serb", në pyetjen që ja bën Grey Gruiqit se çka nënkuptoni me fjalën "bregdeti serb", ky arsyetohet se në mesjetë ka qenë i serbëve.[20] Grey i përgjigjet se edhe bregdeti verior i Francës i ka takuar Anglisë por përsëri ai nuk quhet anglez. Në përfundim të bisedimeve Gruiqi kërkoi një mbështetje më të madhe të Londrës për kërkesat serbe, ndërsa nga ana e tij Grey e siguroi që këtë mbështetje do ta ketë deri në atë masë që të gjitha palët ballkanike do të jenë të kënaqura por jo të gjitha kërkesat serbe për çështje e kufijve të shtetit të ardhshëm shqiptar.[21] Pas këtij takimi, më 21 janar 1913 qeveria serbe dërgoi edhe një memorandum të Konferencës nëpërmjet Gruiqit në lidhje me Shqipërinë. Së pari Pashiqi e udhëzonte Gruiqin që t'i bindë Fuqitë e Mëdha se ky memorandum

[19] Qeveria e Përkohshme e Vlorës 1912 - 1914, Tiranë, 1963, Dok. nr. 135, 2 janarë1913, f. 98-100.
[20] Dokumenti o spolnoj politici… Raport i Gruiqit nga Londra dërguar Pashiqit më 9 janar 1913.
[21] *Po aty*.

është edhe në emër të shteteve ballkanike. Në lidhje me çështjen e shtetit të ardhshëm shqiptarë dhe kufijtë e saj, Serbia tentonte të bindë Konferencën për prezencën etnike të serbëve në tokat shqiptare dhe se qeveria serbe nuk është dakord të tërhiqet nga tokat shqiptare të pushtuara gjatë Luftës Ballkanike duke përfshirë qytetet Prizreni, Gjakova, Peja, Dibra dhe territorin e Liqenit të Ohrit.[22] Më tej Pashiqi theksonte: "në interes të paqes në Evropë, kufiri në mes Shqipërisë dhe Serbisë duhet të jetë ai që është paraqitur në memorandum, në qoftë se nuk do të plotësohet kërkesa jonë, Qeveria serbe do të zgjedhë rrugë tjera për të realizuar qëllimet e veta".[23] Sipas tij, shteti i ardhshëm shqiptar duhet të përfshijë një territor të ngushtë për shkak se vetëm në këtë mënyrë mund të ekzistonte dhe se mund të mbrohet edhe nga shtetet ballkanike.[24]

Tentimet për kërcënim nga ana e Serbisë për të fituar më shumë në Konferencë shihen edhe nga takimi i Mihajloviçit në Romë me ministrin italian San Xhuliano ku në mes tjerave Mihajlloviçi thekson: "Në qoftë se Italia dhe Austro - Hungaria kanë vendosur të formohet shtet i ri shqiptar, duhet ta kenë të qartë se pa plotësimin e kërkesave dhe interesave të Qeverisë serbe nuk do të ketë paqe në këta kufij.[25] Pasi kontradiktat në Konferencë rreth trajtimit të çështjes shqiptare në lidhje me kufijtë e ardhshëm të shtetit shqiptar edhe me tepër po ashpërsoheshin, ambasadori anglez në Vjenë Kertrajt, shprehu mendimin që me anë të gjyqit të Hagës të zgjidhet çështja për kufijtë e Shqipërisë duke u bazuar më parë në një vijë maksimale dhe minimale.[26] Gjithashtu edhe Qeveria e Vlorës më 25 janar 1913, Konferencës i dërgoi një shtojcë të memorandumit të mëparshëm, në të cilën njoftonte për të dhëna statistikore nga jugu deri në veri, përbërjen e popullsisë për të bindur Fuqitë e Mëdha se kërkesat e shteteve ballkanike nuk kishin të bënin me realitetin e tyre të kërkesave, por për

[22] Dokumenti o splonoj politici… Telegram i Novakoviçit dërguar Pashiqit nga Londra 26 dhjetor 1912.
[23] Fejzulla Shabani, vep.cit., f. 195.
[24] Dokumenti o spolnoj poltici … letër e Pashiqit dërguar Qeverisë Ruse në Petrograd 27 dhjetor 1912, f. 622.
[25] Dokumenti o spolnoj politici… Letër e Mihajlloviçit nga Roma dërguar Pashiqit më 13 janar 1913, f. 734-744.
[26] Dokumenti o sponoj politici… Letër e Jovanoviçit nga Vjena drejtuar Pashiqit më 15 janar 1913.

fat të keq të shqiptarëve, edhe ky memorandum nuk u mor parasysh nga ana e Fuqive të Mëdha, të cilët kishin qëllimet e veta.[27]

Dallimet e mëdha në mes Austro - Hungarisë dhe Rusisë vazhduan edhe gjatë muajit shkurt dhe deri në fund të marsit të vitit 1913, e që këto mosmarrëveshje ishin në dëm të trajtimit të çështjes shqiptare nga shkaku se sipas Mensdorfit që e siguronte Berhtoldin, qëllimi i vërtetë i rusëve është që të marinë diçka me emër që e vërtetonte edhe Grey dhe për herë të parë theksohet se ndoshta edhe në (Vjenë) duhet të lëshojmë pe për Gjakovën dhe Dibrën.[28] Në një telegram tjetër të 13 shkurtit që e dërgonte Mensdorfi, Ministrisë së tij, ai gati-gati jepte alarmin se po që se Vjena nuk do të lëshonte pe, marrëdhëniet austro - ruse do të hynin në një gjendje shumë të tensionuar sa që një luftë midis tyre brenda një kohe shumë të shkurtë ishte e pashmangshme.[29] Edhe përkundër këtyre kontradiktave Grey më 6 shkurt të vitit 1913 thirri mbledhjen e radhës së Konferencës me të cilët i njoftoi për propozimin e Berlinit që ishte dakorduar Vjena e që e përkrahte edhe Londra, por edhe ky propozim u kundërshtua nga Rusia që nënkuptonte se trajtimi dhe diskutimi për çështjen shqiptare vazhdoi që të ketë kundërshtime të mëdha dhe për fat të keq të gjitha këto shkonin në dëm të interesave shqiptare, për shkak se nuk kishin aleatë të vërtetë në radhët e Fuqive të Mëdha.

Në këtë periudhë shumë delikate që po kalonte Konferenca, nuk mungoi aktiviteti diplomatik i shteteve ballkanike, e sidomos i Serbisë, ku Pashiqi i udhëzonte përfaqësuesit e vetë që të bëjnë të gjitha përpjekjet që Rusia të ketë më tepër aleatë në Konferencë, ndërsa nga ana tjetër nuk mungoi edhe aktiviteti i diplomacisë ruse sidomos i Sazanovit, duke potencuar se Serbia dhe Rusia bënë lëshime për Shkodrën, prandaj kërkojnë nga Vjena që të bëjnë lëshime për Dibrën dhe Gjakovën dhe nga kjo mund të shihet se çështja shqiptare është trajtuar në Konferencë, por pa pëlqimin dhe mendimin e shqiptarëve. Nga ana tjetër Vjena kishte deklaruar se ende nuk e ka thënë fjalën e fundit në lidhje me kufirin verilindor të shtetit shqiptar, paralajmëronte thellimin e mëtejshëm të mosmarrëveshjeve me pasoja për marrëdhëniet ndërkombëtare. Për këtë qëllim ambasadori anglezë në Petrograd ua

[27] AQSH, Kryesia e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës. Veprimtaria diplomatike, Dok. 19.
[28] HHStA-PAA. Raport i Mensdorf-it dt. 15 shkurt 1913, Dok. 5814.
[29] Arben Puto, vep. cit., f. 199.

tërhoqi vërejtjen qarqeve militare ruse për rrezikun nga lufta evropiane.[30]

Në fillim të marsit të vitit 1913 mosmarrëveshjet në mes Rusisë dhe Austro - Hungarisë për çështjen e kufirit verilindor kishte arritur kulminacionin, me çka Konferenca e Ambasadorëve ndodhej para ndërprerjes së punimeve të veta me çka po trokiste dhe trondiste paqen evropiane. Austro - Hungaria filloi përgatitjet ushtarake, të njëjtën gjë po e bënte edhe Rusia.[31] Për të tejkaluar këtë situatë shumë delikate diplomatike por edhe ushtarake mendohej që të formohet një komision i veçantë që do të merret me çështjen e kufirit të Serbisë me shtetin shqiptar. Sazanovi theksonte, "në qoftë se vjen deri te formimi i një komisioni për çështjen e kufirit verilindor duhet të luftohet që ky komision të mos merr parasysh të dhënat etnografike të këtyre viseve sepse atëherë do të jetë në disfavor për ne, por duhet të insistohet që si element të merret çështja gjeografike".[32]

Në lidhje me trajtimin jo të drejtë të çështjes shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër do të kemi prononcime të njohësve të mirë të çështjes shqiptare dhe ballkanike, si dhe shkrimet e ndryshme në gazetat evropiane. Kështu, Miss Durahm për Rusinë cariste dhe pretendimet e saja në Ballkan theksonte: "ata (shqiptarët) e dinin fare mirë se derisa në një vend ndodhen dhjetë serbë bashkë, Rusia bën be që gjithë krahinat janë sllave".[33] Ndërsa nga ana tjetër, njohësi i mirë i rrethanave ballkanike Alfred Rappaporti theksonte: "Argumentet kundërshtare që nuk kishin kurfarë mbështetje, paraqesnin edhe këtë herë gënjeshtra dhe intriga faqe botës. Është një gjë krejt e pakuptimtë se si guxohej me u mohua Shqipërisë viset e domosdoshme për jetesë dhe në këtë mënyrë me u vue në rrezik paqja e përbotshme, vetëm pse në Gjakovë gjindej një manastir ortodoks, ndërsa në rrethin e Dibrës disa katunde serbe që i kishin mbetur Serbisë".[34] Ndërsa, shtypi i kohës ka qenë i ndarë në këtë drejtim, kështu gazeta "Pravda" shkruante: "Serbia i pranoi vendimet e Fuqive të Mëdha pasi i realizoi qëllimet e veta dhe nuk ka treguar më asgjë nëse është e pakënaqur dhe

[30] Dokumenti o spolnoj poltici… Telegram i Popoviçit për në Beograd më 20 shkurt 1913.
[31] Liria e Shqipërisë, 8.III. 1913, Sofje.
[32] Dokumenti o spolnoj politici… Letër e Popoviçit nga Petrogradi dërguar Pashiqit më 19 mars 1913.
[33] Fejzulla Shabani, vep. cit., f. 205.
[34] Alfrerd Rappaporti, *Rrjedhat e punëve në Shqipëri*, Tiranë, 1928, f. 41.

nuk ka bërë protestë".[35] Ndërsa "Radniçke Novine" në artikullin me titullin "Shqiptarët e mjerë" theksonte: "Fati i keq i këtij populli, një pjesë të madhe të territorit më herët e kishte marrë Greqia, tani edhe më shumë po grabitet nga Serbia dhe Mali i Zi. Pjesa e mbetur nën autonominë e Shqipërisë i lihet kontrollit financiar ndërkombëtar dhe kontrollit ushtarak nga Fuqitë e Mëdha dhe kjo bëhej për një popull vital, të shëndoshë në Ballkani si që janë shqiptarët dhe gjithë kjo bëhej në emër të civilizimit".[36]

Fundi i muajit mars shënon një kthesë negative nga ana e Austro - Hungarisë në Konferencë nga shkaku se edhe atë pak shpresë që kishin shqiptarët, do ta humbasin kur Vjena pikërisht më 20 mars informon Greyn se tërhiqet nga qëndrimi që Gjakova dhe Dibra t'i takojnë Shqipërisë, vetëm për një arritje të një kompromisi. Kjo tërheqje e Vjenës tregon qartë se çështja shqiptare nuk është trajtuar në drejtim të barabartë dhe të drejtë në Konferencën e Ambasadorëve dhe se pas 22 marsit që do të jetë vendimi përfundimtar në lidhje me kufijtë e shtetit të ardhshëm shqiptar, Konferenca deri në përfundim të punimeve të veta në korrik, nuk do të merret me çështjen shqiptare, por do të caktojë komisione për caktimin e vijave kufitare me shtetet ballkanike, ndërsa në Shqipëri do të sillte Princ Vidin që nënkupton se nuk e pranoi Qeverinë e Ismail Qemalit e dalur nga Kuvendi i Vlorës. Kështu siç theksuam më lartë, Vjena njoftoi se tërhiqet nga kërkesa për Gjakovën, ndërsa kërkoi që të jepeshin garancë dhe liri kulturore minoritetit shqiptar në shtetet ballkanike, ky propozim nuk u miratua pasi Rusia ishte kundër. Kështu pas shumë diskutimeve dhe tensioneve në mes Rusisë dhe Austro - Hungarisë për çështjen e shtetit shqiptar, por për fat të keq kurrë më nuk i kërkuan Serbisë më kushte që shqiptarët nën Serbinë të jenë nën mbikëqyrjen e Fuqive të Mëdha sepse qeveria serbe potenconte se kjo është përzierje në punët e brendshme të Serbisë.[37] Me këtë lë të kuptohet se me territoret shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve u bë tregtia më e madhe e territoreve në dëm të popullit shqiptar dhe në dobi të Serbisë. Kur Rappaporti e pyeti Berhtoldin për kufijtë ai iu përgjigj: " Të gjitha këto që i thekson janë të drejta, por a mund t'i mbrojmë ne, pasi këto janë shkak lufte".[38] Me këtë lë të

[35] Pravda 14. III. 1913.
[36] Radnicke Novine, 14 V.1913, Beograd.
[37] Dokumenti o spolnoj politici… Telegram i Vesniqit nga Parisi dërguar Pashiqit më 24 mars 1913.
[38] Alfred Rappaporti, vep.cit., f. 43.

kuptohet se Vjena ka bërë maksimumin e vet për të mbrojtur tokat shqiptare, por kurrë nuk ka tentuar që të konsultohet me Qeverinë e Vlorës, ndërsa për çështjen e luftës, shqiptarët do të ishin në gjendje të luftojnë me të gjitha mjetet për të mbrojtur tokat e tyre. Lufta diplomatike në Konferencën e Londrës siç potencuam më lartë, përfundoi më 22 mars të vitit 1913, për shkak se në mbledhjen e thirrur nga Grey, informoi përfaqësuesit tjerë se Viena ka rënë dakord që të tërhiqet nga kërkesat e tyre, ndërsa kjo ishte edhe një fitore e madhe për Serbinë dhe Rusinë në Ballkan, ndërsa një padrejtësi e madhe që iu bë popullit shqiptar në fillim të shekullit të kaluar ose më mirë të theksojmë se shqiptarët humbën gjysmën e territoreve të veta pa mos qenë aspak fajtor, si dhe pa mos qenë aktor në vendimmarrje që lirisht mund të thuhet se është një precedent i madh në aspektin e marrëdhënieve ndërkombëtare, si dhe do të ketë pasoja të mëtejshme për Ballkanin për shkak se shqiptarët kurrë nuk do të kënaqen me këtë padrejtësi kombëtare që e përjetuan në Konferencën e Ambasadorëve në Londër.

Vendimet e padrejta të Konferencës së Ambasadorëve për trajtimin jo të barabartë dhe jo të drejtë, i indinjoi shqiptarët në tërësi si në vend ashtu edhe në diasporë. Nga ana tjetër në këtë situatë shumë delikate për kombin shqiptar nuk mungoi edhe tentimi diplomatik i Qeverisë së Vlorës, e cila vendosi që të caktojë një komision në krye me Ismail Qemalin, për të vizituar qendrat më të rëndësishme evropiane, për të shprehur kundërshtimin nga vendimet e Londrës, si dhe për t'i informuar se shqiptarët kurrë nuk do të pajtohen me këto vendime dhe se lufta e tyre për të drejta nacionale tani po fillonte, por jo në dëm të popujve ballkanik, por për të krijuar një realitet të ri të situatës gjeopolitike në Ballkan. Gjatë muajve prill - maj Ismail Qemali së bashku me Isa Boletinin, Luigj Gurakuqin do të vizitojnë Romën, Vjenën, Parisin dhe Londrën me shpresë se do të gjenin mbështetje dhe të përmirësohet gabimi që ka qenë në dobi të serbëve dhe grekëve.[39] Që në takimin e parë që patën në Romë me San Xhulianon u pa qartë se shumë vështirë delegacioni shqiptar do të has në mirëkuptim në kërkesat e veta, nga shkaku se u fitua përshtypja se këto fuqi që kishin vendosur në dëm të popullit shqiptar shumë të vështirë e kishin që edhe një herë të trajtojnë çështjen shqiptare. Edhe në takimin që e patën në Vjenë me Berhtoldin u pritën shumë ftohtë, edhe pse këtu mendonin se do të

[39] Thoma Murzaku, *Politika e Serbisë kundrejt Shqipërisë gjatë Luftës Ballkanike, 1912-1913*, Tiranë, 1987, f. 307.

gjejnë mbështetjen më të madhe, por me rëndësi është të theksohet se edhe përkundër padrejtësive në Konferencë, Vjena përsëri nuk lejoi që plotësisht të copëtohen tokat shqiptare, dhe se mbrojti deri në fund idenë e krijimin të një shteti shqiptar në Ballkan. Në takim me delegacionin shqiptar ky do të shprehet: "shpresat për të shpëtuar integritetin territorial të Shqipërisë ishin të pakta, me gjithë përpjekjet që kishte bërë dhe po bënte diplomacia Vjeneze".[40] E njëjta situatë ishte edhe në takimet që i patën në Londër dhe Paris nga ku edhe nuk pritej ndonjë mbështetje më e madhe, sidomos nga Parisi, për shkak se tërë kohën në Konferencë gjithmonë ka mbështetur qëndrimin rus dhe të shteteve ballkanike, ndërsa Anglia ka tentuar që të jetë neutrale, por animi ka qenë nga ana e shteteve ballkanike. Qëndrimin e delegacionit shqiptar në Evropë e ka përcjellur edhe diplomacia serbe, e kjo vërehet edhe nga raporti i Jovanoviçit nga Vjena dërguar Beogradit ku thekson: "Delegacioni shqiptar është shumë i zhgënjyer nga këto takime e sidomos nga takimet në Romë dhe Vjenë".[41]

Në bazë të kësaj që u theksua më lartë mund të nxjerrim konkluzion për periudhën në të cilën është zhvilluar Konferenca e Ambasadorëve në Londër si dhe ndryshimet gjeopolitike që kanë ndodhur në Ballkan në një distancë kohore një shekullore, për fat të mirë për shqiptarët edhe në fillimin e këtij shekulli shqiptarët paraqesin faktor relevant në Ballkan, duke mos dëmtuar popujt tjerë të Ballkanit, por duke krijuar një realitet të ri gjeopolitik në Ballkan dhe me gjerë. Pavarësisht zhvillimeve evolutive pozitive që ndodhën në fillim të këtij shekulli, përsëri në bazë të dokumenteve mund të nxjerrim këto konkluzione për trajtimin e çështjes shqiptare në Konferencën e Londrës: 1. Qeveria shqiptare që në fillim nuk ka qenë e përfshirë në lojërat diplomatike që po zhvilloheshin për Ballkanin dhe për shtetin shqiptar, me këtë lë të kuptojmë se nuk ishin të barabartë me delegacionet e shteteve tjera ballkanike; 2. Delegacioni shqiptar nuk shkoi zyrtarisht në Londër pasi Qeveria shqiptare nuk mori ftesë për t'i shprehur qëndrimet e veta lidhur me çështjen që kishte të bënte me të ardhmen e shtetit shqiptar; 3. Gjithashtu duhet të theksohet se edhe në radhët e delegacionit shqiptarë kishte përçarje; 4. Qeveria shqiptare më tepër mbështetej te Vjena se Roma edhe pse nuk kanë gabuar se vetëm Vjena ka tentuar deri në fund të mbrojë territoret shqiptare, por nga ana tjetër kurrë nuk i ka marrë në

[40] Arben Puto, vep. cit., f. 360.
[41] Dokumenti o spolnoj politici… Raport i Jovanoviçit nga Viena dërguar Pashiqit më 16 prill 1913.

konsideratë udhëzimet dhe propozimet e delegacionit shqiptar; 5. Shtetet ballkanike edhe pse nuk ishin në tavolinën e bisedimeve, ato kishin mbështetje pa rezervë nga Parisi dhe Londra, ndërsa Rusia me këmbëngulje ka mbrojtur kërkesat serbe; 6. Dhe në fund duhet me theksuar se pavarësisht lëshimeve dhe padrejtësive që u bënë për shqiptarët, kjo Konferencë ka një rëndësi të veçantë sepse ka qenë forumi më i lartë diplomatik i Fuqive të Mëdha deri në atë kohë ku për herë të parë është vendosur në tavolinë të bisedimeve trajtimi i çështjes shqiptare.

Fejzulla SHABANI

SUMMARY

AN ANALYSIS OF THE ALBANIAN CASE AT THE CONFERENCE OF AMBASSADORS IN LONDON AND THE GEOPOLITICAL CONSEQUENCES OF IT IN THE BALKANS

In this paper I will analyze the diplomatic aspect of the Albanian case at the Conference of London, as well as the geopolitical variations that occurred in the Balkans after the Conference. Within the same topic, I will also analyze the role of the Great Powers and their interests in the Balkans that came about as a result of the destruction of the Ottoman Empire, as well as the Albanian armed uprisings, the Balkan wars, the declaration of the Independence and finally I will conduct an analysis on the Albanian case at the Conference of London. A special importance is paid to the diplomatic analysis regarding the diplomatic confrontation between the Great Powers, with a special emphasis on the future of the Albanian state, specifically the assignment of Albanian borders and its importance on the political future of the Albanian state.

The political and diplomatic character of the Conference in regards to the Balkans' political configuration that was to come about after the Conference, is also analyzed with a special regard in this paper. It is worth noting that the borders that were assigned to Albania had very little to do with Albania's actual borders in the historical and national context, and it appears evident from a historical perspective that these truncated borders were assigned with the sole intention of fulfilling Russia's requests at the Conference.

The paper also analyzes the project-maps that were submitted at the Conference, including the Austro-Italian ones, the Russian ones, as well as those prepared from the Balkan states, such as the project-map and memorandum of the Vlora government. From observing these maps, it becomes evident that there were very distinct and noticeable difference was present, where each submitted map varied with each other. Inferring from this observations, it becomes evident that the Great Powers and the Balkan states requested to expand their territories within the Albanian borders, whereas the government of Vlora requested for a more natural Albania that corresponded with its ethnic borders where

Albanians formed a majority. At the end of the paper, I provide a geopolitical analysis that presents the occurrences in the Balkans after 100 years, which proves that the Balkans continues to be a sphere within the interests of the Great Powers, with the only difference being that the Albanians represent a more important factor in the Balkans nowadays.

Hasan BELLO*

KODI CIVIL OSMAN DHE TRASHËGIMIA JURIDIKE OSMANE NË SHQIPËRINË E VITEVE 1912 - 1928

1. Si dhe kur u hartua Kodi Civil Osman (Mexheleja)

Sistemi ligjor osman deri nga fillimi i shek. XIX gëzonte unitet të plotë. Përgjatë pesë shekujve në strukturën ligjore të Perandorisë Osmane nuk kishte pasur ndryshime thelbësore, përveç disa ligjeve që evoluan natyrshëm në raport zgjerimin e administratës. Por, duke nisur nga viti 1839, kur u shpall Dekreti Perandorak i Reformave, i cili në histori njihet me emrin reformat e Tanzimatit, ligji osman filloi të ndryshoi dukshëm nga ai i periudhës së kaluar.

Përpara reformave të Tanzimatit, në sistemin ligjor të Perandorisë Osmane mbizotëronte ligji islamik (*Ser'î Hukuk*). Problemet dhe mangësitë që shfaqeshin gjatë administrimit të këtij ligji plotësoheshin nga parimet e ligjit tradicional (*Örfi Hukuk*), duke krijuar një kompaktitet në sistemin ligjor osman. Në periudhën e Tanzimatit, bota perëndimore dhe sistemi i saj ligjor, i cili më parë nuk ishte marrë në konsideratë, filloi të shfaqej gjithnjë e më shumë në sfond. Me reformat e Tanzimatit në fushën ligjore dhe në fusha të tjera nisi një periudhë e re, me orientim perëndimor. Struktura legjislative osmane mori çdo ditë e më shumë natyrë evropiane.[1] Arsyeja më e rëndësishme për këtë ishte fakti se, qeveritarët osmanë u ndikuan shumë nga lëvizjet dhe doktrinat juridike që po zhvilloheshin në perëndim.[2]

---

*Dr.,Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë - Tiranë.

[1] Bilal Eryılmaz, *Tanzimat ve Yönetimde Modernleşme*, Istanbul: İşaret Yayınları, 1992, s.225.

[2] Hulusi Yavuz, "Mecelle'nin Tedvini ve Cevdet Paşa'nın Hizmetleri", *Ahmet Cevdet Paşa Semineri*, İ. Ü. Edebiyat Fakültesi Tarih Araştırma Merkezi, İstanbul, 1986, s.45-46.

Shteti osman, i cili vazhdimisht dobësohej deri në shek. XIX, iu nënshtrua një sër reformash që synonin përmirësimin e sistemit ligjor. Pushtetarët osmanë e konsideruan rrugën drejt perëndimit në të gjitha fushat si një shndërrim dhe një qëllim të arritshëm për të shpëtuar shtetin. Mendimtari dhe drejtuesi osman i shek. XIX përpiqej t'i projektonte dhe zbatonte reformat e nevojshme brenda një dileme gjysmë islamiste dhe gjysmë perëndimore.[3] E vetmja mangësi e këtij procesi ishte fakti se, elita politike osmane pa u menduar mirë nëse do t'i përshtateshin ose jo strukturës shoqërore dhe nëse do t'u përgjigjeshin kërkesave ligjore, e pa të nevojshme ndërmarrjen e reformave në strukturën ligjore osmane si dhe në fushën e kodifikimit, duke ndjekur shembullin evropian. Sipas disa studiuesve ligjet perëndimore u përvetësuan verbërisht, pa u parë mirë nëse funksiononin në harmoni me ligjet osmane. Kështu, ato dëmtuan rëndë unitetin e sistemit ligjor osman, duke krijuar vartësi ndaj ligjit perëndimor dhe, duke krijuar terren për pranimin e tërësishëm të tij në të ardhmen. Siç edhe ndodhi në periudhën e Republikës turke pas vitit 1923. Këto konstatime bëhen duke patur parasysh specifikat politike, historike dhe strukturën sociale të shoqërisë osmane, pasi dihet se ligjet perëndimore tepër moderne për kohën ishin hartuar duke pasur parasysh këto specifika, të cilat ishin të ndryshme nga ato të Perandorisë Osmane.

Një rrethanë tjetër që i detyroi shtetarët osmanë për të ndërmarrë reforma në strukturën ligjore, ishte presioni i vazhdueshëm i shteteve evropiane.[4] Kjo, për shkak të nevojave që këto shtete kishin pas Revolucionit Industrial të vitit 1840 për të gjetur tregje të reja dhe për të siguruar infrastrukturën e duhur ligjore në këto shtete. Por, nuk duhet neglizhuar edhe politika që ato ndiqnin për të siguruar pakicat kombëtare dhe religjioze brenda Perandorisë Osmane.[5] Ligji më i rëndësishëm që u hartua në periudhën e Tanzimatit ishte Kodi Civil Osman (*Mecelle-i Ahkam-i Adliye*) ose i quajtur ndryshe "Libri i Rregullave dhe i Drejtësisë". Fillimisht elita e juristëve osmanë u nda në dy grupe kryesore:

a) në grupimin e kryesuar nga Ali Pasha dhe Mit'hat Pasha të cilët, nën presionin e Francës ishin për përkthimin dhe aplikimin e Kodit Civil Francez (Code Napoleon),

[3] Ilber Ortaylı, *İmparatorluğun En Uzun Yüzyılı*, Istanbul: Timaş, 2008, s.210.
[4] Cevdet Paşa, *Tezâkir 1-12*, Ankara: Türk Tarih Kurumu, 1991, s. 63.
[5] Bilal Eryılmaz, *Tanzimat ve Yönetimde…*, s. 235.

b) në grupimin e kryesuar nga Ahmed Xhevdet Pasha, të cilët mendonin se duhej hartuar një Kod Civil në përputhje me specifikat social - politike dhe religjioze të shoqërisë dhe shtetit osman.[6]

Për këtë u ngrit një komision për të kontrolluar dispozitat e Kodit Civil Francez dhe për të vlerësuar se, cilat prej tyre ishin në harmoni të plotë me ecurinë e bërë në këtë fushë. Ndërkohë ideja e përgatitjes së Kodit Civil nëpërmjet shqyrtimit të parimeve islame u përforcua sidomos me përpjekjet e Ahmed Xhevdet Pashës. Për këtë u themelua një komision nën drejtimin e tij dhe filloi të punonte për përgatitjen e Kodit Civil, të bazuar në parimet e shkollës juridike hanefite. Ky Komision i vazhdoi punimet nga viti 1868 deri në vitin 1889. Kodi Civil Osman (*Mecelle*-ja) u publikua dhe hyri në fuqi në formën e një serie prej gjashtëmbëdhjetë vëllimesh me gjithsej 1851 artikuj. Hyrja dhe vëllimi i parë u publikuan në vitin 1869. Ndërsa vëllimi i gjashtëmbëdhjetë u përgatit dhe hyri në fuqi në vitin 1876. Ahmed Xhevdet Pasha luajti rol kryesor në hartimin e dispozitave të Kodit Civil Osman. Sipas tij, Kodi Civil Francez ishte themeli i "kombit" në shoqëritë evropiane, ndërsa bashkësitë islame duhet të qëndronin mbi themelet e fikhut.[7]

Ky Kod ishte shembulli i parë i kodifikimit të ligjit islam në Perandorinë Osmane. Ai, hapi rrugën dhe shërbeu si shembull për përpjekje të mëtejshme në kodifikimin e ligjeve në shtetin osman si dhe në shtetet e tjera myslimane që do të krijoheshin gjatë shek. XX. Për këtë arsye, specialistët që janë marrë me këtë çështje, kanë theksuar se Mexhele-ja nuk zë vend të veçantë vetëm në historinë osmane, por në të gjithë historinë e jurisprudencës islame.[8] Nën shembullin e Mexhelesë në këtë periudhë u hartuan edhe dy kode të tjera: Kodi i Procedurës Penale në vitin 1879, i cili u përgatit duke marrë si model Kodin Francez të Procedurës Penale[9] dhe Kodi i Procedurës Civile në vitin

[6] Mehmet Akif Aydın, *İslâm ve Osmanlı Hukuku Araştırmaları*, İz Yayıncılık, İstanbul, 1996, s. 48-49.

[7] Niyazi Berkes, *Türkiye`de Çağdaşlaşma*, Ankara: Bilgi Yayınevi, 1973, s.198-199.

[8] Mehmet Âkif Aydın, *"*Mecelle'nin Hazırlanışı*", Osmanlı Araştırmaları-IX*, İstanbul, 1989, s. 31-50.

[9] Hıfzı Veldet Velidedeolu, "Kanunlaştırma Hareketleri ve Tanzimat", *Tanzimat I*, Stamboll 1940, s. 198.

1880, i cili u përgatit nga kombinimi i draftit të paraqitur nga Komisioni i Mexhelesë dhe nga Kodi Francez i Procedurës Civile.[10]

2. Reformimi i sistemit ligjor shqiptar dhe abrogimi i Kodit Civil Osman

Shqipëria, e cila u krijua si shtet i pavarur më 28 Nëntor 1912, deri sa të hartonte një legjislacion kombëtar, ndjeu nevojën që të pranonte përkohësisht ligjet, kodet dhe rregulloret e Perandorisë Osmane.[11] Sistemi gjyqësor ruajti pak a shumë po të njëjtin organizim. Kryetari i Gjykatës Penale dhe Politike të Vlorës, Kristo Floqi, për këtë çështje argumentonte në gazetën "Përlindja e Shqipënisë" se gjykatat shqiptare kur kishin filluar aktivitetin e tyre ishin përballur me nevojën e përdorimit të një sistemi gjyqësor. Për këtë, ministri i Drejtësisë, në bazë të vendimit të qeverisë kishte dhënë urdhër që të përdorej legjislacioni osman, deri sa Parlamenti Shqiptar zyrtarisht të përcaktonte sistemin më të mirë gjyqësor për nevojat e Shqipërisë e të shqiptarëve, në raport me natyrën e karakterin e shqiptarit.[12] Sipas tij, qeveria shqiptare, kishte arritur në këtë përfundim për dy arsye kryesore: *e para*, se nuk mund të përgatiste menjëherë një sistem ligjesh të veçanta, të cilat kërkonin njerëz të kualifikuar dhe kohën e tyre për t`u bërë dhe, *e dyta*, se me këto ligje ishin të stërvitur të gjithë ata që ishin thirrur si nëpunës në sistemin gjyqësor. "Tani, - vijonte më tej Kristo Floqi, - në janë a po jo të nevojshme ligjet e Turqisë edhe për Shqipërinë, në i përkasin apo jo këto natyrës dhe karakterit shqiptar ose, cili sistem ligjor është më i mirë dhe më i dobishëm për Shqipërinë, këto janë pika të cilat do nisim t`i sqarojmë e t`i shohim me radhë dhe ngadalë që në numrin që pason".[13] Por, situata politike që u krijua brenda vendit "turbullimet e shpeshta, lufta e përgjithshme dhe okupacionet e huaja nuk premtuen me formue një legjislaturë kombëtare".[14]

---

[10] Ebu'l ula Mardin, *Medenî Hukuk Cephesinden Ahmet Cevdet Paşa*, Ankara: T.D.V.Y, 1996, s. 126.

[11] *Jurisprudenca shqiptare*, "Raporti justifikues i Kodit Tregtar", nr.10-11-12, 1930, f. 58.

[12] Kristo Floqi, "Gjygjësia në Shqipëri-I", *Përlindja e Shqipënisë*, nr.1, 3 gusht 1913, f. 3.

[13] Kristo Floqi, "Gjygjësia në Shqipëri-II", *Përlindja e Shqipënisë*, nr.3, 7 gusht 1913, f. 3.

[14] *Po aty*.

Edhe diplomacia austro - hungareze në një raport të detajuar mbi organizimin e shtetit shqiptar të hartuar më 16 tetor 1913 ishte e mendimit se sistemi ligjor në Shqipëri duhej transformuar në mënyrë graduale. Sipas këtij raporti, e drejta islamike mbi familjen dhe trashëgiminë, e drejta private, institucionet esenciale, në të cilat e drejta ekzistuese në Shqipëri devijonte prej asaj evropiane, duhej që të ruheshin me doemos.[15] Kjo, vlente edhe për organizimin e pushtetit lokal, mbasi sipas këtij raporti, në shtetet ballkanike procedura burokratike evropiane të çonte vetëm në një vonesë të veprimeve.[16]

Në këtë drejtim, një qëndrim i njëjtë u mbajt edhe gjatë periudhës së principatës shqiptare. Në dekretin që Widi nxorri më 4 qershor 1914, për organizimin e gjykatave shqiptare shkruhej se, deri sa të hartohej legjislacioni i ri, do të ruheshin ligjet e Turqisë që kishin qenë miratuar përpara themelimit të shtetit shqiptar (nenin 32).[17] Ndërsa korpuskomanda austro - hungareze me qendër në Shkodër, e cila, në vitet e Luftës së Parë Botërore kishte pushtuar një pjesë të madhe të territoreve të Shqipërisë Veriore dhe të Mesme, në organizimin provizor të gjykatave civile, ruajti ligjet dhe sistemin gjyqësor osman.[18] Pas Kongresit të Lushnjës kur filloi realisht edhe procesi i konsolidimit të shtetit shqiptar, në shtypin e përditshëm u botuan artikuj, të cilët, bënin thirrje për t'u shkëputur një herë e përgjithmonë nga ligjet osmane. Kështu, në një shkrim që u botua në gazetën "Zani i ri" me pseudonimin "Komini" shkruhej: "E kemi thënë kurdoherë se ligjet e përkthyeme të shteteve të huaja nuk bëjnë për ne. Ligjet e Turqisë na kanë çue deri sot në buzë të varrit e në qoftë se nuk bëhemi praktikë t`i shohim punët e nevojat tona për së afërmi, jemi të humbur. Ligjet e Turqisë që na shkatërruan deri sot do të bëhen shkak që të na shuajnë krejt prej faqes së dheut".[19] Pavarësisht këtyre mendimeve, elita politike shqiptare, e kushtëzuar nga rrethanat historike, vazhdoi të ndiqte një politikë të zëvendësimit gradual të legjislacionit osman. Kjo, vihet re edhe në nenin 13 të ligjit për organizimin e gjykatave shqiptare, miratuar më 28

[15] *Haus und Hof Staats Archiv, Wien, Politisches Archiv, Albanien* (më tej: *HHSt.A.PA.A*.), në *Arkivin e Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), Vj, 23-20-2012. Raport i detajuar mbi organizimin e shtetit shqiptar, Vjenë, 16.10.1913.
[16] *Po aty*, f. 27.
[17] *Shteti Shqiptar-Ligjet e reja*, Korçë: Korça, 1920, f. 13-14.
[18] *HHSt.A.PA.A*. në *AIH*, Vj, 26-16-1660, Organizimi provizor i gjyqeve civile në Shqipëri, Shkodër, 8.10.1916.
[19] *Zani i ri*, 23.3.1920, f. 1.

janar 1923, në të cilin vazhdonin të njiheshin kompetencat e gjykatave fetare mbi këto çështje specifike:

a) Kurorëzim,
b) Shkurorëzim,
c) Detyrimet që rridhnin prej kurorëzimit,
d) Kthimi i pajës dhe çështjet që rrjedhin prej mos zbatimit të kontratës së pajës,
e) Ushqimi dhe edukimi i foshnjës pas shkurorëzimit.

Vendimet e Gjykatave fetare mbi çështjet e mësipërme do të zbatoheshin prej Zyrës së Përmbarimit.[20] Ndërsa në nenin 16 shkruhej se, ligjet e organizimit të gjykatave të miratuara që nga Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë si dhe dispozitat e ligjeve otomane që binin në kundërshtim me këtë ligj, abrogoheshin.[21]

Trashëgimia juridike osmane u ruajt edhe në fushën penale. Kodi Penal Osman, i cili, siç e kemi theksuar më sipër ishte përgatitur, duke marrë si model Kodin Francez të Procedurës Penale, u përkthye dhe u botua më 17 shkurt 1924 me autorizim të Ministrisë së Drejtësisë nga turqishtja, nga avokatët Dhimitër Kacimbira dhe Koço Tasi. Në kapakun e brendshëm të këtij botimi gjendet edhe parathënia e ministrit të Drejtësisë, avokat Stavro Vinjau, i cili përgatitjen e kësaj broshure e argumenton me faktin se: "Djemt e rinj që kanë mësuar në Evropë nuk kuptojnë më gjuhën turqishte dhe kështu nuk mundin të përdorin tekstet e ligjevet tona të shkruara në këtë gjuhë. Për të shëruar një nevojë të tillë Ministria e Drejtësisë filloi të përkthejë në gjuhën tonë këto tekste. Por, meqenëse kjo gjuhë shfaq disa mungesa në termat teknike, tekste autentike do të jenë ato në gjuhën turqishte; përkthimet do të kenë vetëm një vlerë ndihmëse për profanët në gjuhën turke".[22] Ndërsa përkthyesit në raportin e tyre justifikues për Ministrinë e Drejtësisë, shkruajnë: "Në bazë të kontratës së lidhun midis asaj Ministrie dhe të nënshkruëmvet, përkthyem në gjuhën shqip Ligjën Penale Otomane, nga teksti origjinal turqisht, në fuqi në Perandorinë Osmane gjer në nëntor 1912 dhe të adoptuar prej shtetit tonë". Në fund të tekstit, përkthyesit, duke pasur parasysh mungesën e terminologjisë teknike në jurisprudencën shqiptare në atë periudhë, kanë vendosur edhe një fjalorth shqip - turqisht.[23]

[20] *Ligje e organizimit të gjykatavet*, Tiranë: Mbrothësija, 1923, f. 5-6.
[21] *Po aty*, f. 6.
[22] *Ligja Penale*,Tiranë: Mbrothësia, 1924.
[23] *Po aty*, f. 72-74.

Pjesë nga legjislacioni osman u përdorën edhe në fusha të tjera. Kështu, në faqet e revistës "Jurisprudenca shqiptare" sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, avokat Qerim Çelo, përktheu nga origjinali turqisht "Dekretligj - Mbi shoqnit anonime dhe siguruese të huaja më datë 12 mars 1906 (1322)", e cila, kishte gjithsej 36 nene dhe që do të përdorej për rregullimin e marrëdhënieve juridike midis shtetit shqiptar dhe shoqërive anonime.[24]

Për procesin e transformimit dhe modernizimit gradual të legjislacionit shqiptar, nga ai osman në atë perëndimor, një nga juristët e njohur të viteve '20, avokat Elmas Kokona, shkruante: "Kjo ishte një vepër thellë - kqyrëse e udhëheqësit të madh të kombit, birit të naltë të Atdheut, Ismail Qemali. Fati i Shqipërisë, prej disa shekujsh, me që ishte i bashkuem me të asaj perandorie dhe kështu gjith lidhjet dhe relacionet e popullit shqiptar me që ishin rregullue me ato ligje pra, një sundim i vërtetë, sidomos, ai, plaku filozof nuk ishte e mundur të vepronte ndryshe duke aprovue ligje të tjera të huaja me të cilat, një rregullim i përgjithshëm dhe i vazhdueshëm prej kaq kohësh, të bëhej pel-mel, menjëherë, si lesht e Arapit".[25] Ai, nuk e mohonte aspak superioritetin e legjislacionit perëndimorë. Por, ishte i mendimit se Shqipëria të metat e saj në këtë aspekt duhej t'i plotësonte shkallë - shkallë. Ajo duhej të përparonte në rrugën e saj drejt një qytetërimi më të zhvilluar në formë evolutive. Prandaj, ai ishte në kundërshtim me të imituarit në mënyrë të verbër, pa caktuar dhe pa fiksuar me logjikë një sistem në përputhje me nevojat e shoqërisë shqiptare. Për ta argumentuar këtë, ai, shkruante se: "Historia dhe Filozofia e së Drejtës na tregon dhe nuk na lë të dyshojmë aspak se, ligjet janë rezultatet e zakoneve e traditave të kombeve. Pra, nuk mund të ndërrohen këto menjëherë. Por, përmirësohen dhe kështu ndërrimi ose më mirë të themi plotësimi i tyne bëhet dal-ka-dal, me një mënyrë të pandjeshme, duke mos i tronditur veprimet e përherëshme të popullit, duke i lënë ato në rrejedhën e tyne, duke ndjekur natyrën dhe rregullat e evolucionit. Se veprimi në të kundërtën nuk bie veçse dëm, veç se shkatërrim".[26]

---

[24] *Jurisprudenca shqiptare*, "Dekretligj - Mbi shoqnit anonime dhe shigurueshe të huaja më datë 12 mars 1906 (1322)", nr.2, 1924, f. 141-145.

[25] Elmas Kokona, *Pris`i i gjykatësve përmbi rregullat e gjykimit të padinavet civile*, Tiranë: Mbrothësia, 1925, f. 1.

[26] *Po aty*, f. 2.

Në kuadër të modernizimit të legjislacionit vendas, në përputhje me modelin perëndimor të ndërtimit të shtetit shqiptar, në vitin 1926 në Ministrinë e Drejtësisë u formua një komision për të hartuar një Kod të ri Penal. Atëherë ministër i Drejtësisë ishte Petër Poga dhe këshilltar i Ministrisë Faik Shatku. Mehdi Frashëri, në kujtimet e tij shkruan: "Një ditë, kur fjalosesha me Faik Shatkun, i thashë se është e mira që të hartoheshin jo vetëm kodi penal, por të pesë kodet, d.m.th edhe Kodi Civil, Kodi Tregëtar, Procedura Civile dhe Procedura Penale".[27] Më i zorshëm dhe vështirësi më e madhe, sipas tij, ishte hartimi i Kodit Civil. Për këtë, në vitin 1927 me dekret presidencial u formua një komision ligjpërgatitës, i përbërë prej katër personash: Thoma Orollagai, Agjah Libohova, Faik Shatku dhe Mehdi Frashëri. Kur u bë publike se do të lihej mënjanë "Mexhelleja" dhe do të adoptohej Kodi Civil, "nga të gjitha anët, - shkruan Mehdi Frashëri, - kishte dalë një zë kundërshtimi, sidomos nga kleri katolik, i cili, në asnjë mënyrë nuk donte të pranonte martesën civile dhe shkurorëzimin. Pjesa ortodokse shqiptare kundërshtonte fort pak. Juristët që kishin qenë nënpunës ose avokatë në Turqi, dëshironin që të adoptohej Kodi Civil Zvicerian, për shkak se e kishte pranuar Turqia qemaliste dhe i kishte të përkthyera në turqisht komentet përkatëse të atij kodi".[28] Këtë mendim, sipas tij, "ata e justifikonin duke thënë se, përveç turqishtes, nuk dinin ndonjë gjuhë tjetër për të studiuar kodin e ri dhe komentet e tyre, kurse komisioni përpiqej si e si të krijonte një Kod Civil që të ishte më i perfeksionuari në shek. XX dhe më i përshtatshëm për nevojat shqiptare".[29] Pohimi i Mehdi Frashërit se përveç turqishtes ata nuk dinin ndonjë gjuhë tjetër, për mendimin tonë nuk qëndron. Nga tabelat e mëposhtme shihet se një pjesë e madhe e nëpunësve shqiptarë kishin mbaruar për jurisprudencë ose për shkenca politike dhe administrative, fakultete në të cilat gjuha frënge ishte jo vetëm një kusht i domosdoshëm, por edhe modë për burokracinë osmane të asaj kohe.

Për hartimin e neneve të Kodit të ri Civil u morën parasysh kodet civile gjermane, zvicerane dhe kodi civil i gjykatave mikse të Egjiptit. Nga Kodi Rural Otoman, i cili, përmbante dispozita shumë praktike për punimin e tokave djerrë që nuk i përkisnin ndonjë personi tjetër, u morën disa nene të cilat i jepnin të drejtë pronësie punuesit të parë që merrte leje prej qeverisë dhe, punimin e vinte në praktikë brenda tre

[27] Mehdi Frashëri, *Kujtime vitet 1913-1933*, Tiranë: OMSCA-1, 2005, f. 218.
[28] *Po aty*, f. 220.
[29] *Po aty*, f. 221.

vjetësh.[30] Hartimi i Kodit të ri Civil ngjalli reagime, shumë individë iu drejtuan personalisht Ahmet Zogut, që atëherë ishte kryetari Republikës Shqiptare, për të mos dekretuar Kodin Civil.[31] Por, Zogu, shkruan Mehdi Frashëri, i kishte bindur dhe të gjitha insinuatat i kishte larguar.

Në diskutimet që u zhvilluan në Parlament për miratimin e Kodit Civil, krahasuar me deputetët e besimeve të tjera, deputetët myslimanë, të cilët edhe prekeshin më shumë nga të gjithë, mbajtën një qëndrim parimor. Ata, vunë në dukje përparësitë që sillte Kodi Civil në jetën shoqërore dhe në përmirësimin e të drejtave të gruas në familje dhe, iu kundërvunë diskutimit të deputetëve të ndonjë besimi tjetër, të cilët e quajtën të papranueshëm kapitullin që sanksiononte të drejtën e shkurorëzimit e sidomos kundër së drejtës që i jepej gruas për të prishur martesën. Në fjalën e tij, deputeti Sali Vuçiterni, i cili, ishte një nga figurat e njohura të Komunitetit Mysliman Shqiptar dhe njeri i afërt me Ahmet Zogun, deklaroi se Kodi Civil nuk urdhëronte divorc, por vetëm e pranonte atë. Sipas tij, shqiptari i çfarëdolloj feje që të ishte, në bazë të këtij Kodi mund t`i drejtohej zyrës së shtetit e të kërkonte divorcin dhe ajo zyrë ishte e detyruar ta pranonte.[32] Ndërsa një personalitet tjetër po aq i njohur siç ishte Ferit Vokopola, lidhur me miratimin e Kodit Civil deklaroi se: "Me këtë Kod shoqëria shqiptare ka hedhur hapin më të qëndrueshëm në rrugën e qytetërimit".[33] Komuniteti Mysliman Shqiptar qëndrimin e vet ndaj Kodit Civil e shprehu edhe me një artikull që u botua në revistën "Zani i naltë". Aty shkruhej se anëtarët e tij nuk ishin kundërshtarë të Kodit Civil, pasi e kuptonin se në një vend me disa religjione, çështja e të bërit të ligjeve dhe të aplikimit të tyre nuk i përkiste fesë, por kombit. Ky Kod Civil nuk sillte asnjë pengim në ndërgjegjen e frymëzuar nga feja islame dhe mund të aplikohej me ndërgjegjje nga çdo mysliman.[34] Në fjalën e mbajtur në parlament, Sali Vuçiterni, evidentoi rolin pozitiv që luajtën myslimanët, duke mos bërë asnjë ankim. Ai, i përgëzoi ata për faktin se ashtu siç kishin bërë sakrifica për sigurimin e pavarësisë kombëtare, tani po bënin sakrifica edhe për votimin e këtij Kodi. Këtë qëndrim pozitiv të deputetëve, klerit dhe popullsisë myslimane e vlerësoi edhe shtypi i kohës.

[30] *Po aty*, f. 222.
[31] *Po aty*.
[32] *Fletorja Zyrtare*, nr. 41, 19 prill 1928, f. 6.
[33] *Fletorja Zyrtare*, nr. 2, 3 janar 1928, f. 6.
[34] *Zani i naltë*, nr. 2-3, 1928, f. 469.

Sipas nenit 57 të ligjit mbi aplikimin e Kodit Civil, kompetenca e gjykatave fetare për martesë, veçim, shkurorëzim, ushqim, edukim, prikë dhe pajë, abrogohej. Sekretarët e gjykatave fetare detyroheshin t'i dorëzonin të gjithë regjistrat, dosjet dhe aktet e këtyre çështjeve prokurorit, i cili duhet t'ia dorëzonte ato gjykatave kompetente. Në vendet ku nuk kishte prokuror, aktet i dërgoheshin gjyqtarit paqtues, i cili, ato çështje që nuk ishin kompetencë e tij duhet t`ia dërgonte gjykatave përkatëse. Çështjet, të cilat, ditën që hynte në fuqi Kodi Civil ndodheshin nën shqyrtim të gjykatave fetare, kalonin po në të njëjtën shkallë të gjykatave civile (neni 58).[35] Sipas nenit 61, "Mexheleja, kodi i tokave, dispozitat e vesaja, të Feraizit si dhe të gjith dispozitat e tjera të Sheris dhe ato eklasiastike që i përkasin të drejtës familjare dhe të drejtave civile të tjera e përgjithësisht të gjith ligjet që janë në kundërshtim me Kodin e ri Civil, abrogohen".[36]

Shtypi i kohës shkruante se Kodi i ri Civil kishte rëndësi të madhe edhe në pikëpamjen e dispozitave të martesës civile, e cila, kishte për të lehtësuar bashkimin e elementëve të ndryshëm fetar.[37] Pasi u organizua shteti dhe regjimi, të gjitha degët e administratës dhe të makinës shtetërore u organizuan mbi baza moderne.[38] Këto zhvillime u realizuan në përputhje me hapat e kohës, pasi edhe vetë Republika turke, më 17 shkurt 1926 e kishte abroguar Kodin Civil Osman (Mexhelenë), duke e zëvendësuar atë me Kodin Civil Zviceran.[39] Por, ndryshe nga elita politike turke, e cila, e futi shoqërinë e saj në ndryshime radikale, elita politike shqiptare preferoi, në përputhje me rrethanat historike, një transformim evolutiv. Me hyrjen në fuqi të Kodit të ri Civil, më 1 prill 1939, merr fund edhe trashëgimia juridike osmane në Shqipëri.

Një faktor që ndikoi në jetëgjatësinë e kësaj trashëgimie ishte fakti se një numër i madh personalitetesh shqiptare kishin studiuar në katedrat e Stambollit. Këtu bëjnë pjesë, bie fjala, edhe dy ish-ministra Drejtësie të krishterë siç ishte Petro Poga i diplomuar në shkollën e drejtësisë Mektebi Sulltan (Mekteb-i Sultânî) më 1883 dhe Pertef Pogoni, i cili, kishte përfunduar shkollën e Shkencave Politike dhe Administrative në Stamboll (Mülkiye). Ky aspekt pasqyrohet akoma më mirë dhe nga tabelat e mëposhtme.

---

[35] *Ligja për aplikimin e Kodit të ri Civil*, Tiranë: Mbrothësia, 1928, f. 14.
[36] *Po aty*, f. 16.
[37] "Kodi Civil i ri", *Gazeta e Korçës*, nr. 596, 30 mars 1929, f. 2.
[38] "Kodi Civil që sot hyn në fuqi", *Gazeta e Korçës*, nr.597, 1 prill 1929, f. 1.
[39] *Türkiye Büyük Millet Meclisi Zabıt Ceridesi*, 22. cilt. 17 Şubat 1926, s. 256-257.

Tabela. I.
Studentët shqiptarë që studionin në Fakultetin e Shkencave Politike dhe Administrative të Stambollit në vitet 1909 - 1910[40]

Nr	Emri	Vendlindja
1	Abedin Nepravishta	Gjirokastër
2	Bahri Karagjozi	Gjirokastër
3	Bahri Omari	Gjirokastër
4	Faik Dishnica	Përmet
5	Hajri Çani	Gjirokastër
6	Hysni Çabej	Gjirokastër
7	Ibrahim Et`hem Leskoviku	Leskovik
8	Ihsan Murati	Ohër
9	Ismail Vehbi Leskoviku	Leskovik
10	Izet Prizreni	Prizren
11	Mahmud Nedim Përlepja	Prilep
12	Mehmet Mit`hat Janina	Janinë
13	Mustafa Asim Merlika	Krujë
14	Myin Myezini	Vlorë
15	Sulejman Ruhi Përmeti	Përmet
16	Shaban Shefqet Vuçiterni	Prishtinë
17	Shefqet Leskoviku	Leskoviku
18	Xhaferr Vila	Korçë
19	Zyhdi Karagjozi	Gjirokastër

Tabela. II.
Studentët shqiptarë që studionin në Fakultetin Juridik të Stambollit në vitet 1909 - 1910[41]

Nr	Emri	Vendlindja
1	Xhevdet Musta	Gjirokastër
2	Ragip Ibrahimi	Borsh

[40] Këto tabela janë ndërtuar mbi bazën e të dhënave që na jep Mustafa Kruja për këto personalitete. Një pjesë e mbiemrave të tyre vjen nga vendi i origjinës, pasi në atë periudhë në përputhje me traditën islame nuk kishte mbiemra. *Shih*: *Mustafa Kruja në historinë shqiptare*, Tiranë: OMSCA-1, 2012, f. 78-79.
[41] *Po aty*.

3	Hysej Sulua	Libohovë
4	Sulo Bogdo	Libohovë
5	Ahmed Xhevdet Çani	Gjirokastër
6	Fehim Qorri	Libohovë
7	Taip Çomua	Libohovë
8	Ferdi Kumbaro	Libohovë
9	Namik Libohova	Libohovë
10	Ulvi Kade	Libohovë
11	Fazli Gjirokastra	Gjirokastër
12	Xhelal Angoni	Gjirokastër
13	Sezai Libohova	Libohovë
14	Hamid Remzi Myftiu	Berat
15	Behxhet Frashëri	Frashëri
16	Kahreman Frashëri	Frashëri
17	Nikollaq Viska	Korçë
18	Muço Qulli	Leskovik
19	Sadedin Avni Struga	Strugë
20	Sabri Qyteza	Korçë
21	Ismet Çano	Libohovë
22	Muhidin Manastiri	Manastir
23	Behxhet Reka	Rekë
24	Fuat Fico	Gjirokastër
25	Beqir Sami Kosova	Kosovë
26	Halid Kërçova	Kërçovë
27	Sejfedin Manastiri	Manastir
28	Rasim Babameto	Gjirokastër
29	Shemsi Manastiri	Manastir
30	Faik Prizreni	Prizren
31	Muslis Reka	Rekë
32	Selami Libohova	Libohovë
33	Ferid Manastiri	Manastir
34	Emrullah Hilmi Ohri	Ohër
35	Andrea Apostoli	Berat
36	Ataullah Preveza	Prevezë
37	Agjah Libohova	Libohovë

Tabela. III.
Studentët shqiptarë që studionin në medresetë e Stambollit
në vitet 1909 - 1910[42]

Nr	Emri	Vendlindja
1	Mehmet Ali Kosova	Kosovë
2	Murat Kosova	Kosovë
3	Hysejn Remzi Dibra	Dibër
4	Nexhmedin Behxhet Reka	Rekë
5	Hysni Kosova	Kosovë
6	Demir Kosova	Kosovë
7	Ali Peja	Pejë
8	Xhevat Peja	Pejë
9	Osman Pertev Shkodra	Shkodër
10	Aqif Namik Shkodra	Shkodër
11	Hysni Durrësi	Durrës
12	Jusuf Durrësi	Durrës
13	Abdyrrahim Dibra	Dibër
14	Kerim Durrësi	Durrës
15	Kasem Tirana	Tiranë
16	Nuredin Mezini	Gjirokastër
17	Salih Elbasani	Elbasani
18	Hasan Tahsin Çani	Margarit
19	Haxhi Jusuf Janina	Janina

Tabela. IV.
Studentët shqiptarë që studionin në shkollën e kadijëve në Stamboll
në vitet 1909 - 1910[43]

Nr	Emri	Vendlindja
1	Shefqet Kokona	Gjirokastër
2	Hudaverdi Jahua	Gjirokastër
3	Refik Gega	Gjirokastër
4	Hafiz Kavaja	Kavajë
5	Alaedin Kosturi	Kostur
6	Ismet Hivzi Gjirokastra	Gjirokastër

[42] *Po aty*, f. 81.
[43] *Po aty*.

Mexheleja, e cila u zbatua për 57 vite me radhë në Perandorinë Osmane dhe në Republikën turke, në disa vende, ashtu si në Shqipëri, vazhdoi të aplikohej edhe më vonë. Kështu, në Liban ajo qëndroi në fuqi deri në vitin 1932, në Siri deri në vitin 1949, në Irak deri në vitin 1953, ndërsa në Jugosllavi disa nene të saj patën jetëgjatësi edhe për shumë për pakicat myslimane. Sipas disa studiuesve edhe sot e kësaj dite bazat e Kodit Civil në Jordani, Qipro dhe Izrael akoma mbështeten në Kodin Civil Osman ose, Mexhelenë.[44]

[44] Hulusi Yavuz, "Mecelle'nin Tedvini ve Cevdet Paşa…", s.96; Abdullah Demir, *Mecelle ve Külli Kaideler*, Istanbul: Işık Akademi Yayınları, 2011, s. 228.

Hasan BELLO

SUMMARY

OTTOMAN CIVIL CODE AND THE OTTOMAN LEGAL LEGACY ALBANIA IN THE YEARS 1912 - 1928

Albania, which was created as an independent state on 28 November 1912 until the draft national legislation, felt the need to temporarily accept the laws, codes and regulations of the Ottoman Empire. Albanian judicial system maintained more or less the same setup. After Lushnjes when Congress actually starts the process of consolidation of the Albanian state newspapers published articles, who called, to be permanently disconnected once the Ottoman laws. Regardless to these opinions, the Albanian political elite, conditioned by historical circumstances continued to pursue a policy of gradual replacement of Ottoman legislation.

A qualitative step in this direction was rezalizua especially in the years of the republic, when by order of President Ahmet Zogu at the Ministry of Justice set up a special commission, which consisted of the best specialists of the Albanian judiciary. The main purpose of this committee was to replace the Ottoman legislation with Western laws and codes.

Jani SOTA

KONGRESI ARSIMOR I VITIT 1920 DHE RËNDËSIA E TIJ NË PËRCAKTIMIN E FIZIONOMISË KOMBËTARE TË ARSIMIT NË SHQIPËRINË E VITEVE 1920-1922

Shteti shqiptar, qoftë qeveria e Vlorës, qeveria e Durrësit, principata e Princ Vidit apo qeveritë e tjera të krijuara deri në vitin 1919, nuk ishin në gjendje t'i realizonin aspiratat dhe shpresat e popullit shqiptar, duke përfshirë edhe ato në fushën e arsimit. Mbarimi i Luftës së Parë Botërore shtroi problemin e ekzistencës së shtetit shqiptar dhe të tërësisë tokësore të Shqipërisë së vitit 1913. Më 1919 gjendja e brendshme në Shqipëri ishte shumë e rëndë. Shkodra ishte nën administrimin ushtarak të Francës, Anglisë dhe Italisë; në Korçë ishin trupat ushtarake jugosllave, ndërsa pjesa më e madhe e vendit gjendej nën administrimin ushtarak italian.

Kjo gjendje do të vazhdonte deri në vitin 1920. Kështu, pas ndërprerjes së jetës shtetërore kombëtare më 1914, Shqipëria e rifilloi atë në vitin 1920. Fillesat lidhen me Kongresin Kombëtar të Lushnjes, që u mbajt prej 28-31 janar 1920.[1] Nga ky Kongres Kombëtar doli një qeveri e re kombëtare, e kryesuar nga Sulejman Delvina dhe "Bazat e Kanunores së Këshillit të Naltë" (Statuti Themelor i shtetit shqiptar). Këshilli i Naltë kolegjial përbëhej prej Aqif Pashë Elbasanit, Abdi Bej Toptanit, Mihal Turtulli dhe Imzot Bumçi.[2] Kongresi vendosi të organizoheshin zgjedhjet parlamentare për Asamblenë Kushtetuese, e

---

[1] *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi i Ministrisë së Arsimit (1911-1944) - nr. 195,viti (më tej: V.) 1920, dosja (më tej: D.) 5, fl. 37.

[2] *Historia e Popullit Shqiptar,* vëll. III, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, f. 187; Shih edhe: Gramor Hysi, *Organizimi i shtetit shqiptar dhe lufta politike rreth tij*, Tiranë: 1988, f. 10; Fane Veizi, *Kongresi i Lushnjes*, botim i Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës, Tiranë: 1959, f. 35.

cila do të përcaktonte pastaj formën e regjimit politik në Shqipëri. Qeveria mori disa vendime të rëndësishme, siç ishte bashkimi i të gjitha viseve shqiptare dhe caktimi i Tiranës, kryeqytet i Shqipërisë.

Ndër problemet parësore ishte arsimi, sepse gjendja kulturore dhe arsimore në Shqipëri, në prag të viteve '20 ishte shumë e rëndë. Numri i shkollave ishte i vogël; shkollat ekzistuese ishin në gjendje të mjerueshme; në vend nuk ekzistonte një sistem unik arsimor; veç shkollave shqipe ekzistonin edhe mjaft shkolla të huaja; ishte e pranishme edhe ndarja e shkollave mbi baza fetare; niveli arsimor i popullit ishte i ulët etj. Shkaqet e kësaj gjendjeje duhen kërkuar në traditën e pamjaftueshme arsimore, në mundësitë e pakta financiare të institucioneve arsimore, por edhe në ngathtësinë e administratës lokale, e cila ndonjëherë spekuloi me vështirësitë për gjetjen e ndërtesave shkollore të përshtatshme.

1. Përpjekjet për një ridimensionim perëndimor të arsimit shqiptar

Pas Kongresit Kombëtar të Lushnjes dhe Luftës së Vlorës kundër pushtuesve italianë, mori hov lëvizja e re politike dhe kulturore. Ishin pikërisht rritja e mëtejshme e arsimit kombëtar, përhapja e shpejtë e mësimit shqip dhe çelja e qindra shkollave e kurseve në gjuhën shqipe që shtruan për zgjidhje një numër problemesh të rëndësishme, me karakter pedagogjik, organizativ dhe financiar, si përpunimin e një programi të vetëm për shkollat shqipe; organizimin më të mirë, në shkallë kombëtare, të rrjetit shkollor që ishte krijuar dhe që ishte duke u zgjeruar; sigurimin e mjeteve të nevojshme financiare për mbajtjen e shkollave dhe pajisjen e tyre me tekste e mjete mësimore; njësimin e gjuhës së shkruar që do të përdorej në botimet shkollore dhe joshkollore dhe mbi të gjitha përgatitjen e mësuesve për shkollat në vend. Përveç këtyre, mendimtarët shqiptarë për edukimin synonin ngritjen arsimore në Shqipëri në një shkallë më të lartë dhe ta zhvillonin më tej nga ç'ishte parashikuar në programin e Kongresit të Lushnjes, duke i hapur atij dhe shtetit shqiptar perspektiva të reja.

Përpjekjet për demokratizimin dhe laicizimin e shkollës në vitet 1920-1924 ishin pjesë përbërëse e lëvizjes së përgjithshme të forcave progresive të shoqërisë shqiptare për demokratizimin e tërë jetës së vendit. Këto probleme dhe të tjera me karakter politik e organizativ të

shtetit shqiptar e bënë të nevojshme thirrjen e një kongresi të ri mbarëshqiptar.

Iniciator për thirrjen e një kongresi të ri kombëtar u bë qeveria shqiptare, përkatësisht Ministria e Arsimit e drejtuar nga Sotir Peci, e cila i shtroi vetes detyrë urgjente riorganizimin rrënjësor të sistemit arsimor në vend. Çështje themelore në atë kohë ishte unifikimi i sistemit arsimor, çka do të thotë unifikimi i legjislacionit shkollor, i tipit të shkollave, i programeve dhe i teksteve shkollore.

Në letrën drejtuar Kryetarit të Këshillit të Lartë, Aqif Elbasanit, që mbante datën 26 korrik 1920, Sotir Peci vendosi si vend për mbajtjen e kongresit, qytetin e Lushnjes dhe si kohë, 15 gushti 1920.[3] Në fillim të kësaj letre tregoheshin arsyet që e shtynë Sotir Pecin për të kërkuar mbajtjen e një kongresi të ri. Në të thuhej: "Duke ditur se sa rëndësi ka mësimi fillor për vendin tonë, kjo ministri me qëllim që të veproj mbas një programi sa më të pëlqyeshëm, e të përkueshëm për nevojë të atdheut tonë ka vendosur që të mbledh një komision prej fuqive më të forta në fushën arsimore. Ky komision do të mblidhet në Lushnje, vend historik në kohë të sotshme, të atdheut tonë".[4]

Në thirrjen nr. 650, të datës 2 gusht 1920 theksohej se, "Ministria e Arsimit në gjysmën e gushtit do të mbledh disa arsimtarë, 10-12 veta për çështje shkollore"[5] dhe se ata, duhet "të gjenden atje më datën 10-të".[6] Në thirrje parashikohej gjithashtu rendi i ditës, i cili përmbante këto çështje: "1. Të bëhet një program për 5 klasa të pjesëtuara në javë duke marrë për ndihmë programat e analizuara prej G. Beltojës, G. Mikelit, M. Bellkamenit, Th. Papapanos, A. Xhuvani prej çdo tjetër që më tepër t'ju pëlqejë; 2. Të sajuarit e një programi për shkollën 3-klasëshme, por një mësues i mësimit kolektiv; 3. Bisedimet përmbi librat shkollorë në pikëpamje dialektore që të kuptohen prej gegëve dhe toskëve; 4. Bashkëveprimi për të hartuar tekstet për shkollat fillore sipas programës që do të caktohet; 5. Themelimi dhe botimi për një të përkohshme pedagogjike dhe didaktike".[7] Nga ky dokument dalin qartë disa çështje kryesore: *së pari*, nevoja e ngutshme e përgatitjes së programeve të njësuara, të përbashkëta për të gjitha shkollat shqipe që

[3] *AQSH*, F. 195, V. 1920, D. 4, fl. 1.
[4] *Po aty*, f. 1; Shih edhe: *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar*, botim i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Shqipërisë, Instituti i Studimeve Pedagogjike, Tiranë: Nënë Tereza, 2003, f. 378; *Historia e Popullit Shqiptar ...*, f. 189.
[5] *AQSH*, F. 195, V. 1920, D. 4, fl. 7-9.
[6] *Po aty*, fl. 2.
[7] *Po aty*.

vepronin në Shqipëri; *së dyti*, me këtë punë do të merreshin specialistët më të mirë në fushën e arsimit dhe mendimit pedagogjik; *së treti*, mbledhja apo kongresi do t'i zhvillonte punimet në qytetin historik të Lushnjes dhe do të organizohej nga Ministria e Arsimit.[8]

Përzgjedhja e Lushnjes, si qyteti ku do të mbahej Kongresi Arsimor nuk mund të ishte kurrsesi një akt spontan, thjesht personal dhe i pamenduar mirë, apo thjesht emocional. Duket që ishte një hap i menduar mirë, i koordinuar me specialistët e mirëfilltë që kishin kontribuar në evolucionin e mendimit pedagogjik dhe të shkollës shqipe. *"Kongresi që do të mbahet në Lushnje është vetëm teknik,* - theksohet në një dokument të kohës, - *është dialektik për gjuhën"*.[9] Simbolika ishte tepër e qartë. Në Lushnje "u arrit bashkimi i forcave demokratike për forcimin e shtetit shqiptar, të krijuar në vitin 1912".[10] Po këtu, duhet të bashkoheshin "fuqitë më të mira në lëmin e arsimit, për të shkoqitur e për të vendosur mbi programet, ... për mirësinë e mbarë shkollave tona, të këtyre misëve më të fuqishëm të përparimit e qytetërimit".[11]

Lajmi për mbajtjen e një Kongresi të ri në Lushnje për problemin e njësimit dhe kombëtarizimit të shkollave shqipe u mirëprit, ngjalli gëzim e shpresa, por edhe një farë besimi. Në letrën që Aleksandër Xhuvani i dërgoi nga Elbasani drejtorit të gazetës "Shqipëria e Re", Mihal S. Xoxes, në gusht 1920, shkruante: "Po marrim vesh me gëzim se Ministria e Arsimit të Botuer paska parë me udhë e vendosur të mbahet tani shpejt një kongres pedagogjik në Lushnje për të rrahur çështje arsimore me të shpejtë, sikurse natyrisht na erdhi në mend se vendi i këtij kongresi nuk mund të ishte tjetër, veçse në Lushnjen e kombit tonë. Këtë lajm e morëm vesh me gas e me hare ... ".[12] Po kështu, gazeta "Drita" shkruante se, "shpresohet që kongresi pedagogjik i Lushnjes do të hedhë gurin themeltar të arsimit e të shkollave shqipe në Shqipëri. Nga ky kongres pritet pritmja e kombit tonë, se vetëm nga ato shkolla pritet drita e qytetërimit që të përhapet mi gjithë anët e Shqipërisë".[13] Gëzimi dhe shpresat shpjegohen me faktin se, siç shkruante Zef Fekeçi, "nuk besojn që të ndodhet ndonjë shqiptar që të mos ta shohë e mos ta kuptojnë nevojën e madhe që ka kombi ynë për

[8] *Historia e arsimit ...* , f. 387.
[9] *AQSH*, F. 195, V. 1920, D. 9, fl. 11-12.
[10] *Po aty*.
[11] *Po aty*.
[12] *Shqipëri' e re*, Kostancë, 5 gusht 1920.
[13] *Drita*, Gjirokastër, 13 gusht 1920.

mirësinë e mbarë shkollave të veta".[14] Mendimi ishte "mjaft i pëlqyeshëm, në qoftë se nga ai do të nxirreshin të gjitha ato fryte që presim".[15]

Gjithsesi, duhet thënë se pati shumë diskutime lidhur me caktimin e afatit shumë të shkurtër për mbajtjen e Kongresit, jo vetëm sepse kjo binte në kundërshtim me atë pjesë të vogël të atdhetarëve dhe intelektualëve që kishin qenë pjesë e diskutimeve dhe të vendimmarrjes në kongreset historike,por para së gjithash, sepse brenda disa muajsh ishte e pamundur të përgatitej si duhej, në kushtet e atëhershme, një Kongres mbarëshqiptar e për probleme aq të rëndësishme kombëtare. Ndryshe nga gazetat e tjera,gazeta "Koha e re" e drejtuar nga Nikoll Ivanaj, për Kongresin Arsimor të vitit 1920, tregohej mjaft skeptike. Sipas saj, "çështja e arsimit e të shkollave mund të mbrohej vetëm më një udhë dhe kjo s'kërkon as kongrese, as delegat, as të holla",[16] por duhej që "të gjithë forcat më të mira pedagogjike dhe qeveria shqiptare të vlerësonte si një element shumë pozitiv orientimin e shqiptarëve drejt arsimit dhe kulturës së vendeve të zhvilluara perëndimore".[17] Më tej, po kjo gazetë pohonte se "shqiptarët do të preferonin të përdornin në shkollat e tyre një gjuhë perëndimore, gjersa të zhvillohej literatura e tyre".[18]

Shqetësimi shtohej më tepër për arsye se pakënaqësia nuk shprehej nga një person ose nga ndonjë gazetë e vetme, por nga disa qarqe të caktuara të politikës shqiptare të asaj kohe. Ajo që të binte në sy, ishinkontradiktat mes intelektualëve progresistë, të formuar në universitetet perëndimore evropiane dhe kastës politike që në përgjithësi shihte me skepticizëm rindërtimin demokratik të sistemit institucional arsimor në Shqipëri. Kjo është edhe arsyeja, që përpjekja për krijimin e një legjislacioni modern, duke zhvilluar strategji për të ofruar të mirat e arsimimit në një sistem shkollor shtetëror kombëtar, për shkollimin e fëmijëve shqiptarë të të gjitha besimeve dhe për një jetesë normale në një vend demokratik evropian, shkonte në kahë të kundërt edhe me përpjekjet e pavarura të klerikëve dhe të qarqeve drejtuese të shkollave private dhe atyre të huaja brenda dhe jashtë Shqipërisë.

---

[14] *Agimi,* Shkodër, 22 korrik 1920
[15] *Po aty*.
[16] *Koha e re*, Shkodër, 19 gusht 1920.
[17] *Po aty*.
[18] *Po aty*.

Me gjithë rezervat që kishin për mënyrën e thirrjes së Kongresit të ri shqiptar, në përgjithësi veprimtarët dhe intelektualët atdhetarë kishin arritur në përfundimin se "do ta mbështesnin reformën e qeverisë për kombëtarizimin dhe modernizimin e arsimit shqiptar, por parashtronin si kusht të vetëm, eliminimin e ndërhyrjes së politikës në këtë proces".[19] Ata, duke pranuar në parim nevojën e organizimit të Kongresit, kërkuan në të njëjtën kohë që së pari, të shtyhej koha e mbartjes së tij për t'u përgatitur më mirë; së dyti, Ministria e Arsimit për çdo veprim në këtë drejtim të merret vesh me drejtuesit e institucioneve arsimore në njësitë vendore, e sidomos me atë të drejtorive arsimore në qarqe; së treti, të rishikohej e të plotësohej programi i shpallur i Kongresit, i cili përmbante kryesisht problemin e shkollave.

Me qëllim që kongresi të përgatitej sa më mirë, Sotir Gjika, drejtor i revistës politike e përjavshme "Kuvendi", që botohej në Romë, këshillonte që çdo gjë "përpara të përpiqemi që ta vështrojmë me kujdes e me vërejtje të madhe e ta sjellim pastaj në praktikë ashtu siç duhet e si rëndësia e punës kërkon".[20] Prandaj, ai kërkonte që Kongresi të shtyhej të paktën edhe tre a katër muaj. Ai mendonte, gjithashtu, se "Ministria e Arsimit do të bënte punë edhe më të mirë e të çmueshme për forcimin e unitetit kombëtar, pikësëpari me fuqizimin dhe përparimin e shkollave në gjuhën shqipe".[21]

Përsa i përket programit të shpallur të kongresit, qëndrim kritik mbajti në fillim gazeta "Dielli", e cila, pasi pyeste për shkakun e nxitimit "për të thirrur një kongres pedagogjik", shkruante se nuk do të ishim "aqë kundër kongresit të ri", po të kishim edhe shpresën më të vogël se mendimtarët e tjerë në fushën e arsimit mund të shtronin në të një "një program të përbashkët" dhe t'i kërkonin qeverisë "drejtpërdrejtë ato që na mungojnë në çdo pikëpamje".[22] Por, duke njohur gjendjen politike të Shqipërisë në atë kohë, gazeta "Dielli" tregohet realiste kur, ndonëse kritikonte programin e shpallur, nuk ishte për të parashtruar kërkesat më të avancuara të lëvizjes intelektuale progresiste, por kërkesa të realizueshme nën një regjim konstitucional. "*Duam nga kongresi i ri pedagogjik,* - shkruante "Dielli", - *njëmijë gjera praktike për shkollat, për udhët etj"*.[23]

---

[19] Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2013, f. 319.
[20] *Kuvendi*, Romë, 27 korrik 1920, f. 7-8.
[21] *Po aty*.
[22] *Dielli*, Boston, 9 gusht 1920.
[23] *Po aty*.

Siç del nga gazeta "Jeta e re" e Korçës, Ministria e Arsimit dhe ministri i saj, Sotir Peci, që në fillim iu drejtuan intelektualëve dhe veprimtarëve shqiptarë të shquar në fushën e edukimit për të sjellë në Kongres mendimet dhe propozimet e tyre, lidhur me reformimin e sistemit arsimor në Shqipëri. *"Ishte nevojë e madhe*, - shkruante gazeta "Jeta e Re", më 4 prill 1921, - *që delegatët që do të vinin në Lushnje, ashtu sikurse që rrëfen edhe thirrja e komisionit organizator, të njiheshin edhe ata me programin të përcaktuar për sa pika që do të kuvendoheshin, se nuk është qëllimi që të vendosen fjalë të mira, po do menduar bukur e mirë dhe anët me të cilat do të mbaroheshin ato vendime"*.[24] Po kjo gazetë shprehte "një shpresë të madhe",[25] se në Kongres do të ketë "njerëz që interesohen për përparimin e gjuhës dhe arsimit shqiptar",[26] dhe se ata që do të shkonin, ishin "të përgatitur për punët që do të kuvendonin, duke sjell një mendim dhe një gjykim të vlejtur".[27] Gjithsesi, reagimet e veprimtarëve shqiptarë për edukimin dhanë shkas për një këmbim mendimesh dhe ndikuan pozitivisht në forcimin e ndërgjegjes dhe të bashkimit kombëtar. Zhvillimi i arsimit kombëtar do të bënte që brezi i ri të zhvillohej dhe të formohej me dituri dhe ideale kombëtare.

Keqësimi i situatës së brendshme politike në verën e vitit 1920, shkaktuar nga zhvillimi i situatave dramatike në qytetin e Vlorës dhe nga interesat ushtarake të Italisë kundër Shqipërisë, patën rrjedhim shtyrjen disa herë të kohës për mbajtjen e mbledhjeve të komisionit organizator të Kongresit Arsimor të vitit 1920. Ndonëse gazeta "Drita", si shkak të shtyrjes jepte vazhdimisht"trazirat e Vlorës", nga disa shkrime të saj del edhe pse ishte menduar që Kongresi mund të shtyhej një muaj, data do të caktohet përfundimisht vetëm pasi Ministria e Arsimit të merrej vesh me drejtuesit e nënprefekturës së Lushnjes.[28] Më në fund u vendos që Kongresi të mbahej në gjysmën e gushtit të vitit 1920. Kështu, me anën e një thirrje të re të datës 11 gusht 1920, Ministria e Arsimit njoftonte se, "më 15 gusht do të hapet kongresi teknik i arsimtarëve të Lushnjes",[29] duke caktuar "anëtarët Dhimitër Mborja, Aleko Kondili që të nisen atje, duke gjetur instruksionet

[24] *Jeta e re*, Korçë, 4 prill 1921.
[25] *Po aty*.
[26] *Po aty*.
[27] *Po aty*.
[28] *Drita*, Gjirokastër, 19 korrik 1920.
[29] *AQSH*, F. 195, V. 1920, D. 9, fl. 2.

përkatëse",[30] për organizimin e kongresit. Një rol të rëndësishëm në këto përgatitje luajtën atdhetarë dhe arsimtarët e Lushnjes, e në mënyrë të veçantë"nënprefekti Hiqmet Delvina dhe Besim Nuri, Kryetari i Bashkisë së qytetit të Lushnjes".[31] Atdhetarët dhe shtypi përparimtar u bënë jehonë përgatitjeve për kongresin e ardhshëm, i cili, siç shkruante gazeta "Shkëndija"e Korçës,pritej që "të hidhte themelet e fizionomisë të shkollave shqiptare që do të çeleshin në Shqipëri".[32]

Gjatë gjithë periudhës së trazuar politike 1920-1924, fqinjët ballkanikë u përpoqën, dhe jo pa sukses, të përfitonin nga vështirësitë dhe tensionet e brendshme për të penguar procesin e ndërtimit të institucioneve kombëtare ose thënë shkurt procesin e ndërtimit kombëtar.[33] Në mungesë kuadri dhe dobësi organizimi, shkollat minoritare nuk kontrolloheshin rregullisht ose nuk kontrolloheshin fare nga organet eprore përkatëse. Kështu, "shkollat e rajonit të Delvinës dhe të Konispolit, deri në fund të vitit 1920, nuk ishin kontrolluar asnjëherë, që nga koha e çeljes së tyre".[34]

Duke shfrytëzuar mungesën e kontrollit të rregullt nga organet kompetente shqiptare, në ato shkolla u teprua aq shumë me greqishten, "sa që disa, shumë ose të gjitha lëndët, që duhet të zhvilloheshin në gjuhën shqipe sipas programit shtetëror, zhvilloheshin në greqisht".[35] Më tutje, "mjaft nga librat e shkollave grekofone, ishin shtypur larg çdo fryme kombëtare shqiptare, madje në kundërshtim dhe për rrezik të saj".[36] Po kështu, me synime shoviniste, propaganda greke, me klerikët grekomanë-ortodoksë, duke dyshuar se kongresi i ardhshëm shqiptar nuk do të kufizohej në problemet e arsimit, u përpoqën me lloj-lloj mënyrash ta minonin mbajtjen e tij. Jo vetëm kaq, por ata edhe problemin e shkollave mendonin ta zgjidhnin në përputhje me interesat e tyre fetare e politike, jo në mënyrë të pavarur, por në kuadrin e sistemit arsimor shqiptar dhe në atë masë sa t'i shërbente politikës demagogjike të regjimit të tyre dhe jo çështjes kombëtare shqiptare. Ndër masat e para të qarqeve shoviniste në këtë drejtim, ishin instruksionet telegrafike të cilat, udhëzonin autoritetet klerikale dhe qarqet filogreke të nënprefekturës së Korçës, më 3 korrik 1920, me anën

[30] *Po aty*.
[31] *Po aty*, fl. 17.
[32] *Shkëndija*, Korçë, 28 korrik 1920.
[33] B. Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi ...* , f. 319.
[34] *AQSH*, F. 195, V. 1920, D. 10, fl. 9.
[35] *Po aty*, fl. 11-12.
[36] *Po aty*.

e të cilave njoftoheshin se "kërkesat që të mësohej në gjuhën e vendit (greqishten - J.S.) është e drejtë",[37] prandaj ndër shkolla fillore dhe të mesme "të lejohej edhe mësimi i gjuhës greke".[38]

Përveç kësaj, nëpërmjet shtypit të tyre, parashikohej që mësimi i greqishtes të përfshihej "në programin mësimor zyrtar të shkollave fillore dhe të mesme" dhe mësuesit e gjuhës greke, që deri tani shpërbleheshin nga qarqet grekomane-ortodokse, "këtej e tutje të paguheshin nga buxheti shtetëror".[39] Sigurisht ky lëshim ishte rezultat i presionit të vazhdueshëm ndër vite të lëvizjes shoviniste greke, por njëkohësisht ai kishte si qëllim të ngjallte iluzione të reja e të bënte të panevojshëm mbajtjen e Kongresit të Lushnjes për shkollat. Gjithashtu, gazeta "Koha" dhe "Posta e Korçës" e ngritën me forcë këtë problem dhe i bënë presion qeverisë shqiptare të merrte masa të shpejta. "Koha" akuzoi dhespotin Jakov, se po zhvillonte propagandë dhe po bënte presion të madh që të ruheshin shkollat greke në Korçë,[40] duke u bërë "një pengesë për zhvillimin e shkollës shqipe në Korçë".[41] Po kjo gazetë shkruante se, "Shkollat janë të tonat, ne i kemi ndërtuar. Gjer dje nuk kishim shtet, kishim një komunatë (komunitet) dhe qenë të saj. Sot, meqenëse kemi shtet, janë të shtetit. Populli sot me një zë thërret kundër kësaj padrejtësie dhe kërkon drejtësi nga qeveria e tij.".[42]

"Këmbëngulja e qeverisë dhe institucioneve të tjera greke, - thekson Akademik Beqir Meta, - *për ruajtjen e këtyre shtyllave të helenizmit në Shqipërinë e Jugut ka qenë e jashtëzakonshme dhe ka vijuar gjatë gjithë periudhës së shtetit shqiptar deri në ditët e sotme".*[43] Ndërsa atdhetarët dhe intelektualët shqiptarë progresistë e vlerësuan të drejtë mendimin "për mbylljen e shkollave të huaja në Shqipëri dhe zëvendësimin e tyre me shkollat shqipe jo vetëm si një të drejtë të pakontestueshme por edhe si një masë themelore të plotësimit dhe konsolidimit të ndërgjegjes kombëtare shqiptare dhe në përgjithësi të ndërtimit të shtetit dhe institucioneve kombëtare".[44]

---

[37] *Po aty*, Fondi i Ministrisë së Punëve të Brendshme - nr. 152 (1919-1944), V. 1920, D. 42, fl. 25-26, Prefekturës së Korçës.
[38] *Po aty*.
[39] *Po aty*.
[40] B. Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi ...* , f. 346-347.
[41] *Historia e arsimit ...* , f. 384.
[42] "Jakovi dhe shkollat në greqisht" në: *Koha*, Korçë, 3 shtator 1921; Shih edhe: B. Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi ...* , f. 347.
[43] B. Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi ...* , f. 347.
[44] *Po aty*.

Një problem tjetër shqetësues ishte dhe "dhënia e mësimeve në mënyrë private në familje, të cilat pengonin zhvillimin e arsimit. Kështu, në qytetin e Gjirokastrës dhe në disa fshatra të kësaj krahine disa mësues që jepnin mësime në familjet shqiptare, jepnin jo vetëm gjuhën greke por edhe lëndë të tjera si, aritmetikë, gjeografi dhe histori të Greqisë".[45] Një performancë e tillë e mësimdhënies tek disa mësues, kishte shkaktuar rënien e numrit të nxënësve në shkollat e qytetit.

Pavarësisht se shteti shqiptar kishte një tablo pak a shumë të qartë të gjendjes së funksionimit të shkollave të minoritetit grek në Shqipëri, gjithashtu, u përpoq që të vepronte me kujdes dhe me një frymë kompromisi në marrëdhëniet e shtetit me fenë. Kjo gjeti shprehjen e vet në Statutin Kombëtar të Lushnjes (janar 1920), ku shkruhej se: "Shteti shqiptar nuk ka fe zyrtare ... Fetë e besimit kurrsesi nuk mund të përdoren për qëllime politike".[46] Kjo do të gjente pasqyrimin e vet dhe në marrëdhëniet shkollë-fe: Kuptohet se lëvizja për demokratizimin dhe laicizimin e shkollës ishte pjesë përbërëse e lëvizjes së përgjithshme për demokratizimin e shoqërisë shqiptare. Duhet theksuar se disa çështje mbi këtë pikë të rëndësishme, por edhe delikate, kishin lidhje me qëndrimin e parlamentit dhe të qeverisë, që në këtë kohë nuk përcaktuan qëndrimet e tyre.

Qëndrimi i qeverive shqiptare ndaj reformimit të sistemit arsimor në fillim të viteve '20, shfaqen si pjesë e formimit dhe qëndrimeve komplekse të anëtarëve të kabinetit, në të cilën dominonte fryma demokratike në vendimmarrje. Por, paralelisht, në politikën e tyre nuk mungonin elementët e modernizimit, aq të domosdoshëm për t'u afruar me Evropën. Mendojmë se, politika e shtetit shqiptar në pikëpamje formale ka qenë një politikë që synonte njësimin dhe laicizimin absolut të sistemit arsimor kombëtar, e shkaktuar nga nevoja praktike e modernizimit të një shteti, si dhe nga dëshira e tij për të kufizuar fuqitë politike të kundërshtarëve të mundshëm, të jashtëm dhe të brendshëm.

Gjatë kohës që bëheshin përgatitjet për organizimin e Kongresit, u shkëmbyen mjaft mendime lidhur me rendin e ditës së tij. Ato janë pasqyruar kryesisht në dokumentacionin arkivor të kohës dhe në shtypin shqiptar, cili shpesh herë i nënshtrohej censurës të elementëve reaksionarë e konservatorë. Mendimet e shprehura dhe që njohim deri më sot mund të ndahen në dy kategori: në atë që jepte mënyra të ndryshme se si do të zgjidheshin më mirë problemet e shkollës shqipe e

[45] *Po aty*.
[46] *Statuti i Shtetit Shqiptar*, Tiranë, 1922, f. 2.

të arsimit kombëtar, që përmbante programi i shpallur i Kongresit; si dhe në atë që kërkonte që kongresi të merrej me probleme që nuk i përmbante programi, por që lidheshin me interesat imediate të politikës shqiptare. Sipas konsultimeve të veprimtarëve për edukimin, "ana progresiste" i jepte "rëndësi të posaçme diskutimit të pikave të para",[47] që kishin të bënin me miratimin nga kongresistët për disa probleme të "përmbajtjes së programit, hartimin e teksteve shkollore dhe përdorimin e një gjuhe të njësuar në to".[48]Madje, kjo mospërputhje mendimesh e qëndrimesh për çështje të caktuara është vlerësuar si shprehje e "një lufte klasash në planin kombëtar".[49] Koha tregoi se sa rëndësi kishte mbajtja e një Kongresi të ri kombëtar për problemet e arsimit shqiptar, dhe sa të drejtë kishte Sotir Peci që mori iniciativën për një gjë të tillë.

Ndërkohë vazhdonin përgatitjet për organizimin e kongresit. Një rol të veçantë në këtë drejtim luajtën kryepleqtë e nënprefekturës të Lushnjes. Me anë të shtypit, kërkohet që çdo shqiptar të ndihmonte Kongresin "me aq sa mundet; kush me mënt, kush me fuqi, kush, me të holla, se të gjitha këto ndihma duhen për të mbaruar qëllimin".[50]

Kujdes të madh u tregua sidomos për zgjedhjen e delegatëve. Ministria e Arsimit insistoi që delegati që do të shkonte në Kongres të ishte "kompetent për çështjet shkollore".[51] Rrethet atdhetare në shkallë prefekture dhe nënprefekture, gjithashtu, kërkuan që të mos zgjidheshin delegatë ata persona, që dihej se kishin relacione me shtetet e huaja, me qëllim që t'i pritej rruga ndikimit të tyre në punimet e kongresit. Po ky mendim shprehej dhe nga Berati, me anën e një letre dërguar gazetës"Koha".Ministria e Arsimit u kujdes jo vetëm për të zgjedhur delegatët e vet, por edhe për ata që do të përfaqësonin krahinat e tjera shqiptare, ku ata kishin punuar apo punonin.

Gjatë përgatitjeve u ndeshën me vështirësi të ndryshme. Kështu, në Tiranë, si rezultat i veprimit të disa elementëve fanatikë e klerikëve konservatorë, të nxitur dhe të manipuluar nga veprimtarë, kundër shqipes e atdhetarëve, nuk ishte e lehtë të bëheshin përgatitje për Kongresin dhe, siç shkruante një bashkëkohës, "vështirë se do të

---

[47] Aleksandër Xhuvani, "Rëndësia e ditës së 28 nëntorit për arsimin kombëtar dhe përparimi i tij rrokull 16 vjetëve", në: *Përpjekja shqiptare*, nr. 3, Tiranë, 1936, f. 56-67.

[48]*Po aty*.

[49] Siri Shapllo, *Nga historiku i zhvillimit të arsimit në Shqipëri*, botim i Institutit të Studimeve Pedagogjike, Tiranë: 1975, f. 106.

[50]*Gazet' e Korçës*, Korçë, 23 qershor 1920.

[51]*AQSH*, F. 195, V. 1920, D. 9, fl. 9.

guxonte njeri të shkonte në Lushnje".[52] Ndërsa në Durrës, nuk u ndërmor ndonjë veprim konkret, aq më tepër që ndikonin negativisht elementët reaksionarë e konservatorë që vepronin në atë kohë.

Krahas zgjedhjes së delegatëve, kërkohej që njësitë vendore të prefekturës së Beratit të analizonin gjendjen e tyre financiare dhe të përdornin nevojat për shkollat dhe ç'ndihma mund të jepnin. Në një korrespondencë të botuar në gazetën "Gazet' e Korçës" thuhej: "Ditët afruan që të mblidhet Kongresi pedagogjik, të mestohet çashtja e arsimit e të shkollave",[53] prandaj kërkohej që përpara se të dërgoheshin delegatët të bëheshin "mbledhje në çdo qytet" dhe në rast se do të rezultonte se ndihma e parashikuar do të ishin të pamjaftueshme, i duhej drejtuar edhe qeverisë që të ndihmonte për Kongresin.[54] Gjithashtu, kërkohej që "të pasurit e Shqipërisë të ndihmonin më tepër arsimin kombëtar".[55]

Pasi u bënë përgatitjet e nevojshme, më 14 gusht 1920, pjesa më e madhe e delegatëve arriti në Lushnje, ku u prit me entuziazëm nga popullsia e qytetit së bashku me nxënësit e shkollave shqipe. Siç dëshmohet nga një delegat i Fierit, "më 14 gusht hymë në Lushnje, në një atmosferë të ngrohtë e të gëzueshme. Shumica e madhe e qytetit na kishte dalë përpara bashkë të shquarit e bashkisë edhe fëmijët e shkollave plotore, të cilët depërtonin erën me këngët e ëmbla që këndonin".[56]Pasi"u mbajt një fjalë e shënuar për mirë se arthtë" nga një vendas atdhetar (Besim Nuri, Kryetari i Bashkisë Lushnje - J.S.), u nisëm të gjithë tok drejt shkollës plotore të qytetit ku ishin gati të gjitha lehtësirat për miq udhëtar".[57] Duke shprehur ndenjat dhe emocionet për këtë pritje të veçantë, Naun Prifti (Doko) një nga delegatët e Kongresit, ka shkruar: "Brohoritje dhe përshëndetje shpërthyen nga turma që na priste në hyrje të qytetit. Nuk kam ndierë aq shumë emocion, se sa në atë çast".[58] Një bashkëkohës i huaj që u ndodh atë ditë në Lushnje ka shkruar: "Lushnja është në festë, delegatët nga të gjithë anët e Shqipërisë erdhën sot dhe pritet që nesër të arrijnë përfaqësuesit e viseve më të largëta. Dëshira për të mësuar, e ndaluar prej shumë

[52]*Populli,* Tiranë, 11 gusht 1920
[53]*Gazet' e Korçës*, Korçë, 30 qershor 1920.
[54]*Po aty*.
[55]*Po aty*.
[56]*AQSH*, Fondi i Naun Prifti (Doko),V. 1922, D. 1, fl. 19-22.
[57]*Po aty*.
[58]*Po aty*.

kohësh nga Turqia, është një manifestim i karakterit shqiptar. Ne u prekëm kudo ... nga qëndrimi krenar dhe mikpritës e shqiptarëve".[59]

Në Lushnje, dita e parë e çeljes së Kongresit u shoqërua me një ceremoni festive kombëtare, masive dhe entuziaste, ku u mbajtën fjalime dhe u brohorit për lirinë dhe për përparimin kombëtar. Duke përmendur Kongresin Arsimor të Lushnjes, në një dokument të kohës shkruhej: "Faktojmë hapjen e kongresit pedagogjik e dhashtë pemë të mira dhe të bukura për lulëzimin e arsimit atdhetar. Lushnja u bëftë fole përparimi kombëtar, e kongresistëve u lusim zell e mend duke uruar jetë e shëndet".[60] Kjo ishte "shenjë mbarësie dhe përparimi".[61]

Në një atmosferë të tillë përzemërsie, filloi punimet më 15 gusht 1920, ora 9 paradite, Kongresi Arsimor i Lushnjes, i cili vazhdoi 9 ditë, deri më 24 gusht.[62] Fakti që Kongresi Arsimor u mbajt pas gjashtë muajsh pas Kongresit Kombëtar të Lushnjes, tregon se ky i fundit nuk e ndryshoi ecurinë e politikave arsimore dhe as vendimin e marrë qysh më parë për të organizuar një Kongres të ri kombëtar në Lushnje dhe se vendimet e tij, u morën parasysh nga rrethet e atdhetarëve shqiptarë.

Pasi u bë përshëndetja e Ministrisë së Arsimit, në emër të delegatëve, të pranishmit i përshëndeti Dhimitër Mborja, delegat i Korçës dhe Gaspër Mikeli, delegati i Shkodrës.[63] Në Kongres morën pjesë 12 delegatë - veprimtarë e intelektualë të njohur të arsimit e të Lëvizjes Kombëtare, si: Aleksandër Xhuvani, Ahmet Gashi, delegatë të Elbasanit; Ilia Dilo Sheperi, Thoma Papapano, Pertef Pogoni, delegatë të Gjirokastrës; Gasper Mikeli, Ndue Paluka, Kol Margjini, Zef Fekeqi, delegatë të Shkodrës; Dhimitër Mborja, Aleko Kondili, delegatë të Korçës; Ismail Anamali, Mihal Bellkameni, delegatë të Pogradecit etj.[64] Në sallën e Kongresit, gjithashtu, ndodheshin edhe disa mësues myzeqarë, midis të cilëve mund të përmendim: Ikonom Kozma Dhima, Elmaz Boce, Anastas Laska, Naun Prifti (Doko), Theodhor e Aleko Rista, si dhe organizatorët Jani Mingae Tefik Zoto.[65]

Krahas intelektualëve përparimtarë që kishin peshën kryesore, në Kongres merrnin pjesë edhe atdhetarë nga shtresat e pasura të qytetit. Hapja e Kongresit Arsimor të Lushnjes u bë në godinëne shkollës

[59] *Drita,* Gjirokastër, 19 gusht 1920.
[60] *AQSH*, F. 195, V. 1920, D. 9, fl. 21.
[61] *Po aty*.
[62] *Po aty*, D. 2, fl. 3-6.
[63] *Po aty*.
[64] *Po aty*.
[65] Petraq Dhana, *Arsimi dhe kultura në Myzeqe (1912-1990),* Tiranë: Morava, f. 152.

plotore të qytetit.Për drejtimin e kongresit, u zgjodh një kryesi, e drejtuar nga Aleksandër Xhuvani - kryetar.

Ashtu siç ishte parashikuar në rendin e ditës të shpallur qysh më parë, në qendër të vëmendjes për seancat publike të Kongresit Arsimor të Lushnjes, ishin problemet e zhvillimit dhe të organizimit të arsimit kombëtar. Diskutimet u përqendruan më tepër rreth problemeve kryesore: 1) për krijimin e një sistemi arsimor, struktura dhe përmbajtja e shkollës; 2) për organizimin dhe drejtimin e shkollës; 3) për hartimi e planeve, programeve dhe teksteve shkollore; për ngritjen profesionale të mësuesve dhe përmirësimi i gjendjes materiale dhe statusit shoqëror të tyre; 4) për standardizimin e terminologjisë pedagogjike-shkollore; dhe 5) për shumë çështje të tjera didaktike dhe organizative për bashkërendimin më të mirë të veprimtarisë arsimore në shkallë prefekture dhe nënprefekture.[66] Për t'i analizuar ato në detaje, për të përcaktuar masat konkrete dhe për të hartuar rregulloret përkatëse u krijuan komisionet, të përbërë nga intelektualë përparimtarë dhe profesionistë në fushën e edukimit.

Problemi i parë që shqyrtoi Kongresi, që në ditën e dytë të punimeve të tij, ishte ai i shkollës shqipe dhe i arsimit kombëtar, "pika më e rëndësishme e të cilit", siç shkruante Naun Doko, ishte "ngritja e një Këshilli të Epërm Arsimor të përbërë prej dy fijeve të Shqipërisë".[67] Një pjesë e delegatëve shfaqën mendimin që Këshilli të përfshihej në strukturën organizative "të Ministrisë së Arsimit - shkalla më e lartë e arsimit publik".[68] Lidhur me këtë, në Kongres u diskutua për rëndësinë e një projekt-rregulloreje të Këshillittë Epërm Arsimor, e cila do të përpunohej nga një komision i formuar për këtë qëllim, pas përfundimit të Kongresit. Në këtë projekt-rregullore, për Këshillim Arsimor parashikohej mënyra e drejtimit, personeli pedagogjik dhe ndihmës i tij, si dhe mënyra e organizimit në të. Në të duhet të bënin pjesë "persona që gëzojnë emër të mirë",[69] me aftësi dhe mundësi praktike "për të kryer detyrën e ngarkuar".[70]

Problemi i dytë i rëndësishëm, që u diskutua në Kongres dhe që lidhej drejtpërdrejtë me problemin e ristrukturimit të institucioneve drejtuese në njësitë vendore dhe përgjithësisht me atë të Drejtorive të

[66] *AQSH*, F. 195, V. 1920, D. 9, f. 3-9.
[67] *Po aty*, Fondi i Naun Prifti (Doko),V. 1922, D. 1, fl. 19-22, Kujtime për Naun Priftin nga Jorgji Xoxa.
[68] *Kumtari arsimuer*, nr. 3-4 / 1921, Elbasan, qershor 1921, f. 34.
[69] *AQSH*, F. 195, V. 1920, D. 9, fl. 3-9.
[70] *Po aty*.

Arsimit, ishte ai që kishte të bënte me pezullimin e tyre, "ndërsa punën e tyre ta kryejnë inspektorët e arsimit".[71] Në parim, të gjithë delegatët ishin dakord për krijimin e inspektorive, që do të merreshin vetëm me problemet e shkollës dhe të arsimit në shkallë njësie vendore. Kongresi për këtë qëllim, paraqiti për diskutim hartimin e një rregulloreje, që do të zbardhte funksionet dhe kompetencat që ajo do të kishte gjatë ushtrimit të detyrës, si një nga institucionet drejtuese më të rëndësishme që do të ngriheshin pranë njësive vendore të Shqipërisë.

Në seancën e katërt, më 16 shtator, delegatët e Kongresit morën në shqyrtim çështjen e shkollave fillore, organizimin e tyre më të mirë, si dhe zgjedhjen e numrit të nxënësve në shkollë. Lidhur me këtë u paraqit për diskutim hartimi i projekt-rregullores për shkollat fillore, që parimisht ishte diskutuar nga komisioni organizator i Kongresit. Për këtë problem të rëndësishëm, që kishte të bënte jo vetëm me çështje arsimore, por edhe me organizimin e drejtimin e gjithë sistemit arsimor kombëtar, pati mjaft diskutime. Që në fillim disa delegatë e diskutuan atë pjesë të programit të përgjithshëm të shkollave fillore, ku shkruhej për strukturën me "katër ose pesë klasëshe" dhe ato "tre klasëshe për ato të fshatit".[72]

Duhet thënë se, hartimi i programit mësimor sintetik parashikonte të përdorej "për shkollat fillore e qytetëse*",[73] ndërsa programi mësimor analitik, "për shkollat fillore 4 ose 5-klasëshe të qytetit dhe 3-klasëshe për ato të fshatit".[74] Në këtë kontekst, të gjithë delegatët që gjendeshin në këtë kuvend do të përpiqeshin për t'i mënjanuar ato dhe për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve për arsimim. Planet mësimore të shkollave fillore, të miratuar nga Ministra e Arsimit, ishin të një niveli me ato të shkollave fillore evropiane të asaj kohe. Në përshtatje me kushtet e atëhershme politike e fetare, në planin mësimor të shkollave fillore mendohej të përfshihej edhe mësimi i fesë (myslimane, ortodokse e katolike) sipas besimit që kishin nxënësit. Propozimi i bërë në Kongres, që në shkollën fillore të "mos jepej mësimi i fesë, nuk gjeti shumicën e nevojshme",[75] të pranishmëve në sallë.

[71] *Po aty*.
[72] *Po aty*.
* Shkollat qytetëse ishin me 3 klasë mbi filloren.
[73] *AQSH*, F. 195, V. 1920, D. 9, fl. 3-11.
[74] *Po aty*.
[75] *Po aty*.

Me gjithë debatet e zhvilluara për çështje të veçanta, delegatët e Kongresit vendosën që "shkolla fillore pesëklashëse të bëhej e detyruar"; që "shkollat me më pak se 40 nxënës të mbyllen"; që "secili qark të ketë mësues "endës ... qi të mësojnë fëmit e atyne katundeve, qi janë pa shkollë".[76] Kjo përbënte një fitore të rëndësishme për forcat arsimdashëse demokratike, sepse ato qëndronin në pozita të drejta politike dhe kishin qenë vazhdimisht në krye të lëvizjes për reformimin e arsimit kombëtar.

Gjatë zhvillimit të punimeve, Kongresi miratoi njëzëri vendimin që "mësuesit endës do të kenë shtesë rroge"; që "mësuesit të cilët mbeten pa punë, por që mund të punojnë, mund të vijojnë një kurs në normalen, si bursistë të shtetit, i cili do të hapet në fillim të vitit shkollor"; që "shkalla e rrogave të mësuesve do të jetë e kategorizume[**] ma mirë se ajo e nëpunësve të Shtetit"; që "të merret në konsideratë edhe vjetët e shërbimit dhe aftësi e mësuesve"; që "të themelohet një fond e nji ligjë pensionesh për mësues".[77] Kongresi duke iu përgjigjur nevojave të zhvillimeve arsimore në rritje, të organizuar në shkallë kombëtare me anë të diskutimeve, u vendos që "së paku një herë në vit të mblidhen të gjithë inspektorët në kryeqytetin (Tiranë) për të trajtuar çështje të ndryshme të arsimit".[78]

Një vendim tjetër i rëndësishëm i Kongresit Arsimor 1920, që kishte të bënte me forcimin e mëtejshëm të lidhjeve të bashkëpunimit ndërmjet arsimtarëve, shkollave dhe njësive vendore për "themelimin e një këshilli shkollor në çdo inspektori",[79] i përbërë: "së pari, prej prefektit (nënprefektit) ose zëvendësi i tij, kryetari i dy këshilltarëve të bashkisë, inspektori, prifti apo hoxhës së vendit; së dyti, do të jetë e përbërë prej më të vlefshmit drejtor të një shkolle të vendit, prej priftit a hoxhës a prej dy myftarëve të vendit".[80]Në një pikë të këtij vendimi

[76]*Po aty*.

[**]Në "*kategorinë e I-rë*, përfshiheshin të gjithë ata mësues që kishin mbaruar universitetin, *kategoria e II-të*, mësuesit me Normale ose me shkollë më të lartëseajo; *kategoria e III-të*, mësuesit me normale evropiane ose me gjimnaz, por që kanë përvojë të gjatë pune; *kategoria e IV-të*, mësuesit me normale fillore të Turqisë ose me gjysëmgjimnaz turqisht të mbaruar me kurs të shpejtë, ose qytetëse greke me praktikë; *Kategoria e V-të*, mësuesit që kanë mbaruar qytetëse shqip a turqisht". (Marrë nga: *AQSH*, F. 195, V. 1920, D. 2, fl. 6-8).

[77]*AQSH*, F. 195, V. 1920, D. 9, fl. 3-9.

[78]*Po aty*.

[79]*Po aty*.

[80]*Po aty*,pika 30.

thuhej: "Ky këshill do të përkujdeset pikësëpari për ndërtimin dhe pajisjen e shkollave që themeloheshin prej prefekturës; të kontrollonte shkollat që themeloheshin prej krahinave, komuniteteve dhe prej njerëzve të veçantë; të nxitë dhe të inkurajonte zhvillimin e arsimit në vend;të mbështeste dhe të ndihmonte mësuesit, të cilët nuk kishin mundësi të mbanin veten. Të shfaq mendimin e vet mbi ligjet dhe urdhëresat që i përkisnin arsimit; të vinte në zbatim urdhrat dhe vendimet që siguronin rrjedhën e mirë të problemeve të arsimit si dhe urdhrat që jepeshin prej Ministrisë së Arsimit për këto çështje, të përpiqej të ndërtoheshin shkolla të reja në ato vende ku mungonin. Të mbikëqyrte administrimin e fondeve të formuara nga të ardhurat e njësive vendore.[81]

Sipas gazetës "Koha", shpirti i Kongresit dhe i Shqipërisë ishin tre vendimet e tjera që lidheshin me dokumentacionin shkollor dhe unifikimin e tij, si: ditari, libri i amzës, libri i kronikës së shkollës, protokolli i punëve zyrtare etj.[82] Vendin kryesor në vendimet e Kongresit e zinin problemet që lidheshin me tekstet shkollore. Me gjithë debatet e zhvilluara për këtë çështje, delegatët e Kongresit vendosën që, "pasi deri sot nuk kemi as gjuhë letrare as libra të kuptueshëm prej të dy fiseve shqiptare, për këtë vit shkolluar si në Gegni ashtu edhe në Toskëni do të përdoren abetaret që janë përdorur vjet ... ".[83] Kurse për klasat e tjera u vendos "të përdoren librat e Komisisë Letrare ose ato që janë botuar në Elbasan".[84]

Në vendimet e Kongresit parashikoheshin edhe masa në të mirë njësimit të gjuhës së shkruar dhe të krijimit të gjuhës së përbashkët letrare shqipe, gjë që diktohej si nga shkalla e zhvillimit ekonomiko-shoqëror e kulturor të vendit, ashtu edhe nga nevoja e rritjes së mëtejshme e lëvizjes arsimore e përgjithësisht asaj kombëtare. Ndonëse nuk u morën, dhe në ato kushte nuk mund të merrej, një vendim i prerë për këtë çështje, ka rëndësi fakti që Kongresi e diskutoi këtë problem të rëndësishëm kulturor e politik, që përfshihej në rend të ditës dhe që preokuponte rrethet atdhetare e intelektuale shqiptare dhe i dha atij një zgjidhje të përshtatshme për rrethanat e atëhershme të vendit tonë. Duke vlerësuar lart këtë moment, revista "Kumtari arsimuer" shkruante: "në

[81] *Po aty*.
[82] *Koha*, nr. 5, Korçë, 18 shtator 1920.
[83] *AQSH*, F. 195, V. 1920, D. 9, f. 3-11; Shih edhe: *Kumtari arsimuer*, nr. 2 / 1921, Elbasan, prill, 1921, f. 31.
[84] *Po aty*.

punën e Kongresit Pedagogjik të Lushnjes zuri vend edhe puna për standardizimin e "skajeve teknike", të terminologjisë shkollore (gramatikore) në gjuhën shqipe. Duke u mbështetur në terminologjinë përkatëse në gjuhë të huaja, në Kongres u trajtuan një varg termash nga burimet e shqipes si: fjalia, tingulli, zanorja, bashkëtingëllorja, dyzanori, germa, shkronja, i shquem, i pashquem, shkalla pohore, krahasore, sipërore, përemrat, foljet, kohët e foljes, rranja, mbaresa, parashtrimi, prapashtimi, ndajfoljet, lidhëza, pasthirrma, pikësimi, pika, presja, pikëpresja, kllapa etj. Duhet theksuar edhe pse Kongresi për "skajet teknike" nuk vendosi në mënyrë të prerë,[85] shumë prej tyre përdoren edhe sot. Kongresi shtroi nevojën për "botimin e një reviste pedagogjike".[86]

Në pikat 14 dhe 15 të vendimeve parashikohej që "nxënësit, përveç festave të njohura[*], të kenë dy ditë pushimi në javë (nxënësit mysliman të premten, nxënësit e krishterë të dielën, si dhe një ditë tjetër apo dy gjysma ditësh).[87]

Gjithashtu, vendim i rëndësishëm i Kongresit ishte ai "për nga një internat (konvikt) për nxënësit në Korçë, në Gjirokastër, në Berat, në Elbasan, në Tiranë e Shkodër",[88] i cili përbënte pikën e 25 të vendimeve. Sipas parashikimeve të delegatëve të Kongresit, këto

[85] *Kumtari arsimuer*, nr. 1 / 1921, Elbasan, prill, 1921, f. 11.
[86] *Po aty*, nr. 3-4 / 1921, Elbasan, qershor, 1921, f. 35.
[*] *AQSH*, F. 195, V. 1920, D. 9, fl. 11-14. "Si të kremte kombëtare fetare ditë të cilat do të mbaheshin mbyllur shkollat u caktuan: A. Për katolikët: Dita e parë e vitit. Dita e gjashtë e janarit (uji i bekuar).Dita 19 mars (Shën Jozefit). Dita 25 mars. Dita 29 qershor (Shën Pjetri e Pali). Dita 15 gusht (të ngjiturit e zonjës në qiell). Dita 1 nëntor (të gjithë të shenjtat). Dita 8 dhjetor (Zonja e papërlyeme). Krishtlindjet (24-27 dhjetor). Pashkët, 6 ditë. Dita e Shelbuenit etj.; B. Për ortodoksit: Dita e parë e vitit (Shën Vasili). Dita 6-7 janar (Shën Joan Pagëzorit. Dita e tre irarkve. Dita 25 mars. Dita e 6 majit (Shën Gjergji). Dita 21 maj. Dita 8 shtator (Lindja e Shën Mërisë) Dita 8 nëntorit (Shën Mëhillit). Dita 21 nëntor. Dita 6 dhjetor (Shën Kolli). Krishtlindjet, 4 ditë (24-27 dhjetor). Pashkët, 6 ditë. Dita e Shelbuemit. E hëna e Rrshajvet. Dita e Kishës së vendit. Si e kremte kombëtare u njohën: Dita e flamurit (28 nëntor) dhe Dita e fronit (7 mars). C. Për Myslimanët: Kurban Barjami, 5 ditë. Ramazan-Bajrami, 3 ditë. Mevludi, 3 ditë. Nata e Galipit, 1 ditë. Nata e Mirazhit, 1 ditë. Nata e Kadrit, 1 ditë dhe Nata e Novruzit, 1 ditë. Në kohën e Ramazanit u nda, që mësimet të bëhen 3 orë në ditë, duke mësuar vetëm lëndët më të nevojshme. Caktimi i orëve, u la në dorë të inspektorit e të mësuesve. Dy ditë para Ramazanit – Bajramit, u la që të mos bëhet mëim".
[87] *Po aty*, F. 195, V. 1920, D. 9, fl. 3-11; Shih edhe: *Kumtari arsimuer*, nr. 1/1921, Elbasan, prill, 1921, f. 11-12.
[88] *Po aty*.

konvikte duhet të organizoheshin në mënyrë të tillë që "të pranonin fëmijët mendorë shtëpiash së ndershme në parqe të qyteteve të lartpërmendur, që s'kanë rastin të ndjekin një shkollë (të ngutshme) në vend të vet. Nga numri i nxënësve që ndjekin internatet, do të zgjidhen ata që bëhen mësues edhe nëpunës të tjerë të shtetit, dikush duke ndjekur shkollat e mesme të vendit, dikush duke u dërguar në shkollat e përshtatshme".[89]

Ashtu siç u vendos në Kongres, në pasdreken e ditës së fundit, vendimet e tij u shpallën në mënyrë solemne përpara delegatëve dhe përfaqësuesve të komunitetit vendas, si dhe priti me entuziazëm fjalimet që u mbajtën me atë rast. Vendimet e Kongresit Arsimor të viti 1920, u mirëpritën kudo në Shqipëri dhe nga shqiptarët e mërguar. Për problemet që shqyrtoi dhe zgjidhi, për vendimet që mori e ndikimet pozitive që pati në zhvillimin e përparimin e mëtejshëm të vendit, Kongresi Arsimor i vitit 1920 përbën një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e arsimit dhe të mendimit pedagogjik shqiptar. Ajo ishte shprehje e aspiratave të politikës kombëtarizuese të qeverisë shqiptare dhe e përpjekjeve për përmbushjen e aspiratave për njësimin, unifikimin dhe standardizimin e shkollës në strukturë, në përmbajtje dhe metodë.

2. Masat e qeverisë shqiptare për jetësimin e vendimeve të Kongresit Arsimor të vitit 1920

Vështirësitë e shumta materiale e politike dhe mungesa e përvojës kompensoheshin me atdhetarizmin dhe optimizmin e shqiptarëve, me punën e palodhur e sakrifica të mëdha. Atdhetarët shqiptarë u treguan të gatshëm për të dhënë ndihmesën e tyre me atë çka kishin mundësi dhe për të vënë në jetë vendimet e Kongresit Arsimor të Lushnjes. Kështu, pas përfundimit të punimeve të Kongresit Arsimor, pas shumë përpjekjesh puna e nisur filloi të japë fryte. Në rrafshin kombëtar arsimi shënoi disa suksese, siç ishin formimi pranë Ministrisë së Arsimit i Inspektoratittë Përgjithshëm dhe Këshillit të Epërm Arsimor (Komisia Letrare) me vendim të Këshillit Kombëtar, më 8 shtator 1920.[90]E rëndësishme është të theksohet se Këshilli i Epërm Arsimor i drejtuar nga Aleksandër Xhuvani, kishte si qëllim trajtimin e të gjitha problemeve të përmbajtjes, duke përfaqësuar mendimin e specializuar pedagogjik në këtë fushë parësore të shkollës.

[89] *Po aty*.
[90] Sheremet Krasniqi, *Komisja Letrare e Shkodrës (1916-1918)*, Prishtinë: 2004, f. 163.

Në këtë kontekst, më 18 shtator 1920, Ministria e Arsimit i ngarkoi Këshillit të Epërm Arsimor një varg detyrash konkrete siç ishin: hartimi i programeve arsimore për shkollën fillore, qytetëse etj.; hartimi i rregullores për detyrat e inspektorive të arsimit dhe mënyrën e inspektimit; hartimi i rregullores për detyrat e drejtorive dhe mënyrën e inspektimit; hartimi i rregullores për detyrat e drejtorive të shkollave, të mësuesve dhe të shërbëtorëve; përcaktimi i masave disiplinore brenda shkollës; vlerësimi i doreshkrimeve të paraqitura për tekstet shkollore; hartimi i librave shkollorë; përcaktimi i "skajeve teknike"; angazhimi "për botimin e një të përkohshmeje pedagogjike".[91] Këshilli detyrohet që "një herë ndë muej ka me mbajtën ji mbledhje të përgjithshme, ndër të cilën kanë me ndodhë titullarët e kësa Ministrije dhe njerës të tjerë kompetentë të caktuemë e të ftuemë prej tij".[92]

Ndër të tjera, Këshilli i Epërm Arsimor përmirësoi programet shkollore me një hyrje metodike për çdo lëndë mësimi për shkollat fillore, përgatiti për botim abetaren dhe këndimin e klasës së dytë, përgatiti një projektligj mbi organizimin e përgjithshëm të arsimit dhe rregullores përkatëse. Më vonë filloi të hartojë një seri projektligjesh dhe tekstesh shkollore.[93]

Në vitet shkollore 1920-1921 dhe 1921-1922, u zbatua plani dhe programi i shkollave austriake, që doli nga Kongresi Arsimor i Lushnjes. Para së gjithash, kishin rëndësi miratimi i një varg ligjesh arsimore dhe rregulloreve, më 1921, për krijimin dhe përhapjen e sistemit arsimor shqiptar me përmbajtje e karakter kombëtar, duke vënë në themel të tij parimin e madh të atdhetarizmit e të shqiptarizmit për njësimin e shkollës shqiptare. Ato u përmblodhën në një paketë ligjore me titull: "Ligjet dhe rregulloret e Ministrisë së Arsimit Botuer", të miratuar nga Këshilli i Lartë, më 26 nëntor 1921,[94] dhe botuar nga Ministria e Arsimit Botuer, më 1922. Nëpërmjet kësaj pakete ligjore, ligjvënësit shqiptarë hodhën themelet e para të legjislacionit shkollor në Shqipëri. Ato ishin:

- Rregullore nr. 1131/11, datë 7.4.1921*
- Ligji mbi emërimin dhe shpërnguljen e mësuesve (21 nëntor 1921);

[91] *Kumtari arsimuer*, nr. 1/1921, Elbasan, prill, 1921, f. 12.
[92] *Po aty*, f. 2.
[93] S. Shapllo, *Nga historiku ...* , f. 100.
[94] *AQSH*, F. 195, V. 1921, D. 13, fl. 1,"Ligjet dhe rregulloret e Ministrisë së Arsimit Botuer", datë 26.11.1921.

* Kjo rregullore parashtron funksionet e inspektoratit, detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorëve të shkollave, të mësuesve dhe të nxënësve.

- Ligji mbi ngritjen dhe mbajtjen e ndërtesave shkollore (21 nëntor 1921);
- Ligji mbi organizimin qendror të Ministrisë së Arsimit (26 nëntor 1921);
- Ligji mbi organizimin themelor të Ministrisë së Arsimit (26 nëntor 1921);
- Ligji mbi të ndjekurit e detyrueshëm të shkollës (26 nëntor 1921);
- Ligji mbi taksat shkollore (26 nëntor 1921);
- Ligji mbi bursat kombëtare (26 nëntor 1921).

Gjithashtu, Këshilli i Epërm Arsimor bëri punë me vlerë edhe për hartimin dhe vlerësimin e teksteve shkollorë. Vlerësimet, vërejtjet, sugjerimet për dorëshkrime të teksteve, Këshilli i botonte në revistën "Kumtari arsimuer" (1921), me të cilat kishte mundësi të njihet edhe opinioni i gjerë. U hartua Abetarja, Këndimi për kl. II, Kl. III dhe kl. IV, të shkollës fillore.[95] Ato u hartuan në të folmen e Elbasanit.

Në vitin shkollor 1920-1921, Shqipëria kishte 452 shkolla fillore e foshnjore dhe 647 mësues gjithsej.[96] Në disa qytete punonin edhe disa shkolla qytetëse 2-3 klasëshe. Rihapja e Normales së Elbasanit dhe të Liceut të Korçës, më 20 gusht 1920, ishin një tjetër vendim i qeverisë së dalë nga Kongresi i Lushnjes, si të vetmet shkolla të mesme në vend.[97]

Gjithashtu, qeveria shqiptare, krahas hapjes së shkollave shqipe shtetërore lejoi të funksiononin edhe shkollat private, por ai ishte i kushtëzuar. Në shtator të vitit 1920, Ministria e Arsimit nxori një urdhëresë me anën e së cilës caktoheshin kushtet e ekzistencës së shkollave private. Këto kushte qenë:

1. "Leja zyrtare nga ana e qeverisë shqiptare për çështjen e shkollës.
2. Përdorimi i gjuhës shqipe si gjuhë mësimi.
3. Kontrolli i programeve, i librave shkollorë dhe i titujve të studimit të personelit mësimor.
4. Nënshtrimi i plotë ndaj shtetit".[98]

Në paragrafin e parë të urdhëresës së Ministrisë së Arsimit thuhej, "se ndjekja e shkollave shqipe ishte e detyrueshme për fëmijët shqiptar".[99]

---

[95] *AQSH*, F. 195, V. 1921, D. 13, fl. 4-12.
[96] *Po aty*; Shih edhe: Tek Selenica, *Shqipënia më 1927*, vëll. I, Tiranë, 1927, f. 64.
[97] Hajrullah Koliqi, *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar*, Prishtinë: Libri Shkollor, 2002, f. 348.
[98] *AQSH*, F. 195, V. 1920, D. 10, fl. 78-79.

Në kuadrin e zgjerimit të rrjetit shkollor, në fillim të vitit 1920, në Shqipëri filluan të operonin edhe organizata misionare amerikane. Kështu, po atë vit një mision amerikan mori përsipër ngritjen e një jetimore në qytetin e Korçës; Kenedi dhe e shoqja vazhduan të mbanin shkollën e vajzave të Korçës gjatë vitit 1920 dhe 1921.[100] Shkolla të tjera shqiptaro-amerikane u hapën edhe në Tiranë e Elbasan.

Përgatitja dhe niveli i personelit arsimor të periudhës 1921-1922 ka qenë mjaft e larmishme dhe në shumë raste e ulët, fenomen ky që influencoi negativisht në punën arsimore, e metë tjetër në themel të punës mësimore ka qenë mungesa e përgatitjes tekniko-profesionale e mësuesve. Në këtë kontekst, për aftësimin profesional të mësuesve të shkollës fillore, të cilët nuk kishin arsim përkatës, Këshilli i Epërm Arsimor hartoi një projekt. Sipas këtij projekti, kandidatët që nuk tregonin sukses të kënaqshëm në një provim prej disa lëndësh, parashikohej të vijonin një kurs pedagogjik njëvjeçar, me të suksesshmit parashikohej të vijonin një kurs tjetër prej 3-6 muaj, ndërsa kandidatët mësues që ishin më të dobët në provim parashikohej të largohen nga detyra. Kursi pedagogjik parashikohej të mbahej në Elbasan dhe kishte këto lëndë: pedagogji dhe didaktikë, gjuhë shqipe, matematikë, histori dhe gjeografi, vizatim dhe bukurshkrim, dituri natyre, gjimnastikë dhe muzikë.[101]

Më 18 dhjetor 1920, Ministria e Arsimit i dërgoi një shkresë Këshillit të Epërm Arsimor, ku ndër të tjera kërkohej "nxjerrja e një reviste pedagogjike kombëtare".[102] Këshilli i Epërm Arsimor e miratoi daljen e revistës pedagogjike "Shkolla e Re" në Shkodër.[103] Kjo ishte e para revistë pedagogjike shqiptare, ku u botuan materiale studimore teorike dhe praktike në fushën pedagogjike-arsimore. Ajo luajti rol të rëndësishëm në ngritjen e nivelit profesional të arsimtarëve. Numri i parë i saj doli në Tiranë, ndërsa numrat e tjerë dolën në Shkodër.

Marrë në tërësi, në Kongresin Arsimor të Lushnjes dhe pas tij, qeveria shqiptare dhe organizmat e saj, bënë përpjekje për unifikimin e sistemit arsimor, përmes një administrimi të thjeshtë si në qendër, ashtu edhe në qarqe, dhe për ngritjen cilësore të tij. E gjithë kjo shënon një hap cilësor në riorganizimin e sistemit të arsimit kombëtar.

---

[99] *Po aty*.
[100] Joan Fultz-Kontos, *Kryqi i Kuq, Shqiponja e Zezë - Biografi e Shkollës Teknike Shqiptaro-Amerikane të Tiranës*, Tiranë: Shtëpia Botuese Enciklopedike, 1994, f. 25.
[101] *Kumtari arsimuer*, nr. 2/1921, Elbasan, prill, 1921, f. 47.
[102] *AQSH*, F. 195, V. 1920, D. 12, fl. 1-2.
[103] *Po aty*.

Ndërkohë, me ndihmën e Kryqit të Kuq të Rinisë Amerikane, përfaqësuesit e të cilit erdhën në Shqipëri qysh në muajin shkurt 1919, "më 21 korrik 1921, Ministria e Arsimit me qarkoren nr. 1798/VI, bënte me dije hapjen e Shkollës Teknike Amerikane në Tiranë me nxënës të moshës 6-14 vjeç".[104] Gjatë 12 vjetëve të ekzistencës së saj (1921-1933), Shkolla Teknike nxori 185 specialistë për agronomi, teknikë, mekanikë (elektrik, motor, metalprerje, tipografi, ndërtim etj.) dhe mësuesi.[105]

Në vitin 1921, mbi bazën e shkollës fratnore të vitit 1861, hapet Gjimnazi "Illyrikum" i françeskanëve në Shkodër.[106] Kjo shkollë ishte e tipit perëndimor, e cila financohej dhe mbikëqyrej nga shteti. Drejtori i parë i saj ishte At Gjergj Fishta.Një vit më vonë, më 1922, hapet Gjimnazi i Shtetit dhe Shkolla Normale e Motrave Stigmatine në Shkodër. Në këtë periudhë hapen edhe shkolla të tjera, ndër të cilat edhe Shkolla-konvikt "Kosova".[107]

Në fund të vitit shkollor 1921-1922, në Shqipëri numëroheshin 574 shkolla gjithsej, prej të cilave 3 shkolla të mesme, 12 qytetëse, 519 shkolla fillore, 4 kopshte, 36 shkolla të minoritetit grek. Gjatë kësaj periudhe, në këto shkolla vijonin mësimet 25.197 nxënës, 5.889 prej tyre ishin vajza, dhe punonin 863 mësues gjithsej.[108]

Viti mësimor 1922-1923, që duhej të fillonte në kushte më të mira sepse kishte në themel vendimet e Kongresit Arsimor të Tiranës (22 korrik - 2 gusht 1920) për demokratizimin e shkollës, për njehsimin e punës mësimore etj., nuk solli progres të dukshëm. Kjo lidhet edhe me ndryshimet politike në Shqipëri. Kryeministri i asaj kohe shpalli se "në qeverinë e tij nuk do të kishte shumë mësues, po ata që do t'i kishte, do të qenë të merituar".[109] Vetëm pak ditë pas shpalljes së programit të qeverisë, parlamenti shqiptar komunikoi mbylljen e 100 shkollave fillore.[110] Arsyet e mbylljes ishin të ndryshme. Fjala vjen, si shkak për mbylljen e shkollës së Dajçit të Zadrimës ishte: "Nuk ka ndërtesa e as orenditë e nevojshme e mos vijim të nxanësish".[111]

---

[104] Iliaz Gogaj, *Shkolla Teknike dhe Harry Trevlye Fultz*, Tiranë: Kumi, 2010, f. 29.
[105] *Po aty*, f. 274.
[106] H. Koliqi, *Historia e arsimit ...* , f. 351.
[107] *Po aty*.
[108] *AQSH*, F. 195, V. 1922, D. 14, fl. 1-7; Shih edhe: Xhevat Repishti,*Lëvizja sindikale e mësuesve shqiptarë në vitet 1921-1924*, Tiranë: 1974, f. 13.
[109] *Arsimi Popullor*, nr. 6 / viti 1962, Tiranë: 1962, f. 43.
[110] *Po aty*.
[111] Ilir Kanini, "Arsimi në Krahinën e Lezhës në vitet 1920-1924", në: *Historia e*

Edhe prefektura e Beratit e ndjeu mjaft këtë goditje. Për të parashikohej një ngushtim prej 12 shkollash, nga të cilat 3 vetëm në nënprefekturën e Lushnjës. Veç kësaj, shkollat që funksionuan, jo vetëm ishin të gradës fillore, por të gjitha ishin me 1, 2, e rrallë ndonjë me 3 klasë. *"Prej vorfnis gjetëm nxanës qi s'kishin as libra e as fletore,* - thekson drejtori i drejtorisë arsimore të Shkodrës Gaspër Beltoja, - *edhe shkolla ishte mjaft e thatë me tjera mjete msimi, kështu qi edhe rezultati rrin si equlibër me peshën e të mbetave".*[112]

Këto pak rreshta janë një sintezë e qartë e gjendjes së arsimit në Shqipëri në vitin 1920-1923. Por nuk duhet harruar se shkolla shtetërore shqiptare ishte në hapat e saj të parë. Me mund e përpjekje mësuesit dhe drejtuesit e arsimit do të dinin t'i kapërcenin vështirësitë e t'i jepnin shkollës në vitet e mëvonshme fytyrën e një shkolle bashkëkohore, së cilës nuk i munguan edhe rezultatet.

arsimit, vëll. 2, Tiranë: 2002, f. 110.
[112] *AQSH*, F. 195, V. 1924, D. 19, fl. 142-143.

Jani SOTA

SUMMARY

THE EDUCATION CONGRESS OF 1920 AND ITS IMPORTANCE IN DEFINING THE STRUCTURE OF THE NATIONAL EDUCATION SYSTEM IN ALBANIA 1920-1922

Referring to the main phases the Albanian school has gone through from the National Awaking until now, it can be stated that education in Albania has steadily progressed towards the unification of the education system. The Society of printing in Albanian (1879), The Congress of Monastir (1908), The Congress of Elbasan (1909), The Literature Congress of Shkodra (1916-17) are some of the landmarks in this long and difficult journey, which was finalized with the Education Congress of Lushnje in 1920. This Congress not only confirmed the education policies initiated by the government of Vlora but also took them a step further. It is very meaningful that in the Education Congress of Lushnje was dealt with issues related to standardization and unification of the school's structure, content and methodology.

Of special importance are considered the guidelines and decisions of the Congress on the standardization of programs, textbooks and written language, elements which would directly influence the establishment of a unified national education system throughout the country and also the political unification and strengthening of the national unity among Albanians. The role and importance of the Education Congress of 1920 lies not only in the issues that it discussed or the decisions it took, but also in the implementation of reforms in 1921 to 1924, which were part of the process for the standardization, secularization and democratization of the Albanian school. The Congress influenced in the improvement of the school's quality by acquiring new pedagogical theories and patterns taken by the western school. This progressive tendency became steadily stronger and widespread until it was established as the mainstream of those years giving the Albanian school a true European character.

Albana MEMA

PARLAMENTI I PARË I ZGJEDHUR NË SHQIPËRI 1921-1923

Zgjedhjet e para, sado që u mbajtën në një kohë tepër të papërshtatshme për Shqipërinë, do të krijonin parlamentin e parë të vërtetë shqiptar, të dalë nga zgjedhje të lira politike. Themelimi i një parlamenti pluralist dhe demokratik, ishte i një rëndësie të veçantë për fillimin e një jete politike e demokratike dhe ndërtimin e institucioneve shtetërore. Por, klasa politike shqiptare ende nuk e kishte bërë të sajën këtë ligj themelor të qeverisjes demokratike. Ajo ishte larg shpirtit dhe frymës së mbajtjes së debatit dhe luftës politike brenda suazave të Parlamentit dhe normave kushtetuese.

Këto zgjedhje përfunduan me fitoren e "Krahut Kombëtar". Në kontekstin shqiptar, fitorja e kësaj linje politike nacionaliste, ishte dëshmi e fuqizimit të elitës politike me tipare kombëtare. Shtresa nacionaliste shqiptare, kishte filluar një veprimtari të ngjeshur politike në Shqipëri pas vitit 1908, si shkak i frymës nacionaliste xhonturke të shpallur në Stamboll, pasi pozitat e tyre u lëkundën. Si pasojë e kësaj premise, ato u angazhuan në Lëvizjen Kombëtare dhe atë shtet-formuese. Kjo shtresë, për shkak të kontakteve, të zhvillimeve politike në Perandorinë në shpërbërje e sipër, u angazhua në lëvizjen që solli shpalljen e pavarësisë. Më tej konservatorët ishin shtresa mbizotëruese në zhvillimet politike si në qeverinë e Vidit, ashtu edhe përgjatë Luftës së Parë Botërore. Për ligjin e zgjedhjeve, ka pasur qëndrime kritike në historiografi, si për censusin e zgjedhjes deputet, vetëm të atyre që dinin me shkrim gjuhën shqipe, pasi kështu përjashtoheshin të varfrit; për përcaktimin që votuesi të shkruante vetë ose me ndihmën e dikujt emrin e deputetit, për sistemin dy shkallësh etj.[1] Por, në këtë rast, duhet pasur

[1] Historia e Popullit Shqiptar, v. III, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë,Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2007, f. 178-179; Arben Puto, Shqipëria politike 1912-1939, Tiranë: Toena, 2009, f. 316.

parasysh se, ligji i përshtatej kushteve dhe mundësive në të cilat gjendej shoqëria shqiptare, në atë kohë. Madje, siç do ta provonte koha, edhe vetë opozita që e kritikoi shumë këtë ligj, kur erdhi në pushtet, nuk ishte në gjendje të bënte një ligj tjetër zgjedhor, por, adoptoi ligjin e mëparshëm. Sejfi Vllamasi thekson se, "në atë kohë zgjedhjet direkte qenë të pamundura".[2]

Në procesin e ndërtimit të parlamentit të ri shqiptar, i cili, do të dilte nga zgjedhjet e vitit 1921, kemi një rast interesant dhe tipik përfaqësimi. Në të u përfaqësua edhe diaspora shqiptare e Amerikës, me një përfaqësues të organizatës më të madhe të saj, Federatës Panshqiptare "Vatra". Kryeministri Iljaz Vrioni, njoftonte Ministrinë e Brendshme se "me vendim të Këshillës Ministrore, nr. 1169 me 20. XII. 920 e pëlqimit të Këshillës së Naltë, nr. 332/1 me 2. I. 921, i jepet e drejta e Shoqënis Federata "Vatra" e Amerikës e formueme prej nji shumice të madhe shqiptarësh, e njohtune si nji person moral, për me pasë nji deputet në Parlamentin Kombëtar të Shtetit t'onë, me kondicion se si qi do të zgjedhet si deputet, të ndodhet tani n'Amerikë e të ketë ma të paktën tri vjet qi gjendet atje me qellim qi të jetë i dalun me të vërtetë prej gjinit t'asaj shoqënije".[3]

Menjëherë pas kërkesës së qeverisë shqiptare, mbi caktimin e përfaqësuesit të "Vatrës" në Parlamentin shqiptar dhe propozimin e Fan Nolit, këshilli Ministror miratoi vendimin përkatës mbi pranimin e tij, si deputet në Parlamentit shqiptar. Në telegramin e Kryetarit të Shoqërisë Shqiptare Federata "Vatra" e Amerikës na thuhet se, "si depytet i asaj shoqënije për në Parlamentin kombëtar asht zgjedhe Imzot Fan Noli, i cili massi asht ndodhun n'Amerikë shumë kohë e ma në funt si përfaqësuesi i Shtetit Shqiptar pranë Lidhjes së Kombevet në Genevë, Këshilla nuk sheh nonji ndalim mbi mos pranimin e tij".[4] Zgjedhjet u mbajtën më 5 prill 1921. Këshilli Kombëtar me një dhomë, i filloi punimet më 21 prill 1921 dhe i vazhdoi deri më 10 shtator 1923. Pandeli Evangjeli ishte Kryetar i Këshillit Kombëtar gjatë vitit 1921, me

[2] Marenglen Verli, Tiranë: Neraida, 2000, f. 246.

[3] *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH),* Fondi. 152, Viti. 1921, Dos.25, fl.2. Telegram i Kryeministrit Z. Iljas Vrioni drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, mbi caktimin e përfaqësuesit të "Vatrës" në Parlamentin Shqiptar.

[4] *Po aty,* fl.4. Vendim i Këshillës Ministrore, Nr. 109 me 1/ 2/ 921, për pranimin e Fan Nolit si deputet në Parlamentin shqiptar.

përjashtim të një periudhe të shkurtër, pasi u bë Kryeministër. Eshref Frashëri ishte Kryetar i Këshillit Kombëtar, në vitet 1922-1923.[5]

Për organizimin dhe funksionimin e vetë Këshillit Kombëtar, pati rëndësi të veçantë Rregullorja e tij. Parlamenti vendosi ta linte përkohësisht në fuqi Rregulloren e miratuar nga Këshilli Kombëtar i dalë nga Kongresi i Lushnjes. Gjatë diskutimit spikatën tre momente: përcaktimi se betimi i deputetëve duhej të bëhej përpara vetë parlamentit, si organ që personifikonte sovranitetin e popullit dhe jo përpara Këshillit të Lartë, sikurse pati disa mendime; e drejta e parlamentit për të kërkuar shpjegime nga qeveria, çka plotësonte një mangësi të Statutit të Lushnjes, ku një gjë e tillë nuk përmendej shprehimisht por, deduktohej; botimi i procesverbaleve të diskutimeve në Këshillin Kombëtar, çka do të siguronte transparencën, për të përdorur një term të ditëve të sotme. Kjo çështje e fundit mori një karakter të mprehtë, pasi Ministria e Punëve të Brendshme, e drejtuar nga Ahmet Zogu, e kundërshtoi botimin e këtyre procesverbaleve, por Parlamenti, nën presionin e opozitës, e anuloi këtë masë, kështu që vazhdoi rregullisht botimi i tyre.[6]

Studiuesi kanadez, Robert Austin, pohon se, "Parlamenti i vitit 1921, nuk ishte një institucion me atributet e plota të një parlamenti të një vendi demokratik. Rëndësia e tij kufizohej nga fakti, se lufta kryesore bëhej në nivelin e kabinetit, me konkurencë interesash, duke luftuar për të fituar kontrollin mbi pozitat kyçe dhe luksin që krijonte pushteti politik".[7] Të dy partitë kryesore të jetës politike në vend, do të bëheshin "Partia Popullore" dhe "Partia Përparimtare". Të dyja këto forca, u krijuan pas zgjedhjeve dhe brenda Këshillit Kombëtar. "Partia Popullore" u krijua më 24 prill 1921, në pjesën më të madhe nga ish-organizata "Krahu Kombëtar", që ndryshe njihej me emrin "Klika". Ajo deklarohej, një parti politike në mbrojtje të një "programi reformash thjesht moderne nga shpirti por të urta, e të shkallëzuara", që të mos tronditej "asnji ndjenjë ose zakon i vendit; për një politikë paqësore e kombëtare të jashtme; kundër ndërhyrjeve në punët e brendshme të Shqipërisë, për një administratë moderne e për të drejtat e nëpunësve; kundër koncesioneve robëruese; sistem të përshtatshëm taksash, etj. Pas Qazim Kokoshit, kryetar i kësaj partie ishte Fan Noli, pastaj Sejfi Vllamasi, Bedri Pejani dhe më pas Ahmet Zogu. Kjo parti përfaqësonte mendimin

[5] *Ligjvënësit shqiptarë*, Tiranë: Kuvendi, 2005, f. 7-18.
[6] Luan Omari, *Sistemi Parlamentar,* Tiranë: Elena Gjika, 2004, f. 169-170.
[7] Robert C. Austin, *Shtegu i pashkelur i Fan Nolit,* Tiranë: Albin, 2003, f. 54.

konservator dhe atë liberal. Në shtator 1923, me largimin e mjaft figurave, dikur kryesore të saj, "Partia Popullore" mbeti tërësisht në drejtim të Ahmet Zogut. "Partia Përparimtare", e krijuar pak ditë më vonë, përfshinte në gjirin e saj klasën e lartë të pronarëve të mëdhenj si: Shefqet Vërlacin e Iljaz Vrionin, Mehdi Frashërin etj., si dhe elementë kosovarë, që vinin nga "Komiteti Mbrotja e Kosovës" si Hoxha Kadri, (që ishte dhe kryetar i partisë), Hasan Prishtina, Bajram Curri, etj.[8]

Ashtu sikurse më parë, edhe pas zgjedhjeve, forcat përparimtare iu përmbajtën vijës politike për mbrojtjen e platformës së Kongresit të Lushnjës. Duke i bërë jehonë dhe duke çmuar lart, veprën historike të këtij Kongresi, forcat përparimtare u përpoqën të ngrinin dhe të imponoin si kriter bazë, si për vlerësimin e çdo ngjarjeje ashtu edhe të veprimtarisë shtetërore, faktin e vetëm, nëse ajo i përgjigjej ose jo frymës së vendimeve të Lushnjës. Ato ngulnin këmbë në vlerën e vendimeve të Kongresit të Lushnjës, si parime juridiko-kushtetuese të shtetit të rimëkëmbur shqiptar, prej nga shtronin edhe kërkesën e drejtpërdrejtë, që e gjithë veprimtaria shtetërore, duhet të ishte në përputhje të plotë me këto vendime.

Pozita juridiko-kushtetuese e Këshillit Kombëtar, si organi kryesor në sistemin e organeve shtetërore, bënte që të shtrihej veprimtaria e tij edhe mbi atë të organeve të tjera të larta shtetërore. Në këtë çonin vetë raportet e varësisë juridike të tyre, sipas Statutit të Lushnjës, ndaj Këshillit Kombëtar, si të shprehura (në rastin e qeverisë), ashtu edhe të nënkuptuara (në rastin e Këshillit të Lartë). Nga kjo pikëpamje, tribuna e Këshillit Kombëtar tërhoqi vëmendjen e forcave konkurruese dhe secila prej tyre vari shpresa të mëdha.[9] Mbledhja e parë e Këshillit Kombëtar, u hap më 21 prill 1921 dhe që me fillimin e punimeve të tij, u formuan dy grupe deputetësh apo "parti" parlamentare: "popullore" dhe "përparimtare". Pati edhe një numër deputetësh që nuk bënin pjesë në asnjë prej këtyre partive, por merrnin, sipas rastit, anën e njërës apo të tjetrës prej tyre. Deputetët me pirje progresive, fillimisht dhe në përgjithësi, u përfshinë në "Partinë Popullore", kryetar i së cilës, u zgjodh F. S. Noli. Por, deputetë të tillë përparimtarë, pati edhe në partinë tjetër, në atë "Përparimtare", siç ishte kryetari i saj H. Kadri, etj. Gradualisht, brenda radhëve të Këshillit Kombëtar, u vu re një proces

[8] Kastriot Dervishi*, Historia e shtetit shqiptar 1912-2005,* Tiranë: 55, 2006, f. 131-133.

[9]Gramoz Hysi, *Organizimi i shtetit shqiptar dhe lufta politike rreth tij në vitet 1920-24*, Tiranë: 1988, f. 97-98.

diferencimi i ndjeshëm. U shpërbënë partitë parlamentare të mëparshme dhe deputetët e Këshillit Kombëtar u ndanë përfundimisht në dy krahë kundërshtarë. Sipas historiografisë së mëparshme këto ishin, pasqyrim i dy rrymave politike në vetë gjirin e shoqërisë së atëhershme, rrymës përparimtare, demokratiko-borgjeze, nga njëra anë dhe rrymës konservatore, nga ana tjetër. Sipas Gramoz Hysit, përfshirja e deputetëve përparimtarë në një grupim të qëndrueshëm, ndodhi nga fundi i vitit 1921 dhe fillimi i vitit 1922, me shkëputjen e tyre të plotë nga "Partia Popullore", që kishte rënë nën zotërimin e krahut "reaksionar", si edhe me shpërndarjen e "Partisë Përparimtare". Ky ishte grupi i Opozitës, në kuadrin e së cilit, deputetët përparimtarë filluan të ndërmarrin veprime të organizuara, në luftën e tyre kundër "krahut reaksionar", në vend të veprimeve të veçuara dhe individuale të deriatëhershme.[10]

Në këtë rast, Gramoz Hysi, na ka dhënë me saktësi, fillimin e një procesi të ri diferencimi politik por, koncepti i tij për ndarje të grupimeve në përparimtarë dhe reaksionarë, është i gabuar dhe në bazë të vlerësimeve klasore dhe ideologjike. Kuptohet qartë se, në këtë analizë, dominojnë motivet ideologjike të periudhës së mëparshme, ku njëri grup përcaktohet si përparimtar dhe tjetri si reaksionar. Ky konceptim, ka prodhuar një paraqitje tërësisht të deformuar të përbërjes dhe të veprimtarisë së Parlamentit të parë shqiptar dhe është përpjekur të argumentojë grushtet e shtetit dhe veprimtarinë antikushtetuese e të dhunshme të segmenteve të veçanta të opozitës së kësaj kohe.

Lufta politike, që bënë në Këshillin Kombëtar, përfaqësuesit e forcave përparimtare për organizimin demokratiko-borgjez të shtetit mori rëndësi, sidomos, në tre drejtime: Së pari, në veprimtarinë legjislative ose "ligjbërëse", siç përdorej shpesh në atë kohë dhe si organ i së cilës ishte pikërisht Këshilli Kombëtar, (nën shtytjen e deputetëve përparimtarë, çështja e zëvendësimit të legjislacionit të huaj me atë shqiptar u shtrua pak a shumë në krejt gjerësinë e vet) dhe për më tepër, në ballafaqimin e saj të drejtpërdrejtë me parimet e Statutit të Lushnjës, si ligji themelor i shtetit, si baza e burimi i vetëm i legjislacionit të ri; së dyti, në kontrollin juridiko-kushtetues të veprimtarisë së dy organeve të tjera shtetërore, të Këshillit të Lartë e të Qeverisë, nga ana e Këshillit Kombëtar; së treti, në jehonën që u bëhej në Këshillin Kombëtar ngjarjeve jashtë mureve të tij dhe gjendjes së

[10] *Po aty,* f. 99-100.

vendit, përgjithësisht, të cilat lidheshin ngushtë ose ishin pasojë e drejtpërdrejtë e veprimtarisë shtetërore.[11]

Që në këtë kohë, në shtyp, pati mjaft kritika ndaj efektivitetit të Parlamentit të ri. Kështu, Gazeta "Fjal' e Lirë", tërhiqte vëmendjen se, para se të formohej partia e shumicës që do të krijonte qeverinë definitive, të bazuar mbi pikat e programit të saj, çdo tentativë që do kishte për qëllim rrëzimin e kabinetit të Ilias Vrionit ishte e dëmshme, pasi mungesa e shumicës do t'i hapte rrugën ambicies dhe do të krijonte një gjendje anormale apo një krizë të përhershme. "Legjislatura e Shqipërisë pasi të rregullojë problemin e qenësisë konstitucionale të saj dhe pasi të nxjerri qeverinë definitive, ka për të menduar ngrehjen e Statutit." [12] Po kaq interesante, ishin edhe komentet e kësaj gazete, mbi demokracinë në vend dhe faktin se si qëndronin partitë e krijuara, në raport me të. Ajo shkruante se: "Partia Popullore", përgjithësisht është formuar nga njerëz demokratë dhe patriotë, por prapë s'dyshojmë që patriotizmën dhe demokracinë nuk e përfaqësojnë vetëm këta të 30-të. Prapë nuk mund të themi se demokracia mbretëron vetëm në mendimin dhe shpirtin e Toskës. Por demokratët tonë kanë nxituar sa më shpejt të marrin qeverinë në dorë dhe për t'ia arritur këtij qëllimi, kanë formuar partinë popullore, pa çmuar nevojën e një maxhoriteti të fortë të bazuar mbi një mendim të kulluar. Kjo parti duhej të ishte formuar, pasi deputetët e saj t'i shfaqnin mendimet e tyre edhe deputetëve të veriut.[13] Pra, këtu ka një kritikë me vend, për karakterin disi krahinor të dy partive, ndonëse kritika drejtohet konkretisht ndaj "Partisë Popullore".

Edhe gazeta "Jet' e Re", bënte komente pozitive, rreth programit të "Partisë Popullore" dhe nënvizonte këtë pjesë të tij: "... Partia do të përpiqet t'a rritë, t'a edukojë (mësonjë) e t'a pasuronjë popullin e t'a vërë në radhën e popujve Evropianë të Perëndimit. Partia do të mbrojë njësinë (egalitetin) e gjithë qytetarëve Shqiptare, pa ndryshim feje si dhe lirinë personale, të fesë, fjalës, shtypit, mbledhjes e shoqërimit." Ky program ishte votuar dhe nënshkruar prej tërë deputetëve të Korçës, deputetëve të Gjirokastrës, veç Kolekës, i cili kishte vajtur në Shkodër, deputetëve të Matit, një i Durrësit zotit Zia Toptanit. Kryetar i saj u zgjodh Imzot Fan Noli, Sekretar Qazim Kokoshi".[14]

[11] *Po aty,* f. 104.
[12] *Fjal' e Lir*, Vlorë, nr. 9, dt. 21 prill 1921, "Fillimi i punës".
[13] *Po aty,* nr. 10, dt. 30 prill 1921, "Shpirti i Parllamentit".
[14] *Jet' e Re,* Korçë, nr. 7, dt. 5 maj 1921, "Për mi grupin parlementar".

Përveç stabilitetit politik, të një maxhorance të qëndrueshme, një problem tjetër edhe më delikat, ishte çështja e përfaqësimit politik në Parlament. Shumica e deputetëve ishin të vendosur që të bëhej gjithçka që të ruante unitetin kombëtar në këtë fazë të parë të vështirë të konsolidimit të shtetit shqiptar.[15] Nga shumica e deputetëve, u përkrah propozimi i Ali Këlcyrës, i cili, ndonëse e pranonte se populli shqiptar kishte një ndërgjegje kombëtare, shprehte shqetësimin se mund të ndodhnin ngatërresa e përçarje. Ai sugjeroi që me vendim të Parlamentit, të respektohej përbërja fetare. Pra, në ato rajone ku ortodoksët ishin në shumicë, të zgjidhej detyrimisht një deputet ortodoks. Ndërsa në zonat ku myslimanët ishin shumicë mund të caktohej edhe një deputet nga pakica ortodokse.[16] Edhe më pas, në bisedimet e mbajtura gjatë Kuvendit Kushtetues, Ali Këlcyra, e arsyetoi në këtë mënyrë këtë fakt: Ai theksoi se, "shteti shqiptar ishte afetar, por, për oportunitet politik, ne propozuam që të merret si bazë në hartimin e ligjeve proporcioni midis elementeve fetare. Arsyeja ishte se ende ngjarjet historike të së kaluarës mund të ndikonin në jetën politike, ku shumica mund të shtypte të drejtat e pakicës. Pasi shteti shqiptar nuk kishte arritur atëherë ende në shkallën e duhur të qytetërimit politik, propozuam që zgjedhjet të bëheshin në bazë të proporcionit të elementëve fetarë, për të vetmen arsye që shumica të mos mund të shkelte të drejtat e pakicës. Kjo u bë që në kohën e qeverisë së Iljaz Vrionit. Ajo pati kundërshtime të mëdha, ndërsa ne përkrahësit e kësaj vije u akuzuam si kaur e kaurofila". Kritikat më të ashpra iu bënë Mehdi Frashërit që atëherë ishte Ministër i Punëve të Brendshme.[17]

Problemi i përfaqësimit në parlament, do të diskutohej gjatë dhe diskutimet rreth tij, do të zhvilloheshin edhe në vitin 1923. Deputetë si: Ali Koprencka, I. Xhindi, V. Xhuvani, N. Ivanaj kërkuan që, me qenë se shteti shqiptar nuk kishte fe zyrtare, të mos vendoseshin proporcione në zgjedhjen e deputetëve sipas përkatësisë fetare.[18] Lidhur me këtë çështje, Ministri i Drejtësisë, M. Tutulani, kundërshtoi, duke theksuar se, "qeveria e kishte bërë propozimin për të ruajtur përpjestimet midis feve në Parlament, për arsye se ajo kishte pranuar një nen në Lidhjen e

[15] Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar në Shqipëri 1912-1924*, Tiranë: Kristalina-KH, 2013, f. 326-327.
[16] *Bisedimet e Këshillit Kombtar (më tej: BKK)*, Legjislatura e Parë, Sesioni i VI, Tiranë 1923, Mbledhja e 19-të.
[17] *Bisedimet e Kuvendit Kushtetues*, Tiranë 1924, Mbledhja 11-të, 14 shkurt 1924, f. 173.
[18] *BKK,* Mbledhja e 19-të, 23 shtator 1923, f. 1487.

Kombeve, i cili theksonte se në Parlament do të ruheshin proporcionet fetare". Qazim Koculi, e kritikoi ashpër këtë pretendim, duke theksuar se e kishte kundërshtuar me kohë këtë sepse shqiptarët myslimanë e të krishterë nuk ia kishin kërkuar këtë gjë Lidhjes së Kombeve. Sipas tij, parashikimet e Lidhjes së Kombeve, ishin vetëm për pakicat nacionale.[19] Ai e quajti Deklaratën në Lidhjen e Kombeve një gabim trashanik, i cili ose duhej të ndreqej ose do të mbetej një letër e vdekur dhe të mos zbatohej. Por, Ali Këlcyra, vijoi të këmbëngulte që proporcionaliteti të pranohej, jo për hir të deklaratës në Lidhjen e Kombeve, por për interesat e vendit. Kështu u pranua propozimi se në caktimin e numrit të anëtarëve të Kuvendit Kushtetues të ruhej përpjesëtimi ndërmjet feve të ndryshme.[20]

Çështja e përfaqësimit fetar në institucionet kombëtare, ishte një problem i mprehtë për shtetin shqiptar, i cili, ishte diktuar nga niveli ende i ulët politik, i edukatës dhe ndërgjegjes kombëtare, si rezultat i kushteve specifike të zhvillimit historik të kombit shqiptar. Por, këto probleme do të shtoheshin edhe më shumë, si rezultat i presionit të fuqishëm që bënin shtetet fqinje dhe disa fuqi të mëdha dhe organizma ndërkombëtare, që dominoheshin prej tyre, ndaj shtetit shqiptar, që ky i fundit, t'i konsideronte komunitetet fetare si komunitete minoritare dhe për pasojë, ato duhej të gjenin përfaqësim proporcional në këto organe.

Ndërtimi i institucioneve mbi bazën e përqindjes fetare dhe krijimi i përfaqësimeve të tilla, do të shkatërronte unitetin e brendshëm të shtetit shqiptar, që në embrion dhe do të pengonte çdo lloj përpjekjeje për konsolidimin, rritjen e efektivitetit, modernizimin dhe demokratizimin e institucioneve kombëtare. Ky lloj segregacioni, do të dekurajonte të gjitha përpjekjet për progres dhe prosperitet, do të krijonte konflikte dhe mosmarrëveshje të brendshme, të vazhdueshme dhe çka ishte edhe më problematike, do të krijonte një terren ideal për ndërhyrjen e fqinjëve më të fuqishëm, e me shtete të konsoliduara, me tipare të theksuara nacionaliste dhe shovene, në punët e brendshme të shtetit shqiptar, duke e bërë kështu ekzistencën e këtij shteti, pothuajse të pamundur, ose në rastin më të mirë, do ta bënin jetën e tij politike një kalvar të vërtetë. Për këtë arsye, kjo fazë e parë e viteve 1920-1924, do të shërbente si një periudhë transitore, drejt formimit të institucioneve unike kombëtare, gjë që do të arrihej pas rikthimit të A. Zogut në pushtet në vitin 1925. Por, gjithashtu, kjo periudhë do të shërbente edhe si një eksperiencë, e

[19] *Po aty,* f. 1497.
[20] *Po aty*.

cila, do të diktonte më vonë kapërcimin e vendosjes së barrierave dhe kornizave fetare e krahinore brenda institucioneve përfaqësuese kombëtare. Më tej, respektimi i përkatësive fetare, në përbërjen e institucioneve fetare, do të mbetej një kriter për shtetarët shqiptarë, të cilët, do ta respektonin atë si një kod të pashkruar moral dhe politik.

Parimi themelor, i këtij kodi të pashkruar, ishte pjesëmarrja e shqiptarëve të krishterë gjerësisht në institucionet kombëtare edhe në një shkallë më të lartë, se sa pesha specifike që ata kishin në popullsinë shqiptare. Kjo i ka shërbyer procesit të konsolidimit të institucioneve kombëtare dhe fuqizimit të unitetit kombëtar. Por, nga ana tjetër, nga të gjithë shqiptarët, u refuzua me vendosmëri, vendosja e përqindjeve dhe numrave fikse të përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së popullsisë së besimeve të ndryshme në institucionet kombëtare dhe lokale, si dhe u refuzua dhe u kundërshtua me forcë çdo lloj ndërhyrje e huaj në këtë drejtim. Kjo ka qenë rruga më e drejtë, në ato situata specifike, në të cilat ndodhej kombi shqiptar, në procesin e vështirë të formimit të shtetit të tij kombëtar.

Në kuadër të zhvillimeve parlamentare, ishte me interes bashkëpunimi mbi çështje që cenonin sovranitetin e Shqipërisë, siç ishte kryengritja antiqeveritare e Mirditës. Faktori politik i kohës, u angazhua në arritjen e një marrëveshjeje politike për të shtypur këtë kryengritje. Ahmet Zogu, një lider i njohur tashmë, arriti të siguronte aleancë politike qeverisëse me koalicionin "Bashkimi i Shenjtë". Studiuesi B. Fischer thekson se, në këtë organizatë fluide merrnin pjesë të gjithë elementet e politikës shqiptare, që nuk bënin pjesë në "Partinë e beut"".[21] Përveç arsyes së lartpërmendur, ky bashkëpunim parlamentar, arriti të shpërbëjë një qeveri, ku palët e përfshira në bisedime për krijimin e tij, nuk ishin pjesë e saj. Fillimisht, u formua grupi iniciator për formimin e qeverisë, i përbërë nga Bajram Curri, Qazim Koculi dhe Avni Rustemi.[22] Ndërmarrja e tyre, më pas, u përkrah nga shumë personalitete si: Bahri Omari, Luigj Gurakuqi, Kristo Floqi, Petro Harito, Ahmet Zogu, Hoxhë Kadriu, Riza Dani, Kristo Dako, Ali Këlcyra, Qemal Mullai, Dom Ndre Mjeda, Koco Tasi, P. Gjergj Fishta, Eshref Frashëri, Mustafa Kruja e Rexhep Mitrovica.[23] Ky protokoll, mban datën 11 tetor 1921 dhe në historinë e politikës shqiptare, arritja e

[21] Bernd J. Fischer, *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri*, Tiranë: Çabej, 2004, f. 41.
[22] *AQSH*, F.418, Viti.1921, Dos.3, fl. 1.
[23] *Po aty.*

këtij kompromisi politik, ka një domethënie të veçantë, pasi formohet një qeveri koalicioni.

Mbi arritjen e këtij kompromisi politik u njoftua edhe Kryeministri në detyrë më datë 11 tetor 1921, ku theksohej se, "Bashkimi i Shenjtë" u formua për mbrojtjen e integritetit të Shqipërisë. Qeverisë i kërkohej ta publikonte këtë marrëveshje të arritur në Parlament. Dokumenti mbante nënshkrimet e Anastas Pandeliut, Hoxha Kadriut, Ferit Vokopolës, P. Gj. Fishtës dhe Bahri Omarit.[24] Shtypi i kohës, bëri interpretime të ndryshme për krijimin e këtij koalicioni. Ai u cilësua si një krijesë politike e detyruar nga kërcënimi i integritetit të vendit si dhe nga krizat e vazhdueshme të qeverisë. Kështu, Gazeta "Posta e Korçës", shumë aktive në këtë kohë, në pasqyrimin e detajuar të situatës politike, e veçanërisht, asaj në parlament, në një kryeartikull të saj, arrinte në konkluzionin se: "Për të bërë Bashkimin më të fortë midis Popullit u formua "Bashkim i Shenjtë".[25] Nëpërmjet protokollit të themelimit të koalicionit, e më pas, njoftimit të bërë Këshillit të Ministrave, dëshmohej serioziteti i lidershipit të përfshirë në këtë proces. Prej këtij koalicioni, doli qeveria Evangjeli, e cila shpalli angazhim për të ruajtur integritetin dhe independencën e Shtetit Shqiptar, përpjekjen për të siguruar njohje nga shtetet e huaja, e lidhjen e marrëdhënieve diplomatike me to. Kjo qeveri, më 19 tetor 1921, shpallte se do përpiqej për krijimin e raporteve miqësore me shtete të tjera, sidomos me fqinjët, për të dhënë prova se, Shqipëria ishte element paqeje dhe progresi në Ballkan.

Në politikën e brendshme, kabineti i ri, do të kishte për bazë parimin, "qeverim i pëlqyem prej të qeverisurve", ndërmarrjen e reformave të duhura administrative që përfshijnë modernizimin e administratës, përmirësim e legjislacionit në fushën civile dhe penale. Në programin e qeverisë së P. Evangjelit, konsiderohej domosdoshmëri, krijimi i një shkolle të lartë ku të jepeshin mësime të së drejtës administrative, konstitucionale, financiare etj., organizimi i ushtrisë dhe xhandarmërisë.[26] Misioni britanik në Shqipëri, e shpjegonte krejt ndryshe, krijimin e "Bashkimit të Shenjtë", duke i atribuuar A. Zogut një rol të veçantë në këtë drejtim. Në një raport të detajuar të Harry Smith, drejtuar Lordit Curzon me titull: *"pamja sipërfaqësore e partive"* thuhej: "Grupet parlamentare në Tiranë, të zgjedhura në

[24] *Po aty*, F.149, Viti 1921, Dos. I-230, fl. 5.
[25] *Gazeta Poste e Korcës,* Korçë, nr 56, 15 tetor 1921, f. 1.
[26] *Gazeta Shkumbini,* Elbasan, nr. 35, " Programa e Kabinetit të ri", f. 1.

qershor 1921, u etiketuan si Progresive, Popullore dhe grupi Katolik. Përveç këtyre, ishte Fan Noli si i pavarur dhe Hasan Prishtina me disa deputetë të Drinit, si irredentistë. Dy grupet më të mëdha parlamentare, kanë në të vërtetë programe identike. Secili flet për reforma, edukim dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Partia në pushtet, ajo Progresive, në radhët e së cilës fillimisht ishin 20 anëtarë ortodoksë, gradualisht mori emrin e partisë së bejlerëve. Të krishterët, duke e parë pafuqinë e tyre kundrejt myslimanëve, e shtuan fushatën kundër bejlerëve. Ahmet Beu, si person i mprehtë që është, përfitoi nga kjo lëvizje për t'u bashkuar me "Bashkimin e Shenjtë", i cili u krijua për t'i dhënë fund pushtetit të bejlerëve, edhe pse ai përfaqësonte tipin më ekstrem të bejlerëve që duheshin shtypur. Fan Noli për qëllime praktike u integrua në "Partinë Popullore" dhe pastaj në përbërjen e "Bashkimit të Shenjtë", ndërsa katolikët, që mendonin të bashkoheshin me lëvizjen kundër bejlerëve, ishin kryesisht nga Shkodra. Tipari më kryesor i grupit të Hasan Beut, është karakteri i tij i hapur pro-italian."[27]

Ky raport interesant i britanikëve, të cilët po i vëzhgonin me kujdes dhe thellësi zhvillimet politike, na jep një pjesë të tablosë se çfarë metamorfoze politike po ndodhte në parlamentin shqiptar në këtë kohë. Kështu, ndonëse "Partia Progresive" deri në këtë kohë, kishte pasur një dominim fare të lehtë e të paqëndrueshëm në parlament, kryeministër i qeverisë së "Bashkimit të Shenjtë" u zgjodh P. Evangjeli, anëtar i "Partisë Popullore". I paqartë është roli i Zogut në këtë kombinacion politik. Sipas britanikëve, ai ishte frymëzuesi i tij por, sipas italianëve ai nuk bën pjesë në grupin e deputetëve të "Bashkimit të Shenjtë". Gjithashtu S. Vllamasi, siç do ta shohim më tej, pohon se Zogu ishte kundër këtij kombinacioni politik, por më në fund u bind pasi shumica e "Partisë Popullore" ishte pro kësaj lëvizjeje.

Gjithsesi, zhvillimet e mëvonshme, dëshmuan se, jo të gjithë palët e respektuan vendimin për ta ruajtur këtë koalicion, duke u angazhuar shumë shpejt, në denoncimet ndaj tij. Gazeta autoritare "Dielli", ishte zëdhënësja kryesore e denoncimit ndaj këtij kombinacioni parlamentar dhe në një kryetitull të saj e cilësonte si "epidemia që ka rënë në Parlament". Kriza sipas saj, u shkaktua prej intrigave që u luajtën nën maskën e "Bashkimit të Shenjtë". "Dielli", e karakterizonte koalicionin si manovër e një shumice deputetësh për të marrë ministri dhe

[27] *The British National Archives (TNA),* Foreign Office (më tej: FO) 371/7330, f. 581-586, Telegram i Heathcote Smith për Curzon, 18 janar 1922, mbi situatën politike në vend.

përfundimi ishte shkatërrimi i të tre partive, me përjashtim të "Partisë Popullore", e cila pa dyshim, do të kishte sërish shumicën, kur të rihapej Parlamenti.[28] Por, më e keqja, do të vinte disa ditë më vonë, me grushtin e shtetit, që do të realizohej, pikërisht, nga organizatorët e "Bashkimit të Shenjtë". Këto ngjarje të dhimbshme dëshmonin se, sistemit parlamentar i kanoseshin edhe rreziqe të tjera.

Rrjedha e ngjarjeve që pasuan, tregonin se, vendi nuk do të shpëtonte nga krizat politike. Trupat qeveritare, nuk përfunduan dot shtypjen e kryengritjes së Mirditës dhe Ali Fehmi Kosturi, u ndërrua, duke u zëvendësuar nga Ibrahim Prishtina, e më pas nga Rexhep Shala. Për të përballuar gjendjen e përgjithshme në veri të vendit, më 4 nëntor 1921, qeveria emëroi komandant të operacioneve ushtarake, për krahun lindor Ahmet Zogun dhe për krahun perëndimor, Bajram Currin, duke sjellë në të njëjtën kohë edhe kundërveprime nga kundërshtarët politikë të Ahmet Zogut.

Në të njëjtën datë, Këshilli i Lartë, i kërkoi Këshillit Kombëtar, të mbyllte sesionin parlamentar, për shkak të gjendjes në veri dhe për t'i lënë dorë të lirë qeverisë të punonte.[29] Ky dekret, i zuri një pjesë të parlamentarëve në befasi dhe rreth tij, pati debate të ashpra. Ai u etiketua edhe si një grusht shteti, madje sipas Vllamasit, situata shkoi deri në kufijtë e një përleshje të armatosur.[30] Për të sjellë panoramën e këtij debati të ashpër, ia vlen të japim disa nga debatet që u zhvilluan për këtë çështje. Kështu, deputeti Bahri Omari deklaroi: "Dekreti i Këshillit të Naltë për përndarjen e Parlamentit, asht kundra konstitysionit qi kemi pranue në Kongresin e Lushnjës e kundra Statutit t'onë simbas të cilit Këshilli i Naltë s'ka as nji të drejtë t'përndajë parlamentin. Simbas Statutit të Lushnjës, kur Parlamenti ndodhet tri herë rishtas në konflikt për formimin e Qeverisë, Këshilli i Naltë konvokon Assamblenë Konstityente e cila vjen dhe zgjith litizhin. Prandaj Këshilli i Naltë, me këtë veprim qi ka ba, ka shkel Statutin e Shenjt të Lushnjës, e ka marrë nji të drejtë qi ky nuk ja jep. Lypset pra qi këtë dekret t'a refuzojmë". Një qëndrim krejt të kundërt, mbajti Ali Këlcyra, i cili theksoi: "Po t'a marrim këtë çështje nga pikpamja juridike, e po të marrim Statutin e Lushnjës, do të shofim se natyralisht Këshilli i Naltë nuk e ka këtë të drejtë. Por Këshilli i Naltë tue pa se

[28] *Dielli,* Boston Mass, nr 2329, 7 janar 1922, f. 2, " Epidemia e Keqe që ka rënë në Parlament".
[29] *BKK*, Mbledhja e 71-të. Më 4 Nantuer 1921, f. 572.
[30] S. Vllamasi, *Ballafaqime politike* ..., f. 258.

përfaqësuesit e Shtetit Shqiptar ndodheshin në nji mos-marrëveshje të shtymun prej ambicijave personale, si edhe tue marrë parasysh gjendjen e kritikshme si të mbrendshme ashtu edhe të jashtme, e dha këtë vendim për shkak të drejtë edhe detyrë morale dhe patriotike që t'i largojë për disa kohë përfaqësuesit e popullit Shqiptar me qëllim që kur të mblidhen rishtas, do të kthehen me nji mendje ma të kthjelltë, me santimente ma të mira dhe me nji ndërgjegje ma të plotë.

Pra këtë çashtje duhet ta ndajmë në dy pikpamje: Juridike dhe Oportuniteti. Nga pikpamja juridike, si thashë dhe ma parë, Këshilli i Naltë nuk ka të drejtë me përnda Parlamentin, por nga pikpamja e Opportunitetit, Këshilli i Naltë dhe Qeverija kanë të drejtë t'a marrin këtë vendim, e mbi këtë bazë duhet t'a bisedojmë çështjen me gjak të ftohtë e pa u-nxeh, jo tue ulërit e tue bërtit. Unë këtë vendim të Këshillit të Naltë nuk e shof të pa-drejtë, por e gjej t'arsyeshëm që Parlamenti për disa kohë të mbyllet, që të mund të na largohet ay nervozitet që na ka rrethue, se tash nji muaj nuk bajmë gja tjetër veç se të gatitim lista në mëngjes dhe t'i fshijmë mbrëmjevet për të bam të tjera". Më tej edhe deputeti M. Tutulani, jep mendimin e tij, për aktin e kryer nga kreu i shtetit shqiptar. Sipas tij: "Nji dekret ksisoj duhet të jetë i mbështetun mbi nji të drejtë juridike, e cila simbas Statutit të Lushnjës i mungon, dhe ksisoj abuzon të drejtat e Tij. Këshilli i Naltë i shtynum prej santimenteve qi nëmëroj Z. A. Këlcyra, në vend qi t'na këshillonte me ba nji pushim, del nga e drejta e Tij, abuzon e ban nji (coup d'etat). Përveç kësaj Këshilli i Naltë në dekretin e Tij, na njeh si në sesion ekstraordiner, por kjo nuk asht fare e drejtë, se na jena në stinë ordinare. Nga këto dy pika dekreti i Këshilli të Naltë asht nji (coup d'etat) dhe Këshilli Kombtar duhet t'a refuzojë kategorikisht e mos t'a marrim as pak para sysh". Ndërsa Mustafa Kruja shprehej se: "Mbreti ose Kryetari i Republikës ose Regjenca, në çdo Shtet konstitutional ka përpara parlamentit dy të drejta: 1) Pushimi i Parlamentit d.m.th. ndërprerja e sesionit parlamentar që sikur e dini në gjuhën frënge quhet "ajournement". 2) Çkatërimin e Parlamentit dhe kjo është nji nga të drejtat më të mëdhaja që ka fuqija ekzekutive. Këtë gja e kanë gjithë shtetet monarqike dhe republikane të botës që kanë nji konstitucion".[31] Me interes është që të shihet edhe qëndrimi ndaj parlamentit, në momentet më të vështira që kalonte vendi, të cilat, do t'i prinin grushtit të shtetit. Për këtë tërheq vëmendjen një artikull i gazetës "Shqipëria e Re", i titulluar "Mbyllja e Parlamentit shqiptar." Në këtë artikull,

[31] *BKK*, Mbledhja e 71-të, më 4 Nantuer 1921, f. 572-573.

parlamenti vlerësohet negativisht. “Parlamenti, ai gjyq i naltë, ku kish kthyer sytë gjithë kombi dhe priste sende me rëndësi, priste sigurimin e jetës kombëtare, u-bë, më në funt një vënt, për të hipur dhe zbritur ministra, për të mbushur ambicjet personale, për t’i bërë qefin njërit ose tjetërit. Të pakë ishin ata deputetë qi kishin hedhur prapa krahëvet të gjitha dhe mendonin, punonin si Shqipëtarë!” Gazeta, vlerësonte në mënyrë kritike, edhe “Bashkimin e Shenjtë”, i cili, siç shkruante ajo, fillimisht bëri aqë bujë dhe u prit me aq simpati por shpejt e humbi rëndësinë e tij “se gjithë ata qi s’e kishin me zemër u hoqnë, me gjithë q’i kishin vënë nënëshkrimet e tyre. Partia Kombëtare, ose më mirë feudale, fitoj përsëri shumicën dhe kabineti i ri i z. P. Evangjeli ish në rrezik”. Gazeta, me të drejtë, bënte një vërejtje mjaft serioze. Ajo shkruante se, “në një kohë kur Sërbia po bombardonte katundet tona, po shkonte në thikë shqipëtarët e Matit dhe me një fuqi të madhe po i drejtoheshe kryeqytetit, në këtë kohë aqë të rrezikshme për tërësinë e vendit tonë, deputetët, q’i na u lavdëruanë se do bënin çudira, ishin të përçarë, përpiqeshin të rëzonin kabinetin të bënin këtë ose atë ministër, të fitonin inatin ose qefin.”[32]

Duke e parë situatën në këtë prizëm, gazeta, mbronte vendimin e kabinetit të P. Evangjelit, për të shpërndarë parlamentin. Ajo shkruante: “Kabineti i ri, ky kabinet demokrat dhe atdhetar gjer në palcë, duke parë rezikun, kërkoj nga Këshilla e Naltë shpërndarjen e Parlamentit. Këshilla e Naltë me një dekret luste depytetët të shpërndahen për dy muaj po, kongresi i Lushnjës s’i ipte këtë fuqi Këshillit të Naltë; atëherë shpërndarja u vu në votim dhe si për çudi fituan anëtarët e “Bashkimit të Shenjtë”. Me shumicë votash u vendos shpërndarja e Parlamentit për dy muaj d.m.th. gjer në Janar 1922”. Këtë përfundim, gazeta e quante pozitiv dhe nënvizonte se “ me sa gëzim që u prit çelja e këti Parlamenti me aqë gëzim u prit dhe mbyllja e tij. Më kot u kundërshtua Hoxha Kadriu, më kot hipi mi tryezën, depyteti i Elbasanit, Hastopalli, dyke thirur duamë “Asamble”, Fuqija e së drejtës, zëri i rrezikut, zëri i Shqipërisë, ish më fortë se të gjitha.” Sipas gazetës, i çliruar nga Parlamenti, kabineti ishte i suksesshëm në përballimin e ndërhyrjes jugosllave. “Kabineti, duke mos patur mbi krye Parlamentin posi shpatën e Dhamokleut, mori të gjithë masat e nevojshme për t’i bërë ballë armikut. Bajram Curri dhe Ahmet Zogolli u emëruan komandantë të përgjithshëm të fuqive kombëtare. Vetëdashës nga Vlora dhe Berati,

[32] *Shqipëri e Re,* (organ i shqipëtarëve të Rumanisë), Konstancë, nr. 58, dt. 4 dhjetor 1921, “Mbyllja e Parllamentit Shqiptar. Lufta Sërbo-Shqiptare”.

Ushtarë nga Koça shkuan për në fushën e luftës. Bajram Xhani erdhi me 700 vetëdashës nga Kavaja dhe shkoj kundra Sërbit. Ramazan Aga nga Peqini me 150 shpirt vrapoj në Mat. Nga gjithë anët po vijnë vetëdashës, po vijnë flamurë kuq-zi-kuq, në ballë dhe shkojnë kundër serbëve po dalin në shesh dhe, tërë bota e kuptoj qëllimin e diplomatëvet të Beogradit." [33]

"Iniciatorët e "Bashkimit të Shenjtë", të cilët do të bëheshin edhe organizatorët e grushtit të shtetit gabuan edhe Pandeli Vangjelin, më 4 nëntor 1921, provokojnë mbledhjen e parlamentit, duke thënë se qeveria do të bënte një ekspoze mbi situatën e jashtme të Shqipërisë. Kurse për çudinë e madhe të deputetëve, në vend të ekspozesë, u lexua dekreti i Këshillit të Naltë mbi shpërndarjen e parlamentit, me motivacion se qeveria ka nevojë të ketë liri veprimi, për t'i bërë ballë situatës së rrezikshme të krijuar gjatë kufirit jugosllav. Parlamenti e kundërshtoi fort kërkesën për shpërndarjen e tij, por duke mos e parë oportune të çonte punën deri në gjakderdhje, ndonëse e refuzoi dekretin si jashtë statutit, vendosi ta pushojë aktivitetin e tij (veçse) jo deri më 4 janar, por më 1 janar 1922."[34] Kërkesa e Këshillit të Lartë, për mbylljen e organit legjislativ, deri në datën e caktuar, u votua nga Këshilli Kombëtar. Me 41 vota pro, 10 kundra dhe 4 abstenime, organi legjislativ, vendosi që punimet e tij të çeleshin më 10 janar 1922, datë e cila, për shkak të zhvillimeve të papritura, nuk do të zbatohej. Zhvillimi i këtyre ngjarjeve, përkonte me dobësimin e "Bashkimit të Shenjtë". Deputetët e Korçës, u shkëputën nga ky formacion politik dhe iu bashkuan grupit të Iljaz Vrionit, që filloi të quhej "Indipendent". Në këtë mënyrë, rënia e Qeverisë së Pandeli Evangjelit, dukej e shpejtë.[35] Ironia e fatit ishte se, kur po gatuhej ky komplot, pozita ndërkombëtare e Shqipërisë ishte përmirësuar në mënyrë të dukshme. Ishte dhënë vendimi final i Konferencës së Ambasadorëve dhe një numër vendesh, midis të cilave, edhe Fuqitë e Mëdha, kishin njohur qeverinë shqiptare.

Interesante janë edhe shpjegimet që na jep Sejfi Vllamasi. Sipas tij, "sado që "Partija Përparimtare" kishte një farë epërsie mekanike, kjo shumicë nuk vinte nga një parti homogjene që të kishte edhe solidaritetin moral për të formuar një qeveri të qëndrueshme e që të impononte një besim për të kryer veprat me rëndësi që impononte situata. "Partia Popullore" ishte me një ndryshim të vogël në raport me

[33] *Po aty.*
[34] S. Vllamasi, *Ballafaqime politike* ..., f. 258.
[35] K. Dervishi, *Historia e shtetit shqiptar 1912-2005*...., f. 147-148.

partinë tjetër. Ndonëse në pakicë, ajo ka qenë nga çdo pikëpamje më superiore se e para. Pas zgjedhjeve, pamundësia e formimit të një qeverie homogjene krijonte një situatë shqetësuese, e nga ana tjetër, vlonte propaganda e partikularizmës krahinore e fetare në formë të organizuar, për të shkaktuar anarshi mendimesh, sidomos midis elementit të padjallëzuar dhe të elementit që nuk kish njohuri të vërtetë mbi qëllimin e kësaj propagande".[36]

Vllamasi, ndryshe nga britanikët, iniciativën për formimin e "Bashkimit të Shenjtë" nuk ia dedikon partisë së tij dhe as Zogut por, partisë kundërshtare. Ai thotë se, "pasi anëtarët që përbënin "Partinë Përparimtare" nuk mundën të formonin një qeveri të fortë me anë të zgjedhjeve parlamentare dhe pasi me anë të bisedimeve nuk mund të bëhej një marrëveshje për shkak mosbesimi, "Partija Përparimtare" pranoi formimin e një "Bashkimi të Shenjtë." Prej këtij bashkimi do të zgjidhej një komision prej tre vetësh: Bajram Currit, Qazim Koculit e Avni Rustemit. Parlamenti do t'ia jepte kompetencën e tij këtij komisioni për formimin e një qeverie, e cila do t'ish e pranueshme prej të dy partive". Vllamasi pohon se, "anëtarët e "Partisë Popullore", që nuk bënin pjesë në Organizatën "Krahu Kombëtar", nuk i njihnin mirë kundërshtarët dhe qëllimet e vërteta të tyre, prandaj në këto plane nuk shihnin ndonjë rrezik të dukshëm, ndërsa anëtarët që bënin pjesë në "Krahun Kombëtar", ngurruan për herë të parë të pranonin propozimin në fjalë, i cili u bë objekti i diskutimeve të gjata midis tyre". Me rëndësi është pohimi i Vllamasit se: "Zogu qysh në fillim u tërhoqi vërejtjen shokëve, duke thënë se kundërshtarët kanë prapamendim dhe qëllim të keq dhe mbasi nga ky komision do të dalë një qeveri jo e fortë, puna e parë e tyre në një moment të përshtatshëm do të ishte të bëjnë një grusht shteti, të marrin qeverinë në dorë e t'i bënin zgjedhjet duke përdorur forcën qeveritare".[37]

Nga ana e tij, diplomati britanik Harry Smith, i jepte Zogut, një rol parësor në formimin e asaj që edhe ai e quante "Partia sekrete" ("Klika"). Ai informonte Sekretarin e Shtetit Curzon se: "Menjëherë pas mbledhjes së Parlamentit, ndërsa në hapje ishte një anëtar i fuqishëm i Partisë Popullore, Zogu formoi atë që këtu njihet si "Klikë". Ajo është një shoqëri sekrete dhe krahasohet me Komitetin turk të Bashkimit dhe Përparimit. Anëtarët më të njohur janë: Ahmet Bej Zogolli i Matit, për momentin Ministër i Punëve të Brendshme; Eshref Bej Frashëri, për

[36] S. Vllamasi, *Ballafaqime politike* ..., f. 254.
[37] *Po aty,* f. 254-255.

momentin President i Dhomës së Parlamentit; Kolonel Maliq Bej Frashëri, në këto momente drejtues i stafit; Kolonel Xhavit; Kolonel Ismail Tatzati, tani Ministër i Luftës; Xhafer Bej Ypi, tani Kryeministër; Bajram Fevzi, më parë Ministër i Punëve të Brendshme; Sotir Peci, i krishterë nga Korça, për momentin Regjent; Kol Thaçi, i krishterë nga Korça, tani Ministër i Financave; Mustafa Maksuti, më parë zëvendës Ministër i Luftës; Rexhep Bej Mitrovica, tani Ministër i Edukimit."

Smith, shprehte, në atë kohë, një mendim të kundërt me atë që ka pohuar Vllamasi. Gjithashtu, ai rendiste edhe disa tipare negative të "Klikës", si përpjekjet për të ndërhyrë në administratën e vendit, duke bërë rekrutime politike, tendencën për të bërë arrestime të motivuara politikisht dhe ndërhyrjen për të shtrirë influencën e saj politike në ushtri. Ai shtonte se, " çdo veprim i anëtarëve të "Klikës" synonte marrjen e pushtetit (dhe pasurisë) për anëtarët e saj, dhe prej saj nuk konsiderohej i paligjshëm asnjë mjet për të realizuar këtë qëllim". Smith parashikonte që konflikti i "Klikës" me grupe të tjera jashtë saj do të vijonte. "Ngjarjet e fundit, nënvizonte ai, kanë provuar se, çfarëdo organizatash sekrete nën pushtetin e Hasan Beut ose të një lideri tjetër, nëse ndodh diçka e tillë, janë për momentin në kundërshtim me "Klikën"".[38]

Rrezikun e shpërndarjes së Parlamentit e kuptoi më vonë edhe Pandeli Vangjeli por, tashmë puna kish mbaruar. "Këshilli i Nalt dhe grupi inisjator i "coup d'etat"-ve kish filluar kanosjet, kërcënimet kundra kryeministrit për të cilin kishin mbledhur ku ishin e ku s'ishin fuqit civile të Dan Canit e të shokve dhe e friksonin të jepte dorëheqjen. Pandeli Vangjeli përpara insistimit të Këshillit të Naltë për dorëheqjen e tij ish përgjigjur se me t'u mbledhur parlamenti do të jepte demisionin por Kshilli i Nalt si syflor i grupit inisjator i përgjigjësh se nuk kish nevojë për mbledhjen e parlamentit se vet Kshilli i Nalt në pak orë-ndonse dhe në minut-formonte Kabinetin."[39] Pra, edhe një herë, Parlamentit iu sugjerua një zgjidhje e vetme për të tejkaluar krizën dhe shmangur gjakderdhjen por, organizatorët e grushtit të shtetit kundërshtuan pasi projekti i tyre nuk kishte mbështetjen e shumicës parlamentare. Ngjarjet e vitit 1921 dhe reagimi ligjor ndaj autorëve të grushtit të shtetit, dëshmojnë se sa në çfarë niveli ishte sistemi parlamentar i asaj kohe, si dhe shteti ligjor. Ndaj grushtit të shtetit reaguan shumë

[38] FO 371/7330, f. 581-586, Telegram i Heathcote Smith për Curzon, 18 janar 1922, mbi situatën politike në vend.
[39] Teki Selenica, *Shqipëria më 1923*, Tiranë, 1923, f. 91-92.

deputetë, por, edhe Kryetari i Parlamentit, Eshref Frashëri, i cili, i dërgoi këtë telegram, Këshillit të Regjencës, më 9 dhjetor 1921: "Kabineti i Pandeli Evangjelit, u detyrua kundrejt armëve, të jepte dorëheqjen, që bie në kundërshtim me statutin tonë. I nënshkruar, në cilësinë e Presidentit të Parlamentit, dhe të gjithë deputetët që gjenden këtu, protestojmë kundër kësaj goditjeje arbitrare kundër shtetit, e cila ve në rrezik ekzistencën e atdheut tonë. Sipas Statutit të Lushnjes, një qeveri nuk mund të qëndrojë në fuqi pa votë besimin e parlamentit. Kabineti i ri nuk është njohur nga përfaqësuesit e popullit; i cili kundërshton edhe mbledhjen e Dhomës së Deputetëve, gjë e cila provon faktin se kërkon të drejtojë me forcë. Keni përgjegjësinë për çdo gjakderdhje që mund të ndodhi, ndaj qeverisë uzurpatore dhe ndaj kujtdo që sjell provokime."[40]

Por, roli stabilizues i Parlamentit, do të evidentohej pas shtypjes së grushtit të shtetit. Aty ish-Kryeministri Pandeli Evangjeli dha këto shpjegime mbi ngjarjet e fundit: "Zotnia juaj e dini fort mirë, se, në gjendjen e sotme të partinavet politike, të Parlamentit, sa randë asht qi të formohet nji Kabinet homogjen, nji kabinet prej njerzish nga një parti vetëm. Ka qenë nevojë kurdoherë që me koalicione dhe me Bashkime të Shenjta të formohet nji kabinet, ndryshe nuk do të mundet të marë vot-besimin t'Uej plotësisht. Në të tilla kondisione ndodhesh kabineti në kohën e fundit, dhe kështu vepronte për të mbrojtur interesat e Shtetit në politikën e jashtme si edhe për të vënë në udhë të mirë administratën e Shtetit gjer sa të mblidhesh Parlamenti. Kabinet koalicioni, ministri (qeveria) i dalë nga një ndërmjetësi e disa personave politike dhe patriotë të ndershëm, të ngarkuar prej shumicës t'anëtarëvet të partinavet parlamentare, kështu ish formuar ministeri nënë kryesinët'ime. Forca ekstra-guvernante, fuqija e popullit asht përdorur kurdoherë e kudo, po vetëm kur ka qenë fjalë me heth poshtë një diktatori të tmerrshme, një Qeveri arbitrare e cila ka përdoruar keq forcën publike për dëm të shtetit për të shkelur nënë këmbë të drejtat e popullit. Ky ka qenë qëllimi i revolucioneve; kështu kanë vepruar bota që të shpëtojnë nga një e keqe, nga një rrezik të drejtat e tyre. Ndër ne përkundrazi, ngjarja e fundit n'a çfaqi një mantalitet fare të ndryshëm, një punë që asnjë gjykim logjik nuk e pranon, një vepër reaksionare që nuk ka aspak qëllimin që thamë më sipër. Këshilla e Naltë përdori

[40] *AQSH,* F. 163, Viti. 1921, Dos. 16, fl.19. Telegrame mbi krizat qeveritare, Presidenti i Dhomës- Eshref Frashëri i dërgon telegram Këshillit të Regjencës, dt. 9 dhjetor 1921, mbi ngjarjet e fundit në vend.

mënyra të pa rregullta."[41] Më tej Evangjeli lexoi korespondencën që kishte pasur me anëtarët e këshillit të Naltë. Pas kësaj Parlamenti diskutoi grushtin e shtetit duke e dënuar atë.

Në lidhje me ngjarjet e fundit, M. Frashëri deklaroi: "Kësaj i thonë Coup d'Etat (grusht shteti) d.m.th me rëzue me forcë nji Kabinet qi kishte besimin e Parlamentit dhe që kishte dhanë fjalën e nderit dhe besën për mbledhjen e Parlamentit me 4 Jenar dhe që nuk kish as ndonji shkak të mbrendshëm ose të jashtëm për nji krizë të këtillë. Vendimi ynë lipset të bazohet përmbi këtë grusht Shteti. Disa prej nesh thonë se Statuti i Lushnjës nuk na ep të drejtë për rrëzimin e Këshillit të Naltë. As ndonji Statut në botë nuk përfshinë dispozicionet e posaçëm përmbi grushtin e shtetit. Kjo asht provokim i nji revolutioni, fillimi i Luftës civile. Ata që shkelin Statutin vetë dhe provokojnë me këtë sende të rrezikshme për me rrëzue Statutin qysh kan të drejtë t'invokojnë po at Statut që duen t'a marrin nepër kamë? Grushti i shtetit ai asht fillesa e luftës civile, provokon nji reaktion të fuqivet të Shtetit, të Kombit, t'ushtris, të cilat janë të shtypur prej shtengut (instinct) të gjallëris e të rrnesës të Kombit e të Shtetit."[42] Edhe deputeti L. Koja dha mendimin e tij për këtë çështje: "Sot po bisedohet nji çashtje me randsi dhe gadi nji trathëti. Për me mujt me gjykue nji ligje e me i dhan interpretimin e duhur duhe tpik së parit që neve të rrimë në ligjë e jo me i dhan nji interpretim si pas interesave personale dhe të partisë sikurdoherë që kemi punue deri tash tue shkel Nomin. Po flitet se Këshilli i Naltë ka ba nji (coup d'Etat) dhe vertet që u ba, por para këtij coup d'Etatje ishte ba dhe nji coup d'Etat tjetër. Kur u ba Bashkimi i Shenjtë (nji shoqni e shenjtë) u formue nji gabinet ilegal i cili pati shumë kundreshtime. Pas kësaj Këshilli i Naltë dekretoj mbylljen e Parlamentit. Atëherë kjo vepër nuk u quejt me nji za jasht kanunit, se atëherë Këshilli i Naltë ishte i mirë. Sot si u ba ky i lik dhe bani këtë coup d'Etat? Them se massi kjo vepër e parë e Këshillit të Naltë nuk u kundërshtue, kjo i dha guxim dhe bani të dytën."[43] Z. Vinjau i komentonte në këtë mënyrë ngjarjet e fundit: "Dy nga misët e K. Naltë, Z. Aqif Elbasani dhe Emzot Bumçi, me nji dekret pushojnë Z. Pandeli Evangjeli prej Kryeministrisë dhe ngarkojnë Q. Koculi të formojnë nji qeveri të re. Z. Pandeli Evangjeli refyzon dekretin e pushimit të K. të Naltë si kundra Statutit dhe thërrret Parlamentin për në 15 të Muajit për vazhdim; K. Naltë i bindur se me

[41] *BKK*, Mbledhja e 73-të, 22 Dhetuer 1921, f. 610.
[42] *Po aty.*
[43] *Po aty,* Mbledhja e 73-të, 22 Dhetuer 1921, f. 616.

mbledhjen e Parlamentit këtu, kapricet e tij nuk do të mbusheshin, urdheron dhe ndalon heqjen e telegramit të Z. P. Evangjelit për thirrjen e Parlamentit. Z. Koculi tue mos dashur të përballje responsabilitetin e mbajtjes të nji karike me të tilla kondita, i jep dorëheqjen dhe kemben e tij e ze Z. H. Prishtina i cili me anën e ministravet të tij urdhëron vrasjen e depytetëve të cilët tue mos shikuarë cilësinë e tyne të ndodhun në siguri në kryeqytet, u larguane andej. Le t'i gjykojmë nga pikpamja juridike të tëra këto ngjarje nji nga nji: K. Naltë pushon Z. P. Vangjelin me dekret. A ka të drejtë pas Statutit t'onë K. Naltë të rëzojë nji kabinet që ka marë votë besimi nga Parlamenti? Statuti jonë i Lushnjës, thotë se K. Naltë emnon Kryeministrin, po ky s'mund të fillojë nga puna pa marë votë besimi nga parlamenti; dhe kjo e fundit d.m.th që gjer sa të merret kjo vot' e besimit do të vazhdojë në punë ministeri i vjetër. Pra Statuti ynë i jep të drejtë K. Naltë vetëm të emënojë kryeministrin, dhe vetëm këtë, dhe jo t'a pushojë që kësi soj dy janë mënyrat e ndrimit të nji kabineti pas këti Statuti: 1) rezimi nga an' e Parlamentit dhe e 2). dorëheqja e nji kryeministri prej vetiu. Pra K. Naltë duke pushuarë Qeverinë e P. Evangjelit kapërxeu të drejtat që i jepte Statuti."[44]

Në fakt, duhet gjykuar me kujdes, situata në të cilën u gjendën institucionet përfaqësuese të vendit, në ato momente. Atyre iu mungonte eksperienca, tradita ligjore dhe kapacitetet institucionale, për ta zgjidhur situatën në një mënyrë që, nga njëra anë të ruhej stabiliteti i vendit dhe në anën tjetër, të merreshin masa të tilla ligjore, të cilat të mos lejonin përsëritjen e ngjarjeve të tilla në të ardhmen. Por, qëndrimi i butë apo hezitues i tyre kishte edhe arsye objektive. Ndjekja e një politike të vendosur dhe dënimi ligjor i organizatorëve të grushtit të shtetit, ishte shumë i vështirë. Një politikë e tillë, duhej të kalonte përmes një shtegu tepër të ngushtë e të thepisur, ku shumë lehtë mund të rrëshqitej drejt një lufte civile, e cila, do ta hidhte në erë procesin e sendërtimit të institucioneve dhe të shtetit kombëtar dhe ta vinte në një rrezik serioz vetë ekzistencën e këtij shteti, duke pasur parasysh se fqinjët e Shqipërisë, ishin aty të gatshëm në pritje të zhvillimeve të tilla, për të realizuar objektivat e tyre aneksioniste. Prandaj, qëndrimi i moderuar i institucioneve shtetërore, ndaj komplotistëve, ishte një politikë e urtë, që synonte pajtimin kombëtar me anë të vullnetit të mirë, për ta toleruar opozitën dhe për të pranuar bashkëjetesën me të, duke e shpëtuar kështu, sistemin politik parlamentar dhe duke e lënë të hapur rrugën drejt zhvillimit të institucioneve kombëtare, në mënyrë paqësore, në rrugën drejt demokracisë. Nga ana

[44] *Po aty,* f. 619-621.

tjetër, ky qëndrim tolerant dhe jo adekuat, i vlerësuar në këndvështrimin e zbatimit të ligjit, siç do të ishte bërë në çdo vend tjetër, ku funksionon një shtet pak a shumë ligjor, me institucione relativisht të konsoliduara, linte të hapur gjithashtu rrugën për përsëritjen e grushteve të tjera të shtetit në të ardhmen. Dhe për fatin e keq të Shqipërisë, episode të tilla, të dhimbshme dhe të rrezikshme, nuk do të vononin të vinin.

Roli i Parlamentit, e sidomos i rrymave politike, që vepronin brenda tij, ishte veçanërisht i rëndësishëm gjatë negociatave për formimin e "Bashkimit të Shenjtë", mbi formimet e kabineteve qeveritare dhe mbi krijimin e grupeve parlamentare. Pikërisht, nga dinamika e zhvillimeve të brendshme parlamentare, u konfiguruan dhe u rikonfiguruan disa herë, grupimet politike të viteve 1920-1924. Ndërkohë, debati politik pas vitit 1923, u përqendrua në formën e regjimit politik që do të kishte Shqipëria. Mazhoranca për sa i përket formës së regjimit, u përpoq për krijimin e kushteve të përshtatshme, të cilat mundësonin një procedurë të rregullt parlamentare.

Në sfondin e zymtë të vështirësive të jashtme dhe trazirave të brendshme, duhen vënë në dukje edhe disa prirje pozitive në zhvillimin e jetës shoqërore dhe politike. Para së gjithash, vihet re një gjallërim i rrymave të ndryshme dhe debatet në Parlament filluan të ndiqeshin me interes në të gjithë vendin. Në qytetet kryesore, dolën një numër i konsiderueshëm gazetash, me orientime politike të ndryshme. Për pasojë, filloi të formohej një opinion publik, në kuptimin e mirëfilltë. Është llogaritur se në periudhën prej vitit 1921 deri më 1924, numri i gazetave dhe revistave shkoi në rritje duke arritur në 12.[45] Po ashtu, gjatë kësaj periudhe, u krijuan edhe shumë shoqata që përfaqësonin interesat e shtresave të ndryshme.

Një analizë e hollësishme dhe kritike, i bëhej sistemit parlamentar, në gazetën "Fjal' e Lirë". Sipas saj, sistemi parlamentar në Shqipëri ishte i padobishëm dhe mbase dhe i dëmshëm, "pasi kemi shumë pak fytyra sot për sot politike dhe përkundrazi shumica mendon dhe vepron sipas njerëzve nga të cilët ajo varet." Gazeta shkruante se: "Sistemi parlamentar te ne është një kundër histori, pasi kanë kaluar afro pesë muaj që bëhen mbledhje dhe nuk shohim asnjë rezultat. Parlamenti i mbledhur që me 21 prill e deri sot, s'ka marrë asnjë masë për t'i dhënë popullit ligje që ndalojnë varfërinë, e cila është duke u shtuar dita ditës". Artikulli nënvizonte se, "në bisedimet parlamentare, sidomos në seancën që shkaktoi votën e mos besimit të kabinetit të Vrionit, ishin

[45] Teki Selenica, *Shqipëria më 1927*, Shtypshkronja Tirana, 1928, f. 19-24.

shfaqur dy mentalitete të ndryshme, të cilat, nuk do të zinin vend në historinë e vendit dhe populli nuk do të përparojë dot në këtë mënyrë". Propozimi ishte se, sistemi parlamentar, mund të ishte i dobishëm, vetëm kur të kishte në krye një "Rregullues të Naltë, një Mbret me dorë çeliku, i cili të dërgojë deputetët në shtëpi kur të shohë që varka e shtetit pa timon është në fortunë, ashtu siç e shohim neve sot, siç e kanë lënë kabinetet e shkuara". [46]

Mbi veprimet e Parlamentit, në këtë periudhë, dhanë mendime dhe bënë analiza të ndryshme, shumë eksponentë të politikës së asaj kohe, një ndër të cilët, ishte edhe deputeti Ali Këlcyra. Sipas tij, Këshilli Kombëtar, ishte formuar nga elementë të ndryshëm nga pikëpamja morale dhe kulturore. Ky ndryshim, që shihej në të gjitha parlamentet e botës, ishte edhe më i theksuar ndërmjet deputetëve të kombit shqiptar, ku qytetërimi dhe zhvillimi shoqëror ndryshonte nga një njeri te tjetri dhe nga një krahinë te tjetra. Përveç kësaj, vërente ai, shumë deputetë nuk kishin akoma lirinë e ndërgjegjes së tyre. Nuk mund të mohohej fakti se ata ndodheshin nën influencën e aristokracisë, prandaj dhe në Parlament nuk mund të formohej një parti e lidhur në principe e formuar prej një elementi idealist dhe përparues, e zhveshur nga intrigat dhe ambiciet. Kjo ishte një vërejtje shumë interesante, e cila, flet shumë për mundësitë e kufizuara që kishte Shqipëria e asaj kohe, për të ndërtuar një sistem parlamentar.[47]

Më tej, Këlcyra, analizonte edhe veprimtarinë e Parlamentit, në dy muajt e parë të jetës së tij dhe arrinte në përfundimin se, "ajo nuk është shumë në favorin e tij dhe se nuk jep shpresa për të ardhmen e tij." Ai nënvizonte se, "ishin bërë vetëm dy apo tre propozime të vlefshme, si ai i formimit të një këshilli të posaçëm për elaborimin e ligjeve e ca vendimeve të tjera, dhe nuk ishte bërë asnjë bisedë me rëndësi, në interesin e atdheut". Këlcyra, evidentonte edhe shkeljen e rregullave për konstituimin e një parlamenti normal. Ai shkruante: "Çështjet e Dibrës dhe të Shkodrës ngatërruan dhe ndaluan vazhdimin e veprës parlamentare këto dy muaj. Këtu përgjegjësia është krejt e qeverisë, e cila më shumë në çështjen e Dibrës, e la Parlamentin e parë të Shqipërisë përpara një dileme të keqe: të shkelte normën, atë normë që populli e kishte zgjedhur që ta mbronte dhe kështu të niste jetën e saj me

[46] *Fjal' e Lir,* Vlorë, nr. 34, dt. 27 Vjesht e II, 1921, "Sistemi parllamentar ndër nee dhe mentalitetet e soçmë".
[47] *Drita*, Gjirokastër, nr. 52, datë 27 qershor 1921, Ali Këlcyra, "Mi vepërimet e Parlamentit".

një padrejtësi, ose të mbronte të vërtetën, me gjithë se kjo mund të shkaktonte rrëmujë dhe ngatërresa të përgjithshme." Sipas tij, "Partia Popullore", "nuk mund të mbyllte sytë e të aprovonte këto zgjedhje", të cilat ishin një shuplakë jo vetëm ndaj ligjit dhe të drejtave të një populli, por edhe një komplot kundër mendimit e programit të të rinjve.[48]

Këlcyra akuzonte qeverinë, së cilës, populli i kishte lënë në dorë pa kontroll fatin dhe drejtësinë e zgjedhjeve. Kjo sipas tij, e shtyrë jo vetëm nga ambicia, por, edhe nga "klika e aristokracis së çifligarëve", me të cilët, "ajo kishte bashk'interesa, zgjodhi vetëm veten, si përfaqësuese e provincës së Dibrës, duke përfituar nga gjendja anormale e atjeshme dhe duke shkelur të drejtat e një populli". Këlcyra pohonte se, "të gjitha këto padrejtësi, ishin bërë që të frenohej grupi i të rinjve që po fitonin në Dibër e të mos bëhej një shumicë e fortë në Parlament", nga "Partia Popullore". Ai shtonte se, "protestat dhe kundërshtimet energjike të "Partisë Popullore", për këtë çështje, i humbën parlamentit një muaj kohë. Veç kësaj, intrigat e qeverisë, bashkuar me ato të të huajve, kishin penguar zgjedhjet e Shkodrës deri në atë kohë". Nga ana tjetër, Këlcyra, e quante të drejtë qëndrimin e parlamentit, i cili, duke marrë parasysh rëndësinë e mungesës së 14 anëtarëve, "pëlqeu, jo pa arsye, ta lërë bisedën e vendimin e ndonjë çështjeje me rëndësi, ashtu edhe formimin e qeverisë së re, pasi të vinin përfaqësuesit e popullit të Shkodrës." Kjo vlerësohej prej tij, si një pengesë në punën e Parlamentit, por këto arsye theksonte Këlcyra, nuk e justifikonin mungesën e aktivitetit të parlamentit, këto dy muaj. Tashmë që do të niste vërtetë jeta parlamentare, ai parashikonte dhe sugjeronte që çështjet me rëndësi, që do të diskutoheshin në këtë sesion, ishin të shumta dhe mund të ndaheshin në dy kategori: ato që i përkisnin drejt për drejt organizimit e rregullimit të shtetit dhe ato që lidheshin me zhvillimin e përmirësimin e jetës shoqërore të tij. Sa për formën e shtetit, as që mund të bëhej fjalë në këto momente. Duke marrë para sysh rëndësinë e saj, ajo do të shqyrtohej nga një mbledhjeje e posaçme e përfaqësuesve të kombit e formuar nga qeveria dhe e zgjedhur nga populli për këtë qëllim. "Sa të japë Evropa sanksionin juridik ne jemi të detyruar të mbajmë statu quo-në", shkruante Këlcyra.[49] Ndër detyrat praktike dhe emergjente të parlamentit, Këlcyra rendiste, shqyrtimin e buxhetit, pasi qeveria akoma nuk e kishte prezantuar atë. Ai mendonte se, sistemi financiar që vazhdonte nga koha e Turqisë, me gjithë të metat e tij, nuk mund të

[48] *Po aty.*
[49] *Po aty.*

ndërrohej krejtësisht. Të dhjetat dhe shumë taksa të tjera, ishte e nevojshme të mbeteshin edhe ca kohë, deri sa të bëhej një kadastër. Ai pohonte se, për reformat e tjera, si ato të administratës, të gjykatave e të ushtrisë, "qeveria kishte pregatitur ca nome dhe të tjera do të përgatiteshin nga Këshilli që do të formohej për t'i përgatitur lëndë parlamentit, duke elaboruar ligjet e duhura". Për sa i përket përmirësimit të jetës shoqërore, ai vinte në dukje se "reformat që duhej të bëheshin ishin të panumërta". Por, përfundimi i tyre, varej nga koha e nga mjetet e tjera kapitale dhe nga specialistët, për të cilët, ai theksonte, se atëherë mungonin krejt.[50]

Në pikëpamje institucionale, është me interes edhe vërejtja që bënte gazeta, e cila shkruante se, "deputetët duhej t'i jepnin shpjegime popullit në gazetat e vendit të tyre, se çfarë pune kishin bërë dhe cila ishte pikëpamja e tyre mbi atë dhe këtë çështje. Tashmë nuk kishte Prefekturë që të mos kishte dy ose më shumë gazeta, të cilat mund të shërbenin për të ndërmjetësuar deputetët me popullin. Kjo gjë ishte veçanërisht e nevojshme në një vend si Shqipëria, ku nuk kishte parti të organizuara mirë dhe të njohura anë e mbanë. Nëse do të ishte kështu, çdo vepër e deputetit do të gjykohej nga anëtarët e partisë dhe në bazë të programit. Kurse në Shqipëri, çdo deputet vepronte individualisht, sipas pikëpamjes së tij të veçantë". [51]

Por, kriza politike dhe njëherësh kriza e parlamentarizmit në Shqipëri, nuk u shmang dhe rezultat i saj, ishte grushti i shtetit, i dhjetorit të vitit 1921. Interesant është se kësaj ngjarje të dhimbshme i bëri koment edhe shtypi i huaj. Kështu, gazeta britanike "London Times" shkruante: "Parlamenti shqiptar u-mblodh sërish më 22 dhjetor e vendosi ta quajë të paligjshme zgjedhjen e tetë deputetëve të qarqeve që qenë zaptuar hëpërhë prej serbëve, duke pasur parasysh prezencën e ushtarëve të huaj në krahinat e tyre. Me këtë vendim H. Prishtina dhe ca nga përkrahësit e tij i humbën vendet e tyre në Parlament. Parlamenti pastaj adoptoj një rezolutë që deklaron se Regjentët Akif Pasha dhe Mgr Bumçi nuk janë më anëtarë të Regjencës, nga që vepruan kundër kushtetutës kur kërkuan dorëheqjen e z. Pandeli Evangjelit, i cili kishte besimin e Parlamenti dhe kundërshtonte influencën e huaj që inspironte politikën e atyre Regjentëve".[52] Nga ana e saj, gazeta "Dielli", bënte këtë koment negativ për situatën e re që u krijua në Parlament pas

[50] *Po aty.*
[51] *Po aty,* nr. 58, datë 7 gusht 1921, "Depytetët dhe populli".
[52] *Dielli,* dt. 16.01.1922.

dështimit të grushtit të shtetit: "Parlamenti e nxorri jashtë Hasan Prishtinën dhe shtatë deputetë të tjerë. E quajti zgjedhjen e tyre të pakanunëshme, duke marrë para sysh ndodhjen e ushtarëve të huaj në vent të tyre. Sido që të jetë, Gegëria sot përfaqësohet në Parlamentin tonë me 43 deputetë dhe Toskëria me 34. Çdo distrikt elektoral, i Gegërisë gëzon privilegjin të nxjerrë të paktën një deputet më tepër se sa ka të drejtë pas popullatës. Drini dhe Kosova janë më të favorizuarat, se cilado prej këtyre nxier nga tre deputetë më tepër, dhe këta jo të zgjedhur prej popullit, po të emëruar prej Guvernës së ditës. Me hyrjen e deputetëve të Drinit e të Kosovës, Parlamenti ynë u-bë një veglë e verbër e Ahmed Beg Zogut dhe "klikës" së tij. Nga të 78 deputetët tanë kanë mbetur në opozitë nga 23 veta, dhe këta të ndarë e pa lidhje parimesh: Vatranët 4, Shkodranët e Gurakuqit 8, Beratasit e Qemal be Vrionit 6, Sulejman be Delvina, Koço Tasi e Ibrahim Xhindi".[53] Pra, dobësimi i opozitës parlamentare konstatohej me saktësi nga "Dielli".

Shkarkimi i dy anëtarëve të Këshillit të Lartë, i cili, ishte një veprim i detyrueshëm, do ta thellonte krizën politike, e cila, do të shfaqej edhe si një krizë e këtij organizmi. Më tej, dorëheqjen e dhanë edhe dy anëtarët e tjerë të regjencës. Duke njoftuar dorëheqjen e tyre, Këshilli Kombëtar me shkresën Nr. 750, i drejtohej Kryeministrisë: "Kemi nderin me u bamë të njoftun se Këshilli Kombëtar në mbledhjen e sotme n'orën 10 para dreke, këndoj dorëheqjen me Nr. 574/R dhe datë 23/XII/921 të ish-shkëlqesiëvet të tyne antarëvet të Këshillit të Naltë z. Dr. Turtulli dhe Abdi Toptani. Këshilli Kombtar emnoj e dërgoj nji komision me u çfaq dëshirën e ish-Shkëlqesivet të tyne, t'a marrin prapsh dorëheqjen dhe të vazhdojnë në detyrë. Mbi insistimin e këtyne, Këshilli Kombtar ua pranojë dorëheqjen dhe me vota të plota zgjodhi si antar të Këshillit të Naltë Shkelqësiët e tyne z. Refik Topija dhe Sotir Pecin të cilët masi i betojë u dorëzoj dhe vendimin e vet t'eminimit të tyne".[54]

Pas dështimit të grushtit të shtetit dhe masave që u morën kundër shkaktarëve të tij, opozita filloi të artikulojë gjithnjë e më me forcë kërkesën për thirrjen e Asamblesë Kushtetuese. Këtë pikëpamje, e shprehte edhe Faik Konica, i cili nënvizonte se, ""Kanuni i Themelit" kishte një rëndësi të veçantë, pasi ishte guri mbi të cilin mbështetej tërë

[53] *Po aty,* dt. 7.10.1922.

[54] *AQSH*, F. 155, Viti. 1922, Dos. I-62, fl.1. Shkresë e Këshillit Kombëtar dërguar kryeministrisë, mbi dorëheqjen e anëtarëve të Këshillit të Naltë, Eshref Frashëri, dt.24.12.1921.

trupi politik i një kombi të lirë". "Po shtete të reja, si Shqipëria s'kanë se ç'bëjnë tjetër veç se të caktojnë një Kanun të Themelit me të shkruar dhe (brand new), anë e mbanë të ri. Ç'do komb që nis një jetë zyrtare dhe hyn në radhë të shteteve, është i shtrënguar t'i bindet asaj nevoje. Ta heqim një herë e mirë nga mendja besimin se "Evropa" e vendosi si shtet Shqipërinë. Jo, Evropa deshi vetëm t'i japë Shqipërisë një rast që të provojë se është e zonja të formojë një shtet".[55]

Dështimi i grushtit të shtetit, i dhjetorit të vitit 1921, ishte një shans i ri që i jepej mbijetesës së sistemit parlamentar në Shqipëri. Nga ana tjetër, vetë grushti i shtetit dhe shpërndarja para tij me mendjelehtësi e parlamentit, dëshmonte se sa i brishtë ishte ky institucion në Shqipëri dhe se sa të vakëta ishin shanset për forcimin dhe konsolidimin e tij në të ardhmen.

Duke përfunduar mund të themi se, në Shqipëri, ndonëse, ishte krijuar një parlament me fuqi të gjera legjislative dhe qeverisëse, ai ishte i detyruar të bashkëjetonte me fuqitë personale të individëve të fuqishëm, jashtë strukturave shtetërore. Kjo, ishte një anomali e madhe, jo vetëm për qeverisjen demokratike, por, edhe për procesin e shtet-formimit, e cila u shndërrua në një pengesë kërcënuese për ekzistencën dhe funksionimin e institucioneve kombëtare.

[55] *Dielli,* nr. 2521, dt. 7.10.1922, F. Konica, "Jeniçerët dhe kanuni i themelit".

Albana MEMA

SUMMARY

SOME PERSPECTIVES ON THE ACTIVITY OF THE FIRST ELECTED PARLIAMENT IN ALBANIA 1921-1923

Even though the first elections in Albania were held at a very inconvenient time, the first truly Albanian parliament resulted from these democratic and free elections. The formation of a pluralist and democratic parliament was of a special importance for the beginning of a democratic political life and the creation of state institutions. However, the Albanian political class had not yet fully grasped the concept of democratic governing. As such, the political class had not yet developed the habit of debating nor was it aware of the concenpt of political war within the context of the parliament and the constitutional norms.

However, some historiographical criticism was made in regard to the law for elections, as well for the census for mandating as a parliament member only those who were able to write in Albanian – a law which excluded those who were financially underprivileged. The possibility of the citizen to vote on their own or have someone assist them was also criticiezed, however it should be taken into consideration that the law was written conform the condition of the Albanian society at the time. As time would prove later on, even the opposition was unable to bring into power a different law for elections, and was thus obligated to adopt the previous existing law.

At this period, the two main political parties in Albania was the 'Popular Party' and the 'Party for advancement'. Both these parties were formed after the elections at the National Council. Even though the latter maintained legislative power, they were obligated to conform to the personal authority and power some individuals had. As such, this co-habition would become a serious threat to the proper functioning of the state and national institutions in the attempts for consolidating and stabilizing them.

Anduana SHAHINI (KERTALLI)

QËNDRIMI POLITIK I SHQIPËRISË DHE PENGESAT E NDESHURA NË KONFERENCËN E PARË DHE TË DYTË BALLKANIKE

Politika e jashtme shqiptare në vitet '30, për shkak të shumë faktorëve, merr një orientim ballkanik. Pjesëmarrja e qeverisë shqiptare në Konferencën e Parë dhe të Dytë Ballkanike shoqërohet me një interes të madh brenda dhe jashtë vendit. Platforma e qeverisë mbështetet tërësisht në mbrojtjen e interesave kombëtare pavarësisht vështirësive që paraqiten herë pas here gjatë konferencës. Me gjithë vështirësitë ekonomike, delegacioni, i kryesuar nga Mehmet Konica, kërkoi si në Konferencën e Parë dhe të Dytë të zgjidhej çështja madhore e minoriteteve shqiptare në vendet fqinjë dhe përfshirjen e Shqipërisë në çdo pakt apo marrëveshje me lehtësira ekonomike. Në këtë rast vendet pjesëmarrëse nuk nguruan të paraqesin pakënaqësitë e tyre, optimizmin apo në rastin më të keq synimet e tyre hegjemoniste. Me gjithë karakterin joqeveritar konferencat kishin në themel platformat e qeverive që ato përfaqësonin.

Në tërësi, Shqipëria, për shkak të pozicionit të saj gjeopolitik, përpiqej të aplikonte një politikë të jashtme adriatiko – ballkanike, me synim mbijetesën në mes kthetrave të fqinjëve të saj tokësor dhe jo vetëm. Ftesa për të tilla konferenca e takime me shtetet ballkanike vjen pikërisht në kohën e krizës së marrëdhënieve shqiptaro – italiane, presionit Italian për të rinovuar Traktatin e Parë të Tiranës që kërcënonte drejtpërdrejtë pavarësinë e Shqipërisë dhe shfrytëzohet pozitivisht nga qeveria shqiptare. Organizimi i Konferencave Ballkanike është nisma më e bujshme e shteteve të Ballkanit drejt idesë për bashkëpunim në vitet '30 të shek. XIX. Periudha përpara viteve '30 të shek. XIX përshkohet nga një klimë jo e favorshme ekonomike dhe diplomatike mes vendeve ballkanike. Historikisht bashkëjetesa e tyre ka kaluar në rrjedha të vështira, mes konfliktesh territoriale dhe nacionale.

Shkaqet e fenomeneve të tilla e kanë origjinën në zgjidhjet e gabuara të diktuara nga Lufta e Parë Botërore. Të njëjtin problem ekonomik po e kalonte edhe Evropa e viteve '30, e cila prej kohësh po punonte dukshëm drejt zyrtarizimit të idesë për bashkim.

Në situatën politike të viteve '20 – '30 të shek. XIX sistemi i marrëdhënieve ndërkombëtare kishte ndryshuar. Evropa Qendrore, kryesisht Gjermania, e shikonte Ballkanin si një mundësi të mirë depërtimi ekonomik. Ndërkohë që Franca dhe Italia i kishin të hershme ndikimet e tyre në Ballkan si pjesë të politikës së jashtme. Gjermania tenton të ndërhyjë për të ndryshuar këto ekuilibra, ndërsa Italia e sheh veten të lidhur ngushtë me Ballkanin, sidomos me Shqipërinë edhe pse në vitet '30 shfaqet dukshëm kriza mes dy vendeve. Pra interesi për Ballkanin shtohet në prag të thirrjes për krijimin e një konfederate ballkanike.

Një tjetër faktor i shfaqur në aspektin ekonomik dhe evidentuar në këtë periudhë ishte Amerika. Ajo ishte kthyer në superfuqi ekonomike pas Luftës së Parë Botërore, ndërsa Anglia po konkurrohej ndjeshëm nga Franca në tregun evropian. Presione ekonomike dhe jo vetëm kishte edhe përtej kontinentit nga shtete, si Rusia apo edhe Turqia, të cilat tashmë po ecnin të sigurta drejt zhvillimit të tyre. Pra pozicioni i Evropës nuk ishte më i njëjti si ai përpara Luftës së Parë Botërore. Në kuadrin e këtij fenomeni të ri, në Evropë lind nevoja e një bashkëpunimi ndërshtetëror. Ideja e një bashkëpunimi të tillë mban autorësinë e Aristidh Briandit, politikanit të njohur francez.

Franca ishte një nga vendet kryesore të Evropës, interesat e së cilës prekeshin nga luhatjet e tregut ndërkombëtar, ekuilibri ekonomik kishte ndryshuar në Evropë dhe kështu që ndihej domosdoshmëria e një bashkimi mes vendeve të Evropës në aspektin ekonomik. Plani i Briandit mbi formimin e një konfederate evropiane konsiderohet si një përpjekje tepër serioze drejt krijimit të frymës bashkëpunuese të shteteve evropiane. "Nisma të tilla në Evropë kishte pasur edhe në të shkuarën, por rëndësia e planit të Briandit qëndron në faktin e jetëgjatësisë dhe jehonës që shkaktoi, si dhe pjesëmarrjes masive të vendeve"[1]. Ndikimi planit të Briandit përcaktohet edhe nga shpeshtësia e letrave që vinin për këtë qëllim nga legata Franceze. Ndër to përmendim letrën që përcjell idenë bazë të platformës së tij ku ndër të tjera shprehet se "në përgjithësi është fakti që Z. Briand nuk do të

[1] Gazmend Shpuza, "Shqipëria ndërmjet Ballkanit dhe Apenineve" Ekstra, Tiranë 1999, f. 17

improvizojë "shtetet e bashkuara të Evropës", sepse e gjithë kjo do të ishte e parealizueshme edhe e frikshme hë për hë... por të krijojë përmes një pakti një kontakt të vazhdueshëm për të marrë vendime në raste të veçanta në favor të tyre"[2]

Citimi i planit të Briandit është tepër i rëndësishëm, pasi ka një ngjashmëri të madhe mes tij dhe idesë për krijimin e konfederatës ballkanike. Ideja e planit të Briandit zhvillohet pothuajse në atë frymë që nisën Konferencat Ballkanike. Pra, huazohet e njëjta ide për t'u vënë në jetë, por kësaj radhe në kushte dhe në një terren krejt tjetër, në Ballkanin e viteve '30.

Vendet ballkanike e kristalizuan idenë e tyre për bashkëpunim dhe ftuan zyrtarisht për pjesëmarrje shtetet, si: Jugosllavia, Bullgaria, Shqipëria, Rumania, Turqia dhe vetë Greqia. Jehona e kësaj konference rajonale kishte filluar që në shtator të vitit 1930 përmes shtypit dhe propagandës së qeverive të vendeve pjesëmarrëse. Shtypi shqiptar e nisi informimin pikërisht në shtator të vitit 1930. Ky bashkëpunim sipas tyre përcaktohej si i ngjashëm me organizatën e Lidhjes së Kombeve, ku më e rëndësishmja është që se çdo shtet e ruan statusin e vet dhe nuk cenohet nga asnjë shtet tjetër.

Konferenca e Parë Ballkanike u realizua nën moton " Ballkani ballkanasve"[3] , e cituar nga Jugosllavët përkundrejt popujve ballkanas. Në parim kjo nismë është pozitive, por mendoj se problemi i ballkanasve është i dyfishtë, ai buron së brendshmi dhe nga ndërhyrjet e fuqive të mëdha. Megjithëse marrëdhëniet diplomatike pas Luftës së Parë Botërore ishin rimodeluar, Ballkani mbeti përsëri me shumë probleme. Vendet ballkanike shqetësoheshin përsëri për problemet nacionale dhe problemet e minoriteteve. Madje në këndvështrimin perëndimor të viteve '30, Konferenca e Athinës u perceptua si një aktivizim i përbashkët i popujve ballkanas, për t'u mbrojtur ndaj lëvizjeve revolucionare të kohës, fashizmit dhe komunizmit. Kjo do të shërbente si një nismë, për të marrë pjesë në mënyrë të përbashkët e për t'i siguruar kompetencat e nevojshme bllokut antisovjetik. "Masat revolucionare dhe klasa punëtore në Ballkan i njihnin mirë kontradiktat dhe përgatitjet e reja për luftën interballkanike"[4]. Ato njihnin njëlloj

[2] AQSH, F. 151, V. 1930, D. 103, fq. 23 (Letër e legatës shqiptare ne Francë dërguar MPJ-së)

[3] E. Rossi " La seconda coferenza Balcanica" Botuar në revistën "L'Europe Orientale" Roma 1932, nr.1-2, f.6 (pjesë e koleksionit të revistës "Les Balkan's" në fondin e Bibliotekës Kombëtare Tiranë)

[4] Po aty, fq.1-6

qëllimet kriminale të këtyre qeverive, thekson Prof. E. Rossi, një studiues i Ballkanit, duke iu referuar themelimit e gjallërimit të lëvizjeve politike ekstremiste në vendet kryesore të Ballkanit. Gjithashtu masat revolucionare, kryesisht punëtore, në Ballkan do të mblidhnin forcat për të parandaluar politikat kriminale të diktaturave qeveritare të asaj kohe. Ato do të gjenin forcën e nevojshme për të ndërtuar, për të ngritur me duart e tyre bashkimin e popujve të Ballkanit në një federatë ballkanike të popujve punëtore[5]. E megjithatë Padefordi, një tjetër studiues i fenomenit, pohon se "formimi i grupimeve rajonale bazuar në objektiva të përbashkët dhe afërsitë gjeografike, kanë qenë një nga drejtimet kryesore të marrëdhënieve ndërkombëtare që nga Lufta e Parë Botërore"[6] duke na dhënë kështu një këndvështrim tjetër të fenomenit. Megjithatë Konferencat Ballkanike parashtruan fillimisht problemin ekonomik, me gjithë ndërhyrjen e qeverisë shqiptare dhe asaj bullgare për të përfshirë edhe problemin e minoriteteve.

Qeveria Shqiptare u njoftua përmes një shkrese zyrtare dërguar në prill të vitit 1930 në MPJ në Tiranë. Përmes saj bëhej e ditur natyra, qëllimi dhe objektivat e Konferencës së Parë Ballkanike që do të mbahej në tetor të po atij viti. Në vazhdim të shkresës zyrtare pranohej se do të kishte çdo vit konferencë dhe se vendet e ndryshme të Ballkanit do të ishin mikpritëse të saj. Komisioni i krijuar paraprakisht për vendet pjesëmarrëse ishte krijuar dhe kishte marrë jetë në Kongresin XXVII Universal të Paqes të mbajtur në Athinë në 6-10 tetor 1929. Shqipëria ftohet të merrte pjesë "pa qenë nevoja që të merret me punë apo me të drejta, gjatë konferencës së parë, me qëllim që ta informojë qeverinë mbretërore mbi punimet e konferencës"[7]

Qëllimi i kësaj konference është afrimi i popujve që kanë interesa ekonomike dhe afërsi territoriale, ngjashmëri kulturore dhe historike. Qëllimi i shërben bashkëpunimit, i cili mund të përmblidhet në një projekt - ide si më poshtë:

- Do të hartohej programi i konferencës në mënyrë që të evidentoheshin problemet që i ndanin ballkanasit në mënyrë që të hartoheshin zgjidhjet më të mira të mundshme pa krijuar probleme të reja.

[5] Po aty, f.1-6
[6] Norman J. Padelford "The movement toeëards international organization in the Balkans", New York, Ocford university press, 1935, f.2
[7] AQSH, F.151, D.103, V.1930. F.101

- Në organizimin e konferencës do të merrte pjesë një delegacion, ku në këtë delegacion nuk duhej të kishte më shumë se 30 personalitete nga çdo vend përfaqësues.

- Përzgjedhja e delegatëve do të bëhej në funksion të qëllimit të konferencës. Personalitetet duhet të përfaqësonin interesat e shtresave të ndryshme sociale, por edhe interesat e shteteve në përgjithësi. Ato mund të zgjidheshin nga shoqata të ndryshme, mjafton që të përcillnin idetë e drejtësisë dhe solidaritetit ndërkombëtar.

  Zyra ndërkombëtare do të ishte konsultative, në të do të merrnin pjesë edhe dy përfaqësues ndërkombëtarë, njëri nga Lidhja e Kombeve dhe tjetri nga ndonjë organizatë tjetër e kësaj natyre. [8]

- Konferenca parashikohej të zhvillohej në të gjithë kryeqytetet ballkanike, por komiteti drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Paqes vendosi Athinën si qytetin e parë ku do të zhvillohej konferenca.

Për të informuar në mënyrë të detajuar qeverinë shqiptare dhe vendet e tjera pjesëmarrëse përpilohet edhe memorandumi nga Komiteti Ndërkombëtar për Paqen në Gjenevë. Përmes këtij memorandumit jepen të gjitha udhëzimet e duhura për krijimin e delegacionit për çdo vend. Përfaqësuesit duhet të jenë pjesë të komiteteve lokale të krijuara për këtë qëllim. Ata duhet të jenë përfaqësues të qarqeve parlamentare e politike, anëtarë të shoqatave kombëtare, të dhomës së industrisë, të dhomës së agrikulturës, shoqërive tregtare, shoqatave intelektuale apo shkencore, universiteteve, gazetarë dhe të shoqatave të gruas. Delegacioni përgjithësisht nuk duhet të ketë më shumë se 30 përfaqësues.[9] Për sa i përket programit paraprak të konferencës ai përmblidhet në tre zëra kryesorë:

I. Parimet e përgjithshme mbi të cilat duhet të organizohet Bashkimi Ballkanik (organet, kompetencat, marrëdhëniet me

[8] AQSH, F.151, D.103, V.1930. F.105 (Lidhja e Kombeve, Zyra Ndërkombëtare e Punës, Dhoma Ndërkombëtare e Tregëisë, Bashkimi Interparlamentar, Bashkimi Parlamentar Ndërkombëtar i Tregtisë)

[9] AQSH. F. 151, D. 103, f. 19 – 20(Sipas Memorandumit të dërguar më 30 qershor 1930 nga Bureau International De La Paix)

Lidhjen e Kombeve) si dhe organizimi i Konferencave Ballkanike.

II. Masat për afrimin politik dhe intelektual të shteteve ballkanike.

III. Masat për të favorizuar bashkëpunimin ekonomik[10]

Për çështje të tilla si dobia dhe mundësia e locarno-s ballkanike, krijimit të një instituti intelektual ballkanik, reforma e mësimit të historisë në shkolla, krijimit të një banke ndërballkanike, do të merrej parasysh opinion i çdo delegacioni duke u mbështetur veçanërisht në opinion e specialistëve në delegacion[11]

Menjëherë pas mbërritjes së këtij lajmi hartohet një qarkore nga MPJ në Tiranë, e cila u shpërndahet secilës legatë (Athinë, Beograd, Sofje, Bukuresht, Romë[12]), sidomos atyre të vendeve ballkanike që të informoheshin mbi këtë ngjarje. Një rëndësi të veçantë duhej t'i kushtonin interpretimit të pjesëmarrjes së Shqipërisë në këtë konferencë. Çfarë mendimi kishin krijuar qarqet politike të çdo vendi mbi konferencën dhe pjesëmarrjen e Shqipërisë, sigurisht aty ku ekzistonte mundësia të sigurohej mendimi i tyre. Për këtë konferencë vetë ministri i jashtëm është "favorevoleve" dhe sipas tij observatori " nuk ka aspak të drejtë të angazhojë qeverinë por vetëm të raportojë mbi qëllimet, dëshirat, sugjerimet dhe internocionet e konferencës në fjalë"[13]. Pra shkresa përcjell jo vetëm kërkesën ndaj legatave për të raportuar mbi mendimet e vendeve ku ato punonin por edhe qëndrimin e ministrit, i cili në fakt është edhe qëndrim i qeverisë të cilën ai përfaqëson.

Pra në qershor të vitit1930 qarkorja mbërrin në Bukuresht dhe më 11 qershor 1930, menjëherë vjen edhe raporti me qëndrimin e qeverisë dhe perceptimin e Rumanisë mbi pjesëmarrjen e Shqipërisë në Konferencën e Athinës. Raporti " fton Shqipërinë të marrë pjesë me anë të një observatori në konferencë"[14] Meqenëse qëllimi i konferencës është afrimi i popujve ballkanas në aspektin ekonomik, kulturor, historik dhe shpirtëror në kuadrin e Lidhjes së Kombeve, nuk mund të

[10] AQSH. F. 151, D. 103, F. 21

[11] AQSH. F. 151, D. 103, F. 29 (Dok. në emër të Komisionit Ndërkombëtar të Paqes, hartuar nga sekretari I përgjithshëm H. Golay)

[12] AQSH, F. 151, D. 103, V. 1930. F. 101-102 (Qarkore, nr. 1013/4)

[13] AQSH, F.151, D.103, F.103- 107

[14] AQSH, F.151, D.103, F.103- 107 (Në këtë raport paraqiten të detajuara të gjitha arsyet e pjesëmarrjes së Shqipërisë në Konferencën e Para Ballkanike 5 tetor 1930)

ketë ndonjë përplasje në parim. Nga ana tjetër qeveria nuk ngarkohet domosdoshmërish me detyrime pasi konferenca organizohet si një nismë jashtë sferave qeveritare, por që sigurisht pa mbështetjen e tyre nuk do të mund të organizohej. Rëndësia e saj në sferën ekonomike është për t'u vlerësuar, pasi, në delegacionet që do të përfaqësojnë vendet, kërkohen jo vetëm politikanë të shquar por edhe përfaqësues të organizatave të mëdha si Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Dhoma e Agrikulturës, Shoqatat e punës dhe Shoqatat Bashkiake. Ajo pra e sheh me pozitivitet pjesëmarrjen dhe madje vlerëson edhe interesin e qeverisë mbretërore shqiptare. Ndër të tjera në raport thuhet se " ka disa legjenda të cilat duhet të marrin fund në mënyrë që Ballkanet të pushojnë së qeni vendi nevralgjik i Evropës, e për këtë ilaçin e ka brenda vetes"[15] shprehet ministri në këtë raport.

Një përgjigje nga Beogradi pritej me interes në qarqet shqiptare, për vetë faktin e natyrës së marrëdhënieve të krijuara me këtë shtet. Në retrospektiven historike Jugosllavia karakterizohej në atë kohë si një shtet me synime hegjemoniste, i cili gjatë viteve 1912-1920 në çdo rast kishte këmbëngulur në shtrirjen e autoritetit të saj në territoret shqiptare. Në historiografinë shqiptare rivaliteti tradicional italo-jugosllav në Shqipëri ka qenë një nga faktorët negativë që ka penguar konsolidimin e shtetit shqiptar[16]

Në prill të vitit 1919 Pashic kishte biseduar me Willson-in për çështjen shqiptare dhe i kishte lënë të kuptonte këtij të fundit që nuk kishin asnjë kundërshtim me parimin "Ballkani popujve të Ballkanit, dhe se popullit shqiptar t'i jepej pavarësia brenda kufijve të caktuar"[17] duke ju referuar hapsirave për veprimtari ekonomike dhe intelektuale e kulturore. Entuziazmi i tij vazhdon edhe më tej përpara Willson-it me idenë e bashkëpunimit me Shqipërinë në aspektin doganor. Por ndryshimet politike në Beograd kishin ndryshuar edhe kursin e politikës së jashtme, revanshi agresiv i Jugosllavisë ndaj Shqipërisë u ndal vetëm me pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, pas përpjekjeve të vazhdueshme të Britanis. Periudha më pas shoqërohet me incidente të krijuara në kufi, për të ekuilibruar depërtimin italian në Shqipëri. Periudha 1924-1928 përkon me një klimë të turbullt politike në

[15] AQSH. F.151, D.103, F.106.
[16] Paskal Milo "Shqipëria dhe aleanca ballkanike" Tiranë, Studime Albanologjike, 1997, fq.55
[17] Vuk Vinaver "Anglia dhe pozita ndërkombëtare e Shqipërisë midis dy luftrave botërore" Gjurmime Albanologjike, Prishtinë 1968, fq. 187

Jugosllavi, rreth 24 qeveri zëvendësuan njëra-tjetrën duke e thelluar akoma më tepër krizën ekonomike, politike dhe ndërhyrjen masive të kapitalit të huaj në ekonominë jugosllave. Sektorët industrialë e bankarë, në pjesën më të madhe ishin të financuar nga Franca. Ndërhyrja franceze konsiderohej nga historiografia shqiptare përpara viteve '90- të si një tentativë për "Stabilizim të situatës nën petkun e rivendosjes së rendit konstitucional,u shërbente planeve e interesave politike dhe ekonomike të imperializmit Francez në Jugosllavi dhe Ballkan."[18] Marrëdhëniet mes dy vendeve ishin acaruar në 1926 kur u nënshkrua Pakti i Parë i Tiranës, impakti negativ i të cilit kishte drejtuar Jugosllavinë drejt nënshkrimit të një serie traktatesh dypalëshe me Francën, Bullgarinë dhe Rumaninë. Situata kishte degraduar në ndërprerje të marrëdhënieve deri në fillim të vitit 1930, kohë kur ishte shfaqur edhe fillimi i krizës italo-shqiptare.

Në lidhje me këtë fenomen të shfaqur në marrëdhëniet ndërballkanike, Beogradi përfaqësonte një nga aktorët kryesorë. Për këtë arsye nga Beogradi vjen përgjigjja relativisht e shpejtë (20 qershor 1930) drejtuar MPJ-sw, Z. Reuf Fico. Përfaqësuesi i Shqipërisë në Beograd njofton ministrin e Punëve të Jashtme mbi qëndrimin e Jugosllavisë. Pas takimit që kishte pasur me Z. Marinkovic kishte kuptuar se "Jugosllavia do të merrte pjesë, por me qenë se çështja e konfederatës apo e bashkimit ballkanik shkakton "objeksione" dhe se vështirësitë që ekzistojnë janë të mjaftueshme, delegatët nuk do të jenë përfaqësues të qeverisë dhe kjo e fundit nuk do të lidhet zyrtarisht me vendimet që do të merren në këtë konferencë."[19] Qëndrimi i qeverisë jugosllave dukej se do të ishte në përputhje me rrethanat që do të krijoheshin gjatë konferencës.

Qeveria bullgare ndërkohë e kishte pranuar ftesën dhe kishte konfirmuar pjesëmarrjen e saj[20] Megjithatë vizioni i saj në lidhje me konferencën është tepër pesimist. Sipas qeverisë bullgare realizimi i një afrimi të vërtetë ballkanik nuk mund të ndodhë pa u zgjidhur disa çështje:

- Çështja e minoritetit bullgar në Greqi, Rumani dhe Serbi.
- Çështja e kufijve të saj me shtetet fqinje

[18] Paskal Milo "Histori e evendeve të Ballkanit 1918-1939" Kombinati Poligrafik, Tiranë 1987, fq.35
[19] AQSH. F.151, D.103, F.192
[20] AQSH. F.151, D.103, F.17 (25 qershor 1930, nr.152/1)

- Dalja e Bullgarisë në detin Egje, premtim i parealizuar ndaj shtetit bullgar.

Bullgaria nuk e shikon me simpati edhe për faktin se Greqia këmbëngul në idenë e hedhjes së bazave të reja për afrimin ndërballkanik, por kjo nuk është e mundur pasi sipas saj nuk mund të shkelen të drejtat e popujve të cenuar më parë. Optimizmi i Bullgarisë shfaqet në aspektin ekonomik dhe kulturor kur e quan këtë konferencë si një mundësi për të shtuar bashkëpunimin ndërballkanik. Për arsye të natyrës jozyrtare të konferencës edhe qeveria bullgare vendos të mos i bëjë publikë delegatët e saj.

Përgjithësisht ruajtja e ekuilibrave në Evropë ishte "meritë" e diplomacisë britanike. Në se do t'i referohemi çështjes së bashkimit ballkanik, Britania përpiqej të krijonte "Lokarnin e Ballkanit"[21]. Që në vitin 1926 ajo u përpjek të krijonte paqe në këtë rajon duke ekuilibruar mbivendosjen e synimeve ekspansioniste të Jugosllavisë që mbështetej nga Franca dhe Italisë që kishte nisur në atë kohë të investonte aq shumë në Shqipëri. Në studimet e kohës ndërhyrje e kapitalit të huaj në Shqipëri paraqitet në shifra shumë të larta. Kështu, në periudhën 1929-1931 sasia e mallrave në franga ari për eksport –importin variojnë për Italinë 60.4%-46.2% në 66.1%-46.8%, për Jugosllavinë 1.5%-7.9% në 1.9%-9.7%, për Britaninë 0.4%-7.0% në 1%-5.9% [22]. Ndërhyrja italiane është ajo që shqetëson Jugosllavinë, ndërsa ndërhyrja e kapitalit Britanik merret si një investim në eksporte për të ekuilibruar ndërhyrjen italiane[23]

Për sa i takon legatës mbretërore në Londër, përmes shkresës zyrtare, më 22 korrik 1930 njoftohet se ministri i Shqipërisë në Londër është ftuar të marrë pjesë në një mbledhje të organizuar nga ministri i Greqisë në Londër me qëllim komunikimin e përgatitjeve të Greqisë për Konferencën Ballkanike. Në të merrnin pjesë ministrat e të gjithë vendeve ballkanike në Londër dhe vetë nismëtari i konferencës, Z. Papanastasiu, mbajti fjalën e rastit. Ai porositi dhe nxiti pjesëmarrësit që të këmbëngulnin në krijimin e komiteteve lokale në vendet e tyre.[24] Ministri shqiptar pohon në letër se në një bisedë me Z. H. Lafontaine[25]

[21] Vuk Vinaver " Anglia dhe pozita…" f.207
[22] Naqo Sinani "Politika reaksionare e Portës së hapur të qeverisë së Zogut" Tiranë, Studime historike, nr.1, 1893, f.98
[23] Vuk Vinaver "Anglia dhe pozita …" f.221
[24] AQSH. F.151, D.103, F.20
[25] AQSH. F.151, D.103, F.20 (Z.H. Lafontaine është kryetar i Zyrës Ndërkombëtare të

si dhe me disa përfaqësues grekë e bullgarë pranojnë se ndjehet domosdoshmëria e një afrimi të popujve të Ballkanit"[26] Në këtë rast nuk mund të kuptojmë cili është qëndrimi i qeverisë britanike në lidhje me konferencën apo pjesëmarrjen e Shqipërisë në të, por fakti që lejon organizimin e mbledhjeve të ndryshme me këtë rast, tregon interes ndaj çështjeve ballkanike. Këtë e dëshmon edhe përpjekja e vitit 1930 kur ajo hyri në tratativa mes Italisë, Francës e Jugosllavisë që të parandalonte nënshkrimin e pakteve analogë mes Shqipërisë, Italisë, Francës e Jugosllavisë. "Nuk duhet t'i japim mundësi Italisë të thotë se ishte e detyruar ta përtëri Paktin e Tiranës, sepse nuk ishte në gjendje të sigurojë pavarësinë e Shqipërisë në një mënyrë tjetër."[27]

Roma dukej shumë e ndjeshme ndaj lëvizjeve që po ndërmerrte qeveria Shqiptare, sepse përgjigje pozitive arritën të marrin pothuajse nga të gjithë vendet e tjera, përveç Italisë, e cila nguroi të japë pëlqimin e saj. Në fillim të viteve '30, mes Shqipërisë dhe Italisë kishte nisur një krizë në marrëdhëniet dy palësh. "Pakënaqësia kishte nisur në shtresën e ulët shoqërore, por nuk përjashtohej edhe pakënaqësia e elementëve të veçuar në rrethet politike." [28] Ndërhyrjet e kapitalit italian në Shqipëri ishin në nivelet më të larta[29] dhe ekonomia pothuajse ishte e varur plotësisht nga huat dhe kreditë e Italisë. "Marrëdhëniet italo - shqiptare veçanërisht gjatë qeverisjes së Musolinit kanë qenë të komplikuara"[30] shprehet prof. Kerner, dhe mendoj se kjo ka shërbyer si një shtysë drejt politikës adriatiko - ballkanike të Zogut. Pra drejt trajektoreve të reja politike me vendet fqinjë. Rasti më i mirë i paraqitet me ftesën për pjesëmarrje në Konferencën e Parë Ballkanike të cilën e vlerësoi menjëherë.

Qeveria Shqiptare në aspektin e brendshëm po punonte për krijimin e një komisioni me specialistë për t'u përfaqësuar ne konferencë. Këshilli i Ministrave në praninë e kryeministrit z. Pandeli Evangjeli, të z. Reuf Fico, ministër i Punëve të Jashtme dhe kabinetit qeveritar,

---

Paqes në Gjenevë)

[26] AQSH. F.151, D.103, F.20.

[27] Vuk Vinaver "Anglia dhe pozita …" f.222

[28] Massimo Borgogni "Tra continuata e incertezza. Italia e Albania 1914-1939) Francoangeli, Milano, f.117

[29] Iliaz Fishta " Ndërhyrja e kapitalit të huaj dhe pasojat skllavëruese për Shqipërinë 1931-1936" 8 Nëntori, Tiranë 1989, (shih kreu III "Tensioni ne marrëdhëniet shqiptaro-italiane" f.57-116)

[30] Robert J.Kerner & Harry N.Howard "The Balkan Conferences and the Balkan Entente" University of California Press, Berkeley, California 1936, f. 18

morën vendimin që do të merrnin pjesë në Konferencën e Parë Ballkanike dhe do të dërgojnë në këtë konferencë një komision të përbërë nga z. Mehmet Konica, z. Mid'hat Frashëri e Patër Gjergj Fishta.[31] Më vonë komisioni mori trajtë të plotë. Pjesë e komisionit u bënë edhe Jul Bonati, Maliq Bushati, Bedri Peja, Asim Jakova, Stavro Stavi, Leonidha Naci, Fasli Frashëri, Seid Toptani, dhe Zj. Emine Toptani.

Në aspektin e respektimit të pakicave duhej të punonin shumë diplomatët shqiptarë, pasi kjo çështje përbënte problem për mbarëvajtjen e konferencës. Në të njëjtin qëndrim shfaqen edhe bullgarët, të cilët kërkojnë domosdoshmërish respektimin e pakicave të tyre. Shqipëria u bë pjesë e Konferencës së Parë Ballkanike dhe u përpoq të arrinte qëllimet e saj. Motivet që e shtynë qeverinë shqiptare në pjesëmarrje ishin të shumta: kriza ekonomike botërore, kriza në marrëdhëniet me Italinë, problemet e vazhdueshme nacionale me fqinjët dhe mundësia e perspektivave të reja. Impenjimi i delegacionit duket në të gjitha fushat e bashkëpunimit. Komisionin politik, ku edhe situata paraqitej shumë e nxehtë, u menaxhua nga diplomacia e hollë e z. Mehmet Konica. Po ashtu edhe komisionet e tjera patën përfaqësuesit e tyre, p.sh., ai i komunikimit dhe gazetarëve u përfaqësua nga Leonidha Naci apo komisioni mbi çështjet sociale, sektori i gruas u përfaqësua nga znj. Emine Toptani.

Të gjithë delegatët u munduan të përfshihen në politikat rajonale përmes mbështetjes që i dhanë krijimit të unionit ballkanik. Megjithëse Konferenca e Parë hodhi vetëm themelet e krijimit të këtij unioni, mund të themi që impakti i saj filloi të ndihet në rajon sidomos në Shqipëri. Kjo e fundit më shumë se kurrë e ndiente domosdoshmërinë e ndryshimit të kursit të politikës së jashtme. Rishikimi i pozitave të saj me fqinjët tokësor dhe pozicionimi në lidhje me Italinë ishin problemet kryesore që duhej të zgjidhte. Në të gjitha drejtimet mbreti Zog dëshironte, madje këmbëngulte në fqinjësi të mirë dhe përfshirjen aktive të Shqipërisë në Konferencat Ballkanike. Nisma e tij për të orientuar shtypin të shkruaj sa më shumë për konferencën ballkanike[32] dhe miratimi që ai personalisht i akordoi përfaqësuesve janë dëshmi e dukshme e orientimit të tij. Të tilla veprime diplomatike në favor të politikës ballkanike ndodhin në të njejtën kohë me krisjen e

[31] AQSH. F.151, D.103, F.30.(Vendim nr. 622 dt. 23. 07. 1930, Këshilli i Ministrave)
[32]AQSH. F.151, D.52, F.150.(Mbretëria Shqiptare, Zyra e shtypit; Porosi Fletorevet Shqipëtare "rezervat")

marrëdhënieve shqiptaro-italiane. Pas kërkesave të vazhdueshme nga qeveria shqiptare për ulje të nivelit të shlyerjes së kredisë dhe akordimit të një kredie të rem, por jo me kushtet e pretenduara nga Musolini, vjen edhe kjo hapësirë e re për politikën e jashtme shqiptare.

Mbyllja e punimeve në Konferencën e Parë Ballkanike, që u mbajt 5-12 tetor 1930 dhe rikthimi i delegacionit në atdhe, çel siparin e debateve publike në qarqet akademike shqiptare dhe në diasporë. Çështja kryesore ishte se sa ishte arritur të dëgjohej zëri i Shqipërisë dhe se sa përparësi do të sillte anëtarësimi i vendit atje. Në shtypin e kohës u trajtuan gjerësisht çështja e programit dhe e statusit që do të gëzonte çdo shtet pjesëmarrës. Në përgjithësi intelektualët ishin ata që prisnin realizimin e këtyre aspiratave ballkanike. Nën moton e lokarnos evropiane kërkonin të realizonin lokarnon ballkanike, mbi baza reale dhe të drejta.

Shqipëria kishte meritat e saj në lidhje me përfaqësimin dhe çështjet e drejta që parashtroi në konferencë. Problemi i minoriteteve, edhe pse nuk i shkonte për shtat politikave jugosllave apo greke, arriti të diskutohej në konferencë e madje të sigurojë mbështetjen e Bullgarisë e Rumanisë[33]. Shqipëria u përfaqësua denjësisht në të gjashta komisionet e krijuara në seancën e parë të konferencës. Komisioni i politikës, që përfaqësohej nga Mehmet Konica, e përballoi me sukses akuzën e delegacionit jugosllav kur u shpreh se mund të arrihej një marrëveshje vetëm nëse nuk kishte ndërhyrje në punët e brendshme nga fuqi të treta, duke iu referuar Shqipërisë dhe pozitës së saj me Italinë. Argumentet e paraqitura nga diplomati Konica, ku theksoi mbi të gjitha independencën shqiptare, u vlerësuan me ovacione nga të gjithë pjesëmarrësit, aq sa e detyruan përfaqësuesin jugosllav të tërhiqej nga deklarata e tij dhe të theksonte se ishte tërësisht mendim personal dhe jo qëndrim i qeverisë që ai përfaqësonte. Sipas delegacionit, afërsi politike u krijua më tepër me Turqinë, Rumaninë, Bullgarinë Greqinë e më pak me Jugosllavinë. Në Konferencën e Parë qëndrimi i Shqipërisë ishte i njëjtë me atë të pjesëmarrësve të tjerë, pra në favor të një bashkimi ballkanik, por në platformë disi më ndryshe nga sa e parashtronin vendet e tjera. Me gjithë dëshirën e mire për veprimtari kombëtare në favor të Konferencës Ballkanike, vendi pati praktikisht më tepër artikuj të shkruar nëpër gazeta se sa veprimtari konkrete. Pra, përgjegjësia që mori me vete delegacioni mbeti praktikisht në letër. Gjendja e vështirë ekonomike e bashkërenduar edhe me faktorët e tjerë diplomatikë patën

[33] AQSH. F.151, D.103, F.248

efektin e tyre frenues për sa i takon iniciativave organizative. Përplasjet ideore dhe polemikat mbi qëndrimet e ndryshme të palëve, në rastin më të mirë botoheshin në gazeta. Vitet e krizës së thellë ekonomike e kishin përqendruar vëmendjen e qeverisë shqiptare drejt gjetjes së mundësive për të kapërcyer vështirësitë ekonomike dhe mesa duket tek Konference e Parë Ballkanike nuk i perceptuan sinjalet e bashkëpunimit.

Në verë të 1931 u intensifikua veprimtaria proballkanike e qeverisë shqiptare. Mbreti Zog në atë periudhë pohonte se "çështja Shqiptare është një çështje Ballkanike dhe jo e Adriatikut siç propagandonte Italia."[34] Përpjekjet e tij u thelluan në drejtim të vendeve fqinjë sidomos me Jugosllavinë, nga e cila shpresohej për rrugë të reja bashkëpunimi, sidomos në kushtet e krizës së thellë me Italinë. Pra "larg" Italisë por jo presionit të saj dhe në mes të krizës së thellë ekonomike, projektohet pjesëmarrja në Konferencën e Dytë Ballkanike. Ministri i Jashtëm, Hysen Vrioni, deklaroi në qarqet politike vendase dhe në takimet me përfaqësuesit e huaj se qeveria ishte e entuziazmuar për pjesëmarrjen në Konferencën e Dytë Ballkanike. Këtë e përforcoi më tej me urdhrin e saj zyra e kryeministrit ku përmes një letre i kërkonte gazetave shqiptare që të botonin aktivitete nga konferenca e Stambollit.[35]

Mbi bazën e një raporti të ardhur në MPJ në Tiranë (25 qershor 1931)[36] u ngrit dhe funksionoi programi i komisionit përfaqësues në Konferencën e Dytë Ballkanike. Programi u hartua mbi baza kombëtare, madje karta nacionaliste vazhdoi të përsëritet edhe në këtë konferencë. Zhvillimet e Konferencës së Dytë të mbajtur në Stamboll, sollën një detajim të problematikave të gjashtë seksioneve të konferencës. Sipas perceptimit të shumicës së vendeve pjesëmarrëse orientimi i tyre duhet të orientohej drejt aspektit ekonomik, sepse aty ishte i garantuar suksesi. Nëse edhe në këtë konferencë do të hapej çështja e pakicave, çdo arritje do të vihej në diskutim. Presioni më i madhe ishte i fokusuar në sesionin politik, vetëkuptohet për natyrën e problemeve që paraqiste Ballkani. Aspektet sociale dhe ekonomike në përgjithësi hodhën bazat e bashkëpunimit rajonal, "thembra e Akilit" vazhdonte të ishte çështja e minoriteteve. Përmes traktateve bilaterale ishte rregulluar çështje postare, gjithashtu u hodhën bazat për bashkëpunimin tregtar, doganor, intelektual dhe universitar. Risia që sjell Konferenca e Dytë është plani për hartimin e draftit të parë për realizimin e paktit ballkanik.

[34] Paskal Milo " Shqipëria dhe …" fq.61
[35] AQSH, F.151, V.1931, D.52, F.150
[36] AQSH, F.151, V.1931, D.52, F.60-62

Detyrat e vendosura në Konferencën e Parë Ballkanike kishin filluar të zbatoheshin. Në vende si Jugosllavia dhe Greqia jehona e veprimtarive kombëtare në favor të unionit ballkanik vazhdonte, megjithëse jo në ritmet e kërkuara. Shpeshherë raportet që duhej të vinin nga selitë e vendeve pjesëmarrëse në selinë qendrore nuk mbërrinin në kohën e duhur ose nuk vinin fare. Një mungese e tillë vështirësonte punën e komisioneve të ngritura në konferencë. Për pasojë të mungesës së koherencës, problemet nuk evidentoheshin siç duhet dhe pasonin njëri-tjetrin.

Për të motivuar qeverinë shqiptare, shpesh është drejtuar nga Athina edhe diplomati Mehmet Konica. Ai e informon qeverinë mbi seancat parlamentare që zhvillohen në parlamentin grek, me qëllim përshpejtimin e punës së komisioneve intelektuale dhe postare, dhe e udhëzon këtë të fundit të krijojë një komision me gjashtë specialistë përkatësisht në fushat: politikë, ekonomi, sociale, intelektuale dhe komunikacion[37], të cilët duhet të hartojnë raportet përkatëse dhe t'i dërgojnë ato në Stamboll në prill të vitit 1931. Në këtë kuadër do të ketë edhe vizita të ndërsjella midis vendeve përfshi edhe Shqipërinë, sidomos në fushën e administrimit lokal. Gjithashtu, ai informon përmes raportit mbi veprimtarinë e këshillit të konferencës ballkanike në Selanik. Në këtë këshill ishin diskutuar disa aspekte të rëndësishme të organizimit të Konferencës së Dytë Ballkanike. Çështje të tilla, si: natyra dhe organizimi i unionit ballkanik, krijimi i një komisioni paraprak për hartimin e një projekt-ideja mbi paktin ballkanik, masat për unifikimin e drejtësisë, caktimin e një dite ballkanike në nder të bashkimit ballkanik, zgjedhja e një komisioni për mbrojtjen e duhanit dhe komisioni i financave, ishin çështjet parësore në këtë mbledhje të kryesisë së këshillit të konferencës.

Çështja më e rëndësishme ishte ajo e ngritjes së një komisioni, i cili do të hartonte draftin e paktit ballkanik, dhe në këtë pikë komisioni parashikonte se çdo grup kombëtar do të caktonte dy specialistë që do të studionin çështjen dhe do të paraqisnin platformën e tyre në këtë komision. Në fazën e dytë vetë komisioni do t'i studionte variantet dhe do t'i publikonte ato edhe për grupet e tjera kombëtare dhe do të diskutohej publikisht në Konferencën e Stambollit.[38] Gjithashtu Konica e njoftoi qeverinë shqiptare se me disa reduktime është pranuar edhe plani i punës për Konferencën e Dytë Ballkanike, sigurisht me shumë

[37] AQSH, F.151, V.1931, D.52, F.10-11
[38] AQSH, F.151, V.1931, D.52, F.13

polemika nga ana e përfaqësuesve jugosllavë për çështjen e minoriteteve. Me rëndësi është pika tre e planit të punës ku pranohet se do të ketë " bisedim mbi raportin e komisionit të posacëm për aplikim pikërisht të marrëveshjeve në fuqi dhe të detyrimeve që rrjedhin prej tyre, tue marrë brenda edhe ato që u përkasin pakicave."[39] Pranimi i kësaj çështjeje, krahas aspekteve të tjera, ishte një mundësi e mirë për t'u shfrytëzuar nga ana e popujve që ndiheshin të cenuar nga ky fakt. Mbetej vetëm impenjimi i tyre dhe dëshira e mirë e popujve të tjerë dhe e kryesisë së vendeve ballkanike për t'u trajtuar. Për të realizuar pjesën e publicitetit në shtyp, mbi Konferencës Ballkanike dhe arritjeve të saj, çdo grupi kombëtar do t'i akordohej një mijë dollarë, të cilat do të përdoreshin për botimet e ndryshme me në fokus unifikimin ballkanik. Vetë qeveria shqiptare, përmes përfaqësuesit të saj, i ishte bashkuar nismës së Greqisë dhe Turqisë për të ndihmuar selinë e kryesisë për veprimtarinë e saj me shumën 25000 franga.

Shqipëria vazhdoi të ishte mjaft e interesuar për veprimtarinë e fqinjëve të saj në lidhje me Konferencën e Dytë Ballkanike e cila po afronte. Eksperienca e Konferencës së Parë dhe polemikat e vazhdueshme me Jugosllavinë e kishin qartësuar trupën diplomatike shqiptare për terrenin e vështirë të krijuar në konferencë. Por në kushtet e krizës së thellë ekonomike dhe ndërprerjes së marrëdhënieve diplomatike me Italinë, fqinjët tokësore dhe nisma e bujshme e krijimit të unionit ballkanik ishin e vetmja shpresë për Shqipërinë. Për t'u parapërgatitur për situatën dhe qëndrimin e Jugosllavisë, nga legata e Beogradit, në prill të vitit 1931 vjen një kopje e memories së tyre që do të paraqite në konferencë. Përpjekjet e Jugosllavisë kishin nisur me mbajtjen e mbledhjes së Antantës së Vogël, thelbi i të cilës kishte qenë qëndrimi i tyre kundër iniciativës gjermano-austriake mbi projektin e bashkimit doganor[40]. Sigurisht që pas organizimit të mbledhjes qëndronte Franca, e cila do të mbështeste Jugosllavinë në çdo aspekt për t'ju kundërvënë potencialit gjithmonë e në rritje të Gjermanisë.

Qëndrimi i tyre shkonte në favor të bashkimit ekonomik, sepse e shikonin si jo të plotë edhe pse midis vendeve ishte nënshkruar pakti Kello-Briand, si dhe nënshkrimin e një pakti arbitrazhi. "Disa çështje të varura nga pakti Kello-Briand krijojnë një pengesë serioze drejt unionit ballkanik."[41] Pikëpamja e Jugosllavisë mbështet bashkëpunimin

[39] AQSH, F.151, V.1931, D.52, F.14
[40] AQSH, F.151, V.1931, D.52, F.81
[41] AQSH, F.151, V.1931, D.52, F.60

ekonomik, sidomos atë bujqësor për vetë natyrën e ekonomisë së shteteve ballkanike. Kjo memorie u shfaq publikisht në mbledhjen e Bukureshtit ku u diskutuan disa aspektet të afrimit ballkanik dhe veprimtaritë e Konferencës së Stambollit[42].

Memoria e Jugosllavisë paraqitej skeptike për sa i takon afrimit politik. Ajo sugjeron realizimin e dy faktorëve për të arritur një bashkëpunim ndërballkanik.

Së pari, *ndërhyrja në jetën e brendshme të shteteve fqinje me qëllimin që të ndalojë konsolidimin e tyre, të turbullojë paqen dhe qetësinë ndër to, të jetë drejtpërsëdrejti ose indirekt me anë të organizatës ose tolerimit në tokën e tij, të grupeve të armatosura, të cilat kanë për qëllim të atakojnë paqen e brendshme e sigurinë e shteteve fqinje.*

Së dyti, *afrimet dhe aleancat me shtetet ekstra-ballkanike që kanë për qëllim tendenca kolonizimi në tokat ballkanike e që toka e tij dhe forcat e tyre dhe institucionet janë në dispozicion për t'u përdor kundra një ose më shumë shteteve ballkanike.*

Mbretëria shqiptare pasi kishte siguruar informacionin e nevojshëm e kishte të qartë terrenin politik me të cilin do të përballej në Konferencën e Dytë. Përmes zyrës së shtypit, më 5 shtator 1931, përpilohet një deklaratë. Midis rreshtave pohohet qëndrimi kombëtar i delegacionit shqiptar dhe luten gazetat të realizojnë një fushatë energjike dhe të pareshtur[43] në favor të çështjes së minoriteteve. Delegacioni do të mbështesë këto parime dhe nuk do të pranojë asnjë detyrë nëse ndodhe kundërta.

Në Konferencën e Dytë Ballkanike sesioni politik kryesohej nga Z. Pella dhe në rend të ditës qëndronin çështjet: pakti ballkanik, pengimet që ndalojnë afrimin politik midis kombeve të Ballkanit dhe çarmatimi. Duke iu referuar çështjes së paktit ballkanik, zyrtarisht u shpalos një projekt-ide nga delegacioni grek i kryesuar nga z.Spiropullos. Ky draft përmbante të gjitha parimet e vendosura në Konferencën e Parë, kriteret e realizimit të një pakti mossulmimi, arbitrazhin dhe ndihmën reciproke, si edhe probleme të tjera ku përfshihej edhe çështja e pakicave. Grupi bullgar paraqitet me një memorandum për çështjen e pengesave morale dhe politike të afrimit ballkanik. Sipas pikëpamjes së tyre duhet të krijohej një bazë e përbashkët ligjore, veçanërisht për trajtimin e minoriteteve në Ballkan. Për këtë arsye memorandumi i referohet edhe

[42] AQSH, F.151, V.1931, D.52, F.138.
[43] AQSH, F.151, V.1931, D.52, F.150

artikullit 19 të Paktit të Lidhjes së Kombeve. Jugosllavia paraqitet me platformën e saj që bazohet në dy parimet e sipërpërmendura. Përfaqësuesit turq e vënë theksin tek mungesa e traktateve bilaterale mes shteteve si parakusht për krijimin e unionit ballkanik dhe përfunduan me dhënien e dy rekomandimeve për vendet e tjera të rajonit: së pari, sheshimin e mosmarrëveshjeve me natyrë madhore, dhe së dyti, domosdoshmërinë e lidhjes së marrëveshjeve dypalëshe midis shteteve që nuk kanë ende.

Delegacioni shqiptar, i kryesuar nga Mehmet Konica, propozoi krijimin e gjashtë komisioneve në gjashtë vendet pjesëmarrëse për të studiuar gjenden e pakicave, nëse për pakicat zbatohen traktatet respektive. Këto komisione do të kishin varësi nga kryesia e komitetit ballkanik dhe do të ushtronin veprimtarinë për tre muaj, duke nisur nga dita e mbylljes së Konferencës së Dytë Ballkanike. Parimisht delegacioni shqiptar u shpreh pro për cilindo propozim që do të siguronte gjerësisht të drejtat e pakicave.[44]

Çështja e pakicave fillon të marrë rëndësinë e duhur pikërisht pas deklaratës së delegacionit shqiptar. Menjëherë përfaqësuesi grek, Papanastasiu, propozoi krijimin e një komisioni të vetëm për çështjen e pakicave, ndërsa delegacioni bullgar propozoi që çështja të zgjidhej me traktate dypalëshe jashtë konferencës. Për sa i takon qëndrimit të delegacionit jugosllav mund të themi që këtu shpërthyen polemikat mes përfaqësuesve të delegacioneve. Memoria shqiptare kishte tronditur palën Jugosllave, sepse thellësia dhe këmbëngulja mbi çështjen e pakicave në përmbajtjen e platformës i referohej drejtpërdrejtë shqiptarëve, që pas traktateve të paqes së Luftës së Parë Botërore jetonin jashtë territorit etnik shqiptar. Z. Topallovic deklaroi se memoria shqiptare është një sharje kundër shtetit jugosllav[45], por vetë Konica e mohoi një deklaratë të tillë. Tensioni mes dy grupeve vazhdoi më tej kur fjalën e merr Z. Jonic, që ishte edhe kryetar i delegacionit jugosllav. Përmes toneve të ashpra ai akuzoi delegacionin shqiptar për memorien e tyre, e cila, sipas tij, ishte tërësisht e krijuar nën influencën italiane, duke e quajtur "emertinencë". Por, Konica sërish e kundërshtoi qetësisht atë duke u shprehur se " emertinencë quhet sjellja e juaj që është e një t'egri të zbritur prej maleve dhe jo të një njeriu të qytetëruar siç pretendoni ju. Do të bëni mirë të heshtni se ndryshe kam për t'u parashtruar këshillit të gjithë keqbërjet e juve kundër pakicave

[44] AQSH, F.151, V.1931, D.52, F.200-201.
[45] AQSH, F.151, V.1931, D.52, F.202

shqiptare."[46] Vetëm kaq mjafton për të kuptuar brishtësinë e një nisme të tillë. Konica e shfrytëzoi këtë moment dhe përpara të gjithë delegacioneve pohoi publikisht se Jugosllavia po e akuzonte Shqipërinë padrejtësisht, madje po e vendoste përpara përgjegjësisë atë " ose me italinë kundër neve ose me neve kundër Italisë". Por interesat e të gjithëve ishte që Shqipëria të mbetej e paanshme. Marrëdhëniet me Italinë erdhën, përveç të tjerave, edhe si rezultat i refuzimit dhe i pretendimeve të Jugosllavisë. Madje Konica nuk e humbi këtë rast për t'i ballafaquar edhe aleancën mes Jugosllavisë dhe Francës. Por këto të fundit u justifikuan nga ana e tyre se nënshkrimi i aleancës ishte si pasojë e traktateve italo-shqiptare, megjithëse realisht aleanca franko-jugosllave është më e hershme se ajo italo-shqiptare. Në këtë ngjarje akuzat shkuan deri në atë pikë sa Shqipëria u akuzua nga Jugosllavia për pranim të forcave ushtarake italiane në territorin e saj, fakt i cili shqetësonte këtë të fundit. Mbi këtë çështje edhe vetë delegacioni jugosllav u kristalizua në dy rryma të ndryshme, pjesa që ishte kundër një marrëveshje ballkanike (përfaqësuar nga Z. Jonic) dhe pjesa pro një marrëveshje të tillë (përfaqësuar nga Z. Marinkovic)

Meritë e delegacionit shqiptar ishte që e mbajti të mbërthyer akoma në agjendën e Konferencës Ballkanike çështjen e pakicave. Me gjithë vështirësitë që pati, këmbëngulja e tyre bëri të mundur krijimin e një komisioni të veçantë që do të merrej me problemet që solli kjo çështje, zgjidhjen e konfrontimeve dhe vendosjen e veprimtarive në rrugë të drejtë.

Arritjet më të mëdha të Konferencës së Dytë Ballkanike i përkasin aspektit të afrimit intelektual. Raporti i delegacionit shqiptar mbi afrimin intelektual, u botua në organin e konferencës "Les Balkanes". Për sa i takon unifikimit të së drejtës në Ballkan, u krijua një seksion juristësh njohës të mirë të të drejtave të shteteve të tyre, të cilët do të bashkërendonin punën e tyre për të sjellë një të drejtë të përbashkët. Pjesë e këtij seksioni ishte dhe delegati shqiptar Suad Aslani. Për sa i takon çështjes së krijimit të federatës së shtypit ballkanik, rolin kryesor në krijimin e statutit të saj e ka Rumania. Rëndësi i kushtohej aktiviteteve të "Javës Ballkanike" të përcaktuara në janar të çdo viti, për të cilën edhe shkrimet do të bëheshin në gjuhën amtare. Masa duhej të merreshin në lidhje me lëndët e historisë dhe gjeografisë në shkollat e mesme, ku duhej të vendosej një raport i ri mes njohurive që merren dhe atyre që duhej të merreshin për historinë dhe gjeografinë rajonale.

[46] AQSH, F.151, V.1931, D.52, F.202

Gjithashtu u hodh ideja e mësimit në shkolla si gjuhë e huaj e dytë një gjuhë ballkanike, apo të krijimit të një instituti ndërballkanik në formën e një shkolle normale ku të mësonin nxënës dhe nxënëse nga i gjithë Ballkani.

Konferencat Ballkanike janë një fenomen historik i viteve 30-të të shek.XX. Ky studim në mënyrë specifike ka për qëllim të rishqyrtojë edhe një herë rëndësinë e pjesëmarrjes së Shqipërisë në këto konferenca. Vështim krahasimor mes versioneve zyrtare të historisë së Shqipëris, përpara e pas viteve 1990-të dhe materialit në Arkivin Qëndror Shtetëror në Tiranë, që përkojnë me këtë ngjarje. Të gjtha këto zenë një pjesë të konsiderueshme të materialit studimor. Në mjdisin e ri ndërkombëtar të krijuar në evropë në përiudhën midis dy luftërave botërore, një ngjarje e rëndësishme i orientoi vendet drejt bashkëpunimit ekonomik, kjo ishte kriza ekonomike e viteve 1929 - 1933 e cila preku pothuajse cdo vend evropian në përmasa të ndryshme. Ballkani, sigurisht si pjesë nevralgjike e evropës e përjetoi me thellë krizën ekonomike sepse përgjithësisht gëzonte nga e kaluara një model ekonomik kryesisht bujqësor dhe industria në shumicën e vëllimit të saj ishte e investuar nga vendet e zhvilluara të evropës me qëllim përfitimi personal. Një tjetër factor ishte edhe tërësia e problemeve të brëndëshme politike, lufta për pushtet mes forcave politike , sundimeve të pa konsoliduara , elitave politike të cilat në të shumtën e rasteve nuk i përgjigjeshin problematikës së kohës.

Organizimi i Konferencave Ballkanike në literaturën e huaj njihet si inisiativë e politikanit Grek Papanastasiu. Në kuadrin e tyre të përgjithshëm tërësia e konferencave që do të zhvilloheshin cdo vit në qytetet e ndryshme të shteteve të ballkanit do të siguronin bashkëpunim në të gjitha fushat e mundëshme, midis vendeve pjesëmarrëse. Konferenca e Parë dhe e Dytë Ballkanike 1930-1931 të mbajtura në Greqi dhe Turqi ishin prelud i nismës së herëshme ballkanase, për krijimin e një formacioni të konsoliduar të vendeve të ballkanit, Unioni Ballkanik që do të realizohej përmes “Pakti ballkanik”. Shqipëria përmes delegacionit të saj, mori pjesë në dy konferencat e organizuara në Greqi dhe Turqi. Interesi i qeverisë shqipëtare ishte në favor të nismës “ballkani ballkanasve” por mbi bazën e kritereve të drejta. Delegacioni i kryesuar nga politikanë dhe intelektualë të zgjedhur mbështeti në konferencën e parë qëllimin dhe organizmat që do të krijonin bazën e një bashkimi ballkanik. Cështja që delegacioni shqipëtar parashtroi për zgjidhje ishte rishikimi i gjëndjes së minoriteteve. Kjo cështje si pasojë e problemeve që shkaktoi u ndesh në

një kundërshtim të hapur nga Jugosllavia dhe Greqia të cilat vazhduan intesivisht të lobonin për unifikim në aspektin ekonomik. Përkrah Shqipëris u rendit Bullgaria interesi i së cilës ishte dalja në Egje dhe çështja e minoriteteve. Polemikat e shumta midis delegacioneve shoqëruan të gjitha seancat e mbledhjes së sesionit politik në Konferencën e Parë Ballkanike. Nuk duhet lënë mënjanë interesi që paraqet mbreti Zog për këtë eveniment ballkanik. Në optikën e tij politike shfaqen në këtë periudhë dy orientime të reja, distancimi nga politika pro Italiane dhe afrimi me ballkanasit, në kuadrin e politikës adriatiko-ballkanike. Në dokumentacionin e shqyrtuar në Aqsh, vecanërisht pjesa që i takon Legatës Italiane, nxjerr në pah qëndrimin e mbretit Zog. Në kontekst të përgjithshëm pranohet se vetë Zogu i jepte udhëzimet delegacionit, në lidhje me qëndrimet që duhejt të mbanin në çështje të caktuara.

Po të krahasojmë versionet zyrtare të Historisë së Popullit Shqipëtar përpara dhe pas viteve 1990 dalim në përfundimin së vetëm version i pas viteve 1990 i jep rëndësi periudhës së Konferencave Ballkanike. Rishikimi i pjesës së politikës ballkanike të Zogut është një domosdoshmëri e cila sipas dokumentave lidhet me dy faktorë kryesorë: Presionin e vazhdueshëm Italian mbi qeverinë shqiptare për depërtimin e saj në cdo aspekt në Shqipëri, dhe gjëndjen e vështirë ekonomike të Shqipërisë. Ftesën për pjesëmarrje në konferencën e parë ballkanike mbreti Zog e priti mjaft mirë duke e perceptuar këtë si një mundësi të mirë për tu afruar me fqinjët dhe me vendet e rajonit. E gjithë veprimtaria e delegacionit mbështetej tërësisht mbi parimet kombëtare dhe në mbrojtje të interesave të vendit.

Ashtu sikurse në Konferencën e Parë Ballkanike të Athinës edhe në Konferencën e Dytë në Turqi , pozicioni i Shqipërisë mbetet i njejtë, parimisht janë pro nismave konkrete për Unionin Ballkanik por mbi baza reale, dmth mbetej në fuqi ende çështja e respektimit të minoriteteve. Madje kjo kauz e delegacionit shqiptar shkaktoi një debat të madh me qëndrimin e delegacinot Jugosllav. Vetëm me ndërhyrjet e ministrave Turk dhe Grek për sqarimin e çështjes u evitua procedimi në këtë konferencë. Pervec kësaj, delegacioni shqiptar u përball edhe me akuzat që buronin nga delegacioni Jugosllav në lidhje me nivelin e ndërhyrjes së qeverisë Italiane në Shqipëri dhe synimet e saj Ballkanike. Ndaj këtij qëndrimi gati ofendues ju përgjigj Konica me një fjalim në të cilin pohonte qartazi se vetë Jugosllavia ishte në të njëjtat kushte, marrëveshjet e saj me Francën kishin të njejtën natyrë. Duke u fokusuar edhe në çështjen e minoriteteve, ai përmes këtij fjalimi që përmbante

qëndrimin shqiptar, shpalosi publikisht përballë të gjithë delegacioneve se Jugosllavia nuk respektonte aspak minoritetin shqiptar, për këtë arsye qëndrimi i delegacionit shqiptar ishte në favor të zgjidhjes së cështjes politike fillimisht dhe më pas cështjeve të natyrave të tjera.

Konferenca e Dytë Ballkanike i siguroi Shqipërisë edhe një aleat të ri në marrëdhëniet ndërkombëtare. Turqia i rifilloi marrëdhëniet e saj me Shqipërinë sepse dihet që me shpalljen e monarkisë shqiptare ajo i kishte ndërprerë marrëdhëniet diplomatike. Ataturku nuk e kishte mirëpritur regjimin monarkik të Zogut dhe publikisht e kishte dënuar atë. Pas kësaj konference dhe porosisë së vecantë të mbretit Zog për të realizuar tratativa me ministrin e jashtëm turk, ndodhi edhe njohja e mbretëris shqiptare nga qeveria e Ataturku.

Pjesëmarrja e Shqipërisë në Konferencat Ballkanike tregon një vision të ri në politikën e jashtëme ballkanike të Zogut gjatë fillimit të viteve 30-të. Aktivitetin e tij në rikuperimin e marrëdhënieve me fqinjët dhe sigurimin e mbështetjes së aleatëve perëndimor, justifikohet edhe me pjesëmarrjen në Konferencat Ballkanike, këtë nismë rajonale. Megjithëse triumfi i konferencave ishte “Pakti Ballkanik” në të cilin Shqipëria nuk u ftua të marrë pjesë, kjo mund të përkufizohet si një nismë e cila shqyrtuar në optikën e kohëve tona, për periudhën në të cilën u realizua pati kufizimet e veta dhe që në asnjë mënyrë nuk e realizoi plotësisht objektivin e saj.

Anduana SHAHINI (KERTALLI)

SUMMARY

THE POLITICAL STANCE OF ALBANIA AND THE OBSTACLES AT THE FIRST AND SECOND BALKAN CONFERENCE

Foreign politics of Albania in the '30s took a Balkanic orientation. The attendance of the Albanian government in the First and Second Balkan Conference was accompanied with a great interest in Albania and abroad. The platform of the government was fully based on the defence of national interests despite the obstacles that were presented several times during the conference.

With all the economical hardship, the delegation headed by Mehment Konica on the occasion of both conferences asked for the issues of Albanian minorities in neighbouring countries to be solved by incorporating Albania in agreements that would warrant economical favoring. Because of its geographical position, Albania was attempting to apply Adriatic-Balkanic oriented foreign policies, which aimed to ensure Albania's survival in the talons of the neighbouring countries. The invitation for such conferences and meetings with the Balkan states came forth at the time of the Albanian-Italian crisis, which resulted in Italy pressuring Albania to revive the First Treaty of Tirana, a treaty which directly threatened Albania's independence.

Beqir META

PËRPJEKJET GREKE NË VITET 1936 - 1939 PËR TË RIGJALLËRUAR HELENIZMIN NË SHQIPËRI DHE PËR TË DOBËSUAR ELEMENTIN SHQIPTAR NË ÇAMËRI

Marrëdhëniet shqiptaro - greke në vitet '20 -'30 të shekullit të kaluar u karakterizuan nga një debat i gjatë për një sërë çështjesh themelore. Pala greke u përpoq me të gjitha mënyrat që të realizonte disa objektiva: të ruante dhe të avanconte helenizmin në Shqipërinë e Jugut dhe ta zgjeronte atë edhe përtej saj. Në këtë kuadër ajo bëri çmos që t'i impononte shtetit shqiptar ruajtjen e shkollave greke në zonat me popullsi ortodokse shqiptare dhe të pengonte përhapjen dhe krijimin e sistemit arsimor kombëtar shqiptar në këto zona. Po në këtë kuadër Athina bëri çmos që të pengonte forcimin dhe afirmimin e Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare dhe ta reduktonte statusin e saj në nivelin e një autonomie të kufizuar, ku Patriakana greke të kishte ndikim thelbësor. Nga ana tjetër qeveria greke vijoi presionin sistematik dhe të studiuar kundrejt popullsisë shqiptare në Çamëri me qëllim që të nxiste shpopullimin dhe asimilimin etnik të saj.

Qeveria shqiptare ndoqi me vendosmëri rrugën e konsolidimit të arsimit kombëtar pa ju nënshtruar presioneve greke, çoi përpara edhe procesin e vështirë të afirmimit të autoqefalisë së kishës ortodokse dhe u përpoq me të gjitha format të mbronte të drejtat e popullsisë shqiptare në Çamëri. Nga ana tjetër ajo respektoi të drejtat e minoritetit grek por gjithashtu u përpoq që edhe të pengonte ndërhyrjen propagandistike me synime antishqiptare të qeverisë greke në zonën e minoritetit. Për këtë qëllim në vitet 1933 - 1934 qeveria shqiptare bëri shtetëzimin e shkollave private minoritare, duke ruajtur të paprekur karakterin grek të tyre. Qeveria greke reagoi duke nxitur kundërshtimin e minoritetit dhe çështja u shtrua për shqyrtim në Këshillin e Lidhjes së Kombeve, i cili nga ana e tij e cilësoi si një problem juridik dhe ja referoi Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë. Gjykata e Hagës vendosi në favor

të kërkesave greke dhe qeveria shqiptare pranoi zbatimin e vendimit të saj.

Pasi arriti objektivin e saj për shkollat private greke, qeveria helene vijoi të avanconte më tej politikën e saj për forcimin e helenizmit në Shqipërinë e Jugut. Në fillim të vitit 1936 Konsullata greke e Gjirokastrës po përpiqej të përpilonte në fshehtësi një statistikë të shtëpive e banorëve të krishterë.[1] Po në këtë kohë edhe Konsullata greke e Korçës kërkoi që në këtë qytet të çelej një kishë, e cila t'i kryente shërbesat në gjuhën greke. Prefektura e Korçës i sugjeroi Ministrisë së Brendshme që kjo kërkesë të refuzohej pasi ajo synonte të krijonte një precedent të cilin Konsullata greke do ta shfrytëzonte më vonë për qëllime antishtetërore.[2] Ministria e Brendshme udhëzoi që konsullit grek t'i thuhej se zhvillimi i meshave në gjuhë të huaja nuk mund të lejohej, pasi ishte në kundërshtim me kanunet eklektike, ndërsa personeli konsullor mund të falej në kisha shqipe, ashtu siç faleshin shqiptarët kur ndodheshin në vende të huaja.[3] Konsulli grek e quajti të padrejtë këtë refuzim dhe këmbënguli se "vetë kryetari i kishës shqiptare, me rastin e krishtlindjeve të kaluara, kishte dhënë meshë në gjuhën greke në Tiranë".[4]

Ndërkohë, e inkurajuar nga marrëveshja greko - shqiptare për mësimin e gjuhës shqipe në shkollat ekzistuese greke në Çamëri dhe për hapjen e shkollave shqipe atje ku nuk kishte shkolla greke, në shkurt të vitit 1936 popullsia e Filatit përgatiti një lutje me shumë nënshkrime, ku i kërkohej qeverisë greke dhe organizmave ndërkombëtare, çelja e shkollave shqipe. Mirëpo, çuditërisht, konsulli shqiptar i Janinës i kërkoi prefekturës së Gjirokastrës të udhëzonte Myftiun e Filatit që popullsia shqiptare të mos bënte kërkesa për shkolla shqipe.[5] Këtë qëndrim e përforcoi Ministria e Brendshme e cila e urdhëroi prefekturën e Gjirokastrës të vepronte me shpejtësi që popullsia e Çamërisë të mos bënte kërkesa për shkollat shqipe.[6] Por kërkesa e nënshkruar prej 150

[1] *AQSh*, Fondi MPB, viti 1936, dos.131, fl.2. Komanda e Xhandarmërisë, Gjirokastër - Komandës së Përgjithshme të Xhandarmërisë, 14 janar 1936.
[2] *AQSh*, Fondi MPB, viti 1936, dos.190, fl.2-3. Prefektura e Korçës - MPB, 11 janar 1936.
[3] *AQSh*, Fondi MPB, viti 1936, dos.190, fl.5. MPB - Prefekturës Korçë, 18 janar 1936.
[4] *AQSh*, Fondi MPB, viti 1936, dos.190, fl.6. Prefektura Korçës - MPB, 28 janar 1936.
[5] *AQSh*, Fondi MPB, viti 1936, dos.125, fl.3. Prefektura e Gjirokastrës - MPB, 1 mars 1936.
[6] *AQSh*, Fondi MPB, viti 1936, dos.125, fl.4. MPB - Prefekturës Gjirokastër, 2 mars 1936.

personave nga qyteti i Filatit i ishte dërguar një javë më parë qeverisë greke. Banorët e Filatit kishin kërkuar çeljen e shkollave shqipe, veças nga ato greke dhe që mësuesit të emëroheshin prej vetë shqiptarëve.[7]

Në Gumenicë e në Filat autoritetet greke kishin caktuar katër mësues (dy prej tyre ishin grekofonë nga Gjirokastra dhe dy korçarë) dhe i kishin paraqitur ata si të dërguar nga Mbreti i shqiptarëve. Kjo ishte një shkelje e hapur e marrëveshjes së arritur me qeverinë shqiptare. Edhe popullsia shqiptare kishte dyshime dhe mendonte se këta mësues i kishte emëruar qeveria greke për të bërë propagandë. Megjithëkëtë porosia e qeverisë shqiptare u zbatua dhe nënshkrimi i lutjeve e kërkesave të tjera u ndalua.[8] Duket se ky ishte një qëndrim i sinqertë por disi naiv dhe i tërhequr i qeverisë shqiptare e cila nuk donte t'u jepte një pretekst grekëve që të tërhiqeshin nga angazhimet e marra me gjysmë zemre dhe jo me sinqeritet. Nga ana e tyre, mësuesit e lartpërmendur po përpiqeshin të mblidhnin nënshkrimet e banorëve shqiptarë të Paramithisë dhe fshatrave të tjera se gjoja çamët preferonin këta mësues për të dhënë gjuhën shqipe dhe greke. Popullsia vendase nuk pranoi të nënshkruante deklarata të tilla, pasi e dinte se ata ishin propagandistë të qeverisë greke.[9]

Në prill qeverisë shqiptare filluan t'i vinë informacione se popullsia e Çamërisë po keqtrajtohej nga shkaku se kishte kërkuar shkolla shqipe. Paria e Gumenicës ishte arrestuar dhe dërguar në Prevezë, me pretekstin se kishin brohoritur për Mbretin Zog.[10]Ndërkohë u riaktivizuan qarqet vorio - epirote. Në Korfuz u organizua një demonstratë ku u kërkua aneksimi i Epirit të Veriut dhe Dodekanezit prej Greqisë.[11]Edhe Komanda e Xhandarmërisë së Konispolit informonte se shqiptarët e Çamërisë po kalonin ditë të vështira. Autoritetet greke kishin filluar një fushatë të re persekutimi, nën pretekstin e mbledhjes së armëve, të cilat thuhej se ishin depozituar në Margëlliç e gjetkë për kryengritjen kundër Greqisë. Dukej qartë se kjo fushatë po zhvillohej për të ushtruar presion

[7]*AQSh*, Fondi MPB, viti 1936, dos.125, fl.6. Prefektura e Gjirokastrës - MPB, 7 mars 1936.
[8]*AQSh*, Fondi MPB, viti 1936, dos.125, fl.6. Prefektura e Gjirokastrës - MPB, 7 mars 1936.
[9]*AQSh*, Fondi MPB, viti 1936, dos.125, fl.7. Prefektura e Gjirokastrës - MPB, 13 mars 1936.
[10]*AQSh*, Fondi MPB, viti 1936, dos.125, fl.18. Nënprefektura Sarandë - MPB, 15 prill 1936.
[11]*AQSh*, Fondi MPB, viti 1936, dos.125, fl.18. Nënprefektura Sarandë - MPB, 15 prill 1936.

mbi popullsinë çame që ajo të mos kërkonte hapjen e shkollave shqipe.[12] Greqia po përpiqej me çdo mënyrë ta pengonte hapjen e këtyre shkollave. Iniciatorët për hapjen e shkollave shqipe, autoritetet i cilësonin si intrigantë dhe propagandistë shqiptarë, kurse popullin e quanin "të pafajshëm dhe turk", me të cilin "elementët e krishterë dhe qeveria greke duhej të shkonin mirë, pasi populli grek dhe populli turk janë pajtuar dhe të lidhur midis tyre".[13]

Duke ushtruar dhunë mbi popullsinë, autoritetet greke, jo vetëm u përpoqën të ndalojnë kërkesat për hapjen e shkollave shqipe por shkuan edhe më tej. Duke u bazuar në përvojën e viteve 1923-1925, kur ata e kishin detyruar një pjesë të popullsisë shqiptare të deklaronte se dëshironte shkëmbimin me grekët e Azisë së Vogël dhe shpërnguljen në Turqi, ato u përpoqën t'i detyronin banorët shqiptarë të nënshkruanin peticione se ata nuk donin hapjen e shkollave shqipe. Me gjithë këtë dhunë, asnjë fshat çam nuk pranoi të bënte kërkesë kundër mësimit të gjuhës shqipe.[14]

Në vjeshtën e vitit 1936 edhe qeveria shqiptare ndryshoi qëndrimin e mëparshëm të tërhequr ndaj mbështetjes së kërkesave të shqiptarëve për të hapur shkolla shqipe në Çamëri. Konsullata shqiptare e Janinës udhëzoi parinë shqiptare të Filatit, Margëlliçit, Paramithisë, Gumenicës që të kërkonin me këmbëngulje, qoftë duke bërë edhe sakrifica, mësimin e gjuhës shqipe në shkollat e fshatrave të tyre.[15] Edhe në dhjetor fushata shtrënguese e qeverisë greke nuk kishte përfunduar. Madje prefektura e Gjirokastrës informonte se qeveria greke po e intensifikonte fushatën e reprezaljeve kundër popullsisë shqiptare të Çamërisë që ta detyronte atë të hiqte dorë nga kërkesat për çeljen e shkollave shqipe. Disa persona ishin internuar pasi refuzuan të nënshkruanin një deklaratë të përgatitur nga autoritetet greke se gjoja shqiptarët e Çamërisë nuk dëshironin shkollat shqipe.[16] Por dhuna dhe shtypja greke nuk u kufizuan me kaq. Nacionalizmi grek po arrinte në kufij të paparashikuar më parë në shtypjen e minoriteteve. Nënprefektura e Bilishtit informonte se qeveria greke kishte ndaluar të

[12] *AQSh*, Fondi MPB, viti 1936, dos.125, fl.17.
[13] *AQSh*, Fondi MPB, viti 1936, dos.125, fl.17.
[14] *AQSh*, Fondi MPB, viti 1936, dos.125, fl.30. Konsulli i Shqipërisë në Janinë - MPJ, 10 tetor 1936.
[15] *AQSh*, Fondi MPB, viti 1936, dos.125, fl.30. Konsulli i Shqipërisë në Janinë-MPJ, 10 tetor 1936.
[16] *AQSh*, Fondi MPB, viti 1936, dos.125, fl.33. Prefektura e Gjirokastrës - MPB, 5 dhjetor 1936.

flisnin gjuhën e tyre gjithë bullgarofonët si dhe pakicat e tjera në Greqi. Për këtë qëllim, nëpër fshatrat minoritare ishin vendosur edhe shpallje publike, ndërsa prefekti i Follorinës kishte bërë një turne nëpër fshatra dhe kishte urdhëruar popullsinë që të mos fliste gjuhë tjetër, përveç gjuhës greke.[17]

Prefektura e Korçës informonte se, ata që nuk flisnin gjuhën greke, gjobiteshin menjëherë dhe, përveç fshatrave shqiptare e sllave, këto sanksione ishin zbatuar edhe kundër nënshtetasve shqiptarë që udhëtonin në Greqi me pasaportë të rregullt shqiptare. Kështu më 18 nëntor xhandarët grekë kishin arrestuar 3 shoferë shqiptarë ngaqë i kishin dëgjuar të flisnin shqip midis tyre. Ata i kishin liruar pas disa orësh në mesnatë, duke i kërcënuar se do të arrestoheshin nëse do të dëgjoheshin të flisnin përsëri shqip.[18] dërsa, Konsullata shqiptare në Manastir informonte se urdhri për ndalimin e sllavofonëve të qarkut të Follorinës që të flisnin gjuhën e tyre po zbatohej me vendosmëri. Në këto fshatra ishin çelur shkolla nate në të cilat mësohej gjuha greke prej sllavofonëve deri në moshën 55 vjeç.[19]

Interesant është fakti se për katundet shqiptare që kishin mbetur në qarkun e Follorinës nuk ishte marrë kjo masë drastike, siç ishte marrë kundrejt fshatrave sllavofone[20]. Ndoshta ky ndryshim lidhet me faktin se, pas spastrimit etnik intensiv të popullsisë shqiptare nga kjo zonë në vitet 1923 - 1925, autoritetet greke mendonin se, tashmë, e kishin arritur objektivin e tyre politik. everia greke u përpoq ta detyronte Tiranën që të pranonte çeljen e shkollave greke në Himarë. Ajo, tashmë, e kushtëzoi lejimin e mësimit të gjuhës shqipe në Çamëri me çeljen e këtyre shkollave. Qeveria shqiptare, fillimisht, refuzoi këtë kërkesë dhe kërkoi respektimin e angazhimeve që kishte marrë më parë Athina. Refuzimi i qeverisë shqiptare për të çelur shkolla greke në Himarë shkaktoi reagimin e shtypit grek. Gazeta "Estia" shkruante se në Himarë, "e cila ka tituj gjakësorë dhe shekullorë që është greke", po

[17] *AQSh*, Fondi MPB, viti 1936, dos.127, fl.3. Nënprefektura Bilisht - Prefekturës Korçë, 22 tetor 1936.
[18] *AQSh*, Fondi MPB, viti 1936, dos.127, fl.7. Prefektura e Korçës - MPB, 23 nëntor 1936.
[19] *AQSh*, Fondi MPB, viti 1936, dos.127, fl.9. Konsullata shqiptare në manastir - MPJ, 23 dhjetor 1936.
[20] *AQSh*, Fondi MPB, viti 1936, dos.127, fl.9. Konsullata shqiptare në manastir - MPJ, 23 dhjetor 1936.

vazhdon arbitrariteti i organeve të shtetit shqiptar.[21] Ndërsa, gazeta "Proini" nënvizonte "shtypjet që po i bëheshin elementit grek në Shqipëri" nga autoritetet shqiptare.[22] "Kathimerini" e paraqiste si "të padurueshme gjendjen e grekëve në Epirin e Veriut"[23], po në të njëjtën mënyrë shkruante edhe "Elinikon Melon"[24] dhe gazeta të tjera.

Në fund të vitit 1936 shtypi grek po vijonte të mbante një qëndrim kritik ndaj qeverisë shqiptare, Për këtë arsye diplomati britanik në Shqipëri A. Ryan zhvilloi një bisedë me Skeferis i cili i tha se marrëdhëniet me Shqipërinë ishin përmirësuar qysh prej zgjidhjes së çështjes së shkollave nga qeveria shqiptare dhe rreth 70 shkolla greke po funksiononin në mënyrë të kënaqshme. I vetmi burim grindjesh midis dy qeverive tani mbetej ai që lidhej me tre fshatrat e Himarës. Ata kishin pasur një pozitë të privilegjuar qysh në kohën e Perandorisë Osmane dhe ishin duke këmbëngulur për të hapur shkolla greke. Qeveria shqiptare kishte kundërshtuar dhe kishte mbështetur apelet që kishin bërë një pjesë e banorëve për shkolla shqipe. Skeferis theksoi se kërkesa për shkolla shqipe nuk ishte rezultat i presionit të qeverisë por ishte bërë për arsye të interesave vetjake të autorëve të saj të cilët kishin arsye për ta pasur mirë me autoritetet. Ai tha se këto fshatra ishin, padyshim shqiptare, duke shtuar me ironi se kokëfortësia e tyre e provonte këtë. Ai do ta nxiste qeverinë shqiptare që t'i lejonte ata të hapnin shkollat greke, më tepër për të qetësuar fshatarët se sa për rëndësinë e çështjes të cilën ai e shpërfilli.

Skeferis përmendi gjithashtu edhe shkollat e Çamërisë dhe shtoi se qeveria greke kishte siguruar mësimin e shqipes në pesë shkolla të kësaj krahine. Shqiptarët kishin kritikuar cilësinë e mësimit dhe ai shtoi se qeveria greke ishte e predispozuar t'i plotësonte këto vërejtje. Por ai kishte frikë se intrasigjenca e qeverisë shqiptare ndaj shkollave greke në Himarë po shkaktonte një efekt negativ. Ai u tregua i kujdesshëm për të mos shkuar më tej në këtë argument dhe nuk tha se të dy çështjet do të kushtëzoheshin me domosdo nga njëra - tjetra.[25] Kuptohet se ky qëndrim diktohej nga fakti se qeveria shqiptare i kishte plotësuar tashmë të gjitha zotimet për minoritetin grekofon dhe Greqia ishte angazhuar që, në këmbim, do të lejonte hapjen e shkollave shqipe në Çamëri.

[21] *AMPJ*, viti 1936, dos.268, fl.30. Përkthim i gazetës "Estia", 20 tetor 1936.
[22] *AMPJ*, viti 1936, dos.268, fl.30.Përkthim i gazetës "Proini", 21 tetor 1936.
[23] *AMPJ*, viti 1936, dos.268, fl.30.Përkthim i gazetës "Kathimerini", 21 tetor 1936.
[24] *AMPJ*, viti 1936, dos.268, fl.30.Përkthim i gazetës "Elinikon Melon", 21 tetor 1936.
[25] FO 371/20252 Sër A. Ryan nga Durrësi për Anthony Eden, 14 nëntor 1936.

Qeveria greke ju shmang me lehtësi angazhimit të saj, të cilin tani qëllimisht po e kushtëzonte, jo me lejimin e shkollave private të minoritetit grek, siç kishte bërë më parë në marrëveshjen me qeverinë shqiptare, por me hapjen e shkollave greke në Himarë e cila ishte një zonë me një popullsi shqiptare që fliste të dyja gjuhët. Grekët parashikonin se do të dilnin të fituar në të dyja rastet pasi, nëse qeveria shqiptare refuzonte hapjen e shkollave greke në Himarë, Athina do t'i shmangej lehtësisht angazhimit të saj për mësimin e gjuhës shqipe në Çamëri, në ato pak shkolla që ajo kishte premtuar më parë. Në rast se autoritetet shqiptare do të lejonin hapjen e shkollave greke në Himarë, atëherë qeveria greke parashikonte se do të arrinte një fitore edhe më të madhe, pasi do të krijonte precedentin faktik dhe ligjor për rigjallërimin e arsimit grek në Shqipërinë e Jugut, ashtu siç kishte qenë në periudhën e sundimit osman dhe, më tej, ringjalljen dhe fuqizimin e helenizmit në këtë rajon. Kjo aspiratë ishte ende e gjallë në qarqet politike dhe mediatike greke. Himara do të shërbente si guri i provës dhe si bastioni i parë që nacionalizmi grek do të fitonte për arritjen e këtij objektivi madhor. Ndërsa, për sa i përkiste mësimit të gjuhës shqipe në një numër të kufizuar të shkollave greke që funksiononin në Çamëri, grekët e dinin se si do ta zvetënonin pak nga pak dhe si të vepronin që kjo çështje të shuhej. Po të kihen parasysh metodat e egra dhe perfide që ata kishin përdorur në vitet 1923 - 1926 e më vonë për dëbimin e shqiptarëve nga trojet e tyre në Greqi, kuptohet se shtypja e dëshirës së asaj pjese të popullsisë shqiptare që kishte mbetur në Çamëri për arsimin në gjuhën shqipe ishte një objektiv fare i lehtë për shovinizmin grek.

Qeveria shqiptare, me plot të drejtë, nuk ishte e kënaqur nga Athina. Konsulli i Shqipërisë në Janinë theksonte se premtimi i çdo ministri grek në Tiranë kishte qenë gjithmonë një premtim i thatë që nuk ishte realizuar kurrë. Ministri i Greqisë në Tiranë kishte premtuar se do të hapeshin shkolla shqipe në Çamëri por ky angazhim u përgënjeshtrua prej qeverisë greke. Gjithashtu, ai vinte në dukje se pala greke kishte vepruar në të njëjtën mënyrë me pasuritë e shqiptarëve në Greqi.[26] onsulli shqiptar nënvizonte edhe trajtimin e ashpër që po u bënte qeveria greke çamëve që përpiqeshin të udhëtonin fshehurazi në Shqipëri për të mësuar në shkollat shqipe. Në të gjitha vendet ballkanike pakicat ndaloheshin të dërgonin fëmijët në shkollat e shtetit amë. Por masat shtrënguese që merreshin për zbatimin e këtyre ligjeve nuk kishin të

[26] *AMPJ*, viti 1937, dos.107, fl.1-3. Konsulli i Shqipërisë në Janinë - MPJ, 30 dhjetor 1936.

njëjtën forcë dhe karakter. Kështu, masat që kishte marrë qeveria shqiptare për ndalimin e këtij fenomeni ishin shumë më pak të ashpra dhe efektive se sa ato që kishte marrë qeveria greke ndaj shqiptarëve të Çamërisë. Konsulli i lartpërmendur pohonte se në shkollat greke të Shqipërisë ishin më tepër se 100 mësues të cilët, që të gjithë, kishin studiuar në shkollat e Greqisë, pa lejen e autoriteteve shqiptare, kryesisht në shkollën "Vella" të Janinës, me bursë të Mitropolisë greke. Këta kishin ikur fshehurazi pa pasaportë nga Shqipëria dhe ishin kthyer fshehurazi. Tashmë ata po vazhdonin propagandën greke. Përveç këtyre, në shkollat e Vellasë, në gjimnazet e Janinës dhe të Voshtinës, në shkollat bujqësore të Janinës e Konicës, në shkollën artizanale të Filatit dhe në Athinë po studionin 200 - 300 djem shqiptarë të cilët, me përjashtimin e një pjese fare të vogël, nuk kishin lejen e duhur të Ministrisë së Arsimit. Krejt e kundërta ndodhte me shqiptarët e Çamërisë të cilët kishin dërguar në Shqipëri 15 - 18 nxënës.

Qeveria shqiptare i njihte diplomat e shkollave greke dhe i pranonte këta nxënës në administratën shtetërore. Ky qëndrim liberal inkurajonte shkollimin e paligjshëm në Greqi. Prindi dropullit e dinte se djali i tij që kishte kapërcyer fshehurazi kufirin dhe studionte në Vella, do të kthehej përsëri fshehurazi në shtëpinë e tij, do të emërohej mësues në shkollën minoritare e do të merrte rrogë nga qeveria greke pa pësuar ndonjë dënim. Ndërsa prindi çam e dinte se do të hiqte mundime të mëdha nga autoritetet greke kur djali i tij do të kthehej fshehurazi nga Shqipëria. Qeveria greke nuk u jepte kurrë leje shtetasve të vet që të mësonin në shtete të huaja, qoftë edhe me paratë e tyre.

Konsulli shqiptar ankohej se Ministria e Arsimit e Shqipërisë kishte lejuar djem të vegjël që të mësonin në shkollën tregtare të Janinës dhe në shkollën bujqësore të Konicës, megjithëse këta mund të mësonin fare mirë në shkollat shqiptare dhe të mos humbnin atdhedashurinë e tyre, siç ngjiste me ata që mësonin në Greqi. Ai kërkonte që çdo nxënës grekofon i cili shkonte për studime në Greqi fshehurazi, të ndëshkohej rreptësisht prej ligjeve të shtetit, pasi edhe ligji e parashikonte qartë këtë gjë.[27] Çështja e shkollave të Himarës ishte tema kryesore e një takimi që zhvilloi kryeministri i Greqisë, Metaksas me ministrin e Shqipërisë në Athinë, Reuf Fico. Duke marrë shkas nga përfundimi i çështjes së njohjes së Kishës Autoqefale Shqiptare nga Patriakana, Metaksas kërkoi që të përfundonte edhe zgjidhja e çështjes së shkollave greke, duke

[27] *AMPJ*, viti 1937, dos.107, fl.1-3. Konsulli i Shqipërisë në Janinë - MPJ, 30 dhjetor 1936.

lejuar hapjen edhe të tre shkollave në Himarë.[28] Fico u përgjigj se qeveria shqiptare kishte pranuar shtimin e orëve të gjuhës greke në tre shkollat e Himarës, me kusht që të hapeshin shkollat shqipe në Çamëri dhe, kështu, nuk mbetej më gjë tjetër për të plotësuar prej saj. Metaksas tha se nuk i kishin raportuar ende për këtë çështje dhe shtoi se pas zgjidhjes së saj nuk kishte më gjë tjetër që mund të ngacmonte marrëdhëniet midis dy shteteve. Qeveria shqiptare i kishte bërë lëshime të mëdha palës greke për çështjen shkollore. Përveç rihapjes së shkollave private të minoritetit grek ajo kishte pranuar edhe shtimin e orëve të mësimit të gjuhës greke në Himarë. Si kompensim kishte fituar shumë pak vetëm premtimin për lejimin e mësimit të gjuhës shqipe në 10 shkolla greke të Çamërisë.

Metaksas jo vetëm që nuk pranonte ta trajtonte çështjen shkollore në bazë reciprociteti e pariteti, por u përpoq që të linte mënjanë edhe çështjen e madhe të kompensimit të pasurive shqiptare në Greqi i cili ishte ndërprerë pas shtetëzimit të shkollave greke nga qeveria shqiptare. Por, pala shqiptare këmbëngulte për rifillimin e pagesave nga qeveria greke. Fico i tha kryeministrit grek se, pa u paguar pasuritë e shpronësuara të shqiptarëve, nuk mund të thuhej se "shkaqet ngacmuese" ishin eliminuar tërësisht, pasi me qindra familje shqiptare po jetonin në varfëri të thellë. Metaksas pranoi se zgjidhja e kësaj çështje ishte zgjatur dhe premtoi se me të do të merrej ministri i Greqisë në Tiranë, Skeferis.[29] Në maj, Ministria e Jashtme e Shqipërisë iu ankua ministri grek në Tiranë për sjelljet e dyshimta të disa mësuesve të pakicës grekofone në Shqipëri. Atij iu paraqit edhe harta që përdorej nga shkollat në Greqi dhe që ishte gjetur në disa shkolla të minoritetit, në të cilën Shqipëria e Jugut përfshihej brenda Greqisë. Ministri grek shfaqi keqardhjen dhe tha se do të ndërhynte atje ku duhej. Ai nuk e miratoi një propagandë të tillë e cila dëmtonte marrëdhëniet midis dy shteteve.[30] Por edhe pala greke nuk hoqi dorë nga ankesat. Drejtori Politik i MPJ, Kusta u ankua për shtrëngimet që u ishin bërë 7 - 8 mësuesve të shkollave minoritare greke nga autoritetet shqiptare.[31]

---

[28] *AMPJ*, viti 1937, dos.107,fl.3-4. Ministri i Shqipërisë në Athinë, Reuf Fico -MPJ, 19 mars 1937.

[29] *AMPJ*, viti 1937, dos.107,fl.3-4. Ministri i Shqipërisë në Athinë, Reuf Fico-MPJ, 19 mars 1937.

[30] *AQSh*, Fondi MA, viti 1937, dos.129, fl.88. MPJ - Këshillit të Ministrave, 14 maj 1937.

[31] *AQSH,* Fondi MPB, viti 1937, dos.85, fl.1. Ministri i Shqipërisë në Athinë - MPJ, 24 maj 1937.

Greqia nuk po i mbante premtimet e saj për mësimin e gjuhës shqipe në Çamëri. Qeveria shqiptare kishte pranuar që gjuha shqipe të mësohej në 10 fshatra të Çamërisë (Filat, Gurrës, Lopes, Sallopi, Smerto, Vrohone, Faskomilja, Mazrek, Grikohor dhe Karbunar) me mësues shqiptarë çamë që do të zgjidheshin nga vetë banorët vendas dhe do të miratoheshin nga Legata e Shqipërisë në Athinë. Kundrejt mësimit të gjuhës shqipe në pesë fshatrat e fundit, pala shqiptare i kishte premtuar ministrit të Greqisë në Tiranë, akordimin në parim të lejes për çeljen e tre shkollave greke në Himarë, duke bërë të qartë se çelja e këtyre tre shkollave do të varej nga mësimi efektiv i gjuhës shqipe, jo vetëm në shkollat qeveritare greke të fshatrave Filat, Gurrës, Lopes dhe Smerto, por edhe në ato që ndodheshin në fshatrat e tjera të lartpërmendura. Pra shkollat e Himarës do të hapeshin vetëm pasi të kishte nisur efektivisht mësimi i shqipes në 10 shkollat qeveritare greke të Çamërisë.[32]

Në ditët e para të gushtit, me urdhër të Mbretit Zog, ministri i Jashtëm thirri Ministrin e Greqisë në Tiranë për t'i theksuar edhe njëherë angazhimet e qeverisë greke për mësimin e gjuhës shqipe në 10 shkolla qeveritare në Çamëri. Ministri grek deklaroi në mënyrë të prerë se angazhimi i qeverisë së tij ishte definitiv dhe, nëse mësimi i gjuhës shqipe në 10 shkollat e Çamërisë nuk do të zbatohej, edhe qeveria shqiptare do ta ndalonte çeljen e tre shkollave në Himarë.[33] Në përgjigjen e ministrit grek bie në sy fakti se ai tashmë e lidhte dhënien e mësimit të gjuhës shqipe në shkollat e Çamërisë vetëm me hapjen e shkollave greke në Himarë. Qeveria greke nuk donte ta lidhte reciprocitetin e mësimit të gjuhës shqipe në Çamëri me funksionimin e shkollave greke në zonën e minoritetit. Kjo strategji e grekëve synonte t'i shmangej angazhimit për mësimin e gjuhës shqipe në Çamëri dhe njëkohësisht të mënjanonte çdo presion që mund të bënte në këtë rast pala shqiptare ndaj funksionimit dhe statusit të privilegjuar të shkollave të minoritetit grek. Tashmë, pasi njëri ndër objektivat kryesore të politikës greke ishte arritur, edhe shtypi grek filloi të reagonte pozitivisht. "Eleftheron Vima" shkruante se "çelja e gjithë shkollave greke në Shqipëri dhe fillimi i funksionimit të tyre me mësues grekë në kushte të favorshme përbënte një gjest të qeverisë së Tiranës që meritonte çdo lavdi. Me anën e këtij vendimi shqiptarët shfaqin

[32] *AMPJ*, viti 1937, dos.261, fl.75. Projekt-shkresë e MPJ për Legatën shqiptare në Athinë, 7 gusht 1937.
[33] *AMPJ*, viti 1937, dos.261, fl.76. Ministi i Jashtëm, Ekrem Libohova-Mbretit Zog, 7 gusht 1937.

dispozitat e tyre më të sinqerta për një bashkëpunim harmonik dhe për lidhjen e marrëdhënieve të ngushta midis dy shteteve e dy popujve".[34]
Me të vërtetë në dukje marrëdhëniet shqiptaro - greke krijonin përshtypjen se tashmë kishin hyrë në një fazë të pazakonte përmirësimi. Këtë e raportonin edhe përfaqësitë britanike në të dy vendet respektive. Diplomati britanik në Shqipëri Weld Forester informonte se: "Ministri grek më tha se marrëdhëniet shqiptaro - greke janë përmirësuar më tej nga një marrëveshje verbale mbi dy çështje të vogla në lidhje me shkollat. Zoti Skeferis më tha se qeveria shqiptare ka rënë dakord të lejojë tre fshatra ortodokse në Himarë të kenë shkollat e tyre, si ato që funksionojnë në minoritetin grek. Në të njëjtën kohë qeveria greke ka rënë dakord që të lejojë dhënien e mësimit fetar në gjuhën shqipe në shkollat e Çamërisë".[35] Edhe ministri i Jashtëm shqiptar e konfirmoi këtë marrëveshje dhe shprehu kënaqësinë e plotë të tij. Ai i shpjegoi diplomatit britanik se qeveria greke do t'i jepte gjuhës shqipe statusin e një gjuhe të dytë të detyrueshme. Ndërsa, ministri grek i kishte thënë gjithashtu se qeveria e tij kishte plotësuar dëshirën e qeverisë shqiptare për transferimin nga Korfuzi në Xanthi të disa refugjatëve politikë shqiptarë.[36]

Greqia i kishte arritur objektivat e saj kryesorë kundrejt shqiptarëve. Prandaj ajo kishte vendosur të ndiqte përkohësisht një politikë luajale për t'i konsoliduar arritjet e sajë dhe të vështronte drejt së ardhmes së çfarë rrethanash do të krijoheshin dhe se çfarë mundësish do të krijonin ato për realizimin e dy objektivave të saj strategjike: aneksimin ose së paku helenizimin e Shqipërisë së Jugut dhe spastrimin etnik ose asimilimin gradual të elementit shqiptar në Çamëri. Strategjinë e re greke e zbulonte disi ministri grek Skeferis i cili i tha Weld-Forester se në gjendjen miqësore të marrëdhënieve shqiptaro - greke, një marrëveshje verbale kishte avantazhe kundrejt një marrëveshje me shkrim, pasi ajo krijonte më pak mundësi që të bëhej një lojë fjalësh rreth çështjeve të vogla. Ai shtoi se politika e tij, tani që nuk kishte më çështje serioze midis qeverisë së tij dhe Tiranës, ishte që të plotësonte dëshirat e shqiptarëve për gjërat e vogla, sa më shumë që të ishte e mundur dhe që të zvogëlonte në minimum çdo grindje që mund të shkaktohej nga zelli i tepruar i autoriteteve lokale në rajonet kufitare. Ai

[34] *AMPJ*, viti 1937, dos.261, fl.81. Përkthim i një artikulli të gazetës "Eleftheron Vima", 24 shtator 1937.
[35] FO 371/21113, Weld- Forester për A. Eden, Durrës 11 gusht 1937.
[36] *Po aty*.

kishte gjetur një mirëkuptim nga ministri i Jashtëm shqiptar dhe ishte shumë i bindur se marrëdhëniet midis dy vendeve kishin hyrë tani në një periudhë qetësie dhe miqësie të fortë.[37]

Edhe Royan informonte se shtypi shqiptar kishte njoftuar më 13 nëntor formimin e një shoqërie shqiptaro - greke në Tiranë, e cila ishte si homologe e shoqërisë greko - shqiptare e cila ekzistonte prej disa vitesh në Athinë. Promotori i saj ishte Mehmet Konica.[38] Kolegu grek i tha atij më 23 nëntor se kjo shoqëri kishte pak rëndësi, përveç faktit se ishte një gjest pozitiv publik. Ai përsëri i foli A. Royanit me superlativa për gjendjen e marrëdhënieve greko-shqiptare. Kur Royan e pyeti për çështjen e shkollave të Himarës, Skferis u përgjigj se marrëveshja ende nuk ishte zbatuar, por ai nuk ishte i shqetësuar për këtë dhe mendonte se qeveria shqiptare do ta zbatonte atë në kohën e duhur.[39] Gjithashtu Sir Sydney Waterlow informonte nga Athina se në një pritje në Legatën shqiptare dje "unë pashë me sytë e mi demonstrimin e vëllazërimit të përzemërt midis kryeministrit dhe zv. ministrit të jashtëm të Greqisë nga njëra anë dhe të ministrit shqiptar në anën tjetër. Ata më folën mua me shumë kënaqësi për fazën shumë miqësore në të cilën kanë hyrë marrëdhëniet shqiptaro - greke, se nuk ka mbetur asnjë shkak për grindje dhe se shkollat në të dy anët e kufirit po funksionin lirisht".[40]

Zëvendësministri i Jashtëm grek i tha Waterlow se, përveç zgjidhjes së çështjes shkollore, faktor përcaktues për përmirësimin e marrëdhënieve greko - shqiptare kishte qenë qëndrimi pajtues i Patriarkanës në zgjidhjen e çështjes kishtare dhe gjithashtu edhe frika në rritje e shqiptarëve për penetrimin e ardhshëm italian nën maskën e propagandës katolike. Ai theksoi se këtej e tutje afrimi politik do të ishte mbi bazën e vetëmbrojtjes së ortodoksëve.[41] Kjo do të thoshte se shteti grek tani kishte vendosur si axhendë kryesore forcimin e helenizmit në Shqipëri nën maskën e vetëmbrojtjes së ortodoksëve. Zyrtari i lartë grek informoi Waterlow se "ministri shqiptar, cilësitë e të cilit si një shtetar ai i vuri në dukje, i kishte thënë dy herë kohët e fundit për nevojën e nënshkrimi të një Traktati Miqësie greko - shqiptar. Por, instinkti i tij ishte që kjo ide të lihej të ngrohej ngadalë për momentin, vetëm për arsye të rrezikut të zemërimit të jugosllavëve dhe italianëve

[37] *Po aty*.
[38] FO 371/21113, A. Ryan për A. Eden, Durrës 26 nëntor 1937.
[39] *Po aty*.
[40] FO 371/21113, Telegrami Ser Sydney Waterlow për FO, Athinë 29 nëntor 1937.
[41] FO 371/21113, Ser Sydney Waterlow për FO, Athinë 30 nëntor 1937.

në konjunkturën aktuale".[42] Ndërsa, më 2 dhjetor 1937 Waterlow i përcolli Londrës një artikull të "Messager d'Athenes" i cili raportonte për një deklaratë të përzemërt të bërë nga Mbreti Zog për Delegatët grekë që ishin në Tiranë për festimin e 28 Nëntorit, si dhe për një deklaratë tjetër që K. Kota i kishte bërë një përfaqësuesi të shtypit grek lidhur me çështjen e minoriteteve.[43]

Në fillim të vitit 1938, qeveria shqiptare vijoi përpjekjet për çeljen dhe plotësimin e funksionimit të shkollave shqipe në Çamëri. Ministri i Jashtëm i Shqipërisë diskutoi me ministrin e Greqisë në Tiranë problemin e librave që do të përdoreshin nga nxënësit shqiptarë në shkollat e Çamërisë. Por, ministri grek u përgjigj se ai nuk ishte në dijeni nëse autoritetet greke do të lejonin shtypjen e librave në gjuhën shqipe për t'i përdorur në shkollat e Çamërisë. Ai sugjeroi që, hë për hë, të përdoreshin tekstet e shkollave të Shqipërisë, duke u hequr atyre fletët që përmbanin material të papajtueshëm për Greqinë.[44] Nga ana e saj, qeveria shqiptare i kishte shtypur tekstet greqisht për shkollat greke në Shqipëri[45]. Përfundimisht, në janar 1938 qeveria greke pranoi që në shkollat e Çamërisë të përdoreshin librat e shkollave të Shqipërisë, pasi t'u ishin hequr faqet e caktuara prej Inspektorit të Arsimit të Greqisë.[46]

Mirëpo kjo nuk do të thotë se çështja e arsimimit të fëmijëve çamë në gjuhën shqipe u zgjidh njëherë e përgjithmonë. Në prapaskenë dhe në vijim, qeveria greke bëri çmos për ta penguar atë. Kështu qysh në fillim të shkurtit një mësues shqiptar, Habib Hamiti, u pushua nga puna, me pretekstin se kishte zhvilluar mësimin e fesë në shkollë në gjuhën shqipe dhe jo në gjuhën greke ose turke[47]. Ky ishte njëri nga mësuesit e kualifikuar shqiptarë që ishin emëruar për mësimin e gjuhës shqipe dhe pushimi i tij ishte krejtësisht arbitrar. Gjithashtu paga mujore që u ishte caktuar mësuesve shqiptarë të Çamërisë ishte 30 fr. ari, ndërsa kolegët e tyre grekë merrnin më tepër se dyfishin e kësaj page. Konsulli shqiptar i Janinës i propozoi Ministrisë së Jashtme që këtë diferencë t'ua plotësonte qeveria shqiptare.[48]

---

[42] *Po aty*.
[43] FO 371/21113, S. Waterlow për FO, Athinë 2 dhjetor 1937.
[44] *AMPJ,* viti 1938, dos.86, fl.72-73. Shënime të ministrit të Jashtëm, 20 janar 1938.
[45] *AMPJ,* viti 1938, dos.106, fl.73. MPJ - MA, 4 janar 1938.
[46] *AMPJ,* viti 1938, dos. 106, fl.3. Legata shqiptare Athinë - MPJ, 5 shkurt 1938.
[47] *AMPJ,* viti 1938, dos. 106, fl.9. Konsulli i Shqipërisë në Janinë - Legatës shqiptare në Athinë, 16 shkurt 1938.
[48] *AMPJ,* viti 1938, dos. 106, fl.12. Konsulli i Shqipërisë në Janinë - MPJ, 24 shkurt 1938.

Mësuesit grekë filluan përpjekjet për të penguar mësimin e shqipes në shkollat e Çamërisë të cilat konsistonin që nga fyerjet, provokacionet dhe presionet e shumta ndaj nxënësve dhe mësuesve shqiptarë deri në rrahjet e tyre.[49] Konsullata shqiptare e Janinës u dha këshilla mësuesve shqiptarë që të shmangnin provokacionet dhe incidentet që do të cenonin qetësinë dhe marrëdhëniet normale me mësuesit dhe autoritetet greke, pasi ajo druhej se në të ardhmen mund të bëheshin provokacione edhe më të rënda.[50]

Në mes të shkurtit ministri shqiptar në Athinë i kërkoi zëvendësministrit të Jashtëm, Mavrudis të jepej leja për përdorimin e teksteve shqiptare në shkollat e Çamërisë. Ky i kërkoi Ministrisë së Arsimit që të zbatoheshin urdhrat për përdorimin e teksteve të shkollave shqiptare. Mavrudis i tha ministrit shqiptar se do të formohej një Komision i Posaçëm për përgatitjen e teksteve të cilat, para se të shtypeshin, do t'i tregoheshin edhe Legatës Shqiptare. Gjithashtu ministri shqiptar kërkoi që orët e mësimit të gjuhës shqipe të shtoheshin nga dy, në katër orë në javë. Mavrudis e pranoi këtë kërkesë dhe udhëzoi që t'i shkruhej Ministrisë së Arsimit.[51] ë mars të vitit 1938, Ministria e Arsimit e Shqipërisë vuri në dispozicion të nxënësve shqiptarë të Çamërisë 1 000 copë abetare, 500 copë libra këndimi të klasës së II, 20 copë gramatika për klasën e III dhe 10 copë sintaksa që do dërgoheshin në Çamëri.[52] Por ndërkohë qeveria greke kundërveproi në një mënyrë edhe më të rrezikshme. Me anë të agjentëve dhe të agjencive të saj ajo intensifikoi përpjekjet për të nxitur largimin e shqiptarëve nga Çamëria. Konsullata shqiptare e Janinës filloi të jepte lajme tronditëse se shumë familje shqiptare nga krahina e Gumenicës po përgatiteshin të shkonin në Turqi ose, nëse atje nuk do të pranoheshin, të vinin në Shqipëri. Këto përgatitje po bëheshin me përkrahjen dhe me nxitjen e hapur të prefektit të Gumenicës. Në Smokvinë (e cila tani ishte emërtuar nga autoritetet greke Sikohorë), një prift kishte shpallur se do të blinte pasurinë e 28 familjeve, me kusht që ata të iknin në Turqi dhe pasuria e tyre të shitej definitivisht. Në fshatin Vola (që tashmë ishte

[49] *AMPJ,* viti 1938, dos. 106, fl.15. Konsullata shqiptare në Janinë - MPJ, 24 shkurt 1938.
[50] *AMPJ,* viti 1938, dos. 106, fl.15. Konsullata shqiptare në Janinë - MPJ, 24 shkurt 1938.
[51] *AMPJ,* viti 1938, dos. 106, fl.19. Legata shqiptare në Athinë - Konsullatës shqiptare, Janinë, 26 shkurt 1938.
[52] *AMPJ,* viti 1938, dos. 106, fl.21. MPJ - Konsullatës shqiptare në Janinë, 15 mars 1938.

emërtuar Murto), me ndërmjetësinë e një sekseri shqiptar që quhej Emin Zëri, prefekti po nxiste shitjen e pasurisë së 150 familjeve dhe kishte marrë përsipër që të lehtësonte marrjen e vizës për këta banorë, me kusht që ata të nënshkruanin një deklaratë në të cilën pohohej se ishin të kënaqur nga autoritetet greke dhe se emigronin me dëshirën e tyre. Konsullata shqiptare e Janinës njoftonte se ky lajm ishte pëlqyer nga fshatarët e paditur dhe i gjithë fshati ishte i gatshëm të hynte në marrëveshjen që kishte projektuar prefekti grek.[53] "Ideja e emigrimit po përhapet si një epidemi edhe në katundet e tjera" - informonte konsulli i Janinës. Në Margëlliç, më se 15 familje mendonin të largoheshin në Shqipëri dhe për këtë qëllim ishin lidhur me Jasin Haxhiun, ish-kryetar komune i Margëlliçit dhe bashkëpunëtor i ngushtë i grekëve në persekutimin e elementit shqiptar.[54]

Konsullata shqiptare informoi për situatën e krijuar Ministrin e Shqipërisë në Athinë dhe i kërkoi atij të ndërhynte shpejt për të ndaluar këtë fushatë. Nga ana tjetër, ajo po përpiqej t'i bindte fshatarët shqiptarë të hiqnin dorë nga emigrimi dhe të zbatonin porosinë e Mbretit Zog i cili kishte thënë se "muslimanizmi gjendet në Mekë e jo në Turqi dhe lumturia e shqiptarit gjendet në vendlindjen e vet e jo gjetiu".[55]Ministria e Jashtme e Shqipërisë dhe Legata Shqiptare në Athinë u kërkuan autoriteteve greke të ndalonin këtë fushatë të re që nxiste emigrimin e shqiptarëve, por ato u përgjigjën se nuk kishin dijeni për një propagandë të tillë.[56]

Ministri grek në Tiranë ngriti alibinë se propaganda për emigrimin e çamëve mund të ishte shkaktuar nga ndonjë organizatë turke. Ai gjithashtu u tha autoriteteve shqiptare se legjislacioni grek për emigracionin ishte mjaft liberal dhe e favorizonte shumë emigrimin e shtetasve grekë të çdo kategorie, meqenëse popullsia greke ishte mjaft e shtrënguar në tokën e saj të ngushtë. Ai pohoi gjithashtu se krijimi dhe detyrat e Bankës Bujqësore të Greqisë kishin për qëllim të favorizonin shpërnguljen e shtetasve grekë.[57] Duke mos mundur të ndikonte tek qeveria greke për ndërprerjen e kësaj fushate, qeverisë shqiptare i mbeti vetëm një mundësi për të vepruar. Ministria e Jashtme e Shqipërisë porositi përfaqësitë në Greqi që, me gjithë mjetet që dispononin dhe,

[53] *AMPJ,* viti 1938, dos. 106, fl.21. Konsullata shqiptare Janinë - MPJ, 17 mars 1938.
[54] *AMPJ,* viti 1938, dos. 106, fl.21. Konsullata shqiptare Janinë - MPJ, 17 mars 1938.
[55] *AMPJ,* viti 1938, dos. 106, fl.21. Konsullata shqiptare Janinë - MPJ, 17 mars 1938.
[56] *AMPJ,* viti 1938, dos. 106, fl.30. MPJ - Konsullatës shqiptare në Janinë, 4 prill 1938.
[57] *AMPJ,* viti 1938, dos. 106, fl.35. MPJ - Konsullatës shqiptare në Janinë, 9 prill 1938.

veçanërisht, nëpërmjet personave atdhetarë e me influencë në Çamëri, të këshillonin popullsinë çame të mos largohej nga vendlindja e saj, sepse interesi i tyre kërkonte që të rrinin atje e jo në Turqi, ku nuk mund të siguronin një jetesë më të mirë.[58]

Në vijim edhe Ministria e Brendshme e Shqipërisë mori informacione të tjera se, kohët e fundit, qeveria greke po zhvillonte një propagandë sistematike, sidomos në krahinat e Gumenicës dhe të Margëlliçit, për të nxitur shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi. Ajo po propagandonte se ishte marrë vesh me qeverinë turke për instalimin e shqiptarëve në toka të mira e të bollshme.

Gjithashtu, qeveria greke, nëpërmjet bankave të saj, kishte filluar të blinte vetë tokat dhe pasuritë e çamëve, me një vlerë të konsiderueshme, duke u krijuar pronarëve çamë lehtësira të mëdha për kryerjen e formaliteteve të shitjes së pronave dhe të shpërnguljes së tyre.[59] Ministria e Brendshme informonte se autoritetet greke, nëpërmjet Bankës Bujqësore, u jepnin kredi shtetasve grekë të krishterë për blerjen e pasurive të çamëve. Kështu priftit të Kajters së Paramithisë, Papa Andreas, i kishin dhënë 2 milionë dhrahmi për blerjen e të gjitha pasurive të fshatit Smokovna. Ky u kishte paguar banorëve 5 milionë dhrahmi paradhënie, ndërsa pjesën tjetër do t'ua jepte në mbarim të formaliteteve. Autoritetet greke po projektonin blerjen e gjithë pasurive të fshatit Salicë të Gumenicës prej Kristo Pitulit dhe dy tregtarëve të Janinës për një shumë prej 18 milionë dhrahmi.[60] Propaganda për emigrim ishte intensifikuar dhe çamëve po u jepej çdo lehtësi për emigrimin në Turqi.

Në maj qeveria shqiptare udhëzoi Legatën në Athinë që të bënte demarshe të reja tek autoritetet greke, të cilave t'u vihej në dukje se deri në këtë kohë politika e nxitjes së emigracionit nuk kishte qenë aplikuar në Çamëri, as prej autoriteteve lokale, as prej institucioneve financiare, si Banka Bujqësore e Greqisë, por ajo ishte një fushatë e re e rigjallëruar dhe intensifikuar muajt e fundit. Qeverisë greke do t'i kërkohej që, për hir të marrëdhënieve miqësore, t'i jepte fund kësaj politike dhe të ushtronte të gjithë influencën e saj për të ndaluar këto aktivitete të Bankës Bujqësore helenike në Çamëri.[61] Pak kohë më parë, zyrtarët e lartë të MPJ të Shqipërisë i kishin deklaruar ministrit të Greqisë në

[58] *AMPJ,* viti 1938, dos. 106, fl.35. MPJ - Konsullatës shqiptare në Janinë, 9 prill 1938.
[59] *AMPJ,* viti 1938, dos. 106, fl.28. MPB - MPJ, 4 prill 1938.
[60] *AMPJ,* viti 1938, dos. 106, fl.43. MPB - MPJ, 19 prill 1938.
[61] *AMPJ,* viti 1938, dos. 106, fl.41. MPJ - Legatës shqiptare në Athinë, 7 maj 1938.

Tiranë se lajmet për emigrimin e çamëve kishin bërë përshtypje të dhimbshme në Shqipëri. Sekretari i përgjithshëm i MPJ të Shqipërisë pohonte se, edhe nëse do të pranohej pikëpamja se qeveria greke nuk po e nxiste emigrimin e popullsisë çame, nuk mund të mohohej fakti se autoritetet lokale greke kishin mbyllur sytë ndaj veprimeve të atyre njerëzve e agjencive që po trafikonin, duke shfrytëzuar mirëbesimin e çamëve. Ai kishte paralajmëruar se çamët e gënjyer nuk do të gjenin në Turqi parajsën që u ishte premtuar dhe, kështu, do të detyroheshin të ktheheshin në Shqipëri. Kjo e kishte alarmuar qeverinë shqiptare, sepse ajo nuk kishte ku t'i vendoste këto emigrantë. Ajo mund të detyrohej t'i vendoste ata midis grekofonëve të zonës kufitare, pasi çamët do të donin të qëndronin sa më afër vendeve të tyre. Kështu çështja mund të shndërrohej në një burim zemërimesh dhe grindjesh, gjë të cilën qeveria shqiptare donte ta mënjanonte.[62]

Ministri grek e pranoi këtë argument dhe premtoi që t'i shkruante sërish qeverisë së tij për të ndaluar emigrimin e popullsisë çame.[63] Qeveria shqiptare ishte e shqetësuar më tepër për faktin se ky fenomen po vërehej edhe në Kosovë.[64] Ajo dyshonte se mund të gjendesh përpara një politike të koordinuar greko - jugosllave për dëbimin e shqiptarëve nga trojet e tyre. Legata shqiptare u ankua sërish pranë qeverisë greke për lëshimin e pasaportave për emigrim nga prefektura e Gumenicës, familjeve të fshatit Smokovinë. Drejtori politik i MPJ të Greqisë, Kusto, premtoi se do të urdhëronte menjëherë ndalimin e emigrimit të këtyre familjeve, duke theksuar edhe njëherë se qeveria greke nuk kishte asnjë synim dhe asnjë interes për të larguar çamët. Ai tha se, përveç arsyeve politike, ajo kishte edhe arsyen tjetër që, me ikjen e çamëve, vendi do të mbetej i shkretë, pasi në Epir nuk kishte punëtorë të tillë që t'i zëvendësonin ata.[65] Pastaj Kusta i tregoi përfaqësuesit shqiptar një kërkesë të firmosur nga banorët e katundit "Argyrotopos" drejtuar MPJ të Greqisë, të cilët "protestonin kundër emërimit të mësuesve çamë për gjuhën shqipe, duke deklaruar se ata nuk kishin ndonjë lidhje shpirtërore me Shqipërinë, pasi ishin turq me shpirt dhe dëshironin që fëmijët e tyre të mësonin gjuhën greke". Përfaqësuesi shqiptar u përgjigj se kjo kërkesë ishte bërë me shtytjen e autoriteteve lokale greke për të justifikuar veprimet e tyre ndaj popullsisë çame. Kusta deklaroi se

[62] *AMPJ,* viti 1938, dos. 106, fl.41. MPJ - Legatës shqiptare në Athinë, 7 maj 1938.
[63] *AMPJ,* viti 1938, dos. 106, fl.41. MPJ - Legatës shqiptare në Athinë, 7 maj 1938.
[64] *AMPJ,* viti 1938, dos. 106, fl.41. MPJ - Legatës shqiptare në Athinë, 7 maj 1938.
[65] *AMPJ,* viti 1938, dos. 106, fl.45. Legata shqiptare Athinë - MPJ, 12 maj 1938.

dy ditë më parë kryeministri Metaxas i kishte dhënë urdhër prefekturës së Gumenicës që të ishte shumë e kujdesshme, në mënyrë që të mos kishte asnjë ankesë nga çamët. Por ai shtoi se çamët kishin marrë vesh lëvizjen për grumbullimin e popullsive myslimane që po bëhej në Ankara dhe kërkonin vetë të shkonin në Turqi. Madje, gjatë vizitës që kishte bërë disa ditë më parë kryeministri i Turqisë në Greqi, ata kishin dërguar tek ai disa persona të cilët i kishin kërkuar ndihmë për emigrimin e çamëve në Turqi. Kusta mohoi ekzistencën e një marrëveshje me qeverinë turke për emigrimin e çamëve dhe shtoi se, deri në këtë kohë, nuk kishte bërë asnjë bisedë për këtë çështje.[66] Edhe presioni dhe pengesat e autoriteteve arsimore dhe administrative greke ndaj mësimit të gjuhës shqipe në Çamëri vijuan në mënyrë sistematike. Dy shkollat shqiptare të Çamërisë mbetën të mbyllura. Kjo situatë e detyroi Legatën shqiptare të protestonte sërish në MPJ të Greqisë.[67]

Për shkak të presionit grek dhe vështirësive të tjera, përparimi i arritur në mësimin e gjuhës shqipe në Çamëri ishte modest. Në Filat ekzistonte shkolla më e rëndësishme në Çamëri, në të cilën 85 nxënës shqiptarë mësonin gjuhën shqipe. Në fillim kjo shkollë funksionoi rregullisht, por në mes të vitit shkollor mësuesi mungoi tre muaj për arsye shëndetësore dhe mësimi u ndërpre, për të rifilluar në ditët e para të prillit deri në fund të qershorit.

Në Lopës ishte shkolla e dytë e rëndësishme me 75 nxënës. Muajt e parë mësuesi shqiptar nuk u lejua të kryente detyrën sepse mungonte kolegu i tij grek. Mësimet në këtë shkollë filluan rregullisht më 20 dhjetor. Smarta kishte një shkollë të vogël me 14 nxënës dhe mësuesi ishte i paaftë. Nista kishte një shkollë me 40 nxënës e cila ishte e vetmja ku gjuha shqipe u mësua rregullisht. Në Sollop funksiononte një shkollë me 27 nxënës në të cilën kishte pasur mjaft pengesa, por mësuesi shqiptar i kishte kapërcyer ato. Në Gurrës kishte një shkollë me 16 nxënës. Në Mazrek ishte e vetmja shkollë e Çamërisë ku nxënësit ishin të gjithë shqiptarë. Ajo kishte 80 nxënës, por mësuesi ishte një hoxhë pa përgatitjen e duhur. Në Grikohor kishte 50 nxënës. Mësuesi i kësaj shkolle ishte emëruar nga prefekti i Gumenicës me qëllim që të informonte mbi aktivitetin e mësuesve shqiptarë në shkollat e Çamërisë. Në shkollën e Vrohnas mësimi i shqipes nuk u zhvillua pasi mësuesi i saj u pushua nga autoritetet greke. Pra, në Çamëri kishte 10 shkolla ku, me gjithë pengesat e lartpërmendura, mund të thuhet se lejohej mësimi i

[66] *AMPJ,* viti 1938, dos. 106, fl.45. Legata shqiptare Athinë - MPJ, 12 maj 1938.
[67] *AMPJ,* viti 1938, dos. 106, fl.48. Legata shqiptare Athinë - MPJ, 21 qershor 1938.

gjuhës shqipe. Kishte 8 mësues për këtë gjuhë dhe mësonin shqip 397 nxënës.[68] Po të bëhet një krahasim midis numrit të popullsisë shqiptare të Çamërisë dhe numrit të nxënësve që mësonin gjuhën shqipe rezulton se progresi ishte shumë i kufizuar. Ndërsa, nëse ky raport krahasohet me shtrirjen dhe shkallën e mësimit të gjuhës greke në shkollat greke të Shqipërisë do të dilte në pah ndryshimi i thellë në politikat arsimore të dy shteteve ndaj minoriteteve përkatëse. Politika greke ishte shumë më refraktare dhe kufizuese në lejimin e zhvillimit të mësimit në gjuhën shqipe.

Por diferenca nuk dukej vetëm në numrin dhe përqindjen e nxënësve që mësonin gjuhën e tyre amtare. Ajo ishte po kaq e thellë edhe në intensitetin dhe efektivitetin e mësimit të kësaj gjuhe nga minoritetet në të dyja anët e kufirit. Ndërsa, në dhjetë shkollat greke të Çamërisë, gjuha shqipe jepej vetëm dy orë në javë, në shkollat e minoritetit grek të gjitha lëndët zhvilloheshin në gjuhën greke dhe fëmijët edukoheshim me tekste greke. Konsullata shqiptare e Janinës i sugjeronte Ministrisë së Jashtme që të gjendeshin mënyrat efikase për të zbutur qëndrimin e ashpër të inspektorëve të arsimit dhe të arsimtarëve grekë, pasi pengesat më të mëdha vinin prej tyre.[69] Vështirësitë që po krijonin grekët në Çamëri për mësimin e gjuhës shqipe u denoncuan edhe nga shoqëria "Çamëria" në SHBA. Protestave të saj u bëri jehonë edhe gazeta "Dielli" e cila kërkoi trajtim të barabartë të minoriteteve shqiptare e greke në të dyja vendet.[70]

Nga ana tjetër autoritetet lokale greke vijonin të demonstronin qëndrime të ashpra dhe armiqësore kundrejt parisë shqiptare të krahinës. Prefekti i Filatit kërcënoi parinë e vendit (Musa Demin dhe Myftiun e Filatit), duke u deklaruar: "Portat janë të hapura, akoma rrini këtu?!". Gjithashtu ai i kishte thënë Musa Demit: "Dosja jote është zmadhuar shumë aq sa ke arritur të bëhesh i padurueshëm".[71] Në tetor të vitit 1938 qeveria greke filloi sërish fushatën e mbledhjes së armëve në Çamëri[72],

[68] *AMPJ,* viti 1938, dos. 106, fl.49-54. Raport i Konsullatës shqiptare në Janinë mbi mësimin e gjuhës shqipe në Çamëri në vitin shkollor 1937-1938.
[69] *AMPJ,* viti 1938, dos. 106, fl.49-54. Raport i Konsullatës shqiptare në Janinë mbi mësimin e gjuhës shqipe në Çamëri në vitin shkollor 1937-1938.
[70] "Dielli", 22 gusht 1938. Art. *Gjuha shqipe në Çamëri*; Po aty, 25 nëntor 1938. Art. *Dita e Flamurit dhe makthi i pakicave shqiptare*; Po aty, 2 dhjetor 1938. Art. *Çamët, qeveria greke dhe qeveria shqiptare.*
[71] *AQSh*, Fondi MPB, viti 1938, dos.97, fl.5. Prefektura e Gjirokastrës - MPB, 25 korrik 1938.
[72] *AQSh*, Fondi MPB, viti 1938, dos.97, fl.7. Prefektura Korçë - MPB, 29 tetor 1938.

duke e përdorur këtë si pretekst për të shtuar presionin ndaj popullsisë çame që ajo të largohej nga vendi i vet. Në fund të vitit 1938 raportet e përfaqësive shqiptare në Greqi theksonin se gjendja e popullsisë së Çamërisë po keqësohej dhe presioni për emigrimin e saj po rritej. Këto presione e kishin shtuar dëshirën e banorëve të Margëlliçit e Gumenicës për të emigruar.[73]

Në Çamëri po vepronte një klikë zyrtarësh të lartë të cilët po përpiqeshin të realizonin spastrimin etnik të popullsisë shqiptare. Legata shqiptare ishte informuar nga qarqet e Zyrës Politike të Kryeministrisë se zëvendësguvernatori i përgjithshëm i Janinës, prefekti i Gumenicës dhe gjyqtari paqtues i Pargës po inkurajonin organet e xhandarmërisë që të keqtrajtonin popullsinë çame. Ata i kishin paraqitur qeverisë raporte për rrezikun që mund t'i vinte Greqisë prej çamëve të cilët i konsideronin si element armiqësor dhe sugjeronin zhdukjen e tyre. Legata Shqiptare ishte informuar gjithashtu se qeveria greke nuk i kishte marrë parasysh këto sugjerime.[74]

Në fund të nëntorit, drejtori i ri politik i Ministrisë së Jashtme të Greqisë, Gafos, u tha përfaqësuesve shqiptarë se qeveria greke nuk e kishte favorizuar kurrë emigrimin e çamëve por, përkundrazi, ishte kujdesur për ta penguar me çdo mjet emigrimin e tyre. Ai pohoi se i ishte dhënë urdhër Bankës Bujqësore të anulonte kontratat që kishin lidhur me 19 çamë për shitjen e pasurisë së tyre. Banka e lartpërmendur kishte njoftuar se 10 vetë kishin pranuar ta anulonin kontratën ndërsa 9 të tjerë jo.[75]

Me gjithë politikën liberale të qeverisë shqiptare, vijoi fenomeni i largimit fshehurazi për në Greqi të shumë djemve nga Nënprefektura e Himarës, për të studiuar në shkollat greke.[76] Në fakt Ministria e Arsimit pohonte se nuk u kishte krijuar asnjë pengesë djemve grekofonë që kishin kërkuar leje për të kryer studimet jashtë shtetit. Atyre vetëm u ishte kërkuar plotësimi i formularëve sipas dispozitave ligjore, kërkesë që ishte për gjithë studentët shqiptarë që kërkonin të studionin jashtë.

[73] *AQSh*, Fondi MPB, viti 1938, dos.97, fl.64. Legata shqiptare Athinë - MPJ, 3 nëntor 1938.
[74] *AQSh*, Fondi MPB, viti 1938, dos.97, fl.66. Legata shqiptare Athinë - MPJ, 8 nëntor 1938.
[75] *AQSh*, Fondi MPB, viti 1938, dos.97, fl.68. Legata shqiptare Athinë - MPJ, 25 nëntor 1938.
[76] *AQSh*, Fondi MPB, viti 1938, dos.218, fl.3. MPB - Prefekturës së Durrësit, 8 mars 1938.

Madje djemve grekofonë u ishin akorduar edhe lehtësira specifike.[77] Por, qeveria greke nuk mjaftohej dhe kënaqej që këto lehtësira t'u akordoheshin vetëm minoritarëve. Ajo kërkonte që këto të drejta t'u akordoheshin edhe ortodoksëve shqiptarë. Për këtë arsye drejtori politik i MPJ të Greqisë, Kusta, i ishte ankuar Legatës shqiptare për pengimin e djemve që dëshironin të studionin në Greqi nga autoritetet shqiptare të Gjirokastrës e Delvinës.[78] Gjithashtu ai ishte ankuar edhe kundër dënimit prej gjyqeve shqiptare të disa personave nga Palasa për arsye se ata kishin dërguar fëmijët në shkollat greke.[79]

Ndërkohë autoritetet policore greke rifilluan praktikën e vjetër të deformimit të nënshtetësisë së ortodoksëve shqiptarë. Në dokumentet që ata u lëshonin ortodoksëve shqiptarë shënonin nënshtetësinë: "Elin, omojenis" ose "Vorio - Epirot". Legata shqiptare në Athinë protestoi dhe zëvendësministri i Jashtëm grek Mavrudis premtoi se nuk do të përsëritej më ky veprim[80]. Këto veprime u ndërprenë për disa muaj por rifilluan përsëri në shtator. Legata shqiptare u ankua përsëri për këtë dhe sërish mori premtime se do të jepeshin urdhrat e duhura.[81] Presioni grek ndaj qeverisë shqiptare vijoi edhe në muajt e parë të vitit 1939. I ngarkuari me Punë i Greqisë në Tiranë u ankua në Ministrinë e Jashtme për masat disiplinore që autoritetet e arsimit kishin marrë ndaj tre mësuesve të cilët kishin shkelur rregullat e shkollës ose kishin kryer falsifikime dëftesash etj.[82]

Ministria e Arsimit informonte Kryeministrinë se ndaj minoritetit grekofon po ndiqej një politikë shumë liberale. Në këtë raport ndër të tjera thuhej: "Është dhënë leje për hapje shkollash nëpër katunde që s'kanë pasur kurrë shkollë dhe që s'kanë pas dhe s'kanë ende minimumin e nxënësve në moshë shkollore. Janë gjetur shkolla të çelura pa pasur lejen e duhur dhe nuk është bërë asnjë ndjekje për kundërvajtje. Janë emëruar mësues të tepërt, pa u marrë parasysh numri i nxënësve dhe nevojat reale të shkollave. Këto lehtësi e të tjera si këto në çështjet e programit të shkollave, rekrutimit të nxënësve etj., i kemi

[77] *AQSh*, Fondi MPB, viti 1938, fl.5. MA - MPJ, 19 tetor 1938.
[78] *AQSh*, Fondi MPB, viti 1938, fl.6. I Ngarkuari me Punë a.i. i Shqipërisë në Greqi - MPJ, 12 tetor 1938.
[79] *AQSH,* Fondi MA, viti 1938, dos.29, fl.1-2. Legata shqiptare në Athinë - MPJ, 21 qershor 1938.
[80] *AMPJ*, viti 1938, dos.106, fl.81. Legata shqiptare në Athinë - MPJ, 10 qershor 1938.
[81] *AMPJ*, viti 1938, dos.106, fl.87. Konsullata shqiptare Selanik - Legatës shqiptare Athinë, 6 shtator 1938.
[82] *AMPJ,* viti 1939, dos.125, fl.7. MPJ - Kryeministrisë, 30 janar 1939.

bërë për hir të miqësisë që na lidh me shtetin fqinj, pasi, nëse do të zbatohej me korrektësi rregullorja për shkollat private të minoriteteve, rrethet grekofone nuk do të kishin kaq shkolla dhe kaq mësues sa kanë sot".[83]

Krejt ndryshe po vepronte qeveria greke në Çamëri. Qeveria greke kishte emëruar në Margellëç mësues, jashtë listës së propozuar nga Legata Shqiptare, të cilët nuk dinin të shkruanin e të lexonin në gjuhën shqipe. Konsullata shqiptare e Janinës informonte se autoritetet greke kishin emëruar elementë të përzgjedhur prej tyre me qëllim që të pengonin mësimin e gjuhës shqipe. Në rastet kur komunitetet shqiptare vendase nuk i pranonin këto mësues, autoritetet greke përfitonin dhe i shtynin emërimet e mësuesve të tjerë edhe disa muaj dhe shkollat mbeteshin jashtë funksionit. Ky ishte sistemi i sabotimit të shkollave shqipe që po aplikonte qeveria greke. Gjithashtu, ishte ndjekur edhe politika e hapjes së shkollave ku mësohej gjuha shqipe në katundet e vogla si Gurreti, Smerta e Faskomilja me nga 15 - 20 shtëpi, duke u lënë mënjanë katundet e mëdha si: Margelliçi, Picari, Arvenica, Kurtesi e shumë të tjera që kishin nga 200 - 300 shtëpi.[84]

Me këtë veprim, qeveria greke donte të plotësonte numrin e 10 shkollave ku mësohej shqipja dhe, nga ana tjetër, të pakësonte në maksimum numrin e nxënësve që mësonin këtë gjuhë. Autoritet greke gjithashtu po përpiqeshin të diskreditonin dhe inkriminonin mësuesit që jepnin gjuhën shqipe në Çamëri, duke i paraqitur ata si elementë antigrekë. Drejtori politik i MPJ të Greqisë i lexoi ministrit shqiptar një raport të autoriteteve greke në Çamëri, i cili fliste kundër mësuesve çamë. Ministri shqiptar e cilësoi këtë raport si të ekzagjeruar. Ai theksoi se autoritetet policore në Çamëri dhe mësuesit e gjuhës greke atje i shihnin me sy të keq mësuesit e gjuhës shqipe.[85]

Politikat asimiluese ndaj minoriteteve ishin tipar thelbësor i politikës së shtetit grek në periudhën midis dy Luftërave Botërore. Përveç qëndrimit agresiv ndaj minoritetit shqiptar, shteti grek ndoqi një politikë shkombëtarizuese edhe ndaj pakicave turke, maqedone e vllehe, gjë që e bën krejtësisht të ndryshme politikën greke nga ajo shqiptare. Një rast konkret është qëndrimi ndaj pakicës turke në Thrakën Perëndimore. Në bazë të Traktatit të Lozanës, Thraka Perëndimore, e

[83] *AMPJ,* viti 1939, dos.125, fl.8-11. MA - Kryeministrisë, 13 shkurt 1939.
[84] *AMPJ,* viti 1939, dos.125, fl.23. Konsullata e Shqipërisë në Janinë - Legatës shqiptare Athinë, 27 shkurt 1939.
[85] *AMPJ,* viti 1939, dos.125, fl.31. Legata shqiptare Athinë - MPJ.

cila popullohej në shumicë nga turqit, iu la Greqisë. Traktati i Lozanës përcaktoi njohjen dhe respektimin e të drejtave të minoriteteve dhe ndalimin e dëbimit të turqve nga Thraka Perëndimore. Për këtë qëllim u parashikua kufizimi i vendosjes së grekëve në këtë rajon dhe rikthimi i pronave turke që ishin pushtuar forcërisht nga refugjatët ose qytetarët grekë në Thrakën Perëndimore tek pronarët e tyre legjitimë turq. Popullsia e Thrakës Perëndimore në vitet 1922 - 1923 kishte qenë 191 699 vetë (129 120 turq, 33 910 grekë, 26 266 bullgarë, 1 480 izraelitë dhe 923 armenë). Raporti i turqve me grekët ishte 4 me 1. Turqit zotëronin 84% të tokës dhe jetonin në 34 fshatra, grekët zotëronin 5% të tokës dhe jetonin në 12 fshatra.[86]

Por më vonë situata ndryshoi në mënyrë drastike. Sipas regjistrimit të popullsisë së Greqisë të vitit 1951, popullsia e Thrakës Perëndimore ishte 356 555 banorë. Prej saj vetëm 100 000 ishin turq megjithëse nataliteti i turqve kishte qenë 28/1000 në vit. Arsyeja e kësaj rënie të numrit të popullsisë turke ishin masat shtypëse e shkombëtarizuese të qeverisë greke të cilat shkaktuan emigrimin masiv të turqve në Turqi edhe gjatë viteve '20 - '30, ndërsa grekët u vendosën në këtë rajon, në kundërshtim me Traktatin e Lozanës.

Numri i fshatrave turke u zvogëlua nga 300 në 42. Zotërimi i tokave prej turqve zbriti nga 84% që ishte në vitet 1922 - 1923, në 50% në vitin 1960 dhe zotërimi i tokave prej grekëve u rrit nga 5% në 45% në vitin 1960.[87] Ky proces i tjetërsimit etnik të Thrakës Perëndimore ishte intensiv në vitet 30. C. Evelpidi theksonte se numri i refugjatëve që u vendosën në Thrakën Perëndimore, në kundërshtim me Traktatin e Lozanës, në vitin 1930, kishte arritur në 100 000 vetë.[88] Gjyqet greke refuzuan t'u njihnin turqve vlefshmërinë e titujve të pronësisë dhe gjyqet zgjateshin nga viti në vit.

Ligjet greke ndihmuan procesin e shpërnguljes së minoriteteve. Gjithashtu një faktor që bënte presion ishte edhe krediti agrar. Ndërsa, fermerët grekë gëzonin përfitime të shumta nga Bankat Bujqësore dhe nga shoqëritë e kreditit të sponsorizuara nga qeveria, fermerëve

[86] *Turkish Minority in Greece, Greek Minority in Turkey*, f.7. Këto të dhëna janë marrë nga shënimet zyrtare të Konferencës së Lozanës, First Series, Volume I, f.30-33, 49. Ato janë të konfirmuara gjithashtu edhe nga dokumentet zyrtare greke.

[87] *Turkish Minority in Greece, Greek Minority in Turkey*, f.7. Këto të dhëna janë marrë nga shënimet zyrtare të Konferencës së Lozanës, First Series, Volume I, f.30-33, 49. Ato janë të konfirmuara gjithashtu edhe nga dokumentet zyrtare greke. f.8.

[88] C. Evelpidi, *Balkan States*. A Compared Study of Politics, Sociology, Economy and Finance, Paris, 1930, f.57.

shqiptarë, turq dhe bullgarë u ishin mohuar këto lehtësi. Në fakt, kjo ka qenë një praktikë gjerësisht e përdorur nga shteti grek për spastrimin etnik të pakicave.

SUMMARY

Beqir META

GREEK ATTEMPTS TO REVIVE HELLENIZATION IN ALBANIA AND TO WEAKEN THE ALBANIAN ELEMENT IN ÇAMËRIA FROM 1936 UNTIL 1939

Prior to Italy occupying Albania, the Greek - Albanian relations were relatively peaceful. Both sides were significantly worried in regard to the expansionist Italian policies in the Balkans. However, the most threatened one was Albania. In accordance to relevant archival and bibliographical research, this paper will present for the first time the Greek attempts to benefit from the newly created conditions to advance its policies for hellenizing Albania, as well as to weaken the Albanian minority in Greece.

The paper will present authentic information highlighting the attempts of Albanians from Çamëria to open Albanian school, as well as the attempts and acts of the Greek governments to halt this process. The Greek government undertook several restrictive measures to suppress the Albanian will to open Albanian schools. The Greek government went so far as to take restrictive measures to even halt the usage of the Albanian language altogether.

In 1938 the Greek government restarted their attempts to expel Albanians from Çamëria. The paper presents interesting information regarding this topic. The paper also presents the extremely withdrawn stance of the Albanian government, which seeing the threat looming towards Albania from the Adriatic, did everything in its power to maintain peaceful relations with Greece.

The paper also presents the Greek attempts to open Greek school in Himarë and the results of such attempts. Himara was considered a strategic bastion for Greek politics, which they assumed would pave the way for the advancement of Greek education and Hellenization of other areas in Southern Albania.

Nuri DRAGOJ

VËSHTRIM MBI LUFTËN ITALO - GREKE DHE PASOJAT QË RRODHËN PREJ SAJ NË TREVAT JUGORE TË SHQIPËRISË

Në prag të Luftës së Dytë Botërore, thuajse gjithë shtetet e evropiane dominoheshin nga tregtia gjermane. Shumë prej tyre qenë zhytur në borxhe nëpërmjet kredive dhe e kishin të vështirë shlyerjen. Në muajin mars 1939, Italia i detyrohej Gjermanisë 350 milionë lira borxh. Më 18 mars, Bernero, në emër të kabinetit të Romës, siguronte Hitlerin se qëllimi i tyre ishte të mbështesnin Gjermaninë, ndërsa më 10 qershor, ai deklaroi në Pallatin Venecia se lufta përkrah Gjermanisë ishte luftë e popullit të varfër kundër atyre që patën grumbulluar arin e botës.[1] Por, në raport me Shqipërinë, Italia ndihej superiore dhe kishte vite që bënte presion për të pranuar kushtet e saj. Mbreti Zog bëri tentativa për të shmangur konfliktin, por nuk ia arriti qëllimit. Mori disa masa ushtarake nëpërmjet një mobilizimi të pjesshëm të rezervistëve në disa rrethe, veprime të cilat tentonte t'i kryente pa rënë në sy të italianëve. Më 6 prill ai thirri Parlamentin, të cilin e njohu me situatën e krijuar dhe pas rrahjes së mendimeve u vendos të mos i pranonin kushtet italiane, duke u vendosur në këtë mënyrë në gjendje lufte me të. Por Musolini nuk do të kthehej mbrapa, pasi kishte plane të tjera pushtimi edhe për Greqinë e më gjerë. Ishin përgatitur 22 mijë trupa ushtarake, ushtarë, nënoficerë dhe oficerë, 64 topa të kalibrave të ndryshëm, 134 tanke, 860 automjete, 1 200 motoçikleta, 5 500 biçikleta,

[1] Roberto Bataglia,*Lufta e Dytë Botërore,* Tiranë: 8 nëntori, 1991, f. 121-122.

2 500 kuaj dhe mushka, 14 aeroplanë etj. Por ka dhe burime të tjera që bëjnë fjalë për 50 mijë trupa.[2]

Pavarësisht nga gjendja në të cilën ndodhej vendi dhe mungesa e organizimit, forcat pushtuese u pritën me armë gati në gjithë vijën bregdetare. Natyrisht, njerëz që u shërbenin italianëve brenda radhëve të ushtrisë shqiptare bënë punën e vet, duke nxjerrë jashtë luftimi disa armë të artilerisë bregdetare. I ndodhur në rrethana të disfavorshme, populli shqiptar iu përgjigj "ndërgjegjes kombëtare". Në mbarë Shqipërinë, qindra luftëtarë u drejtuan drejt brigjeve të Adriatikut e Jonit. Në Durrës, atdhetarët e vërtetë drejtuan armët mbrojtëse kundër pushtuesve. Kur Italia u përballë me rezistencën shqiptare, të cilën nuk e kishte parashikuar, u detyrua të niste dhe 74 aeroplanë të tjerë, të cilët bombarduan gati gjithë rajonin bregdetar.

Sulmi ndaj Shqipërisë u prit keq edhe nga vet populli italian. Në mitingjet që zhvilloheshin në mbështetje të politikës së Romës vihej re pjesëmarrje e dobët. Këtë situatë e konstatonte dhe ushtaraku gjerman Fon Rintelen, i cili pohonte se në sheshin Venecia kishte patur pak njerëz dhe mungonte entuziazmi.[3] Por në Shqipëri ndihej pasiguri. Në pasditen e datës 8 prill, Mbreti Zogu i I-rë kishte marrë vendim të largohej në drejtim të Greqisë. Atij i kishte dhënë azil mbretëria greke me kusht që të hynte në Greqi para datës 9, sepse kufiri do të mbyllej. Greqia i kushtëzoi emigrantët e oborrit, që për sa kohë do të ishin brenda territorit helen, nuk duhej të merreshin me politikë.[4]Në kohën që mbreti udhëtonte për në Greqi, legata shqiptare në Paris, më 8 prill 1939, i kërkoi Lidhjes së Kombeve të kundërshtonte agresionin italian mbi Shqipëri.[5] Qeveria e Musolinit mori masa për të shkrirë ushtrinë shqiptare dhe organizimin e saj në njësi të vogla, të cilat do të ishin në varësi të ushtrisë italiane. Repartet e mëdha shqiptare u shpërbënë për të shmangur ndonjë rrezik të mundshëm.[6] Pas kësaj filloi puna për krijimin e disa batalioneve shqiptare, të cilët do të quheshin "Batalione Vullnetarësh Rajonal Shqiptarë". Ata drejtoheshin nga komandantë

[2] Gjergj Titani, *Lufta italo - greke, tetor 1940-prill 1941*, Tiranë: Botimet Morava, 2011, f. 50-51.
[3] R. Bataglia, *Lufta e Dytë Botërore*…, f. 127.
[4] Gj. Titani, *Lufta italo - greke…,* f. 52-58.
[5] Beqir Meta, *Tensionin greko - shqiptar* 1939 - 1949, Tiranë, GEER, 2002, f. 54.
[6] Piero Croaciani, *Shqiptarët në forcat e armatosura italiane* (1939-1943), Romë 2001, Tiranë 2005, f.23

shqiptarë me gradën major, të cilët caktoheshin nga Luogotenenca.[7]Në çdo batalion ishte dhe një oficer italian, që quhej "këshilltar".

Vullnetarët duhej të ishin të veshur me rroba civile dhe të mbanin një shirit në mesin e krahut të majtë, me ngjyrat kuq e zi të flamurit shqiptar dhe një mbulesë krahu në këtë ngjyrë, e cila kishte një disk tri ngjyrash, jeshil, bardhë dhe kuq, me një yll.[8]

Me pushtimin e Shqipërisë, Italia ndërmori një aksion të madh ndërtimor në rajonin lindor dhe jugor të vendit. Propaganda e komentonte atë si një hap pozitiv për zhvillimin infrastrukturor dhe bujqësor të Shqipërisë, por nuk ishte e vështirë të kuptohej që ato ishin punime ushtarake, të cilat kryesisht synonin hapjen e rrugëve. Kjo shihej edhe në ndërtimin e disa objekteve sanitare që do të shërbenin për dhënien e ndihmave mjekësore. Pikat sanitare në jug u vendosën në Vlorë, Delvinë, Gjirokastër, Përmet, Këlcyrë, Çorrovodë, Leskovik, Jorgucat, Sarandë etj. Ndërkohë u ndërtuan me urgjencë dhjetëra burgje të shpërndara në gjithë vendin. Për jugun ato u përqendruan në Porto Palermo, Drashovicë, Berat e Skrapar.[9] Në janar të vitit 1940, u kërkua thirrja nën armë e të rinjve shqiptarë të datëlindjes 1919. Në muajin prill duhej të ishin mbledhur 5 280 vetë. Ata do të stërviteshin dhe të punonin në rrugë deri në muajin shtator. Pas kësaj duhej të ishin të gatshëm për luftë. Gjeneral Visconti Prasca, më 28 shtator 1940, vinte në dukje se ministria e luftës kishte miratuar krijimin e batalioneve vullnetare shqiptare. Do të ngriheshin 6 batalione të tilla, me qendër në Sarandë, Delvinë, Gjirokastër, Përmet, Leskovik dhe Korçë. Në Përmet do të krijohej batalioni IV me 3 kompani që i përkiste divizionit "Ferrara".[10]

Batalioni "Gramozi", me qendër në Përmet, në atë kohë kishte 580 forca dhe priste 300 rekrutë të tjerë.[11]Veç tij u krijuan dhe batalionet "Dajti" në Delvinë, "Korata" në Barç, "Kaptina" në Ersekë, "Tomorri" në Librazhd dhe "Taraboshi" në Tiranë. Batalioni "Gramozi" që u vendos në Përmet, bënte pjesë në Regjimentin e këmbësorisë Ferrara dhe kishte në përbërje të vet 30 oficerë, 29 nënoficerë, 799 ushtarë, 34 kafshë, 740 pushkë, 24 automatikë, 4 mitrolozë.[12]

---

[7]*Po aty*, f. 188.
[8]*Po aty*.
[9] Gj. Titani, *Lufta italo-greke*.., f. 58-59.
[10]*Po aty*, f. 331
[11] Piero Croaciani, *Shqiptarët në forcat e armatosura*…, f. 54-59.
[12]*Po aty*, f.28.

Më 18 korrik Hitleri ftoi Musolinin në Mynih për bisedime, por jo si ortak. Ai nuk e përfshiu atë si pjesë të delegacionit për armëpushimin me francezët. Me sa duket, Duçe u ndie i fyer, ndaj për të fituar autoritetin e duhur dha urdhër të sulmoheshin francezët në Alpe, ku pësoi humbje të mëdha.[13]

Ky rezultat e tronditi kreun e qeverisë së Romës. Kjo bëri që t'i hetonte me kujdes propozimet rreth planit të sulmit mbi Greqi. Vëmendja ishte përqendruar te ushtarakët shqiptarë. Lidhur me gjendjen shpirtërore të oficerëve të Tiranës, në një dokument sekret të muajit dhjetor 1939, thuhej se ata ishin korrekt në formë, por "të papenetrueshëm në ndjenjat e tyre". Kultura e oficerëve shqiptar cilësohej e paktë dhe shtohej se ata nuk kryenin asnjë lloj detyre me gjithë zemër. Ndërkohë përballeshin edhe me vështirësi ekonomike, pasi çmimet ishin rritur.[14] Për të zbutur këtë situatë, propozohej të shihej mundësia e daljes së një dekreti për trajtimin me pagë edhe të bashkëshorteve të ushtarakëve.[15] Italianët i trembeshin indiferencës që tregonin oficerët shqiptarë sepse vërehej një farë ftohtësie me oficerët italianë. Shefat e ushtrisë, një fakt të tillë e shpjegonin me inferioritetin kulturor, mos njohjen e mirë të gjuhës dhe pabarazisë në paga. Madje edhe oficerët italianë nuk pajtoheshin me barazinë midis tyre, pasi ata i përkisnin "një ushtrie fisnike dhe me tradita të shkëlqyera".[16] Ushtarakët shqiptarë, ndonëse u inkuadruan në radhët e ushtrisë italiane për nevoja ekonomike, nuk ishin për të sulmuar një vend tjetër. Në raportin e muajit gusht 1940, që i dërgohej Komandës së Karabinierisë Mbretërore thuhej se oficerët shqiptarë "nuk tregohen shumë entuziast ndaj një fushate eventuale kundër Greqisë", edhe pse fushata italiane pretendohej se kishte si qëllim të realizonte rivendikimet shqiptare.[17]

Italia luajti me ndjenjat e shqiptarëve. Duke qenë se ngjarjet e vitit 1914 ruheshin ende të freskëta në kujtesën e banorëve të trevave jugore, propagandohej se ajo, një mike e mirë e Shqipërisë, po përpiqej të korrigjonte padrejtësitë e bëra nga Konferenca e Ambasadorëve të Londrës së vitit 1913. Nën këtë frymë ishin inkuadruar në radhët e ushtrisë italiane edhe trupa shqiptare. Ata besonin se Italia do të sillte bashkimin e Kosovës dhe Çamërisë me Shqipërinë. Më 16 shtator 1940,

[13] R. Bataglia,*Lufta e Dytë Botërore...,* f. 123-126.
[14] P. Croaciani, *Shqiptarët në forcat e armatosura italiane* … f.46.
[15]*Po aty*.
[16]*Po aty,* f. 49.
[17]*Po aty*, f. 51.

raportohej se trupa e batalionit "Gramozi", pas një shfaqje kinematografike kishte kënduar "plotë entuziazëm për Perandorin dhe Duçen, duke i kërkuar në mënyrë të përsëritur Themeluesit të Perandorisë, që të çlironin vëllezërit e Çamërisë dhe Kosovës".[18]

Ndërkohë edhe qeveria e Tiranës bënte të njëjtën propagandë. Ata informonin krerët e Çamërisë se gjithë populli shqiptar do të luftonte krahas forcave italiane. Fryma e krijimit të një Shqipërie me kufijtë etnik ndihej kudo. Rekrutimi në radhët e milicisë fashiste bëhej nën këtë moto. Jakomoni shprehej më 20 tetor 1940, se gjendja në radhët e milicisë shqiptare paraqitej shumë e mirë dhe ndihej "dëshira për të luftuar për Shqipërinë e Madhe dhe Perandorin".[19]Më 15 tetor, Jakomoni i raportonte Duçes se në Shqipëri sulmi ndaj Greqisë pritej me ankth. Për gjeneralin Viskonti Prasca, nga radhët e shqiptarëve mund të angazhoheshin çeta me 2 500 - 3 000 veta nën kujdesin e oficerëve italianë.[20] Ndërsa, Jakomoni premtonte 7 000 rekrutë të rinj. Këto raportime e bënë më entuziastë Duçen. Çiano dhe Jakomoni e siguruan Musolinin se Greqia do të binte menjëherë. Ata hapën fjalë për rritje pagash, me qëllim që hyrja e tyre në Shqipëri të shihej si shpresë për të nesërmen. Por premtime të tilla do të zgjonin edhe interesin e Greqisë, e cila nuk e dëshironte qëndrimin pro italian të shqiptarëve.[21]

Ngjarjet zhvilloheshin me shpejtësi. Në kohën kur Duçe e kishte saktësuar kohën e sulmit, gjeneral Prasca inspektoi menjëherë divizionet e vendosura në vijën e kufirit shqiptaro - grek. Madje, ai shkoi të merrte takim me gjithë komandat e regjimenteve. "Vicenza" dhe "L'Aquila" ishin vendosur në pritje, pranë Urës së Peratit, përgjatë degës së lumit Sarantaporos që derdhet në Vjosë. Në Korçë ishte vendosur Korparmata e XXVI, ndërsa në Gjrirokastër ajo e XXV. Ndërkohë, edhe Greqia ishte informuar për një sulm të tillë, ndaj kishte marrë masat përkatëse. Me propozim të kryetarit të Këshillit të Ministrave, duke filluar nga mesnata e datës 28 tetor 1940, deklarohej gjendje lufte duke përfshirë çdo efekt tjetër ligjor mbi tokat e prefekturës Tiranë, Korçë, Vlorë, Elbasan, Gjirokastër, Durrës, Berat.[22]Po ashtu urdhërohej mobilizimi civil i gjithë atyre që i përkisnin administratës shtetërore, bashkiake e

[18] P. Croaciani, *Shqiptarët në forcat e armatosura italiane* … f. 60.
[19]*Po aty*, f. 61.
[20]*Po aty,* f. 62.
[21] R. Bataglia,*Lufta e Dytë Botërore…,* f. 139.
[22]*Fletore Zyrtare*Nr. 165, datë 28 tetor1940, f. 1. Dekret Nr. 448, datë 28 tetor 1940. Deklarohet gjendje lufte në disa prefektura.

komunale.[23]Po atë ditëishte dhënë urdhri për sulm. Fillimisht, në përpjekje me forcat greke, kishte rënë një batalion shqiptar, në lindje të Peratit, të cilët kishin luftuar ashpër për gati tri orë.[24]

Të nesërmen e sulmit mbi Greqi, legata shqiptare në Paris i afroi ministrit grek mbështetjen shqiptare kundër armikut të përbashkët. Të njëjtën gjë bëri dhe legata shqiptare në Ankara, me thirrjen e së cilës u regjistruan shumë vullnetarë për të shkuar në mbështetje të frontit grek kundër Italisë.[25] Por forca të tilla nuk u pranuan nga komanda greke, pa dhënë asnjë shpjegim.

Regjimenti 8 alpin dukej se kishte përparuar mirë, ndërsa i nënti ishte futur në luginën e sipërme të Vjosës dhe po i afrohej Mecovës. Ata kishin krijuar mendimin se rezistenca greke do të ishte e dobët. Mirëpo, aty do të përballeshin me një sulm të ashpër. Dukej se grekët i kishin lënë të përparonin për t'i futur në kurth. Regjimenti i IX përpiqej të kalonte Vjosën por shumë ushtarë dhe mushka i kishte përpirë ujë. Divizioni alpin u habit nga ky sulm i papritur grek por vazhdonte të rezistonte. Komanda italiane në Shqipëri u dha urdhër të tërhiqeshin dhe t'u prisnin rrugën forcave greke për të mos hyrë në Urën e Peratit.[26]Pesë ditë pas sulmit mbi Greqi, divizioni alpin "Julia" u thye dhe u tërhoq në drejtimin e Tri Urave dhe vijës Grevene - Leskovik. Por Korparmata e Parë greke do të jepte një sulm të fuqishëm në vijën Konicë - Ura e Peratit me divizionin e kavalerisë, si dhe një tjetër sulm në vijën Janinë - Sarandë. Në 6 nëntor, Çiano detyrohej të pranonte se iniciativa kishte kaluar në favor të grekëve. Ata kishin kundërsulmuar në frontin e Maqedonisë Perëndimore, duke u shkaktuar disfatë trupave italiane. Më 23 nëntor deri në 10 dhjetor, forcat greke u hodhën në ofensive të përgjithshme me objektiv marrjen e malit të Gjerë, Dhëmbelit dhe Kokojkës së Frashërit. Pas kësaj ushtria greke do ta kishte më të lehtë të përparonte në drejtim të Beratit.[27] Komanda ushtarake italiane e hutuar nga humbjet e mëdha dhe mungesa e përforcimeve dha urdhër për tërheqjen e forcave në drejtim të Leskovikut për të garantuar mbrojtjen e divizionit të tretë alpin "Julia" dhe atij të pestë "Pusteria", gjatë përroit të Lemnicës. Por brenda javës forcat greke ishin mobilizuar dhe nuk u lanë kohë italianëve për t'u organizuar. Kjo e detyroi komandën të

[23]*Po aty*.
[24] Gian Carlo Fusco, *Lufta në Shqipëri,* Tiranë: "55", 2008, f. 27-29.
[25] B. Meta, *Tensionin greko - shqiptar*…, f. 54.
[26] Gian Carlo Fusco, *Lufta në Shqipëri…,* f. 35-36.
[27]Gj. Titani, *Lufta italo-greke* …, f. 117-120.

urdhëronte divizionin "Julia", i cili po vendosej në Përmet, që të kapte vijën Miçan - Selishtë e Frashërit. Aty besohej se ishte më e lehtë për të ndalur forcat greke, pasi mali i Qelqit, Kokojka e Frashërit dhe mali i Taborrit, bashkë me kurrizin e Luarit, i prisnin të gjitha rrugët që vinin nga krahina e Ersekës për në krahinën e Frashërit dhe Përmetit. Italianët vendosën një tjetër vijë mbrojtje me armatën e XI, në vijën Qarrishta e Fratarit - Rapckë, me të cilën do të pengonte mësymjen e mëtejshme greke. Luftimet e zhvilluara në malin e Qelqit, atë të Miçanit dhe kurrizin e Luarit ishin të ashpra, por italianët, ndonëse të rraskapitur dhe të rënë moralisht, mundën të frenonin sulmet greke për disa ditë.[28]

Ndërkohë trupat helene kishin planifikuar marrjen e Dhëmbelit dhe lirimin e krahinës së Zagories, me synim vendosjen në vijën Dobrushë - Vokopolë - Gllavë - Zhapokikë - mali i Thatë - Himarë. Në këtë mënyrë ata siguronin kalimin me mjete në drejtimin Tepelenë - Këlcyrë dhe mund të vazhdonin mësymjen më tej. Në pritje të forcave të reja italianët menduan të tërhiqeshin dhe të ruanin vijën mbrojtëse Himarë - Mali i Golikut - Qarishtë e Fratarit e deri në malin e Mokrrës. Armata e 9 shtrihej nga Kreshova në Liqenin e Ohrit, ndërsa dy divizione kishin drejtimin Tepelenë - Berat. Korparmata e parë ishte në vijën Golik - Hormovë - Tepelenë. Në ato pika italianët hapën transhe dhe fortifikime, gjë e cila u krijoi vështirësi forcave greke, dëmet e të cilëve në fazën e parë të luftimeve ishin të shumta, pasi favorizoheshin nga lodhja, koha e keqe, çrregullimet në furnizime me ushqime e municion dhe rënia e moralit.[29] Për pozitën e saj gjeografike, Këlcyra duhej të paraqiste çelësin për zgjidhjen e betejës së madhe, piketuar në pesëmbëdhjetë ditshin dytë të muajit nëntor 1940. E ndodhur midis malesh të lartë, Këlcyra kontrollonte të gjitha kalimet drejt detit dhe drejt Prevezës.[30]

Më 6 nëntor 1940, lajmet bënin të ditur se forcat greke po përparonin. Visconti Prasca vazhdonte të ishte në krye të armatës së Epirit dhe Musolini shpresonte ende që të merrte në dorë situatën.[31] Më 21 nëntor, gjenerali Soddu njoftonte se detyrohej të linte Korçën dhe të tërhiqej, ndërsa më 4 dhjetor bëhej e ditur, që edhe Pogradeci ishte marrë nga forcat greke.[32]Nga data 28 tetor kur filloi sulmi dhe deri më

[28]*Po aty*, f. 122-123.
[29]*Po aty*, f.125-130.
[30] Gazeta *Tomorri*, 18 prill 1941, f.1.
[31] Gaetano Ciano, *Ditari i Kontit Ciano, Shqipëria*, Tiranë: Albinform 1994, f. 67-68.
[32]Po aty, f. 75.

10 nëntor, Divizioni alpin "Julia", që mbahej nga më të mirët, kishte humbur 49 oficerë, 1 700 ushtarë si dhe 400 kafshë ngarkese. Numri i të plagosurve ishte shumë i madh dhe pikat sanitare të ngritura nuk mund t'i përballonin. Por edhe forcat greke kishin vështirësi pasi furnizimi me ushqime dhe materiale luftarake nga prapavija kishte ndërprerje për shkak të kohës së keqe dhe rrugëve të pakalueshme. Kafshë dhe mjete motorike të të dy palëve kishin mbetur në baltë.[33]

Gati 10 ditë ishte bërë një armëpushim i heshtur, pasi forcat italiane ishin pozicionuar në mbrojtje dhe ato greke nuk po sulmonin. Por nga data 12 deri në datë 23 dhjetor, trupat greke do të ndërmerrnin sulme të ashpra në Qarrishtën e Fratarit dhe luginën e Tomorricës. Divizioni "Julia" vazhdonte të mbante peshë të madhe në luftime, duke filluar nga Frashëri në Qarrishtën e Fratarit dhe në luginën e Osumit. I ndodhur nën breshërinë e artilerisë efikase greke dhe të një sulmi që nuk e kishin menduar, ata mbetën të mbërthyer në malin e Topojanit. Në kohën që duhej të bëhej tërheqja e tyre ishte dhënë urdhër që të mbanin Çukën e Feçit mbi fshatin Pavar, midis divizionit "Bari" dhe "Lupi di Toscana". Por për shkak të mungesës së ndihmave në forca e mjete, ai do të mbetej rrugëve, duke u pakësuar në 1 000 vetë, për shkak se kishin humbur 153 oficerë dhe 3 844 pjesëtarë të tjerë të efektivit.[34] Më 14 dhjetor, Soddu dërgonte raporte shqetësuese. Musolini vihej në dijeni se, 5 gjeneral ishin zënë rob dhe një ishte vrarë.[35]

Italia do t'u kushtonte rëndësi sulmeve ajrore. Gazeta "Tomorri" njoftonte se vetëm në datën 22 janar kishin qenë më shumë se 1 000 bombardonjës, që lëshonin bomba në vijat e prapme të frontit grek, sidomos në ato të trevës së Përmetit, duke shkaktuar viktima dhe dëme materiale.[36] Shtetet e boshtit i jepnin kurajë njëri - tjetrit. Nuk dyshonin aspak në fitore, ndonëse Hitleri i përçmonte inisiativat e nxituara të Duçes dhe paaftësinë e ushtrisë së tij. Ai nuk pajtohej me sulmin ndaj Greqisë për të cilin nuk ishte vënë në dijeni. Takimi i 18 janarit midis Duçes dhe Hitlerit do të zhvillohej në Bornnero. Ai njihej si takimi i

[33] Gian Carlo Fusco, *Lufta në Shqipëri*. f. 47-52.
[34] *Po aty*, f. 54-58.
[35] G. Ciano, *Ditari i Kontit Ciano*…, f. 78.
[36] Gazeta *Tomorri,* 24 janar 1941, f.2. Shpallje e Duçes mbi mobilizimin civil në Shqipëri dhe Puglie.
Po aty, Nr. 312, datë 23 janar 1941, f.1. Aviacioni ynë në mënyrë të shkëlqyer rreh pa rreshtur armikun.

gjashtë midis tyre, ku premtohej se do të vazhdonte bashkëpunimi në luftë kundër forcave angleze për të marrë në dorë Afrikën.[37]

Askush nuk donte të largohej nga Këlcyra. Ajo ishte marrë e lënë disa herë nga palët. Më 29 janar forcat italiane të divizionit "Pusteria" dhe "Sforzesca", të vendosura në brinjat jugore të Trebeshinës dhe Shëndëllisë, morën urdhër për një sulm të rreptë, me qëllim që të rimerrnin Këlcyrën. Por, pas 48 orë luftimesh, trupat helene të komanduara nga gjenerali Ekonomakis u hodhën në ofensivë dhe jo vetëm që do të mbanin Këlcyrën, por do të shkonin deri në Tomorricë.[38] Më 30 janar forcat greke sulmuan nga lartësitë e Dhëmbelit e Golikut, për të marrë Urën e Dragotit. Italianët qëndronin fort midis lumit të Drinos dhe Bënçës. Mijëra të vrarë. Të dy palët luftonin ashpër, njëri për të mbajtur dhe tjetri për të marrë nyjën lidhëse të Shqipërisë Jugore. Luftohej edhe për zotërimin e një ure, në një kënd të së cilës ishte një pllakë metalike e salduar me mbishkrimin "Ansaldo, 1938". Bëhej fjalë për Urën e Dragotit.[39]

Cavallero do të linte Këlcyrën me kalanë e saj mbi krye, e cila gjeneralit italian i ngjasonte me atë të Romës. Ishte po aq e vjetër sa ajo. Kishin të njëjtën moshë, por ishin rrënuar nga kohërat, nga luftërat. Kalaja e Romës mbahej ende më këmbë, me muret e saj ta lartë, pjesërisht të restauruar, ndërsa ajo e Këlcyrës thuajse ishte rrafshuar. Dhe në çast mendonte, përse kaq shumë gjak. Kujt mund t'i duhen këto jetë të hedhura tej pa kuptim?

Forcat italiane kishin ndalur në Qafën e Kiçokut dhe nuk donin ta lëshonin. Ishte pikë strategjike, një portë që hapej kur doje të kalohej drejt Beratit apo Përmetit, por dhe mbyllej me lehtësi kur nuk dëshiroje kalimin e kundërshtarit. Forcat greke i kishin hedhur sytë mbi Tri Avgatë. Me këtë emër i kishin pagëzuar tri kodrat e Çukës së Komarit, aty pranë Qafës së Gllavës. Janë tri kodra që nga larg ngjasojnë me tri kokrra vezë. Prej andej e ke në dorë Beratin. Pikërisht këtë synonin forcat helene. Por atje mund të shkosh vetëm nëse të lejon Qafa e Kiçokut, pika që ndan tri nënprefektura: atë të Përmetit, Beratit dhe Tepelenës. Ndodhet 40 km larg nga Berati dhe gati 20 km nga Këlcyra. Prandaj forcat italiane bënin gjithçka për të mos e lëshuar. Për këtë ndërtuan dhe një skalion të dytë mbrojtje në Tërpan. Grekët ndodheshin

[37] *Po aty*, Nr. 311, datë 22 janar 1941, f. 1. Takimi i Duçes me Fuehrerin.
[38] Gian Carlo Fusco, *Lufta në Shqipëri*…, f. 59 - 60.
[39] Gianni Granzotto, *Vjosa ime e dashur, ditar lufte,* Tiranë: Elena Gjika, 2005, f. 25. "Ansaldo, 1938", ishte emri i firmës italiane që e kishte ndërtuar.

në jug të kësaj qafe, ndërsa italianët kontrollonin veriun, por i tmerronte ideja e mundësisë së zotërimit të Beratit prej ushtrisë helene.[40]

Musolini qe informuar se Hitleri po përgatitej të sulmonte Greqinë nëpërmjet kufirit maqedon. Marrja e Greqisë nga forcat gjermane, kur trupat e tyre ishin në Shqipëri, nuk tingëllonte mirë për shefin e fashistëve italian. Prandaj, vendosi të ndërmerrte një ofensivë të madhe në pranverë, me shpresë se do t'i thyente forcat greke. Në këtë mënyrë kishte moral më të ngritur përkrahë Hitlerit, i cili gati e përbuzte. Në atë ofensivë, Duçja kishte vendosur të shkonte dhe vetë. Më 2 mars ai u nis për në Shqipëri. Vajti në Gllavë, ku pa nga afër Tri Avgatë, dhe vijoi më tej për t'u orientuar lidhur me pozicionin e Qafës së Kiçokut. Shkoi në vijën e parë të luftimeve për t'u thënë ushtarëve se ishte mes tyre. Dukej aktiv por dhe i tronditur. Veç humbjeve të ushtrisë e mërziste dhe balta, të cilën do ta quante "baltë e mallkuar". I kishte mbetur makina dhe ishte detyruar të zbriste dhe ai për ta shtyrë bashkë me shoqëruesit e vetë.

Nga kujtimet e bashkëkohësve thuhet se ai, kishte shkuar deri afër Qafës së Kiçokut, ku të dy ushtritë arritën të luftonin bajonetë më bajonetë. Përroi i Maricajve ishte mbushur me të vrarë. Divizioni grek "Evzone" ndodhej në krahun e Skraparit. Duçe në Tërpan kishte dalë në një vend të lartë që ngjasonte me një ballkon dhe shihte me dylbi sa në drejtim të Qafës së Kiçokut në malin e Tomorrit. I dukeshin aq afër, sa mund t'i prekte me dorë. E lakmonte orakullin e shqiptarëve, por ëndrra e tij ishte Janina. I trishtuar që nuk e mori dot, shpresonte të mbante Beratin dhe kjo varej nga ajo Qafë me emrin Kiçok. Prej andej shihte grykën e Osumit dhe habitej, si nuk ishte ndërtuar ndonjë rrugë prej osmaneve ose edhe me vonë nga italianët, si një degëzim të rrugës Egnatia.[41]

Nën vëzhgimin e tij, trupat italiane u hodhën në sulm më 9 mars. Kavallero kishte në dispozicion 28 divizione dhe 900 avionë. Duçe u jepte shpresë. Me prezencën e tij u thoshte se jemi të gjithë bashkë. Por nuk e fshihte dyshimin që e brente nga brenda. Gjithsesi nuk tërhiqej nga sulmi në front të gjerë, ku pati gati dy herë më shumë forca se sa Greqia.[42] Më 13 mars jepej lajmi, sipas të cilit qenë bërë bombardime të

[40] Asllan Sulo, *Dy net që ngrinë Romën* (Mbijetesa e popullit shqiptar gjatë luftës italo-greke), Tiranë : Eugen, 2001, f. 82-85.
[41] A. Sulo, *Dy net që ngrinë Romën*…, f. 146 - 152.
[42] Luigi E. Gianturco, *Pietro del muro.Raconti di guerra d'Albania*. Bologna, 1954, f. 101-103.

shumta dhe forcat italiane u kishin shkaktuar humbje trupave greke në frontin e Vjosës. Ndërkohë, ishin rrëzuar 4 avionë bombardues, dy për secilën palë.[43]

Por ofensiva italiane dështoi duke lënë mbi 12 mijë të vrarë. Duçe i indinjuar shprehej se, i vinte ndot për një situatë të tillë. Ai pohonte se e kishin gënjyer me informacionet që i patën dhënë, duke e detyruar të merrte vendime të gabuara.[44] Madje shante dhe racën e kombit të vetë. Por ngjarjet e mëvonshme do të zhvilloheshin në favor të tij, pasi më 28 mars, Hitleri sulmoi Jugosllavinë, e cila kapitulloi më 14 prill. Në datat 7 - 11 prill, forcat gjermane kishin hyrë në Bullgari. Kjo i gëzonte italianët, pasi sipas tyre, në rrethanat e reja, Greqisë i mbetej një krah i vdekur.[45]

Athina i trembej rrezikut gjerman ndaj urdhëroi tërheqjen nga fronti. Politika e saj u drejtua në krijimin e një mirëkuptimi me gjermanët, që t'u garantohej mbrojtja e jugut të Shqipërisë. Gjithsesi, tërheqja greke u krijoi mundësinë forcave italiane të rivendoseshin përsëri deri në Korçë.[46] Më 18 prill 1941 thuhej se trupat e armatës XI kishin pushtuar Këlcyrën dhe vazhdonin të ndiqnin ushtrinë greke në tërheqje.[47]Në rrethanat e reja, Italia përsëriti thirrjen për mobilizimin e shqiptarëve në luftë, pasi do të bëhej Shqipëria e Madhe. Atë e pohonte dhe kreu i qeverisë kuislinge Shefqet Vërlaci, sipas të cilit Shqipëria do të zgjerohej së shpejti dhe se fitorja kundër forcave anglo - greke ishte garanci për arritjen e objektivit të saj.[48]

Shqiptarët në radhët e ushtrisë italiane

Pjesëmarrja e shqiptarëve në radhët e ushtrisë italiane, është parë në këndvështrime të ndryshme. Nga pala greke ata janë konsideruar agresorë njëlloj si dhe forcat italiane. Në fakt ushtarakët shqiptarë nuk kanë qenë asnjëherë dakord për të sulmuar fqinjin. Ata e kuptuan që një sulm i tillë nuk sillte dobi për Shqipërinë, përveç robërisë. Por situata e

[43] Gazeta *Tomorri,* Nr. 70, datë 13 mars 1941, f.1. Komunikata Nr. 278. Në frontin e Vjosës.
[44] Arben Puto, *Lufta italo-greke, diktaturë kuislinge*, Tiranë: Toena 2011, f. 90-94.
[45] Gazeta *Tomorri,* Viti II i botimit, Nr. 64, datë 6 mars 1941, f.2. Hyrja e trupave gjermane në Bullgari e bënë Greqinë me një krah të vdekur.
[46] A. Puto, *Lufta italo-greke…,* f. 90-94.
[47] Gazeta *Tomorri,* Nr. 101, datë 18 prill 1941, f.1. Thyrja e ballit të Këlcyrës.
[48] *Po aty*, Nr. 110, datë 29 prill 1941, f. 1. Artikulli Salidarësia vëllazërore armësh italo - shqiptare. Vërlaci në pritje me gazetarë të huaj.

vështirë ekonomike bënte të mos shpreheshin hapur. Këtë e konstatuan dhe italianët, ndaj komanda e lartë vendosi të largonte nga shërbimi një numër të madh oficerësh shqiptarë, të vjetër në moshë dhe që nuk jepnin garanci politike, por duke u siguruar më parë një rrogë të mjaftueshme, për të shmangur mundësinë e ndonjë pakënaqësie dhe propagande kundër tyre.[49]

Pavarësisht se në ushtrinë italiane kishte oficerë, nënoficerë dhe ushtarë shqiptarë, nuk pranohej "asnjë lloj ndërhyrje nga ana e qeverisë shqiptare në fushën ushtarake".[50] Plani italian fillimisht ishte që të mbante në radhët e saj vetëm 50 % të oficerëve vendas. Por, për të shmangur zemërimin e tyre, u vendos që pjesa më e madhe të mbahej në detyrë. Gjithsesi për italianët situata nuk ishte e pëlqyeshme, pasi shumë prej oficerëve nuk pajtoheshin me gjendjen e krijuar pasi dhe jeta qe shtrenjtuar për shkak të dyfishimit të çmimeve.

Fronti i luftës italo - greke përditë jepte lajme në favor të ushtrisë helene, e cila bënte një luftë të drejtë. Një gjë të tillë e dinin mirë dhe shqiptarët, të cilët nuk mund të bëheshin bashkëpunëtor me italianët në një luftë të padrejtë. Gjatë një takimi me Duçen në Romë, më 7 nëntor, duke argumentuar shkaqet e humbjes, gjeneral Benini bënte përgjegjës batalionet shqiptare që ishin tërhequr nga frika, duke e lënë bosh vijën e zjarrit. Por një tërheqje të tillë ai nuk e konsideronte tradhti. Ndërsa, për forcat italiane jepte garanci që nuk do të tërhiqeshin derisa të vritej dhe ushtari i fundit.[51]Mareshalli Badolio kujtonte optimizmin e madh që ekzistonte të Duçja për fitoren ndaj Greqisë. Kjo shihej dhe te disa gjeneralë. Ata besonin se trupat greke do të dezertonin në masë. Mirëpo kjo nuk ndodhi, sepse shqiptarët, që ishin pjesë e ushtrisë fashiste ndërmorën akte sabotazhi kundër italianëve ose kaluan me grekët. Në rrethana të tilla komanda italiane u detyrua t'i tërhiqte forcat shqiptare dhe t'i çarmatoste. Musolini i shkruante Hitlerit më 20 nëntor 1940 se ndër shkaqet kryesore të mos suksesit rendiste dezertimin thuajse total të forcave shqiptare, të cilët ishin revoltuar kundër njësive italiane.[52] Gjeneral L. Zannini, në një letër që i dërgonte komandës së Korparmatës C, duke bërë fjalë për qëndrimin e batalioneve shqiptare "Dajti" dhe "Gramozi", shkruante se, në periudhën fillestare "qëndrimi i

[49] P. Croaciani, *Shqiptarët në forcat e armatosuraitaliane ...,* f.34 - 35.
[50] *Po aty,*f. 35.
[51] G. Ciano, *Ditari i Kontit Ciano*…, f. 68.
[52] Sherif Delvina, *Mid'hat Frashëri figurë madhore e diplomacisë shqiptare,* Tiranë: Fan Noli, 2002, f.137-138.

tyre ishte i kënaqshëm, ndërsa me intensifikimin e sulmit armik, janë venë re "braktisje kolektive të frontit të luftës".[53]E njëjta situatë vërehej dhe në batalionet e tjera vullnetare shqiptare. Ndaj gjeneral Zannini arrinte në konkluzionin se prezenca e batalioneve shqiptare në "kompanitë divizionale italiane ishte e dëmshme".[54] Prania shqiptare mund të ndikonte negativisht para ushtrisë italiane, të krijonte kriza të rënda apo të sillte ndonjë situatë kompromituese. Në radhët e tyre kishte paqëndrueshmëri, pasi një repart shqiptar, i cili në mëngjes dukej aktiv për luftë kundër trupave greke, në mbrëmje mësohej se kishte kaluar në krahun e armikut me gjithë armatime.[55]

Anglezët me anë të radios BBC dhe burimeve të tjera mediatike, i bënin jehonë dezertimit të forcave shqiptare nga fronti, ndërsa qeveria italiane e fshihte atë në publik, duke deklaruar se shqiptarët kishin besim te Italia dhe po qëndronin përkrah forcave të saj.[56]Dy majorë italianë në informacionet e dërguara në datat 12 - 14 nëntor, raportonin se batalionet shqiptare kishin patur shumë të ikur dhe ankoheshin për mungesa në veshje e çadra. Ndaj jepej porosi të plotësoheshin disa kushte dhe angazhimi i trupave shqiptare në vijën e parë të frontit, të bëhej përherë i shoqëruar nga trupat italiane, të mbikëqyrura prej tyre.[57]

Duçe pohonte se humbja kishte për shkak bllokimin e mjeteve të motorizuara nga balta dhe dezertimet ndaj kishte urdhëruar çarmatosjen e 6 000 shqiptarëve.[58] Një gjë të tillë e pranonte dhe vet marshalli Badiglio, kur shkruante se forcat shqiptare që bënin pjesë në divizionet italiane kishin tradhtuar, madje një pjesë patën kaluar në anën e grekëve.[59]

Shumë shpejt shqiptarët e përfshirë në radhët e ushtrisë italiane kuptuan se qëllimi i fashistëve në sulmin ndaj Greqisë nuk ishte realizimi i aspiratave shqiptare për bashkimin kombëtar, por pushtimi i vendit. Për këtë shkak oficerë dhe ushtarë të batalioneve shqiptare dezertonin çdo ditë nga fronti, duke i krijuar shqetësime të mëdha komandës italiane. Në ditarin historik të regjimentit të 47 të këmbësorisë, të datës 26 nëntor, duke bërë fjalë për batalionin shqiptar "Dajti", thuhej se gjithë efektivi i tij "me pajisje dhe armatim kaloi te

[53]*Po aty,* f. 235.
[54]*Po aty.*
[55]*Po aty*, f. 250.
[56] Gazeta *Tomorri*, Nr. 343, datë 23 shkurt 1941, f. 1. Shqiptarët dhe ne.
[57] P. Croaciani, *Shqiptarët në forcat e armatosura italiane* … f.69.
[58] A. Puto, *Lufta italo-greke…,* f. 78.
[59]*Po aty,* f. 79

armiku".[60]Në ditar theksohej se gjatë gjithë ditës dhe natës vazhdonin goditjet e mortajave "Brixia" dhe mitrolozëve "Breda" mbi trupat italiane. Besohej se ishin shqiptarët që i përdornin ato armë, pasi grekët nuk i njihnin dhe s'mund t'i përdornin dot, sidomos mortajat "Brixia".[61]

Me marrjen e këtij informacioni, komanda qendrore urdhëronte që shqiptarët të tërhiqeshin në prapavijë, pasi do të fillonte riorganizimi i tyre në një batalion tjetër në Shijak. Një numër i madh i të rekrutuarve u burgos. Çështja u bë problem deri në instancat e larta. Vet Musolini në telegramin që i dërgonte Hitlerit në datën 10 nëntor 1940, humbjet e shkaktuara për ushtrinë italiane dhe mos përparimin e saj i shpjegonte me mungesën e mbështetjes shqiptare në fushën politike, mos organizmin e një kryengritje në Çamëri dhe qëndrimin e keq të disa reparteve shqiptare. Sipas Musolinit, detyra mbrojtëse e ushtrisë gjatë dimrit, në radhë të parë duhet të ishte ajo e rimarrjes së asaj pak toke që shqiptarët patën humbur.[62]Edhe Enver Hoxha pohonte të njëjtën gjë. Sipas tij, edhe ata pak shqiptarë që u detyruan të shkonin në radhët e ushtrisë italiane nën forcën e bajonetave, nuk zbrazën asnjë pushkë kundër vëllezërve grekë, por dezertuan nga fronti dhe u kthyen pushkën pushtuesve.[63]

Natyrisht askush nuk mund të bindej në delegimin e përgjegjësisë te shqiptarët, ndonëse ajo ndikonte në këtë humbje. Në letrën drejtuar Hitlerit thuhej se gjithë trupat shqiptare kishin hedhur armët duke kaluar në masë te armiku, prandaj çarmatimi i ushtarëve shqiptarë ishte i domosdoshëm.[64]Hendeku i krijuar mes italianëve dhe shqiptarëve vinte duke u thelluar. Fryma e mosbesimit ndihej kudo. Kishte raste kur nga italianët propozohej zgjidhja e mosmarrëveshjeve me anë të pushkatimit të elementeve të veçantë, por kjo nuk mund të zgjidhte problemin e dezertimeve, kur numëroheshin rreth 3 100 raste.[65]Numri i të dezertuarëve në muajin janar 1941 arrinte shifrën 3 114, nga të cilët 1 872 këmbësorë, 135 karabinierë, 542 artiljerë etj. Të gjithë këta oficerë dhe ushtarë shqiptarë do të dërgoheshin në gjyqin ushtarak territorial të

[60] P. Croaciani, *Shqiptarët në forcat e armatosura italiane* … f.70.
[61]*Po aty*, f.71.
[62] Piero Croaciani, *Shqiptarët në forcat e armatosura italiane ...* f. 77. Cituar sipas Dokumente të Diplomacisë Italiane, seria e Re, 1939-1943, Vol.V
[63] Enver Hoxha, *Kur lindi Partia,* botim i III, f. 97.
[64] Sherif Delvina, *Mid'hat Frashëri figurë madhore e diplomacisë shqiptare,* Tiranë: Fan Noli, 2002, f.137-138. Piero Croaciani, *Shqiptarët në forcat e armatosura italiane* … f.78
[65] Piero Croaciani, *Shqiptarët në forcat e armatosura italiane* … f.80

luftës.[66]Shqiptarët e dezertuar nga forcat italiane shprehën gatishmërinë për të luftuar krahas atyre greke, u pritën me indiferencë dhe u internuan në kampe përqendrimi duke u trajtuar si robër lufte. Në mbarim të luftës nga kampi i Kretës u liruan 842 ushtarë dhe 45 oficerë shqiptarë.[67]

Qëndrimi i politikës greke dhe italiane ndaj Shqipërisë

Me fillimin e sulmit ndaj Greqisë, në trevat jugore të Shqipërisë u vendos ligji i luftës. Komanda italiane evidentoi gjithë personat që ishin me bindje antiitaliane, të cilët i internoi menjëherë. Më 31 tetor 1941, kuestura Gjirokastër informonte këshilltarin e përhershëm të Policisë se ishin evidentuar disa persona që merreshin me politikë dhe kishin alarmuar popullsinë grekofone, duke folur kundër Italisë.[68] Gjeneral Agostinucci, njoftonte Mëkëmbësinë e Përgjithshme rreth veprimeve të Armatës së Përmetit, e cila kishte proceduar njerëz të dyshimtë në çështje politike. Ata ishin: Kristul Joçka, avokat në Përmet; Aleksandër Lipe, prift ortodoks në Kaludh të Petranit; Androkli Angjeli, këpucar; Vasil Teli Shukollari, tregtar në Përmet; Dimtri Kola, pronarë tokash në Biovizhdë; Sotir Ranca, prift në Biovizhdë.[69]

Komandës italiane i raportohej çdo bisedë e dyshimtë. Në Përmet, ditët e para të muajit nëntor ishin gjetur fletushka ku komentohej lufta. Në debat ishin përfshirë kryetari i bashkisë së Përmetit Abas Shukri, gjyqtari Estref Myftiu, drejtori i financës Fuat Frashëri dhe avokati Dhimitër Kacimbra. Ky i fundit ishte një nga përfaqësuesit më me influencë në mbulimin e zyrave publike para fillimit të luftës. Ndërsa, kryetari i bashkisë konfirmonte që Anglia ishte në prag të rrëzimit, Kacimbra i qe përgjigjur se ajo ishte ende e fortë dhe, me kalimin e kohës, do të forcohej më tepër, pasi furnizohej nëpërmjet ajrit nga Amerika, ndërkohë që fabrikat e mjeteve ajrore gjermane po shkatërroheshin çdo dite nga forcat ajrore angleze. Sipas tij, shumë

[66]*Po aty,* f. 85.
[67] Muharrem Dezhgiu, *Shqipëria nën pushtimin italian* 1939-1943, Tiranë: Mësonjtorja, 2005, f. 222.
[68]*AQSH,* F. 153 V. 1940 D. 31/4 f.215. Shkresë e Kuesturës Gjirokastër, Nr. 0671, datë 31.10.1940, dërguar Këshilltarit të Përhershëm të Policisë.
[69]*AQSH,* F. 161, V. 1940, D. 558, f. 7. Shkresë e Gjeneral Divizioni C. Agostinucci, Nr. 834/28, datë 25 tetor 1940, ku njofton Mëkëmbësinë e Përgjithshme (Shërbimin e Informacionit Ushtarak në Shqipëri) mbi kërkesën e Komandës së Regjimentit të 47 të Fanterisë lidhur me procedimin e disa personave nga Armata e Përmetit.

shpejt Gjermania do të detyrohej të kapitullonte.[70] Meqenëse Kacimbra vlerësohej si njeri me bindje anglofile dhe sidomos grekofile, urdhërohej që të internohej menjëherë në Elbasan.[71]

Raportohej dhe prifti ortodoks Aleksandër File dhe avokati Joçka, të cilët ishin regjistruar në listën e personave për t'u arrestuar në rast emergjence. Ata ishin ndaluar dhe dorëzuar tek S.I.M. ndërsa Simon Dilo, person i rëndësisë dytësore, për momentin mendohej të mos procedohej.[72] Kiço Baleshi nga Këlcyra ishte internuar në Brindisi. Pas 3 muajsh ai kthehet sërish në vendlindje, por me kusht që të paraqitej rregullisht në zyrën e policisë.[73] Ai qe larguar në drejtim të Burrelit për të punuar në zanatin e tij dhe të mbante familjen me ushqim. Kjo e alarmoi komandën, e cila porosiste kuesturën e Durrësit, që ai të kontaktohej dhe të detyrohej të vinte në dijeni policinë për çdo lëvizje.[74] Numri i të internuarve bëhej me shkak dhe pa shkak. Ministria e Punëve të Jashtme, më 3 maj 1941, pohonte se i kishte kërkuar Ministrisë së Brendshme riatdhesimin e Tahir Cankos nga Seniçani, i cili qe internuar në Picinisco (Frosinone), meqenëse emri i tij ishte ndër të propozuarit për falje.[75]

Të dy palët bënin arrestime, pasi dyshonin se ishin venë në shërbim të kundërshtarit. Për pasojë, lista e nëpunësve të arsimit të arrestuar dhe të arratisur në Greqi, me motivacionin: "s'kanë mbajtur sjellje të mirë gjatë okupacionit italian", ishte relativisht e gjatë. Ishte arrestuar Goli Dango, mësues në Kaludh të Përmetit, me argumentin, që ishte sjell keq. Peço Stefani, mësues në Limar të Malëshovës ishte raportuar prej

[70] *AQSH*.F. 161.v. 1940.D.670 .fl. 1. Comando Superiore Carabinieri Reali dell'Albania. Ufficio Servizio, Nr. 2473/5, Tirana 4 novembre 1940. Propaganda a favore della Grecia. Alla R. Luogotenenza Generale- Uff. Aff. Civili, Tirana; Al Servizio Informazioni Militare, Ufficio Albania, P.M.22 A. Rir. Folio Nr. 2134/Int, del 16.10.1940.

[71] *AQSH.* F. 161, V. 1940, D. 670, f. 1. Shkresë e Komandës Eprore të Karabinierisë Mbretërore të Shqipërisë, Nr. 2473/5, datë 4 nëntor 1940, firmosur nga kolonel G. Riccioni.

[72] *Po aty*.

[73] *AQSH*.F. 153 .v. 1941.D.135/1.fl. 291. Kuestura Gjirokastër më 25 qershor 1941, bënte me dije Komandën Stacionare CC.RR. të Këlcyrës, komandën e kompanisë në Përmet, si dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë Tiranë.

[74] *Po aty*, f. 294

[75] *AQSH*.F. 153.v. 1941.D.135/1.fl. 342. Komanda e Lartë e Karabinierisë Mbretërore, Zyra për çështje speciale të rezervuara, Nr. 2277/1, datë 3.5.1941-XIX, dërguar Ministrisë së Brendshme; Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë; Komandës së Grupit CC.RR. Gjirokastër.

kryetarit të Komunës Zagori, me pretendimin se kishte qenë spiun i autoriteteve greke.[76]

Nën arrest ishin vënë edhe Monika Pantazi nga Delvina; Marika Vaso, Nivicë; Gjergji Jani, Delvinë; Koço Mosko, Libohovë; Grigor Muço e Misto Vrana, Piqeras; Spiro Mëhilli, Salari e Tepelenës, të cilët akuzoheshin se kishin qenë në shërbim të politikës greke.[77] Por nuk qëndronin pas dhe forcat ushtarake të Athinës. Sipas ministrit të Arsimit, komanda greke kishte arrestuar dhe internuar 6 mësues, "për të cilët, deri tash s'dihet asgjë". Ata ishin: Hamid Rami, nga Tatzati, mësues në Kalasë të Delvinës; Sami Seferi nga Malëshova e Këlcyrës, mësues në Leskaj; Pandeli Neçka dhe Filip Tole nga Labova e Poshtme e Tepelenës; Foto Meksi nga Labova e Madhe dhe Andrea Andriku, mësues i gjuhës shqipe në Dhrovjan.[78]

Ndërkohë kishte filluar ndjekja dhe internimi i shumë familjeve që gjykoheshin me bindje antiitaliane dhe sidomos familjet e oficerëve dhe nënoficerëve që dezertuan nga fronti. Prefektura e Gjirokastrës, në bazë të propozimit të bërë nga nënprefektura Përmet, vinte në dijeni M.P.B. për internimin e disa personave që kishin mbajtur qëndrim antiitalian.

Për secilin prej tyre paraqiteshin dhe argumentet përkatëse.[79] Nisur nga rëndësia që kishte shmangia e personave, që nuk pajtoheshin me politikën italiane dhe rrezikun që paraqiste propaganda e tyre, prefektura kërkonte lejen e Ministrisë për të vepruar, por dhe vendin se ku duhej të dërgoheshin personat që nevojitej të internoheshin.[80] Më 21 tetor 1940, MPB i dërgonte Komandës Eprore të KK MM, listën me emrat e personave që duhej të internoheshin, shoqëruar me motivacionin "propagandist kundër regjimit të sotëm". Ata ishin: Kristul Joçka,

[76] *AQSH*. F. 195. V. 1941. D. 84, f. 4. Shkresë e ministrit të Arsimit, Nr. 12 27 dt. 19. 5. 1941, dërguar Kryeministrisë.

[77] *AQSH*. F. 195. V. 1941. D. 84, f. 4. Shkresë e ministrit të Arsimit, Nr. 12 27 dt. 19. 5. 1941, dërguar Kryeministrisë.

* Sami H. Seferi, lindur më 1901 në Leskaj. Kishte kryer shkollën fillore në turqisht dhe më pas italisht. Kishte kryer kursin në Labovë të Gjirokastrës. Filloi si mësues më 1918 në shkollat Limar e Malëshovë. AQSH. F. 803. D. I-212, f. 63

[78] *AQSH*. F. 195. V. 1941. D. 84, f. 2. Kjo letër i mbrriti kryeministrit më 19 prill të vitit 1941, ditën e hënë, në orën 10. [00] të mëngjesit. Ai thirri menjëherë një prej inspektorëve të tij dhe ishte këshilluar me të, por nuk u mor asnjë masë.

[79] *AQSH,* F. 152/2, V. 1940, D. 95, f. 362. Shkresë e prefekturës Gjirokastër, Nr. 370, dt. 10.10.1940, firmosur nga prefekti Daut Çarçani, drejtuar MPB, mbi internimin e disa personave propozuar nga nënprefektura Përmet me shkresën Nr. 119, dt. 8.10.1940

[80] *AQSH*, F. 152/2,V. 1940, D. 95, f. 362.

Dhimitër Kacimbra, At Aleksandër Lipe, Simo Dilo, banues që të gjithë në Përmet.[81] Mirëpo, prefektura Gjirokastër, me anë të një tjetër shkrese jepte mendimin se nuk kishin bindje të plotë, që Dhimitër Kacimbra dhe Simo Dilo të merreshin me propaganda të tilla.[82]Komanda Superiore e Karabinierisë, më 4 nëntor 1941 bënte me dije se komanda e Ballabanit, kishte arrestuar barinjtë Baftjar Çapokaj, i Myftarit 15 vjeç, Hydai Toçiaj i Hashimit 15 vjeç, Nevruz Lazaj i Adilit 15 vjeç, Haxhi Çapokaj i Muharremit 37 vjeç, të cilët cilësoheshin përgjegjës për mbajtje abuzive të armëve e municioneve që konsideroheshin plaçkë lufte.[83]

Por edhe qeveria greke kishte marrë të gjitha masat për t'u informuar hollësisht mbi zhvillimet në Shqipëri dhe për më tepër, në krijimin e një fryme antiitaliane në Jug të saj. Prefektura e Gjirokastrës, në muajin shkurt 1940, njoftonte M. P. Brendshme se, ishte konstatuar që konsulli grek zhvillonte propagandë të gjerë në disfavor të shtetit shqiptar dhe bënte ndërhyrje të vazhdueshme në çështje që ishin jashtë kompetencave të tij. Ai mbante lidhje me popullsinë grekofone të asaj province me anë të sekretarit të vet. Duke aktivizuar gjithë grekomanët dhe financuar shuma të mëdha, kishte mundur të ushtronte ndikim të madh në gjithë trevën. Sipas prefekturës, mund të thuhej pa ekzagjerim se çdo çështje e atyre katundeve dirigjohej prej vet konsullit, i cili pati mbledhur dhe pleqësinë e atyre katundeve dhe i këshillonte që t'i drejtoheshin telegrafisht Mëkëmbësit të Përgjithshëm për çështjen e shkollave të minoritetit.[84] Ndërhyrja e tij favorizohej prej personave që ende jetonin me iluzionin e grekomanisë. Prefektura kërkonte të dinte se çfarë masash duheshin marrë kundër disa krerëve të parisë, që guxonin të shoqëronin konsullin nëpër fshatra për të bërë propagandë antishqiptare.[85]

Zyra Politike e M. P. Brendshme, në muajin shkurt 1940, i dërgonte Mëkëmbësisë së Përgjithshme një kopje të raportit Nr. 43, të prefekturës

[81]*Po aty,* f. 363. Shkresë e M.P.B. Nr. 2602, datë. 21.10.1940, me firmën e ministrit, drejtuar Komandës Eprore të KK MM, shoqëruar me shkresën Nr. 119, datë 8.10.1940, XVIII, të nënprefekturës Përmet, përcjellë nga prefektura Gjirokastër.
[82]*Po aty,*f. 363.
[83]*AQSH*, F. 153, V. 1941, D. 33/1, f. 197. Shkresë e Komandës Superiore të Karabinierisë, Zyra e Shërbimit dhe Gjendjes, Nr. 1/316, datë 12.11.1941, dërguar Ministrisë së Brendshme.
[84]*AQSH*, F. 152, V. 1940, D. 201, f. 2. Shkresë e prefekturës Gjirokastër, Nr. 43 datë. 8.2.1940, dërguar M.P.Brendshme, Zyrës Politike dhe të Personelit, mbi propagandën antishqiptare të konsullit grek.
[85]*Po aty*, f. 3. Shkresa mban firmën e Prefektit Daut Çarçani.

së Gjirokastrës, që bënte fjalë për aktivitetin propagandistik që zhvillohej prej konsullit grek. Ata luteshin t'u dërgohej sa më parë udhëzimi për mënyrën e veprimit.[86] Pas kësaj do të arrestoheshin disa persona që ushtronin propagandë antishqiptare, por kjo do të haste në reagimin e konsullit të Athinës. Ai u ankua në prefekturë për arrestimin e pesë personave që kishin qenë në konsullatë. Madje donte të dinte, nëse ishte vënë nën vëzhgim edhe ai, gjë e cila tregonte zemërimin e tij. Ajo vihej re në çdo rast kur i zbuloheshin agjentët dhe informatorët".[87]

Greqia ndiqte një politikë paqeje me Italinë, pa thënë asnjë fjalë për pushtimin e Shqipërisë. Madje, të nesërmen e 10 qershorit 1940, kur Italia u shpalli luftë aleatëve, kryeministri grek Metaksa i deklaroi ministrit italian në Athinë se ajo luftë do të mundësonte bashkëpunimin më intim midis Italisë dhe Greqisë. Por tre muaj më vonë, Metaksa do të akuzohej për strehimin e anijeve angleze në portet e saj dhe marrëdhëniet italo - greke u acaruan, ndonëse veprimtaria antishqiptare vazhdonte.[88] Diversionin propagandistik të politikës greke ndaj Shqipërisë e mbështeste edhe Anglia. Më 18 shtator 1940, P. Dikson shkruante se Foreing Office e aprovonte mendimin, që të përparonte puna me planet subversive greke në Shqipëri. Por, në të njëjtën kohë, Foreing Office paralajmëronte që të bëhej kujdes në hapat që hidheshin. Nuk duhej t'u jepej shkas italianëve që të pretendonin se ishin grekët ata që po kryenin veprimtari kundër Shqipërisë, pasi në këtë mënyrë do të gjenin pretekst për të sulmuar Greqinë.[89]

Foreing Office bënte fjalë për lidhjet që kjo zyrë kishte me individ shqiptarë, njerëz me influencë dhe të dobishëm, që ishin venë në shërbim të tyre. Dikson theksonte se, duke qëndruar gjithmonë në prapaskenë, "ne i kemi furnizuar këta njerëz me të holla dhe kemi mundur të kemi një influencë të konsiderueshme mbi udhëheqësit e tyre".[90]

---

[86] *AQSH*, F. 152, V. 1940, D. 201, f. 1. Shkresë e Zyrës Politike të M.P.Brendshme, Nr. 476, datë 16.2.1940, dërguar Mëkëmbësisë së Përgjithshme të Madhërisë së tij, Mbretit Imperator në Shqipëri.

[87] *AQSH,* F. 152, V. 1940, D. 201, f. 5 Shkresë e prefektit të Gjirokastrës Daut Çarçani, Nr. 43/1, datë 19 shkurt 1940, dërguar M.P. Brendshme.

[88] B. Meta, *Tensioni greko-shqiptar* 1939 - 1949, Tiranë: GEER, 2002, f. 49.

[89] *AIH*. A-V-122. Marrëdhëniet greko - shqiptare dhe qëndrimi i Greqisë karshi Shqipërisë, f. 3. Publikim i vitit 1940, material i përkthyer nga Shpëtim Mema.

[90] *AIH.* A-V-122. Marrëdhëniet greko-shqiptare dhe qëndrimi i Greqisë karshi Shqipërisë. Viti 1940 Material i përkthyer nga Shpëtim Mema f. 9.

Ndonëse shqiptarët e dënuan agresionin italian kundër Greqisë, autoritetet greke nuk shfaqën as më të voglin vlerësim. Me të stabilizuar frontin, komanda helene ndaloi ngritjen e flamurit shqiptar dhe fshinë gjuhën shqipe nga administrata".[91] Nisur nga mënyra e sjelljes së tyre u kuptua se të dy palët kishin qëllim pushtimi dhe jo çlirimi. Ushtarakët shqiptarë pranuan të luftonin krahas trupave greke, me kusht që kompanitë dhe batalionet të mbanin flamurin shqiptar, gjë e cila u kundërshtua nga forcat greke.[92]Fillimisht, mobilizimin e trupave shqiptare nën komandën e oficerëve shqiptarë, e pranoi dhe Metaksa. Por, më 29 nëntor 1940, shefi i shtabit të përgjithshëm të ushtrisë, gjenerali Papagos, e hodhi poshtë një kërkesë të tillë, me argumentin se shqiptarët mund të ktheheshin kundër ushtrisë greke.[93]

Grekët kundërshtuan dhe organizimin e një revolte të armatosur antiitaliane në prefekturën e Gjirokastrës, e cila kishte si kusht të vetëm njohjen e pavarësisë së Shqipërisë. Ahmet Zogu u premtoi ë sillte në frontin antiitalian rreth 30 mijë forca, në sajë të mbështetjes së madhe që kishte në veri të vendit. Duke u rënë italianëve pas vijës së frontit, mendonte se mund t'i detyronte ata që ta lëshonin vijën mbrojtëse. Një propozim i tillë u pëlqeu dhe anglezëve, por as ky nuk u pranua nga politika greke.[94]

Madje, Endrju Rajën, një oficer ndërlidhës midis mbretit shqiptar dhe Foreign Office, e shihte konstruktiv propozimin e Zogut. Prandaj, Foreign Office udhëzonte këshilltarin britanik në Athinë, Majkëll Pelëre t'i kërkonte qeverisë greke të binte dakord me ofertën e mbretit shqiptar, duke theksuar se Athina nuk kishte asnjë detyrim të merrej me ardhjen e tij në fron, pas ribërjes edhe një herë të Shqipërisë së pavarur. Por përsëri Athina nuk pranoi. Për pasojë edhe ata shqiptarë që ishin rreshtuar me trupat greke kundër koalicionit fashist, u dërguan në thellësi të Greqisë dhe fati i tyre ishte venë në dyshim.

Në gjithë jugun e vendit, trupat greke do të silleshin me ashpërsi ndaj shqiptarëve. Duke qenë në rolin e pushtuesve edhe nënshkrimi i marrëveshjeve me ta qe i pamundur. Shqiptarët ndodheshin midis dy zjarresh. Të dy palët kërkonin aneksimin e trojeve të tyre. Nga njëra anë propaganda e huaj e rendiste Shqipërinë si pjesëmarrëse në luftën kundër Greqisë. Komanda italiane vazhdonte të bënte përpjekje për

[91]*Përmeti gjatë Luftës Nacional Çlirimtare (*1939-1944), Tiranë 1970 f. 96.
[92]*Historia e Popullit Shqiptar* Vëll IV, Tiranë 2008, f. 43-45.
[93] B. Meta, *Tensionin greko - shqiptar…*, f. 54
[94]*Po aty*, f. 58-59.

tërheqjen e shqiptarëve në luftë kundër grekëve, duke u kujtuar atyre ngjarjet e vitit 1914. Nga ana tjetër, politika greke kishte rivendosur lidhjet me njerëzit e saj në Shqipëri dhe synonte marrjen e "Vorio - Epirit". Grekomanët në jug të vendit ishin riaktivizuar. Dukej qartë se Athina nuk kishte në mend të hiqte dorë nga zonat e pushtuara, madje çështjen e "Vorio - Epirit" e kishte dërguar në rangjet më të larta të diplomacisë evropiane.[95]

Në këtë kuadër, qeveria greke me vendimin Nr. 2636 / 40 të muajit nëntor 1940, si dhe me dekretin e Mbretërisë së Greqisë, nënshkruar më datë 10 dhjetor 1940, e cilësonin Shqipërinë një vend armik, me të cilin Greqia ishte në luftë. Ky vendim vinte si kundërpërgjigje e "dekretit mbretëror shqiptar", Nr. 194, datë 9 qershor 1940-XVI-II, në nenin Nr. 1 të të cilit thuhej: "Mbretëria e Shqipënisë njifet e hymne në luftë me ato shtete me të cilat mbretnija e Italisë ka me qënë në luftë". Në fakt, ky dekret ishte i Viktor Emanuelit III, i cili qe shpallur mbret i Italisë dhe Shqipërisë. Kjo u realizua me anë të mëkëmbësit të mbretit italian në Tiranë, Francesco Jakomoni, i cili e detyroi qeverinë Vërlaci të miratonte këtë ligj më 9 qershor 1940.[96]

Hyrja e ushtrisë greke u prit me ankth nga popullsia e jugut të vendit. Paria e Korçës nuk mund të pajtohej me pretendimet greke se atybanonin mbi 44 mijë grekë. Qytetarët korçarë i kishin pohuar korrespodentit britanik për Ballkanin, Patrick Maithland, se ishin shqiptarë ortodoks dhe se ushqenin ndjenja të pastra kombëtare shqiptare.[97] Ndërsa në Korçë, patriotët e ndjenë rrezikun dhe gradualisht u mbyllën në vetvete, duke komunikuar vetëm me njëri-tjetrin.[98] Përkundrazi elementi grekomanë u ndie i përfshirë në strukturat greke dhe u përkëdhel me shpresën se këtë radhë Greqia nuk do të largohej më nga trojet që kishte pushtuar. Në Gjirokastër, peshkopi Pandelejmoni

[95] Arben Puto, *Lufta italo - greke…,* f. 98 - 100.

[96] Nuri Dragoj, *Eshtra që akuzojnë, zhvarrimet në Përmet turp i politikës*, Tiranë: 2006, f. 28.

[97] Muharrem Dezhgiu, *Shqipëria nën pushtimin italian* 1939-1943, Tiranë: Mësonjtorja, 2005, f. 220, f. 220

[98] Sonila Boçi, *Minoritetet në Shqipëri, midis identitetit dhe integritetit* 1939-1949, Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, 2012, f. 90.

*Pandelejmoni Kotoko ishte me origjinë nga Korça por me ndjenja të dukshme grekomane, i cili u bashkua me kishën greke për të realizuar pretendimet e shtetit helen për marrjen e Shqipërisë së jugut.

Kotoko*, organizoi një miting dhe u përpoq t'u krijonte mjedis festiv ardhjes së ushtrisë greke.[99]

Ushtria greke me të hyrë në tokat shqiptare vendosi ligjin e luftës dhe deklaroi se tokat e pushtuara ishin greke dhe se kush kundërshtonte një vendim të tillë do të dënohej. Ata dogjën flamujt shqiptarë dhe italianë, veprime të cilat u përkrahën nga grekomanë, si Nasho Vllahu e Niko Qerici.[100] Trupat greke dogjën thuajse të gjitha teqetë në Korçë, Ersekë, Leskovik, Përmet e Gjirokastër, duke mos kursyer as dhjetëra kisha nga Korça në Voskopojë e deri në Gjirokastër, të revoltuar nga qëndrimi patriotik i shqiptarëve myslimanë dhe atyre ortodoksë.[101]

Me marrjen e Korçës, Metaksa deklaroi se grekët luftonin edhe për "çlirimin e Shqipërisë". Dhe nëse trupat greke mund të pushtonin Korçën dhe Gjirokastrën, këtë nuk e bënin për pavarësinë e Shqipërisë. Madje Foreign Office pranonte që grekët kishin të drejtë të merrnin aq territor shqiptar, sa do të mund të pushtonin në luftën italo - greke. Në një dokument të Foreing Office bëhej fjalë për deklaratën e Metaksasë lidhur me pavarësinë e Shqipërisë. Kërkohej një përsëritje e saj, në mënyrë që të ndikonte pozitivisht në veprimtarinë e politikës greke me njerëzit e rekrutuar në Shqipëri. Metaksa theksonte se, Greqia luftonte jo vetëm për ekzistencën e saj, por edhe për popuj të tjerë të Ballkanit, sidomos për çlirimin e Shqipërisë, por jo për pavarësi të saj.[102] Përfaqësuesi i Foreing Office, nënvizonte se, fjala "çlirim" në gjuhën greke ishte një fjalë krejtësisht e ndryshme nga fjala "pavarësi". Metaksa ka dashur të thotë që Greqia luftonte për çlirimin e Shqipërisë nga sundimi italian dhe në asnjë mënyrë nuk do të implikohej në çështjen për restaurimin e një Shqipërie të pavarur.[103]

Me të marrë nën zotërim trevat jugore, komanda greke vendosi ligjin e luftës në Përmet, Korçë, Kolonjë dhe Gjirokastër, ku pati disa arrestime në radhët e patriotëve, të cilët u internuan në ishujt e largët të

[99] S. Boçi, *Minoritetet në Shqipëri, midis identitetit dhe integritetit* 1939-1949, Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, 2012, f. 91

[100] M. Dezhgiu, *Shqipëria nën pushtimin italian* 1939-1943, Tiranë: Mësonjtorja, 2005, f. 220. Promemorie e toger K. Libohovës për zyrën e I të Korparmatës XI, 15 maj 1941.

[101] Po aty, f. 221.

[102] *AIH.* A-V-122. Marrëdhëniet greko - shqiptare dhe qëndrimi i Greqisë karshi Shqipërisë. Viti 1940 Materiali i përkthyer nga Shpëtim Mema f. 20.

[103] *AIH*. A-V-122. Marrëdhëniet greko-shqiptare dhe qëndrimi i Greqisë karshi Shqipërisë, viti 1940. Deklaratë e Foreing Office S.Ë.E, datë 29 nëntor 1940. Material i përkthyer nga Shpëtim Mema f. 20.

Greqisë.[104]Qeveria e Athinës mori masa të shpejta për administrimin e pushtetit vendor nga ana e ushtarakëve të saj. Pas marrjes së Korçës, në krye të Bashkisë do të vendosej një person i afërt për politikën greke dhe do të krijohej këshilli bashkiak me 11 grekomanë dhe 4 shqiptarë. Më 8 dhjetor trupat helene hynë në Gjirokastër dhe Përmet, bashkitë e të cilave do të merreshin nën drejtimin e njerëzve që ishin në shërbim të Athinës.[105]

Qeveria greke mori të gjitha masat për administrimin e trevave jugore, e bindur se ato do t'i jepeshin Greqisë prej Fuqive të Mëdha. Metaksa përfitoi nga kërkesa gjermane për largimin e anglezëve nga Greqia dhe të pushimit të luftës me Italinë, duke u kërkuar atyre më 20 dhjetor 1940, që t'i lejonin të mbanin të pushtuar jugun e Shqipërisë, deri në Vlorë, të cilën nuk kishin mundur ta merrnin ende.[106]

Komanda greke dha urdhër të arrestoheshin gjithë elementi patriot shqiptarë, myslimanë dhe ortodoksë. Në janar të vitit 1941, në Korçë u arrestuan 21 vetë për shkak të ndjenjave të tyre atdhetare.[107] Në prefekturën e Korçës dhe atë të Gjirokastrës, pushtuesit gjetën terren të përshtatshëm për të zhvilluar veprimtari përçarëse, jo vetëm midis myslimanëve dhe të krishterëve, por edhe midis ortodoksëve minoritarë grekë dhe atyre shqiptarë. Për shkak të vrasjes dhe terrorit të ushtruar mbi shqiptarët patriotë, pati dhe reagime. Në Delvinë ishte formuar një organizatë me emrin "Dora e zezë", e cila vepronte si kundërpeshë e dhunës greke. Në pranverën e vitit 1942 ajo kreu disa atentate, midis të cilëve u vranë dhe dy nacionalistë minoritarë grekë, Thoma Laze dhe Miho Qirici.[108]

Natyrisht, politika greke për aneksimin e Shqipërisë kishte mbështetjen e britanikëve. Kjo u duk qartë para se Italia të hynte në luftë me Greqinë. Diplomatë anglezë shpreheshin të lëkundur në qëndrim e tyre lidhur me pavarësinë e Shqipërisë, madje ata nuk ndihmonin as nacionalistët shqiptarë që ishin shprehur qartë kundër pushtimit italian. Gjithçka lidhej me ndikimin grek në politikën britanike, e cila shpresonte që në ato kohë trazirash ndërkombëtare të përfitonte ato territore që nuk mundi t'i merrte më 1913, në dëm të Shqipërisë. Shefi i departamentit të Foreing Office për Jugun, P.

[104]*Përmeti gjatë Luftës Nacional Çlirimtare*…, f. 97.
[105] A. Puto, *Lufta italo-greke*…, f. 95-97.
[106] B. Meta, *Tensionin greko-shqiptar…,* f. 52-53.
[107] S. Boçi, *Minoritetet në Shqipëri…*, f. 93.
[108] Faik Quku, *Qëndresa shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore* 1939-1944, Vëll. II, Tiranë: Liar, 2006, f. 70-71.

Nichols, pohonte se nuk ishte për të mbështetur nacionalistët shqiptar kundër italianëve. Sipas tij, ishte e mundur që dhe në të ardhmen të mos bëhej asnjëherë një gjë e tillë.[109]

Shpërngulje e popullsisë drejt zonave që ishin jashtë luftimit

Në nëntor të vitit 1940, kur tërheqja e italianëve ishte e dukshme dhe flitej se po hynin forcat greke, u shtua edhe më shumë frika e përsëritjes së masakrave të vitit 1914. Për këtë shkak, shumë familje braktisën shtëpitë dhe u zhvendosën në rrethe të tjera, në drejtim të Shqipërisë së Mesme. Më 6 dhjetor 1940, një divizion i ushtrisë greke kishte marrë Kolonjën e Leskovikun dhe një tjetër zbriti nga mali i Dhëmbelit dhe pushtoi Përmetin."[110] Brenda pak ditësh trupat helene mbërritën në Këlcyrë, dolën në Dangëlli dhe hynë në Dëshnicë. Italianët kishin kapur Qafën e Kiçokut dhe Trebeshinën, ku patën ardhur përforcime të reja të divizionit "Lupi di Toskana" dhe "Centauro". Gjithë treva e Përmetit ishte kthyer në prapavijë greke.[111]

Luftimet midis palëve vazhduan rreth 4 muaj. Krahina e Dëshnicës dhe lugina e Vjosës pësuan dëme të mëdha për shkak të bombardimeve, ku pati njerëz të vrarë dhe shtëpi të shembura. Shumë familje kërkuan ndihmën e të afërmeve të tyre në rrethe të tjera, që ndodheshin jashtë frontit të luftës. Të tjera u futën nëpër kampe dhe prisnin ndihmën e shtetit, por ai nuk ekzistonte. Nënprefektura e Përmetit, me pushtimin e qytetit nga grekët, i kishte zhvendosur zyrat në Fier.[112]

Pas kësaj tabloje, shihet qartë se luftimet më të ashpra janë kryer në zonën e Përmetit. Aviacioni i të dy ushtrive bombardonte pa pushim tokën shqiptare. Bombat i drejtoheshin vijës së frontit, por ato nuk kursenin tufat e bagëtive, kasollet e tyre, arat e mbjella dhe pemët drufrutore, ndonëse më rrallë edhe shtëpitë e banimit. Fshatarët të tmerruar nga bombardimet dhe humbja e shtëpisë dhe pasurisë, merrnin rrugët. Iknin drejt rretheve që nuk ishin përfshirë në luftë. Komandat e të dy ushtrive ndërluftuese i këshillonin të zbraznin vendin. Shumë shtëpi ziheshin nga oficerë italian apo grekë. Një pjesë ktheheshin në spitale. Pati dhe nga ata që u larguan nga frika e masakrave, duke kujtuar ato që kishin ndodhur në vitin 1914. Ikjet filluan që në muajin

[109] B. Meta, *Tensionin greko-shqiptar…*, f. 61.
[110] *Përmeti gjatë Luftës Nacional Çlirimtare* (1939-1944), Tiranë 1970 f. 96.
[111] *Po aty,* f. 96.
[112] *Po aty*.

dhjetor, por në janar e shkurt ato ishin masive. Në Berat dhe fshatra të tij u strehua një numër i madh refugjatësh. Të tjerë do të shkonin në Mallakastër, Fier, Vlorë e gjetkë.[113]

Kur fronti i luftës hyri në Dëshnicë, komanda greke këshillonte, që fshatrat e asaj krahine të shpërnguleshin në drejtim të Përmetit e Malit të Bardhë. Duke qënë popullsi myslimane, në kujtesë të së cilës ruheshin ende të freskëta masakrat e vitit 1914, shumë familje u larguan vet. Kush kishte mundësi financiare e gjeti individualisht mënyrën për t'u strehuar, të tjerë kërkuan ndihmën e njerëzve të njohur. Por edhe komanda greke ishte e interesuar të largoheshin sa më shumë banorë të besimit mysliman, pasi trembeshin mos ata luanin rolin e spiunit në favor të italianëve.

Bagëtitë thereshin për ushqim, pasi kishte periudha kur vononin furnizimet. Nuk kurseheshin as qetë e punës. Ata që qëndruan në shtëpitë e tyre dhe mundën t'u mbijetonin predhave dhe plumbave, ruajtën një pjesë të pasurisë. Të tjerët e humbën atë pak pasuri që kishin. Luigi Gianturco, duke përshkruar luftimet e 20 janarit 1941, në fshatin Bubës, tregon se goditjet me mortaja i kishin tmerruar barinjtë, të cilët iknin dhe i linin tufat e deleve vetëm. Të gjitha ato u therën dhe u konsumuan nga ushtria, e cila kishte patur probleme në furnizimin me ushqime nga prapavija.[114] Banorët që braktisën fshatin, kur u kthyen nuk gjetën asgjë në shtëpi. Zairet e dimrit ishin konsumuar nga ushtria. Bagëtitë ishin therur në intervalet kohore kur ushtrisë i vonohej furnizimi. Gjithë shtresat ishin grabitur ose djegur dhe pemët frutore ishin prerë për dru zjarri për shkak të dimrit të madh.[115]

Në korrik doli një dekret mbretëror, sipas të cilit, refugjatëve që kishin lënë banimet e tyre për shkak të urdhrave të autoriteteve ushtarake dhe nuk mund të mbanin veten dhe familjen sepse ishin të papunë, u akordohej ndihmë nga shteti. Familjet e kategorisë së parë me 1 pjesëtar përfitonin 3 franga shqiptare, me 2 persona 4 franga dhe për çdo person më tepër shtohej një frang. Familjet e kategorisë së dytë me një pjesëtar merrnin 2 franga dhe kështu me radhë, duke patur një frang më pak se kategoria e parë. Kur numri kalonte 8 - 10 persona, jepeshin

[113] A. Sulo, *Dy net që ngrinë Romën*…, f. 95-98.
[114] L. E. Gianturco, *Pietro del muro*…, f. 72-75.
[115] A. Sulo, *Dy net që ngrinë Romën*…, f. 95-98.

10 franga. Por dekreti këshillonte të shihej mundësia edhe për ndihma të tjera.[116]

Numri i saktë i refugjatëve nuk dihej. Në janar të vitit 1942, pranë Këshillit të Ministrave ishte krijuar një komision, i cili u quajt Komiteti Qendror për Refugjatët.[117] Komunat duhej të dërgonin pranë tij informacione të hollësishme për refugjatët, të cilat kalonin nëpërmjet prefekturës. Për çdo të shpërngulur lëshohej një certifikatë, në të cilën nuk vihej numër, por bëhej shënimi "extra". Kryesisht të ikurit ishin përqendruar në prefekturat Tiranë, Berat, Vlorë, Elbasan, Durrës, Shkodër, e cila shihet edhe në korrespodencën që Komiteti Qëndror i Refugjatëve kishte me ato prefektura. Në çertifikatat e lëshuara nga prefektura e Beratit mësohet se refugjatët vinin nga fshatrat e Përmetit, Leskovikut, Këlcyrës dhe Kolonjës.[118]

Dokumentet që lëshoheshin nga pushteti vendor ishin të thjeshta. Në to shkruhej emri i kryefamiljarit, numri i frymëve dhe vendi prej nga vinte. Në raste të tjera shënohej vetëm emri dhe fshati. Për shembull: Qazim Rrapo me 10 frymë nga fshati Xhanaj i Këlcyrës; Seit Kostreci nga fshati Kostrec; Nebi Muhametaj nga fshati Pavar etj.[119]Natyrisht, numri i çertifikatave të lëshuara në raport me refugjatët ishte i vogël, pasi pjesa më e madhe e tyre nuk kishin informacion dhe nuk u paraqitën në zyrat e shtetit.

Dëmet nga lufta dhe riparimi i shtëpive të dëmtuara

Dëmet e shkaktuara nga lufta italo - greke në trevat jugore qenë të mëdha. Popullsia e pafajshme përballoi bombardimet e aviacionit dhe goditjet e artilerisë së dy ushtrive ndërluftuese. Gjatë asaj periudhe u vranë 127 njerëz të pafajshëm dhe u shkaktuan dëme të mëdha materiale, si djegie të shtëpive, shkatërrime të rrugëve, dëmtim të të mbjellave për më shumë se 1 400 familje.[120] Fshatarësia u detyrua të

[116]*Fletore Zyrtare*, Nr. 98, datë 5 korrik 1941, f. 3. Dekret i Mëkëmbësit Mbretëror Nr. 218, datë 1 shkurt 1941. Caktimi i ndihmës për refugjatët.
[117]*Fletore Zyrtare*, Nr. 11, datë 3 shkurt 1942, f. 1-2. Dekret i Mëkëmbësit Nr. 2, datë 22 janar 1942. Formimi i Komisionit Qendror për vërtetimin e pagimin e dëmeve të luftës.
[118] A. Sulo, *Dy net që ngrinë Romën*…, f. 100-101. Çertifikata të lëshura nga prefekrura e Beratit për refugjatët.
[119]*Po aty*.
[120]*AQSH,* F. 193, V. 1942-1943, D. 179, f. 213- 412. Komiteti Qendror për dëmet e shkaktuara nga lufta italo-greke. Të dhëna për nënprefekturën e Përmetit. AQSH F.

braktiste banesat dhe të merrte rrugët, duke i rezistuar jetesës nën qiell të hapur, pa asnjë mbështetje ekonomike. Shumë prej tyre gjetën strehë në shpellat e Nemërçkës, Dhëmbelit dhe Trebeshinës. Pas betejës trupat greke bënë disa arrestime në njerëz të pafajshëm me akuza absurde si agjentë të italianëve, apo sepse shprehnin ndjenja patriotike shqiptare.[121]

Ministria e Punëve të Brendshme i kërkonte mendim kryeministrisë si të vepronte me kërkesat për dëmshpërblim, për dëmet e shkaktuara nga operacionet ushtarake apo trupat civile, pasi shuma financiare ishte e madhe. Nëse ata duhej të shpërbleheshin, shihej e nevojshme të planifikohej një shumë e caktuar nga buxheti. Në të kundërt, duhej të refuzoheshin, duke u vënë si shkak mungesën e fondeve. Gjithsesi ministria mendonte që të bëhej likuidimi i pjesshëm i tyre.[122]

Kabineti i Musolinit, për të krijuar përshtypjen se kujdesej për popullin, i dha porosi qeverisë shqiptare në varësi të saj, për të pranuar dëmet e shkaktuara nga lufta, e cila në shkresa cilësohej "dëme nga ushtria armike". Zyrat përkatëse, për dëmtimet e shkaktuara në banesa dhe prona gjatë luftës, bënin përgjegjëse vetëm ushtrinë greke dhe aviacionin e saj. Ligji parashikonte dhënien e shpërblimeve për dëmet e shkaktuara nga lufta në toka, sende të luajtshme dhe të paluajtshme.[123] Çdo person që pretendonte se ishte dëmtuar nga lufta duhej të paraqiste një kërkesë, në të cilën shkruhej adresa e saktë, lloji i dëmit dhe vlera financiare. Mund të bëhej fjalë për dëmtim të bagëtive, shtëpive të banimit, kasolleve, prodhimeve, pemëve frutore dhe tokës bujqësore.

193 V. 1942-1943 D. 180 f. 3 -125; D. 181 f. 3 -15; D. 183 f. 2 -76; D. 184 f. 3 -70; D. 183 f. 2 -76; D. 184 f. 3 -70; D. 185 f. 1 – 22; D. 186 f. 1 – 74; D. 183 f. 2 -76; D. 184 f. 3 -70; D. 185 f. 1 – 22; D. 186 f. 1 – 74; D. 187 f. 1 – 87; D. 188 f. 1 – 7; D. 183 f. 2 -76; D. 184 f. 3 -70; D. 185 f. 1 – 22; D. 186 f. 1 – 74; D. 187 f. 1 – 87; D. 188 f. 1 – 7; D. 189 f. 3 – 320; D. 190 f. 2 – 142; D. 191 f. 3 – 95; D. 192 f. 3 – 255; D. 193 f. 3 – 158; D. 194 f. 2 – 15; D. 195 f. 2 – 445; D. 196 f. 3 – 176; D. 197 f. 1 – 10; D. 198 f. 1 – 154; D. 199 f. 1 – 116; D. 199 f. 2 – 260. Dhe AQSH F. 177 V. 1941 D. 43, f. 249; D. 73 f. 245-290.

[121] A. Tundo, S. Andoni, *Historiku i Përmetit*, V. 1956, f. 6, cituar nga Apostol Kotani, në librin, Lëvizja nacional-çlirimtare në rrethin e Përmetit (1939-1944), Tiranë 1969, f. 28

[122] *AQSH*, F. 149, V. 1943, D. III-839, f. 73. Shkresë e MPB (Drejtoria e korrespodencës) Nr. 33523/II, datë 13 korrik 1943-XXI. Mbi dëmet e shkaktuara nga ushtria dhe vullnetarët. Dërguar P.T.Kryesisë së Këshilit të Ministriave, Zyrës Ushtarake. Firmoset nga ministri dhe majori Isa Kokalari, ndihmës i kryetarit të zyrës ushtarake.

[123] *Fletore Zyrtare*, Nr. 147, datë 2 tetor 1941, f. 1-4. Shpërblime për dëme lufte, Ligji Nr. 272, datë 10 shtator 1941.

Lutja dorëzohej në komunë, e cila duhej të provonte në praktikë vërtetësinë e dëmeve që listoheshin në bazë të dokumenteve që dispononte. Njëkohësisht ajo verifikohej edhe nga zyra italiane, e cila përpiqej ta minimizonte vlerën financiare të dëmit. Jo vetëm kaq, por përfaqësuesi italian hetonte dhe për qëndrimin politik të personit që kishte pësuar dëmet. Kur ai ishte proitalian, kërkesa pranohej, në të kundërt arkivohej, por nuk ekzekutohej. Në shkresë thuhej se, pas hetimeve dhe verifikimeve të bëra në vend, rezultonte që kur trupat greke patën pushtuar trevat jugore qenë vendosur në vendbanimet private, duke përvetësuar dhe përdorur gjithçka gjenin, sidomos ushqimet, të cilat i munguan ushtrisë për njëfarë kohe. Më tej theksohej se meqë bëhej fjalë për një qytetar shqiptar pa precedentë penal e politikë, në bazë të informacioneve nga Forcat Ushtarake dhe P. F. A., propozohej që të kompensohet nga buxheti për dëmet e pësuara gjatë konfliktit italo - grek.[124] Nënkolonel Francesco Murgia shkruante në një rast, meqenëse bëhet fjalë për qytetarët shqiptarë, me precedent pozitive penale dhe politike, gjë që provohet dhe nga informatat e siguruara nga Ushtria dhe ato të Partisë, duhej të zhdëmtoheshin.[125]

Por kishte raste kur dëmshpërblim kërkohej edhe për tokën e pa punuar. Pronarët e dëmtuar luteshin, të paktën t'u ulej barra e taksës mbi sipërfaqen. I tillë ishte rasti i Thoma Gore Goxhabashit, pronar tokash, banues në qytetin Përmet. Ai shkruante se, për pasojë të luftimeve, pronat e tij që ndodheshin në Malibardhë të Komunës Petran, kishin mbetur pa punuar dhe e pa u vjelë prodhimet. Në to luftonin më shumë se 25.000 ushtarë bashkë me mjetet e tyre. Por edhe mbas luftës, ushtria ishte vendosur mbi ato prona. Për këtë, ai kërkonte një vlerësim dëmi nga komisioni.[126]Duke qenë se ishte dëmtuar për shkak të mos mbjelljeve, por dhe dëmtimit të gjësë së gjallë, lutej që taksa e së dhjetës t'i hiqej ose të paktën t'i zbritej sa të shihej e arsyeshme nga

[124]*AQSH,* F. 193, V. 1942/1943, D. 169, f. 96-99 Komisioni Qendror për kompensimin e Dëmeve të Luftës, Nr.1565 D/G. Gjirokastër, 19 Shtator 1942, për dëmet e shkaktuara nga lufta ndaj qytetarit Aleks Koçi Meçi. Shkresat gjenden me firmën e Kapiten komandant Angelo di Petrillo, N/Kolonel Komandant Francesco Murgia, F. to C. Fusco.

[125]*AQSH,*F. 193, V. 1942/43, D.179, f. 76. Komanda e qarkut të drejtimit të Guardia di Financa në Gjirokastër, Zyra e dëmeve të luftës. Konkluzion i nënkolonel Francesco Murgia, Gjirokastër, datë 25.11.1942 XXI

[126]*AQSH*, F. 313, V. 1941, D. 437, f. 2. Kërkesë e Thoma Gore Goxhabashi, datë 26. XI. 1941 drejtuar nënprefekturës Përmet.

Komisioni.[127]Nënprefektura e Përmetit porosiste që kërkesa e tij të merrej në shqyrtim nga Intendenti Financiar.[128]Ky i fundit u kërkonte tatimorëve që një rast të tillë t'ia referonin komisionit kompetent.[129]

Nga kontrolli i tokave të pa mbjella dhe atyre të mbjella, por të dëmtuara, si dhe nga hetimet e bëra lidhur me lutjet e kryepleqësive, më 15 dhjetor 1941, komisioni konstatonte se sipërfaqja e përgjithshme e tokës që mbillej dhe punohej para luftës në atë fshat ishte 250 dynym, nga të cilat vetëm 80 dynym mund të punohej dhe të vilej rregullisht. Pjesa tjetër, për shkak të luftës mbeti e pambjellë. Pengesë ishte dhe mungesa e kafshëve të ngarkesës, që ishin marrë nga ushtritë okupuese. Disa parcela, duke qenë të mbjella u dëmtuan nga kalimi dhe qëndrimi i ushtrisë, bashkë me mjetet e tyre luftuese. Për pasojë, komisioni konstatonte se, prej 100 kuintalëve grurë dhe 150 kv misër, që prodhonte katundi Malibardhë para lufte, atë vit prodhoi vetëm 15 kv grurë dhe 35 kv misër. Edhe prodhimet e tjera bujqësore kishin pësuar një dëm mbi 80%, kurse gjëja e gjallë thuajse ishte zhdukur. Ndaj jepej mendimi që taksa e të dhjetës, me një tatim prej 297.50 franga të bëhej një zbritje prej 50%, d.m.th. t'i mbetej 148.75 fr. shq.[130]

Në shumicën e rasteve likuidimi financiar zvarritej ose nuk bëhej për mungesa në buxhet. Të dëmtuarit dërgonin letra të shumta në institucionet qendrore të shtetit e deri në Këshillin e Ministrave, me shpresë se ata do të ndërmjetësonin. Po japim vetëm një rast, kur Kryesia e Këshillit të Ministrave i dërgonte komisionit kompetent lutjen telegrafike të parive dhe kryepleqve të disa katundeve të Përmetit, me të cilën kërkonte pagimin e shpejt të dëmeve të luftës, mbasi ndodheshin në gjendje ekonomike të vështirë.[131]

---

[127]*Po aty.*

[128] *AQSH*, F. 313, V. 1941, D. 437, f. 2/1. Shkresë e nënprefektura e Përmetit Nr. 313/14, datë 26. XI.1 941.

[129]*Po aty.* Shkresë e Intendentit të Financës, Teki Idrizi, Nr. 491, datë 27.11.1941, dërguar zyrës së tatimeve.

[130]*Po aty,* f. 3. Procesverbali i datës 15.12.1941, firmosej nga Manol Petro Dindi, nëpunës i tatimeve pranë zyrës Financiare të Përmetit, i deleguem prej iintendentit të Financave, z. Teki Idrizi; Lefter Loni Pepo, Agronom i Qarkut të nënprefekturës Përmet dhe Llaqi Mandi Dhonato, Kryetar i Komunës së Petranit. Ai bazohej në vendimin e Këshillit Administrativ të nënprefekturës së Përmetit, Nr. 31, dt. 23. IX. 1941 XIX, si komision i parapamë nga rregullorja e datës 14.4.1935, për zbatimin e ligjit mbi zëvendësimin e së dhjetës me një tatim në të holla.

[131]*AQSH*, F. 149/1, V. 1942, D. III-839, f. 279. Telegram i Kryesisë së KM, datë 14.4.1943, me firmën e zëvendësministrit, drejtuar Komisionit Qendror për Dëmet e Luftës.

Po japim një shembull. Tahir Abedini nga fshati Panarit i Komunës së Këlcyrës, ankohej se gjatë luftës italo - greke i ishte dëmtuar shtëpia nga bombardimet dhe detyrohej të merrte rrugët e emigrimit brenda vendit. Ai u vendos në Bubullimë të Lushnjës, por aty nuk mund të qëndronte gjatë ilegalisht, ndaj më 20 janar 1941, i kërkonte ministrisë së Bujqësisë dhe Pyjeve, të miratonte të drejtën e vendosjes së tij në Bubullimë.[132] Në kërkesë thuhej seme hyrjen e forcave greke, "shtëpia ime asht djegur e shkatërruar krejtësisht". Duke qenë se kishin mbetur pa strehë, qenë detyruar të largoheshin si familje, burrë e grua me pesë fëmijë, 4 djem dhe një vajzë. Sipas tij, toka në vendlindje ishte e paktë dhe jo produktive, ndaj lutej që të miratohej vendosja e familjes së tij në tokat shtetërore të Lushnjës ose Fierit, me cilësinë e emigrantit.[133]

Mirëpo miratimi i kërkesave nuk mund të bëhej pa u provuar vërtetësia e tyre. Seksioni i Reformës Agrare në ministri, më 6 mars 1941, i kërkonte nënprefekturës të verifikonte kërkesën e Tahir Abedinit nga Panariti, sa sipërfaqe toke kishte, nga sa frymë bëhej familja e tij dhe ku ishte e regjistruar.[134]Edhe Ministria e Bujqësisë dhe Pyjeve i shkruante nënprefekturës Këlcyrë të verifikonte nëse ishin të vërteta pohimet e Tahir Abedinit, i cili pretendonte se i qe dëmtuar pasuria nga lufta, për të cilën kërkonte të instalohej në rrethin e Lushnjës".[135]

Riparimi i dëmeve nga lufta ishte problem dite. Njerëzit që u ishin dëmtuar banesat nuk kishin ku të fusnin kokën. Numri i ndërtesave të dëmtuara ishte i madh. Por qeveria kishte vendosur që të ndihmonte vetëm familjet me gjendje të keqe ekonomike dhe që nuk kishin anëtarë në moshë pune. Vështirësi në procesin e merremetimit të tyre shtoheshin edhe për faktin se qeveria donte të shpenzonte sa më pak, ndërsa punëtorët tentonin të përfitonin nga nevoja e qeverisë, për të marrë një lekë më shumë. Këshilltari i Ministrisë së Punëve Botore, L. Gambarini, në muajin dhjetor 1941, i shkruante Federalit Fashist në Gjirokastër, se në Këlcyrë, muratorët dhe zdrukthëtarët vendës po bënin kërkesa të papranueshme, pasi për një ditë pune në riparimin e shtëpive të dëmtuara nga lufta kërkonin 15 fra. shq.[136]

---

[132]*AQSH,* F. 171, V. 1941, D. VI-269, f. 32.
[133]*AQSH,* F. 171, V. 1941, D. VI-269, f. 32.
[134]*Po aty*.
[135]*Po aty*, f. 34.
[136]*AQSH*, F. 177, V. 1941, D. 73, f. 245. Shkresë e Këshilltarit të M.P. Botore, L. Gambarini, datë 3. XII. 1941, dërguar Federalit Fashist në Gjirokastër. Një shifër e tillë zyrtarëve u dukej e lartë.

Sekretari Federalit Fashist, Xhemal Çuçi, i cili ishte ngarkuar të verifikonte në vend çështjen, i shkruante Ministrisë se ishte e vërtetë që "punëtorët e Këlcyrës kërkojnë shumë para". Ai bënte me dije se kishin urdhëruar Shoqërinë "GIUDICE" që specialistëve t'u paguante 8 fra.shq. në ditë, ndërsa punëtorët të paguheshin më pak.[137] Dëmtime nga bombardimet ajrore ishin bërë dhe në ndërtesa shtetërore. Zyra e Punëve Botore të Gjirokastrës kërkonte inxhinierin Italo Petrosino, për drejtimin e punës në riparimin e godinës së postës në Këlcyrë. Tre muaj më vonë, zyra në fjalë do t'i paraqiste listën e materialeve të blera për rikonstruksionin e saj, prej tregtarëve Janaq Joanidhi dhe Vangjel Kosta, përkatësisht në shumat 477.10 dhe 465.40 fra. shq., si dhe shpenzimet për punëtorinë prej 640 fra. shq.[138]Komuna e Këlcyrës ditën e parë të korrikut shpallte ankand për meremetimet e godinës së dëmtuar për shkak të luftës. Riparimet konsistonin në ndërtim muresh të rrëzuara, suvatime, dyer, dritare etj.[139]

Për përballimin e situatës dhe dhënien e ndihmave elementare u ngritën dhe shoqëri mirëbërëse, të cilat bënin përpjekje për të grumbulluar fonde dhe ndihmuar familjet që ishin më keq ekonomikisht. Shoqëria Mirëbërëse e Prefekturës Gjirokastër, në një dokument që mbante datën 24. VIII. 1944, kishte mbledhur 112 083 fra. shq. Në të thuhej se "deri tani kemi shpërndarë 9 715 fr. shq. dhe janë blerë 163 kv miell gruri me vlerë 72 903 fra. shq.[140]Çështja ishte se nuk kishte evidencë të qartë rreth numrit të refugjatëve dhe vendosjes së tyre. Ata që ishin shpërndarë në fshatra të ndryshme të vendit apo ishin strehuar pranë miqve dhe të afërmve në qytete nuk ishin evidentuar. Në plan të parë dilnin familjet që ishin rrugëve dhe të tjerë që do të guxonin të trokisnin në dyert e institucioneve shtetërore. Më 13 prill 1944, Kryesia e Këshillit të Ministrave u shkruante shoqërive mirëbërëse, se Komiteti për të Ndihmuar të Mjeruarit nga Lufta kishte vendosur të jepte ndihma të vogla për të ikurit nga krahinat e Jugut. Por, duke qenë se lutjet e paraqitura ishin të shumta, ndihmë duhej t'u jepej vetëm familjeve të mjeruara, që ishin dëmtuar më rëndë dhe nuk kishin asnjë mundësi financiare. Ata kërkonin që lutjet e paraqitura të verifikoheshin

[137]*AQSH*, F. 177, V. 1941, D. 73, f. 290. Telegram i Sekretarit të Federalit Fashist, Xhemal Çuçi, datë 15 dhjetor 1941, dërguar M. P. Botore.
[138]*AQSH*, F. 177, V. 1941, D. 43, f. 249. Telegram i Zyrës së Punëve Botore Gjirokastër, Nr. 122/3, datë 7. X. 1941, ku kërkohet dërgimi i një inxhinieri për riparimin e godinës së PP. TT. Këlcyrë.
[139]*Fletore Zyrtare*, Nr. 95, datë 14 gusht 1942, f. 6-7.
[140]*AQSH* F. 189, V. 1944, D. 10, f. 80.

nga shoqëritë mirëbërëse dhe të raportohej kujt i qe dhënë ndihmë prej tyre. Ishte menduar, që, për të lehtësuar qeverinë, ndihmat të shpërndaheshin prej këtyre shoqërive.[141]Më 10 qershor 1944, nga Përmeti kishin marrë ndihmë 84 familje me 470 frymë, në shumën 15 120 fra. shq. Dy ditë më pas morën ndihmë dhe 56 familje të tjera përmetare, me 330 frymë ose 10 640 fra. shq.[142]

Ndihma jepeshin herë pas here. Pati familje që do të merrnin ndihma më shumë se një herë, ashtu siç kishte të tjera që nuk morën fare. Në një dokument pohohej që merrnin ndihmë për herë të parë 15 persona në shumën 2 600 fra. shq.[143]Po atë ditë do të ndihmoheshin dhe 20 familje të tjera përmetare nga 140 deri në 220 fr. shq. secila.[144]

[141] AQSH, F. 189, Pa vit, D. 15, f. 117.
[142] AQSH, F. 189, Pa vit, D. 15, f. 271-275.
[143] AQSH, F. 189, Pa vit, D. 15, f. 304.
[144] AQSH, F. 189, Pa vit, D. 15, f. 315.

Nuri DRAGOJ

SUMMARY

THOUGHTS ON THE ITALIAN - GREEK WAR AND ITS IMPACT ON SOUTHERN ALBANIA

The Italian-Greek war happened as a consequence of Italy's plan to extend its colonies as part of an Axis operation. The war developed on Albanian soil and was followed by a loss in human lives, and grave political and material consequences for Southern Albania. The attack against Greece paved the way for the Greeks to declare war on Albania, which at the time was under Italian rule.

To obtain the support of the Albanian people, Italy offered to create Greater Albania in exchange. Italy went as far as to justify its attack against Greece as an attempt to regain Albanian territories that were unjustly given to Greece in 1913. This caused for some Albanian officers and civilian recruits to join the frontlines. However, two weeks after the attack was initiated, numerous Albanian soldiers retreated from the frontlines because they realized that the war was not about creating a Greater Albania but rather about expanding Italy's colonies. Albanians' retreat from the frontlines and the sabotage and damage caused to the Italian forces, were considered by the High Command as the most significant reasons that led to Italy's defeat.

The Albanian population was subjected to a brutal terror from both sides. The Italians arrested a large number of people under the accusations that they were in service to Greece. A similar approach was adopted by Greek officers against Albanians as well. The arrests and deportations of pro-Italian Albanians were numerous. The main target were the intellectuals, however major losses were experienced from the bombardments, killing of innocent people, population displacement from war-zones, the destruction of homes from artillery attacks, the destruction of crops, the killing of livestock, the destruction of forests and so forth.

The paper clearly identifies the attempts made by Albanian politicians and officers to co-operate with Greek forces against Italians which came to existence because of Greece's expansionist intentions. Numerous Albanians deserted from the Italian frontlines to join the

Greek forces in the war, only to end up in internment camps in Southern Greece. The documents presented in this paper prove that the Greek High Command was ordered to invade the entire Albanian territories of Korça and Gjirokastra after the Italian defeat.

Zelihe SHALA

PLANET ÇETNIKE PËR SHFAROSJEN E POPULLATËS MYSLIMANE DHE SHQIPTARE

Lufta e Dytë Botërore solli shumë ndryshime dhe zhvillime të bujshme në territorin e ish-Jugosllavisë. Kjo situatë nxori në pah forcat antifashiste që luftonin për t'u çliruar nga nazizmi dhe fashizmi. Në këtë vorbull ngjarjesh dhe zhvillimesh, nxorën kokë elementët nacionalistë të cilët përfituan më së shumti. Në radhë të parë ishin çetnikët serbë të cilët konsideroheshin si mbështetës të ish-mbretit të tyre Petrit të Dytë. Ata krijuan *Shtabin e Komandës së radhëve Çetnike të Ushtrisë jugosllave.* Ky grup nacionalistësh serbë kishin për qëllim krijimin e një Serbie të gjerë në dëm të territoreve të fqinjëve por edhe mendonin ta zbatonin programin e Vasa Çubrilloviqit, i njohur si një shovinist i madh serb. Kësaj radhe viktima ishte elementi nacional shqiptar si dhe ai mysliman. Nga të dyja anët ishin shqiptarët që do të viktimizoheshin. Siç do të shihet me vonë pikërisht shqiptarët do të viheshin *në tehun e shpatës,* vuajtjet e të cilëve nuk do të pushojnë as pas përfundimit e LDB, kur e themi këtë kemi parasysh faktin se shqiptarët ndiqeshin vetëm e vetëm se ishin shqiptarë por edhe si element mysliman. Pra, në kurrizin e tyre ngarkoheshin dy elementë të padëshirueshëm. Ideja për zhbërjen e elementit do të vazhdojnë deri në vitet e '60-ta deri kur dominoi pushteti me ambicie serbomëdha i Rankoviqit, pushtet i cili u ripërtëri pas viteve '80-ta.

Dokumentet çetnike mbi aneksimin e trojeve shqiptare

Synimet e çetnikëve serbo - malazezë kishin zgjedhur tokat shqiptare si edhe territoret tjera në ish-Jugosllavi mbi të cilat donin të krijonin Serbinë e Madhe dhe Malin e Zi. Këto qëllime pasqyrohen qartë në dokumentet sekrete të tyre të cilat do t'i hedhim në dritë në këtë shkrim të shkurtër. Në dokumentin me numër 370 të Shtabit të

Komandës së Radhëve Çetnike të Ushtrisë jugosllave, me në krye majorin e Shtabit të Përgjithshëm z. Gjorgje Loshiq nga Mali i Zi dhe udhëheqësi i Komandës së Radhëve Çetnike të Limit të Ushtrisë Jugosllave, Pavle Gjureshiqit[1]sidhe dokumenti me nr. 1 154 i Komandës së Ushtrisë Jugosllave të Atdheut, Korpusi Sulmues i Kosovës, i datës 14 nëntor 1944.[2] Për të arritur qëllimin e tyre serbo - malazezët, shpresat i mbështetnin tek mbreti i cili bashkë me qeverinë[3] vepronte në ekzil. Ai ishte i ngarkuar që të vepronte në fushën diplomatike në qarqet ushtarake gjithashtu pranë aleatëve të mëdhenj.[4] Mirëpo, barra kryesore i binte organizimit të çetave çetnike të cilat do të vepronin në terren, nën moton e krijuar të ushtarëve çetnik *"lufta për popull", d. m .th. le të ndijojmë se çka dëshiron populli e pastaj atë ta punojë.*[5] Meqenëse lufta e tyre kishte karakter nacionalist dhe mbështetej në të vetmin qëllimin "lirinë e popullit", ata nuk duhej të kursenin asgjë për realizimin e objektivave të veta[6], pra duhej të pushtonin sa më shumë toka të popujve jo serb e malazez.

Shtabi i Komandës së Radhëve Çetnike të Ushtrisë Jugosllave synimet e veta i parashtronnë 10 pika kryesore të cilat në pjesën më të madhe drejtpërdrejt rrezikojnë trevat shqiptare e myslimane.[7] E me qenë se *qëllimi dhe projektimi* i planeve çetnike ishte shfarosja e popullsisë myslimane dhe shqiptare[8], çetnikët përdornin pretekstet se gjoja Ushtria jugosllave u tradhtua nga elementë të shumtë të errshim e për atë arsye patë mbërri katastrofën e madhe.[9] Për këtë katastrofë Shtabi i Komandës Çetnike i bënë fajtor të gjithë ushtarët myslimanë që në ditët tragjike pa mëshirshëm e zhduknin popullsinë tonë[10] (popullin serb, Z. Sh). Me paragjykime të tilla dhe pretekste të këtij lloji, çetnikët i kishin vënë objektivë vetës që të bënin spastrime etnike e territoriale të mëdha duke

[1]*A. Sh. K*., Fondi: Dokumente armiqësore viti 1941 - 44, Kutia nr. 41, Nr. dokumentit 946, Shtabi i Komandës së radhëve Çetnike të Ushtrisë Jugosllave, 20 dhjetor 1941.
[2]*A. Sh. K*., Fondi: Dokumente Armiqësore viti 1941 - 44, Kutia nr. 41, Nr. dokumentit 1154, Komanda e Ushtrisë Jugosllave të Atdheut Korpusi Sulmues I Kosovës i datës 14.11.1944.
[3]*Po aty.*
[4]*Po aty.*
[5]*Po aty*.
[6]*Po aty*
[7]*Po aty.*
[8]*A. Sh. K.,* Fondi: Dokumente armiqësore viti 1941 - 44, Kutia nr. 41, Nr. dokumentit 946, Shtabi i Komandës së Radhëve Çetnike të Ushtrisë Jugosllave, 20 dhjetor 1941.
[9]*Po aty*.
[10]*Po aty*.

njekë, vrarë dhe shpërngulur popullsinë myslimane, por edhe shqiptare, ashtu siç kishte vepruar Mbretëria Serbe dhe ajo Malit të Zi në vitin 1912-15. Gjatë këtyre viteve ata patën për qëllim që t'i detyronin shqiptarët me propaganda të rreme dhe më shumë me dhunë të largohen nga viset ku ata ishin banorë shumicë.[11] Në saje të këtij aksioni famëkeq vetëm brenda dy vitesh (1912 - 14), në Turqi u shpërngulën 40 000 veta.[12] Me çdo kusht çetnikët dëshironin t'i përmbushnin synimet e tyre të errëta dhe kërkonin t'i rimerrnin territoret, që gjithnjë sipas logjikës së tyre hegjemoniste u takonin atyre dhe se pushtuesi italian, gjerman dhe bullgar ua kishe okupuar. Ku plan hegjemonist i tyre duhet të shtrihej mbi shumicën e territoreve të Shqipërisë së Veriut dhe deri në Shkodër, sepse kinse dëshironin që të siguronin Malin e Zi nga sulmet e elementit shqiptarë nga Shqipëria.[13] Për çetnikët ishte e domosdoshme që të bëhej spastrimi i territorit shtetëror nga të gjitha pakicat kombëtare jo serbe.[14] Ideja e tyre mbështetej në shtrirjen e kufijve të përbashkët në mes të Serbisë dhe Cërrnagorës si dhe kufirit në mes Serbisë dhe Sllovenisë duke spastruar Sanxhakun dhe Bosnjën nga popullsia myslimane dhe kroate.[15] Atëherë, kur do të arrihej të pastroheshin viset e lakmuara në ato vise do të bëhej kolonizimi me elementin malazez (në plan nuk hyjnë vetëm familjet e vobekta të mirësjellshëm e të ndershme).[16]

Në këto dokumente që jemi duke i përfolur më tutje ceket se ishe e nevojshme të sigurohej trupi politik i cili do të udhëheq anijen shtetërore drejt dëshirave dhe interesave të mëdha, por për këtë qëllim duhej të shkohej deri edhe te lufta që do të ishte shtetërore për të arritur përmbushjen e dëshirave dhe interesave të popullit[17], e që nënkuptohet të atij serb. Gjithashtu u bëhej thirrje të gjitha elementeve Kombëtare (Nacionale) që të rreshtohen sa më parë në radhët çetnike sepse ngjarjet zhvilloheshin me një shpejtësi të mrekullueshme e s'duhet të na gjen të papërgatitur.[18]

---

[11]E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi, Tiranë, 1990, f. 259.
[12]*Po aty*.
[13]*Po aty*.
[14]*A. Sh. K*., Nr. dokumentit 946, Shtabi i Komandës së Radhëve Çetnike të Ushtrisë Jugosllave, 20 dhjetor 1941, Fondi: Dokumente Armiqësore viti 1941 - 44, Kutia nr. 41.
[15]*Po aty*.
[16]*Po aty.*
[17]*Po aty.*
[18]*Po aty.*

Problem në vete që pengonte realizimin e projekteve çetnike, ishin komunistët dhe partizanët, ngase me ta s'mund të bëhet kurrfarë bashkëpunimi sepse ata luftojnë kundra Dinastisë (Familjes Mbretërore) dhe për realizimin revolucionit shoqëror.[19] Ndërkaq, në një letër që i dërgohet shtabit rus, kërkohej që ata të intervenonin tek njësitet popullore partizane që të mos i sulmonin[20] çetat çetnike sepse ata po luftonin kundër armikut të përbashkët gjermanëve dhe arnautëve (shqiptarëve Z.SH.). Kërkohej një intervenim i tillë, nga pala ruse, sepse sa herë që kanë ndërmarrë sulme kundër gjermanëve, prapa shpine janë sulmuar nga partizanët.[21] Në mes tjerash kjo komandë kërkon që urgjentisht të urdhërohen partizanët për të lidhur një marrëveshje, kur dihet mirëfilli se korpusi i Kosovës numëronte 5 000 njerëz të armatosur të cilët ishin në gjendje të jepnin kontributin e vetë të madh për çlirimin e atdheut[22] dhe se qëllimi ynë është i njëjtë kur dihet që ne jemi vetëm ushtarë e luftëtarë për mbretin, atdheun e popullin e lirë.[23]

Për të qenë sa më të përgatitur kur të ndërmerren aksionet çetnike kundër tokave shqiptare, myslimane dhe kroate, ata llogarisin për të përdorur të gjitha radhët çetnike në Mal të Zi, në momentin kur mendohet se duhet të vihen në jetë këto qëllime.[24] Sulmet do të drejtoheshin në fillim në Luginën e lumit Lim drejt Belles që do të kenë detyrë parësore të spastrojnë Peshterin nga popullata myslimane dhe shqiptare.[25] Të gjitha forcat çetnike duhet të bashkëpunonin me radhët e Galisës dhe Javorit.[26] Sulmi i dytë do të orientohej në drejtim të Çakorit, Rugovës - Metohisë gjithnjë me qëllim që të spastrohen këto vise nga elementi shqiptar, për të zbatuar në përpikëri synimet duhej të priten e të vriten të gjithë ata që ikin nga Peshteri dhe Sanxhaku. Këto forca duhet të bashkëpunojnë me forcat e radhëve të Kopaonikut[27], kurse sulmi i tretë do të bëhej në Primorje dhe Dubrovnik. Të gjitha këto forca duhet të bashkëpunojnë me kolonën e majtë të Dangiçit e cila do të veprojë

[19] *Po aty.*
[20] *A.Sh .K.*, Fondi: ,,Dokumentet armiqësore ", dok. 1154, Br, str. pov. 14, nëntor 1944, Kutia 41.
[21] *Po aty.*
[22] *Po aty.*
[23] *Po aty.*
[24] *Po aty.*
[25] *Po aty.*
[26] *Po aty.*
[27] *Po aty.*

(sulmojë) Mostarin.[28] Dhe drejtimi i katërt i sulmeve planifikohej të orientohej drejt jugut me qëllimin që të pushtohet Shkodra dhe në këto raste qëllimisht të sigurohet Mali i Zi prej sulmit shqiptar nga Shqipëria.[29]

Të gjitha çetat çetnike thuhet se ishin të obliguara të mbanin lidhje me Komandën, me anë të korijerëve dhe të bënin përgatitjet e duhura për të kontrolluar aeroportet prej nga do të zbarkonin ndihmat që do të vinin nga jashtë ose të jepeshin koordinatat e sakta se ku duhet të lëshoheshin ato, me parashuta, por kërkohej gjithashtu si shumë e nevojshme që vendet duhej të ndriçoheshin[30] vazhdimisht. Po ashtu, çetnikët e kishin shumë të nevojshme sigurimin e një rruge për krahina detare për në brendësinë e vendit, sepse është e mundur që ndihmat të vijë përmes detit.[31] Çetnikët duhet të kishin parasysh që lidhja me Dangiçin, në Bosnje të bëhet përmes Gaçkos dhe Bileqes dhe nëpër Foçë drejt Kolinevikut.[32] Kurse lidhja me radhën çetnike serbe kërkohej të mbahej me anë të radhëve çetnike të Limit.[33]

Përgatitja e çetave çetnike dhe planet e tyre shoviniste shfarosëse ndaj shqiptarëve ishin gjithnjë aktuale dhe të gatshme. I vetmi popull që ishte "halë në sy" si për serbët ashtu edhe për malazezët, ishte populli shqiptar si tërësi autoktone që i prishte planet dhe synimet e tyre hegjemoniste. Prandaj, planet e paraqitura kishin një rëndësi të përhershme dhe konsideroheshin si shumë të rëndësishme për të gjitha projektet hegjemoniste të forcave serbe e malazeze.

[28] *Po aty.*
[29] *Po aty.*
[30] *Po aty*.
[31] *Po aty*.
[32] *Po aty*.
[33] *Po aty*.

Zelije SHALA

SUMMARY

THE CHETNIK PLANS FOR THE ELIMINATION OF THE ALBANIAN AND MUSLIM POPULATION

Throughout the history Albanians were conquered by foreign forces and subdued to terror and ethnic cleansing from the neighboring countries (Serbia, Montenegro, Greece, etc.) who attempted to actualize their hegemonic plans by conquering Albanian lands. Therefore, it is not by chance that we discuss the documents presented above, which documents introduce the Serbian projects towards the Albanian issue, much similar to those introduced by Garashanin, Cubrilovic, and finally those of Mihajlovic.

The Serbs aimed to acquire access to the Adriatic, and they believed that this would be achieved only through eliminating the Albanian population which to them represented the greatest obstacle. Aside from gaining access to the sea, the Serbs were fundamentally aiming to rid of the Albanian element in the area. The Montenegrins on the other hand aimed to assess their dominance over the fertile Albanian lands. To achieve these goals, the Albanian element needed to be eliminated. The Chetniks were the most active in this direction during the Second World War, having had targeted the Albanians and Muslims. These documents in Serbian are only a small portion of the numerous documents that introduce to us the hegemonic Serbian plans.

Fehmi REXHEPI

LUFTA E DYTË BOTËRORE DHE LUFTA ANTIFASHISTE NË KOSOVË

Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore fuqitë imperialiste nuk i realizuan të gjitha synimet e tyre. Çarjet e para të botës kapitaliste u paraqiten që në Konferencën e Versajës e më pas ato vetëm sa u thelluan. U organizuan Lidhja e Kombeve e konferenca të herëpashershme, u lidhën traktate e marrëveshje, pranuan obligime, por antagonizmat mbeteshin dhe gjithnjë e më shumë rriteshin. Përpjekjet për çarmatim apo së paku për kufizim të armatimit dështuan në Konferencën e Uashingtonit (1921 - 1922) dhe në Konferencën e Gjenevës (1932), ngase edhe fituesit edhe humbësit mundoheshin t'ia hidhnin njëri - tjetrit. As pranimi i përbashkët i obligimeve, si në Lucern (1925) as Pakti i Briand - Kellgov-it, me të cilin ndalohej lufta si mjet i politikës nacionale, nuk mundën t'i eliminojnë mospajtimet e ndërsjella dhe t'i sjellin paqen e vërtetë popujve.[1] Franca okupoi territore ekonomikisht me peshë të Gjermanisë dhe kështu me politikën e saj ndikoi në dobësimin e Gjermanisë, ndërsa Anglia dhe SHBA-të mbështetnin Gjermaninë si aleate të ardhshme dhe si kundërpeshë ndaj Francës, por dhe si luftëtare të nesërme kundër Bashkimit Sovjetik. Një qëndrim i tillë i fuqive perëndimore zgjoi dhe e forcoi në Gjermani dëshirën për revansh dhe e ofroi nga Italia e cila kishte mbetur e pakënaqur dhe synonte të marr rolin prijës dhe dominues në Detin Mesdhe. Ajo e para filloi të kërkojë revidimin e marrëveshjes së paqes. Kësaj kur ia shtojmë edhe ardhjen e Hitlerit në pushtet në Gjermani del

[1] Priruçni leksikon, Znanje, Zagreb, 1959, f. 944.

konstatimi se u forcua taboriagresiv që ndikoi në krijimin e vatrave të konfliktit. Kështu Italia më 1935 sulmoi Etiopinë, Japonia forcoi agresionin në Kinë, gjenerali Franko filloi luftën qytetare kundër Republikës Spanjolle (1936), e deri sa ende vazhdonte lufta qytetare në Spanjë, Hitleri kreu anshlusin e Austrisë pa asnjë kundërshtim të nënshkruesve të Paktit të Versajit. Apetitet e Hitlerit nuk përfundonin me kaq ai edhe më tej vazhdoi t'i realizojë synimet e veta ndaj vendeve fqinje sidomos ndaj Çekosllovakisë dhe Polonisë, duke shfrytëzuar kështu edhe indiferentizmin e Francës dhe të Anglisë. Në prill të vitit 1939 Italia fashiste sulmoi dhe pushtoi Shqipërinë, kështu Shqipëria ende pa filluar zyrtarisht Lufta e Dytë Botërore u bë viktimë e agresionit fashist. Në rrethana të tilla, të ndërlikuara ndërkombëtare më 1 shator 1939, Gjermania naziste sulmoi Poloninë dhe kështu filloi Lufta e Dytë Botërore e cila do të zgjasë deri më 1945. Lufta e Dytë Botërore filloi si luftë imperialiste - pushtuese në mes shteteve kapitaliste, ku shtetet nazifashiste (Gjermania, Italia, Japonia dhe satelitët e tyre), kërkonin ndarjen e re të botës për të krijuar sistemin e ri shoqëror në të cilin këto shtete do të siguronin dominimin ekonomik, politik dhe ushtarak.[2] Në vitet e para të luftës 1939 - 1942 agresorët shënuan rezultate të mëdha duke i falënderua para së gjithash përgatitjeve të mëparshme e të gjithanshme ushtarake, propagandës, kolonës së pestë dhe befasisë, pastaj mosharmonisë dhe lëshimeve të fuqive perëndimore, mos syqeltësisë së BRSS, dobësive të Lidhjes së Kombeve etj.

Aleatët nga Koalicioni Antihitlerian vetëm më 1943 ndërmorën ofensivë të fortë në tokë dhe në ajër me të cilën më 1945 i përfunduan fitoret mbi Fuqitë e Boshtit. Lufta e Dytë Botërore ishte luftë e përgjithshme, nga se në të ishin të angazhuara të gjitha forcat njerëzore dhe të gjitha potencialet materiale të shteteve ndërluftuese. Me përdorimin e armëve të reja (aeroplanëve - kështjellave fluturuese, bombave fluturuese, bombave atomike, njësiteve sulmuese ajrore etj.) u shtuan në maksimum dimensionet e fushëbetejave duke depërtuar kështu veprimet luftarake në thellësi të prapavijave të palëve ndërluftuese.[3]

Nëse llogarisim të gjithë të vrarët, nga luftimet ose nga bombardimet e vendbanimeve, të vdekurit nga epidemitë e ndryshme, të zhdukurit në kampet e përqendrimit etj., humbjet e përgjithshme në njerëz arrijnë afër 50 milionë. Dëmet nga shkatërrimet e luftës

[2] Mala enciklopedija I, Prosveta, Beograd, 1959, f. 399.
[3] *Po aty.*

vlerësohen deri në 260 miliardë dollarë vetëm në Evropë, ndërsa dëmet e vërteta ekonomike gjatë Luftës së Dytë Botërore arrijnë 1 384 miliardë dollarë.[4]

Midis dy luftërave botërore dhe në dy vitet e para të Luftës së Dytë Botërore, Kosova dhe shqiptarët gjendeshin nën sundimin e egër të Mbretërisë jugosllave, territoret e saj ishin të ndara në tri njësi administrative - banovina (Moravës, Vardarit dhe Zetës). Gjendja e vështirë ekonomike, shoqërore dhe politike, shtypja nacionale, terrori, dhuna, zhdukja fizike, kolonizimi, reforma e padrejtë agrare, shpërnguljet me dhunë dhe format e tjera të shfrytëzimit dhe të shtypjes nacionale, ishin faktorë që ndihmuan në shtimin e pakënaqësisë së popullit shqiptar të Kosovës ndaj Mbretërisë jugosllave. Kjo gjendje dhe ky disponim ndikoi te shqiptarët që mezi pritën shkatërrimin e kësaj krijese antishqiptare. "Edhe djalli po të vinte në pushtet ishte më i mirë se pushteti serb - jugosllav", ishte ky mendim i pakontestueshëm i të gjithë shqiptarëve të të gjitha shtresave dhe rrymave politike në këtë kohë.[5]

Me fillimin e Luftës së Dytë Botërore dhe me zhvillimet e asaj periudhe u krijuan parakushte për shqyrtimin dhe zgjidhjen e problemit kombëtar të popullit shqiptar, problem ky që nuk ishte zgjidhur me krijimin e shtetit të pavarur shqiptar më 1912, prandaj e tërë lëvizja çlirimtare që zhvillohej gjatë atyre viteve në Kosovë dhe në viset e tjera etnike ishte vazhdimësi e përpjekjeve të pandërprera të popullit tonë për çlirim e bashkim kombëtar. Popullsia dhe forcat politike shqiptare në Kosovë me interesim të veçantë i ndoqën ngjarjet e fundmarsit të vitit 1941. Derisa në njërën anë popullsia serbe e malazeze në Kosovë edhe nën ndikimin e Partisë Komuniste të Jugosllavisë ishte kundër politikës kapitulluese të qeverisë jugosllave,në anën tjetër popullsia shqiptare mezi priste të shkatërrohej kreatura artificiale e Mbretërisë jugosllave qoftë edhe me intervenim të jashtëm siç ishin Fuqitë e Boshtit. Shqiptarët e Kosovës në parim ishin kundër fashizmit që kishte okupuar Shqipërinë qysh më 1939, por më shumë urrenin pushtetin jugosllav që mbante të pushtuar Kosovën që nga viti 1912 e për këtë arsye ata

[4] *Po aty*, f. 400.

[5] Fehmi Rexhepi, "Kosova në vitet e Luftës së Dytë Botërore", *Studime historike*, nr. 1-2, LIX (XLII), Akademia e Shkencave të Shqipërisë & Instituti i Historisë, Tiranë, 2005, f. 155.

pritën forcat fashiste që pushtuan Jugosllavinë si çlirimtarë dhe si shpëtimtarë të tyre[6].

Gjermania naziste dhe Italia fashiste, pasi shpartalluan ushtrinë jugosllave në prill të vitit 1941 ia bashkëngjitën Shqipërisë pjesën më të madhe të Kosovës, pjesërisht Çamërinë dhe një pjesë të Maqedonisë. Por, ky bashkim edhe pse i drejtë duke qenë një veprim i njëanshëm i fashistëve, për rrjedhojë dhe jo i plotë për nga vlerat juridike dhe për nga legjitimiteti ndërkombëtar në një anë u prit me entuziazëm sidomos nga forcat nacionaliste të shqiptarëve të të gjitha viseve, kurse nga ana tjetër shumica e komunistëve dhe atyre që ishin nën ndikimin e ideologjisë bolshevike të PKJ-së dhe PKSH-së, këto akte i pritën me skepticizëm sepse Koalicioni Antifashist nuk i pranonte kufijtë që i kishin vendosur forcat fashiste.

Shqiptarët nuk u pajtuan me ndarjen e Kosovës në tri zona okupuese, prandaj ata nën udhëheqjen e komunistëve, nacionalistëve dhe antifashistëve organizuan protesta e demonstrata antifashiste pothuajse në të gjitha qytetet kryesore të saj. Me angazhimin e komunistëve por edhe të nacionalistëve u organizuan protesta e demonstrata sidomos në qytetet të cilat i takonin zonës okupuese bullgare, me të vetmen kërkesë që t'i bashkohen Shqipërisë, ndonëse edhe vet ajo ishte e okupuar nga Italia fashiste.[7] Përhapjen e ideve komuniste dhe antifashiste në Kosovë te masat e gjëra e avancuan sidomos intelektualët, nëpunësit dhe mësuesit e ardhur nga "Shqipëria e vjetër", siç i quante populli me admirim për dallim nga "Shqipëria e re", viset që ishin bashkuar shtetit shqiptar, më 1941.

Për fillet e organizimit politik dhe ushtarak në dobi të Lëvizjes Antifashiste dhe të luftës së armatosur kundër fashizmit në Kosovë, padyshim moment me rëndësi paraqet themelimi i PKSH-së, si parti që ndër pikat kryesore të programit të saj kishte organizimin dhe udhëheqjen e LANÇ-së, për çlirimin e vendit dhe për krijimin e një shteti etnik. Përhapja dhe zhvillimi i ideve dhe i Lëvizjes Antifashiste te popullsia shqiptare në Kosovë, ishte më e lehtë dhe më e realizueshme në zonën e pushtimit bullgar dhe në zonën gjermane për shkak të pakënaqësisë të të gjitha shtresave shoqërore për gjendjen e krijuar, ndërsa në anën tjetër popullsia serbe e malazeze ishte më e disponuar për luftë kundër fashizmit në zonën pushtuese italiane jo vetëm pse ishin më shumë nën ndikimin e Partisë Komuniste por edhe për faktin se

[6] *Po aty*, f. 156.
[7] *Po aty*.

mendonin se i kishin humbë të drejtat nacionale dhe shtetin e tyre Jugosllavinë.

Shqiptarët e të gjitha rrymave dhe shtresave shoqërore, sidomos ata në zonën okupuese bullgare por edhe në atë gjermane, sidomos nën ndikimin e komunistëve dhe antifashistëve në LANÇ hynë me idealin e pastër të bindur se po luftonin jo vetëm fashizmin por edhe rikthimin e pushtetit të Jugosllavisë. Pra, për shqiptarët e Kosovës ashtu si edhe për ata të viseve të tjera që u bashkuan me Shqipërinë më 1941, lufta kundër fashizmit kishte rëndësi të shumëfishtë. Duke luftuar për çlirimin nga fashizmi sidomos në zonën bullgare dhe gjermane ata bashkoheshin me koalicionin e madh antifashist dhe në të njëjtën kohë aspironin të çliroheshin njëherë e përgjithmonë edhe nga pushtuesi i mëparshëm jugosllav. Si rezultat i përhapjes dhe zgjerimit të ideve antifashiste dhe komuniste edhe në Kosovë ashtu si në Shqipëri e në viset tjera për rreth, filloi organizimi i formacioneve të para ushtarake dhe luftarake siç ishte APNÇSH "Zenel Hajdini" (27. IX. 1942) që u formua në fshatin Ramjan të Çarkut të Gjilanit, në afërsi të vijës së demarkacionit. Më vonë u organizuan edhe shumë aradha e çeta partizane të tjera e që në fund të Luftës së Dytë Botërore u krijuan tetë brigada dhe një brigadë e korporatës së mbrojtjes popullore të Jugosllavisë.[8]

Nuk ka dyshim se të gjitha kushtet dhe rrethanat për veprimtari të LANÇ-it ishin më të favorshme në zonën okupuese bullgare nga se kjo trevë aspironte bashkimin me shtetin amë Shqipërinë, edhe pse vet ajo ishte nën sundimin e fashizmit italian. Të gjitha aksionet e armatosura kundër fashistëve bullgarë dhe italianë gjatë viteve 1942 dhe 1943 në Kosovë i kryen pothuajse në tërësi partizanët dhe antifashistët shqiptarë që udhëhiqeshin nga komunistët. Pozita e Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore ishte e veçantë, edhe Lufta Antifashiste që u zhvillua ishte e veçantë ngase shqiptarët synonin jo vetëm çlirimin nga fashizmi, por edhe çlirimin nga pushteti i Jugosllavisë, ndërsa serbët synonin çlirimin nga fashizmi dhe rikthimin e pushtetit të Jugosllavisë. Përcaktimi dhe angazhimi i shqiptarëve të Kosovës dhe i viseve të tjera në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare ishte faktor me rëndësi që i ndihmoi e i kontribuoi forcimit të lidhjeve e të bashkëpunimit ndërmjet lëvizjeve çlirimtare të Jugosllavisë dhe Shqipërisë. Formacionet partizane që vepronin në brezin kufitar me krahinën e Tropojës e në Rrafshin e Dukagjinit, u formuan me luftëtarë nga të dyja anët. Të tilla ishin çetat që vepronin në krahinën e Tropojës e të Rrafshit të Dukagjinit. Këto

[8] Ali Hadri, *Lëvizja Nacionalçlirimtare në Kosovë 1941 - 1945*, Prishtinë, 1971, f. 468.

formacione u zhvilluan gjatë vitit 1943 në Tropojë, në Gjakovë, në krahinën e Bytyçit e të Plavës, në rrugën Ferizaj - Prizren - Kukës, në rrugën Gjakovë - Prizren, duke e kthyer Tropojën në një prapavijë të sigurt për forcat partizane në Kosovë.[9] LANÇ në Kosovë udhëhiqej nga KK i PKJ-së që ishte i lidhur dhe i varur drejtpërdrejtë nga KQ i PKJ-së. PKJ në këtë kohë pothuajse në të gjitha ftesat drejtuar popujve të Jugosllavisë numëronte edhe shqiptarët, të cilëve u drejtohej si popull e jo si pakicë kombëtare. Komunistët dhe antifashistët shqiptarë dhe simpatizantët e tyre, duke besuar në parimin e vetëvendosjes që u riafirmua edhe në artikullin e Josip Brozit, botuar në gazetën "Proleter". Më 1942 iu përgjigjën thirrjes së PKJ-së për luftë të armatosur kundër fashizmit në kohën kur gëzonin shumë më tepër të drejta kombëtare, ekonomike dhe politike. Në këtë artikull Josip Broz Tito në mes tjerash shkruante: "Çështja e Maqedonisë, çështja e Kosovës dhe e Dukagjinit, çështja e Malit të Zi, çështja e Kroacisë, çështja e Sllovenisë, çështja e Bosnjës dhe Hercegovinës, të gjitha këto do të zgjidhen lehtë në mënyrë të kënaqshme për të gjithë vetëm në një mënyrë të tillë që me zgjidhjen e tyre të merret vetëm populli dhe secili popull do ta fitojë këtë të drejtë me pushkë në dorë në këtë luftë të sotme nacionalçlirimtare".[10] KK gjithashtu mbante lidhje edhe me KQ të PKSH-së. Ndikimi i PKSH-së dhe i komunistëve shqiptarë nga Shqipëria ishte i rëndësishëm sidomos për t'i bindur dhe për t'i lidhur me LANÇ shtresat e gjëra të popullsisë së Kosovës.

Shqiptarët e Kosovës dhe të viseve të tjera në ish-Jugosllavi, sidomos pas Konferencës së Bujanit, duke u mbështetur edhe në Kartën e Atlantikut ku garantohej e drejta e popujve për vetëvendosje në bazë të pjesëmarrjes në luftë kundër fashizmit, në premtimet e PKJ-së dhe të PKSH-së iu përgjigjën thirrjes së PKJ-së për luftë të armatosur kundër fashizmit, me bindje se do të realizonin të drejtën për vetëvendosje dhe bashkim kombëtar. Konsiderojmë se angazhimi i pamjaftueshëm i PKSH-së ndaj problemit të udhëheqjes me LANÇ-në në Kosovë, ndikoi negativisht sidomos në përfshirjen e popullsisë shqiptare në të. Edhe pse PKSH-ja kishte mbështetje më të mëdha te populli i kësaj treve,për

[9] Dokumente të Shtabit të Përgjithshëm, vëllimi I, f. 443 - 444, cituar sipas Xhelal Gjeçovi, Pushtimi gjerman në Shqipëri 8 shkurt 1943 - 29 nëntor 1944, Tiranë, 2004, f. 86.

[10] Josip Broz Tito, *Çështja kombëtare dhe vetëqeverisja*, Prishtinë, 1976, f. 14 - 15; Fehmi Rexhepi, *Gjilani me rrethinë në Luftën e Dytë Botërore 1941 - 1945*, Instituti i Historisë - Prishtinë, Prishtinë, 1998, f. 145-146.

shkak të varësisë dhe inferioritetit që kishte ndaj PKJ-së, ajo ia kishte lënë kësaj të fundit duart e lira edhe në Kosovë. Pra, edhe pse de jure dhe de fakto në këtë kohë Kosova ishte në kuadër të shtetit shqiptar ku PKSH-ja udhëhiqte me LANÇ, për çudi me LANÇ-në në Kosovë udhëhiqte një parti eksterritoriale PKJ. Nuk ka fije dyshimi se kuadrot e PKJ-së dhe veprimtarët e saj, duke përfshirë këtu edhe kuadrot serbo - malazeze nga Kosova ,kishin në prapavijë djallëzinë, demagogjinë dhe hegjemonizmin e në këtë drejtim tërë veprimtarinë e tyre e mbështetnin në mbrojtjen e interesave nacionale që përputheshin me interesat serbomëdha duke i maskuar me internacionalizëm proletar. Ndërsa, në anën tjetër shumica e kuadrove shqiptare, duke iu besuar ideve internacionaliste dhe idealizmit komunist, nuk mundën ta shihnin apo ta kuptojnë këtë profeci djallëzore me kohë.[11] Gjatë Luftës së Dytë Botërore në Kosovë do të krijohen dhe do të funksionojnë jo vetëm organizma të veçanta e të mëdha ushtarake, politike dhe organe të pushtetit popullor e ushtarak, që paraqisnin strukturë të mëvetësisë shtetërore e politike, sikurse njësitet e tjera të popujve të Jugosllavisë siç ishin: Komiteti Krahinor i Kosovës, Shtabi Kryesor i Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Kosovës e deri te organi më i lartë i pushtetit popullor i Këshillit Krahinor Nacionalçlirimtar për Kosovë e Rrafsh të Dukagjinit. Të gjitha këto organe e institucione në një mënyrë për popullin shqiptar të Kosovës ishin edhe një provë e garanci se pas përfundimit të luftës do të realizohej e drejta e patjetërsueshme për vetëvendosje dhe bashkim kombëtar.[12]

Kuadrot më të devotshëm komuniste dhe antifashiste, nga radhët e shqiptarëve të Kosovës që mbronin krahas ideve komuniste edhe platformën kombëtare apo ata që i stigmatizonin dhe që i denonconin aktet antikombëtare, nga ana e veprimtarëve të PKJ-së filluan të akuzohen dhe të etiketohen si nacionalistë, shovinistë e shqiptaromëdhenj për t'u eliminuar ose likuiduar në forma dhe mënyra më perfide si p.sh: Emin Duraku, Xheladin Kurbaliu, Hajdar Dushi, Xheladin Hana, Qemajl e Nexhat Agolli, Abdullah Krashnica etj. Përkundër pozitës specifike dhe vështirësive të shumta në të cilat u gjendën shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore, ata jo vetëm që u rreshtuan në Koalicionin Antifashist, pra në anën e fituesit por edhe

[11] F. Rexhepi, *Studime historike*, pun. i cit., f. 158.

[12] Fehmi Rexhepi, "Lufta e shqiptarëve të Kosovës për vetëvendosje dhe bashkim kombëtar", *Kosova*, nr. 2, revistë historiko - politike, Instituti i Historisë - Prishtinë & Instituti i Historisë - Tiranë, Tiranë, 1994, f. 33.

ishin ndër të parët në Evropë që u çliruan nga fashizmi me forcat e veta. Mirëpo, siç dihet mirë ngjarjet që u zhvilluan në fund të Luftës së Dytë Botërore nuk shkuan në favor të shqiptarëve e as të udhëheqësve të Lëvizjes Antifashiste të cilët u angazhuan për realizimin e vendimeve të Konferencës së Bujanit që nënkuptonte bashkimin e Kosovës me Shqipërinë.

Pas çlirimit të Kosovës nga fashizmi në nëntor të vitit 1944, me vendimin e Shtabit Kryesor të UNÇJ-së, njësitet partizane të Kosovës dhe të Shqipërisë u urdhëruan që të shkojnë në viset veriore dhe veriperëndimore të Jugosllavisë për të vazhduar operacionet luftarake kundër forcave gjermane që po tërhiqeshin në drejtim të Gjermanisë. Krejt kjo bëhej në emër të ndihmës internacionaliste, kurse në anën tjetër shumë njësite partizane jugosllave në të cilat nuk ishte i vogël as numri i çetnikëve, që kurorën çetnike e kishin zëvendësuar me yllin pesëcepësh komunist, u dislokuan në Kosovë. Ato zhvilluan dhunë, terror, vrasje e gjenocid mbi popullsinë e Kosovës. Kjo pati për pasojë masakrimin e dhjetëra mijëra shqiptarëve sidomos në Karadak, Ferizaj, Gjilan, Drenicë, Pejë, Mitrovicë etj.[13] Në këtë situatë të turbullt në fund të Luftës së Dytë Botërore, komandanti suprem i UNÇJ-së, Josip Broz Tito më 8 shkurt 1945 vendosi Administrimin Ushtarak në Kosovë me synimin që të sigurohen rrethanat për të penguar realizimin e vetëvendosjes së popullit shqiptar të Kosovës aq shumë të premtuar gjatë LANÇ-së, si dhe me qëllim të përgatitjes së terrenit për aneksimin e Kosovës në Kuvendin e Prizrenit në verë të vitit 1945 (8 - 10 korrik).

Kështu përderisa ende zhvilloheshin aksione luftarake në fund të Luftës së Dytë Botërore, shqiptarët e Kosovës në vend që të bashkoheshin me Shqipërinë, ashtu siç ishin shprehur përfaqësuesit e saj të të gjitha rrymave në Konferencën e Bujanit (31 dhjetor 1943 dhe 1 - 2 janar 1944) ata u ndanë në tri njësi administrative të federatës jugosllave (Maqedoni, Serbi, Mali i Zi) dhe në Çarkun Autonom të Kosovës. Kjo ndarje nuk ishte asgjë tjetër pos rezultat i jetësimit të strategjisë antishqiptare që ndoqi hegjemonizmi serbomadh nën petkun e PKJ-së në krye me Josip Broz Titon. Edhe në këto momente dramatike (1944 - 1945) për çështjen tonë kombëtare ishte sinjifikativ qëndrimi i shtetit shqiptar, dhe i udhëheqjes së tij, i cili në vend që t'i kushtëzonte dhe t'i ndërpriste marrëdhëniet me PKJ-në dhe me Jugosllavinë, duke kërkuar vendosmërisht të drejtën e patjetërsueshme për vetëvendosje dhe për bashkimin e trojeve etnike në një shtet mbi baza të pjesëmarrjes në

[13] F. Rexhepi, *Studime historike*, pun. i cit., f. 159.

LANÇ, të garantuar edhe me Kartën e Atlantikut, udhëheqja e Shqipërisë edhe më tutje vazhdonte bashkëpunimin dhe koncesionet ndaj Jugosllavisë duke rrezikuar kështu edhe pavarësinë dhe ekzistencën e vetë shtetit shqiptar.

Lëvizja Antifashiste në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore ishte faktor e entitet i veçantë dhe specifik që po krijonte identitetin e vet duke bashkëpunuar me LANÇ-në të Shqipërisë dhe me LANÇ të Jugosllavisë e duke iu bashkuar kështu Koalicionit të madh Antifashist botëror. Ajo dha kontribut të pamohueshëm edhe për faktin se në fund të vitit 1944 dhe në fillim të vitit 1945 në formacionet ushtarake të saj u inkuadruan rreth 50 000 luftëtarë që me luftën dhe gjakun e tyre dhanë kontribut të rëndësishëm për fitoren e Koalicionit Antifashist.

Fehmi REXHEPI

SUMMARY

THE SECOND WORLD WAR AND THE ANTI-FASCIST WAR IN KOSOVA

The Second World War started as an imperialist war between the capitalist states, where the Nazi-fascist and militaristic states (Germany, Italy and Japan) and their satellites requested for a new world order in which these states would ensure economical, political and military dominion in the world.The Second World War is considered a total war, because of the sheer number of countries and groups involved in direct combat. If we account for the number of deaths from fighting or bombardments, the deaths from epidemics, all the missing ones from concentration camps etc., the loss of human lives during the Second World War amounts to 50 million people. In Europe, the destruction caused from war amounted to 260 million dollars, whereas the economic damages in the world amounted to 1.384 billion dollars.
Economic hardship and difficult social conditions, national oppression, colonization, agrarian reforms and violent population displacement were the reasons behind the increasing discontentment amongst the Albanian people in Kosova.

The Albanian people and politicians followed closely the developments of the end of March in 1941. The Serbian and Montenegrin population in Kosova, under strong influence from the Communist Party in Yugoslavia, was against the capitulation of the Yugoslav government, whereas the Albanian population was joyfully awaiting the destruction of the Yugoslav state, even if that would come about as a result of an intervention from the Axis forces.

After the Axis forces defeated the Yugoslav Army in April of 1941, they annexed most of Kosova to Albania. This act was welcomed warmly by a large number of Albanian nationalists throughout the Albanian territories, however most communists from the CPY treated this matter with considerable skepticism. The three occupied zones in Kosova, namely the German, Italian and Bulgarian zones, had their specific characteristics. For most Albanians residing in the German and

Bulgarian occupation zone, the Anti-fascist war in Kosova represented a fight not only against fascism, but a means to prevent the return of Serbian occupation in these ares anew.

The case of Kosova during the Second World War together with the nature of the Anti-fascist war was unique, because Albanians were not only seeking after liberation from fascism but also liberation from the Yugoslav reign. The Serbs and Montenegrins, on the other hand, sought after the liberation from fascism and to bring about the return of the Yugoslav reign.

Various specific military and political organizations were formed during the Second World War in Kosova. Most of these represented independent state and political structures, of which the most renown ones were: The Provincial Committee of Kosova, the Headquarters of National-liberation Army in Kosova, and the highest political institution which was the Provincial National-liberation Council for Kosova and Dukagjini plain. All these institutions and structures, for the most part, were sort of a proof and guarantee to the people of Kosova that after the war would end, they would gain the right for self-determination and national unification.

The Anti-fascist movement in Kosova during the Second World War was a special and unique entity which created its identity in cooperating with the Anti-fascist movement in Albania and the Anti-fascist movement in Yugoslavia, forming thus a large Anti-fascist coalition throughout the world. The Anti-fascist coalition gave a large contribution to the war, which by the end of 1944 and the beginning of 1945 encompassed around 53.000 soldiers, who sacrificed their lives and contributed to the victory of the Anti-fascist coalition.

Regardless of the difficult state the Albanians found themselves in at during the Second World War, a large number of them lined up fighting for the Anti-fascist coalition, and were one of the firsts in Europe to liberate their country from fascism with their own forces. However, it is well known that the events leading up to the end of the war were not favorable for the Albanians nor were they favored by the Anti-fascist movement's leaders, who were engaged in completing the decisions made at the Conference of Bujan which promoted the unification of Kosova with Albania.

Muharrem DEZHGIU

"VATRA" PËR ÇËSHTJEN KOMBËTARE SHQIPTARE NË VITET E LUFTËS SË DYTË BOTËRORE*

Veprimtaria e Federatës Panshqiptare "Vatra" gjatë një shekulli pati si bosht të saj themelor çështjen kombëtare shqiptare, duke i kushtuar asaj një mbështetje të fuqishme në arenën ndërkombëtare.

Krijimi i shtetit shqiptar pas Shpalljes së Pavarësisë, më 28 Nëntor 1912, nuk e zgjidhi përfundimisht çështjen kombëtare shqiptare. Shtetit shqiptar iu desh të kalonte në shumë sfida të tjera, për të marrë përmbajtjen e një shteti kombëtar. Duke mos e patur këtë tipar shteti shqiptar u ndesh me pengesa të brendshme e të jashtme, të cilat rrezikuan dhe vunë në dilemë dhe pavarësinë e Shqipërisë. Në të gjitha këto sfida, Federata Panshqiptare "Vatra" u bë mbrojtëse e flaktë e çështjes shqiptare, si një zëdhënëse e fuqishme e opinionit të shqiptarëve të diasporës.

Kumtesa synon të parashtrojë qëndrimin e shqiptarëve të Amerikës, nëpërmjet "Vatrës" ndaj pushtimit të huaj të Shqipërisë, gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur çështja kombëtare shqiptare ndodhej përpara një rreziku qartësisht të dukshëm.

Diaspora shqiptare në Amerikë, para Luftës së Dytë Botërore, në përbërjen e vet, kishte intelektualë të njohur, të cilët e njihnin historinë e Shqipërisë, që në themelet e shtetit të pavarur. Ata njihnin në vijimësi peripecitë dhe pengesat, në të cilat kishte kaluar çështja shqiptare deri në pushtimin e fundit italian. Për rrjedhojë, ata kishin shprehur pikëpamjet e tyre për këtë problem, madje, në mënyrë të organizuar, nëpërmjet "Vatrës".

---

* Kumtesë e mbajtur në Konferencën shkencore, me rastin e 100-vjetorit të themelimit të Federatës Panshqiptare "Vatra", organizuar nga Instituti i Historisë, pranë QSA, Tiranë, më 28 prill 2012.

Veprimtaria e tyre, e zhvilluar larg ambicieve dhe interesave të ngushta të ditës prodhonte gjykime dhe mendime më të besueshme, më objektive dhe më bindëse. Ndaj dhe mendimi i tyre ishte më racional, për t'u marrë në konsideratë në orientimin e zgjidhjes së çështjes kombëtare shqiptare.

Veprimtaria e "Vatrës", e zhvilluar në një nga vendet demokratike perëndimore, me një hapësirë më të gjerë lirie në fushën diplomatike për çështjen shqiptare, e bënte më objektiv ndikimin e saj në Shqipëri. Që në fillim të agresionit italian, "Vatra" me veprimtarët e saj demaskoi propagandën e shfrenuar dhe bajate të fashizmit italian, lidhur me qëllimet e pushtimit të Shqipërisë. Në faqet e shtypit të "Vatrës" në Amerikë, thuhej qartë se, pushtuesit nuk i kërkonin kufijtë e Shqipërisë deri në Janinë, Selanik, Manastir e Shkup, se këto vende janë shqiptare dhe duhet t'i ktheheshin Shqipërisë, por ato kanë ndërmend t'i grabitin për vete, sikundër grabitën Shqipërinë e lirë.[1]

Megjithatë, sipas analizës që i bënin situatës në Shqipëri, vatranët ishin realistë, duke bërë të ditur se, "Shqiptarët, edhe pse nuk e duan fashizmin, s'kanë fuqi të kundërshtojnë Italinë". Nga ana tjetër, veprimtarët e "Vatrës" dënonin dhe kritikonin atë takëm shqiptarësh, që i quanin "shpirtkalbur", të cilët shiteshin përpara, për t'i bërë varrin Shqipërisë. Nën ndikimin e këtyre "shpirtkalburve" populli shtrëngohej të vishte këmishën e zezë të fashizmit dhe të thërriste "rroftë" për këtë ose për atë "eksponent fashist".[2] Për shqiptarët e Amerikës, slogani fashist, sipas të cilit, "Shqiptarët duhet të luftojnë për madhimin e vendit të tyre", ishte një mashtrim i komandës italiane. Ky slogan kishte për qëllim motivimin e shqiptarëve për t'i çuar në vijën e parë të frontit të luftës e të vriteshin për interesat e Italisë.

Shqiptarët e "Vatrës" e bënë të qartë dallimin midis administratës fashiste, të vendosur në Shqipëri dhe popullit shqiptar. "Bota e di fort bukur, - shprehej "Dielli", - se sot s'ka Shqipëri as qeveri shqiptare, por ajo është një koloni e vogël e Italisë. Për rrjedhojë, për të gjitha sulmet që ndërmori Italia ndaj fqinjëve të Shqipërisë, s'kishte faj as Shqipëria e as populli i saj".[3] Një qëndrim i tillë realist, do të shërbente si strumbullar i argumentit për të hedhur poshtë pretendimet greke ndaj

[1] "Italianët tallen me popullin shqiptar", *Dielli*, organ i Federatës Panshqiptare "Vatra" (më tej: *Dielli*), Boston Mass., 1 korrik 1940.
[2] *Po aty*. Në *Dielli* përmenden emrat e këtyre eksponentëve të fashizmit, Tefik Mborja dhe Ettore Mutti.
[3] "S'ka faj Shqipëria, as populli i saj", *po aty*, f. 2.

Shqipërisë, duke e akuzuar atë si shkaktare e agresionit italian kundër Greqisë.

Diplomacia dhe politika e demokracive të mëdha evropiane shpalosi një qëndrim të dyshimtë dhe të çuditshëm për pavarësinë dhe integritetin territorial të Shqipërisë në periudhën fillestare të pushtimit të saj. Në mënyrë të veçantë një qëndrim i tillë vihej re në politikën dhe diplomacinë britanike. "Qeveria britanike, jo vetëm që bëri sytë e verbër ndaj dhunimit flagrant të ligjit ndërkombëtar, por ajo gjithashtu u përpoq të zvogëlonte asgjësimin e pavarësisë së saj, në sytë e komunitetit britanik dhe atij ndërkombëtar".[4]

Ndërsa, Qeveria e SHBA-së, nëpërmjet deklaratës së Sekretarit të Shtetit, Cordel Hull, të bërë më 5 prill 1939, e konsideroi pushtimin e Shqipërisë nga Italia "një akt i dhunshëm dhe përdorim force, që kërcënonte paqen e botës".[5]

Veprimtarët e "Vatrës" kërkonin që të bëhej presion ndaj qeverisë britanike dhe amerikane për të mbështetur, pa mëdyshje, rimëkëmbjen e pavarësisë dhe ruajtjen e integritetit territorial të Shqipërisë. Në vitet 1941 dhe sidomos gjatë vitit 1942, në adresë të qeverisë britanike, u dërguan një sërë letrash, telegramesh e memorandumesh nga figura e personalitete të njohura, ku kërkohej respektimi i parimeve të Kartës së Atlantikut.

Shqiptarët e Amerikës dhe "Vatra" konsideronin detyrë të dorës së parë, përkrahjen dhe mbështetjen e përpjekjeve për formimin dhe njohjen ndërkombëtare të një qeverie shqiptare në mërgim. Aso kohe, ky organizëm, konsiderohej një faktor themelor juridik e politik për ruajtjen e statusit juridiko - territorial të shtetit shqiptar.

Nga ana tjetër, njohja e një qeverie të tillë, do të ishte faktor mobilizimi dhe organizimi i shqiptarëve në luftën e përbashkët çlirimtare, si dhe, një mbrojtëse e interesave shqiptare në arenën ndërkombëtare. Kjo gjë, ishte e domosdoshme edhe për faktin se, vendet fqinje të Shqipërisë kishin ruajtur qeveritë e tyre në mërgim pas pushtimit. Si të tilla, jo vetëm që mbronin me efikasitet interesat e tyre kombëtare, por po kryenin edhe veprimtari të ethshme politike e

[4]*Foreing Relations of United States* (FRUS), Diplomatic Papers, 1939, volume II, General The British Commonwealth and Europe, Washington: 1956, p. 378, sipas Hamit Kaba në: *Studime historike*, nr. 3-4, 2009, f. 67.

[5]*Peace and War: United States Foreign Policy 1931-1941*, US: Department of State Publication, 1983, f. 454, sipas H. Kaba në: *Studime historike*, nr. 3-4,2009, f. 68.

diplomatike për realizimin e synimeve aneksioniste të tyre ndaj Shqipërisë.

E para tentativë për formimin e qeverisë në mërgim u bë vetëm pak ditë pas sulmit italian kundër Greqisë, duke theksuar se, kjo ngjarje "e kishte shtuar urgjencën e çështjes".[6] Korente të ndryshme të emigracionit shqiptar, të mbështetura në motive, sa kombëtare aq edhe juridike, e vlerësuan Zogun si figurë qendrore për krijimin e qeverisë shqiptare në mërgim. Ai shihej si "përfaqësues legjitim i shtetit shqiptar dhe bartësi i vetëm i vazhdimësisë së tij konstitucionale".[7]

Një qeveri, me A. Zogun në krye shihej si garanci jo vetëm për rimëkëmbjen e pavarësisë, por edhe për paprekshmërinë e kufijve. Në lëvizjen për krijimin dhe pranimin e një qeverie të tillë, u përfshinë përveç "Vatrës", me përfaqësues F. Nolin, F. Konicën, K. Çekrezin, T. Zavalanin, edhe organizata të tjera, si Komiteti "Shqipëria e Lirë", në përbërje të të cilave bënin pjesë Noli, Konica, Çekrezi, Zavalani etj. Në këtë lëvizje u përfshinë dhe shqiptarët që punonin në industrinë e luftës, në SHBA, të cilët me anë të një memorandumi, i kërkonin sekretarit të shtetit C. Hull të pranonte një qeveri shqiptare në mërgim, nën kryesinë e mbretit A. Zogu.[8]

Kërkesa e A. Zogut ndaj diplomacisë britanike, për t'u njohur si kryetar shteti në mërgim, sikurse ishin njohur homologët e tij të Greqisë e të Jugosllavisë, nuk u muar në konsideratë nga Forin Offisi.[9] Me sa dukej, në atë kohë, qeveria britanike nuk e kishte përcaktuar qartë qëndrimin që do të mbante kundrejt çështjes shqiptare[10]. Për Britaninë e Madhe pavarësia e Shqipërisë ishte vënë në dilemë. Noli dhe Konica, me ndikim të fuqishëm në veprimtarinë dhe qëndrimet e "Vatrës", i mbështetën pa rezerva përpjekjet e Zogut. Ata i argumentuan Departamentit të Shtetit Amerikan domosdoshmërinë e krijimit të

[6] *British National Archives, London,* Foreign Office (më tej: FO) 371/24866, Kopje e letrës së Dervish Dumës dërguar Nolit dhe Nelo Dizdarit, kapur nga censura britanike, 6 nëntor 1940 (Cituar sipas B.Metës në: *Tensioni greko - shqiptar, 1939 - 1949,* Tiranë: "Geer", 2002).

[7] *Po aty*, 371/33109, Relacion i P.Dixon-it mbi bisedën me Tajar Zavalanin, 3 korrik 1942.

[8] *United States National Archives* (USNA) DS. 87501/564, 1/2, Memorandumi i shqiptarëve që punonin në industrinë e luftës, dërguar C.Hull-it (pa datë).

[9] FO 371/33110, Raporte të Rajanit mbi bisedat me Zogun, 24 qershor dhe 3 korrik 1942.

[10] FO 371/33109, Shënime të Dixon-it pas bisedës me T.Zavalanin, 3 korrik 1942.

qeverisë me Zogun në krye, duke e vlerësuar si "personaliteti më i shquar shqiptar".[11]

Noli i shprehte C. Hullit shqetësimin se, edhe pse deklarata amerikane ishte e shkëlqyer nga pikëpamja parimore, ishte e dënuar të mbetej në letër në qoftë se ajo (deklarata - M. D.) nuk do të përforcohej me garantimin e integritetit tokësor të Shqipërisë dhe me njohjen zyrtare të Mbretit Zog si kryetar legjitim dhe logjik i qeverisë shqiptare në mërgim, së cilës t'i garantohej edhe një vend në Konferencën e Paqes.[12]

Mbështetja e fuqishme që i dha "Vatra" njohjes së një qeverie shqiptare, me Ahmet Zogun në krye, ishte një tregues i qëndrimit të vendosur ndaj çështjes kombëtare shqiptare në rrethanat e kohës. Noli dhe vatranët, edhe pas humbjes së Konicës në dhjetor 1942, mbajtën një qëndrim konstant, në mbështetje të çështjes shqiptare.

Diaspora shqiptare e Amerikës, nën drejtimin e "Vatrës" i shprehu bindjen e saj Departamentit të Shtetit Amerikan se "vetëm Fronti i Bashkuar Shqiptar nën udhëheqjen e mbretit Zog, ishte mënyra më efektive për të ndihmuar Shqipërinë dhe Kombet e Bashkuara".[13] Noli, i shqetësuar për pozitën e Shqipërisë, në raport me fqinjët, të cilët kishin në Londër dhe Washington ambasadorë dhe qeveri në mërgim, kishte arsyetuar: "Zogu mund të konsiderohej si një nga autoritetet që paraqiste një shpresë se mund të pranohej nga Aleatët si përfaqësues i vazhdimit të shtetit të pavarur shqiptar. Rrjedhimisht, rreth tij mund të krijohej një qeveri shqiptare në mërgim e cila mund të pranohej nga qeveritë amerikane dhe britanike, gjë që do të siguronte njohjen e Shqipërisë si komb i bashkuar dhe njohjen e pavarësisë dhe tërësisë tokësore pas luftës. Kjo, - vazhdonte Noli në arsyetimin e tij, - do të pengonte e do të thyente intrigat e pretendimet tokësore të qeverive shoviniste greke e jugosllave në Londër".[14]

Kundërshtarët e Monarkisë, me në krye Zogun, bënin përçapje të krijonin një komitet kombëtar shqiptar në vend të një qeverie, por, duke pranuar që ky komitet të kishte në krye Zogun. Një organizëm i tillë pa prerogativat e qeverisë, linte të hapur çështjen e përcaktimit të formës së regjimit të pasluftës. Për Zogun, pranimi i Komitetit, në vend të

[11] USNA. DS.FW.875.01/427, Promemorie e Nolit dhe e Konicës pas vizitës në Departamentin e Shtetit, 19 nëntor 1942.
[12] Po aty.
[13] Po aty, 875.01/474, Telegram i Shaqir Buços, Asat Hasanit, Mehmet Kinakolicit, Hysen Panaritit etj., dërguar C. Hull-it, 28 dhjetor 1942.
[14] Behar Shtylla, *Fan Noli siç e kam njohur*. *Kujtime,* Tiranë: "Dituria", 1997, f. 112.

qeverisë, do t'u mohonte shqiptarëve të drejtat e fituara gjatë 20 vjetëve të shtetësisë së pavarur. Kjo rrezikonte që çështja shqiptare të shqyrtohej edhe njëherë nga fillimi, pa patur asnjë siguri, nëse rezultati do të ishte në interes të Shqipërisë. Ndaj, mbështetësit e Zogut, këmbëngulnin në krijimin e qeverisë legale, duke e konsideruar si garanci për mbrojtjen e pavarësisë dhe të integritetit territorial të Shqipërisë.[15]

Në rrethanat e përçarjes së emigracionit politik shqiptar, lidhur me krijimin e qeverisë shqiptare në mërgim, diaspora shqiptare e Amerikës, e organizuar nga "Vatra", qëndroi në bindjen e saj për pranimin pa kushte të mbretit Zog si figurë qendrore politike rreth së cilës duheshin bashkuar shqiptarët.[16]

Duke i bërë një analizë çështjes së krijimit të qeverisë shqiptare në mërgim, "Vatra" do të hetonte dhe shkaqet e dështimit të përpjekjeve për krijimin e Frontit të Përbashkët. Ideja e krijimit të qeverisë në mërgim dështoi, së pari, se nuk gjeti përkrahje nga Aleatët, nga apatia e tyre kundrejt Shqipërisë dhe, së dyti, nuk deshën grupet shqiptare të Londrës (që bënin pjesë në Komitetin "Shqipëria e Lirë", që të vijnë në marrëveshje.[17] Harxhimi i energjive në këto përpjekje, në mënyrë të natyrshme, zbehu dhe zvarriti përpjekjet e shqiptarëve në emigracion për ta kundërshtuar propagandën dhe ofensivën diplomatike të qeverisë greke në Britaninë e Madhe dhe në Amerikë, me synime të qarta aneksioniste ndaj Shqipërisë.

Në verë të vitit 1944, situata ndërkombëtare dhe ajo në Shqipëri ndryshoi në mënyrë të vrullshme. Goditja vendimtare që po merrte fashizmi në shkallë botërore, ndodhi në të njëjtën kohë me rritjen e ndikimit të Lëvizjes Nacionalçlirimtare në Shqipëri, nën drejtimin e PKSH. Ndërkohë, për Shqipërinë rritej rreziku i copëtimit nga ofensiva politike e diplomatike e qeverisë greke. Në këto rrethana, shqiptarët e Amerikës, të mbledhur në një miting, miratuan një rezolutë për Fuqitë e Mëdha dhe Kombet e Bashkuara.[18] Rezoluta kërkonte njohjen zyrtare të qeverisë shqiptare në ekzil, ashtu siç kishte ekzistuar para 7 prillit 1939, si dhe pranimin e Shqipërisë me të drejta të plota në Kombet e Bashkuara. "Vatra" i bënte të ndërgjegjshëm bashkatdhetarët e vet për

[15] FO 371/37137, Kopje e letrës së Sotir Martinit drejtuar T.Zavalanit, 11 maj 1943.
[16] Po aty, Letër e T.Zavalanit dërguar Mis Barkerit, 24 tetor 1943.
[17] "Shqipëria e Enver Hoxhës", *Dielli*, 16 dhjetor 1944.
[18] FO 371/43555, R179/71/90, Telegram dërguar A. Edenit nga kryesia e Komitetit për Çlirimin e Shqipërisë (Christ Lepon, P. Danushi, Çhrist Skurte, Ismail Emini, etj.) 9 qershor 1944.

rrezikun që i vinte Shqipërisë. Ajo u kujtonte atyre qëndrimin kritik që kishte mbajtur ndaj politikës britanike që në vitin 1942, pas deklaratës së A. Edenit, në dhjetor të atij viti. Ajo vinte në dukje se deklarata britanike u përhap si sëmundje ngjitëse në të gjitha anët dhe nuk la asnjë grek pa zënë. Në Amerikë grekomanët "epirotë" hapën kuletat dhe nisën përsëri nga avazi i vjetër, me shpresë që t'i mbushnin kokën popullit amerikan, se shqiptarët janë grekë.[19]

Epërsia e forcave që drejtoheshin nga komunistët, në ngjarjet politike e ushtarake të Shqipërisë në fund të verës 1944 si dhe rritja e presionit dhe rrezikut grek në Shqipërinë e Jugut që kishte të bënte drejtpërdrejtë me interesat kombëtare, ndikuan dhe në qëndrimet e "Vatrës". Ishin këto rrethana, që përmendëm, të cilat e bënë "Vatrën" të mbështeste qeverinë provizore komuniste, që u formua në Shqipëri, duke menduar se ajo do të mbronte interesat e Shqipërisë, kundër copëtimit të saj. "Fakti është që, sot për sot, kjo është qeveria që ka populli shqiptar, këtë qeveri duhet të përkrahim edhe ne".[20] Madje, "Vatra" shtroi detyrën që, Komuniteti Amerikano-Shqiptar duhet të kërkojë sa më shpejt nga Guverna Amerikane njohjen e kësaj qeverie për prurjen e misionit nga Shqipëria. Duke iu përmbajtur këtij qëndrimi, "Vatra" theksonte se, "Gjersa të kapëxejmë rrezikun e copëtimit të Shqipërisë, detyrë e çdo shqiptari është të përkrahë me gjithë shpirt guvernën provizore të E. Hoxhës".[21]

Në rrethanat e ndërlikuara dhe komplekse të Luftës së dytë Botërore, ku ndërthureshin faktorë të brendshëm e të jashtëm, që rrezikonin çështjen kombëtare shqiptare, "Vatra" mbajti një qëndrim konsekuent në shërbim të mbrojtjes së pavarësisë dhe integritetit tokësor të Shqipërisë, duke mbështetur atë forcë qeverisëse në Shqipëri që mendohej se i shërbente interesave të larta kombëtare. Për vatranët ishte e rëndësishme që vendi të kishte një qeverisje që t'i delte në mbrojtje pavarësisë dhe tërësisë tokësore të Shqipërisë. "Vatra" e linte të hapur çështjen e qëndrimit ndaj kësaj qeverie, me shpresën se, "Nesër, po të jetë se bëhet një qeveri tjetër, e cila të përmbledhë të gjitha partitë edhe të pëlqehet e të njihet prej Aleatëve, edhe ne, duhet ta ndihmojmë me çfarë të mundim".[22]

[19] "Toskëria sot", *Dielli*, 18 nëntor 1944.
[20] *Po aty*, 28 tetor 1944.
[21] "Shqipëria e E.Hoxhës", *po aty*, 16 dhjetor 1944.
[22] *Po aty*, 28 tetor 1944.

Qëndrimi i "Vatrës" do të ndryshonte më vonë, kur në Shqipëri, nuk u lejuan parti të tjera në qeverisjen e vendit, por po vendosej diktatura komuniste. "Vatra" nuk e mbështeti qeverinë komuniste të Shqipërisë për qëndrimet dhe veprimet antidemokratike të saj, ndaj shqiptarëve. Në këto rrethana, veprimtarët e saj u dalluan dhe për dimensionin antikomunist të tyre, i cili u shërbente përpjekjeve për çështjen kombëtare shqiptare dhe për vendosjen e demokracisë në Shqipëri, sipas modelit amerikan.

Muharrem DEZHGIU

SUMMARY

"VATRA" AND ITS ACTIVITIES FOR THE ALBANIAN NATIONAL CAUSE DURING THE SECOND WORLD WAR

The activities of the pan-Albanian federation "Vatra" were themed around the Albanian national cause, by attributing a great deal of their endeavors towards giving this cause international attention. The formation of the Albanian state after the declaration of independence on the 28th of November 1912 did not ultimately solve the case of the Albanian national cause. The Albanian state had to overcome numerous varying challenges in order to create a fully national state. In overcoming all these challenges, the pan-Albanian federation "Vatra" transformed into a fervent protector of the Albanian cause, thus becoming a strong voice for the Albanian diaspora.

During the Second World War, the Albanian national cause was exposed once again to an outside peril. It was the constant endeavors of "Vatra" that lead to the exposure of the Italian aggression and mundane propaganda it provided in the process of invading Albania. For Albanian-Americans the fascist slogan "Albanians should fight for the expansion of their country", was a deceitful attempt to incite the Albanians to fight for Italy's interests. The members of "Vatra" had a similar approach regarding Italy's invasion of Albania as western democratic states. The activists of "Vatra" pressured the British and American governments to support the revival of the Albanian independence and the protection of its territorial integrity.

Albanian-Americans and members of "Vatra" considered it as their primary task to lobby in favor of an international recognition of an Albanian government in exile, which they considered to be a crucial judicial and political actor in maintaining Albania's status as an independent state. Such a government would also serve to organize armed liberation forces, and ultimately help in defending Albanian interests in the international arena. A government with Ahmet Zogu as

its leader was considered not only a guarantee for reviving Albania's independence but also as a means to protect the country's borders.

In the process of forming such a government, aside from members of “Vatra” such as F. Noli, F. Konica, K. Çerkezi, T. Zavalani, other organizations were involved as well. Noli and Konica, who enjoyed great authority within “Vatra”, were highly supportive of Zogu's attempts to return to power. They presented to the American State Department the argument that such a government headed by Zogu would be necessary, by labeling him as the most “prominent Albanian personality”.

The superiority of the armed communist forces, the political and military circumstances by the end of the summer of 1944 and the increased pressure from the Greeks in Southern Albania, caused for some members of “Vatra” to modify their views. The increased risk of a potential attack in Southern Albania was one of the reasons that prompted the members of “Vatra” to support the provisory communist government, by assuming that the communists would protect Albania's territories from being divided. In these circumstances, “Vatra” claimed that “until we overcome the risk of Albania's division, it is every Albanians' duty to support the provisory government of E. Hoxha”. For members of “Vatra”, it was highly important that the country would be governed by someone who would protect Albania's borders.

Later on when the communist dictatorship was being established and there were no competing political parties allowed, “Vatra” would change their stance in regards to the communists. “Vatra” did not support the communist government in Albania, nor its anti-democratic stances and acts towards Albanians. In these circumstances, members of “Vatra” continued to serve the Albanian cause by aiming to establish a democratic government in Albania in accordance with the American model.

Sabile KEÇMEZI – BASHA

ORGANIZIMI I TË BURGOSURVE POLITIKË SHQIPTARË NË BURGUN E MITROVICËS SË SREMIT MË 1946

Në bazë të hulumtimeve dhe statistikave që i kemi për të burgosurit politikë, dihej se gjatë viteve 1945 - 1948 u arrestua një numër i madh i atdhetarëve, por ky trend i burgosjeve vazhdoi edhe në vitet e mëvonshme duke shtuar dhe intensifikuar edhe më shumë dhunën e terrorin ndaj shqiptarëve. Me qindra e mija shqiptarë u arrestuan dhe u burgosën. Shumë nga ata u mbytën dhe tinëzisht u likuiduan në burgjet serbe.

Në proceset e gjata gjyqësore që u organizonin ndaj anëtarëve të ONDSH-së, gjykatësit iu shqiptonin dënime të rënda, me mbi dhjetë vite burg, dhe pjesa më e madhe e tyre dërgoheshin për ta vuajtur burgun në Mitrovicë të Sremit. Andaj edhe ishte krejt e natyrshme që takimet e të burgosurve politikë shqiptarë në mes vete të jenë më të shpeshta, dhe si imperativ i kohës u shtrua nevoja që të merrnin hapa konkret për një organizim të mëtejshëm ilegal edhe në kushtet e reja të burgut. Disa nga të burgosurit politik shqiptarë, punën e tyre atdhetare nuk e ndërprenë edhe në qelit e ftohta. Pas arrestimit dhe shqiptimit të dënimit ndaj Raif Cërrrnicës me 20 vjet burg[1], ai dërgohet në Mitrovicë të Sremit dhe kishte numrin 10 të të burgosurit, çka nënkuptojmë se ishte njëri ndër të parët në atë burg. Atje, ai nuk ishte i vetëm. Menjëherë pas vendosjes aty, vuri kontakte me shumë të burgosur të tjerë shqiptarë që ishin dënuar me vite të shumta burgu. Situata në burgjet jugosllave ishte e rëndë. Jo vetëm që rrezikoheshin nga gardianet e pushtetit që në çdo kohë ishin të disponuar armiqësisht ndaj shqiptarëve, por, rreziku ndaj tyre vinte edhe nga brenda burgut. Nga të burgosurit që mund të ishin të porositur e të paguar, për t'iu nxirë jetën

[1] Sabile Keçmezi - Basha, *Të burgosurit politikë shqiptarë në Kosovë 1945 - 1990*, Shkup - Prishtinë -Tiranë, 2010, f. 408.

sa më shumë të burgosurve shqiptarë. Rreziku ishte edhe më i madh nga çetnikët që ishin të burgosur dhe që "rastësisht" ndodheshin në dhomat e tyre.

Si lindi ideja për formimin e Komitetit të NDSH-së, në burg

Duke i parë rreziqet e shumta në burg, të burgosurve politikë shqiptarë nuk iu kishte ngel rrugë tjetër veçse të organizoheshin dhe të ishin më unik në mes veti. Raif Cërrnica, shumë më vonë se: "Në mars të vitit 1946, nisëm veprimtarinë në Organizatën Nacionale - Demokratike Shqiptare, unë - Rai Cërrnica, Ismet Boletini dhe Ramadan Rexha".[2] Rreziku për jetën e shqiptarëve të burgosur në burgun e Mitrovicës së Sremit ishte permanent. Për t'i ikur kësaj ndeshtrashe, tre të burgosurit e lartë përmendur më 20 mars të vitit 1946, gjatë një shëtitjeje në burg, nën kujdesin e rreptë të gardianëve, ashtu në heshtje duke u marr vesh më tepër me sy e me gjeste, morën qëndrim që të formonin një grup ilegal për ndihmë të burgosurve politikë shqiptarë. Sipas Ramadan Rexhës, që shkruan në librin "Kujtimet e mia", botuar më 2004 në Prishtinë, ai thotë se në shëtitoren e oborrit të burgut me: Ismet Boletini, Raif Halimi dhe Ramadan Rexha[3] morëm këtë vendim:

Vendim

"Për formimin e organizatës në Shtëpinë Korrektuese në Mitrovicë të Sremit, me qëllim që ta mbrojnë njëri - tjetrin; të ngritët morali i të dënuarve shqiptarë gjatë vuajtjes së dënimit në burg; që të pengohet demoralizimi i të dënuarve në burg; që të përkrahen moralisht dhe mundësisht edhe materialisht; që të ngritët krenaria shpirtërore e të dënuarve shqiptarë në burg, duke mos lejuar që ata të thyhen fizikisht dhe moralisht nga armiku..."[4] thuhej në vendimin e grupit ilegal. Këta të burgosur marrin qëndrim, që me punën e vet, me sa iu mundësonin kushtet

[2] Ramadan Rexha, ishte i lindur më 1921 në Mitrovicë, ku mbaroi filloren, kurse medresenë në Shkup, Ramadan Rexha u radhitë në anën e forcave të koalicionit antifashist. Ishte komisar i Batalionit IV të Brigadës së Drenicës. Për idealet e bashkimit kombëtar, në burgun famëkeq të Mitrovicës së Sremit vuajti 15 vjet (nga viti 1945 deri më 1961). Historinë e qëndresës e të idealit ai rrëfeu në librin "Kujtimet e mia", të publikuar në kohën kur s'mund të penalizohej për mendimet e shfaqura; Afërdita Halimi - Cernica, Raif Halimi - Cernica, *Veterani i luftës dhe i demokracisë në Kosovë*, Tiranë, 2000, f. 78.

[3] Ramadan J. Rexha, *Kujtimet e mija (dëshmi historike),* Prishtinë, 2004, f. 76.

[4] *ASHAK*, Gjykata e Qarkut, Gjilan, Pjesë nga Vendimi i sjellë në burg më 20 mars , 1946.

në burg, të angazhoheshin në anëtarësimin e dy e më shumë shokëve, por vazhdimisht duke pasur kujdes që të mos zbulohen nga ana e të burgosurve apo gardianëve të shumtë që qarkullonin në dhomat e shqiptarëve të burgosur. Njeriu nganjëherë, thjesht, ngel pa tekst kur dëgjon e lexon edhe për aktivitete të këtilla, kur dihej se në çfarë kushte kanë jetuar dhe vepruar këta atdhetarë. Por, dashuria dhe kujdesi ndaj njëri - tjetrit ishte më e madhe se sa rreziku që iu kanoste atyre. Andaj edhe u morë hapi tejet i guximshëm për formimin e grupit ilegal në qelit e burgut - ferr.

Më vonë, me organizimin e proceseve të shumta gjyqësore, që mbaheshin anë e kënd ku jetonin shqiptarët, ardhja e të burgosurve në burgun e Mitrovicës së Sremit, vjen duke u shtuar. Ata vinin grupe - grupe, anëtarët e NDSH-së e të tjerë që kishin reaguar hapur e fshehur ndaj riokupimit të Kosovës. Vinin nga Gjilani, Ferizaj, Prishtina, Suhareka, Mitrovica, Prizreni, Kaçaniku, Presheva dhe viset e tjera shqiptare”.[5] Me shtimin e numrit të shqiptarëve të burgosur, filloi të rritej edhe numri i të angazhuarve në grupin e formuar ilegalisht në burg. Nga një grup i vogël fillimisht, në të u anëtarësuan shumë atdhetarë të devotshëm. Më vonë nga grup i vogël i organizuar, doli propozimi që të shndërrohej në një komitet të ONDSH-së, të përbërë prej nëntë anëtarësh. Në mesin e anëtarëve të rinj të komitetit të NDSH-së në burg, ndodhej edhe patrioti i njohur nga Prizreni, Xhemil Fluku, i lindur më 1907. Është e ditur se qysh në moshën 15 vjeçare mori pjesë aktive në demonstratat e organizuara nga Haxhi Ymer Lutfi Paçarizi. Si anëtar i ONDSH-së, ishte zgjedhur kryetar i saj në Prizren. Gjatë procesit gjyqësor u dënua me 20 vjet burg. Anëtarë të këtij komiteti u zgjodhën edhe Destan Ismaili dhe Fahri Hasani, që treguan një aktivitet të madh atdhetar.

Qëllimi i formimit të komitetit të NDSH-së

Formimi i komitetit NDSH-së, në burgun e Mitrovicës së Sremit, për të burgosurit politikë shqiptarë kishte një rëndësi teje të madhe, jo vetëm për mbrojtjen dhe përkrahjen e të burgosurve shqiptarë në mes veti, por ishte edhe një grusht i rëndë për pushtetarët dhe personelin zyrtar të burgut të Mitrovicës së Sremit.

Torturat dhe presionet ndaj tyre ishin të vazhdueshme dhe shumë të rënda. Andaj, organizatorët e grupit pandehën se kjo do iu ndihmonte dukshëm atyre që më lehtë të përballonin trysnin nga gardianët dhe të tjerët. Në mënyrë të organizuar të mbrohen nga spiunët, apo siç i quanin

[5] Intervistë e Raif Cërnicës dhënë në verë të vitit 1995, Afërdita Halimit, Shqipëri.

ndryshe “cinkaroshët” që ishin të shumtë. Megjithëse, ndihma asnjëherë nuk kishte munguar në mes të burgosurve shqiptarë. Andaj, unitetit shqiptar në kazamatet serbe iu kishin lakmi të gjithë të burgosurit e tjerë të ish- Jugosllavisë.

Me zgjerimin e radhëve të grupit të NDSH-së në burgun e Mitrovicës së Sremit, ata tani në një mënyrë apo tjetër qenë të detyruar që të ndërronin vendimin e mëhershëm dhe të marrin një vendim më të avancuar për momentin. Grupi në fjalë, në përbërje të zgjeruar me anëtarët e rinj takohen në qershor të vitit 1947 dhe marrinë e sjellin një vendim të ri, të përbërë prej 6 pikave kryesore, të cilat janë: 1. Organizata për mbrojtjen e njëri - tjetrit, e formuar më 20 mars 1946 shndërrohet në komitet; 2. Komiteti do të ketë më shumë anëtarë; 3. Anëtarët e Komitetit do të kenë resorët dhe detyrat e caktuara; 4. Çdo anëtarë i komitetit do të ketë bërthamën e vet prej 3 - 4 anëtarësh; 5. Anëtarët e komitetit me betim do të marrinë si obligim detyrat paraprake të bërthamës nga organizata e mëparshme; dhe pika e gjashtë (6), fletë për zgjedhjen e komitetit në përbërjen e së cilës zgjidhen këta persona: kryetar i Komitetit zgjedhet Rrustem Statofci, për nënkryetar zgjedhet Destan Ismaili, sekretar i përgjithshëm i organizatës zgjedhet Ramadan Rexha, sekretar organizativ ishte zgjedhur Raif Halimi.[6]

Është me shumë interes të përmendët, se në burgun e Mitrovicës së Sremit në komitetin e ONDSH-së, funksiononte edhe resori për marrëdhëniet me pjesëtarët e kombësive të tjera që ishin aty. Për këtë resor, përgjegjës ishte caktua Fahri Hasani. Ndërsa, sektori tjetër po ashtu mjaft i rëndësishëm ishte sektori për informim. Këtë sektor për ta udhëhequr ishte caktua nga ana e Komitetit Ismet Boletini, nipi i patriotit të njohur, Isa Boletinit. Ky sektor shërbente për informimin e shpejtë e të drejtë të të burgosurve, ngase ndodhte shpesh të vinte te ndonjë padrejtësi, apo te ndonjë mosmarrëveshje te të burgosurit shqiptarë me të tjerët, andaj informimi i shpejt kishte të mirën e vet.

Në qelit e errëta të burgut, shqiptarët e burgosur që dinin shkrim - lexim ose ishin më të arsimuar, kishin marr për detyrë që personave që ishin analfabet, t’iu mësonin shkrim - leximin, bile së paku të dinin të shkruanin letra për familjarët. Andaj edhe e kishin paraparë që të funksiononte sektori për arsim, përgjegjës e kishin caktua Hilmi Ejupi që me profesion ishte mësues. Ky sektor sa veproi në burg u tregua shumë i suksesshëm, ngase shumë të burgosur filluan të shkruanin letrat për shtëpi pa ndihmën e askujt.

---

[6] *AKASH*, Fondi Gjykata e Qarkut në Gjilan, *“Vendimi”* i marrë nga anëtarët e Komitetit të NDSH-së në burgun e Mitrovicës së Sremit, qershor, 1947.

Propaganda në burg kishte ndikim të madh te të burgosurit. Ndodhte shpesh që në burg, të kishte edhe dezinformata, që tek të burgosurit e shumtë e të painformuar, shkaktonin panik e frikë të llahtarshme. Me formimin e resorit për propagandë, të cilën e udhëhiqte Ramadan Agushi, ndikoi dukshëm te të burgosurit dhe gjatë tërë veprimtarisë së vetë u tregua shumë aktiv, dhe që gati - gati asnjëherë nuk ra pre e saj.

Xhemil Fluku, ishte përgjegjës për shëndetësi dhe çështje sociale, ngase këtë sektor, anëtarët e komitetit e kishin paraparë si shumë të domosdoshëm, ngase niveli i mirëmbajtjes së dhomave të burgut dhe pastërtia ishin nën çdo nivel. Komiteti i NDSH-së sipas Ramadan Rexhës, "bazohej dhe mbështetej kryesisht në programin e NDSH-së, andaj edhe të gjithë anëtarët e komitetit e pranuan me kënaqësi".[7] Jeta e Komitetit qe e gjatë, aq sa qëndruan edhe të dënuarit në burg. Ajo asnjëherë nuk u zbulua dhe ndihmoi dukshëm në përmirësimin e jetës së të burgosurve shqiptarë që ndodheshin në burgun e Mitrovicës së Sremit.

Komiteti i ONDSH-së, festoi ditën e flamurit

Të burgosurit politikë shqiptarë pas marrjes së vendimit për themelimin e komitetit NDSH-së, jeta e tyre mori një kuptim tjetër. Shumë rrallë ndodhnin incidente në mes të burgosurve, kur, kryesisht "fajtor" dilnin të burgosurit shqiptarë. Organizimi i komitetit dhe funksionimi i resorëve në të, ishte për çdo lakmi, thënë lakmi, ngase ata vepronin në kushte të pa kushte, megjithatë vepronin dhe mbronin njëri - tjetrin nga të papriturat.

Vlen të përmendët, për jehonën e madhe që pati angazhimi i komitetit tek të burgosurit shqiptarë, për organizimin e manifestimit të 40 vjetorit të Ditës së Flamurit nga anëtarët e komitetit. Ishte 28 nëntori i vitit 1952, që anëtarët e komitetit kishin marrë përsipër që këtë ditë, në mënyrën më konspirative dhe më solemne ta festonin me shokët në burg. Për këtë rast angazhohet atdhetari i madh i Anamoravës, Ramadan Agushi që të mbaj një lloj ligjërate të shkurtër se si dhe kur u ngrit flamuri shqiptar. Kjo fjalë rasti veç që u lexua në dhomën 1/1 në katin e parë të pavijonit 1, ku merrnin pjesë mbi 20 - 30 veta.[8] Ajo u përcoll ashtu e shkruar dhe u lexua nga anëtarët e grupit prej dhome në dhomë.

Mund të përfundojmë se të burgosurit politikë shqiptarë, që vuajtën dënimin e burgut në Mitrovicë të Sremit, u përballuan me padrejtësi të

[7] Ramadan J. Rexha, *Kujtimet e mija (dëshmi historike)*, Prishtinë, 2004, f. 76.
[8] Ramadan J. Rexha*, Kujtimet e mija (dëshmi historike)*, Prishtinë, 2004, f. 77.

shumta që i kishte legjitimuar vet pushteti, por megjithatë ata ngelën deri në fund konsekuent në luftën e drejt për çlirimin e bashkimin kombëtar. Bile, disa nga ata dhanë jetën për qëllimin më suprem të kombit të vet.

Biografitë e disa atdhetarëve që formuan organizatën

1. Raif Ramiz Halimi (Cërrnica)

Atdhetari e patrioti i madh Raif (Ramiz) Halimi ishte i biri i Ramiz Cërrnicës. I lindur në fshatin Cërrnicë të Gjilanit (Anamoravë). Shkollën fillore e kishte mbarua në fshat ndërsa shkollën e mesme gjimnazin ishte regjistrua në Gjilan, por pas një kohe të shkurtër largohet nga aty për të vazhdua shkollimin në Gjermani (Hanover). Megjithatë, shpejt kthehet nga atje dhe regjistrohet në Shkollën Normale "Sami Frasheri" në Prishtinë, në klasën e dytë. Por Lufta e Dyte Botërore dhe ngjarjet që ndodhin në Anamoravë në veçanti e në rajon në përgjithësi, e detyronte që të ndërpres shkollimin dhe të përfshihet në lëvizjen antifashiste.

Në fillim të vitit 1945, fillon regjistrimi i vullnetarëve për të marrë pjesë në LNÇ. Po ashtu nga këta vullnetarë formohet edhe një batalion i të rinjve i ashtuquajturi Batalion i Rinisë. Pas formimit të batalionit, të rinjtë e Gjilanit nisen për Prishtinë dhe posa arrijnë aty, caktohet edhe kuadri komandues. Për komandant të Batalionit caktohet Isuf Ibrahimi, ndërsa për komisar të Batalioni caktohet Raif Halimi.[9]Ky Batalion vendoset në kazermat ushtarake të Prishtinës, dhe pas tri - katër ditë e vazhdon rrugën për Drenas, duke iu bashkangjitur Brigadës së Parë Sulmuese të Kosovës si batalion i katërt i kësaj brigade. Pastaj po e njëjta vazhdon rrugën për Istog, aty vendoset për një kohë më të gjatë.

Derisa ky batalion qëndronte në Istog, në ndërkohë fillon Lufta e Drenicës. Kështu që ishin të detyruar që të merrnin pjesë në këtë luftë. Por, duhet përmendur se lufta kundër forcave atdhetare nga kuadri komandues i batalionit të të rinjve ishte formal dhe nga aty filloi që ata të përcilleshin dhe të ishin në shënjestër të forcave jugosllave. Këtë Raif Halimi me shokë e kishte hetuar, andaj rreziku ishte i madhe po qe se ende do te qëndronin aty. Atyre nuk iu kishte mbetur rrugë tjetër veçse të dezertonin. Është për t'u habitur se si për një kohë të shkurtër të gjithë arrestohen.

Më 24 prill 1945, Gjykata Ushtarake e Prishtinës, para gjyqit i nxjerr 7 persona për t'i dënuar dhe shqiptuar vitet e burgut. Akuzoheshin për rezistencë të dobët ndaj armikut dhe dezertim nga trupat ushtarake. Gjykata

[9]*Po aty.*

Ushtarake e Prishtinës, iu shqipton këto dënime: dënim me vdekje iu shqiptua Jusuf Ibrahimit, Raif Halimit, Xheladin Xhaferi, Abdyl Hyseni dhe Shaban Cërrnica, por në ndërkohë, Raif Halimit dënimi me vdekje i falet dhe i shqiptojnë dënimin me 20 vjet burg. Dy të tjerëve iu shqiptohet dënimi me nga dy vjet burg. Është e ditur se për 20 vitet e shqiptuara Raif Halimi asnjëherë nuk ka shkruar ndonjë shkresë për t'u amnistuar edhe pse edukatorët e gardianët e këshillonin që të bënte një gjest të tillë.

Vështirësia më e madhe Raif Halimit i kishte ndodhur kur kishte kuptuar se edhe babai i tij ishte dënuar me 20 vjet burg dhe për fat të mirë mbi tri vite kishin qëndrua në një dhomë të burgut në Mitrovicë të Sremit, derisa gardianët e kishin kuptuar se çka ishin ata në mes veti.

2. Xhemil Fluku

Atdhetari Xhemil Fluku ishte i lindur më 1907[10], në qytetin e Prizrenit. Me profesion ishte zdrukthëtar. Në Lëvizjen Ilegale atdhetare ishte angazhuar më 1945, kur edhe u formua Organizata Nacional Demokratike Shqiptare. Idealet dhe qëllimet e Xhemilit përputheshin me programin e NDSH-së ngase qëllimi suprem i tij ishte bashkimi i Kosovës dhe viseve tjera që kishin ngelur jashtë të bashkoheshin me Shqipërinë, aty edhe ku e kishin vendin.

Xhemil Fluku i takonte organizatës ku numri i tyre ishte tejet i madh. Në verë të vitit 1945 zbulohet veprimtaria e Halim Spahis dhe e anëtarëve të tjerë, ku aderonte edhe vetë Xhemil Fluku, dhe për një kohë të shkurtër një grup i madh nga ata arrestohen. Procesi gjyqësor që u organizua në atë kohë përbehej prej 26 vetave. Nga ata, gjashtë veta u dënuan me pushkatim, ndërsa Xhemil Fluku dënohet me 10 vjet heqje lirie. Edhe më parë e kam cekur se personat që ishin mbi dhjet vjet të dënuar me burg, ata i dërgonin për të vuajtur dënimin jashtë Kosove, andaj Xhemil Fluku kishte përfunduar në burgun e Mitrovicës së Sremit.

3. Ramadan Agushi

Ramadan Musli Agushi u lind në fshatin Terpezë më 1922[11]. Me profesion ishte mësues. Ishte anëtar i NDSH-së. I takonte Komitetit Nacional Demokratik Shqiptar të Rrethit të Gjilanit. Ai gjatë veprimtarisë

[10] Sabile Keçmezi - Basha, *Të burgosurit politikë shqiptarë në burgjet jugosllave*, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2010, f. 355.
[11] *Po aty*, f. 275.

së vetë mbante kontakte dhe vepronte bashkë me Hamdi Berishen. Arrestohet më 21 tetor 1946. Në procesin gjyqësor të Gjilanit që u mbajt më 1 - 6 shkurt 1947, i shqiptohej dënimi prej 7 vitesh burg të rendë.

4. **Rrustem Muharrem Statovci**

Ishte i lindur në fshatin Batllavë më 1917[12], rrethi i Llapit, por me banim të përhershëm jetonte në Prishtinë. Punonte si nëpunës i Këshillit Popullor të Rrethit të Ferizajt. Me ndihmën e Hamdi Berishes dhe Lazer Josipit u anëtarësua në radhët e NDSH-së. Mori pjesë në shumë takime që u mbajtën në shtëpinë e Lazer Josipit. Rrustem Statovci me punën e vetë ndikoi dukshëm në zbulimin e bashkëpunëtorëve të UDB-së, dhe kishte ndikua dukshëm se si të ruhen nga udbashët që të mos zbulohen. Në fund të vitit 1946, zbulohen nga organet e UDB-së dhe i arrestojnë më 15 tetor 1946. Më 10 shkurt të vitit 1947 organizohet procesi gjyqësor të cilin e quajnë "Grupi i Hamdi Berishes". Rrustem Statovcit në këtë proces i shqiptohet dënimi me 20 vjet burg me punë të detyrueshme.

5. **Ismet Boletini**

Ismet Boletini ishte nipi i heroit tonë kombëtar, Isa Boletinit. Në fillim të vitit 1946, organet e pushtetit të instaluar në Kosovë Ismet Boletinin e kishin dënuar me 20 vite burg.[13] Gjatë kohës së mbajtjes së burgut, Ismeti njihej si një person i panënshtruar dhe deri në pikën e fundit i urrente servilët dhe njerëzit që ndërronin qëndrimet e tyre nga frika dhe nga premtimet e hetuesve.

Për Ismet Boletinin, shokët e burgut thonë se ishte një trim i paepur, duke u nisur nga kjo ai edhe kishte formua në burg "Grupin e posaçëm te të burgosurve shqiptarë". Në këtë grup bënin pjesë të burgosurit e rinj dhe që ishin të fuqishëm nga të burgosurit shqiptarë. Detyrë e tyre ishte që t'i ruanin dhe t'i mbronin të burgosurit shqiptarë nga kërcënimet, rreziqet e shantazhet e ndryshme që vinin nga personat e porositur nga organet e burgut. Për anëtarët e këtij grupi u caktuan të ishin: Ramadan Bogujevci nga Llapi, Rrustem Hoti nga Tutini, Bajram Hajdari nga Gllareva dhe Xhelosh Kola nga Gjakova.

Ismet Boletini dhe Maliq Sahiti gjatë qëndrimit në burg ishin përgjegjës për mbajtjen dhe pastërtinë e oborrit të burgut. Andaj edhe

[12] *Po aty*, f. 355.
[13] Ramadan Rexha, vep. e cit., f. 129.

kishin mundësi të komunikonin me shumë të burgosur politikë shqiptarë. Veç kësaj ata edhe iu ndihmonin duke iu dërguar cigare e fruta në qelit e tyre. Duhet përmendur se ndihmesë të madhe iu kishin dhënë: Kolë Mark Gjinit, Qazim Komonit, Shaqir Currit, Gani Beg Kryeziut, e shumë të tjerëve.

Për hir të mbrojtjes dhe dalur krah të burgosurve shqiptarë, Ismet Boletini mbi 270 ditë i kishte kalua në vetmi si dënim. Me rastin e një amnistie atij i heqin 12 vite burg dhe lirohet pas 8 viteve, më 1954.

6. Ramadan Rexha

Ramadan Rexha u lind më 11 mars të vitit 1921[14], në qytetin e Mitrovicës. Ai vinte nga një familje atdhetarësh dhe nuk ishte e rastësishme që të njëjtën rrugë e kishte vazhduar edhe i biri i tyre. Shkollën fillore (katërklasëshe) e kishte mbaruar në Mitrovicë. Ndërsa, në vitin shkollor 1935/36 ishte regjistruar në Medresenë e Madhe në Shkup, për të cilën kishte siguruar një bursë nga Vakëfit. Ramadan Rexha sa qëndroi në Shkup kishte rënë në sy si nxënës shumë i zoti dhe kishte rast të mirë që të njihet me shumë shokë që në vitet e mëvonshme bëjnë emër në Lëvizjen Ilegal shqiptare dhe në shkencë. Në Medrese ishte njohur me Adem Gllavicën, Idriz Ajetin, Omer Qerkezin, Ali Sokolin, Selami Hallaqin, Kadri Halimin e shumë të tjerë. Pas përfundimit të gjysmëmaturës, Ramadan Rexha punoi në shumë vende ku kontaktet e shpeshta me popullatën e vuajtur ndikuan që ai edhe më mirë ta njoh dhe t'i prekë për së afërmi padrejtësitë e shumta.

Ramadan Rexha u arrestua më 10 maj 1945, ndërsa Gjykata Ushtarake më 18 maj 1945, në Mitrovicë i kishte nxjerr para gjyqit duke i akuzuar se këta ishin kriminelë duke iu shqiptua dënime marramendëse. Në këtë proces "model", Ramadan Rexhës i shqiptohet dënimi prej 15 vitesh burg të rendë. Në vitin 1958, për hir të festave të nëntorit, Kuvendi Federativ i Jugosllavisë kishte bërë amnistinë e të dënuarve për delikte politike[15], sipas Kodit Penal të Jugosllavisë. Me këtë rast edhe Ramadan Rexha kishte përfitua nga amnistia duke iu falë vetëm një vit burg. Te burgosurit politike shqiptare edhe kur iu falte dënimi ndaj tyre pasonin shume peripeci. Kështu kishte ndodhur edhe me këtë rast, kur të amnistuarit nuk ishin fare të informuar për falje. Andaj ata në mënyrën më të vrazhdë i urdhëronin që të lëshonin burgun, e kush nuk pyeste për ta se a kishin mundësi që të

[14] Sabile Keçmezi - Basha, Vep. e cit., f. 288.
[15] Ramadan Rexha, Vep. e cit., f. 87.

udhëtonin. Më 30 nëntor 1958, Ramadan Rexha urdhërohet që ta lëshojë burgun.

Pas tri viteve (22 maj 1961), Ramadan Rexha përsëri është i arrestuar nga organet e ndjekjes por tani me një grup tjetër të të burgosurve. Ramadan Rexha u burgos me grupin e Kadri Halimit. Gjykimi i këtij grupi zgjati katër ditë nga 14 - 18 shtator 1961.[16] Në këtë proces Ramadan Rexhës iu shqiptua dënimi me 1 vit burg. Pas një kohe të kaluar në burg ai lirohet për t'u mbrojtur në liri. Megjithatë, Gjykata Supreme merr qëndrim që ai duhet patjetër që të mbajë burgun prej një viti. Në burg qëndroi deri më 18 nëntor 1962. Gjatë kohës së burgut, ai u shoqërua me Metush Krasniqin, Ramiz Cërrnicën, Enver Talin e shumë atdhetarë të tjerë.

[16] *Po aty*, f. 100.

Sabile KEQMEZI-BASHA

SUMMARY

THE ALBANIAN POLITICAL PRISONERS IN THE PRISON OF MITROVICA OF SREM AND THEIR ORGANIZATION IN 1946

After the invasion and annexation of Kosova in 1945, when Albania, Kosova and other Albanian territories were divided, the latter remained under the administration of Yugoslavia, with numerous issues still left unresolved. At the Assembly of Prizren, held from 8th to 10th of July in 1945, Kosova was officially annexed by Serbia. With the approval of the Resolution by the Federative Assembly on the 23rd of July 1945 and with the approval of the Resolution by the Serbian Assembly on the 1st of September 1945, the case of Kosova was considered closed. Even though during the National Liberation War numerous decisions and agreements were made in favor of the right for self - determination as requested by the majority of the population, these agreements were not respected, and in fact were brutally breached. In light of these developments, the agreements were dubbed treacherous whereas the individuals who signed them were called traitors to the people, and were later persecuted. During the long trials that were organized for the members of ONDSH, the judges would bring forth the hardest verdicts, including decade long imprisonment.

A majority of those found guilty were sent to the prison of Mitrovica of Srem. Thus it was natural that the meetings between the prisoners became more frequent, where they discussed the need to take concrete steps in further organizing their illegal activity. Even though the members of NDSH were imprisoned, they did not stop their patriotic activity even in the cold prison cells. After Raif Cërrnica was arrested and was sentenced to serve 20 years of prison, he was sent to the prison of Mitrovica of Srem. There his prisoner number was 10, which meant that he was one of the first few prisoners there. He was not the only one. Immediately after he was sent there, he came into contact with a lot of other Albanian prisoners who were sentenced for a long time to serve. The conditions in Yugoslav prisons were very bad. The prisoners were not only threatened by the guardians and the at the time Yugoslav regime, but they were threatened from prisoners as well. This came about when certain prisoners were paid to sabotage and bully the

Albanian prisoners. The risk was especially great from Chetniks who had been imprisoned and who “accidentally” were placed in the came cells with Albanians.

Hamit KABA

QËNDRIMI I POLITIKËS GREKE NDAJ KRIZËS SHQIPTARO - SOVJETIKE, 1960 - 1961

Në vitet 1953 - 1959 marrëdhëniet greko - shqiptare njohën disa zhvillime pozitive, të cilat u mundësuan falë përpjekjeve të dy palëve për mirëkuptim, por edhe ndikimit të procesit të Detantës, që kishte përfshirë marrëdhëniet Lindje - Perëndim dhe ndryshimeve që ndodhën në Bllokun Komunist, pas ardhjes së Hrushovit në krye të Bashkimit Sovjetik. Në procesin e afrimit greko - shqiptar luajtën rolin e ndërmjetësit organizma të tilla si: Kombet e Bashkuara, ambasadat sovjetike në Moskë e në Athinë dhe Ambasada franceze në Tiranë. Qeveria shqiptare mori iniciativën për përmirësimin dhe kapërcimin e ngërçit të krijuar në marrëdhëniet ndërmjet të dy vendeve. U paraqitën disa propozime nga të dyja palët, që kishin të bënin me rindërtimin e piramidave dhe shmangien e incidenteve kufitare, riatdhesimin e ushtarakëve e civilëve grekë të mbetur në Shqipëri nga konflikti civil në Greqi (1947 - 1949), pastrimin e kanalit të Korfuzit nga minat, tentativa për tregti të ndërsjellë, bashkëpunimin në luftën kundër epidemive në zonën kufitare, vendosjen e lidhjeve postare, etj.[1] Përmirësimi i marrëdhënieve greko - shqiptare nuk arriti të finalizohej me rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike, të ndërprera pas pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste në vitin 1939. Këto zhvillime arritën pikën më të lartë të tyre, kur e bë e mundur që të dy palët të kontaktonin direkt me njëra - tjetrën, sikurse ndodhi në New York dhe në Moskë. Tendenca ishte inkurajuese por rezultatet e arritura jo të plota. Prirja e Shqipërisë për një lloj hapjeje me Perëndimin, për marrëdhënie më të mira me fqinjët dhe sidomos hapat konkretë për të zgjidhur disa nga problemet e saj të

[1] *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AMPJ*), Viti 1959, Dosja 428, f. 17; Hamit Kaba, Ethem Çeku, *Shqipëria dhe Kosova në Arkivat Ruse,* (Prishtinë: Shtëpia Botuese Brezi 81, 2011), f. 203-204.

rëndësishme me Greqinë, u vlerësuan edhe nga Departamenti Amerikan i Shtetit, pavarësisht armiqësisë së pandryshuar të udhëheqjes komuniste ndaj Shteteve të Bashkuara dhe botës së lirë[2].

Duke filluar nga viti 1959, procesi i normalizimit të marrëdhënieve me Greqinë u ngadalësua derisa u ndërpre. Secila palë fajësonte tjetrën për ngecjen. Enver Hoxha fajësonte mbretin e Greqisë, i cili "rihapi fushatën e luftës së Ftohtë"[3] dhe ngriti sërish problemin e "Epirit të Veriut" në fjalimin e tij të mbajtur në Janinë, më 20 shkurt 1959. Pas vrasjes së një ushtari shqiptar në kufi, në prill 1960, ambasadori shqiptar në Moskë njoftoi kolegun e tij grek, se qeveria shqiptare i pezullonte të gjitha propozimet e saj, duke përfshirë edhe riatdhesimin e eshtrave të 23 oficerëve grekë, për të cilët ishte rënë dakord më parë. Pala greke fajësonte Shqipërinë se i kishte braktisur propozimet e mëparshme. Shkaqet kryesore që çuan në acarimin e marrëdhënieve shqiptaro - greke mund të kërkohen tek: pretendimet e Greqisë për të kushtëzuar vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me kërkesën për dhënien e autonomisë për Vorio Epirin; tek tentativat për të vendosur raketat amerikane në Greqi; tek rigjallërimi i incidenteve kufitare dhe i veprimtarisë së organizatave paramilitare greke, të cilat kërkonin bashkimin e Shqipërisë së Jugut me Greqinë; tek mungesa e besimit të udhëheqjes shqiptare ndaj udhëheqjes së BS dhe dyshimit se, kjo e fundit, përkrahte kërkesat e Greqisë; tek tërheqja e qeverisë shqiptare nga iniciativat e pranuara më parë prej saj, për bashkëpunim ballkanik dhe kthimin e këtij rajoni në një zonë të lirë nga armët atomike; tek retorika antigreke e antiperëndimore e Shqipërisë dhe dënimet e ashpra ndaj kundërshtarëve të saj brenda vendit, të etiketuar si agjentë të Greqisë, të Jugosllavisë, të SHBA-ve dhe Perëndimit në përgjithësi.

Konflikt interesash

Çarja sovjeto - shqiptare e viteve 1960 - 1961 krijoi situatë të re për Perëndimin dhe vendet fqinje të Shqipërisë: Greqinë, Jugosllavinë e Italinë, të njohura për pretendimet e hershme ndaj saj. Shqipëria, në të shkuarën, kishte qenë mollë sherri për fqinjët, politikat e të cilëve në disa raste kishin kompromentuar e komplikuar edhe marrëdhëniet

[2] *National Archive and Record Administration (NARA),* RG 59, Department of State, "Albania, Guidelines for Policy and Operations", Secret, February 1963, p. 6.
[3] *AMPJ,* viti 1959, dosja 428, "Raport mbi marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Greqisë që nga viti 1953 e deri në fund të vitit 1959", f. 17.

ndërmjet tyre. Kriza në marrëdhëniet shqiptaro-sovjetike dhe situata delikate që po kalonte Shqipëria në vitet 1960-61, do t'u lejonte vendeve fqinje të paraqitnin qëndrimet e tyre politike në kushtet e rrethanat e reja.

Italia dhe Jugosllavia e kishin pranuar krijimin e një Shqipërie sovrane dhe të pavarur, në kufijtë ekzistues.[4] Greqia, gjithashtu e kishte pranuar parimisht ekzistencën e një shteti shqiptar të pavarur, por pa njohur kufijtë e tij, për shkak të pretendimeve ndaj Epirit të Veriut, të cilat ajo ishte munduar t'i mbështeste në kritere historike, etnike, strategjike e ekonomike.[5] Greqia ishe mjaftë e ndjeshme ndaj zhvillimeve në Shqipëri, për shkak të pretendimeve të saj territoriale ndaj Shqipërisë, ekzistencës së minoritetit grek në këtë vend, presionit të ushtruar nga Shqipëria dhe vendet e tjera të Bllokut Komunist gjatë Luftës së Ftohtë përmes vijës së përbashkët kufitare. Konflikti i Bashkimi Sovjetik me Shqipërinë e bënte këtë të fundit një vend më të cenueshëm dhe më të dobët politikisht, ushtarakisht dhe ekonomikisht. Në fillim të krizës, kur Shqipëria e vogël ende nuk ishte ankoruar plotësisht pas Kinës komuniste, shpresat për një ndryshim të regjimit shqiptar ishin më të dukshme. Ndryshimi kërkohej nga shumë aktorë, sidomos jashtë vendit.

Të tre shtetet fqinje të Shqipërisë: Greqia, Italia e Jugosllavia e dëshironin rrëzimin e regjimit komunist të Shqipërisë, por asnjëra prej tyre nuk e pranonte dominimin e tjetrës. Trinomi i shteteve fqinje të Shqipërisë vëzhgonte jo vetëm zhvillimet e Shqipërisë, por edhe lëvizjet e njeri - tjetrit, duke u përpjekur që asnjeri të mos fitonte epërsi ndaj tjetrit. Kjo politikë kontribuonte padashje në ruajtjen e gjendjes ekzistuese në Shqipëri dhe të regjimit komunist në këtë vend. Zëvendësimi i qeverisë së Hoxhës me një "lolo" jugosllav apo sovjetik, nuk do të ishte i pranueshëm as për Italinë dhe as për Greqinë. Situata që po kalonte Shqipëria ishte një mundësi e mirë për t'u shfrytëzuar nga fqinji i saj jugor, Greqia e cila do të ngrinte më me forcë pretendimet tradicionale për "Epirin e Veriut" dhe kërkesat për përmirësimin e standardeve demokratike për minoritetin grek në Shqipëri. Duhet të përmendim se, qasja e politikës zyrtare dhe ajo e rretheve nacionaliste

[4]*Foreign Relations of United States* (*FRUS*), *Europe: political and economic developments* (in two parts), Volume IV, Part 2, 1951, pp. 1320, 1324.

[5]*NARA,Record of the U.S. Department of State relating Internal Affairs of Albania, 1960-1963*, Roll 1, File 767.00/21.12.1961, Royal Greek Embassy in Washington D.C. to Department of State, Secret, *Aide-Memoire*, December 21, 1961

greke brenda dhe jashtë vendit ndaj këtij problemi, ka të përbashkëta por edhe dallime të qarta. Qeveria greke ndoqi një politikë më realiste dhe më të matur ndaj Shqipërisë. Politika e saj u ndërtua duke pasur në konsideratë jo vetëm interesat kombëtare të vendit, por edhe ato të NATO-s dhe të grupimit të vendeve perëndimore, të udhëhequra nga SHBA-të. Deviza e SHBA-ve dhe e NATO-s, që e konsideronte Shqipërinë si faktor përçarës brenda bllokut komunist, si një "pykë" ndërmjet kinezëve dhe sovjetikëve, nuk do ta lejonte Greqinë që të përmbushte objektiva e saj tradicionale. SHBA shpalli dhe mbrojti politikën "duart larg"(hands off policy) nga Shqipëria, duke u bërë të qartë vendeve fqinje dhe sidomos Greqisë, se ajo nuk do t'i mbështeste kërkesat e saj territoriale për Shqipërinë e Jugut.

Jugosllavia: e dyshuara për ndërhyrje në Shqipëri

Gjatë periudhës së konfliktit shqiptaro - sovjetik, Italia, Greqia, Perëndimi, por edhe vet regjimi komunist në Shqipëri krijuan dyshime të shumta mbi Jugosllavinë, si shtet që mund të sillte ndryshimin e regjimit në Shqipëri, përmes ndonjë puçi të brendshëm apo ndonjë sulmi të armatosur nga jashtë, vetëm apo në bashkëpunim me Bashkimin Sovjetik. Jugosllavia e Titos konsiderohej si shteti më i motivuar për të ndryshuar në favor të saj situatën në Shqipëri, për shkak të ndarjes së keqe me udhëheqjen shqiptare në vitin 1948, ndikimit të saj në radhët e Partisë së Punës së Shqipërisë dhe duarve më të lira për të ndërmarrë ndonjë sulm të armatosur kundër Shqipërisë. Jugosllavia ndryshe nga fqinjët e tjerë nuk ishte e angazhuar në asnjërin prej dy organizmave më të mëdha ushtarake të kohës, NATO-në dhe Traktatin e Varshavës. Gjithashtu në Jugosllavi gjendeshin një numër relativisht i madh emigrantësh, të larguar nga Shqipëria pas prishjes së marrëdhënieve të saj me Jugosllavinë, të cilët mund të përdoreshin nga kjo e fundit. Por jashtë dyshimeve të udhëheqjes shqiptare nuk mbeteshin as edhe një pjesë e popullsisë shqiptare të Kosovës.

Por krahas rrethanave favorizuese ekzistonin edhe faktorë jofavorizues për të realizuar objektivat e supozuara nga Jugosllavia. As Greqia dhe as Italia nuk ishin dakord që në Shqipëri të vinte në pushtet një qeveri kukull, pro jugosllave. Një përpjekje për të shkatërruar nga brenda udhëheqjen shqiptare do të ishte po kështu e vështirë, sepse Hoxha po vazhdonte fushatën e spastrimeve brenda radhëve të PPSH-së, duke likuiduar kundërshtarët e tij realë dhe potencialë. Udhëheqja shqiptare e trajtoi konfliktin me Bashkimin Sovjetik si një sfidë

ndërmjet dy shteteve, jo thjesht si një konflikt personal për pushtet. Ajo rizgjoi nacionalizmin e fjetur të shqiptarëve dhe dyshimin e tyre të fortë se po rrezikohej pavarësia e Shqipërisë, duke aktivizuar ndjenjën e fortë të mbrojtjes së atdheut nga rreziku fqinj (veçanërisht ai grek), dhe ndjesinë për t'u përballur me Bashkimin Sovjetik, si sinonim i së keqes për kombin shqiptar. Kjo politikë e udhëheqjes komuniste bëri që, shumica e shqiptarëve të rreshtoheshin përkrah saj, pavarësisht nga privacionet dhe pakënaqësitë që kishin ndaj këtij regjimi të egër stalinist. Mundësitë e një sulmi jugosllav apo sovjetik mbi Shqipërinë, në rrethanat e Luftës së Ftohtë, ishin të pakta, duke pasur në konsideratë edhe reagimin e mundshëm të Perëndimit, prishjen e stabilitetit në rajonin e Ballkanit dhe të imazhit të Jugosllavisë, si një vend i paangazhuar. Në përgjithësi rrethanat e krijuara nga Lufta e Ftohtë nuk të lejonin të "kapërceje gardhin". Rasti i Revolucionit Hungarez të vitit 1956, që përfundoi me një banjë gjaku, pa arritur qëllimet e tij ishte ende i freskët.

Informacione më të shumta për Shqipërinë vinin nga burimet diplomatike italiane dhe franceze, të cilat e kishin origjinën nga Shqipëria. Më 16 maj 1961, ministri italian në Londër Prunas, i transmetonte Foreign Office dyshimet e qeverisë italiane, se sovjetikët me dijeninë e jugosllavëve, po përpunonin një plan për të eliminuar Enver Hoxhën nëpërmjet një atentati. Në këtë rast, Jugosllavia, sikurse edhe Greqia do të përfitonte një pjesë nga territori shqiptar.[6] Më 18 nëntor 1961 ministri i Jashtëm i Italisë, në takimin që zhvilloi me Sekretarin Amerikan të Shtetit, do të shprehej se ka thashetheme, ndoshta jo të besueshme se, sovjetikët kanë dhënë në heshtje aprovimin, për një sulm të mundshëm jugosllav kundër Shqipërisë" dhe, më tej shtonte "Italia mund të shikojë mundësinë e afrimit me Shqipërinë.[7] Këtë qëndrim do ta artikulonte qartazi delegacioni italian në NATO, gjatë një sesioni të tij në Venecia, në mars 1962. Ai do të këmbëngulte pranë Aleancës së Atlantikut të Veriut që, shtetet perëndimore të ndihmonin Shqipërinë, duke i lënë mënjanë mosmarrëveshjet e tyre me regjimin komunist dhe duke mos e identifikuar regjimin e Hoxhës me popullin shqiptar.[8] Qëndrimin deri diku të ndryshëm të politikës italiane ndaj Shqipërisë, krahasuar me atë të dy vendeve të tjera fqinje, do ta

[6] *The National Archives* (*TNA*), FO 371/160341, Evelyn Shuckeburgh to Central Department, May 16, 1961.
[7] *NARA*, File 767, Memorandum of Conversation, November 18, 1961.
[8] *NARA*, Owen Jones (Belgrade) to D.C., March 9, 1962.

nënvizonte edhe Enver Hoxha, sipas të cilit Italia ishte më pak e rrezikshme, më pak jo popullore dhe në të njëjtën kohë, më e afta për t'i siguruar ndihmë ekonomike.[9] Italia vazhdonte të ushqente dyshime lidhur me planet jugosllavo - sovjetike për rrëzimin e regjimit të Hoxhës edhe në vitin 1963, kur kriza shqiptaro - sovjetike kishte përfunduar.[10]

Për të mbështetur dyshimet e tyre italianët u referoheshin vështrimeve identike të Beogradit dhe Moskës ndaj çështjes shqiptare; vizitës së fundit të Dushan Mugoshës në Bashkimin Sovjetik; shtimit të numrit të shqiptarëve nga Kosova në ushtrinë jugosllave dhe vendosjen e tyre pranë kufijve shqiptaro - jugosllavë; kontakteve më të fundit të oficerëve të UDB me grupet e zgjedhura të refugjatëve shqiptarë në Belgjikë, në Francë etj. Sidoqoftë, vetë Ministria e Jashtme e Italisë nuk i konsideronte burimet e mësipërme të besueshme, por qëllimi i saj ishte që të tërhiqte vëmendjen e politikës amerikane, për të mos e nënvleftësuar rrezikun që mund të vinte nga planet e përbashkëta të Hrushovit dhe të Titos për të përmbysur udhëheqjen e tanishme në Shqipëri dhe për ta zëvendësuar atë me një tjetër pro tyre.

Edhe burimet diplomatike greke ishin gjithashtu një prurje e rëndësishme për krizën shqiptaro - sovjetike dhe qëndrimin e vendeve fqinje ndaj saj. Kreu i diplomacisë greke Averoff, në nëntor 1961 do t'i karakterizonte marrëdhëniet e Titos me Hrushovin si "flirt i rëndë, por që ende nuk kishin rënë në krevat"[11], ("heavy flirtation but would not get to bed"). Ai i kërkoi ambasadorit amerikan në Athinë, që t'i përcillte urgjentisht Departamentit të Shtetit shqetësimet e tij lidhur me planin jugosllav për largimin e detyruar të udhëheqësve kryesorë të Shqipërisë dhe zëvendësimin e tyre me një regjim të ri, të pranueshëm për Titon.[12] Është e vështirë t'u japësh përgjigje të qartë dyshimeve nëse ka ekzistuar vërtet një plan jugosllav apo sovjeto - jugosllav, për të përmbysur regjimin komunist në Shqipëri. Dokumentet amerikane, britanike, ruse, por edhe ato shqiptare, që kemi në dispozicion, sjellin të dhëna të pakonfirmuara dhe jo rrallë kontradiktore. Megjithatë, në dokumentacionin që disponojmë, nuk mungojnë dëshmitë për dëshirat e jugosllavëve, të cilët e konsideronin të mundshëm rrëzimin e Hoxhës.

[9] William E. Griffith, *Albania and the Sino-Soviet Rift,* (Cambridge, Massachusetts: M.I.T. PRESS, 1963), p. 169.
[10] *NARA,* File 767, A-1049, Julian P. Fromer-American First Secretary in Rome to D.C., January 22, 1963.
[11] *NARA*, File 76.00/11-1861, Briggs from Athens to Secretary of State, Nr. 648, November 18, 1961.
[12] Ibid.

Madje, për jugosllavët do të ishte më mirë të kishin një regjim shqiptar prosovjetik sesa prokinez. Ambasadori jugosllav në Bukuresht do t'i bënte të ditur një anëtari të misionit diplomatik francez se "qeveria e tij kishte bërë mjaft për pavarësinë e Shqipërisë". Më tej ai do të shtonte se "nuk është shumë vonë për ndarjen e Shqipërisë ndërmjet Greqisë dhe Jugosllavisë"[13]. Punisa Peroviç, anëtar i Komitetit Qendror të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë dhe njëherazi sekretar i Komitetit për Marrëdhënie me Jashtë në Asamblenë e Republikës Federative, nuk e mohonte mundësinë e një ndërhyrjeje sovjetike në Shqipëri, apo të një revolte brenda vendit të inspiruar e drejtuar nga sovjetikët. Por sipas tij, revolta do të ishte e pasuksesshme, sepse sovjetikët nuk kishin grupe apo personalitete brenda vendit që t'i mbështesnin. "Miqtë e sovjetikëve dhe tanët shprehej Peroviç, u kapën verën e shkuar dhe jugosllavët e dinë me siguri që konspiratorët e ekzekutuar majin e shkuar, po komplotonin në emër të BRSS".[14]

Diplomati jugosllav, Branko Karagjorgje, do të deklaronte në ambasadën sovjetike në Beograd, se nuk kishte pasur asnjë bisedim zyrtar dhe jozyrtar për arritjen e një marrëveshjeje sovjeto - jugosllave mbi Shqipërinë.[15] Sidoqoftë, të tjerë diplomatë jugosllavë, si këshilltari i ambasadës jugosllave në Washington, Ruziç, do të pranonin se sovjetikët ishin përpjekur të bënin kauzë të përbashkët me Jugosllavinë kundër Shqipërisë, por kjo e fundit i kishin refuzuar propozimet e tyre.[16] Ruziç pretendonte se Jugosllavia, sikurse edhe Greqia donte të ruante paqen dhe stabilitetin në Ballkan. Që të dy këto shtete ishin kundër ndërhyrjes së ndonjë shteti tjetër fqinj në Shqipëri, duke nënkuptuar këtu Italinë. Diplomati jugosllav do të nënvizonte se jugosllavët nuk ndanin të njëjtin mendim për shkallën e rrezikut që sillte prezenca e Kinës në Shqipëri. Për arsye të njohura, jugosllavët ishin kundër pranisë së kinezëve në Shqipëri, ndërsa politika greke ishte në të njëjtën frekuencë me politikën e Perëndimit për këtë çështje.

---

[13] *NARA*, Record of the U.S. Department of State relating to Internal Affairs of Albania, 19601963, Roll 1, "Memorandum of Conversation on Situation in Albania", July 11, 1961.

[14] Ibid, William D. Broderick - Second Secretary of American Embassy in Beograd to the Department of State, December 5, 1961.

[15] *NARA*, Record of the U.S. Department of State relating to Internal Affairs of Albania, 1960-1963, Roll 1, Ambassy Belgrade to Department of State, January 11, 1962.

[16] *NARA,* File 767, Memorandum of Conversation, February 2, 1962.

Dilemave mbi mundësitë apo pamundësinë e ndërmarrjes së ndonjë sulmi të armatosur kundër Shqipërisë nga Jugosllavia apo Bashkimi Sovjetik, do të përpiqej t'u jepte përgjigje ambasadori i sapoemëruar i SHBA-ve në Beograd, George F. Kennan.[17] Kennan hodhi bazat e politikës amerikane dhe të Perëndimit ndaj Shqipërisë në periudhën e konfliktit të saj me BS. Në nëntor 1961, në kulmin e krizës shqiptaro - sovjetike, por edhe më pas ai do të dërgonte disa raporte në Washington, duke nënvizuar se nuk ekzistonin dëshmi të mjaftueshme, që të provonin ekzistencën e ndonjë sulmi të mundshëm të Jugosllavisë apo Bashkimit Sovjetik kundër Shqipërisë. Kennan bënte të qartë se, jugosllavët i ndiqnin me vigjilencë të madhe zhvillimet në Shqipëri dhe e dëshironin rrëzimin e Hoxhës dhe zëvendësimin e tij me një regjim komunist pro jugosllav. Mjeti më i mirë për të realizuar ndryshimet në Shqipëri, sipas mendimit të tij, ishin intrigat dhe manipulimet brenda radhëve të Partisë së Punës së Shqipërisë. "Jugosllavët këtë çast, raportonte Kennan, nuk zotërojnë aftësi manovruese për të realizuar puçin nga brenda". ("Yugos do not at present dispose of capability of engineering internal putsch"), sepse Enver Hoxha, me politikën e egër të spastrimeve, kishte eliminuar pothuajse të gjithë elementët prosovjetikë apo projugosllavë nga udhëheqja shqiptare. Ambasadori amerikan nuk e përjashtonte ndërhyrjen ushtarake të jugosllavëve në Shqipëri, por nga ana tjetër nuk e konsideronte atë si mjetin më efikas për të përmbysur udhëheqjen shqiptare. Kenann paralajmëronte Perëndimin që të mos pritej një ndarje shpërthyese e Shqipërisë me Bllokun Komunist, sepse në këtë rast mund të ndodhte ndonjë ndërhyrje e armatosur e Jugosllavisë apo Bashkimit Sovjetik. Ambasadori amerikan në Beograd, sillte në vëmendjen e politikës amerikane, se Shqipëria çlirohej dhe bashkohej me kauzën perëndimore, por do të kishte rivalitete brenda anëtarëve të NATO-së[18], duke nënkuptuar këtu Greqinë dhe Italinë. Shqipëria, për Kennan, ishte një vend i fiksuar stalinist, i cili nuk ia vlente të ndihmohej nga Perëndimi. Nga fundi i nëntorit 1961 Kennan do të arrinte në përfundimin se, jugosllavët nuk ishin në gjendje të

[17]*NARA*, Record of Department of State relating Internal Affairs of Albania, 1960-1963, Roll 1, Kennan to Secretary of State, November 19, 1961; November 21, 1961; November 25, 1961; Në pranverë të vitit 1961 George F. Kennan u emërua nga Presidenti Kenedi ambasador i SHBAnë Jugosllavi (See; John Lewis Gaddis, *George F. Kennan: an American Life*, (New York: The Pinguin Press, 2011).

[18]*NARA*, Kennan form Belgrade to Secretary of State, November 21, 1961.

ndikonin mbi rrjedhën e ngjarjeve në Shqipëri, pavarësisht se nuk u pëlqente realiteti ekzistues.[19]

Në janar 1962, Kennan u thirr të raportonte në Komitetin për Marrëdhënie me Jashtë të Senatit Amerikan.[20] Ai nuk arriti të mbështeste me fakte të pakundërshtueshme variantin e një sulmi të mundshëm të Jugosllavisë mbi Shqipërinë, por as të provonte të kundërtën. Kennan do t'i bënte të ditur Komitetit se Titoja e kishte thirrur në zyrë dhe e kishte paralajmëruar se ishte kundër çdo ndërhyrjeje të perëndimit në Shqipëri. Në këto rrethana ambasadori i sugjeroi qeverisë amerikane të ndiqte politikën "duart larg" nga grindjet sovjeto - shqiptare. Sugjerimet e Kennan do të shërbenin si bazë e politikës amerikane për Shqipërinë, e cila do të formësohej gradualisht nga Departamenti i Shtetit.

Greqia dhe Italia: raporti mbi Shqipërinë që tensionoi dy shtete

Kriza shqiptaro - sovjetike shtoi nervozizmin edhe ndërmjet vetë fqinjëve të Shqipërisë. Më 15 dhjetor 1961, Beogradi ngriti sërish pas shumë vitesh problemin e pakicës sllave në Maqedoninë greke, duke shtuar tensionin në marrëdhëniet me Greqinë.[21]

Produkt i krizës shqiptare dhe i dyshimit për supermacinë që mund të fitonte "tjetri" në Shqipëri ishte edhe acarimi i marrëdhënieve greko-italiane në verën e vitit 1960. Tensionimi pati si fillesë një raport për Shqipërinë, të paraqitur nga Shtabi i Përgjithshëm Ushtrisë Italiane, në takimin e Aleancës së Atlantikut të Veriut, në Paris, më 2 maj 1960.[22] Raporti i tensionoi marrëdhëniet mes dy fqinjëve, pavarësisht nga pretendimet e Ambasadës italiane në Athinë, se ai ishte një dokument i pastër teknik, i cili nuk paraqiste pikëpamjen zyrtare italiane, qeveria e së cilës e kishte tërhequr atë, para protestës së autoriteteve greke[23]. Ai

[19] *NARA,* Kennan from Belgrade to Secretary of State, November 25, 1961.
[20] *AMPJ,* Dosja 477, viti 1962, fl. 6-8, (Referuar artikullit të autorëve Rober Allen dhe Paul Scott, të botuar në gazetën *Long Island Press*, January 24, 1962).
[21] *AMPJ,* Viti 1962, dos. 477, fl. 1-2; C.U. Sulzberger, *New York Times,* January 3, 1962; William E. Griffith, *Albania and the Sino-Soviet Rift,* (Massachusetts: The M.I.T. PRESS, Cambridge 1963), p.172
[22] NARA, File 767, American Embassy in Athens to D.C., "Italian Military Report to NATO on Albania", June 1, 1960; TNA, File FO 371/152817, British Embassy in Athens to Foreign Office, June 10, 1960.
[23] *NARA,* Record of the U.S. Department of State Relating to Internal Affairs of

shkaktoi reagime të forta brenda dhe jashtë Greqisë, duke u bërë objekt kritikash, debatesh të ashpra dhe demonstrimesh në disa qytete greke.

Ky dokument, sipas komenteve të ambasadorit britanik në Athinë, Roger Allen, ngatërronte "Epirin" me Shqipërinë, duke i konsideruar shumë qytete të këtij rajoni, si Prevezën, Pargën, Konicën, Janinën etj., si qytete me fizionomi shqiptare, të banuar nga toskët [shqiptarë]. Në materialin e paraqitur nga Shtabi italian i Mbrojtjes përmendej se, dy të tretat e popullsisë së Epirit ishin shqiptarë autoktonë, të cilët përbënin elementin më të mirë vendas; se vllaho - romanët ose kuco - vllahët e zonës së Pindit ruanin karakteristika të qarta amtare, pra ishin një popullsi me identitet të veçantë, jo grek, që mbanin lidhje të forta me vendin e origjinës; se suljotët[24] ishin në thelb shqiptarë dhe jo grekë; se kisha dhe priftërinjtë grekë u kishin mohuar elementëve shqiptarë nacionalitetin e tyre kudo ku ata banonin në Greqi, ndërsa klerikët grekë ishin të varfër intelektualisht. Raporti përmendte se, përveç kishës katolike, fetë e tjera në Shqipëri ishin përdorur si mjete për të privuar popullin shqiptar nga nacionaliteti i tyre; se pretendimet greke për Epirin e Veriut ishin në fakt pretendime territoriale për Shqipërinë e Jugut; se qeveria greke, për shkak të pretendimeve të saj ndaj Epirit të Veriut, i kishte refuzuar të gjitha ftesat e Kombeve të Bashkuara për të organizuar një Konferencë Ballkanike, etj.[25]

Raporti italian u bë objekt i një fushate të gjerë zyrtare dhe jo zyrtare brenda dhe jashtë Greqisë. Qeveria greke protestoi pranë Ambasadës italiane në Athinë, më 10 maj 1960, por heshtjen për publikun do ta thyente shtypi. Artikulli i parë u botua në anglisht në gazetën "Athens Daily Post-Sunday," më 29 maj 1960 nga Elias P. Demetracopoulos,[26] ndërsa më 30 maj një tjetër artikull u publikua në "The Times".[27] Në artikujt e botuar denoncoheshin "ëndrrat imperialiste italiane", duke mos pranuar faljen e palës italiane, por duke

Albania, 1960-1963, Roll 1, USRO/POL to Secretary of State/Washington, June 2, 1960

[24] Popullsi shqiptare kristiane e vendosur në kraninën e Sulit, e dalluar për shpirtin luftarak dhe rezistencën deri në vetëmohim ndaj trupave osmane përkrah kryengritësve grekë, në vitet e Revolucionit Grek për pavarësi.

[25] *TNA*, FO 371/152817, British Embassy in Athens to Foreign Office, No. 55, June 10, 1960. Duket se bëhet fjalë për propozimin e qeverisë rumune, për të mbajtur një takim të kryetarëve të qeverive të vendeve ballkanike, për zgjidhjen e çështjeve të diskutueshme dhe çarmatimin lokal, të propozuar nga Teodor Zhivkov.

[26] Elias P. Demetracopoulos, "Italian Govt's Report on Albania to shape completely inaccurate and damaging to Greece", *Athens Daily Post-Sunday*, May 29, 1960.

[27] "Greek anger at Italian report on Albania", *The Times*, May 30, 1960,

këmbëngulur që qeveria italiane të kërkonte falje publike dhe të dënonte autorin e raportit. Shkrime të mbushura me zemërim kundër politikës italiane të shoqëruara me thirrje të forta patriotike, do të botoheshin në disa gazeta brenda Greqisë, si e pavarura konservatore "Kathimerini", "Vima", "Eleftheria", etj. Vetëm gazeta e neo-komunistëve "Avghi" e injoroi botimin e këtij episodi. Në disa qytete të Greqisë veriperëndimore, si Janina, u organizuan demonstrata masive të banorëve, ndërsa në të gjithë vendin u organizuan protesta "për të provuar unitetin grek, kur integriteti i Atdheut sfidohet".[28] Indinjata greke ndaj raportit u reflektua gjithashtu me qëndrimin e zyrtarëve dhe gazetarëve grekë, të cilët e bojkotuan ftesën e ambasadës italiane në Athinë, në pritjen e dhënë me rastin e festës kombëtare të Italisë, më 2 qershor 1960. Bojkotin e mësipërm ambasadori britanik në Athinë do ta krahasonte me "ditën më të keqe të konfliktit të Qipros"[29], kur zyrtarët grekë refuzuan të vizitonin ambasadën britanike në Athinë.

Më 31 maj 1960, raporti italian u bë gjithashtu objekt i një debati të nxehtë dhe patetik, në një seancë të veçantë të Parlamentit grek, pas kërkesës së firmosur prej 12 deputetëve të rajonit të Epirit.[30] Në seancë ishin të pranishëm edhe zëvendës kryeministri i M. Kanelopulos dhe ministri i Jashtëm i Greqisë, M. Averoff. Në debat u përfshinë të gjithë krahët e politikës greke, të cilët dënuan italianët. Përfaqësuesi i ekstremit të majtë të E.D.A. z. Iliu (Iliou) do ta cilësonte raportin si "manifestim të freskët të imperializmit italian" dhe do të kritikonte qeverinë greke për "fshehje të veprimeve të dëmshme kundër Greqisë me qëllim që të ruanin unitetin e Aleancës Perëndimore".[31] M. Kanelopulos do të përgjigjej se, dokumenti nuk mund të bëhej publik, për shkak se ai konsiderohej sekret ushtarak, por shtonte se qeveria greke ishte shprehur kundër tij, duke shfrytëzuar kanalet diplomatike. Lideri liberal demokrat Papandreu, do ta cilësonte NATO-n si një "dyqan antik" ku gjithçka ishte kthyer përmbys mënyrë të çrregullt, dhe ku minimi reciprok ishte bërë rregulli i ditës.[32] Ministri i Jashtëm, Averoff, i drejtoi një protestë të fortë ambasadorit italian në Athinë, duke kërkuar prej tij shpjegime, lidhur me raportin e paraqitur nga

[28] *TNA*, FO 371/152817, British Embassy in Athens to F.O., June 3, 1960.
[29] Ibid.
[30] *NARA*, File 767. 00/6-160, American Embassy in Athens to D.C., "Italian Military Report to NATO on Albania", June 1, 1960.
[31] *TNA*, FO 371/152817, British Embassy in Athens to F.O., June 3, 1960.
[32] *NARA,* File 767, American Embassy in Athens to D.C., Italian Military Report to NATO on Albania, June 1, 1960.

përfaqësuesit ushtarakë të Italisë në NATO.[33] Ai do t'i dëshmonte ambasadorit britanik në Athinë, se "raporti italian kishte prekur edhe ndjenjat e tij personale, si një kucovllah, që i përkiste një minoriteti kombëtar mjaft të helenizuar në Greqi, ndërsa ai vetë ishte trashëgimtar i Jorgos Averoff, i cili kishte bërë vepra të mëdha bamirësie për shtetin grek".[34]

Ankesa u paraqitën edhe pranë ambasadave amerikane e britanike në Athinë. Për të zbutur qëndrimin grek dhe për të qartësuar pozicionin italian ndaj raportit të përmendur, më 1 qershor 1960 u organizua një takim i veçantë i Këshillit të Atlantikut të Veriut.[35] Përfaqësuesi italian M. Alessandrin-i u shpreh se raporti përmbante pasaktësi të paqëllimshme dhe se ai nuk përfaqësonte pikëpamjet zyrtare të Italisë. Pas diskutimeve të përfaqësuesit grek M. Melas dhe të drejtuesit të seancës M. Spaak, tensioni filloi të bjerë. Por duket se stuhia diplomatike greko - italiane u fashit përfundimisht pas takimit të ministrit të Jashtëm të Italisë Segni me ambasadorin grek në Romë më 3 qershor 1960, dhe faljes së kërkuar prej tij për incidentin e ndodhur.[36] Ministri italian do t'i shprehej ambasadorit grek se "qeveria italiane nuk kishte pasur kurrë asnjë qëllim që të lëndonte popullin grek dhe qeverinë greke, me të cilët Italia mbante dhe kishte si qëllim të ruante marrëdhënie shumë të ngrohta miqësie dhe aleance".[37]

Pas takimit me ministrin e Jashtëm grek, ambasadori britanik në Athinë do t'i përcillte Londrës rezultatet e takimit, të shoqëruara me komentet personale të tij. Ai shprehte keqardhjen për incidentin, duke e konsideruar atë të mbyllur zyrtarisht, ndërsa Averoff-in do ta cilësonte si "një dashnor të sinqertë të Italisë"[38] (Monsieur Averoff, who as sincere lover of Italy). Por, diplomati britanik mendonte se incidenti nuk mund të mbyllej kaq lehtë, sepse raporti i italianëve jo vetëm që largonte vëmendjen nga pretendimet e grekëve për Epirin e Veriut, por përsëriste të ashtuquajturit "fakte", mbi të cilat bazoheshin pretendimet italiane për Epirin e Jugut. Duke komentuar këmbënguljen e rretheve nacionaliste greke, edhe pasi Averoff e kishte deklaruar të mbyllur

[33] *TNA*, FO 371/152817, British Embassy in Athens to F.O., June 1, 1960.
[34] Ibid.
[35] *TNA*, FO 371/152817, United Kingdom Permanent Delegation to NATO (Paris) to Foreign Office, June 1, 1960.
[36] *TNA,* FO 371/152817, British Embassy in Athens to F.O., "Italian Military Report on Albania", June 10, 1960.
[37] Ibid.
[38] Ibid, p.5.

incidentin, ambasadori britanik në Athinë do të shprehej: "Grekët priren të humbasin tërësisht kuptimin e përmasave kur janë të eksituar, dhe ky dokument ishte gjëja më e mirë për t'i eksituar ata"[39] (Greeks do tend to lose all sense of proportion where they are exited, and nothing could have been better calculated to exite them than this document). Shpjegimet e dhëna nga ndonjë përfaqësues diplomatik italian, se raporti ishte produkt i disa oficerëve italianë, të cilët kishin shfrytëzuar disa dosje të paraluftës, pa u konsultuar me Ministrinë e Jashtme të Italisë, nuk i bindi diplomatët perëndimorë.[40] Nga vendet e Bllokut Komunist nuk pati ndonjë koment publik për këtë ngjarje, e cila u injorua plotësisht prej tyre.

Historia me raportin italian pati efekte negative në tri drejtime: së pari, shtoi dyshimet tradicionale greke në lidhje me seriozitetin dhe qëndrueshmërinë e miqësisë italiane; së dyti, u vu në diskutim efektshmëria e mekanizmave të NATO-së, që lejoi qarkullimin e raportit italian, dhe së fundi, e mbushi atmosferën greke me emocione nacionaliste për të ashtuquajturën çështje të Epirit të Veriut. Në disa rrethe politike greke qarkulluan dyshime se dokumenti origjinal grek mund të kishte qenë i influencuar nga qarqet komuniste apo fashiste në Itali. Ndaj raportit italian pati reagime të forta edhe nga Federata Pan-Epirote e Amerikës[41], Shoqata e Epirit të Veriut në Francë dhe Evropën Perëndimore, shoqata të ndryshme brenda Greqisë, kisha greke dhe qytetarë të zakonshëm me origjinë greke. Protestat e tyre iu adresuan sidomos Presidentit dhe Zëvendëspresidentit të Shteteve të Bashkuara, Sekretarit Amerikan të Shtetit, Departamentit të Shtetit etj.

Konflikti shqiptaro - sovjetik në sytë e grekëve

Thyerja shqiptaro - sovjetike e vendosi Shqipërinë përballë sfidave të rëndësishme të brendshme dhe të jashtme. Pozita ndërkombëtare e saj u dobësua më tej, ndërsa siguria kombëtare u bë më delikate, pas largimit të sovjetikëve nga baza ushtarake e Vlorës dhe refuzimit të BS që Shqipëria të merrte pjesë në takimet e Traktatit të Varshavës. Shqipëria, tani e tutje nuk do të ishte më një post i avancuar i Bllokut

[39] Ibid, p.6.
[40] *TNA*, FO 371/ 152818, June 1, 1960.
[41] *NARA*, Record of the U.S. Department of State Relating to Internal Affairs of Albania, 1960-1963, Roll 1, "Protest of Pan-Epirotic Federation of America to the President", June 7, 1960.

Komunist, i ndodhur në vijën e parë të përplasjeve Lindje - Perëndim. Kina komuniste, aleatja më e ngushtë e Shqipërisë, nuk ofronte garancitë e duhura për mbrojtjen e saj, për shkak të largësisë, teknologjisë së vjetruar dhe, mbi të gjitha, mungesës së gatishmërisë për të përfunduar një aleancë mbrojtjeje me Shqipërinë.[42] Pavarësisht nga propaganda e udhëheqjes komuniste të Shqipërisë, dokumentacioni që kemi në dorë, nuk na provon se Shqipëria ka qenë e rrezikuar ushtarakisht nga NATO, apo ndonjë vend tjetër perëndimor. Përkundrazi, si e kemi përmendur më sipër, dyshimet më të mëdha në kohën e konfliktit ranë mbi Jugosllavinë e Titos dhe Bashkimin Sovjetik.

Me shkallëzimin e krizës Bashkimi Sovjetik e shtoi qëndrimin kritik ndaj udhëheqjes komuniste të Shqipërisë dhe politikës së saj të jashtme, e cila u konsiderua prej tij si jo koherente, e paqëndrueshme, që nuk i shërbente procesit të normalizimit të marrëdhënieve të saj me Jugosllavinë e Greqinë dhe që nuk kontribuonte për uljen e tensioneve në Ballkan.[43] Kritikat sovjetike, në lidhje me marrëdhëniet shqiptaro - greke, u fokusua tek mungesa e përpjekjeve të udhëheqjes shqiptare për përmirësimin e tyre, tek retorika e saj e ashpër, jo vetëm kundër qarqeve drejtuese greke, por edhe kundër personaliteteve të opozitës, duke përfshirë Venizelosin dhe Partinë Komuniste greke, tek mungesa e përpjekjeve serioze për vendosur lidhje kulturore me forcat progresiste të Greqisë; tek lënia në mes të rrugës e iniciativave të mëparshme, të bëra nga udhëheqësit e BS, apo të vendeve socialiste të Ballkanit, lidhur me bashkëpunimin ballkanik dhe kthimin e këtij rajoni në një zonë të lirë, pa armë atomike dhe raketa, etj.

Kritikat sovjetike në mjedisin shqiptar u perceptuan si shenja të një qëndrimi të dyshimtë ndaj marrëdhënieve greko - shqiptare, si një trysni që i bëhej udhëheqjes komuniste të Shqipërisë për të pranuar kushtet e Greqisë.[44] Sekretari i parë i ambasadës sovjetike në Tiranë, Bespallov, i bënte të ditur Moskës, se korpusi i diplomatëve të huaj në Tiranë ishte në dijeni të iniciativës së Jugosllavisë dhe Greqisë, të cilat po

[42] *Arkivi Qëndor i Shtetit(më tej: AQSH)*, Fondi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, Marrëdhëniet me Partinë Komuniste të Kinës, Viti 1963, Dosja 7, Lista 15, f. 1-19.

[43] H.Kaba, E.Çeku, *Shqipëria dhe Kosova në Arkivat Ruse...,* f.251, "Informacion i ambasadës së BRSS në RPSH mbi marrëdhëniet e Shqipërisë me Jugosllavinë e Greqinë", korrik 1961.

[44] Beqir Meta, *Shqipëria dhe Greqia 1949-1990*, *Paqja e vështirë,* (Tiranë: Shtëpia Botuese Koçi, 2004), f. 164-165.

përgatiteshin të diskutonin në Kombet e Bashkuara ankesat e tyre për veprimet provokative të Shqipërisë në Ballkan.[45] Një formë tjetër presioni ishte edhe sugjerimi i ambasadorit sovjetik në Athinë, Sergejev, që Shqipëria të provonte se nuk ishte në gjendje lufte me Greqinë, duke paraqitur argumentet e veta për këtë çështje në Gjykatën e Hagës, në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, apo në ndonjë komision tjetër. Një propozim i tillë ishte përpjekje e maskuar, që Shqipëria të pranonte diskutimin e pretendimeve greke, duke qenë Moska iniciatore e tij[46].

Politika zyrtare greke: autonomi për Vorio Epirin

Rrethanat favorizuese që krijoi konflikti shqiptaro - sovjetik do të shfrytëzoheshin nga të gjitha kahjet e politikës greke: nga qeveria, organizatat nacionaliste brenda vendit, kleri vendas dhe organizatat e emigracionit në SHBA dhe në Evropën Perëndimore.

Më 31 tetor 1961, Palamas (drejtor i përgjithshëm në Ministrinë e Jashtme të Mbretërisë së Greqisë), do t'i bënte të njohura këshilltarit të ministrit amerikan në Athinë, Bennett, pikëpamjet e qeverisë së tij, në lidhje me zhvillimet në Shqipëri, dhe opinionin e saj ndaj politikës së SHBA.[47]Qeveria greke mendonte, se nuk ekzistonte përputhje e plotë ndërmjet pikëpamjeve amerikane e greke për Shqipërinë. Ajo kishte krijuar opinionin se amerikanët, po mbanin qëndrim indiferent ndaj Shqipërisë, dhe nuk po tregonin ndonjë interes të spikatur për regjimin e Hoxhës. Qeveria greke kërkonte nga SHBA angazhim më të madh në krizën shqiptare, dhe mbështetjen e saj për të mbajtur konstant rolin e Shqipërisë, si faktor përçarës brenda botës komuniste. Palamas do të theksonte, se qeveria e vendit të tij nuk tërhiqej nga Hoxha si person, por nga qëndrimi i tij opozitar me Moskën, gjë e cila ishte për t'u vlerësuar. Në këndvështrimin e qeverisë greke, mosbindja e udhëheqjes shqiptare ndaj Moskës, pavarësisht nga ngjyrimet ideologjike, e kishte bazën tek arsyet personale të saj. Palamas e karakterizonte Hoxhën si udhëheqës komunist që e drejtonte vendin e tij në mënyrë fisnore, nëpërmjet të afërmve të tij. Arsyet e prishjes me Moskën, për

[45] Ibid, p. 251.
[46] Ibid, pp. 164 - 165.
[47] *NARA*, Record of the Department of State relating to Internal Affairs of Albania, 1960-1963, Roll 1, *Memorandum of Conversation*, Participants: H.E. Christian Xanthopoulos-Palamas, Director General, Royal Ministry of Foreign Affairs, W. Tapley Bennett, Jr., Minister - Counselor, October 31, 1961.

politikanin grek, duheshin kërkuar tek pakënaqësia e shqiptarëve ndaj nivelit të ndihmave sovjetike dhe përmirësimit të marrëdhënieve sovjeto - jugosllave. Rrëzimi i regjimit të Hoxhës dhe zëvendësimi i tij me një "lolo sovjetik", nuk ishte i mirëpritur për politikën zyrtare greke, sepse mund të shoqërohej me rikthimin e BS në Shqipëri, dhe me rihapjen e bazës ushtarake të Vlorës. Palamas shprehu shqetësimin e qeverisë greke, lidhur me shtimin e interesit italian në Shqipëri, duke vënë në dukje se, nëse italianët do të arrinin sukses në përmbysjen e Hoxhës, Shqipëria mund të kthehej sërish drejt Moskës. Në këtë rast "Greqia do të preferonte Hoxhën".[48] Italianët, sipas Palamas, nuk kishin ndonjë "mirëkuptim të veçantë psikologjik" për situatën në Shqipëri. Sipas opinionit të tij, ndoshta, lidhja me francezët mund të kishte qenë e mirë, ndërsa zgjidhja më e mirë do të kishte qenë prania e britanikëve në Tiranë, sepse sipas diplomatit grek, këta të fundit, do të dinin si të vepronin në një situatë të tillë.[49] Por, britanikët nuk mund ta luanin këtë rol në Shqipëri, sepse ata nuk kishin përfaqësi diplomatike, dhe historikisht nuk ishin perceptuar nga shqiptarët si miq të tyre, por të grekëve.

Duke iu përgjigjur shqetësimit të qeverisë greke, në lidhje me politikën aktuale të Shteteve të Bashkuara ndaj Shqipërisë, sekretari amerikan i Shtetit, Dean Rusk, autorizoi ambasadorin amerikan në Athinë, Briggs, të informonte për këtë qëllim ministrin e Jashtëm grek Averoff .[50] Rusk e vlerësonte politikën zyrtare greke ndaj Shqipërisë, veçanërisht gatishmërinë e saj për të shqyrtuar në rrethana të përshtatshme zëvendësimin e Ligjit të Luftës me instrumente paqeje, dhe po kështu idenë për të vendosur marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë. Politika amerikane nuk ishte e painteresuar për situatën në Shqipëri, por tani për tani, ajo dukej delikate dhe fluide. Në rrethana të tilla, SHBA-të nuk mund të vepronin para kohe dhe të merrnin ndonjë iniciativë, që do të fshinte ndryshimet midis Pekinit e Moskës dhe t'i hiqte Shqipërisë frymën e mosbindjes. Në këtë kohë SHBA-të nuk parashikonin t'i jepnin Shqipërisë ndihmë ekomomike. Për qeverinë amerikane do të ishte më mirë që Perëndimi të mos merrte ndonjë iniciativë të parakohshme, por ta linte situatën të precipitonte. Rusk, mendonte se ishte e vështirë të parashikohej ndonjë lëvizje e Shqipërisë

[48] Ibid.
[49] Ibid.
[50] *NARA*, XR 867.00, Rusk to Briggs, November 16, 1961.

drejt Perëndimit.[51] Për sytë e Perëndimit dhe të SHBA-ve thyerja shqiptaro - ruse kishte ndryshime thelbësore nga ajo jugosllavo - sovjetike e vitit 1948, për arsye se në Shqipëri qeveriste një regjim dogmatik stalinist, armiqësor me botën demokratike perëndimore dhe veçanërisht me SHBA-të, me mundësi të pakta ndryshimi. Në krye të PPSH ishe Enver Hoxha, një komunist stalinist ortodoks, me formim ideologjik dhe doktrinar të një personi të pandreqshëm. Regjimi komunist në Shqipëri, ndryshe nga vendet e tjera të bllokut komunist ishte kundër politikave liberalizuese të Hurshovit. Shqipëria u lidh me Kinën, e cila në këtë periudhë ndiqte një politikë komuniste ekstreme ndaj Perëndimit, SHBA dhe Jugosllavisë.[52]

Pikëpamjet më të plota të qeverisë greke për Shqipërinë, iu bënë të njohura Ambasadës amerikane në Athinë, përmes memorandumeve të datave 14 dhe 21 dhjetor 1961.[53] Kryeministri grek, Karamanlis e vlerësonte plasaritjen e Shqipërisë me Moskën në këndvështrimin e sigurisë kombëtare të Greqisë dhe përgjegjësive të saj si një vend anëtar i NATO-së. Në të dy memorandumet me përmbajtje pothuajse identike, theksohej ndjeshmëria më e madhe e shtetit grek ndaj situatës në Shqipëri, se sa ajo e vendeve të tjera anëtare të NATO-së. Greqia e konsideronte problemin e kufijve greko - shqiptarë si pjesë të kufijve veriorë të saj, përmes të cilëve ishte ushtruar presion i fortë nga vendet komuniste, duke përfshirë edhe Shqipërinë. Çarja sovjeto - shqiptare ishte në favor të Perëndimit, jo vetëm sepse Blloku Komunist rrudhej me një anëtar tjetër, por edhe pse presioni i Bllokut do të ndjehej më pak, veçanërisht nga Greqia, një shtet kufitar me Shqipërinë. Politikanët grekë shpresonin që hendeku ndërmjet Moskës dhe Pekinit të zgjerohej më tej, dhe Shqipëria të vazhdonte të mbetej jashtë ndikimit të Bllokut Komunist. Mbështetur në dy memorandumet e mësipërme, politika e qeverisë greke ndaj Shqipërisë konturohet si më poshtë: *Së pari*, qeveria greke, si edhe më parë do të vazhdonte të konsultohej dhe të mbante të informuar Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për planet e saj të ardhshme mbi Shqipërinë. *Së dyti*, Greqia do të favorizonte ekzistencën e shtetit të pavarur shqiptar, duke preferuar një regjim demokratik në Shqipëri.

---

[51] Ibid.

[52] Hamit Kaba, "Konflikti Shqiptaro - Sovjetik dhe Sovjeto - Jugosllav në Sytë e Perëndimit", *Studime Historike*, nr.1-2, Tiranë 2008, f. 213-214.

[53] *NARA*, 767.00/12-1461, Briggs, (Athens) to Secretary of State, no. 737, December 14,1961; Philips Talbot to Mr. McGhee, "The Greek Aide Memoire on Albania", December 21, 1961.

Në rrethanat kur vendosja e një regjimi të tillë në Shqipëri dukej një mision i pamundur, politikës zyrtare greke nuk i mbetej veçse të vlerësonte qëndrimin e pavarur të Shqipërisë ndaj BS dhe vendeve të tjera të Bllokut Komunist, dhe të shfaqte gatishmërinë e saj për të pranuar regjimin e Hoxhës[54]. ("Greece willing accept fact of Hoxha rule"). *Së treti,* Mbajtja ende në fuqi e Ligjit të Gjendjes së Luftës me Shqipërinë, arsyetohej me moszgjidhjen e çështjes së Epirit të Veriut, një problem i mbetur pezull nga Këshilli i Ministrave të Jashtëm të katër Fuqive të Mëdha. Ndonëse e konsideronte "një çështje teorike" gjendjen e luftës ndërmjet dy vendeve, politika zyrtare greke kërkonte si këmbim paraprak për heqjen e saj, dhënien nga Shqipëria të autonomisë për "Epirin e Veriut", si dhe garantimin e të drejtave të banorëve grekë aty.[55] Kjo nuk do të thoshte se Greqia po hiqte dorë nga pretendimet territoriale ndaj Shqipërisë.

Kjo politikë fleksibile dhe afatshkurtër projektohej, duke pasur në konsideratë mungesën e kushteve për arritjen e objektivave afatgjata të saj. Sidoqoftë, qeveria greke shprehej se nuk do të merrte përsipër që të ndërmerrte e para iniciativën për normalizimin e marrëdhënieve me Shqipërinë. *Së katërti*, Greqia do të favorizonte dhënien e një farë ndihme ekonomike dhe politike për regjimin shqiptar, nëse ky i fundit do ta kërkonte. Por ndihma greke do të ishte e kufizuar, aq sa Shqipëria të mund të qëndronte në këmbë. Politika elastike e Greqisë, përveç shkaqeve të tjera lidhej edhe me konkurrencën italiane në Shqipëri. Greqia ishte e vendosur që të mos lejonte kthimin e Italisë në Ballkan. *Së pesti*, Qeveria greke dhe kryeministri i saj Karamanlis mbështesnin politikën amerikane "duart larg" (hands off policy) nga Shqipëria. *Së fundi*, Greqia nuk dëshironte të ndante me Italinë pikëpamjet e saj mbi Shqipërinë, për shkak të vështrimeve dhe interesave të ndryshme me të.

Organizatat joqeveritare: bashkim i Vorio Epirit me Greqinë

Situata e turbullt dhe delikate që po kalonte Shqipëria u shfrytëzua edhe nga organizatat e shumta greke brenda dhe jashtë vendit, të cilat iu kthyen më me forcë kërkesave të tyre tradicionale, që kishin të bënin me

[54] Ibid.

[55] *NARA*, Record of the U.S. Department of State Relating to Internal Affairs of Albania, 1960-1963, Roll 1, File 767.00, 21.12.1961, Phillips Talbot to Mr. McGhee, *Aide, Memoire* of Royal Greek Embassy in Washington. D. C.

të drejtat e minoritetit grek në Shqipëri, zgjidhjen e çështjes së "Epirit të Veriut" dhe bashkimin e tij me Greqinë. Mjaft aktive u tregua sidomos shoqatat e emigrantëve grekë në SHBA. Në qershor 1960, Federata Panepirote miratoi një rezolutë të veçantë për të hedhur poshtë raportin italian, të paraqitur në organizatën e NATO-së, duke theksuar negativitetin e tij për kombin grek, NATO-në dhe SHBA-të.[56]

Një tjetër kërkesë iu drejtua sekretarit amerikan të Shtetit Christian Herter nga Chris P. Levantes.[57] Përmes saj kërkohej ndihma e SHBA-ve për çlirimin e Vorio Epirit dhe bashkimi i tij me Greqinë. Në vazhdimësi të politikës amerikane, Departamenti i Shtetit në përgjigjen e vet, qartësonte pozitën e shtetit amerikan, duke u shprehur se për këtë çështje duhej pritur një kohë tjetër, duke vënë në balancë opinionet e secilës palë.[58] SHBA-ja sqaronte pozicionin e saj në lidhje me pretendimet territoriale të Greqisë ndaj Shqipërisë , duke theksuar ajo nuk kishte rënë dakord me ndonjë komb tjetër në lidhje me territorin apo kufijtë e Shqipërisë.[59]

Për qëndrimin e saj aktiv ndaj zgjidhjes së problemit të Vorio Epirit dhe të drejtave të minoritetit grek në Shqipëri u shqua sidomos, shoqata "Pyrrhus Benevolent Society", me qendër në New York.[60] Urdhri i Ahepa (Order of Ahepa) i qytetarëve amerikanë me orgjinë greke, në gusht 1961 miratoi një rezolutë të veçantë, në lidhje me kushtet e Epirit të Veriut, i cili iu dërgua edhe Sekretarit Amerikan të Shtetit, Dean Rusk (Din Rask).[61] Në rezolutë bëheshin përpjekje për të argumentuar shkencërisht pretendimet greke për këtë rajon, duke iu referuar karakterit historik e etnik të tij, madje duke shfrytëzuar edhe deklaratën e Hrushovit në mbështetje të autonomisë së Epirit të Veriut.[62] Rezoluta i

[56]*NARA*, 767.00/6-570, Resolution from Pan-Epirotic Federation of America from Elias Betzios to Richard M. Nixon Vice - President of the United States, June 15, 1960
[57]*NARA*, 767.00/9-2960, September 29th. 1960
[58]*NARA,* Reply of Harold C. Vadeler-Director, Office of Eastern European Affairs to Mr. Levantis, October 31, 1960
[59]*NARA*,767.022/10-2956, Internal Affairs of Albania 1960-1963, Roll 1, Edvard L.Freers-Director Office of Eastern European Affairs to Mr. Peppo, December 14, 1956; NARA, John S. Highland – Acting Assistant Secretary for Congressional Relations to Philip J. Philbin, House of Representative, October 31, 1961.
[59]*NARA,* Robert R. Schott to Mr. Istrou, July 29,1961; NARA, Record of the Department of State relating to Internal Affairs of Albania, 1960-1963, Memorandum of the United States Government, April 5, 1962.
[60]*NARA*, Robert R. Schott to Mr. Istrou, July 29,1961:
[61]*NARA*, 767.00/10-1861, Philip J. Philbin to Dean Rusk, October 18, 1961
[62] See: William E. Griffith, *Albania and the Sino-Soviet Rift*, (Massachusetts: The

sugjeronte Departamentit të Shtetit dhe Senatit, që të studionte kushtet, në të cilat gjendeshin grekët e këtij rajoni, dhe të zgjidhej problemi i tyre, duke çliruar dhe rivendosur të drejtat dhe privilegjet e banorëve të Epirit të Veriut. Gjithashtu, i tërhiqej vëmendja Sekretarit të Kombeve të Bashkuara, që të krijonin një Komitet për hetimin e kushteve, në të cilat jetonin grekët e këtij rajoni.[63]

Gjatë kësaj periudhe u shtua aktiviteti i organizatës së emigracionit grek në Francë. Kjo organizatë, që mbulonte edhe vendet e tjera të Evropës Perëndimore, i njohu drejtuesit e lartë të Evropës, me pretendimet dhe ankesat e saj me procesin e de-helenizimit arsimor, fetar dhe politik të Epirit të Veriut, që po ndodhte sipas saj në Shqipëri. Situata e krijuar gjykohej e përshtatshme për të zgjidhur një problem të mbetur pezull nga periudha e pasluftës së Dytë Botërore. Çlirimi i popullsisë së Vorio Epirit nga zgjedha komuniste konsiderohej si një akt në mbrojtje të civilizimit perëndimor, kundër vërshimit të orientit imperialist dhe pushtimit mongol. Si rrugëzgjidhje shihej vendosja e këtij rajoni nën kontrollin e Kombeve të Bashkuara.[64]

Këtij procesi ankesash iu bashkua edhe Sinodi i Shenjtë i Kishës Ortodokse Greke. Presidenti i tij Theoklitos, në tetor 1960 i dërgoi një telegram peshkopit të Canterbury, duke kërkuar prej tij mbështetje për çlirimin e Shqipërisë së Jugut, në frymën e besimit kristian.[65] Ministria e Jashtme britanike duke iu përgjigjur shqetësimit të peshkopit të Canterbury, shprehu opinionin se problemi i Epirit të Veriut ishte një çështje ende e pazgjidhur, ndërsa e konsideroi të drejtë mospërfshirjen e peshkopit anglez në një çështje politike.[66] Situata e krijuar pas Kongresit të XXII të PKBS dhe prishjes përfundimtare të marrëdhënieve shqiptaro - sovjetike në dhjetor 1961, e bënë edhe më të vështirë dhe më të izoluar se më parë Shqipërinë. Kjo fazë shënon një aktivizim më të madh të organizatave nacionaliste greke, veçanërisht brenda vendit.[67] Në një mbledhje të zgjeruar të KEVA-së në shtator 1961 në Athinë, përfaqësuesi i Sillogut Panepirot të SHBA-ve, Vasilis Fotos, premtoi akordim fondesh financiare nga emigracioni në SHBA

M.I.T. Press, Cambridge, 1963), p. 40.
[63] *NARA*, 767.00/10-1861, October 18, 1961.
[64] *TNA*, FO 371/152818, May 1960.
[65] Ibid, October 26, 1960.
[66] Ibid, November 2, 1960.
[67] Autori i këtij artikulli do të kishte dashur të kishte në dispozicion burimet dokumentare greke për këtë çështje, të cilat, për fat të keq ai nuk mundi t'i siguronte.

për zhvillimin e aksioneve subversive ndaj Shqipërisë.[68] U formua Shoqata e Vullnetarëve Rezervë Vorio Epirotë dhe Këshilli Ushtarak me të njëjtin emër, të cilët koordinuan veprimtarinë me KEVA dhe EAVI, organizatë e rinisë Vorio Epirote. Këto organizata tërhoqën minoritarë greke, të arratisur nga Shqipëria pas LDB-së, ose para përfundimit të saj.[69] Në festën e 25 marsit, Sillogu i Janinës, shpërndau trakte, të cilat bënin thirrje për organizimin e kryengritjes së armatosur në Shqipëri.[70]

Në këtë periudhë u bë më intensive veprimtaria e organizatave të ndryshme të emigracionit grek në SHBA, si dhe e disa figura të njohura të botës politike e publike amerikane, të nxitura e mbështetura nga lobi grek në këtë vend. Presidenti i Komitetit të Marrëdhënieve me Jashtë të Senatit të Shteteve të Bashkuara, J.W. Fulbright, në maj 1962 i përcolli Dean Rusk, një kopje të letrës, që i ishte dërguar atij nga presidenti i shoqatës "Pyrros Beevolent Society", me qendër në New York. Ai e njohu diplomatin amerikan me ankesat e saj, për kushtet e vështira në të cilat gjendeshin disa prej familjeve të minoritarëve grekë në Shqipëri.[71]

Në përgjigje të letrës së përcjellë nga Fulbright, Departamenti i Shtetit do të sqaronte, se politika amerikane e nxiste dhe mbështeste bashkimin e familjeve të ndara në të dy anët e Adriatikut. Por, nga ana tjetër, ajo nënvizonte pamundësinë e saj, për të ndikuar mbi regjimin komunist në Shqipëri, sepse ndërmjet dy vendeve nuk kishte marrëdhënie diplomatike, dhe as ndonjë vend të tretë, i cili do të përfaqësonte interesat amerikane në Shqipëri. Ndërmjet dy vendeve ende nuk kishte ndonjë kanal komunikimi që do të lehtësonte procesin e vështirë të afrimit shqiptaro - amerikan.[72] Në shkurt 1962 "Federata Panepirote e Amerikës" miratoi një rezolutë të posaçme, për gjendjen e popullsisë vorioepirote në Shqipëri, të shoqëruar me kërkesën për bashkimin e këtij rajoni me Greqinë.[73] Rezoluta e konsideronte të favorshme situatën, sepse ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik ekzistonin divergjenca të forta të karakterit politik e ideologjik, ndërsa

[68] B. Meta, *Shqipëria dhe Greqia ..,* f. 171.
[69] *Po aty.*
[70] *AMPJ,* Viti 1962, dosja 728, fl. 29.
[71] *NARA*, 767.00/5-1862, J.W.Fulbright to Secretary of State (Dean Rusk), May 18, 1962.
[72] *NARA*, 767.00/5-1862, Frederick G. Dutton (Assistant Secretary) to Senator Fulbright, May 28, 1962.
[73] *NARA*, Resolution of Panepirotic Federation of America, New York, February 25, 1962.

situata brenda vendit mund të precipitonte në ndonjë kryengritje të brendshme, e cila mund të kërcënonte edhe demokracitë perëndimore. Rezoluta theksonte se Greqia, si shtet aleat i besuar i Perëndimit e meritonte të mbështetej në kërkesat e saj për bashkimin e Shqipërisë së Jugut me Greqinë. Shoqata e greko - amerikanëve shprehte kundërshtimin e hapur, ndaj hapave që mund të ndërmerrte qeveria amerikane në lidhje me rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë, duke vënë si kusht zgjidhjen paraprake të çështjes së Epirit të Veriut.

Më 22 qershor 1962, Constantine Stavropoulos në emër të shoqatës "Pyrrhus Benevolent Society" në New York, iu drejtua sërish sekretarit të shteti Dean Rusk, për problemin e Vorio Epirit.[74] Dokumenti përmban kritika të forta për politikën e ndjekur nga Britania e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara, në lidhje me Shqipërinë, që nga krijimi i shtetit të pavarur shqiptar, politikë e cila nuk e kishte favorizuar bashkimin e Shqipërisë së Jugut me Greqinë. Britania e Madhe fajësohej se kishte ndjekur politikën përça e sundo (devide and conquer) në Ballkan. Ajo nuk i kishte zgjidhur pretendimet greke as në Konferencën e Londrës të vitit 1913, dhe as më pas, ndërsa kishte miratuar në heshtje pushtimin e Shqipërisë nga Italia në vitin 1939. SHBA, bëheshin përgjegjëse për politikën e ndjekur prej tyre pas Luftë së Dytë Botërore, e veçanërisht në vitet 1947 - 1949.

Politika amerikane fajësohej se nuk i kishte lejuar forcat e armatosura greke të pushtonin Shqipërinë në vitin 1949. Në këtë dokument pretendohet, se ndërmjet Ministrisë së Luftës dhe Departamentit të Shtetit kishte pasur mosmarrëveshje për zgjidhjen e pretendimeve greke ndaj Shqipërisë. Ndërsa, Ministria e Luftës kishte qenë dakord me kërkesat e epirotëve, që trupat greke të avanconin në brendësi të territorit shqiptar, kishte qenë Departamenti i Shtetit ai, i cili i kishte ndaluar grekët të realizonin planin e tyre. Gjithashtu, politika amerikane bëhej fajtore, sepse në dimrin e vitit 1940 - 1941, kishte ndalur përparimin e trupave ushtarake greke në ndjekje të ushtrisë italiane në zonën e Tepelenës. Shoqata e emigrantëve greke ishte kundër disa thashetheme që qarkullonin në SHBA, se gjoja Departamenti i Shtetit do të lejonte Gjermaninë Perëndimore që të ndihmonte regjimin e Hoxhës, me qëllim që ta tërhiqte atë drejt demokracive perëndimore. Ky version, sipas dokumentit nuk mund të arrihej me mjete paqësore,

[74] *NARA*, 767.00/6-2262, Constantine Stavropoulos to Dean Rusk, June 22, 1962.

sepse nuk do pranohej nga E. Hoxha. Gjithashtu, ky plan nuk vlente për vorioepirotët, sepse nuk lejonte bashkimin e tyre me Greqinë[75].

Në dokument arrihet në përfundimin se "tani, është koha e përshtatshme për të rrëzuar regjimin komunist në Shqipëri dhe për bashkimin e Vorio Epirit me atdheun mëmë - Greqinë".[76] Dokumentet që njohim nuk provojnë që t'i jetë ngarkuar Gjermanisë Perëndimore një mision i tillë. Gjermania Perëndimore nuk kishte marrëdhënie diplomatike me Shqipërinë, ndërsa kjo e fundit kishte pretendime të forta ndaj saj, për dëmshpërblimet e pashlyera të Luftës së Dytë Botërore. Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk ndërmorën hapa konkrete për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë, përveç disa sondazheve që nuk rezultuan të suksesshme, sepse udhëheqja komuniste e Shqipërisë vazhdoi politikën e saj antiamerikane dhe nuk pranoi të merrte ajo e para iniciativën.

Pas rezolutave, memorandumeve e kontakteve të shpeshta të greko - amerikanëve me zyrtarëve të lartë të Kongresit, Departamentit të Shtetit dhe figurave të tjera të shquara të SHBA, si dhe aktivitetit në rritje të shoqatave greke brenda vendit, qeveria amerikane do të shprehej qartazi dhe me vendosmëri për politikën e saj ndaj Shqipërisë dhe pretendimeve greke për Shqipërinë e Jugut. "The United States does not support any Greek territorial claims against Albania, and disapprove of the paramiltary operations angainst Albania, sponsored by the North Epirus Committee in Greece. The United States group may be unaware of some of these activities by its parent organization in Greece. Official U.S. support, however indirect, of the Greek Committee's activities is not in line with existing U.S. policy".[77] "Shtetet e Bashkuara nuk i mbështesin pretendimet territoriale greke kundër Shqipërisë dhe nuk aprovojnë operacionet paraushtarake kundër saj, të sponsorizuara nga Komiteti i Epirit të Veriut në Greqi. Grupi i Shteteve të Bashkuara mund të jetë i pandërgjegjësuar për disa nga këto aktivitete [të kryera] nga organizata e të parëve të tyre në Greqi. Mbështetja zyrtare e Shteteve të Bashkuara për aktivitetet e Komitetit Grek, ndonëse indirekt, nuk është në të njëjtën linjë me politikën ekzistuese amerikane". Deklarata e hapur dhe e fortë e qeverisë amerikane u bë në një kohë kur rrethet dhe organizatat

[75] Ibid.
[76] Ibid.
[77] *NARA,* Record of the Department of State relating to Internal Affairs of Albania, 1960-1963, Memorandum of the United States Government, "*North Epirote Irredentist Activities"*, April 5, 1962.

e ndryshme të emigracionit grek në SHBA kishin zhvilluar aktivitete të shumta në mbështetje të kauzës greke për Vorio Epirin, duke përdorur edhe lobimin në Departamentin e Shtetit dhe në Kongresin Amerikan. Në qendër të kritikës vendosej me të drejtë Komiteti për Epirin e Veriut, i cili ishte gjeneratori që ushqente veprimtarinë e nacionalistëve greke, brenda dhe jashtë vendit, dhe organizonte aksionet e forcave paramilitare greke.

Politika amerikane e shihte Shqipërinë si faktor përçarës brenda Bllokut Komunist dhe veçanërisht brenda binomit BS-Kinë. SHBA u munduan të ruanin prirjen gërryese të Shqipërisë edhe në vitet në vazhdim. Deviza e saj e njohur tashmë "lart duart nga Shqipëria", ishte një sinjal i qartë për vendet fqinje të Shqipërisë, dhe veçanërisht për disa rrethe politike greke. SHBA-të nxitën dhe mbështetën idenë për të pasur marrëdhënie më të mira ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve fqinje të saj, duke ndërmarrë hapa konkrete për zgjidhjen e disa prej ndryshimeve të njohura ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë.[78]

[78] *NARA*, RG 59, Department of State, *Albania, Guidelines for Policy and Operations*, February 1963, p. 6.

Hamit KABA

SUMMARY

THE GREEK POLICIES IN REGARD TO THE ALBANIAN-SOVIET CRISIS OF 1960-1961

The Albanian-Sovietic conflict at the beginning of the 60's created a significantly delicate situation in regards to Albania's national security. The conflict gained in particular the attention of neighbouring countries. Yugoslavia, Greece and Italiy rewrote their policies in relation to Albania, which policies were based on their national interests as well as their position in the arsenal of international policy. They reconfirmed that they recognize Albania's independence, however the Greek government requested for Albania to recognize the independence of the Greek minority in Southern Albania, whereas Greek nationalist organizations operating both within and outside of Albania's borders requested for Southern Albania to be united with Greece.

The three neighbouring countries were against the communist regime in Albania, however neither of them would accept the others' political dominance in Albania. In order to maintain this equilibrum, their policies somewhat contributed in preserving the communist regime in Albania. The Italian and Greek stance towards Albania was strongly influenced by NATO and the U.S.A, by supporting the policy of respecting Albania's national and territorial integrity. Above all, they acknowledged Albania's function as a disruptive factor within the Communist Block and in particular its function in the Chinese-Sovietic conflict

From all the three Ballkanic states, Yugoslavia was the most interested one in replacing the existing regime with a puppet governmet controlled by Yugoslavia. However, the existing documents neither prove or disprove that Yugoslavia had any plans to initiate an armed attack against Albania, as Greece, Italy and even the Albanian communist regime suspected.

Sabit SYLA

BASHKËPUNIMI KOSOVË - SHQIPËRI*
Shkëmbimet arsimore, kulturore dhe shkencore ndërmjet shtetit shqiptar dhe Kosovës, 1970 - 1980

Vitet ‘70 të shek. XX, karakterizohen nga shkëmbimet arsimore, kulturore e shkencore ndërmjet shtetit shqiptar dhe Kosovës. Përmirësimi i marrëdhënieve të Shqipërisë me Kosovën duhet parë i lidhur ngushtë me zhvillimet ndërkombëtare, me luftën e brendshme të klaneve në Jugosllavi dhe përpjekjeve të Titos për të krijuar balanca brenda vendit, me rritjen e ndërgjegjësimit të shqiptarëve në Kosovë dhe me shtimin e kërkesave të tyre për më shumë të drejta kombëtare dhe institucione të lira nga Serbia, si dhe me shtimin e interesit të shtetit shqiptar për të përmirësuar marrëdhëniet me Jugosllavinë, veçanërisht me popullsinë shqiptare në Jugosllavi. Në fillim të viteve shtatëdhjetë u bë e mundur të vendoseshin kontakte direkte ndërmjet shtetit shqiptar dhe Kosovës. Ky fenomen po ndodhte për herë të parë që nga mbarimi i Luftës së Dytë Botërore. Deri në këtë kohë marrëdhëniet ishin zhvilluar brenda kuadrit të Federatës Jugosllave apo Republikës së Serbisë, pjesë e së cilës ishte edhe Kosova. Pas përmirësimit të marrëdhënieve shqiptaro - jugosllave u krijuan premisa për të pasur marrëdhënie të drejtpërdrejta ndërmjet shtetit shqiptar dhe Kosovës. Duke pasur në konsideratë faktin që të dy vendet pavarësisht nga afrimet e çastit kishin diferenca të rëndësishme në sistemet qeverisëse, për shqiptarët e Kosovës marrëdhëniet do të kishin intensitet në fushën kulturore, arsimore, shkencore dhe në sferat e tjera të jetës politike dhe ekonomike.

Sinjalin për ndjekjen e një politike afrimi me Jugosllavinë do ta jepte kreu i PPSH-së, Enver Hoxha në vizitat që bëri në pranverë të vitit 1970 në rrethet Kukës e Tropojë. Fjalimi i Hoxhës do të pasohej nga një periudhë përmirësimi në marrëdhëniet shqiptaro - jugosllave. Pas atyre fjalimeve do të shtoheshin kontaktet me Kosovën dhe në përgjithësi do

të përmirësoheshin marrëdhëniet shqiptaro - jugosllave. Me gjithë uljen e ritmit të propagandës e kundër propagandës, ajo nuk u ndal nga udhëheqjet e të dy vendeve. Ndër përfituesit më të mëdhenj të kësaj "paqeje" të përkohshme ishin shqiptarët e Kosovës. Përfitime dhe zhvillime të veçanta u shënuan në fushën e kulturës e arsimit dhe në rritjen e ndërgjegjes kombëtare të shqiptarëve në ish-Jugosllavi.

Përveç gatishmërisë së Tiranës për marrëdhënie të fqinjësisë së mirë edhe kryetari i Jugosllavisë Tito në Ulqin, kishte shprehur një interesim të tillë me gjithë kundërthëniet që ekzistonin në mes dy vendeve. Si rezultat i këtij afrimi, më 5 shkurt 1971, Qeveria e Shqipërisë dhe ajo e Jugosllavisë ranë dakord të ngrenë nivelin e përfaqësimit të tyre diplomatik në rang ambasade dhe të shkëmbejnë ambasadorët e tyre.[1] Përmirësimi i marrëdhënieve shqiptaro - jugosllave ishte rrjedhojë e disa faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Secila palë donte të përfitonte nga kjo situatë. Për shtetin shqiptar ato shiheshin si një mundësi më e mirë për të ndikuar dhe ndihmuar shqiptarët e Kosovës dhe të viseve të tjera dhe për të siguruar "krahët" nga ndonjë rrezik i mundshëm që mund t'i vinte vendit nga Bashkimi Sovjetik. Në fakt, fillet për ndihmë mësimore e kulturore ndaj shqiptarëve të Kosovës i takojnë fund viteve '60-ta. Me iniciativën e Universitetit të Prishtinës, më 1967 një delegacion i fakulteteve të Prishtinës i bëri vizitë Universitetit të Tiranës dhe në vitin 1968 (9 - 11 maj), një delegacion i punonjësve shkencor nga Universiteti i Tiranës mori pjesë në Simpoziumin e organizuar në Prishtinë, në shenjë përkujtimi të 500 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut. Në këto kontakte u zhvilluan bisedimet lidhur me mundësitë e bashkëpunimit midis fakulteteve të Prishtinës dhe Universitetit të Tiranës, duke u shprehur gatishmëria e të dy palëve për bashkëpunim[2], që në vitet '70-ta, u kurorëzua me nënshkrimin e Marrëveshjeve dhe Protokolleve të Bashkëpunimit. Në qershor të vitit 1968, u arrit një marrëveshje legale midis "Arteksportit"

---

* Kumtesë paraqitur në Kollokuiumin Shkencor "Sfidat e Shtet ndërtimit dhe e ardhmja e Republikës së Kosovës", organizuar nga Seksioni i Shkencave Shoqërore i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Prishtinë, më 15 qershor 2011.

[1] *Agjencioni Shtetëror i Arkivave të Kosovës* (më tej: *ASHAK*), Fondi: Sekretariati Krahinor për marrëdhënie me botën e jashtme, viti 1979 - 1988, Numri i lëndës 36, Kutia 3, f. 1; Marrëdhëniet midis RSF të Jugosllavisë dhe të RP të Shqipërisë dhe pozita e KSA të Kosovës e detyrat e saj.

[2] *ASHAK*, Fondi: Sekretariati Krahinor për marrëdhënie me boten e jashtme, viti 1972 - 1984, Nr. i lëndës 1-97, Kutia 4, f. 22; 24. Bashkëpunimi arsimor, shkencor dhe kulturor i KSA të Kosovës me RPS të Shqipërisë.

dhe ndërmarrjes "Rilindja" të Prishtinës e cila kishte rezultuar me këto dërgesa në Kosovë, gjatë dy viteve në vazhdim: në vitin 1969, 32 266 ekzemplarë librash nga letërsia shqipe dhe letërsia e huaj e përkthyer në gjuhën shqipe e në vitin 1970, 4 400 copë libra; 650 tekste mësimore dhe dispensa të ndryshme për vitin 1969, për 42 lëndë, ndërsa në vitin 1970, 2 431 copë për 46 lëndë; 20 970 mjete mësimore për vitin 1969 dhe 88 000 copë për vitin 1970 (në mjete mësimore përfshiheshin harta, globe, atllase, numëratore etj); më 1969 u dërguan rreth 60 000 pllaka gramafoni me këngë popullore e për vitin 1970 ishin të parapara për t'u dërguar edhe 95 000 copë pllaka gramafoni të tjera.[3]

Universiteti i Prishtinës bashkëpunimin me Universitetin e Tiranës e zhvilloi në bazë të Protokollit të nënshkruar që nga viti shkollor 1970 - 71. Nga viti 1970 - 1980, për çdo vit shkollor këto dy universitete kanë nënshkruar protokolle për bashkëpunimin mësimor - shkencor, përveç vitit shkollor 1975 - 1976.[4] Zhvillimi i bashkëpunimit ndëruniversitar kishte rëndësi të madhe politike, në një kohë kur marrëdhëniet midis dy vendeve nuk ishin krejtësisht të normalizuara. Midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë nuk ekzistonte një program i nënshkruar ndërshtetëror mbi bashkëpunimin kulturor - arsimor. Bashkëpunimi Kosovë - Shqipëri, do të bëhet kryesisht nëpërmjet kontakteve te drejtpërdrejta të institucioneve dhe organizatave përkatëse, si: bashkëpunimi ndëruniversitar, i shtëpive botuese, bibliotekave, arkivave e muzeve, radio televizioneve në këmbimin e shoqërive kulturo - artistike e sportive, në lëmin e filmit, të pjesëve teatrale, të instituteve e institucioneve tjera. Por, kuptohet që ky bashkëpunim, do të zhvillohej në kushtet e koniunkturave ndërkombëtare shumë te ndërlikuara, ku rolin vendimtar, e lozin gjendja në marrëdhëniet nacionale në Jugosllavi, Serbi e Kosovë. Ndër institucionet shtetërore në Shqipëri, Ministria e Arsimitdhe e Kulturës,do të luante një rol të rëndësishëm në drejtim të Kosovës. Ajo u ngarkua të përgatiste dhe zbatonte disa masa konkrete, të cilat do të kishin për qëllim që të ndihmonin popullsinë shqiptare në Jugosllavi, në drejtim të zhvillimit të përgjithshëm arsimor e kulturor e për forcimin e dashurisë për atdheun mëmë, Shqipërinë. Masat e ndërmarra nga kjo ministri, duhej të plotësonin kërkesat e

[3] *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë* (më tej*: AMPJ*), viti 1970, dos. 583, f. 45; Informacione nga MPJ.

[4] *ASHAK*, Fondi: Sekretariati Krahinor për marrëdhënie me boten e jashtme, viti 1972-1984, Nr. i lëndës 1-97, Kutia 4, f. 4-5; Bashkëpunimi në Lëmin e Shkencës dhe të Arsimit.

shqiptarëve nga Kosova për tekste dhe mjete mësimore. Po ashtu, kjo Ministri duhej të përpiqej, për të dërguar ansamblin e këngëve dhe valleve popullore, grupet teatrale e sportive, të pranonin studentë nga Kosova në Universitetin Shtetëror dhe shkollat e larta, të pranojnë pedagogë të ndryshëm si individë ose në grupe për praktikë, specializim, shkëmbim eksperiencë, shkëmbim dokumentesh historike me institucionet e interesuara[5], etj.

Këshilli i Ministrave të Republikës Popullore të Shqipërisë, me vendimin e datës 24 qershor 1970 vendosi t'u jepte bursë për të vazhduar studimet e larta në Shqipëri për vitin akademik 1970 - 1971, 75 studentëve nga Kosova. Gjithashtu, u vendos që të jepeshin edhe 50 bursa për të vazhduar shkollat e mesme në profilin pedagogjik, industriale dhe mjekësore.Për vitet 1971 - 1975 të rinjve dhe të rejave nga Kosova t'u akordoheshin çdo vit 75 deri në 100 bursa për të ndjekur shkollat e larta dhe 50 për të vazhduar shkollat e mesme. Veç kësaj, Universiteti Shtetëror i Tiranës duhej të pranonte çdo vit gjerë në 5 kuadro të lartë nga Kosova, të cilët do të përgatitnin mbrojtjen e disertacioneve, për marrjen e gradës "kandidat i shkencave". Vendimi i lartpërmendur i ngarkonte Universitetit të Tiranës detyrimin, që gjatë vitit 1971 të pranonte, 20 studiues nga Kosova, për të përfituar eksperiencë apo për t'u specializuar në Shqipëri.[6]

Më 27 tetor 1970, u nënshkrua në Tiranë, Protokolli midis Universitetit Shtetëror të Tiranës dhe Universitetit të Prishtinës, ngaOsman Kraja dhe Dervish Rozhaja. Ai filloi të zbatohej që në dhjetor të atij viti dhe u pasua me ardhjen e grupit të parë të pedagogëve nga Tirana në Kosovë. Protokolli parashikonte ndihma konkretë të USHT-së për UP-në në këto drejtime kryesore: në ngritjen e nivelit të kuadrove të reja të UP-së duke shkuar nga Kosova për specializim dhe eksperiencë pranë katedrave dhe sektorëve të ndryshëm të Universitetit Shtetëror të Tiranës. Në dërgimin nga USHT-së i 50 kuadrove të sajë mësimore - shkencore pranë UP-së për të zhvilluar ligjërata dhe cikle leksionesh me studentë dhe kuadro të UP-së për rreth 25 lëndë si dhe me dërgimin nga ana e USHT-së të teksteve mësimore qe ajo vetë do t'i botojë. Në kuadër të këtij procesi, brenda një viti në Kosovë nga Shqipëria shkuan 7 grupe pedagogësh me gjithsej 38 veta për leksione e konferenca pasuniversitare si dhe dërgoi 8 kuadro të larta për cikle të

[5] *AMPJ*, viti 1970, dos. 584, f. 39; Të dhëna nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës.
[6] *AMPJ*, viti 1970, dos. B/VII-2 (nr. rendor 578), f. 21-22; Vendim i Këshillit të Ministrave, 26 qershor 1970.

shkurtra ligjëratash dhe për ligjërata të veçanta. USHT-ja për katedrat e UP-së dërgoi edhe nga 5 ekzemplarë të të gjitha botimeve të veta të fundvitit dhe nga botimet e mëparshme u dërguan rreth 200 tituj me rreth 900 ekzemplarë. Botimet e reja u dërguan nëpërmjet "Arteksportit" dhe "Rilindjes", në sasitë e parashikuara në kontratat e nënshkruara midis këtyre dy enteve. Në këtë rrugë janë dërguar 80 tituj me rreth 1 000 ekzemplarë. Po ashtu, brenda kësaj periudhe nga Kosova në Shqipëri kanë shkuar rreth 300 veta të sektorëve të ndryshëm të arsimit dhe të kulturës. Shumica prej tyre kanë qenë mësues dhe nxënës të shkollave 8-vjeçare, gjimnazeve, te instituteve pedagogjike 2 vjeçare dhe pjesa tjetër të sektorëve të kulturës. Po ashtu gjatë periudhës 1 vjeçare pati shumë vajtje e ardhje delegacionesh nga të dyja vendet.[7]

Për vitin akademik 1971/1972, Protokolli ndëruniversitar u nënshkrua nga Jorgji Sota dhe Dervish Rozhaja më 10 dhjetor 1971 në Prishtinë. Nga USHT kanë mbajtur ligjërata në UP prej vitit 1970 - 72 në fakultete të ndryshme, 64 pedagogë. Në Fakultetin Filozofik 14, Fakultetin e Shkencave të Natyrës 14, në Fakultetin Teknik 20, në Fakultetin e Mjekësisë 9, në Fakultetin e Drejtësisë 6 dhe Fakultetin Ekonomik 1.8 Pedagogët më të kualifikuar nga USHT-ja pranë UP-së, do të mbajnë cikle të tëra ligjëratash, si prof. Shaban Demiraj, prof. Eqrem Çabej, prof. Petrit Radovicka, prof. Aleks Buda, prof. Fehmi Shehu, prof. Efigjeni Floqi, prof. Ylli Popa, prof. Ciril Pistoli, prof. Androkli Kostallari, prof. Stefanaq Pollo, prof. Arben Puto, prof. Luan Omari, prof. Kristaq Prifti, prof. Hysni Myzyri etj.[9]

Marrëdhëniet e bashkëpunimit ndëruniversitar i ndihmuan shumë shqiptarët e Kosovës dhe të viseve tjera. Ato hapën rrugën që në mes Shqipërisë dhe Kosovës të vendosen marrëdhënie arsimore e kulturore, shpirtërore etj. Bashkëpunimi, brenda një kohe të shkurtër ndërmjet dy vendeve solli të arritura shkencore. U mbajtën një serë konferencash me studiues nga të dy anët e kufirit kushtuar ngjarjeve të rëndësishme të historisë së popullit shqiptar, si: Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike, mbajtur në Tiranë nga data 12 - 18 janar 1968; Simpoziumi kushtuar 500-vjetorit të Gjergj Kastriotit Skënderbeut, në

[7] *AMPJ*, viti 1971, dos. 639, f. 13-19; 30. Informacion mbi marrëdhëniet me Kosovën, 18 qershor 1971.

[8] *ASHAK*, Fondi: Sekretariati Krahinor për marrëdhënie me botën e jashtme, viti 1962/1984, Nr. i lëndës 1-55, Kutia 1, f. 21-22; Informata mbi Bashkëpunimin Kulturo-Arsimor me RP të Shqipërisë, dhjetor 1973.

[9] Ana Lalaj, *Kosova rruga e gjatë drejt vetëvendosjes 1948-1981*,Tiranë: "Mësonjëtorja e parë", 2000, f. 272-273.

Prishtinë, 9 - 12 maj 1968; Sesioni Shkencor mbajtur në Tiranë më 25 maj 1971, me rastin e 125 vjetorit të lindjes së shkrimtarit Naim Frashri; Konferenca Kombëtare e Folkloristikes Shqiptare mbajtur në Tiranë më 26 - 27 maj, 1972; Kuvendi i Parë i Studimeve Ilire, mbajtur në Tiranë më 15 - 20 shtator 1972; Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, mbajtur në Tiranë më 20 - 25 nëntor 1972, etj. Në këtë të fundit morën pjesë specialistë me kumtesa shkencore nga Kosova e viset tjera të banuara me shqiptarë si dhe nga diaspora. Në Kongres u mor vendimi historik për njësimin e gjuhës së shkruar[10], duke fuqizuar kështu vendosmërinë e inteligjencës shqiptare në të dy anët kufirit, se shqiptarët janë një komb me një gjuhë letrare.

Shkëmbimet e ekipeve sportive midis Kosovës dhe Shqipërisë datojnë që nga viti 1971, ndërsa vizitat e shoqërive kulturo - artistike nga Shqipëria datojnë nga viti 1972.[11] Ndërkohë, për vitin akademik 1972/1973, Protokolli u nënshkrua nga Agim Mero dhe Dervish Rozhaja më 12 - 23 shtator 1973 në Tiranë. Gjatë vitit 1972 - 73 u nënshkruan kontrata dhe u dërgua në Kosovë literaturë shkollore dhe artistike si dhe u vunë kontakte me institucione të ndryshme duke vizituar Shqipërinë rreth 1 200 veta nga Kosova si dhe nga Shqipëria në Kosovë rreth 3 - 400.[12] Gjatë vitit 1973 marrëdhëniet patën një intensitet më të ulët.Po ashtu, gjatë vitit 1974 pati një rënie, u ndërpre dërgimi i librit dhe i mjeteve tjera mësimore e pati kufizime në shkëmbimin e grupeve, megjithatë gjendja në marrëdhëniet midis dy universiteteve ruajti dinamiken e saj. Kështu, Protokolli i vitit 1973/1974, firmosur nga Perikli Prifti dhe Idriz Ajeti më 23 janar 1974 në Prishtinë do të realizohet në mënyrë të kënaqshme. Gjatë vitit 1974, UT-ja dërgoi në Prishtinë një numër kuadrosh pranë UP-së, e për herë të parë u bë udhëheqja e diplomës së studentëve nga Kosova, prej pedagogëve të UT-së. Po ashtu, nga Prishtina shkuan kuadro pranë UT-së. Si rezultat i bashkëpunimit, u mbajtën ligjërata të veçanta e të shkallës së tretë pasuniversitare, specializime, shkëmbim përvoje, kërkime arkivale e bibliografike, ekspedita të përbashkëta në fushat e gjuhësisë, etnografisë, folklorit, arkeologjisë, arteve mesjetare etj. Gjithashtu,

[10] Xhelal Gjeçovi e të tjerë, *Historia e Popullit Shqiptar IV*, Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj 1949-1990, Tiranë: "Toena", 2008, f. 291.

[11] *ASHAK*, Fondi: Sekretariati Krahinor për marrëdhënie me botën e jashtme, viti 1972 - 1984, Nr. i lëndës 1-97, Kutia 4, f. 36-37; Bashkëpunimi në sferat e artit muzikor dhe në lëmin e kulturës fizike.

[12] *AMPJ*, viti 1974, dos. 468. f. 43-46; Vlerësim i realizimit te objektivave ndaj Kosovës nga Drejtoria e IV-të, 21 tetor 1974.

shkuan në Shqipëri edhe grupe arsimtarësh nga Kosova e Maqedonia e grupe piktorësh. Nga Shqipëria u dërguan ansamble folkloristike e Radio Tirana dërgoi incizime e pllaka, kryesisht të muzikës popullore etj.[13] Ashtu si më parë, ndihma e UT-së për UP-në ishte një kontribut i rëndësishëm në zhvillimin e procesit mësimor, punës kërkimore - shkencore dhe kualifikimit të kuadrit si dhe për zhvillimin e shkencës e kulturës në Kosovë. Ndihma konsistonte edhe në luftën kundër përçarjes ideopolitike e për krijimin e një botëkuptimi unik më shkencor dhe më shqiptar për të ndier përgjegjësin e luftës kundër të gjitha ndikimeve joshqiptare.[14]

Më 30 dhjetor 1974, u parashtrua plani i aktiviteteve të ndryshme për vitin 1975, në drejtim të Kosovës e shqiptarëve të Maqedonisë e të Malit Zi në fushën e arsimit, kulturës dhe të arteve.[15]Puna në drejtim të Kosovës gjatë vitit 1975 megjithëse qe pozitive, në krahasim me vitet e mëparshme pati një rënie.[16] Më 1975, sidomos krijimet letrare u njohën pak në Kosovë e Maqedoni, krahasuar me dy - tri vitet e mëparshme, ndërsa artet thuajse aspak. Ndërprerja e këtyre marrëdhënieve e këmbimeve te vizitave ndërmjet krijuesve nga të dy palët, mosbotimi në organet letrare të krijimtarisë së studiuesve nga Kosova, që në vitin 1975 u kufizua shumë.[17] Megjithatë, gjatë gjysmës së parë të vitit 1975, u zhvilluan disa lloj marrëdhëniesh e që mund të përmblidhen në "bashkëpunimin midis dy universiteteve, në shkëmbimin e ndonjë trupe artistike apo ekipi sportiv dhe në disa shkëmbime të karakterit tregtar të gjërave artistike dhe librave të ndryshme. Vend të rëndësishëm në këto marrëdhënie zunë edhe vizitat e disa grupeve, sidomos arsimtarësh dhe nxënësish, të cilët vizituan Shqipërinë dhe përfituan nga praktika e zhvillimit arsimor të shtetit amë. Kështu realizimieci me ritmet e duhura, pavarësisht disa ngecjeve në atë drejtim".[18] Udhëheqja shtetërore e Tiranës, do të vazhdojë përpjekjet e saj për të përkrahur shqiptarët në Jugosllavi, në luftën e tyre për të ruajtur dhe forcuar të

[13]*AMPJ*, viti 1974, dos. 468/1, f. 46-50; Informacion nga Drejtoria e IV-të, Mbi marrëdhëniet e Shqipërisë me Kosovën gjatë 9 muajve të vitit 1974, 15 tetor 1974.
[14]*AMPJ*, viti 1973, dos. 727, f. 50-51; Informacion i Drejtorisë se V-të, 5 korrik 1973.
[15]*AMPJ*, viti 1974, dos. 469, f. 19-23; Plani i aktiviteteve në drejtim të Kosovës e shqiptarëve të Maqedonisë e të Malit Zi, 30 dhjetor 1974.
[16] *AMPJ*, viti 1976, dos. 776, f. 13-18; Përgjigje e Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës, Ministrisë së Punëve të Jashtme-Degës së IV-të, 28 shkurt 1976.
[17]*AMPJ*, viti 1976, dos. 775, f. 80-81; Relacion i Lidhjes së Shkrimtareve dhe Artistëve të Shqipërisë, 3 janar 1977.
[18]*AMPJ*, viti 1975, dos. 651/1, f. 40-43; Informacion i Drejtorisë së V-të.

drejtat që u takojnë e për të zhvilluar më tej traditat kombëtare, arsimin, kulturën e shkencën, në mënyrë që ato të mos mbeteshin e zhvilloheshin të shkëputura nga traditat, arsimi, kultura dhe shkenca e shtetit amë.Kështu, realizimi i objektivave ndaj Kosovës, konsistonte në vazhdimin e marrëdhënieve midis institucioneve të ndryshme, përmes të cilave u vazhdua prania, ndikimi, roli dhe ndihma e shtetit shqiptar për një sërë detyrash me karakter arsimor e kulturor duke kontribuar kështu për afirmimin e mëtejshëm kombëtar të popullsisë shqiptare në Jugosllavi. Një vend të rëndësishëm në radhën e objektivave zunë marrëdhëniet midis UP-së dhe UT-së, të zhvilluara gjithnjë në bazë të protokollit dhe në frymën e bashkëpunimit mësimor e shkencor midis dy universiteteve.

Ministria e Arsimit dhe Kulturës më 28 shkurt 1976, hartoi Planin në drejtim të Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi edhe për vitin 1976. Plan i cili parashihte që të ndiqtezbatimin e protokolleve të përfunduara midis USHT-së me UP-në dhe Universitetin e Shkupit, në fushën e arsimit, kulturës dhe arteve, radiotelevizionit e tregtisë.[19] Me gjithë këtë hap të ndërmarrë, gjatë vitit 1976 (ashtu si më 1975) në organet letrare shqipe të Kosovës dhe Maqedonisë botimi i krijimtarisë së shkrimtarëve nga Shqipëria erdhi duke u pakësuar, sa periudhën e fundit thuajse ato nuk botuan asgjë nga letërsia e shtetit amë. Megjithatë, edhe pse gjatë vitit 1976, Sektori i Jashtëm i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, bëri një punë shumë të kufizuar, për të njohur e përhapur letërsinë, artet, mendimin teorik e estetik si dhe arritjet tjera në Kosovë e Maqedoni, nga ana e Lidhjes u dërgua gazeta "Drita", revista "Nëntori", shoqatave letrare e artistike të Kosovës e Maqedonisë. Në fushat e tjera të parashikuara për vitin 1976, Sektori i Jashtëm nuk mundi të kryejë asnjë aktivitet. Ai nuk u njoh fare me krijimtarinë letrare e artistike të studiuesve nga Kosova e Maqedonia. Po ashtu "Drita" dhe "Nëntori", nuk botuan asnjë lloj krijimtarie të këtyre dy trevave e nuk u realizua asnjë këmbim vizitash ndërmjet grupeve nga të dy palët sikundër ishte planifikuar.[20] Më 27 dhjetor 1976, në Tiranë, u miratua Plani i Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës në drejtim të Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi edhe për vitin 1977. Plan i cili

[19] *AMPJ*, viti 1976, dos. 776, f. 19-29; Plani i Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës në drejtim të Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi, 28 shkurt 1976.

[20] Gjatë këtij viti, vetëm në dhjetor të vitit 1976 erdhën nga Shqipëria në Kosovë jashtë planit, dy shkrimtarë të letërsisë për fëmijë të ftuar nga revista "Pionieri" të Prishtinës;Shih:*AMPJ*, viti 1976, dos. 775, f. 70-72.

kishte si synim, të rriste e konsolidonte më lartë ndërgjegjen kombëtare shqiptare të shqiptarëve të Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi, duke ndihmuar aktivisht organet dhe institucionet e arsimit, kulturës dhe të arteve të këtyre trevave. Për këtë qëllim u morën një sërë masash, ashtu si më parë në fushën e arsimit, kulturës dhe të arteve si dhe u dërguan në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi, grupe të ndryshme arsimtarësh e delegacionesh të ndryshme.[21]

Gjatë vitit 1977 u ndihmua UP-ja për të mbuluar 17 lëndë me kurse të plota leksionesh dhe provimet përkatëse, për të mbajtur 7 tema me studentët pasuniversitar dhe një ligjëratë të veçantë, duke dërguar 32 kuadro mësimore. Ndërsa, pranë UT-së kanë shkuar 41 kuadro të UP-së për përvojë, specializim, kërkime shkencore dhe për ligjërata të veçanta dhe skuadrat e basketbollit (24 veta) dhe tre grupe studentësh si vizitore - turiste.Megjithatë, llogaritur përafërsisht, me përqindje protokolli midis dy universiteteve për vitin shkollor 1976 - 1977 është realizuar 65%, kur është fjala për dërgesat nga Tirana.[22]

Me rendësi të veçantë ka qenë gjatë kësaj periudhe edhe realizimi me sukses i objektivave tjera. Kështu, më 1977 u priten grupe studentësh, ekipet e basketbollit të UP-së, punonjës të "Kosovafilmit" dhe të TV Prishtinës etj. Shtëpia botuese "Naim Frashri" botoi dy vëllime me poezi për fëmijë dhe 2 vëllime me poezi për të rritur, të autorëve nga Kosova. Gazeta "Drita", botoi 6 poezi të 3 autorëve. Revista "Nëntori", botoi 9 poezi. Një punë e mirë është bërë edhe në dërgimin e literaturës në Kosovë. Në adresë të 12 bibliotekave të Kosovës ajo e Tiranës dërgoi 122 tituj botimesh me 184 ekzemplarë të organeve periodike dhe 1 041 libra nga titujt e botuar gjatë këtij viti (1977). Ndërsa, ndërmarrja e librit realizoi një kontratë me të madhe se në vitet e mëparshme me ndërmarrjen "Rilindja". Si nëntëmujor janë realizuar 47 677 nga 50 000 që ishte kontrata. Gjatë kësaj periudhe përmes këtyre shkëmbimeve janë dërguar në Kosovë 22 892 copë libra politiko - shoqërore (kryesisht vepra të Marksit, Engelsit e Leninit), 20 022 copë libra tekniko shkencore dhe 47 920 libra të letërsisë artistike. Gjithsej 90 884 copë.[23] Përveç Kosovës, përmes ndërmarrjes u dërguan

[21] *AMPJ*, viti 1977, dos. 1112, f. 1-6; Plani i Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës në drejtim të Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi, 27 dhjetor 1976.

[22] *AMPJ*, viti 1977, dos. 1113, f. 15; Relacion i MPJ-së, Për realizimin e detyrave ndaj Kosovës gjatë vitit 1977.

[23] Gjatë vitit 1977 janë bërë edhe dërgesa të tjera si: Teatri Popullor i Tiranes i dërgoi atij të Prishtinës dhe Gjakovës tekste dramash. Ansamblit Shota iu dërguan incizime të ndryshme. Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve dërgoi dy shkrimtarë në mitingun e

një sasi librash edhe në viset e tjera shqiptare si dhe në vende të ndryshme të botës, ku kishte emigracion shqiptar nga Kosova si në Belgjikë, Australi, Zvicër, Gjermani, SHBA, Kanada[24], etj. Edhe përfaqësitë diplomatike të shtetit shqiptar shpërndanë materiale lidhur me Kosovën sikurse kanë qenë libri "Shote dhe Azem Galica" e "Isa Boletini". Po ashtu, Komiteti për Marrëdhënie Kulturore e Miqësore me Botën e Jashtme dhe Dega e Shtypit e Ministrisë ju dërgonte revistën e gazetën "Shqipëria e re" e materiale tjera.[25]

Pra, si qëllim parimor i udhëheqjes politike të Shqipërisë shikohej shfrytëzimi i mundësive ekzistuese, duke u bërë të qartë shqiptarëve në Jugosllavi që lufta e tyre tani të konsistojë në shfrytëzimin e situatës për të fituar sa më shumë të drejta në arsim, art, kulturë, folklor, zhvillim ekonomik, ndalimit të emigrimit e asimilimit, rritjes së ndjenjave kombëtare patriotike në drejtim të strukturës nacionale, në zhdukjen e zakoneve prapanike etj. Në këtë drejtim do të paraqisnin interes edhe transmetimet e Radiotelevizionit Shqiptar e Radio Kukësit, përmes së cilës trajtoheshin probleme për luftën kundër degjenerimit jugosllav të rinisë, kundër hakmarrjes e në drejtim të përmbajtjes se propagandës të destinuar për Kosovën si dhe në ndihmën që Radiotelevizioni i Tiranës i dha Radiotelevizionit të Prishtinës. Në nëntor të vitit 1978, u nënshkrua Protokolli mbi Bashkëpunimin midis Radiotelevizionit të Prishtinës dhe Radiotelevizionit Shqiptar. Sipas kësaj Marrëveshje, u këmbyen filma arsimor e shkencor të popullarizuar, filma dokumentarë - fejtonistik, emisione muzikore, pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme, në fushën teknike e këmbime tjera reciproke.[26] Ministria e Arsimit dhe Kulturës, në drejtim të Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi, hartoi planin më 7 janar edhe për vitin 1978. Plani u hartua për ndërmarrjen e disa masave

poezisë në Gjakovë, etj. Po ashtu, sipas objektivave dhe planit të Bibliotekës qenë përgatitur edhe 2 kontingjente librash shkencore dhe artistike prej 147 titujsh dhe komplete tekstesh shkollore të 8-vjeçares, që me rastin e vizitës në Kosovë, t'ua dhurojë bibliotekave të Kosovës; *Po aty*, f. 17-18.

[24] *AMPJ*, viti 1977, dos. 1115, f. 35; Informacione nga MPJ dhe përfaqësitë diplomatike.

[25] *AMPJ*, viti 1980, dos. 1161, f. 65-66; 77; Informacione për marrëdhëniet e Shqipërisë me Kosovën dhe Jugosllavinë.

[26] *AQSh*, Fondi: 14/APSTR, viti 1979, dos. 64, f. 75-77; Relacion, Drejtori i RTV Shqiptar, Çajup Rusmali, Tirane, 5 prill 1979; *AMPJ*, viti 1978, dos. 1262, f. 1-20; Program i RTV Shqiptar për shkëmbime të ndryshme me RTV e Prishtinës për vitin 1978, Drejtori, Çajup Rusmali, Tiranë, 21 janar 1978; Mbi marrëdhëniet me Radiotelevizionin e Prishtinës, zv. kryetari i Këshillit të Ministrave Manush Myftiu, Tiranë, 22 maj 1978.

e zgjerimin dhe intensifikimin e rritjes së mëtutjeshme të ndërgjegjes kombëtare shqiptare, për viset shqiptare që ishin nën Jugosllavi. Lidhur me këtë çështje ashtu si më parë u morën një sërë masash në fushën e arsimit, kulturës dhe të arteve e në fushën e kulturës fizike e sporteve.[27] Madje, u ndërmorën edhe një sërë aktivitetesh tjera në drejtim të Kosovës gjatë vitit 1978, si në fushën e botimeve (nga viti 1971 e gjerë në shkurt të vitit 1978, Shtëpia botuese "Naim Frashri", kishte botuar 6 romane, 4 vëllime me tregime nga autorë të ndryshëm, 11 vëllime me poezi dhe 5 libra për fëmijë), në fushën e Radiotelevizionit, në marrëdhëniet e UT-së me UP-në, në fushën e aktiviteteve të Lidhjes së Shkrimtarëve[28], etj.

Universitetit i Tiranës dhe Universiteti i Prishtinës për të zhvilluar e forcuar më tej lidhjet dhe bashkëpunimin midis tyre, u morën vesh që të hartojnë Projekt - Protokoll bashkëpunimi mësimor e shkencor për vitin akademik 1978 - 1979.[29] Bisedimet e para për nënshkrimin e këtij protokolli të bashkëpunimit midis UT-së dhe UP-së, ishin zhvilluar më 2 tetor 1978 dhe Protokolli u nënshkrua më 9 tetor 1978 nga Rektori i UP-së, Feriz Krasniqi dhe nga zv. rektori i Tiranës, Besim Daja.[30] Projekti në fjalë, krahasuar me atë të miratuar vitin e kaluar në përgjithësi rezultonte si një përsëritje e tyre. Megjithatë, në këtë Projekt UT-së merrte përsipër të dërgonte në Prishtinë 89 pedagogë, duke bërë kështu një rritje prej 7 pedagogësh, në krahasim me 82 që ishin vitin e kaluar (realizuar 73). Ndërkaq, parashikohej të priteshin 92 pedagogë të UP-së (sipas kërkesave të UP-së) e që vitin e kaluar në protokoll ishin parashikuar të priten 66 pedagogë të UP-së dhe u realizuan 59. Rritja e numrit te pedagogëve të UP-së për t'u pritur në Shqipëri, në krahasim me vitin e kaluar qe më e madhe, 36 veta.[31] Deri më 30 qershor 1979, Protokolli i lartpërmendur mësimor e shkencor nuk është realizuar i tëri.[32] Megjithatë e rëndësishme është se nga viti 1978 synohej, më

[27] *AMPJ*, viti 1978, dos. 1261, f. 1-5; Plani i Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës në drejtim të Kosovës, Maqedonisë e Malit Zi, 7 janar 1978.

[28] *AQSh*, Fondi: 14/APSTR, viti 1978, dos. 302, f. 3-14; Program masash mbi disa aktivitete në drejtim të Kosovës për vitin 1978 nga institucione të ndryshme.

[29] *AMPJ*, viti 1978, dos. 1262/1, f. 19-21; Projekt Protokolli i Bashkëpunimit mësimor e shkencor midis Universitetit te Tiranës dhe Universitetit të Prishtinës për vitin shkollor 1978/1979.

[30] *Po aty*, f. 36-41; Mbi vizitën e delegacionit të UT-së që shkoi në Prishtinë për nënshkrimin e Protokollit mësimor e shkencor për vitin 1978 - 1979. Kryetari i delegacionit Besim Daja, Tiranë, 16 tetor 1978.

[31] *Po aty*, f. 22; Informacion ditor.

[32] *AQSh*, Fondi: 14/APSTR, viti 1979, dos. 63, f. 306-307; Relacion, mbi realizimin e

shumë shkëmbime në fusha të ndryshme të arsimit dhe kulturës të kuptuara dhe të realizuara si aksione politike për të thelluar më tej praninë e shtetit amë në viset shqiptare e për të intensifikuar ndikimin dhe ndihmën për zhvillimin arsimor e shkencor në Kosovë.

Për të kompensuar sado pak procesin e pakësimit të punës mësimore të UT-së, me UP-në, si dhe për të thelluar ndikimin më tej, qenë në proces hapat për të krijuar lidhje midis Akademisë së Shkencave të Tiranës me atë të Kosovës. Kështu, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, për të vënë në jetë marrëveshjen e bashkëpunimit kërkimor - shkencor të nënshkruar midis tyre miratuan Protokollin për zbatimin e saj, për vitet 1979 dhe 1980 (Protokoll dyvjeçar), në: shkëmbim përvoje e konsultime, kërkime arkivale bibliografike, ekspedita shkencore, ligjërata e shkëmbime të literaturës shkencore, etj.Ky bashkëpunim ndërakademik u nënshkrua në Prishtinë, më 16 qershor 1979, nga Syrja Pupovci dhe Luan Omari.[33]

Protokolli i bashkëpunimit mësimor e shkencor midis Universitetit të Tiranës e Universitetit të Prishtinës edhe për vitin mësimor 1980 - 1981 u nënshkrua nga rektorët e të dy Universiteteve (në Prishtinë), Petrit Radovicka dhe Gazmend Zajmi.[34]Po ashtu, Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqata e Kompozitorëve të Kosovës, me qëllim që të vendosnin e forconin më tej midis tyre marrëdhëniet, miratuan Protokollin për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, për vitet 1980 - 1981, si në: shkëmbim përvoje e konsultime, ligjërata, shkëmbime materialesh muzikore, botime e shkëmbime vizitash.[35] U arrit marrëveshja e bashkëpunimit kërkimor - shkencor edhe në mes Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit

Protokollit të bashkëpunimit mësimor e shkencor midis UT-së nga njëra anë dhe UP-në e UMKSH nga ana tjetër për vitin shkollor 1978 - 1979.

[33]*ASHAK*, Fondi: Sekretariati Krahinor për marrëdhënie me boten e jashtme, viti 1972-1984, Nr. i lëndës 1-97, Kutia 4, f. 25; Bashkëpunimi ndërakademik; *AMPJ*, viti 1980, dos. 1194, f. 1-5; Protokoll për zbatimin e marrëveshjes se bashkëpunimit kërkimor-shkencor midis Akademisë së Shkencave të RPS të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës për vitet 1979 dhe 1980.

[34]*AMPJ*, viti 1980, dos. 1182, f. 1-5; Protokoll i bashkëpunimit mësimor e shkencor midis Universitetit të Tiranës e Universitetit të Prishtinës për vitin mësimor 1980-1981. Protokolli ishte miratuar nga zv. kryetari i Këshillit të Ministrave në Tiranë, Manush Myftiu, më 27. 05. 1980.

[35]*AMPJ*, viti 1980, dos. 1193, f. 1-7; Protokoll i bashkëpunimit, në mes Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Republikës së Shqipërisë e Shoqatës së Kompozitorëve të Kosovës, 1980 - 1981.

Shqiptar dhe Drejtorisë së Arkivit të Kosovës, për vitet 1980 - 1981, që më datë 21 mars 1980 e kishte miratuar Këshilli i Ministrave në Tiranë, projektmarrëveshjen dhe projektprotokollin e bashkëpunimit.[36]

Gjatë vitit 1980, u vazhdua mbi bazën e përvojës dhe rezultateve pozitive të viteve të mëparshme që jo vetëm të ruhet, por edhe të thellohet prania e shtetit amë në Kosovë e viset tjera shqiptare. Janë vazhduar në përgjithësi aktivitetet arsimore - kulturore e janë zgjeruar relativisht shkëmbimet tregtare, si rezultat i të cilave qenë këta tregues kryesore: u vazhdua zbatimi i protokolleve midis UT-së dhe atij të Prishtinë, Akademisë së Shkencave, Radiotelevizionit, Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artisteve e Shoqatave të Kompozitorëve, të artistëve figurativ e të artit aplikativ, Ndërmarrjes së Librit e "Rilindjes" së Kosovës etj. Po ashtu, gjatë vitit 1980 u priten në Shqipëri 166 grupe nga Kosova, Maqedoni e Mali i Zi, me gjithsej 1 502 persona. Shifra këto pak a shumë të të njëjtit nivel të një viti më parë. Në këto grupe përfshiheshin si grupet artistike ashtu edhe të gjitha grupet tjera të ardhura në kuadër të bashkëpunimit midis institucioneve. Veç këtyre janë miratuar gjatë vitit 1 200 viza individuale e shkuan në Shqipëri 903 veta. Ndërkaq, nga ana e institucioneve të Shqipërisë u dërguan në Kosovë e vise tjera 97 grupe me 812 persona, duke shënuar një rritje prej rreth 30 grupesh, si rezultat i zbatimit të një numri marrëveshjesh të reja që janë nënshkruar. Janë akorduar edhe rreth 480 - 500 viza individuale për te vajtur (ardhur) nga Shqipëria në Kosovë e vise tjera. Nga grupet e pritura nga Shqipëria 135 kanë qenë nga Kosova, 14 nga Maqedonia dhe 17 nga Mali i Zi, ndërsa nga grupet e dërguara nga Shqipëria 92 shkuan në Kosovë, 4 në Maqedoni e 1 në Mal të Zi. Në marrëdhëniet midis Bibliotekave nga ajo e Tiranës i janë dërguar Bibliotekës së Prishtinës 1 669 copë libra nga 2 217 që qenë dërguar gjithsej në Kosovë. Ndërsa, nga Biblioteka e Prishtinës janë dërguar rreth 220 copë libra. Biblioteka e Tiranës dërgoi edhe në Mal të Zi 210 copë libra e përgjimnazete Dibrës, Gostivarit e Kumanovës 283 copë.[37]

Puna e institucioneve shqiptare në drejtim të Maqedonisë e Malit të Zi, shikohej si një ndihmë për thellimin e proceseve të afirmimit të shqiptarëve në tërë Jugosllavinë. Një nga hallkat më të rëndësishme në procesin e thellimit të emancipimit të shqiptarëve në Jugosllavi

[36] *AMPJ*, viti 1980, dos. 1195, f. 1-11; Marrëveshje e bashkëpunimit kërkimor - shkencor në mes Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit Shqiptar dhe Drejtorisë së Arkivit të Kosovës, 1980 - 1981.

[37] *AMPJ*, viti 1980, dos. 1161, f. 16-19.

konsiderohej uniteti i tyre i brendshëm në Kosovë dhe i gjithë shqiptarëve në vise dhe i viseve me Kosovën.Tashmë, është e ditur se importimi i teksteve mësimore sipas plan-programeve të gjuhës e të letërsisë shqipe, të historisë, të literaturës shkencore, artistike etj., nga Universiteti i Tiranës në Universitetin e Prishtinës i dha një dimension e impuls të ri arsimit shqip në Kosovë.Në kuadrin e përgjithshëm bashkëpunimi shumëvjeçar ndëruniversitar ka mundësuar që në degët e ndryshme të fakulteteve të UP-së (Fakultetin e Mjekësisë, Teknik, Xehetar - Metalurgjik, Matematiko - Natyror dhe Akademinë e Arteve) të zhvillohen 23 lëndë mësimore në gjuhën shqipe për të cilat nuk ishte e mundur të sigurohej kuadri adekuat në gjuhen shqipe e që deri atëherë e zhvillonin profesorët serbë në gjuhen serbe. Pedagogët e UT-së, gjatë një viti shkollor mbajtën 2 123 orë ligjërata dhe 292 orë ushtrime si dhe provimet nga lëndët që i zhvillonin në ciklet e ligjëratave të shkallës së III në Fakultetin Filozofik.[38]

Në bazë të dhënave që disponojmë, lidhur me angazhimin e kuadrit nga UT-ja për mbajtjen e ligjëratave - studenteve të degëve të ndryshme të fakulteteve të Universitetit të Kosovës, bashkëpunimi është zhvilluar sa vijon: në vitin shkollor 1970/71, ligjërata të rregullta kanë mbajtur 29 arsimtarë; në vitin shkollor 1971/72, 30 arsimtarë; në vitin shkollor 1972/73, 32 arsimtarë; në vitin shkollor 1973/74, 28 arsimtarë; në vitin shkollor 1974/75, 26 arsimtarë; në vitin shkollor 1975/76, 24 arsimtarë e në vitin e fundit shkollor 1980/81, 16 arsimtarë. Në bazë të këtyre të dhënave mund të shihet se deri në vitin 1972/73, procesi mësimor në Universitetin e Kosovës mbulohej me arsimtarët e UT-së me 3%, ndërsa në vitin e fundit 1980/81 kjo përqindje u zvogëlua në 1,6%.[39]

Bashkëpunimi sot dhe në të ardhmen

Në shekullin e kaluar, edhe pse bashkëpunimi u zhvillua në kushtet e konjukturave ndërkombëtare shumë të ndërlikuara, ku rolin vendimtar

[38] *ASHAK*, Fondi: Sekretariati Krahinor për marrëdhënie me botën e jashtme, viti 1972 - 1984, Nr. i lëndës 1-97, kutia 4, f. 23; Bashkëpunimi arsimor shkencor dhe kulturor, Prishtinë, shtator 1980.

[39] *Po aty*, f. 6;Ndërkohë,mbështetur në një dokument tjetër të ASHAK-ut, nga USHT-ja kanë mbajtur ligjërata në UP prej vitit 1970 - 72 në fakultete të ndryshme 64 pedagogë e jo 59, siç na jep shifrën dokumenti i lartcituar; *ASHAK*, Fondi: Sekretariati Krahinor për marrëdhënie me botën e jashtme, viti 1962/1984, Nr. i lëndës 1-55, Kutia 1, f. 21-22; Informata mbi Bashkëpunimin Kulturo - Arsimor me RP të Shqipërisë, dhjetor 1973.

e loznin gjendja në marrëdhëniet nacionale në Jugosllavi, Serbi e Kosovë, ai pati avantazhe në afirmimin e përgjithshëm kombëtar. Sot, bashkëpunimi është një detyrë e rëndësishme, me shumë përgjegjësi, si një sferë e veçantë në zhvillimin e marrëdhënieve ndërmjet Tiranës dhe Prishtinës. Sot me dimensione me të reja bashkëpunimi është instrument jo vetëm i marrëdhënieve të mira, por edhe shprehje e zgjerimit të dijes, mishërimit, ndihmës reciproke, ndikimit progresiv të përparimit kulturor e shoqëror dhe nevojë kohe shumë e domosdoshme. Pavarësisht lëvizjeve të lira shqiptare në të dy anët e kufirit, ato duhet avancuar më tej, përderisa kjo frymë bashkëpunimi nuk gjen zbatim të kënaqshëm, përveç disa segmenteve të veçanta. Megjithëse ekzistojnë marrëdhënie të shkëlqyera, ato duhet të rriten në të gjitha fushat me interes të ndërsjellë, të zhvillohen e intensifikohen në të gjitha drejtimet në të mirë të kombit tonë, paqes e stabilitetit në rajon.

Bashkëpunimi Kosovë - Shqipëri duhet të gjejë zbatim të kënaqshëm në të gjitha sferat e jetës, duke u zbatuar përmes projekteve të përbashkëta në fushën e arsimit, bujqësisë, agrobiznesit, në lëmin e drejtësisë, diplomacisë, ushtrisë, në përvojë, planifikim dhe reformim e në rrugën e integrimit drejt strukturave euroatlantike. Një integrim i tillë është edhe faktor përcaktues i çështjes së përbashkët shqiptare. Me një fjalë, Tirana dhe Prishtina si kryeqendra të rëndësishme shkencore e kulturore, politike e diplomatike, duhet të krijojnë një Program te përbashkët me ekspertë të fushave të ndryshme, si: informative, politike, diplomatike, ushtarake, ekonomike, zbuluese, strategjike etj.

Sa i përket bashkëpunimit në lëmin e zhvillimit arsimor, kulturor dhe shkencor, mjaft gjëra në këtë drejtim janë shënuar. Por përveç oscilacioneve që kanë rrjedhur objektivisht në kuadrin e bashkëpunimit, nuk mund të mos konstatojmë edhe mjaft të meta në këtë drejtim, që duhej të ishin evituar me një punë më të madhe nga ana e institucioneve e me një koordinim më të mirë midis tyre.

Sot duhet të përcaktojmë mirë praktikat e bashkëpunimit dhe koordinimit të tyre, me qëllim që të veprojmë më mirë e të evitojmë të metat. Në përputhje me politikën dhe interesat e ndërsjella, se në cilat fusha mund të zhvilloheshin më tej marrëdhëniet?, mendoj se ekzistojnë të gjitha mundësitë drejt zgjerimit të tyre. Bashkëpunimi, duhet zhvilluar në bazë të marrëveshjeve, protokolleve e kontratave të nënshkruara si dhe në bazë të platformave e objektivave afatshkurtra, afatmesme e afatgjata. Nga aspekti i tanishëm i vështrimit të përgjithshëm, orientimi i aktiviteteve të përbashkëta në zhvillimin e marrëdhënieve të ndërsjella, është i dobishëm kur është fjala për

kontaktet dhe bashkëpunimin në lëmin e kulturës kombëtare, arsimit, shkencës e njohjes reciproke. Por, institucionet shkencore duhet pasur edhe raporte të përbashkëta pune. Andaj duhet insistuar në një bashkëpunim të plotë, të të gjitha sferave të jetës, duke përfshirë këtu unifikim të standardeve shkencore në të gjithë sektorët. Posaçërisht, duhet angazhuar në hartimin e planeve e programeve dhe unifikim të teksteve shkollore e përkatësisht, për të qenë kjo më e suksesshme, duhet harmonizuar edhe sistemin shkollor. Në këtë kuadër, përparësi duhet dhënë plan-programeve e teksteve shkollore, në veçanti mësimit të lëndëve kombëtare, ku, nëpërmjet tyre, të kultivohet tek brezi i ri ndjenja e atdhedashurisë së përbashkët kombëtare. E gjithë kjo veprimtari do të kishte edhe një komponentë shumë të rëndësishme, atë shpirtërore. Kështu, gjithçka do të precipitonte edhe në rritjen e entuziazmit dhe afirmimit kombëtar.

Situatat e krijuara tashmë janë më të favorshme, duke na dhënë mundësinë të forcojmë lidhjet në të gjitha aspektet, që marrëdhëniet të zhvillohen në interes të një shkalle gjithnjë e më të gjerë. Ne sot kemi programe të lëvizjeve e partive të ndryshme politike, por nuk kemi program të veçantë nacional - kombëtar që, ndryshe nga programet politike, të jetë produkt i studimeve dhe kërkimeve të përbashkëta shkencore dhe kulturore. Pra, midis Tiranës dhe Pishinës nuk ekziston Program i nënshkruar kulturoro - arsimor dhe shkencor. Në këtë rrafsh duhet të ekzistojnë Platforma Kombëtare afatshkurtra, afatmesme e afatgjata. Sot, bashkëpunimi bëhet kryesisht nëpërmjet kontakteve direkte të institucioneve. Lidhur me këtë është e nevojshme që truri i kombit i përbërë nga ekspertë të fushave të ndryshme të punojë me një program ambicioz, duke lënë mënjane krenaritë vetjake, të cilat e vështirësojnë dhe komplikojnë tendencat politizuese të skajshme. Por në fund, sado që do të mund të luhet me karta të tilla, askush nuk ka as nuk mund të pretendojë se ka monopolin e tapinë mbi shqiptarizëm. Institucionet shkencore në Tiranë dhe Prishtinë duhet paraprirë integrimeve të përbashkëta në planin arsimor, kulturor e shkencor, duke u bërë Piemonte të tyre, ndërsa institucionet politike duhet dhënë dritën jeshile të tyre.

Realizimi i ngushtë i bashkëpunimit do t'i kontribuojë lehtësimit dhe përparimit të procesit mësimor e afirmimit të rezultateve tona shkencore, përmes të cilave do të vazhdohet prania, ndikimi, roli dhe afiniteti i përbashkët për një sërë detyrash me karakter arsimor e kulturor nacional, duke kontribuar kështu për afirmimin e mëtejshëm kombëtar.

Bashkëpunimi Kosovë - Shqipëri, natyrisht se duhet të jetë edhe më i gjerë sesa duket të jetë në perspektivë. Në kuadër të saj duhet shikuar edhe mundësitë tek shqiptarët që kanë mbetur jashtë kufijve të dy shteteve shqiptare. Natyrisht, bashkëpunimi nuk mund të jetë i njëllojti. Por duhet ekzistojnë module tjera të përgatitura e të hartuara enkas, që ato të konsiderohen si pjesë e përbashkët e unifikimit. Për të realizuar këtë, duhen një sërë platformash, planesh e objektivash të caktuara e hartuara në radhë të parë nga dy akademitë tona, të Tiranës dhe Prishtinës.

Andaj, duhet pasur një qendër të tillë koordinimi edhe për viset që kanë mbetur jashtë dy shteteve shqiptare. Lidhur me këtë çështje, detyrat konkrete duhet të projektohen nga qeveria, ndërsa organizimi i punës, realizimi dhe zbatimi i orientimeve të kryhet nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Punëve të Brendshme, etj. Këto Institucione duhet të vazhdojnë përpjekjet e tyre që të përgatisin dhe zbatojnë disa masa konkrete, të cilat do të kishin për qëllim që të ndihmonin popullsinë shqiptare në ato vise, në drejtim të zhvillimit të përgjithshëm arsimor e kulturor, në luftën e tyre për të ruajtur dhe forcuar të drejtat që u takojnë e për të zhvilluar më tej traditat kombëtare, arsimin, kulturën e shkencën, në mënyrë që ato të mos mbeten e zhvillohen të shkëputura nga traditat, arsimi, kultura dhe shkenca jonë kombëtare. Realizimi i objektivave të hartuara ndaj atyre viseve, do të konsistonte në vazhdimin e marrëdhënieve midis institucioneve të ndryshme, përmes të cilave do të vazhdohej prania, ndikimi, roli dhe ndihma e dy shteteve tona, për një sërë detyrash me karakter arsimor e kulturor nacional duke kontribuar kështu për afirmimin e mëtejshëm kombëtar të popullsisë sonë shqiptare.

Sabit SYLA

SUMMARY

KOSOVAR – ALBANIAN COOPERATION

The ‘70's of the 20th century are characterized by the increase in interest of the ruling class in Tirana for Kosova and other Albanian territories in Yugoslavia. This policy was put to practice especially in the field of education and culture. In this context, various measures were taken to aid Kosova and other Albanian territories, based on an orientation plan approved by the leadership of the Party of Labour of Albania.

One of these measures were the protocols signed between Tirana State University and University of Prishtina, which protocols aimed to help increase the number of lecturers at the University of Prishtina, who completed their specialization at the University of Tirana. Similarly, numerous lecturers from University of Tirana were assigned to lecture at various departments at the University of Prishtina. The Academy of Sciences of the Republic of Albania also collaborated closely with the Academy of Science and Arts of Kosova by signing various agreements which incorporated: exchange of experience and consulting, archival and bibliographic research, scientific expeditions, lectures and exchange of scientific literature.

The League of Writers and Artists of the Republic of Albania and the Society for Composers of Kosova, in an attempt to strengthen their relations, approved a protocol for implementing the agreement of cooperation in: exchange of experience and consulting, lectures, exchange of musical material, publications and visits.

Another scientific - research agreement was achieved between the General Directorate of Archives of the Albanian state and the Directorate of Archives of Kosova, as well as an agreement between Tirana Radio-television and Prishtina Radio-television and so forth. Nowadays the cooperation between Kosova and Albania should find satisfactory implementation in all spheres. This cooperation should be implemented through common projects and programs in the field of education, agriculture, agribusiness, in the subject of law, diplomacy,

military, in experience and in planing and reforming the integration path towards the Euro-Atlantic structures. Such an integration would be a defining factor for the common Albanian cause.

MATERIALE DHE DOKUMENTE

Hatixhe AHMEDI

TRI MBISHKRIME VARRESH NË QYTETIN E PRESHEVËS

Hyrje

Gurët e varreve janë një dëshmi e një pasurie shumë të rëndësishme kulturore. Forma e gurëve, pasqyra e tyre, veçantitë e zbukurimit të tyre në skulpturën e artit osman, paraqesin dhe zbulojnë edhe njëherë personalitetet, familjet dhe paraardhësit e tyre, profesionin e tyre, titujt, emrat e vërtetë që ata ishin të emëruar dikur, llagapet e tyre, sebepin e vdekjes së tyre, sëmundjen e tyre, moshën e tyre, gjininë, lutjet dhe dëshirat e tyre që ata kishin nga Zoti (Krijuesi i tyre) dhe nga njerëzit, të gjithë këto vargje të formuluara në formë poezie dhe vërejtje kanë pasqyruar kulturën e një populli[1] përmes gurëve, që përbëjnë një vend të veçantë dhe autoritativ në folklorin tonë kombëtar shqiptar. Këto janë dokumentet e para të gdhendura në gurë, dokumente që na përcjellin në çdo hapaty ku toka është dhe ka qenë dikur e banuar me shqiptarë.

Mbishkrimet e varreve osmane (epitafet) që do t'i marrim në shqyrtim i takojnë periudhës ndërmjet viteve 1871/72 dhe 1930/31. Kultura shqiptare gjatë gjithë periudhave të zhvillimit të saj paraqet rëndësi dhe specifikë të veçantë gjatë ritualeve të rëndësishme jetësore si p.sh.: lindja dhe vdekja, rritja (zhvillimi), martesa, luftërat, vajtja në ushtri, etj. Secila prej këtyre ngjarjeve paraqet ndryshimin e saj përgjatë periudhave historike, dhe kjo më së shumti është dëshmi e gjallë gjatë varrimit të njerëzve në periudhat e ndryshme historike, ku do të hasim në varrosje të ndryshme të njerëzve, që në të vërtetë paraqesin kulturën tradicionale të varrosjes. Kur themi këtë, bazohemi në atë se gjatë periudhave të ndryshme kohore ka pasur varrosje të ndryshme të njerëzve.Kemi raste kur hasim varrosje të drejtpërdrejtë në dhé, ose

[1] EYICE Semavi, "Mezarliklar ve hazireler, Islam Dunyasinda Mezarliklar ve defin gelenekleri", pjesa I, Ankara, 1996.

përgatitja e një grope të veçantë për të futur të vdekurin, të vendosurit e tij brenda një dhome ose brenda arkivolit (sandëkut), ngritja e një monumenti përkujtimor memorial mbi varr në formën e mbjellë (gdhendja e gurëve si në këto raste), ose në çfarëdo forme tjetër vetëm për të shprehur respekt dhe nderim ndaj personit të vdekur dhe vlerësimin e veprave të tij të mira.[2]Pas kalimit të një kohe, e kaluara harrohet sado që përsëritet në mesin e njerëzve, dhe gjinia njerëzore jep komentime të ndryshme, por kur në themelin e këtyre varreve hasimgurë ose përmendore të shkruara me epitaf, atëherë kuptojmë se aty brenda janë duke pushuar besimet, kultura dhe folklori i atij populli. Pra edhe guri i varrit me mbishkrimin e tij në të është një produkt që vazhdimisht e mban të gjallë një kulturë të vazhdueshme tradicionale, mbishkrimi mbi gur e respekton të vdekurin që pushon brenda në varr, mban të gjallë kujtimin e tij krenar dhe të ndershëm dhe e bën të jetë i përkujtuar përgjithmonë, sa herë që do të ndërrohen brezat e rinj njerëzore.[3]

KATALOGU I TRE VARREVE QË DO T'I SHQYRTOJMË

Fotografi e varrit të Sheh Salim Efendiut, të birit të Sheh Salih Efendiut. Në foton nr. 1 është fotografuar nga afër pjesa e gurit të epitafit të shkruar në gjuhën osmane dhe kapuçi sipër me stilizimet e mëposhtme, në foton nr. 2 është fotografuar varri i tërë nga ana e pasme

[2] KÜTÜKOĞLU Mübahat, Tarih Araştırmalarında Üsûl, İstanbul 1994, 26, 27.
[3] ERTUĞ Necdet, "Osmanlı Mezar Taşları", "Osmanlı Ansiklopedisi", kap. IX, f. 223.

nga larg, dhe në foton nr. 3 është fotografuar nga ana e pasme pjesa e epitafit të shkruar, dhe fotografia është bërë nga afër.

EPITAFI (Mbishkrimi i varrit tek oborri (hazire) i"Tyrbes së Sheh Maksud Efendiut".

Shkrimi osman i nxjerrë nga origjinali i shkruar me alfabet origjinal të gjuhës arabe-osmane është kështu:[4]

دوی اصـــلی بولامـــادم دوشـدوم درده بـــر ناگهـــان
وفـــی (بـــی)نیـــدن دهرفـا بـــو اتمســـون کمســـلر
اجل بـــادی عمرمی نهـــالی اتـــدی قـرار بـــی
چاري بولامـــادی طبیبلـــــــر حیفلـــــــرکم[5]
بقـــی فانیـــــدن مسـکك اتـــدم جنـت[6]
کبریـــــا جنـاب اجر ایـده احسـان ایـدوب فـالـط
بـــن افنـــدی ســـالم الشـــیج المغفـــور المـرحوم
حلوتیـــــة طـــریق افنـــدی صـــالح الشـــیخ
تحـــة الفـــا ایچـــن روحی
١٢٨٨ســـنة

Transkriptimi me shkronja latine në gjuhën e re turke është kështu:

Nâ-gehân bir derde düştüm bulamadım aslâ devâ
Kimse me'mûl itmesûn bu dehr-i fânîden vefâ
Bî karâr itdi Nihâl-i' 'umrimi bâd-i ecel
Hayıflarkim tâbîbler bulamadı çâreyi
Cennet itdim mesken-i fânîden bekâ
Lütf idûp ihsân ide ecrin Cenâb-ı Kibriyâ

El merhûm el mağfûr Eş-Şeyh Sâlim Efendî bin Eş-Şeyh
Sâlih Efendî Tarîk-i Halvetiyye
Rûhîçûn El- Fâtiha
Sene 1288/1871-1872

[4] Shkrimi qëndron edhe sot edhe pse mund të themi se aty-këtu është dëmtuar pak, por sërish falë materialit të mirë të ndërtimit shkrimi pas çdo rreshje zbardhet dhe e ruan origjinalitetin e vet.

[5] Gjatë transkriptimit të këtij rreshti jam munduar shumë por duhet gjurmuar dhe më tej, meqë nga thyerja dhe koha është dëmtuar disi.

[6] Edhe në këtë rresht kam hasur të njëjtin problem.

Përkthimi i epitafit të shkruar në formë poezie të divanit në gjuhën shqipe:

Papritur rashë në një dert dhe nuk munda të gjej asnjëherë ilaçin,
Askush mos të presë nga kjo botë kalimtare besueshmëri,
Ma bëri jetën time të rregullt dhetaze të pavendosur sebepi i exhelit (bad-i exhel[7]),
Kisha frikë se as mjekët nuk ma gjetën çarën,
Tash e bëra Xhennet banimin tim të përhershëm (beka) pas banimit të përkohshëm (fani),
Bëra lutje që të ma shpërblejë me të mira shpërblimin, Atij që i takon Madhëria,
I mëshiruari, që është i falur Shejh Salim Efendiu,
i biri i Shejh Salih Efendiut nga drejtimi i tarikatit Halvetije,
Për shpirtin e tij këndo Fatihanë,
Viti: 1288-1871/72

Dimensionet e varrit të Sheh Salim Efendiut, të birit të Sheh Salih Efendiut, janë këto:

Perimetri i kapuçit të vënë mbi pllakat është 77 cm, ndërsa gjerësia e rrethit të tij është 21 cm. Gjatësia prej qafës e deri në tokë është 79 cm, 20 cm është lartësia vertikale e kapuçit deri te qafa, dhe 28 cm është gjatësia horizontale e pllakatit. Qafa është 10 cm deri në 18 cm, largësia ose gjatësia e krahëve është 10 cm. Gjatësia e plotë e pllakës është 113 cm, gjerësia është 52 cm, ndërsa gjerësia në anën e pjerrët është 10 cm. Ana e prapme gjithashtu ka këtë formacion: qafa është 11 cm, krahët 12 cm dhe gjerësia 5 deri në 30 cm. Pllaka e vënë mbi varr në simbol të dheut është 2, 37 cm, anët e tij janë 55 cm dhe 52, ndërsa gjatësia dhe gjerësia e anës së pasme të pllakatit janë gjatësia 60 cm dhe gjerësia 40 cm. Diametri i kokës është 45 cm, gjatësia e kokës është 26 cm, qafa është 7 - 10 cm, krahët 8 cm, gjatësia e anës vertikale të pllakës së pasme pas qafës është 1, 50 cm, ana horizontale 37 cm, gjerësia e pjerrët 8 cm, ana e përparme e pllakatit të poshtëm është koka 30 cm, qafa 6 - 12 cm dhe gjatësia 1 m.[8]

[7] DEVELLIOĞLU Ferit: "Osmanlica-Turkçe Ansiklopedik Lugat", fjala *bâdî* f. 63 dhe fjala *ecel*, f. 201, Ak Aydin Kitabevi, bot. i 29, viti 2009, Ankara - Turqi.

[8] Matjen e gurëve e bëmë ne personalisht. Përmasat e dhëna nuk tentojmë që të jemi plotësisht të saktë meqë dihet se me kalimin e viteve bëhet edhe shembja dhe prishja e gurit të mermerit, prandaj për çdo lëshim të ndonjë cm ose mm kërkojmë ndjesë.

Pllakata e varrit është e përpunuar nga mermeri.

Fotografia e varrit të shehbenderit (konsullit) Shereffudinit, të birit të Asëf Begut dhe nipit të Edip Efendiut. Foto nr. 1 është fotografuar nga larg, ana e pasme, foto nr. 2 afër nga ana horizontale, foto nr. 3 afër nga ana vertikale e pjesës së poshtme të varrit dhe foto nr. 4 ana e përparme nga larg.

EPITAFI (Mbishkrimi i varrit të shehbenderit (konsullit) të Turqisë në Vranjë, nipit të Edib Efendiut, Drejtori i Mallrave të Shenjta të Padishahut shehidi Sherefuddini, i biri Asëf Begut, varr i cili gjendet në varrezat e Preshevës.

Shkrimi osman i nxjerrë nga origjinali i shkruar me alfabet origjinal të gjuhës arabe - osmane është si më poshtë:

هوالخلاقالبـــــاقی
مظلومك شـــهيد بـــو رب يـــا
حياتنـــــدن ايـــدنلرى قصـــد حياتنـــــه
افنـــــدينك اديـــب ايلـــه مقهور
املاك ســـوريه حفيـــدى
آصـف مـديرى ونهماي
ايورانيـــــه اوغلـــى بـــك
الـــدين شـــرف شـــهيد شـــهبندرى
الفاتحـــــة روحيچـــون بـــك
سـنة ١٣١٤

Transkriptimi në gjuhën e re turke me shkronja latine i mbishkrimit të epitafit të varrit të shehbenderit (konsullit) të Turqisë në Vranjë,

Sherefuddin Begut, të birit të Asëf Begut, nipit të Edip Efendiut, Drejtorit të Mallrave të Shenjta të Padishahut në Siri:

Hüve'l Hal-lâku'l Bâkî
Yâ Rabbî bû şehîd-i mazlûmun
Hayâtına kasd îdenleri hayâtından
Makhûr eyle Edîb Efendînin
Hafîdî Sûriye Emlâk-ı
Hümâyûn Mudîrî Âsıf Bey oğlî Îvrânye
Şehbenderî Şehîd Şerefuddîn
Beg rûhîçûn El- Fâtiha
Sene 1314 (1898/99)

Ai (Allahu) është Ai që krijon gjithmonë,
O Krijuesi Im! Ata që kanë dashur me qëllim të qëllojnë,
Në jetën e këtij shehidi që i është bërë zullum,
Bëji jetët e tyre të brengosura (kahër).
Nipi i Edib Efendiut (Drejtori i Mallrave të Shenjta të Padishahut në Siri),shehbenderi (konsulli) i Vranjës,shehidi Sherefuddin, i biri i Asif Begut.
Për shpirtin e tij këndo Fatihanë.
Viti: 1314 (1898/99)

Përmasat e varrit të shehbenderit (konsullit) Sherefuddin, të birit të Asëf Begut dhe nipit të Edib efendiut janë: Gjerësia e katrorit të varrit është 1, 96 cm, pjesa e parë është 10 - 15 cm, pjesa e dytë 57 cm, pjesa e tretë forma e pjerrët është 20 cm, ana vertikale është 80 cm, gjatësia e pllakatës është 1, 35 cm, gjerësia 43 cm, gjerësia e dytë 13 cm.

Përmasat e kapuçit janë këto: gjatësia 25 cm, 69 cm gjerësia në fillim dhe 85 cm gjerësia në fund të kapuçit 85 cm, qafa 10 cm pjesa e parë dhe 7 cm pjesa e dytë, gjerësia ndërmjet qafës dhe krahëve 25 cm. Gjerësia e pllakatës ku është mbishkrimi 40 cm, gjatësia 1, 35cm, gjerësia tjetër 12 cm. *Kapuçi i pjesës së poshtme*: diametri 85 cm ndërsa gjatësia e kapuçit 47 cm. Gjerësia e qafës 54 cm, krahët 12 cm. *Pllaka e shtruar në tokë*: 2 m gjerësi dhe 2 metër gjatësi. Gropa në mesin e varrit është e hapur me gjatësi 90 cm dhe me gjerësi 5 - 28 cm.[9]

[9] Ky varr gjendet në varrezat e qytetit në Preshevë, koha dhe rreshjet kanë bërë të vetën, dhe sado që jemi munduar të jemi të saktë sërish na ka ikur ndonjë *cm* ose *mm*, prandaj kërkojmë ndjesë.

Pllakata e varrit të shehbenderit (konsullit) Sherefuddin, të birit të Asëf Begut dhe nipit të Edip efendisë është e ndërtuar me gurë mermeri. Është një varr shumë karakteristik që bie në sy për stilin dhe ndërtimin e tij të veçantë, dhe po ta shikosh nga larg e kupton se aty pushon një personalitet i veçantë, i lartë dhe me peshë. Ndodhet në anën e parë të varrezave të qytetit të Preshevës.

Shehbenderin e thërret në aktivitetin e synetllëkut (sünnet dügüni) kajmakami i Preshevës, por duke u kthyer e vrasin kaçakët (kusarët) e Preshevës, bile thuhet se duke dhënë shpirt i drejtohet kajmakamit të Preshevës duke i thënë: "Më thirre të më japësh pilaf të përgjakur?" (Kanli pilaf mi vermege çagirdin beni[10])?![11] Vranja[12] u pushtua nga serbët në vitin 1898[13], ndërsa Presheva deri në vitin 1912[14] ishte pjesë e shtetit osman, edhe Bujanovci gjithashtu. Prandaj, dhe Turqia me Serbinë bënë marrëveshje që t'i shkëmbejnë pozitat e tyre diplomatike, ambasadori shkoi në Beograd ndërsa konsulli (shehbenderi) qëndroi në Vranjë që të ishte afër Preshevës dhe vendeve të banuara me shqiptarë për të kryer obligimet e tyre nga afër. Për çdo çertifikatë ose vërtetim shqiptarët e Preshevës i drejtoheshin kajmakamit të Preshevës e ky i drejtohej shehbenderit (konsullit) të Turqisë në Vranjë dhe ai më pas do t'i drejtohej ambasadorit të shtetit osman në Beograd.

[10] Kjo është një deklaratë gojore e imam hafiz Lutfi Efendi Ahmedit nga Presheva, të cilën e transmetoi i biri i tij hafiz Avni Efendi Ahmedi.

[11] Historia dhe biografia e Shehbenderit duhet të studiohet dhe më shumë nga dokumentet osmane, të cilën do ta paraqesim një herë tjetër.

[12] Më 31 janar 1878 ndodhi beteja serbo - turke, ku mjerisht ushtria serbe e mundi ushtrinë turke, dhe në të njëjtën ditë në Edirne u nënshkrua edhe armëpushimi ndërmjet rusëve dhe turqve. Nikola P. Ilic, shih. "Oslobodjenj".

[13] ILIĆ, Nikola P., "Oslobodjenje Juzne Srbije", bot. Sloboda, Beograd, viti 1977.

[14] *Shukri Rahimi, Vilajeti i Kosovës më 1878 - 1912, Prishtinë, 1969; shih. SALIHU, Xhemaledin, "*Reformat administrative, territoriale e politike dhe ndryshimet themelore në strukturën etnike të popullsisë në Preshevë gjatë historisë"**.**

Fotografia nr. 1 është varri i hafiz Ymerit, të birit të hafiz Ibrahimit në gjendjen e vërtetë në të cilën ndodhet tani, ndërsa në fotografia nr. 2 është varri i hafiz Ymerit por i bashkuar sa për të lexuar.[15]

Epitafi (mbishkrimi i varrit të hafiz Ymerit, të birit të hafiz Ibrahimit, imamit dhe hatibit të xhamisë Sulltan Murat, njohësit të shtatëdhjetë e shtatë melodive (mekameve) të leximit të Kur'anit (Kiraet), varri i të cili gjendet në varrezat e Preshevës. Shkrimi osman i nxjerrë nga origjinali i shkruar me alfabet origjinal të gjuhës arabe - osmane është:

هو
المعيـــن الخـــالق الله
امام خصـــائل منـار منـــبر بـــر
قـرآن عاشـــقان افنـــــدىلردن جامع
ســلطان اســـكوبك
و امامى جـامعى مراد
حـــافظ علمـادن خطيـــبى
ابـــراهيم بـــن افنـــدى عمر
فاتحـــة روحيچـــن
١٣٤٦ ســنة

Hüvellahü'l Hâliku'i Mûîn
Bir Minber-i Menâr Hasâil-i İmâmı
Câmî-i Efendî-i Âşikân-ı Kirâât
Üsküb'ün Sultân Mûrâd Câmî-i İmâmı ve
Hâtîbî Ülemâından<u>Hâfiz</u>
<u>Ömer Efendî bin İbrâhîm</u>
<u>Rûhîçûn Fâtiha</u>
<u>Sene 1346/1930-31</u>

Përkthimi i mbishkrimit të varrit të hafiz Ymer efendiut, të birit të hafiz Ibrahim efendiut është kështu:

Allahu është Ai i cili ka krijuar gjithçka dhe është mbrojtës (ndihmues),
Një imam i veçantë i minberit të ndritur,

[15] Me ndihmën e hafiz Avni efendi Ahmedit e ngritëm gurin dhe e vendosëm në gjendje normale, gjë që i jam mirënjohëse.

Zotëri i rëndë i xhamisë, i dashuruar me Kur'anin (kiraete - shtatë llojet e leximit të Kur'anit),

Imami i xhamisë "Sulltan Murat" në Shkup, dijetar i shquar nga imamët dhe hatibët,

Hafiz Ymer efendiu, i biri i Ibrahimit,

Për shpirtin e tij këndo Fatihanë,

Viti 1346/1930-31.[16]

Dimensionet e varrit të Hafiz Ymerit, të birit të hafiz Ibrahimit janë këto:

Diametri i kapuçit është 70 cm, ndërsa gjatësia e tij në formë të rrumbullakët dhe të pjerrtë është 21 cm. Qafa është 8 cm vertikalisht dhe diametri 22 cm. Pllakati ka 42 cm gjerësi dhe 100 cm vertikalisht. Ana e pasme është 81 cm gjatësi dhe 10 cm + 18 cm nga horizontalja dhe ana e dytë e horizontales, ndërsa gjatësia deri në fund (ana vertikale) është 60 cm dhe 20 cm gjer në tokë[17]. Pllakati i gurit është bërë me gur mermeri. Këto përmasa janë pak të shpërqendruara meqë ky gur në formë të pjerrët është i ndarë në dysh, d.m.th. guri është i thyer në dy pjesë dhe gjatë nxjerrjes së shkrimit është dashur të ngrihet, të bashkohet dhe të nxirren shkronjat në përgjithësi.[18]

Analizë më e gjerë e tre varreve të mësipërme

Të tre varret që përmendëm, janë të stolisura me zbukurime, nga kapuçi që simbolizonte pozitën e tyre, në këtë rast të Sheh Salimit (pozitën e Shehut), që shehu[19] në atë kohë kishte pozitën e delegatit dhe mbikëqyrësit të popullit kur ata kishin halle.

Po ashtu edhe varri i shehbenderit (konsullit të Vranjës), dëshmorit Sherefuddin, të birit të Asif Begut dhe nipit të Edib Efendiut është i rrethuar me pllakë mermeri në formë katërkëndëshe, ndërsa sipër tij

[16] Ky gur është një gur i thyer por me një stil të veçantë të shkrimit, shprehjeve dhe stilit të kapuçit të pllakës së tij.

[17] Anën vertikale të gjatësisë së gurit e paraqesim në dy dimensione 60 dhe 20 *cm* meqë guri është i thyer tërësisht dhe i ndarë në dysh në formë të pjerrët.

[18] Sikurse në të gjithë gurët e tjerë, edhe këtu kërkojmë ndjesë meqë për shkak të thyerjes dhe shkatërrimit është e mundur që të hasim në vështirësi dhe lëshim të gabimeve në formë të padëshirueshme.

[19] PAKALIN, Mehmet Zeki, "Osmanlı Tarih Deyimleri ve Terimleri Sözlüğü", "Şeyh maddesi" - "kapitulli i Shejhut", kapitulli III, f. 346-347.

është vendosur pllaka e shkruar me shkrimin e llojit "thuluth",[20] lloj i shkrimit i cili ishte i përhapur në shkrimin e varreve të Rumelisë - Ballkanitmes periudhës 1800 deri më 1930.[21]

Nga varri i Sheh Salim Efendiut kuptojmë se ai ishte "Sheh[22]", vdiq në vitin 1288[23] - 1870/71 nga një sëmundje që as mjekët nuk mundën t'ia gjejnë ilaçin. Ky mbishkrim përbëhet nga njëmbëdhjetë rreshta të shkruar në formën e shkrimit "thuluth", ku gjashtë prej këtyre rreshtave i takojnë poezisë, dy rreshta janë për të identifikuar personalitetin e tij. Ndërsa në tri rreshta të vegjël njëri pas tjetrit radhitet porosia për këndimin e "Fatihasë", dhe më poshtë shënohet me shkronja viti dhe saktësohet viti 1288 - 1870/71.[24]

Në vargun e parë thuhet: "*Papritmas rashë në një brengë (dert) dhe nuk munda të gjej asnjëherë shërim*", në këtë rast këtu mund të konkludohet se i vdekuri vdiq nga ndonjë sëmundje që iu shkaktua papritmas apo edhe nga mërzia.

Në vargun e dytë thuhet: "*Askush mos të presë nga kjo botë kalimtare besueshmëri",* që nënkupton se kjo botë është kalimtare *(fani)*, dhe askush nuk mund të presë gëzim dhe lumturi, por edhe ndonjë dashuri nga fillimi e gjerë në fund sepse është botë kalimtare. Shprehja "*fani*" - "*faniden*" - "*fena*[25]" që nënkupton se kjo botë është "*kaluese ose urëkaluese për në botën tjetër*" thuajse përmendet në të gjithë gurët e varreve të shkruara nga autorët e tyre.

Në vargun e tretë thuhet: "*Ma bëri fundin e jetës sime të pavendosur sebebi i exhelit (bad-i exhel)*[26]*",* d.m.th. këtij i erdhi vdekja papritmas dhe iu çrregulluan planet dhe gjërat e tjera. Pra, te ky gur fundin e jetës e përshkruan me fjalën perse "*nihali*" që d.m.th. "*ana e poshtme e enës*, që në këtë rast simbolizon se ai është nën dhé, ku në formë alegorike

[20] DERMAN Uğur, "Mezar Kitabelerinde Yazı Sanatımız", TTOK Belleteni, 1975, f. 36-43.
[21] *Po aty*, f. 50.
[22] BUHARAJA Vexhi, vep. e cit., f. 81; shih MEHMETI, Sadik, "Tre mbishkrime..."faqja
[23] Viti është i shkruar në kalendarin "Rumi". Kjo na bëhet e qartë nga shkrimi i numrit dy (2).
[24] Sipas shkrimit të epitafit të shkruar osman të Sheh Selim efendiut, të birit të Sheh Salih efendiut.
[25] DEVELLIOĞLU, Ferit, vep. e cit., fjala (fânî) - (kaluese, joe përhershme etj.), f. 206; (fânîyyet - fânîden) - (relative, transformim, e kalueshme, jo e përhershme, nga jo e përhershmja etj.), f. 206, (fenâ) - (asgjësim, humbje, largim) f. 256.
[26] DEVELLIOĞLU, Ferit, vep. e cit., f. 63 dhe 201.

toka merr formën e pjatës dhe jeta mbi të është të qenit gjallë ndërsa pas vdekjes i thuhet jeta e dytë në varreza "*nihal-i omur*[27]" - "*jeta e poshtme*". Ndërsa, nëse thuhet pa e zgjatur shkronjën "I" atëherë merr kuptimin: "*taze, e rregullt, e syrgjynosur, etj*." Ndërsa, exheli ose dhënia e shpirtit, shpërngulja e shpirtit nga kjo botë në botën tjetër përshkruhet si një gjë që duhet të vijë nga një shkas, prandaj i thuhet: "*bad-i*[28]*exhel*" -"*shkaku ose sebebi i exhelit*". Prandaj thotë se jetën ma bëri të ç'thurur, të pavendosur, të pabalancuar shkaku që exheli i erdhi nga ai shkas dhe nga ajo sëmundje.

Në vargun e katërt thuhet: "*Kisha frikë se as mjekët nuk ma gjetën çaren*"- d.m.th. edhe pse frikësohej as mjekët nuk mundën t'i bëjnë çare. *Në vargun e pestë thuhet*: "*Tash e bëra Xhennet banimin tim pas banimit të përkohshëm (fani)*", që aludon se pas vuajtjeve të kësaj bote "*dunjas fani - botës sëpërkoshme*", e ka shndërruar botën e përhershme në një botë të lulëzuar në "*Xhennet*", që nënkupton se vuajtjet e kësaj bote do të shpërblehen. *Në vargun e gjashtë thuhet*: "*Bëra lutje që të ma shpërblejë me të mira Allahu i Madhëruar*". Ky varg është shkruar në formën e lutjes, të cilin pothuajse e hasim në të gjithë epitafet e gurëve të varreve. Lutja është pjesë e pandashme e ritualeve të besimit islam, prandaj edhe pas vdekjes, gjëja e vetme që mund ta ndihmojë të vdekurin është lutja[29]. *Në vargun e shtatë thuhet*: "*I mëshiruari, që është i falur Shejh Salim Efendiu i biri i...*", jepen të dhënat e emrit të plotë për të vdekurin i cili pushon në varr, që në këtë rast mësojmë se është Sheh Salim efendiu.Nga titulli "s*heh*[30]" mësojmë pozitën e "*shehut*" dhe rolin e rëndësinë e kësaj pozite që kishte si delegat, mësues dhe prijës i popullit të Preshevës me rrethinë, kapitull që do të flasim më gjatë, në një shkrim tjetër. *Në vargun e tetë thuhet*: "*Shejh Salih Efendiut nga drejtimi i tarikatit Halvetijje*", që është vazhdim i të dhënave më të plotësuara për personin në fjalë ku jepet edhe emri i babait të tij[31] dhe i drejtimit Halveti të dergahut që ai drejtonte. Në fakt, teqeja, semahanja dhe tyrbeja e "*Sheh Maksud Efendisë*", delegat në lidhjen e Prizrenit[32], i

[27] Ferit Develiogllu, vep. e cit., f. 835.
[28] SÂMI, Shemsuddîn, "Kamûs Turkî", Derseâdet (Stamboll), bot. "Ikdâm", viti 1317, bot. "Çagrı Yayinlari", shtypi: "Çevik matbaacılık", Stamboll, 2010, f. 260.
[29]LAQUER, HANS PETER, "Hüve'l Bâkî, İstanbul'da Osmanlı ve Osmanlı Mezarlıları ve Mezar Taşları, perkth. Selahattin Dilidüzgün, İstanbul, 1997, f. 80-81.
[30] PAKALIN, Mehmet Zeki, "Osmanlı Tarih Deyimleri ve Terimleri Sözlüğü", "Şeyh maddesi" - "kapitulli i Shejhut", kapitulli III, f. 346-347.
[31]SUBAŞI, M. Hüsrev, "Mezar Taşları Üzerine", Bülten, nr. 5, Stamboll, 1994, f. 11.
[32] "Vilajeti i Kosovës në Dokumente Osmane", Prishtinë, 2007.

takonte *Drejtimit të lartë "Halveti*". Teqeja e Preshevës gjithmonë quhej: "*Tarîkât-ı Aliyye-i Halvetiyye Dergâh-ı Şerîf*[33]" - "*Dergahu i shenjtë i drejtimit të lartë Halveti*", por me kalimin e kohës populli e quajti "*teqe*" ose "*tyrbe*", ndërsa "*Dergah*[34]" quheshin vendet kryesore nëpër qendra qytetesh që kishin një sërë veprimtarish, aktivitete dhe role të rëndësishme. *Në vargun e nëntë thuhet*: "*Për shpirtin e tij këndo Fatihanë*[35]". Kjo lutje përcillet në të gjitha mbishkrimet e epitafeve të varreve, ku porositen ata që e lexojnë për shpirtin e të vdekurit të lexojnë suren Fatiha, sureja me të cilën fillon libri i shenjtë Kur'ani[36]. *Në vargun e dhjetë* shkruhet vetëm fjala "*vit*[37]", ndërsa: *Në vargun e njëmbëdhjetë*: figuron viti i shkruar me numra arabë (1288 - 1871/72) që nënkupton se ky mbishkrim i këtij epitafi varri i takon kohës së sundimit të sulltan Abdulazizit "*Bahtsız şehid*"[38] (dëshmorit të pafat) i cili qeverisi mes viteve 25 qershor 1861 deri në 30 maj 1876. Ndërsa ky gurë i takonte viteve të fundit të periudhës së qeverisjes së tij.

Nëse e analizojmë në formë më të përgjithshme jetën dhe personalitetin e Sheh Salimit nxjerrim këtë përmbledhje: Sheh Salimi ishte "*Sheh*" në *Dergahun e Lartë të Drejtimit Halveti në Preshevë*. Ishte pjesëtar i familjes së njohur të "*Shehajve*", d.m.th. paraardhës i *Sheh Maksud Efendiut*, delegatit të "*Lidhjes së Prizrenit*"[39]. Vdiq papritmas nga një sëmundje apo nga shkaku që i solli exheli. Edhe mjekët u orvatën ta shërojnë por nuk mundën t'ia gjenë çaren. Ishte besimtar i devotshëm që këtë botë e shihte vetëm si botë kalimtare "*fani*" dhe jo të besueshme sepse gjithçka lind, rritet, zhvillohet dhe vdes, prandaj ai kishte si synim që në botën tjetër të siguronte Xhennetin. Ishte nga ata njerëz që lutej për të mirën dhe bamirësinë ndaj

[33] Bazuar sipas shkrimeve të dokumenteve origjinale që janë në arkivin privat të familjes së "Shehajve".
[34] SÂMI, Shemsuddîn, "Kamûs Turkî", vep. e cit., f. 606 dhe DEVELLOĞLU, Ferit, vep. e cit., f. 176.
[35] Sikurse në të gjitha varret edhe këtu porositet për lutje për shpirtin e të vdekurit me lexim të "Fatihasë", sureja e fillimit të librit të shenjtë Kur'anit, e cila përbëhet nga 6 ajete.
[36] Sure"Fatiha" është një sure e përbërë nga 6 ajete. Kjo është sureja e parë e librit të shenjtë të besimtarëve muslimanë Kur'anit.
[37] LAQUER, Hans Peter, f. 94.
[38] ÜNAL, Dr. Uğur, "Sultan Abdülaziz Devri Osmanlı Kara Ordusu 1861-1876, Ankara: "Genelkurmay Basım Evi", 2008, f. 3-6.
[39] REXHA Iljaz, "Lidhja e Prizrenit në dokumente osmane, 1878-1881", bot. i posaçëm i Arkivit të Kosovës, Prishtinë, 1978.

njerëzve, sepse vetë pozita e tij i kishte mundësuar që gjatë gjithë jetës së tij të jetë në shërbimin dhe të mirën e popullit të Preshevës dhe rrethinës së saj, ngaqë dergahu i asaj kohe luante rolin e shkollës, librotekës, faltores, vendit të adhurimit, spitalit, klubit zbavitës, qendrës për shërim dhe kompleksit të një hoteli bamirës dhe humanitar, që kujdesej për njerëzit udhëtarë dhe kafshët e tyre, dhe për njerëzit hallexhinj që vinin të largoheshin sadopak nga hallet dhe brengat e kësaj bote. Ai vdiq në moshë të re dhe nuk mundi t'i realizojë të gjitha planet e tij. Gjithashtu nga mbishkrimi i këtij epitafi të varrit mësojmë se *Sheh Salim Efendiu ishte i biri i Sheh Salih Efendiut*[40], i cili gjithashtu ushtronte pozitën dhe profesionin e shehut[41]po në këtë "*Dergah të Lartë të Drejtimit Halveti*" në Preshevë. Vdiq në vitin 1288 Hixhri, respektivisht në vitin 1870/71 Miladi.

Epitafi është i shkruar në poezi dhe është përshtatur për personin që bëhet fjalë, pra për *Sheh Salihun*. Lloji i kësaj poezie në letërsinë osmano - turke quhet *divan*, është i shkruar në strofë dhe rreshta që i përmbahen rimës (*haxhiv*).[42] Zakonisht epitafet e mbishkrimit të varreve shkruheshin në këtë lloj poezie, e cila përmblidhte: ankim, kërkesë për mos zhytje të thellë në këtë botë, vërejtje dhe sugjerim se kjo botë është botë kalimtare, lutje (dua) duke uruar të mira dhe fisnikëri, kërkim mëshire dhe falje për të vdekurin duke e cituar emrin e tij të plotë dhe të babait të tij, drejtimit, pozitës dhe profesionit, porosinë për leximin e sures Fatiha për shpirtin e tij dhe vitin e vdekjes, asnjëherë të lindjes së tij.[43]

*Në mbishkrimin e varrit të shehbenderit*të Vranjës, shehidit që e humbi jetën duke i bërë zullum sherefuddinit, të birit të Asif Begut dhe nipit të Edib Efendiut (drejtorit të mallrave të padishahut në Siri). Ky mbishkrim ndodhet në varrezat e qytetit në Preshevë. Për dallim nga të gjitha varret, ky varr përmban formën katrore të kutisë së ngritur sipër

[40] Sikurse në të gjitha epitafet edhe këtu figuron emri i prejardhjes së familjes që merret vesh se ishte i biri i Sheh Salih Efendiut edhe ky ishte "Sheh" dhe kishte pozitë të lartë sikurse i biri.

[41] BUHARAJA, Vexhi, "Mbishkrimet turko-arabe të vendit tonë si dëshmi historike", Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike II, Tiranë, Seria e Shkencave Historike, nr. 17, 1987, Prishtinë, 1988, f. 85; Shih: Sadik Mehmeti, "Tre mbishkrime varrore turko-arabe në fshatin Kuk të Opojës".

[42] KAPLAN Mahmut, "Divan Şiirinde Ölüm Düşüncesi", "Divan Şiirinin Kıyısında", bot. Kaşgar Neşriyat, Ankara, viti 2003.

[43]YENITERZI, Emine, "Divan şiirinde ölüme Dair Bazı Hususlar", universiteti "Selçuk Üniversitesi", revista e Institutit të Shkencave Sociale, 1999, nr.5, f. 115-139.

varrit dhe pllakatës së mermertë me kapuçin e "*shehbenderit*[44]*- fesin*[45]*- i cili ishte simbol i konsullit*"[46].Gjithashtu, varri përmban edhe zbukurime me lule[47], është i shkruar me llojin e shkrimit "thuluth"[48], është i përbërë nga njëmbëdhjetë rreshta, ku nëntë rreshta përshkruajnë historinë e vrasjes dhe prejardhjen e personalitetin e tij[49], si dhe dy mini - rreshta që citojnë vitin se kur ndodhi vdekja e tij. Fjala vit shënohet me shkronja dhe vetë viti i ndodhjes me numra, viti shënohet "rumi" 1314 - 1898/99[50]. *Në vargun e parë thuhet*: "*Ai (Allahu) është Ai që krijon gjithmonë*". Ky rresht është një nga rreshtat që pothuajse haset në 70 përqind të epitafeve të varreve të shkruar me shkrimin osman. Kjo është edhe një herë fjalë dëshmuese për ekzistimin e gjithmonshëm të Zotit dhe për forcën e krijimit dhe të rikrijimit të Tij[51]. *Në vargun e dytë thuhet*: "*O Krijuesi Im! Ata që kanë dashur me qëllim të qëllojnë*", në këtë rresht mallkohen vrasësit e shehbenderit (konsullit) të Vranjës, *Sherefuddinit, të birit të Asif Begut dhe nipit të Edib Efendisë*. Mallkimi vazhdon edhe *në vargun e tretë dhe të katërt, ku thuhet*: *Në vargun e tretë dhe të katërt* vrasësit mallkohen[52] në këtë formë: "*Në jetën e këtij shehidi që i është bërë zullum." "Bëji jetët e tyre të brengosura (kahr)*", duke dashur që jeta e tyre tani e tutje të jetë një jetë joe mirë, t'ju kalojë me brenga (*kahr*) sepse ata ishin shkaktarë që i bënë mizori në jetë Shehbenderit (konsullit) të Vranjës. *Në vargun e katërt* në vazhdim, në të *pestin dhe në gjashtin thuhet*: "*Nipi i Edib Efendiut (Drejtori i Mallrave të Shenjta të Padishahut në Siri), shehbenderi (konsulli) i Vranjës, shehidi Sherefuddin, i biri i Asif Begut*", pra përshkruhet emri i tij i vërtetë, dëshmori Sherefuddin, emri i babait të tij Asëf Begu, dhe emri i gjyshit të tij Edib Efendiu. Pozita e tij si "drejtor i mallrave të

[44] Vexhi Buharaja, vep. e cit, f. 81; Shih Sadik Mehmeti, "Tre mbishkrime varrore..."
[45] ŞEYBAN, Lütfi, "Osmanlı Dönemi Taraklı Mezar Taşları ve Kitabeleri, Sakarya Büyükşehir Kültür Yayınları, Adapayarı, 2007, f. 12.
[46] Fesin e bartnin njerëzit që ishin nëpër pozita të larta të shtetërore, diplomatike dhe arsimore.
[47] Sevim, Nidayi, "*Medeniyetimizin Sessiz Tanıkları"*, Mephisto, Stamboll, 2007.
[48] DERMAN Uğur, "Mezar Kitabelerinde Yazı Sanatımız", Türkiye Turing Otomobil Kurumu Belleteni, İstanbul,1975,sayı:49/328,s.41.
[49] BEHNAN, ŞAPOLJO, Enver, "Türk Mezar Taşları", Revista "Önasya", nr. 57, Stamboll, 1970, f.10.
[50] Edhe këtu dallohet qartë forma e shkrimit të vitit në "rumi".
[51] LAQUER, HANS PETER, "Hüve'l Bâkî, İstanbul'da Osmanlı ve Osmanlı Mezarlıları ve Mezar Taşları, perkth. Selahattin Dilidüzgün, İstanbul, 1997, f. 80-81.
[52] Shih ku fitet për gurët që shkruajnë mallkime: "Naci Bakırcı", Mevlevî Mezar Taşları, Stamboll, 2005.

shenjta të padishahut në Siri", si dhe pozita që ushtronte si shehbender (konsull),dhe më poshtë në *vargun e shtatëthuhet*: "*Për shpirtin e tij këndo Fatihanë*", dhe në fund citohet fjala *vit* me shkronja dhe viti i vdekjes në "*rumi*", pra *1314 - 1898/99.*

Në mbishkrimin e varrit të hafiz Ymerit, të birit të hafiz Ibrahimit thuhet kështu:

Allahu është Ai i cili ka Krijuar gjithçka dhe është Mbrojtës (Ndihmues),[53]

Një imam i veçantë i minberit të ndritur (vendit ku falet imami),[54]

Zotëri i rëndë i Xhamisë, i dashuruar në Kur'an (Kiraete - shtatë llojet e leximit të Kur'anit),

Imami i Xhamisë së "Sulltan Muratit" në Shkup, dijetarë i shquar nga imamët (falësit e pesë kohëve të namazit) dhe hatibët (predikuesit, ligjëruesit),

Hafiz Ymer Efendiu, i biri i[55] *Ibrahimit,*

Për shpirtin e tij këndo Fatihan,

Viti 1346/1930-31

Në vargun e parë: "*Allahu është Ai i cili ka krijuar gjithçka dhe është Mbrojtës (Ndihmues)".* Ashtu sikurse në të gjitha mbishkrimet e varreve, dhe këtu përshkruhet madhëria dhe respekti ndaj Zotit, si Krijues, Mbrojtës dhe Ndihmues. *Në vargun e dytë thuhet*: "*Një imam i veçantë i minberit të ndritur",* që nënkuptohet se ishte nga imamët e veçantë dhe të dalluar, personalitet i dalluar që shndriste minberin, d.m.th. kishte dituri dhe aftësi në atë profesion, i dinte mirë rregullat e faljes dhe leximin e Kur'anit. *Në vargun e tretë thuhet*: "*Zotëri i rëndë i xhamisë, i dashuruar me Kur'anin (kiraete - shtatë llojet e leximit të Kur'anit)"*. Në këtë varg Hafiz Ymeri përshkruhet se si një zotëri i rëndë i xhamisë, një njeri që e lexonte mirë Kur'anin dhe ishte i dashuruar me të, e kryente me pasion profesionin e vet si mision e jo

[53]LAQUER, HANS PETER, "Hüve'l Bâkî.. për ndryshim nga varret e tjera ky varr përmban mbishkrimin: "Ai Allahu është Krijues dhe Mbrojtës".

[54] Nga vetë pozita e emërimit të tij në xhaminë kryesore të Shkupit "Sulltan Murat" kuptojmë qartë se ai ishte një imam i veçantë, andaj dhe e ftuan që të shërbente në Shkup në kryeqytet në Xhaminë Qendrore "Sulltan Murat".

[55] Edhe pse në varr i shkruan "Hafiz Ymer Efendiu i biri i Ibrahimit", nga deklarata gojore të trashëguara brez pas brezi nga familja ime, tash Hafëz Avni Efendi Ahmedi e ky nga i ati i tij Imam Hafëz Lutfi Efendi Ahmedi, mësojmë se edhe ky ishte Hafëz d.m.th. e dinte Kur'anin përmendësh.

vetëm si profesion. Hafiz Ymeri ishte ndër të rrallët që i njihte "shtatë llojet e leximit të Kur'anit" dhe njihte shtatëdhjetë e shtatë melodi (mekame) për leximin e tij. Ndër ato mekame janë: *rrast, hixhaz, hixhazkari kurdi, sexhah, husejni, sabahi, hushak, huzzam, suznak, axhemashiran, nihavend,* etj.

Në muzikën turke janë verifikuar të jenë 590 melodi (mekame). Shumica nga këto melodi përdoren edhe në ditët e sotme, në përgjithësi përdorim të përhershëm zënë 150 melodi (mekame) ndërsa meloditë të cilat kanë dhënë vepra janë përafërsisht 40 melodi.[56]Hafiz Ymeri njihte shtatëdhjetë e shtatë (77) nga të gjitha mekamet që cituam më parë dhe këto mekame ua kishte mësuar dhe familjarëve të tij si p.sh. imam hafiz Lutfi Efendi Ahmedit.[57]

Nëse e shohim shkrimin e pemës familjare, gjenealogjinë (silsilenamen) e shkruar me shkrim osman nga myderriz hafiz Ali Efendi Ahmedinxjerrim se hafiz Ymeri, i biri i hafiz Ibrahimit ishte nip i Abdulkerim Efendiut i cili vazhdoi dhe kreu studimet fetare në Stamboll, d.m.th. që Abdulkerim Efendiu kishte djem hafiz Ahmed Efendiun, hafiz Ibrahim Efendiun dhe Jahja Efendiun.[58]

Një ilaçi (këngë fetare) që e shkruajti hafiz Ibrahimi në gjuhën e pastër osmane dhe melodinë e saj e kompozoi hafiz Sahiti nga Shkupi është ilahija: "Bejtullah" (Shtëpia e Zotit - Qabeja).[59]

Materialet e gurëve me mbishkrime osmane

Materialet e gurëve të varreve me epitafe osmane janë të punuara me mermer që merrej në Shkup, është gur kristalor i Shkupit, i quajtur ndryshe *"sheqer tash"* ose *"guri i Shkupit"*. Zakonisht dhe sidomos në fillim të mbjelljes, gurët e varreve janë porositur në Shkup dhe në rrethinën e tij nga mjeshtër vendas, dhe së këndejmi rrjedh edhe emri

[56] Mimaroglu Ilhan, "Muzik Tarihi" - "Historia e Muzikës", bot. "Varlik Yayinlari", 1995; Shih: "Muzikte sistem ve mekamlar" – "Meloditë (mekamet) dhe sistemi në muzikë", Ankara, 2007.

[57] Dëshmi gojore nga bijtë e tij Imam Hafëz Zihni Efendi Ahmedi dhe Hafëz Avni Efendi Ahmedi.

[58] Bazuar nga pema familjare, *silsilename* (gjenealogjia) e familjes, e shkruar nga myderrizi hafiz Ali Efendi Ahmedi.

[59] Kënga fetare (ilahija) e kënduar me zë është edhe sot e inçizuar në shtëpinë tonë. Ilahinë e këndoi imam hafiz Lutfi Efendi Ahmedi me melodinë (mekamin) që kishte mësuar nga hafiz Ymeri, sipas kompozimit të hafiz Sahitit. Informatat për këtë m'i dha hafiz Avni Efendi Ahmedi.

"gurë Shkupi". Këtë të dhënë e konsiderojmë mjaft domethënëse. Gurët e tillë kanë qenë të kushtueshëm dhe jo çdokush ka mundur të porosisë një të tillë.[60]

[60] MEHMETI, Sadik, "Katër mbishkrime varrore turko - arabe në fshatin Kuk të Opojës", kumtesë e mbajtur në simpoziumin ndërkombëtar.

Hatixhe AHMEDI

SUMMARY

THREE TOMBSTONE INSCRIPTIONS IN THE CITY OF PRESHEVA

As a conclusion to the deciphering of these gravestones, we achieve to prove that in the Valley of Presheva and its region there is an abundance of these stones engraved with Ottoman writing, however there is no conclusive discussion on the topic of the number of documents available in the Ottoman Archive at the Prime Minister's Cabinet, which no doubt serves as a proof to a valuable culture which holds a special place in Albanian national history. There are some gravestones in Preshevë which we are currently deciphering, including some that are found in the villages in the vicinity of Preshevë such as Miratoc, Rohovicë, Raincë and others. From an historical perspective, these incontestable documents provide main information pertaining to the history of this place. This is most visibly documented by Sheh Salim Efendia's gravestone, the son of Sheh Salih Efendi, whose gravestone is found at the graveyard of the High Dergjah at the Halveti concentration in Presheva.

The gravestones we presented, that of Sheh Salih, the Shehbender's (the consul) and Hafiz Ymeri, the son of Hafiz Ibrahmi, are a living proof of a century long historical document that teaches us about our past and pleads to us so that we preserve these gravestones in order to know our people by the writings, meaning, history and the message they contain. In the future, this will provide an incontestable service to us and become an example for other cities, as well as for the analysis of other old documents be it of the Ottoman or any other period. It is for this reason that we mentioned that the analysis of these publications holds a great historical, cultural and national value.

Marenglen VERLI

ME RASTIN E 50-VJETORIT TË REVISTËS "STUDIME HISTORIKE" (1964-2014)

Revista "Studime historike" është një revistë shkencore e sferës së albanologjisë, organ i Institutit të Historisë të Qendrës së Studimeve Albanologjike, e profilizuar në botimin e studimeve të shkurtra, apo artikujve, që lidhen kryesisht me historinë e popullit shqiptar nga antikiteti e mesjeta, deri në ditët tona. Përveç studimeve për tema të ndryshme të historisë, revista publikon edhe kumtesa të mbajtura në veprimtari të ndryshme shkencore (konferenca, simpoziume etj.), gjithashtu, dokumente arkivore me rëndësi të veçantë, pjesë memoaresh e materiale të zgjedhura të natyrës historike, mandej informacion për veprimtaritë shkencore, që organizohen nga Instituti i Historisë, ose ku marrin pjesë studiuesit e këtij instituti, etj. Periodikisht, jepet informacion edhe për botimet e Institutit të Historisë, për personalitete të fushës, kryesisht për shqiptarë, por edhe për albanologë të huaj etj.

Revista "Studime historike" është pasardhëse e revistës "Buletin i Institutit të Studimeve", që publikohej në vitin 1947, mandej e revistës "Buletin i Institutit të Shkencave" (1948-1952), më tej e revistës "Buletin për shkencat shoqërore" (1952-1957), dhe, së fundi, e revistës "Buletin i Universitetit të Tiranës – seria shkencat shoqërore" (1957-1964).

Pararendësi i parë i revistës "Studime historike", "Buletini i Institutit të Studimeve" ishte revista e parë shkencore në Shqipëri. Ajo u publikua nga Instituti i Studimeve, që u krijua në vitin 1946 si institucioni i parë i lartë kërkimor shkencor në Shqipërinë e Pasluftës së Dytë Botërore. Në kuadër të tij u krijua një seksion për gjuhësinë, letërsinë dhe historinë. Me këtë emër revista doli vetëm në një numër dhe më tej vijoi si "Buletin i Institutit të Shkencave", që ishte organ i Institutit të Shkencave (1948-1957), vazhduesit të Institutit të Studimeve. Në Institutin e Shkencave figuronin përsëri seksione për

gjuhësinë, letërsinë dhe historinë. Në vitin 1952 Buletini i Institutit të Shkencave u nda në Buletin për Shkencat Natyrore dhe Buletin për Shkencat Shoqërore. Ky i fundit trajtoi probleme të gjuhësisë, të historisë, të arkeologjisë, të etnografisë etj. (artikujt shoqëroheshin me përmbledhje në gjuhën frënge).

Në vitin 1955 seksionet e shkencave shoqërore u shkrinë duke formuar *Institutin e Historisë dhe të Gjuhësisë,* që në vitet 1957-1972 u inkuadrua në Universitetin e Tiranës. Në Institutin e Historisë dhe të Gjuhësisë në vitet 1955 deri në vitin 1972 u bashkuan seksionet e gjuhësisë e letërsisë dhe të historisë, sociologjisë e ekonomisë, që kishin vepruar në kuadër të Institutit të Shkencave. Gjatë periudhës 1957-1964 studiuesit e Institutit botonin në revistën "Buletin i Universitetit të Tiranës – seria shkencat shoqërore". Kurse që nga viti 1964, pra 50 vjet më parë, Instituti filloi botimin e dy organeve shkencore periodike të veta, pikërisht të revistës "Studime historike" (4 numra në vit) dhe të revistës "Studime filologjike".

Krijimi i Akademisë së Shkencave në vitin 1972, solli një riorganizim të institucioneve shkencore. Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, u nda në dy institute, përkatësisht në Institutin e Historisë dhe në Institutin e Gjuhës e të Letërsisë, të cilët ishin ndër institucionet kryesore të albanologjisë që u inkuadruan në Akademinë e Shkencave. Duke filluar nga viti 1973 revista "Studime historike", tashmë pronë e Institutit të Historisë, vijoi të botohej me 4 numra në vit. Në vitin 1979 në Institutin e Historisë numri i sektorëve u rrit nga 5 në 7 sektorë. Krahas sektorëve të mëparshëm të historisë mesjetare, të Rilindjes, të Pavarësisë, të Luftës Nacionalçlirimtare dhe të socializmit u krijuan rishtas sektori i historisë etnike dhe ai i historisë së Kosovës. Veprimtaria shkencore e këtyre sektorëve, ku inkaudroheshin rreth 35 studiues, publikohej rregullisht në revistën "Studime historike". Artikujt shoqëroheshin me një përmbledhje të shkurtër në gjuhën frënge, e cila më vonë, në vitet 90, u zëvendësua me gjuhën angleze.

Pas vitit 1991 numri i studiuesve dhe personelit ndihmës në Institutin e Historisë në rrethanat e tranzicionit, shkoi duke u reduktuar ndjeshëm. Pas reformës së vitit 2008, kur Instituti i Historisë u shkëput nga Akademia e Shkencave dhe u inkuadrua në Qendrën e Studimeve Albanologjike, të krijuar rishtaz, mbetën vetëm 16 studiues të organizuar në 3 departamente (ai i Mesjetës dhe Rilindjes Kombëtare, ai i Pavarësisë dhe ai i Historisë Bashkëkohore si edhe disa forca ndihmëse, që shërbejnë kryesisht në bibliotekën e Albanologjisë dhe në Arkivin e Institutit, të cilat duhet theksuar, se kanë qenë e janë shumë

të pasura e unikale dhe, fatmirësisht, janë ruajtur me fanatizëm. Në këto rrethana të reja revista "Studime historike", pas një ndërprerjeje dyvjeçare (nr. 3-4 /1991 u botua në vitin 1994), rifilloi të botohet një herë në vit (në vitet 1994-1997 u botuan nga një numër në vit për vitet 1992, 1993, 1994, 1995, 1996 dhe 1997), për të vijuar më tej me dy numra në vit, me rreth 250-300 faqe në çdo numër. Aktualisht synohet jo vetëm forcimi i karakterit të mirëfilltë historik të revistës por edhe shtimi në revistë i artikujve nga studiuesit e Institutit, gjithashtu, rritja e rubrikave, afrimi gjithnjë e më shumë i bashkëpunëtorëve të jashtëm cilësor dhe së fundi, gjithashtu, duke siguruar institucionalisht mbështetjen e nevojshme financiare, për t'iu rikthyer publikimit të 3-4 numrave në vit.

Gjatë viteve të ekzistencës, duke marrë pikënisje vitin 1964, revista "Studime historike", ka parë dritën e botimit 151 herë, duke publikuar rreth 38 000 faqe të veprimtarisë studimore e dokumentare nga historia jonë kombëtare.

Sipas një rregulli që vendoste drejtorin e Institutit të Historisë në pozicionin e kryeredaktorit, apo personit përgjegjës për revistën, nëpër vite atë e kanë drejtuar Stefanaq Pollo (1964-1991), Kasem Biçoku (1994-1996), Ana Lalaj (1997-2005), Marenglen Verli (2005-2007), Beqir Meta (2008-2014). Kurse në redaksinë e saj, gjatë 50 vjetëve të ekzistencës së revistës, kanë bërë pjesë Aleks Buda (zv.kryeredaktor), Deko Rusi, Gani Strazimiri, Luan Omari, Mentar Belegu, Petro Lalaj, Rrok Zojzi, Selim Islami, Zija Xholi, Muin Çami (zv. kryeredaktor), Hasan Ceka, Ndreçi Plasari, Viron Koka, Vladimir Misja, Aleksandër Meksi, Kiristaq Prifti (zv. kryeredaktor), Arben Puto, Besim Bardhoshi, Dervish Gjiriti, Koço Bozhori, Dhorka Dhamo, Myzafer Korkuti, Shyqyri Ballvora, Selami Pulaha (zv. kryeredaktor), Stavri Naçi, Iliaz Fishta (zv. kryeredaktor), Gazmend Shpuza, Veniamin Toçi, Xhemil Frashëri, Xhelal Gjeçovi, Luan Malltezi, Lefter Nasi, Dilaver Sadikaj, Hysni Myzyri (zv. kryeredaktor), Ferit Duka, Pëllumb Xhufi, Demir Dyrmishi, Fatmira Musaj, Hamit Kaba, Enriketa Kambo, Muharrem Dezhgiu, Dritan Egro, Ledia Dushku, Sonila Boçi, Edmond Malaj etj.

Në këto 50 vjet të ekzistencës revista "Studime historike" ka pasur bashkëpunimin e personaliteteve të spikatur të historiografisë shqiptare. Përveç anëtarëve të redaksive, njëherësh kontributore të revistës me produktin e vet shkencor, aty qëndrojnë firmat e Kristo Frashëri, Zija Shkodrës, Theofan Popës, Petraq Pepos, Ligor Miles, Paskal Milos, Petrika Thëngjillit, Ahmet Kondos, Franklin Xegës, Hëna Spahiut, Dhimosten Budinës, Kolë Lukës, Frano Prendit, Bep Jubanit, Zhaneta

Andreas, Apostol Kotanit, Iljaz Gogajt, Thoma Murzakut, Filip Liços, Vehxhi Buharasë, Zef Valentinit, Mikel Prenushit, Hysni Dajës, Piro Thomos, Mediha Shuteriqit, Dhimitër Andonit, Petro Shapos, Stilian Adhamit, Qamil Hasanit, Aleksandra Manos, Osman Myderizit, Aleko Harxhit, Drita Mehmetit, Skënder Anamalit, Spiro Shkurtit, Abaz Dojaka, Zef Prelës, Faik Lamës, Burhan Çirakut, Kaliopi Naskës (Karabecit), Aleks Luarasit, Shaban Çollakut, Pranvera Bogdanit (Novit), Përparime Hutës (Mengës), Nezir Batës, Zihni Haskajt, Mark Tirtës, Hysen Kordhës, Fatmira Ramës, Valentina Dukës (Kolçes), Zamir Shtyllës, Jani Sotës, Sokol Gjermenit, Ksenofon Krisafit, Pranvera Dibrës, Faik Qytykut, Liri Shimanit, Ariste Janos, Turhan Shilegut, Xhevat Repishtit, Zana Litos, Aurela Anastasit, Ilir Ushtelencës, Luan Zelkës, Nestor Nepravishtës, Pal Doçit, Dhimitër Dishnicës, Nelson Çabejt, Vangjel Kasapit, Qazim Xhelilit, Ilira Çaushit, Shyqyri Hysit, Kujtim Nuros, Irakli Koçollarit, Bajram Xhafës, Marenglen Kasmit, Hajredin Isufit, Adem Bungurit, Teodor Karecos, Sami Repishtit, Klara Kodrës etj. etj.

Në këtë kuadër do të duheshin përmendur edhe studiuesit shqiptarë ose me origjinë shqiptare, jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, të cilët kanë qenë të pranishëm në faqet e revistës që nga viti 1981 e veçanërisht në 20 vitet e fundit, si Ali Hadri, Rexhep Qosja, Gazmend Zajmi, Sabit Uka, Aleksandër Stipçeviq, Thoma Kaçorri, Gelcu Maksutoviç, Françesko Altimari, Nexhip Alpan, Pajazit Nushi, Fehmi Agani, Ymer Jaka, Emin Pllana, Masar Kodra, Hakif Bajrami, Muhamet Shatri, Ramiz Abdyli, Izber Hoti, Jusuf Bajraktari, Selim Daci, Zef Mirdita, Syrja Popovci, Emine Bakalli, Fehmi Rexhepi, Iliaz Rexha, Haki Kasumi, Musa Limani, Hysen Ibra, Skënder Rizaj, Flamur Hadri, Shkëlzen Raça, Sabile Basha (Keçmezi), Jusuf Osmani, Jahja Drançolli, Fehmi Pushkolli Fehari Ramadani, Muzafer Bislimi, Memli Krasniqi, Muhamet Mala, Frashër Demaj, Sabit Syla etj.

Nuk kanë munguar të prezantohen në revistën “Studime historike”, studiues të huaj si Alen Dyselje, Viktori Puzanova, Rusi Stojkov, Jens Reuter, Michail Shmid-Neke, Josef Macurek, Karl Göllner, Daniel György, Jashar Jyxhel, Hiqmet Syzer, Feyziogllu, Georgia Kretsi, Katerina Todoroska, Selda Kiliç, Orhan Kologllu etj.

Gjatë 50 viteve të botimit të revistës “Studime historike” artikujt e publikuar nga autorët e sipërpërmendur dhe më gjerë, kanë bërë objekt aspekte të rëndësishme për historiografinë shqiptare. Këto janë lidhur me momentet më kulmore të historisë së popullit shqiptar, për të

zgjeruar me kohë këndvështrimin në rrafshin kohor kronologjik dhe tematik.

Në këtë kuadër vëmendje e veçantë i është kushtuar periudhës dhe problemeve të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, gjithashtu të Shpalljes së Pavarësisë dhe konsolidimit e demokratizimit të shtetit shqiptar, të rezistencës antifashiste në vitet e Luftës së Dytë Botërore, të rezistencës antiosmane në shek. XV, veçanërisht viteve kur ajo u zhvillua nën udhëheqjen e Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, etj. Gjithsesi, kërkimi shkencor dhe artikujt e botuar në revistën "Studime historike", fillimisht, jo në pak raste, pësuan deformime tematike dhe përmbajtësore, për shkak të skemave ideologjike dhe censurës të imponuara nga PPSH, përmes aparatit të saj. Parimet marksiste mbi rolin negativ të fesë, mbi luftën e klasave, mbi rolin e masave etj., diktonin në punën e historianëve jo vetëm në shtjellimin e interpretimin e ngjarjeve por edhe deri në përzgjedhjen e dokumenteve.

Censura partiake rëndonte veçanërisht mbi temat që trajtonin historinë e shek.XX, posaçërisht ato të Luftës e Pasluftës së Dytë Botërore, ku nuk mund të devijohej nga gjykimet e shfaqura nga E.Hoxha. Pavarësisht nga pengesat e sipërpërmendura, në faqet e Revistës u botuan studime që përbënin një hap të rëndësishëm sasior dhe cilësor për historiografinë shqiptare. Të rëndësishme ishin arritjet në publikimet e arkeologëve dhe studiuesve të prehistorisë, të cilët për disa vjet ishin të inkuadruar në Institutin e Historisë dhe i botonin arritjet e tyre në revistën "Studime historike". Falë këtyre studimeve u ngrit në një nivel të ri dhe u ndriçua dukshëm historia e Ilirëve, që nga etnogjeneza e tyre deri në pragun e Mesjetës së Hershme.

Gjithashtu, në artikujt e botuar në revistë u hodh dritë mbi historinë e Mesjetës së Hershme në trevat arbërore, duke argumentuar praninë e shqiptarëve të hershëm në trevat e sotme të tyre, çka rrëzoi pikëpamjet e shfaqura për të kundërtën në historiografinë e huaj. Në artikuj të ndryshëm u trajtuan historia e formacioneve politike mesjetare të shqiptarëve, përkatësisht historia e Principatës së Arbërisë, u argumentua shqiptarësia e Principatës së Balshajve dhe veçanërisht u ndriçua formimi i shtetit të parë të pavarur kombëtar shqiptar të Skënderbeut.

Studiuesit e Institutit të Historisë dhanë në faqet e revistës vizionin e ri për periudhën e errët gati treshekullore, nga shek.XV në shek.XVIII, në trajtimin e temave shumëdimensionale me informacion të natyrës politike, ekonomike, shoqërore e kulturore. U ngritën në një

nivel tjetër edhe të dhënat për pashallëqet e mëdha shqiptare të fundshekullit të XVIII dhe fillimshekullit XIX, si dhe u publikuan studime të vyera që pasqyronin fillimet, karakterin, dinamikën dhe përmasat e Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Në saje të këtyre studimeve Rilindja jonë u dëshmua se ishte jo vetëm një lëvizje letrare, por një lëvizje kombëtare çlirimtare, demokratike dhe iluministe, sikurse simotrat esaj në popujt e tjerë të Ballkanit, që synonte krijimin e shtetit kombëtar.

Studimet mbi historinë e Shqipërisë pas Shpalljes së Pavarësisë, ishin veçanërisht të shumta në faqet e Revistës dhe me tematikë të larmishme. Në to ka mjaft publikime me vlerë, që trajtojnë probleme rreth shpalljes së Pavarësisë (1912), rreth çështjes shqiptare në Konferencën e Londrës (1913), për zhvillimet politike dhe ushtarake në Shqipëri në vitet e Luftës së parë Botërore (1914-1918), për qeverisjen e princ Vidit (1914), për qëndrimet rreth çështjes shqiptare në Konferencën e Paqes së Parisit (1919-1920), për zhvillimet në Kongreset e Durrësit dhe të Lushnjes (1920), për luftën çlirimtare të Vlorës (1920), për konfrontimet politike në vend periudha 1921-1924 dhe për Republikën e viteve 1925-1928 dhe Mbretërinë e viteve 1928-1939, për aspekte të jetës ekonomiko-shoqërore, për politikën e jashtme të Shqipërisë midis dy Luftërave Botërore etj.

Politizimin e ndjenë më shumë studimet me tematikë nga Lufta e Dytë Botërore dhe nga periudha e ashtuquajtur e socializmit. Në to konstatohet glorifikimi i kultit të Enver Hoxhës dhe PKSH/PPSh, denigrimi i kundërshtarëve, mbivlerësimi i rolit të PKSH gjatë Luftës ANÇL, si dhe vlerësimi maksimal për veprimtarinë politike, ekonomike, sociale, arsimore etj., të regjimit që sundoi përreth 45 vjet në Shqipëri në periudhën 1945-1991.

Në vitet ’80, në revesitën “Studime historike” filluan të botohen edhe artikuj të studiuesve të Institutit të Historisë për historinë e Kosovës dhe trevave të tjera shqiptare, pas shkëputjes së tyre nga shteti kombëtar me vendimet e Konferencës së Londrës në vitin 1913. Gradualisht u promovuan gjithashtu studiues shqiptarë nga Kosova e Maqedonia. Veçanërisht në 24 vjetët e fundit numri i autorëve dhe larmia e temave për rreth 100 vjet të historisë së viseve shqiptare jashtë Shqipërisë dhe për diasporën është shtuar ndjeshëm. Gjithashtu nuk janë më tabu edhe temat për minoritetet. Në këtë mënyrë, në një shtrirje gjeografike që bën objekt studimi gjithë universin shqiptar të shek.XX, janë botuar në revistë probleme rreth situatës së shqiptarëve në Kosovë, Çamëri e më gjerë, rreth politikës së ndjekur ndaj tyre nga

qarqet drejtuese të Serbisë, Malit të Zi, Greqisë, Mbretërisë Jugosllave dhe Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë, madje rreth organizatave, qëndresës dhe personaliteteve shqiptare në trevat e sipërpërmendura etj. etj.

Në vitet 90-të e në vazhdim, me vendosjen e pluralizmit politik në Shqipëri, me shpërbërjen e RFSJ dhe pavarësimin e Kosovës, si edhe me fitimin e një statusi të ri nga shqiptarët në Maqedoni e në Malin e Zi, në revistën "Studime historike" po botohen studime ku autorët parashtrojnë lirisht pikëpamjet e tezat e veta. Me këtë rast janë bërë hapa të rëndësishëm për trajtimin sa më objektiv e shkencor të shumë temave. Me konceptim të ri e me një bazë burimore bibliografike e dokumentar të shtuar, autorët kanë begatuar vitet e fundit revistën me prurje sasiore, aq edhe cilësore. Ajo është treguar mjaft aktive edhe në publikimin e kumtesave të një varg veprimtarish shkencore të rëndësishme si Konferenca shkencore kushtuar 80-vjetorit të Pavarësisë (Tiranë, 1992), Konferenca shkencore kushtuar çështjes së Kosovës (Tiranë, 1993), Konferenca kushtuar 2000 vjetorit të Krishtërimit në Shqipëri (Tiranë, 1999), Konferencat kushtuar 125-vjetorit dhe 130-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (Prishtinë, Tiranë, 2003, 2008), Konferenca kushtuar 600-vjetorit të lindjes së Skënderbeut (Tiranë, Prishtinë, Shkup, 2005), Konferencat shkencore kushtuar 95 dhe 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë (Tiranë, Prishtinë, Shkup, 2007, 2012), Konferenca për Mbretërinë Shqiptare (Tiranë, 2008), Konferenca kushtuar 100-vjetorit të Principatës Shqiptare (Durrës 2014), Konferencës kushtuar 100-vjetorit të fillimit të Luftës së Parë Botërore (Prishtinë), Konferencave kushtuar ngjarjeve të Luftës së Dytë Botërore dhe Lëvizjes Antifashiste (1999, 2013, 2014, Tiranë, Prishtinë), Konferencave kushtuar Komitetit "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës" (Shkodër, 2003) etj.

Në këtë 50-vjetor të jetës së saj revista "Studime historike" dhe brezat e studiuesve që kontribuan për të, kanë të drejtë të krenohen për një bilanc shumë pozitiv, të arritur në vite me shumë mund e pasion, duke përballuar vështirësi objektive e subjektive. Tradita duhet çuar më tej dhe në Institutin e Historisë besohet se instancat vendimarrëse do ta arsyetojnë e mbështesin materialisht idenë që studimet më të mira në vijim të publikohen periodikisht edhe në gjuhë të huaja.

Jorina VERLI

INTERESIMI DHE NDËRHYRJA E AUTORITETEVE ITALIANE TË PUSHTIMIT MBI PROBLEMET FETARE NË SHQIPËRI

Në orientimet e veta strategjike Italia, në periudhën midis Dy Luftërave Botërore, i kushtoi vëmendje të veçantë depërtimit në Shqipëri në të gjitha fushat, politike, ekonomike, arsimore, kulturore, fetare etj. Dihet se përmes Shqipërisë Benito Musolini, diktatori i madh italian, që dominoi politikën e Romës në vitet 1922 - 1943, planifikonte depërtimin dhe zgjerimin e Perandorisë Italiane në Ballkan. Në këtë kuadër, problemet fetare dhe komunitetet fetare në Ballkan e veçanërisht në Shqipëri, e cila përbënte objektivin e parë të politikës ekspansioniste të Romës matanë Otrantos dhe karakterizohej nga ekzistenca e disa komuniteteve fetare, u vunë në fokusin e vëmendjes së qarqeve drejtuese italiane.

Nuk kemi kryer hulumtime në ato nivele që të japim detaje për kohën e saktë dhe intensitetin e kësaj vëmendjeje, që pa dyshim ekziston qysh para shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, më 28 Nëntor 1912, dhe vijoi në periudhën midis Dy Luftërave Botërore, por kemi në duar dokumente interesante të diplomacisë së Romës, që e pasqyrojnë atë në vitin 1939, domethënë menjëherë pasi Italia pushtoi Shqipërinë. Njeri nga këto dokumente është një raport prej 11 faqesh, i cilësuar "rezervat", me titull "Situata fetare në Shqipëri"[*]. Vëmendja kryesore në këtë raport gjithëpërfshirës për çështjen në fjalë, trajton disa çështje.

E para në trajtim është historia e përpjekjeve për të ngritur kishën unite në Shqipëri, një amalgamë kristiane, katoliko - ortodokse, që do të kishte për drejtues Papën e Romës. Të interesuar për këtë unifikim,

[*] *Archivio del Ministero degli Affari Esteri, Roma* (Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë), Fondi: Sottosegretariato degli Affari Albanesi, Anno 1940, Pacco 56.

qarqet e larta politike italiane ishin të vëmendshëm të gjenin prononcimet pro dhe kundra idesë në fjalë.

Duke e pasur fjalën për myslimanët, në raport, në sythin e parë që titullohet njësoj si titulli i përgjithshëm: *"Situata fetare në Shqipëri",* thuhet:

"a) ... Nga ana tjetër ekziston një tendencë për të formuar një front unik me besimet e tjera kundër lëvizjes komuniste "pa Zot", dhe kështu për të krijuar marrëdhënie më të mira me katolikët dhe deri tek diskutimi miqësor publik mbi çështjet fetare ("Zani i naltë"; organ i komunitetit mysliman, numri i Prillit 1936, artikulli; "Çfarë urdhëron Kurani"),

b) Grekët skizmatikë janë më pak refraktarë ndaj aksionit misionar, të ndryshëm midis tyre për sa i përket ndjenjave fetare; shumë, për nder të grupit të tyre që mendojnë se është çnderuar nga paaftësia dhe padenjësia e kleritskizmatik, të tjerë për ndjenja patriotike.

Pengojnë lëvizjen drejt bashkimit:

- propaganda grekofile,

- kisha skizmatike autoqefale, që imponohet nga regjimi dhe te gjitha grupet skizmatike shqiptare, jo vetëm për t'u larguar nga ndikimi i vendeve te huaja, por edhe për të ndaluar shkrirjen me katolikët, nga e cila do të kishte rezultuar një minorancë e krishtere shumë e fortë.

Sllavo - skizmatikët e Shkodrës, të detyruar të hyjnë tashmë nën kishën autoqefale, janë sot më shumë se kurrë kundër, për arësye interesi, gjuhe dhe ritesh. Duket sikur presin së shpejti të kenë peshkopin e tyre te ritit sllav, të riun Elia Banushi, që po përfundon studimet në Universitetin e Beogradit.

c) Grupi grek - unit është ende shumë i papërmbushur dhe i penguar nga kisha autoqefale skizmatike.

Më tej në raport figuron sythi:

"Të dhëna të shkurtra mbi konfesionet e ndryshme", ku jepen të dhëna për vendndodhjen dhe përbërjen numerike dhe organizim kishtar të komunitetit katolik, atij mysliman - synit, bektashi dhe ortodoks.

Të dhëna të shkurtra mbi konfesionet e ndryshme

Katolikët

Katolikët janë thuajse tërësisht të vendosur në Shqipërinë e Veriut dhe në atë të Mesme. Pavarësisht numrit të pakët, janë një e dhjeta e popullatës së vendit, dhe kuadri i përgjithshëm misionar përfshin:

Arkidioqezat në Durrës,
Arkidioqezat në Shkodër,
Dioqezat në Alessio,
Dioqezat në Sapë (Zadrimë),
Dioqezat në Pult,
Abacia në Orosh.

Myslimanët

Myslimanët kanë udhëheqësin e tyre të besimit, "Krye-myftiun", në Tiranë. Nga ai varen, Seminari i kryeqytetit, nga i cili dalin murgjit e rinj, si edhe myftinjtë që janë vendosur në qytetet kryesore: Shkodër, Durrës, Korçë, Berat, Gjirokastër, Vlorë.
Midis myslimanëve, synitë, përbëjnë thuajse shumicën e banorëve, ata që dikur njihnin autoritetin e Kalifit dhe që sot konsiderohen pjesa ortodokse e islamizmit. Bektashinjtë dhe halvetinjtë janë sekte.

Mungesa e të dhënave dhe statistikave të sakta nuk lejon njohjen e organizimit të tyre të brendshëm dhe numrin e anëtarëve. Mund - ndër të tjera - të thuhet që bektashinjtë janë sekti më i njohur. Këta besimtarë jetojnë në objekte të ndërtuara në Shqipërinë Veriore dhe të Mesme, të quajtura "Teqe" dhe gëzojnë - për ndershmërinë, për respektin ndaj traditave të vendit, për mënyrën se si ndoqën ngjarjet politike që sollën pavarësinë e vendin - shumë kredit (besim, autoritet, respekt), sidomos në krahinat e jugut.

Myslimanët, e gjithashtu të krishterët ortodoksë, nuk kanë organizata misionare si ato katolike, që kanë për qëllim të

propagandojnë fenë dhe ta mbajnë gjallë nëpërmjet mësimit të katekizmit dhe predikimeve.

Ortodoksët

Ortodoksët, thuajse tërësisht të vendosur në Shqipërinë e Jugut dhe atë të Mesme, janë, siç është thënë, në total rreth 200 000, pra dyfishi i katolikëve.

Në të kaluarën ata njihnin autoritetin e Patriarkut grek të Konstandinopojës.

Më 1922, nën shtysën e nacionalizmit dhe të Imzot Fan Nolit, një Kongres i Ortodoksëve në Berat, u shpreh qartë për shkëputjen nga Patriarku dhe për themelimin e Kishës Autoqefale Shqiptare.

Por vullneti i tyre gjeti në praktikë shumë kundërshti në krerët autoritarë të klerit dhe në abstenimin e pjesës më të qetë dhe më të moshuar të besimtarëve, të cilët e mbanin veten të lidhur me traditat antike fetare të familjes. Kundërshtitë dhe dy revolucionet e vitit 1924[*]*, i fundit që solli edhe ndryshimin rrënjësor të regjimit, nuk i lanë mundësi krijimit të kishës autoqefale shqiptare.*

Në një pikë më vete në raportin *"Situata fetare në Shqipëri"* jepen të dhëna dhe për ndjekësit e kishës unite. Ndër të tjera në këtë pikë shkruhet:

"...I respektueshmi edhe sot, Dervish Bej[**]*, që e këshilloi Papa Jorgjin të bëhej katolik. Papa Jorgji nuk hezitoi të pranonte sugjerimin dhe për ta vënë në praktikë, përdori Konsullatën Austriake në Durrës, duke arritur të mashtronte klerin katolik dhe vetë jezuitët, finalizoi kalimin në Kishën e Romës.*

Por edhe pas këtij kalimi në unit aktiviteti i tij ishte negative, sepse qëllimi i tij i vetëm ishte të zhvaste asistencë/ndihmë.

[*] Është fjala për konfrontimet e armatosura të vitit 1924, që larguan dhe risollën në pushtet grupimin politik të kryesuar nga Ahmet Zogu.

[**] Është fjala për një nga figurat potenciale në Elbasan dhe në Shqipëri, Dervish Bej Biçakun.

Pas vdekjes së tij rreth 1928, vepra e unitizmit u ndërmor nga Imzot Pietro Scalpelli - italian - dhe në momentin e parë u duk që lëvizja do të zgjerohej me hapa të shpejtë, gjë që më pas nuk ndodhi. Me fondet e Legatës Mbretërore [të Italisë] u ngrit të 1929 në Elbasan një kishë.

Një syth tjetër i raportit i kushtohet Urdhrave fetare në Shqipëri, i cili titullohet: "Urdhra fetare shqiptare dhe italiane".

Lidhur me katolikët në raport shkruhet:

URDHRA FETARE SHQIPTARE DHE ITALIANE

Nuk mund të flasim për urdhra fetare qartësisht të ndarë për sa i përket kombësisë, por në njëfarë mënyrë mund të jepet lista e mëposhtme:

- *kleri shekullar – të gjithë shqiptare – përveç një peshkopi italian në Kuçovë (A. I. P. A.);*
- *kleri grek-unit: 2 shqiptare, 1 italo-shqiptar;*
- *shoqëria e Jezusit (jezuitët): 41 italianë, 15 shqiptarë, 1 kroat;*
- *Murgjit e vegjël (franceskanë) të gjithë shqiptarë, përveç njërit me shtetësi gjermane.*

Për "françeskanët" që numërohen rreth 100, "lazaristët", "unitet", "motrat stigmatine", "engjëjt e mëshirës", "selasianët" etj., thuhet:

Nga franceskanët vihet re një lloj ksenofobie, e kuptuar në sensin që, nuk duan të kontrollohen nga të huajt dhe kanë për synim të shfaqen të vetmit kontribues në kulturën dhe progresin e vendit të tyre.

Të bindur se propaganda, nëse e bërë mbi baza nacionale është e aftë të sjellë sukses dhe rendiment më të lartë, kanë qëllim të zgjerohen duke zëvendësuar misionet e tjera në jug; dhe qeveria qendrore natyrisht i favorizon. Në vizitën e fundit që Ati i Përgjithshëm i O.F.M., Leonardo Maria Bello, zhvilloi në Shqipëri, u vu re një konfirmim publik për sa u tha më lart, nga vëzhgimi i manifestimeve plot devotshmëri dhe respekt të autoriteteve shqiptare ndaj klerit të lartë.

Jezuitët: Mision i varur nga Provinca e Venecias. 61 subjekte, nga të cilët 26 priftërinj, të tjerët klerikë dhe laikë;

1 famulli: Tirana;

1 kishë, jo e famullisë, në Shkodër, që ushtron detyra të shenjta të ndryshme;

1 mision i lëvizshëm me seli në Shkodër për predikimin e Misioneve të Shenjta midis katolikëve;

1 seminar papnor në Shkodër për formimin e klerit shekullar;

1 lice-gjimnaz në Shkodër (për momentin i limituar);

1 shkollë teknike tregtare dhe pedagogjike në Shkodër (për momentin e limituar);

1 elementare në Shkodër (për momentin e limituar);

1 gjimnaz me konvikt në Tiranë (për momentin e limituar);

1 elementare në Tiranë (për momentin e suprimuar);

1 jetimore në Shkodër;

1 tipografi në Shkodër me dy revista:

"Leka" kulturore;

"Lajmtari" fetare;

Organizata të ndryshme në Shkodër dhe Tiranë;

1 prift resident në Elbasan në shërbim të katolikëve latinë dhe grekëve-unitë.

LAZARISTË: rezidenca në Korçë me një prift të vetëm italian për ushtrimin e shërbesave të ndryshme të shenjta midis italianëve dhe shqiptarëve dhe vetë të huajve.

1 PRIFT ITALIAN rezident në Kuçovë.

3 PRIFTËRINJ TË RITIT UNIT me kishë në Elbasan për Unitet.

MOTRAT STIGMATINE: 1 shkollë magjistrale me konvikt në Shkodër (për momentin e suprimuar).

1 shkollë pune në Shkodër.

1 shkollë fillore në Tiranë (për momentin e suprimuar).

Shkolla të ndryshme fillore dhe kopështë fëmijësh në Shkodër, në Shirokë dhe rrethina (për momentin të suprimuara).

Organizata të ndryshme femërore.

ENGJËJT E MËSHIRËS:

1 shkollë pune në Durrës;

1 elementare në Durrës (për momentin e limituar);

1 elementare në Tiranë (për momentin e limituar);

Asistencë spitaleve civile dhe ushtarake shqiptare në Tiranë dhe spitalit të vogël dhe ambulancës italiane në Durrës;

Asistencë fetare kolonisë italiane në Shijak.

SALESIANE: 1 jetimore me shkollë fillore në Shkodër (për momentin e limituar);

1 shkollë pune në Shkodër (për momentin e limtuar);

Asistencë spitalit të vogël italian në Shkodër.

SERVITE: 1 kopësht fëmijësh në Shkodër (për momentin i suprimuar);

1 kopësht fëmijësh në Tiranë (për momentin i limituar).

MURGESHAT E MËSHIRËS SË KALLMETIT: asistencë famullisë.

MURGESHAT E MËSHIRËS SË ZAGREBIT: asistencë spitalit civil shqiptar në Shkodër.

*

* *

Në dosjen për probleme të fesë e komuniteteve fetare në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Italisë, përkatësisht në "Nënsekretariaton e çështjeve shqiptare" kemi veçuar edhe organizimin e komunitetit katolik në Shqipëri, të përmbledhur me 6 dioqeza që shtriheshin në 115 vendbanime:

LEGATA MBRETËRORE E ITALISË NË TIRANË
LISTA E FAMULLIVE KATOLIKE NË SHQIPËRI

Lista e famullive katolike ekzistuese në Shqipëri

I. Arkidioqezat e Shkodrës

1. Baiza
2. Barbullushi
3. Beltoia
4. Berdica
5. Boga
6. Bushati
7. Dajçi
8. Hoti
9. Jubani
10. Jushi
11. Kastrati
12. Kolaj
13. Kukli
14. Mazreku
15. Oboti
16. Pentari
17. Pulai
18. Reci – Lohe
19. Renci
20. Riolli
21. Shkodra
22. Selca
23. Sheldia
24. Shiroka
25. Shkreli
26. Shllaku
27. Stajca
28. Trushi
29. Vukli

II. Arkidioqezat e Durrësit

1. Bazja
2. Biza
3. Blaj
4. Delbinishti
5. Dervendi
6. Durrësi
7. Juba
8. Kmella
9. Korça
10. Kuçova
11. Kurbini
12. Laçi
13. Lura
14. Miloti
15. Perlati
16. Rështeasi
17. Rrsheni
18. Selita
19. Shna Prende (Skraj)
20. Tirana
21. Vlora
22. Zheja

III. Dioqeza e Lezhës

1. Lezha
2. Breg Mati
3. Bulgri
4. Kakariqi
5. Kallmeti
6. Kryeziu
7. Manatia
8. Merqia
9. Plana
10. Reia (Rubiku)
11. Velia
12. Zeimeni

IV. Dioqeza e Mirditës

1. Blinishti
2. Kaçinari
3. Kalivari
4. Kashnjeti
5. Korthpula
6. Fandi
7. Mnella
8. Nerfandina
9. Oroshi
10. Qafamalit
11. Shëngjergji
12. Spaçi
13. Ungrei
14. Vigu
15. Gomsiqe
16. Gryka e Gjadrit

V. Dioqeza e Pulatit

1. Curraj
2. Dushmani
3. Giani
4. Kiri
5. Nikaj
6. Palci
7. Plani
8. Pogu
9. Prekali
10. Raia
11. Shala
12. Suma
13. Thethi
14. Toplana
15. Shoshi

VI. Dioqezat e Sapës (Zadrimës)

1. Baba
2. Berisha
3. Blinishti
4. Qelza
5. Dajçi di Zadrima
6. Dushi
7. Dardha
8. Fira
9. Gjadri
10. Gramshi
11. Haimeli
12. Iballa
13. Kqira
14. Kodheli
15. Komani
16. Kryeziu
17. Laç
18. Naraci
19. Nenshati
20. Pistulli
21. Troshani

Është e ditur se shtetit i duhen informacione të shumta dhe të sakta për gjithçka, dhe mbi bazën e tyre organizohet puna qeverisëse. Në këtë sens interesimi i autoriteteve italiane të pushtimit, veçanërisht në vitin 1939, për situatën në Shqipëri, përfshi edhe të dhënat për fetë dhe komunitetet fetare janë të kuptueshme. Po çfarë synimi kishin qarqet e larta drejtuese të Perandorisë Italiane? Cila do të ishte politika e tyre dhe si mendonin ato të vepronin ndaj klerit dhe komuniteteve të ndryshme fetare në Shqipëri? Përgjigjen e këtyre pyetjeve na e jep një dokument tjetër në të njëjtën dosje i datës 18 shtator 1939. Përmbajtja e tij nuk ka nevojë për koment.*

Ministria e Punëve të Jashtme
Nënsekretariati i Çështjeve Shqiptare - Zyra 1

SHËNIM

...Kemi nderin të sjellim në vëmendjen tuaj këto çështje:

1. *Luogotenenza e Përgjithshme në Shqipëri, për të thyer pikërisht këtë strukturë myslimane, po i jep rendësi të veçantë sektit bektashi, si më i madh në numër dhe më luftëtar.*

2. *Krerët e kishës ortodokse lenë të kuptohet se kërkojnë kalimin e besnikëve të tyre në unitizëm. Luogotenenza vazhdon të lerë përshtypjen se nuk kërkon ta nxitojë këtë ngjarje, por në të vërtetë, sipas udhëzimeve të kësaj ministrie, po e favorizon në mënyrë të fshehtë.*
3. *Pasi të arrihet bashkimi i katolikëve me ortodoksët dhe ndarja e prerë midis synive dhe bektashinjve, do të arrihet në pikën ku do të kemi ekuilibrin e duhur të grupimeve të ndryshme fetare në Shqipëri.*
4. *Në vend, ndodhet tashmë një komision i Institutit Qendror të Statistikës, i cili gjatë regjistrimit të popullsisë, do të mbajë shënime edhe për çështjet e besimeve fetare.*

Romë, 18 shtator 1939

Përzgjedhja, përkthimi, redaktimi
dhe pajisja me shënime nga:

Jorina Verli

RECENSIONE

Marenglen VERLI

Ledia Dushku: **Kur historia ndau dy popuj fqinj. Shqipëria dhe Greqia (1912-1914)**, Tiranë: Kristalina-KH, 2012, 379 f.

Monografia e Dr. Ledia Dushkut "Kur historia ndau dy popuj fqinj. Shqipëria dhe Greqia (1912-1914)", ndonëse trajton një periudhë e tematikë jo pak të njohur e trajtuar nga historiografia deri më sot, na vjen si një befasi e këndshme me plot risi, detaje, argumente, analiza logjike e elegancë në paraqitje.

Studiuesja Ledia Dushku ka guxuar dhe ja ka dalë me sukses të na ofrojë një monografi me parametra cilësore, e cila është sprova, që e fut në radhën e historianëve të formuar, skrupulozë e me kërkesa ndaj vetes. Natyrisht monografia është edhe ndër arritjet e Institutit të Historisë, që erdhi në kohën e duhur duke kompletuar kolanën e botimeve që Instituti kishte programuar të botonte në kuadër të 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë.

Konstatoj me kënaqësi, duke parë çka është arritur në këtë monografi, se koha e shpenzuar për të mbërritur te ky finalizim, nuk është kohë e humbur, sepse ka shërbyer për të na ofruar një produkt cilësor. Njëherësh ka ndikuar në formatimin e autores, e cila me angazhimet e ndërkohshme me sukses në disa projekte, ka arritur pjekurinë e një studiueseje serioze e pasionante, tipare këto të domosdoshme në punën e një historianeje që synon kuota të larta.

Monografia "Kur historia ndau dy popuj fqinj. Shqipëria dhe Greqia (1912-1914)" është hartuar me një bazë të mirë bibliografike e arkivore, për kushtet në të cilat ka punuar autorja, duke minimizuar dukshëm pasojat e mbylljessë fqinjit tonë jugor, që, për hir të politikës, ende është vend problematik për studiuesit shqiptarë.

Fillimisht në monografi jepet një informacion që i paraprin tematikës në kronologjinë e viteve 1912-1914. Autorja sjell të dhëna interesante rreth përafrimeve dhe ndasive shqiptaro-greke në periudhën e gjallërimit të lëvizjeve kombëtare në Ballkanin e shek.XIX. Është bindës vlerësimi

i saj se, edhe pse ekzistonin faktorë objektivë për afrimin shqiptaro-grek, boshti i politikës së jashtme të Greqisë, synimet dhe veprimet për ekspansion në Shqipërinë e Jugut krijuan dasitë, që nuk do të mbylleshin, pavarësisht predispozicionit të përsëritur të përfaqësuesve të shquar të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

Në këtë kuadër bëhet fjalë për tentativat e Abdyl Frashërit për bashkëpunim në vitet 1877-1878, të Ismail Qemal Vlorës në vitet 1900-1909, për qëndrimin e dyzuar të politikës greke ndaj kryengritjeve shqiptare të viteve 1910, 1911 etj. E gjithë kjo prehistori e raporteve dypalëshe do të vijojë të trajtohet me një vëmendje e analizë kapilare të zhvillimeve të viteve 1912-1914.

Ngjarjeve të vitit 1912, parapërgatitjeve të shqiptarëve për kryengritjen e re antiosmane dhe mandej të dhënave rreth zhvillimit të saj, si edhe përpjekjeve të shqiptarëve për të siguruar mbështetje te fqinjët e tyre, znj. Dushku i ka shtuar faktet dhe analizat për qëndrimin e Greqisë. Në mënyrë të padyshimtë ato dëshmojnë se ndonëse vijonin të ekzistonin objektivisht premisat për bashkëpunim me interes të ndërsjelltë, qarqet drejtuese të Athinës, për shkak të mbështetjes në platformën e hershme ekspansioniste të Megali Idesë, ndërmorën veprime dhe u bënë palë me ato shtete që synonin të pengonin krijimin e shtetit shqiptar dhe aneksimin e trevave shqiptare. Në monografi në këtë kuadër, trajtohet ftohtë, me elegancë dhe skrupulozitet shkencor, mbështetja e Athinës për planin antishqiptar të Serbisë, futja e trupave greke në viset shqiptare, shfaqja e pretendimeve ndaj këtyre viseve në Londër, përpjekjet për të rrëzuar qeverinë e përkohshme tëVlorës dhe për të penguar stabilitetin në Shqipëri etj.

Një vëmendje të veçantë, përmes paraqitjes së dokumentacionit më përfaqësues si edhe përmes analizës së saktë, autorja i kushton përpjekjeve të diplomacisë greke për të ndikuar në vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër e mandej pranë Komisionit Ndërkombëtar për caktimin e kufirit jugor të Shqipërisë. Duke operuar me dokumente të panjohura, ose që më herët janë anashkaluar pa u kushtuar vëmendjen e duhur, znj. Dushku ka dhënë një tablo shumë realiste për zhvillimet intensive të vitit 1913 dhe fillimvitit 1914. Kombinimi i përpjekjeve diplomatike dhe ushtarake të Greqisë, në përpjekjet për të thyer faktorin shqiptar dhe për të gjetur hapësira në qëndrimet me diferenca të Fuqive të Mëdha për çështjet shqiptare e rajonale, japin me vërtetësi situatën, hap pas hapi, gjatë gjithë periudhës në fjalë.

Me shumë realizëm paraqitet nga autorja edhe qëndrimi i Greqisë në gjashtë muajt e qeverisjes së Princ Vidit. Dilemat e diplomacisë së Athinësndaj kandidaturës së Vilhelm Vidit, nxitja dhe përdorimi prej saj i "Lëvizjes Vorioepirote", janë ndërthurje shumë interesante e të trajtuara me argumente të pakundërshtueshme. Hapat e qeverisë shqiptare për të vendosur rendin në jug, roli i Komisionit Ndërkombëtar tëKontrollit, i holandezit Tomson, ndërthurja e ngjarjeve në fjalë me ato të ndodhura në Shqipërinë e Mesme, gjithashtu kanë pa dyshim origjinalitetin jo vetëm stilistik por edhe përmbajtësor të studimit. Situatën e pazakontë në Shqipërinë e kësaj kohe, që I.Kadare e shpreh artistikisht te "Viti i mbrapshtë", monografia e znj. Dushku e paraqet përmes një tabloje rigorozisht shkencore.

Do të përfundoja duke nënvizuar se mënyra e të shkruarit në monografinë "Kur historia ndau dy popuj fqinj.Shqipëria dhe Greqia (1912-1914)" është në parametrat më të mirë redaktorialë dhe frazat rrjedhin me mjaft elokuencë. Po t'i shtojmë këtij konstatimi strukturën mjaft të zgjedhur e funksionale të monografisë, padyshim fryt i këmbënguljes së vazhdueshme të autores për të përmirësuar çdo ditë e deri në çastet e fundit, gjithçka, mandej të shtojmë se argumentet dhe konkluzionet janë të qëlluara, se është pasqyruar siç dihet bibliografia e shfrytëzuar dhe monografia është pajisur me një tregues emrash të evidentuar me kujdes, atëherë është e kuptueshme pse duhet ta përgëzojmë autoren.

Autenticiteti i monografisë, që spikat veçanërisht në kap.II, III, IV, V, VI, kur trajtohet "Kryengritja shqiptare antiosmane e vitit 1912 dhe Greqia", "Shqipëria dhe Greqia në rrjedhojat e Luftërave Ballkanike", "Përpjekjet e Greqisë për të aneksuar Shqipërinë e Jugut", "Marrëdhëniet shqiptaro-greke, mars-prill 1911", "Marrëdhëniet shqiptaro-greke pas reagimit të Fuqive të Mëdha", duke i dhënë vlerë të veçantë studimit, e fut këtë botim midis arritjeve të shëndetshme të historiografisë sonë të viteve të fundit.

Miftar KURTI

KONTRIBUT I ÇMUAR PËR HISTORINË DHE HISTORIOGRAFINË SHQIPTARE

(Me rastin e 65 - vjetorit të lindjes së prof. dr. Izber Hoti)

Izber Hoti, **Në udhëkryqet e historisë dhe historiografisë shqiptare,** Instituti i Historisë, Prishtinë, 2003

Profesor Izber Hoti, është një nga historianët më të shquar shqiptar. Këtë e ka dëshmuar me veprat e tij, një nga të cilat është edhe vepra "*Në udhëkryqet e historisë dhe historiografisë shqiptare*". Vepra "*Në udhëkryqet e historisë dhe historiografisë shqiptare*" sa është voluminoze, po aq është edhe cilësore. Për këtë flasin përmbajtja dhe struktura e saj. Kur flasim për strukturën e kësaj vepre, duhet thënë se e gjithë lënda është sistemuar në tri njësi të mëdha shkrimore, të cilat mund të quhen edhe kapituj, edhe pjesë. Në këta tre kapituj a pjesë, janë sistemuar diku rreth 60 njësi a nënjësi të tjera. Kjo do të thotë se në të janë trajtuar shumësi temash dhe çështjesh që kanë të bëjnë me historinë dhe historiografinë shqiptare përgjatë dy shekujve: shekullit XIX - XX. Çështja e pazgjidhur shqiptare, përpjekjet e shqiptarëve për liri e bashkim kombëtar, LSHP, Lidhja e Dytë e Prizrenit, copëtimi i trojeve shqiptare, çështja shqiptare dhe Fuqitë e Mëdha, Konferenca e Parisit dhe çështja e Kosovës, shqiptarët nën sundimin e MSKS, çështja shqiptare në Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore, "çlirimi', pushtimi dhe ripushtimi i Kosovës (1945), LNÇ në Shqipëri dhe raportet e saj me LNÇJ dhe PKJ, synimet dhe qëllimet serbo -mëdha ndaj çështjes shqiptare, kolonizimi dhe rikolonizimi i Kosovës, shpërnguljet e shqiptarëve, roli dhe kontributi i disa personaliteteve shqiptare në çështjen kombëtare etj., janë disa nga çështjet e trajtuara në këtë libër. Janë disa nga çështjet e trajtuara, por që nuk përbëjnë tërë gamën e interesimit tematik dhe të çështjeve të trajtuara.

Këto dhe çështje të tjera të trajtuara, të cilat përbëjnë strukturën formale dhe përmbajtësore të këtij libri, janë botuar në një periudhë kohore prej 12 - 13 vjetësh: 1990 - 2003, nëpër gazeta dhe revista të ndryshme të kohës, si: *Victoria, Fjala, Kosovarja, Zëri, Veprimi, Bujku, Dielli, Shkëndija, Bota shqiptare, Bota sot, Evrozëri, Forumi etj*., të botuara brenda dhe jashtë gjeografisë shqiptare. Pra, shumica e këtyre shkrimeve që përbëjnë këtë libër janë të botuara përgjatë viteve '90-ta, por ka ndonjë që është botuar edhe pas Luftës së UÇK-së dhe çlirimit të Kosovës. Natyrisht në këtë libër gjejmë edhe shkrime, pjesë dhe vështrime të pabotuara më parë.

Tipat dhe llojet e shkrimeve, kam parasysh këtu zhanrin a llojin e shkrimit, janë të ndryshme, varësisht nga çështja që është trajtuar dhe mënyra se si është trajtuar. Ato janë: kumtesa, recensione, vështrime, studime, ese, qasje kritike, trajtesa, analiza të veprave historike, letrare etj. Në këto tipa të shkrimit janë vënë në fokus dy çështje kryesore: historia dhe historiografia shqiptare.

Në këtë libër, në fund të pothuaj çdo shkrimi, pavarësisht zhanrit, autori ka vënë titullin e gazetës a revistës ku është botuar, por edhe datën e botimit. Këto janë dëshmi që flasin për guximin dhe përkushtimin e tij profesional në kohë e rrethana tepër të vështirë. Kjo dëshmon qëndrimin e tij konsekuentë, pavarësisht sfidave, rreziqeve e rrethanave. Kjo dëshmon se edhe në rrethana të tilla një intelektual, një studiues i mirëfilltë gjen mënyra dhe shtigje për ta plasuar në opinion të vërtetën, mendimin, pikëpamjen a idenë për një çështje të caktuar. Çështjet e trajtuara në këtë libër janë çështje që lidhen me historinë, politikën, diplomacinë, filozofinë, linguistikën, etnopsikologjinë; me terminologjinë, kritikën historike, çështjet teorike etj. Temat dhe çështjet e trajtuara, sa janë të vjetra, po aq janë edhe aktuale, sa janë sipërfaqësore, pra të dukshme, po aq janë edhe të thella.

Historiani dhe historia kanë një mision, janë misionarë. Këtë e pohon edhe ky autor. Sepse, sipas tij, shkenca e historisë duhet ta formojë opinionin shoqëror. Se historia dhe historiani kanë për qëllim, për synim arsimimin, edukimin dhe vetëdijesimin kombëtar e shoqëror. Me këtë dua të them se koncepti i tij për historinë është i qartë dhe i thellë. Konceptin për historinë nuk e redukton, nuk e përkufizon vetëm si histori ngjarjesh, luftërash, betejash, konferencash, aq më tepër vetëm në histori politike. Për të historia është më shumë se kaq. Është më shumë se një disiplinë, se një shkencë. Madje mund ta quajmë edhe si një dije multidisiplinare.

Autori, siç del edhe nga ky libër, lexon, analizon e studion dokumente arkivore të ndryshme: apele, memorandume, proklamata, raporte; libra e literaturë të ndryshme për të ardhur deri te zbardhja e një çështjeje, e një të vërtete. Të gjitha këto i vë në funksion të argumentimit sa më të mirë, të mendimit sa më të thellë dhe konceptit të tij sa më të qartë për historinë a historiografinë.

Autori është shumë kërkues, është studiues i rrallë, qëmtues i madh. Duke vepruar kështu, ai vëren se në historinë dhe historiografinë shqiptare, madje dhe evropiane e botërore, ka shumë çështje të paqarta, koncepte të ndryshme, madje edhe kontradiktore e të gabuara. Prandaj, denjon të merret me çështje shumë të thella për mendjen njerëzore, me rryma e ide të ndryshme, me drejtime, ideologji, sisteme shoqërore, me botëkuptime, me hipoteza e teza; me idealizmin dhe materializmin, me Lindjen e Perëndimin, me evolucione e revolucione dhe konceptet e opinionet për to. Çështjet e ndryshme të historisë dhe historiografisë, që autori ka në fokus të këtij libri, i kundron nga aspekti historik, filozofik, teorik, kritik, analitik, sociologjik, etnopsikologjik, madje edhe semantik. Semantike, sepse, sipas tij, edhe shkenca e historisë ka semantikën e vet. Dhe për këtë ai merr shembuj konkret, sepse si në taborin e historianëve, të konceptologëve, si të Lindjes, si të Perëndimit, ka vërejtur se ka shpërpushje të mëdha idesh, shpërpushje konceptuale për historinë, historiografinë, politikën etj. Me këtë autori, vë në spikamë edhe çështjen e konsolidimit të terminologjisë, sidomos asaj të historisë dhe historiografisë sonë.

Autori i këtij libri, shpesh, çështjet e historisë dhe historiografisë i shtron për trajtim në aspektin sinkronik dhe diakronik, sociologjik e semantik. Ai, është për qasje ndaj historisë edhe në aspektin deduktiv dhe induktiv, ezoterik dhe ekzoterik, pra i hapur ndaj mënyrave, metodave e qasjes të shumanshme ndaj studimit të historisë dhe problemeve historiografike. Duke u marr me qasje të ndryshme ndaj historisë dhe historiografisë, me tema, ide, metoda, koncepte etj., ai jo vetëm që shpërfaq para nesh një varg çështjesh me të cilat duhet të merremi, por hap edhe një varg dilemash me të cilat duhet merret shkenca e historisë, sidomos ajo shqiptare.

Në këtë libër ka shumë çështje që janë trajtuar, shumë koncepte që janë bërë më të qarta. Ai këtë e arrin, sepse nuk kufizohet për t'i lexuar a trajtuar vetëm veprat e "fahut" të vet, pra që lidhen me historinë dhe historiografinë, por edhe me ato filozofike e letrare, të cilat, fatkeqësisht disa historianë i injorojnë, duke menduar se në vepra të tilla s'mund të gjesh asgjë që ka të bëjë me historinë. Ai ka mendim dhe qasje tjetër.

Me këtë, autori na përkujton "*Poetikën*" e Aristotelit, e cila, ndër të tjera, merret edhe me raportet mes historisë dhe letërsisë. Sepse, dihet botërisht dhe historikisht se historia dhe letërsia marrin dhe japin nga njëra - tjetra dhe e ndihmojnë njëra - tjetrën. Se është kështu, është mirë të lexohen, madje edhe të rilexohen shkrimet ku autori ka marrë në shqyrtim vepra letrare nga letërsia botërore dhe shqiptare të autorëve, si: Marsel Prusti, Nermin Vlora Falaski, Fan Noli, Rexhep Murtez Shala, Arif Demolli etj. Jo vetëm vepra letrare në poezi, por edhe në prozë. Madje edhe prozë tipike postmoderne, siç është romani "*Papa Global Wor(l)d*"i prof. R. M. Shalës. Natyrisht, autori nuk merret me çështje të interpretimit të tekstit letrar, por me dukuri e fenomene shoqërore, historike e filozofike. Me këtë Izber Hoti e dëshmon se është i hapur ndaj temave, koncepteve dhe ideve. Këtë dëshmon me qasjen e tij ndaj historisë dhe historiografisë në aspektin filozofik dhe komparativ.

Profesor Izber Hoti, me anë të këtij libri, dëshmon se kemi historianë shumë të mirë, kemi studiues, analistë, por edhe kritikë të historisë, por ende na mungon kritika historike. Flas për institucionin e kritikës historike, e cila presim të konsolidohet. Dhe një kontribut të veçantë në këtë aspekt autori ka dhënë me anë të këtij libri dhe librave të tjerë.

Në fund duhet theksuar se libri "*Në udhëkryqet e historisë dhe historiografisë shqiptare*", është një libër nga i cili mëson disa prej mënyrave, metodave se si duhet t'i qasesh çështjeve që kanë të bëjnë me historinë dhe historiografinë. Është një libër i rëndësishëm për studentë dhe studiues. Si i tillë do të duhej të ishte literaturë obliguese për këto kategori në Universitetet dhe Institutet tona shkencore. Sepse ky libër përbën një kontribut të çmuar për historiografinë shqiptare.

LIBËRTH ME NJË MESAZH TË THELLË

Izber Hoti, **Nismë e ndërprerë që në fillim (Adem Ismaili)**, Prishtinë, 2002

Sapo e përfundova së lexuari librin "*Në udhëkryqet e historisë dhe historiografisë shqiptare*", më ra në dorë (falë mikut tim, Sabit Sylës) një libërth, po nga ky autor, shumë i veçantë, me titull "*Nismë e ndërprerë që në fillim*", të cilin e lexova, si thonë, me një frymë. E quajta libërth, duke pasur parasysh formatin e tij, por jo përmbajtjen dhe cilësinë e tij, sepse del më shumë se një libërth. Vetë autori, ndërkaq, e quan broshurë, ndërsa tipin e shkrimit fejton. Në fakt, si përmbajtje, si

strukturë, ky libërth mund të konceptohet si libër, i cili formalisht përbëhet prej dy pjesëve. Në pjesën e parë autori flet për fatin e një të riu 18 vjeçar, Adem Ismailit, nga Druari i Vushtrrisë, i cili, në vitin 1958, ishte akuzuar për shkak se, së paku, kishte guxuar të ëndërrojë lirinë, madje duke përmendur edhe kryengritjen si gjë të mundshme, pse jo dhe të domosdoshme. Kjo ishte bërë duke shkruar një roman. Ai roman në dorëshkrim u bjen në dorë njerëzve të sigurimit. Ndaj tij pason akuza. Në pjesën e dytë të këtij libri, pa të cilin libërthi do të mbetej gjysmak, rrëfen ai, ndaj të cilit i është bërë akuza, Adem Ismaili. Edhe pse nuk kemi të bëjmë me libërth letrar, këtu rrëfimi zhvillohet së paku në dy nivele. Në nivelin e parë, Izber Hoti, rrëfen për përmbajtjen e dosjes që gjen në Arkiv, i cili, duke folur për fatin e një të riu shqiptar dhe dorëshkrimin e tij, në fakt flet për gjendjen e shqiptarëve nën ish-Jugosllavinë Mbretërore dhe atë sllavo - komuniste, të Titos. Në nivelin e dytë, rrëfen vetë protagonisti, duke evokuar kujtime për mënyrën se si dhe për çka u akuzua ai.

Ky libërth, që autori e quan broshurë, është ndërtuar mbi bazën e materialeve arkivore (një romani në dorëshkrim), mbi dokumente, që janë dy fletore, të vulosura, të ruajtura në arkiv. Këtu kemi dhe fotografi e faksimile dokumentesh. Këtu kemi dhe kujtimin e protagonistit në formë kujtimesh. Kemi analiza, komente, opinione për dorëshkrimin dhe përmbajtjen e tij të vetë profesor Izber Hotit. Këto janë të mjaftueshme për të dëshmuar se kemi të bëjmë me fakte historike, me një ngjarje të errët në historinë e shqiptarëve, për vitet ’50 të shekullit XX, kur shqiptarët pothuaj s’kishin asnjë të drejtë, madje as të drejtën që të jetojnë të lirë. Mbi ta rëndonte “faji” historik se ishin shqiptar, se kishin lindur e jetonin me shekuj në këto troje.

Motivet që e kanë shtyrë prof. Izber Hotin ta bëjë këtë libërth, nuk janë personale, as materiale, por profesionale. Thjesht për të dëshmuar një të vërtetë, për të zbardhur sa më shumë që të jetë e mundur të vërtetën për jetën e shqiptarëve në ish-Jugosllavi në një periudhë historike, duke marrë shkas nga fati i një individi. Është një libërth që lexohet me një frymë, por që përçon një mesazh të thellë.

Si përfundim, këto dhe veprat e tjera janë dëshmi e mirë se profesor Izber Hoti, është historian i dëshmuar. Është historian, është analist i mirë, kritik i rreptë, por shumë i drejtë dhe korrekt. Ai është i pa kompromis në argumentim. Edhe kur s’pajtohet me disa qasje, ai nuk është nihilist, por nuk është as glorifikues. Është i thellë në mendime, korrekt në vlerësime. Ai ka guximin intelektual ta zbulojë të vërtetën, ta thotë e mbrojë atë. Është vrojtues e vëzhgues i thukët e i kujdesshëm i

dukurive dhe fenomeneve shoqërore dhe historike. Ai është i arsyeshëm edhe kur reagon ashpër. Është i qartë dhe bindës edhe kur trajton çështje të thella historike e historiografike. Është shumë kritik për "gjuhën e vështrimeve dhe recensioneve" të kohëve të fundit, për të cilat thotë se është gjuhë panagjerike, e lëvdatës, e retorikës, patriotike e politike. Ai është mosdurues ndaj një gjuhe të tillë.

Krejt në fund, duhet thënë se profesor Izber Hoti, për punën, përkushtimin dhe veprimtarinë e tij shkencore meriton respekt dhe mirënjohje të thellë për gjithë atë që ka bërë deri sot.

Teuta SHALA – PELI

AKTIVITETET E INSTITUTIT TË HISTORISË - PRISHTINË, GJATË VITIT 2013

I. Promovimet, konferencat shkencore

Në nëntor të vitit 2013 Instituti i Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë në bashkëpunim me Institutin e Historisë - Tiranë, në vazhdën e aktiviteteve shkencore organizuan: Promovimet e veprave dhe revistave shkencore të Institutit të Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë dhe të Institutit të Historisë Tiranë, si dhe Konferencën Shkencore "Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore". Mbajtja e këtyre dy aktiviteteve të përbashkëta dëshmon për një bashkëpunim të mirëfilltë shkencor në mes të dy instituteve shkencore, atij të Tiranës dhe të Prishtinës, në fushën e dijes e të shkencës së historisë në përgjithësi.

1. Promovimet

Më 18 nëntor 2013 në Prishtinë, në organizim të Institutit të Historisë "Ali Hadri - Prishtinë dhe Institutit të Historisë në Tiranë, u mbajt promovimi i botimeve shkencore të dy instituteve gjatë viteve 2012 - 2013. Për veprimtarin botuese të të dy instituteve folën studiues nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia, me ç'rast u promovuan këto botime:

Akademik Beqir Meta, pasi bëri një vështrim mbi veprimtaritë studimore e botuese të Institutit të Historisë më 2012 - 2013, foli edhe për monografinë e autorit Jani Sota, "*Zhvillimet arsimore në rrethin e Fierit (1945 - 1963)*". Ndërsa, Arben Arifi, prezantojë veprimtarinë botuese të Institutit të Historisë - Prishtinë gjatë vitit 2012 - 2013.

Ledia Dushku, foli për librin, "*Kur historia ndau dy popuj fqinj. Shqipëria dhe Greqia 1912 - 1914*", si dhe për revistën "Studime historike", nr. 3 - 4 /2011 dhe nr. 1 - 2 /2012. Hamit Kaba, prezantoi

monografinë e prof. assoc. dr. Sabit Syla, "*Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës 1939 - 1981*".

Sonila Boçi, foli për librin, "*Minoritetet kombëtare në Shqipëri midis identitetit dhe integrimit (1939 - 1949*)", si dhe për librin e Edmond Malaj, "*Hebrenjtë në trojet shqiptare* (Me një përqendrim në historinë dhe kulturën hebraike)". Halim Purellku**,** foli për librin, "*Zona e pushtimit jugosllav në Shqipëri (1918 - 1921)*". Sabile Keçmezi - Basha prezantoi monografinë e Sabit Sylës, "*Arsimi shqip në Mitrovicë 1990 - 1999*".

Ndërsa, Haki Kasumi prezantoi studimin e Izber Hotit, "*Konferenca e Paqes në Paris (1919 - 1921) dhe çështja e viseve të pushtuara shqiptare*". Ibrahim Gashi, prezantoi studimin e Sabile Keçmezi - Basha, "*Programet politike të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare 1878 - 1990*". Ndërsa, Jusuf Osmani prezantoi studimin tjetër të Sabile Keçmezi - Basha, "*Veprimtaria atdhetare ilegale në Anamoravë 1945 - 1968*". Marenglen Verli prezantoi korpusin me dokumente "*Shqipëria në dokumentet austro - hungareze (viti 1912),* vëll. II, III, IV, V, VI, si dhe këto monografi: Syrja Vlora, "*Kujtime - Nga fundi i sundimit osman në Luftën e Vlorës"*; Franc Nopça, "*Pikëpamjet fetare, doket dhe zakonet e Malcisë së Madhe*"; Franc Nopça, "*Fiset e Malësisë së Shqipërisë Veriore dhe e drejta zakonore e tyre*"; Muhamet Shatri, "*Dokumente britanike për çështjen shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër (1912 - 1913)*". Hamit Kaba, prezantoi vëllimin e Sabit Sylës, "*Dokumente diplomatike të Qeverisë shqiptare për Demonstratat e vitit 1981 në Kosovë*". Izber Hoti foli për vëllimin e Muhamet Shatrit, "*Dokumente franceze për Shqipërinë dhe shqiptarët më 1912",* vëll. II. Muharrem Dezhgiu prezantoi vëllimin me dokumente të Dritan Egro, "*Ligji Osman ndër shqiptarët e mesjetës së vonë (gjysma e dytë e shek. XV - fillimshekulli XVII)*".

2. Konferenca shkencore "Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore"

Instituti i Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë, në bashkëpunim me Institutin e Historisë Tiranë, më 19 nëntor 2013 në Prishtinë, organizuan Konferencën shkencore "Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore", ku morën pjesë gjithsej 23 studiues nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia. Fjalën e hapjes së Konferencës shkencore e mbajti, Sabit Syla u.d. drejtori i Institutit të Historisë - Prishtinë. Konferenca shkencore

"Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore", i zhvilloi punimet në dy seanca.

Në seancën e parë u lexuan 11 kumtesa, ndërsa në seancën e dytë 12. Me kumtesën e akademik Beqir Metës, "*Shqiptarët në optikën e forcave të majta dhe të djathta greke gjatë Luftës së Dytë Botërore*",f illuan punimet e Konferencës shkencore. Në kumtesën e tij akademik Beqir Meta, u përqendrua kryesisht në qëndrimet e forcave politike greke gjatë luftës ku sipas tij qëndrimet e forcave politike greke gjatë luftës pavarësisht nga nuancat midis tyre, ishte nacionalist dhe me tipare të qarta shovene dhe antishqiptare. Hakif Bajrami, prezantoi kumtesën, "*Programet serbe për likuidimin e shqiptarëve 1941 - 1945*", ku u përqendrua tek programet serbe të hartuara gjatë viteve 1941 - 1945, të cilat kishin për qëllim likuidimin e shqiptarëve. Referuesi i radhës Muharrem Dezghiu, mbajti kumtesën, "*Çështja kombëtare shqiptare dhe bashkëpunimi i LNÇ shqiptaro - jugosllave gjatë Luftës së Dytë Botërore*", duke vënë në dukje se pozita e shqiptarëve para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, përbën një veçori që duhet marrë domosdoshmërish në konsideratë, për trajtimin objektiv të qëndrimit të tyre gjatë luftës.

Ana Lalaj, prezantoi kumtesën, "*LANÇ një debat i hapur: roli i britanikëve*", në të cilën potencoi faktin se për rolin e britanikëve gjatë dhe pas luftës, në historiografinë shqiptare nuk është shkruar pak, e keqja është se kjo çështje ka qenë ndoshta më e politizuara nga të gjitha temat e luftës, kësisoj dhe nga më të deformuarat. Fejzulla Shabani, u paraqit me kumtesën, "*Veprimtaria e organizatave politike në trevat lindore shqiptare dhe lufta e tyre për bashkim kombëtar*", ku vuri në dukje se patriotët shqiptarë duke analizuar situatën politike në viset e trevave lindore shqiptare pas pushtimit fashist, filluan që të mendojnë për formën e organizimit politik - ushtarak që nënkuptonte krijimin e komiteteve të cilat do të kishin qëllime politike dhe ushtarake për të organizuar popullatën shqiptare të këtyre trevave në luftë për bashkim kombëtar.Marenglen Verli, prezantoi kumtesën "*Antifashizmi - alternativa e perspektivës për kombin shqiptar*", ndërsa Izber Hoti, paraqiti kumtesën, "*Gjendja e tashme e semasiologjisë së historisë mbi Luftën e Dytë Botërore në Kosovë*", sipas tij deri më tani në Kosovë nuk kemi histori të shkruar për Luftën e Dytë Botërore.

Sabit Syla, lexoi kumtesën, "*Qëndrimi i forcave politike dhe ushtarake të Shqipërisë ndaj Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore*", duke u përqendruar tek qëndrimi i forcave politike dhe ushtarake të Shqipërisë ndaj çështjes së Kosovës theksoi se lufta solli një alternativë

të re të momentit historik, në të cilën forcat politike dhe ushtarake në Shqipëri, ishin të ndara në qëndrimet e tyre rreth zgjidhjes së çështjes së Kosovës. Daut Bislimi, në kumtesën e tij, "*Statusi i Qarkut të Mitrovicës gjatë vitit 1941*", vuri në dukje se motivet ekonomike ishin një ndër shkaqet kryesore të okupimit të këtij territori nga okupatori nazifashist në prill të vitit 1941. Fehmi Rexhepi, prezantoi kumtesën,"*Lufta e shqiptarëve të Kosovës për çlirim e bashkim gjatë LDB*", në të cilën theksoi se me fillimin e Luftës së Dytë Botërore dhe me zhvillimet e asaj periudhe u krijuan parakushte për rishqyrtimin dhe zgjidhjen e problemit kombëtar të popullit shqiptar, problem ky që nuk ishte zgjidhur me krijimin e shtetit të pavarur shqiptar më 1912.

Eva Babameto, u paraqit me kumtesën, "*Rezistenca e shqiptarëve nën vështrimin britanik gjatë LDB*". Qëndrimi i Britanisë së Madhe ndaj Shqipërisë pas pushtimit të saj nga Italia, nuk kushtëzohej nga ndonjë interes i veçantë, por nga politika e përgjithshme e paqëtimit, u shpreh ajo. Hamit Kaba, në kumtesën e tij, "*Studime britanike e amerikane për kufijtë e Shqipërisë pas Luftës së Dytë Botërore*", duke u bazuar kryesisht në dokumentacionin arkivor britanik, theksoi se një vështrim i thjeshtë krahasues i dokumentacionit amerikan dhe britanik për problemin e kufijve të Shqipërisë me Jugosllavinë, të çon në përfundimin se alternativat e ofruara nga SHBA-të ishin më realiste e të paanshme se ato britanike, por asnjëherë të mjaftueshme për të përmbushur aspiratat e shqiptarëve.

Sabile Basha - Keçmezi, në kumtesën, "*Karakteri kombëtar i programit të Lidhjes së Dytë të Prizrenit*", theksoi se Lidhja Shqiptare e Prizrenit e vitit 1878, u dha shqiptarëve programin kombëtar për ruajtjen e tërësisë tokësore të atdheut dhe bashkimin kombëtar, kërkesat që përbënin themelin e programeve të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në vijim. Ledia Dushku, në kumtesën e saj, "*Situata politike e shoqërore në Kosovë sipas raportit të Mazar Sopotit (12 nëntor - 9 dhjetor 1941)*", duke elaboruar raportin e Mazar Sopotit, ajo u shpreh se interesantja e raportit është se hartuesi i tij jep një pasqyrim të realitetit mbështetur në opinionin dhe perceptimet e shqiptarëve të Kosovës. Megjithatë, ai mban firmën e një nëpunësi të administratës fashiste, gjë që është e dukshme si në frymën edhe në përmbajtjen e tij.

Sonila Boçi, prezantoi kumtesën, "*Minoritetet në Shqipëri përballë sfidave të Luftës së Dytë Botërore*", ku potencoi faktin se pas pushtimit italian, minoriteteve në Shqipëri iu desh të përshtateshin me ndryshimet politike të ndodhura në planin e brendshëm. Muhamet Shatri, në kumtesën, "*Kosova u çlirua apo u ripushtua në nëntor 1944?*", vuri në

dukje se Kosova dhe trojet etnike gjatë Luftës së Dytë Botërore u gjenden përballë zhvillimeve dhe ndryshimeve të reja gjeopolitike kur ato u pushtuan nga Italia, Gjermania dhe Bullgaria, ndonëse në bisedimet rreth caktimit të zonave të pushtimit, u theksua se kriter themelor do të ishte përkatësia etnike dhe ky parim nuk u përfill në tërësi.Skender Asani, u paraqit me kumtesën,**"***Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Shkup, shtator - nëntor 1944*".Sipas tij, kjo periudhë e veprimit të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare është më rëndësi historike, ngase ndikoi në zhvillimin e vetëdijes nacionale edhe në afirmimin e çështjes kombëtare shqiptare në suaza të brendshme dhe ndërkombëtare. Etleva Goxhaj dhe Pranvera Dibra, mbajtën kumtesën, "*Pozicioni i Mbretit Zog gjatë pushtimit të Shqipërisë nga Italia*", ku vunë në dukje se Shqipëria ka qenë vazhdimisht në qendër të interesave italiane në Ballkan.

Qerim Lita, në kumtesën e tij, "*Trevat Lindore shqiptare pas kapitullimit të Italisë*", u ndal tek Kuvendi Kombëtar i cili u mbajt në Tiranë pas kapitullimit të Italisë, me iniciativën e disa intelektualëve dhe nacionalistëve shqiptarë nga të gjitha trojet shqiptare, si dhe tek Lidhja e II e Prizrenit, në të cilën morën pjesë edhe delegatët nga trevat Lindore. Zeqirja Rexhepi, mbajti kumtesën, "*Tetova dhe rrethi i saj gjatë Luftës së Dytë Botërore*". Ai vuri në pah se shqiptarët e Tetovës me rrethinë gjatë Luftës së Dytë Botërore, edhe pse në rrethana shumë të ndërlikuara, arritën të ruajnë njëfarë kohezioni të brendshëm ndëretnik.

Lush Culaj, në kumtesën, "*Vrasjet në Klinë dhe rrethinë 1944 - 1945*", duke folur për vrasjet në Klinë theksoi se vetëm gjatë një viti në Pejë dhe rrethinë që përfshinte fshatrat edhe të Klinës së sotme u pushkatuan 3 600 shqiptarë, pra thekson ai edhe pas Luftës së Dytë Botërore problemi kombëtar i shqiptarëve të mbetur nën pushtetin jugosllavo - titist u shikua në mënyrë po aq të njëanshëm sikurse edhe në Jugosllavinë e vjetër. Nebi Dervishi, prezantoi kumtesën, "*Masakra e Ladorishtës së Strugës, 28 Tetor 1944*", të cilën masakër e cilësoi si një ndër ngjarjet dhe datat më tragjike e të dhimbshme të historisë sonë më të re, ku brenda disa orëve nga falanga nazifashiste u vranë dhe u dogjën 85 persona dhe me dhjetëra të tjerë u plagosën.

Nuri Dragoj, mbajti kumtesën, "*Vështrim mbi luftën italo - greke dhe pasojat që rrodhën prej saj në trevat jugore të Shqipërisë*",pasi i bëri një vështrim luftës italo - greke, ai u ndal edhe tek pasojat që rrodhën si rezultat i kësaj lufte në trevat Jugore të Shqipërisë.

Fjalën e mbylljes së Konferencës shkencore e mbajti akademik Beqir Meta, drejtor i Institutit të Historisë - Tiranë. Pjesëmarrësit e Konferencës shkencore më 20 nëntor, bënë një vizitë në Kompleksin memorial, “Adem Jashari”, në Prekaz.

INSTITUTI I HISTORISË “ALI HADRI” - PRISHTINË

KOSOVA

39
2014

Redaktore gjuhësore:
Shqipe Doda

Rezymetë i përktheu:
Mrika Limani

Arti grafik:
Teuta Shala –Peli

Tirazhi: 500 copë